

www.enverhoxha.info
ENVER NOXHA

*Kur u hodhën
themelet
e Shqipërisë se re*

**KUJTIME
DHE SHËNIME HISTORIKE**

BOTOHET ME RASTIN

E 40-VJETORIT TE ÇLIRIMIT TË ATDHEUT

DHE TË FITORES SË REVOLUCIONIT POPULLOR

NË VEND TË HYRJES

Në historinë shumëshekullore të Shqipërisë, pushteti ynë popullor dhe uniteti monolit i popullit tonë, i konkretizuar në organizatën e Frontit Demokratik, janë dy riga arritjet më të mëdha e më të ndritura, dy riga veprat më monumentale të epokës së Partisë.

Të dyja këto vepra monumentale e të pavdekshme, ashtu si vetë Partia, që ishte dhe mbetet përherë truri dhe zemra e tyre e fuqishme, nuk lindën në salla luksoze, nuk ishin produkt i «mendjeve» të zhytura nëpër kolltukë kafenesh apo parlamentesh. Jo, ato lindën riga gryka e pushkës partizane në zjarrin e luftës për liri, u rritën në gjirin e popullit dhe Beli të tyre u bënë shtëpitë e thjeshta të popullit.

Sot riga lartësia e mbi katër dekadave, ne komunistët shqiptarë ndihemi krenarë se qysh riga ditët e krijimit e vazhdimisht Fronti Demokratik i Shqipërisë dhe pushteti ynë popullor, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme, i kanë kryer me rider detyrat e misionin e tyre para popullit e atdheut, u kalitën përmes betejash e provash riga më të rëndat, përballuan e bënë të dështonin planet e gjithë armiqve të brendshëm e të jashtëm, janë kthyer në kështjella të pamposhtura të socializmit fitimtar, të jetës së re e të bukur që lulëzon në Shqipëri.

Lart e më lart do të ngrihet nderi e lavdia e tyre edhe në të ardhmen, sepse në themelet e Frontit dhe të pushtetit tonë është derdhur gjaku i 28 000 djemve e vajzave nga më të mirët e kësaj toke, sepse ata janë ngritur, rritur e betonuar me djersë, mund, përpjekje e sakrifica të panumërta nga populli e nga Partia jonë. Ata kanë qenë e do të mbeten përjetë krijesa të pacenueshme të popullit, mbrojtës e shprehës të aspiratave të larta të tij dhe gjithmonë do t'i inspirojë e do t'i përshkojë si fill i kuq vija dhe ideologjia marksiste-leniniste e Partisë sonë të Punës.

Se si arritëm ne t'i krijojmë e t'i ndërtojmë këto vepra të pavdekshme, kjo është një histori e tërë. Dokumente të shumta të asaj kohe, përveç dëshmisë së gjallë të punës e të luftës sonë për krijimin e Frontit dhe të pushtetit, përbëjnë në njëfarë mase edhe historinë e parë të shkruar të procesit të lindjes e të ndërtimit të tyre. Më pas, në vitet e Çlirimit, kaq e kaq herë është shkruar e folur për to e

për krejt atë periudhë të lavdishme të historisë sonë, kur populli, i ndriçuar e i udhëhequr nga Partia, arriti të çlirohte edhe atdheun nga vargonjtë e huaj, edhe veten nga çdo shtypje e shfrytëzim klasor. Jeta dhe vepra e këtyre dy arritjeve tona kolosale do të vazhdojnë në shekuj, por nuk do të harrohen kurrë kohët e para, momentet kur u hodhën themelet, kur në zjarrin e luftës u krijuan Fronti Nacionalçlirimtar dhe pushteti popullor. I jemi kthyer e rikthyer kaq herë asaj periudhe të paharruar, jo për nostalgji, por për ta ndriçuar problemin nga të gjitha anët e për t'ua bërë sa më të qartë e më konkrete brezave të rinj se si arritëm ne, prindërit e tyre, të përmbysnim të vjetrën e të ngrinim të renë.

Këtë qëllim kanë edhe këto shënime të miat, të shkruara herë pas here, në formë kujtimesh e shënimesh historike, që tash po i jap për botim.

Në vigjilje të 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e të triumfit të revolucionit popullor, ato janë edhe një nderim i madh për veprën e shquar të Partisë e të popullit tonë në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, edhe një freskim i ri i së kaluarës, e cila gjithnjë ka qëndruar në bazë të së ardhmes, gjithnjë i ka shërbyer dhe ka ndriçuar të ardhmen.

Gusht 1984

I

FRONTI NACIONALÇLIRIMTAR - FRONT LUFTE E BASHKIMI

Lindja e Partisë Komuniste të Shqipërisë më 8 Nëntor 1941 si një rrymë e fuqishme gjallëroi energjitë e popullit shqiptar, i zgjoi atij shpresat për të ardhmen dhe armiqtë e tmerroi.

Kjo ishte një ngjarje vendimtare në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar, veprimi më i rëndësishëm, sepse për herë të parë në udhëheqje të popullit tonë ishte vënë Partia e klasës punëtore, e vetmja Parti që, duke pasur si udhërrëfyese ideologjinë e saj revolucionare, do t'i printe popullit në luftë dhe në fitore.

Ky moment historik u reflektua shumë shpejt në luftën e popullit shqiptar, e cila erdhi duke u fuqizuar dhe duke u organizuar përherë e më mirë.

Ne komunistët e pritëm me gëzim dhe entuziazëm këtë fitore të madhe, për të cilëri kishim ëndërruar e luftuar prej kohësh. Tani ne kishim Partinë që do t'i drejtonte të gjitha përpjekjet tona, do të na mësonte e do të na edukonte, do të na udhëhiqte në luftën për çlirimin e atdheut dhe, më vonë, drejt realizimit të idealit tonë të lartë, komunizmit.

Para Partisë së sapoformuar dilnin detyra të shumta e të mëdha.

Lidhja me popullin, njohja e masave me programin e qëllimin e Partisë, mobilizimi dhe organizimi i tyre në luftën për jetë a vdekje me pushtuesit fashistë dhe tradhtarët vendas, ishte një ndër këto detyra, bile nga më kryesoret e më të rëndësishmet. Pa popullin, pa masat asgjë nuk mund të realizojë një parti komuniste, qoftë kjo e sapoformuar apo me stazh të gjatë jete e veprimtarie.

Ne komunistët shqiptarë e kishim të qartë këtë aksiomë të marksizëm-leninizmit. Ajo që e vështirësonte punën tonë ishte fakti se, në kushtet e rënda të pushtimit e të terrorit, duhej të dilnim para popullit, ta bënim për vete, ta organizonim e ta udhëhiqnim në një kohë kur na duhej të organizoheshim edhe vetë, të ndërtonim e të kalitnim Partinë, ta afirmonim në luftë si forcë udhëheqëse të aftë, të sigurt e të pazëvendësueshme.

Ky ishte një rast pa precedencë në histori, por, si të thuash, ky qe «fati» ynë. Të pritnim sa të forcohej e të rritej Partia, sa të shtrihej ajo në gjithë anët e vendit, të bënim një punë vetëm

brendapërbrenda Partisë e pastaj t'i drejtoheshim popullit me programin tonë për luftë, kjo do të ishte katastrofike jo vetëm për Partinë, por edhe për fatet e popullit e të atdheut. Ndaj, të ndërgjegjshëm për situatat që kalonim e vështirësitë që kishim, nuk pritëm. U hodhëm menjëherë në veprim, duke u vënë gjoksin njëherësh të gjitha detyrave, midis tyre edhe asaj për ta bërë popullin të ndërgjegjshëm e për ta bashkuar në atë njësi luftarake, e cila shpejt do të merrte emrin Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar i Shqipërisë.

1. Themelet e bashkimit

Gjatë historisë së tij shumëshekullore populli shqiptar kurdoherë është përpjekur dhe ka luftuar për të qenë i bashkuar përballë çdo invazioni që i kërcënonte lirinë dhe tokën amtare. Kjo traditë kaloi brez pas brezi si një mësim e testament i madh dhe pikërisht këtu duhet kërkuar një nga burimet e vitalitetit të popullit tonë, e zotësisë së tij për të përballuar armiq e pushtues nga më të egrit e më të fuqishmit dhe për të mos u asimiluar prej tyre. Në momentet e rënda që po kalonte atdheu, përballë rreziqeve që kërcënonin ekzistencën e tij, ne komunistët pa dyshim që do të mbështeteshim fort në traditat e pasura patriotike dhe luftarake të popullit tonë, në prirjen dhe gatishmërinë e tij për të qenë i bashkuar në luftën për Tiri. Shembujt e periudhës së Skënderbeut, të përpjekjeve të rilindësve tanë të shquar, të Lidhjes famëmadhe Shqiptare të Prizrenit, të kryengritjes së përgjithshme popullore që i solli Shqipërisë pavarësinë etj., do të na frymëzonin jo vetëm ne komunistët, por edhe mbarë popullin e ndershëm, patriot, që i dhimbsej fati i atdheut.

Përveç kësaj, në misionin e madh që kishim përpara do të na ndihmonte edhe diçka tjetër.

Ideja dhe thirrja e Internacionales Komuniste për krijimin kudo të Frontit Antifashist, kishte vite që edhe në Shqipëri përbënte një ndër temat e debateve e të preokupimeve kryesore të komunistëve më të mirë të kohës së grupeve. Në mënyrë të veçantë Grupi Komunist i Korçës, sidomos pas mbërritjes së udhëzimeve të Kominternit në vjeshtën e 1937-s, i shtoi përpjekjet për t'u larguar nga puna e mëparshme e mbyllur e sektare, për t'u lidhur më shumë me masat nëpërmjet organizatave të rinisë, shoqërive punëtore etj. dhe për krijimin e një «blloku demokratik», i cili edhe fitoi në zgjedhjet bashkiake në Korçë. Po ashtu edhe grupet e tjera, veçanërisht ai i Shkodrës, kishin krijuar disa lidhje e mundoheshin ta shtrinin influencën e tyre në radhët e intelektualëve, të nëpunësve, oficerëve e, diçka më pak, edhe në rrethet e kufizuara punëtorësh. Por të gjitha këto ishin shumë pak dhe, pas goditjeve që pësoi lëvizja demokratike e revolucionare në Shqipëri në verën e vitit 1935 me atë që quhet «Lëvizja e Fierit» e, në fundin e vitit 1938, kur u arrestuan e u çuan në gjyq thuajse gjithë anëtarët e Grupit të Shkodrës, duhet thënë se sëmundja e vjetër e konspiracionit të kalbur dhe e mbylljes së grupeve në vetvete, larg njëri-tjetrit, e sidomos larg masave, u bë akoma më e dukshme.

Këtë situatë të rëndë e të dëmshme të lëvizjes sonë komuniste e tronditi nga themelet pushtimi fashist i vendit në prill 1939. Ne e ndiem menjëherë dhe e kuptuam më mirë se kurrë se nuk do të ishim në gjendje ta organizonim si duhej rezistencën ndaj pushtuesit, sepse vetë ishim ende të përçarë, pa një organizim e program të qartë e revolucionar dhe ende s'njiheshim e s'kishim bërë për vete masat, në atë shkallë që ato të na ndiqnin pas të ndërgjegjshme. Ishte e domosdoshme të hidheshin tej, në rrugë revolucionare, këto dobësi, si kusht vendimtar edhe për të krijuar Partinë tonë Komuniste, edhe për t'u afruar e për t'u lidhur me masat.

Komunistët shqiptarë të asaj periudhe, sidomos baza e grupeve, në situatat e reja që u krijuan pas pushtimit, i kuptuan drejt këto detyra dhe, paralelisht me përpjekjet për krijimin e Partisë, shtuan e intensifikuan edhe përpjekjet për t'u njohur e për t'u lidhur me masat. Vërtet kjo ishte një punë ende e paorganizuar dhe e pakoordinuar, vërtet, sidomos në fillim, bëhej edhe nga pozitat e «fitimit të influencës» Y dhe e një lloj «gare» me grupin tjetër, por, sidoqoftë, kishte rëndësi fakti se elementët komunistë nisën të hyjnë në popull, të njiheshin nga populli e të njihnin popullin.

Personalisht ruaj nga kjo kohë, veçanërisht pasi erdha me punë në Tiranë në janar 1940, kujtimet më të mira e më të paharruara. Marrëdhëniet e përditshme me punëtorët e fabrikës «Flora» e, ca më tepër, puna direkte në dyqanin «Flora», me mundësitë e mëdha për lidhje me elementë të shtresave

më të ndryshme, bënë që shumë shpejt të krijonim rreth vetes një aktiv të gjerë punëtorësh simpatizantë. Duke u afruar me ta përmes një pune të pandërprerë e të kujdesshme, ne gradualisht e zgjeruam rrethin me shokë të tjerë punëtorë, me zanatçinj, të papunë, e me rrethin e tyre familjar e farefisnor. Nëse si shkas për njohje shërbenin marrëdhëniet e punës së përbashkët ose të përafërt, si bazë për forcimin e kësaj njohjeje shërbenin bisedat politike kundër pushtuesit, që ne, si gjoja rastësisht, i hapnim sa herë na jepej mundësia. Natyrisht, në hapjen e në thellimin e këtyre bisedave, veçanërisht me të porsanjohurit, kishte edhe rreziqe, por më ka mbetur i pashlyeshëm e domethënës një fakt: thujse asnjëherë, as unë e as shokët e tjerë të grupit që punonim në Tiranë, nuk gjetëm kundërshtim, bile as frikë nga ana e shokëve punëtorë për ato që u thoshim. Përkundrazi, sapo ne hidhnim shkëndijën, ishin ata që gjenin rastin e shfrenin mllefën e urrejtjes e thellë ndaj uzurpatorëve të lirisë e të pavarësisë së atdheut, ishin ata që me logjikën e klasës nuk kënaqeshin vetëm me shfrenimin e urrejtjes, por edhe pyetnin «Si t'ia bëjmë?».

Kjo situatë që e hasnim kudo, na mbushte me besim dhe na shtynte të punonim më me forcë edhe për themelimin e Partisë, edhe për të menduar se si ta organizonim e ta drejtonim urrejtjen popullore që grumbullohej e bëhej gati të shpërthente.

E tillë ishte situata në gjithë vendin. M'u desh të lëvizja në atë periudhë në shumë qytete e qendra punëtore, si: në Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Kuçovë etj. dhe kudo shihej qartë urrejtja dhe gatishmëria në rritje e punëtorisë shqiptare për të luftuar kundër pushtimit e shfrytëzimit të fashistëve italianë. Të njëjtën gjendje raportonin në mbledhjet që bënim shokët e tjerë të grupit tonë komunist, të njëjtin vlerësim kishin për situatat në vend edhe militantët e shquar të Grupit Komunist të Shkodrës, Vasil Shantoja e Qemal Stafa, me të cilët, duke filluar nga vera e vitit 1940, u lidhëm në një shoqëri e miqësi të pathyeshme.

Ndonëse jo me përmasat e intensitetin e punës në qytet, ne qysh në këtë fazë filluam të futeshim edhe në fshat dhe ndiem qartë se edhe atje ziente po ajo situatë e gjendje si edhe në radhët e punëtorëve, të çirakëve e të të papunëve të qyteteve.

Sa për rininë, veçanërisht atë shkollorë e studenteske, duhet thënë se ajo ishte plotësisht e gatshme t'i ndiqte pas komunistët në çdo aksion e veprim. Ndjenjat e zjarra të atdhedashurisë, të goditura rëndë nga gjendja e pushtimit, e kishin bërë rininë tonë të papërmbajtur në kundërshtimet e protestat e saj të hapura, të cilat shpreheshin thujse çdo ditë në rezistencën masive kundër italianizimit e fashizimit të shkollës, në refuzimin demonstrativ për të përshëndetur «ala romana», në bojkotimin e mësimit të doktrinës fashiste, të gjuhës italiane, të organizatave e shoqatave korruptuese që mundoheshin të krijonin fashistët etj.

Kështu, dulce u nisur nga ideja e domosdoshmërisë së një fronti popullor antifashist (i cili më pas, kur u krijua, mori emrin e tij «zyrtar » Fronti Nacionalçlirimtar), dhe nga bindja e thellë se realizimi i tij qe plotësisht i mundshëm, komunistët shqiptarë kishin filluar punën në këtë drejtim menjëherë pas pushtimit fashist. Duke marrë përsipër këtë barrë të rëndë, kishim parasysh edhe mungesën e përvojës lidhur me çështjet e detyrave e të ndërtimit praktik të këtij fronti, të formave organizative të tij, por ishim të bindur e të vendosur që në punë e në luftë, veçanërisht pasi të themelonim Partinë, do ta fitonim përvojën, praktika do të na sugjeronte format e përshtatshme.

Natyrisht, në tërë këtë fazë u ndeshëm me shumë koncepte antimarksiste e me kuptime të shtrembra mbi Frontin Antifashist e mbi mundësitë e krijimit të tij në Shqipëri. Veçanërisht në radhët e Grupit të Shkodrës prej kohësh kishte elementë që kishin përhapur pikëpamje e teorizime krejt të huaja e kapitulluese për këtë problem. Kështu, për shembull, aty nga fundi i verës së vitit 1941, kur ishim në fazën e përgatitjeve intensive për themelimin e Partisë, në një bisedë që kisha me një shok të Grupit të Shkodrës, sapo nisa t'i flas për lidhjet me masat e nevojën e bashkimit të tyre në një front të fuqishëm, ky më përgjigjet fare prerë, si për diçka që s'donte diskutim:

- Fronti popullor antifashist në Shqipëri nuk mund të krijohet!

- Pse?! - e pyeta i habitur.

- Sepse te ne s'ka parti politike si në- Francë, Itali e gjetkë! Me kë do të bëhen bisedime, me kë do të arrihet marrëveshja për krijimin e Frontit, kur s'ka parti?

- E ke gabim! - i thashë. - Sipas kësaj del se te ne s'duhën bërë përpjekje, s'duhën mobilizuar masat në një njësi luftarake për përmbysjen e fashizmit.

- Kjo është specifika e vendit tonë që vjen nga prapambetja! - tha me një ndjenjë keqardhjeje shoku.

- Na kanë lënë Turqia e Zogu batall. Po të kishte parti të ndryshme, secila do të kishte influencat e veta në masat dhe partitë do të bisedonin për një front e, kur të binin dakord, masat do të futeshin automatikisht në Front!

- Po mirë, - e pyeta me durim, - sipas jush, nën influencën e kujt janë masat te ne?

- Nën influencën e askujt! - u përgjigj ai serbes.

- Jo. Gjykon shtrembër dhe nisë nga një konsideracion i gabuar për partitë, për Frontin dhe për masat, - i thashë. - Vërtet në Shqipëri masat s'janë nën influencën e ndonjë partie, por mos harro se, sidomos aktualisht, ato janë nën influencën e urrejtjes kundër pushtuesit, nën influencën e dëshirës për luftë e për Tiri, nën influencën e patriotizmit të thellë kombëtar. Pikërisht këtu duhet të kapemi ne. Bile unë mendoj se s'është një fatkeqësi, por një e mirë e madhe që te ne s'ka pasur e s'ka parti politike të organizuara. Fronti i vërtetë, fronti i çeliktë është ai që krijohet nga poshtë, nëpërmjet punës direkte me masat, duke u lidhur me to, duke u kapur pas urrejtjes që zien kundër fashizmit, pas dëshirës e gatishmërisë për luftë. Kështu ne do të gjejmë gjuhën e përbashkët me popullin, do ta prekim atje ku i dhemb e ai do të vijë me qejf pas nesh, do të bashkohet. Ky është Fronti dhe për një front të tillë duhet të luftojmë ne komunistët shqiptarë dhe Partia jonë!

- E si do ta bëjmë këtë kur akoma s'kemi një parti të organizuar? - pyeti ai.

- Për këtë po luftojmë dhe shumë shpejt edhe Partinë do ta kemi, - i thashë. - Bile domosdoshmëria e bashkimit të masave në luftë e shton akoma më tepër urgjencën për themelimin e Partisë. Me Partinë në krye do të arrijmë gjithçka.

Shoku sikur u bind nga ato që i thashë, megjithëse unë e dija se koncepte të tilla për Frontin ishin propaganduar gjatë nga elementët trockistë të Grupit të Shkodrës, bile kishin zënë vend edhe në organin e tyre të quajtur «Buletini jeshil». Ne do të ndesheshim e do t'i goditnim ashpër këto pikëpamje dhe ishim të ndërgjegjshëm se edhe gabime të tjera mund të bëheshin, por të gjitha këto në luftë e në punë do të korrigoheshin. I pakorrigjueshëm do të ishte vetëm gabimi fatal sikur ne të qëndronim duarkryq, të pritnim «të krijoheshin parti të ndryshme», «të përgatitnim kuadrot», të pritnim «formimin e proletariatit industrial» e të tjera pikëpamje të elementëve antimarksistë e grupashë, që komunistët revolucionarë i hodhën poshtë dhe, më vonë, Partia i dënoi përfundimisht. Një gabim të tillë historia nuk do të na e falte.

Formimi i Partisë na gjeti, pra, në një situatë kur te ne ishin të gjitha mundësitë objektive e subjektive për krijimin e Frontit Antifashist. Ajo që kishte më tepër rëndësi ishte fakti se në radhët e komunistëve e të kuadrove të Partisë sonë të sapoformuar, si rezultat i punës së mëparshme dhe i analizave të bëra në Mbledhjen Themeluese, po rrënjosej bindja se Frontin Antifashist të popullit shqiptar mund e duhej ta krijonte vetë Partia jonë, nëpërmjet punës direkte e konkrete me masat, pa pritur e -pa kërkuar marrëveshje e makinacione me krerë, pra, si një front nga poshtë.

Siç dihet, në Rezolucionin që aprovoi Mbledhja Themeluese e Partisë, ky bashkim u quajt «njësia luftarake në mes masave punonjëse të qytetit e-të fshatit» dhe kjo s'qe gjë tjetër, veçse vetë ideja për Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar të popullit shqiptar. Po ashtu, dokumenti i parë i Partisë sonë që doli në të njëjtën kohë me Rezolucionin, ishte Thirrja e Parë e hapur e luftarake që Partia jonë i drejtoi popullit, duke i bërë të qartë programin e saj e duke e grishur të bashkohej në luftën për Tiri e pavarësi!

Tash Partia, me forca të organizuara e të shumëfishuara, me programin e saj të qartë e luftarak, do ta thellonte e do ta zgjeronte më tej punën për të ngritur atë kështjellë të fuqishme të popullit të bashkuar, përballë forcës e vitalitetit të së cilës do të thyenin kokën edhe taborët e nazifashistëve, edhe përpjekjet e planet e reaksionit të brendshëm e të jashtëm.

Ky bashkim i masave, nën udhëheqjen e Partisë e nën flamurin e saj, do të bënte të mundur shpërthimin dhe kryerjen me sukses të revolucionit, për të cilin ekzistonin kushtet në Shqipëri.

Regjimi feudal i Zogut, shtypja, mjerimi, uria, burgimet, vjedhjet ia kishin sjellë shpirtin në majë të hundës popullit, e kishin zemëruar, egërsuar dhe mbushur me urrejtje për atë regjim. Tamam kur

revolta e zemërimi i masave zënj, pushtimi i vendit, i përgatitur nga Zogu dhe nga feudo-borgjezia, e mbushi kupën plot. Urrejtja e popullit dhe lufta antagoniste në mes shtypësve dhe të shtypurve tashmë arritën kulmin. Pushtimi i Shqipërisë nga fashizmi italian kishte shënuar kështu fillimin e një kthese me rëndësi kornbëtare. Kjo situatë duhej kuptuar e duhej trajtuar drejt, sepse ishte e mbarësuar me revolucion. Tamam këtë situatë e kuptuan komunistët shqiptarë dhe Partia e tyre dhe vendosën t'i dilnin gjendjes zot e të bëheshin udhëheqësit e revolucionit. Partisë sonë Komuniste i takoi, pra, barra historike e rëndë, e vështirë, por e lavdishme: të ngrinte popullin në revolucion, ta udhëhiqte në luftë për çlirimin e atdheut dhe ta çonte në fitore atë dhe klasën punëtore, pararoja e së cilës ishte ajo vetë.

Lenini na mëson se revolucioni është çështje nga më seriozet për fatet e një populli, prandaj po iu fute atij, i duhet shkruar deri në fund.

Në qoftë se nuk ngrihet populli në luftë kundër pushtuesve ose kundër sunduesve e shfrytëzuesve borgjezë kapitalistë, në qoftë se nuk përgatitet populli politikisht kundër atyre që duhet t'i luftojë dhe t'i rrëzojë, në rast se në këtë përgatitje nuk studiohen dhe nuk analizohen raportet e forcave në veprim, nuk mund të ketë revolucion; në këto raste mund të ketë përpjekje, mund të ketë rezistencë, që do të ishte kaotike dhe e përkohshme, por jo revolucion dhe jo arritje të objektivave që kërkon një revolucion, qoftë kryengritje fshatare, qoftë revolucion demokratiko-borgjez, qoftë revolucion proletar.

Revolucionet duhet të kenë një platformë programatike, e cila t'u tregojë masave caqet që duhen arritur, arsyet pse duhet ndryshuar një gjendje në një gjendje tjetër. Dialektikisht u duhet shpjeguar atyre pse duhet kapërcyer nga një etapë në tjetrën, pse janë pjekur kushtet për një kapërcim të tillë cilësor, u duhet bërë masave e qartë, në bazë të një analize reale ekonomike, politike, nacionale, cilat janë arsyet që e mbushën kupën sa të derdhet dhe u duhen bërë të qarta rrugët nga do të ecet dhe mjetet që do të përdoren për ta bërë këtë kapërcim cilësor. Më së fundi duhet bërë e qartë se, duke i analizuar të gjitha këto, ky kapërcim, kjo kthesë vendimtare, nuk mund të realizohet veçse me kryengritje të armatosur, me revolucion.

Musolini, pasi e hodhi çapin kundër Shqipërisë në prillin e vitit 1939, shpresonte e ishte i bindur se çdo gjë do të kalonte ashtu si e kishte planifikuar ai. Por ndodhi e kundërta. Asnjë parapërgatitje e tij nuk mund ta gënjente e as ta përkulte popullin shqiptar. Historia nuk kishte njohur ndonjëherë që populli shqiptar ta kishte pranuar robërinë e të huajve. Ajo njihte vetëm luftëra të pareshtura të popullit shqiptar kundër tyre.

S'kishte asnjë dyshim se kështu do të ngjiste dhe këtë herë, por kjo duhej bërë realitet, kjo luftë duhej organizuar. E lehtë nuk ishte, por edhe e pamundur jo. Megjithatë lufta do të ishte e egër. Kjo luftë edhe do t'u ngjiste luftërave të kaluara çlirimtare të popullit ton' për nga vendosmëria, patriotizmi, nga qëllimi i madh i çlirimit, por edhe nuk do t'u ngjiste nga strategjia, taktika, madhësia, organizimi. Kohët në të cilat do të organizonim luftën, nuk ishin më ato të prindërve dhe të gjyshërve tanë: përballë kishim po të njëjtët armiq, të egër, kriminelë, të rafinuar në ideologji, në politikë, në metoda e në veprime, por edhe të armatosur deri në dhëmbë me armë nga më modernet, shkatërruese dhe dëmprurëse në çdo drejtim, që nuk ishin parë në kohët e mëparshme.

Nazifashistët, duke e propaganduar me të madhe një forcë të tillë shkatërruese goditëse, synonin të kallnin panikun para se forcat e tyre të ndërmeronin goditjen. Psikologjia e tmerrit dhe «kolona e pestë» ishin dy armë ndër kryesoret që u paraprinin legjioneve të Romës dhe të Berlinit.

Por popujt, në unitet dhe të bashkuar rreth idealeve e qëllimeve të qarta, të udhëhequr drejt e me guxim, do të fitonin në këtë luftë vigane që i kishte pllakosur. Popujt që kishin vendosur të jetonin të lirë, do të fitonin mbi armët moderne të armikut dhe mbi ushtritë e tij, pse të parët bënin një luftë të drejtë dhe në vendin e tyre, kurse të dytët një luftë jo të drejtë, grabitqare dhe në një vend të huaj. Partia jonë i kishte të qarta në vija të përgjithshme këto situata dhe bashkë me popullin hynin në luftë jo të papërgatitur, sepse që nga 7 prilli i vitit 1939 dhe deri më 8 nëntor të vitit 1941 kishin kaluar në tepër se dy vjet që kishte filluar rezistenca pasive dhe aktive kundër pushtuesve dhe kuislingëve shqiptarë.

Rezistenca e popullit dhe, në radhë të parë, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kundër regjimit të Zogut, pas pushtimit të vendit, u kristalizua më shumë dhe mori formë më të avancuar. Armiqësia dhe rezistenca e punëtorisë dhe e fshatarësisë shqiptare kundër regjimit të Zogut, të pleksura tarli me ndjenjën e çlirimit kombëtar, ishin baza ku u mbështetën Partia dhe udhëheqja e saj për të mobilizuar vullnetin e kombit, forcën e popullit, mendimet, aspiratat, dëshirat e tij në një unitet luftarak për çlirimin e atdheut dhe të popullit.

Është lehtë ta thuash me fjalë, por Partisë i janë dashur mundime e sakrifica, guxim e heroizma, urtësi e durim në mendime e në veprime për ta realizuar këtë program.

Duhej krijuar, në radhë të parë, besimi i popullit në forcat e veta. Duhej shkukur nga mendja e mjaft njerëzve ideja se nuk mund të përballohej një fuqi kaq e madhe, siç ishte Italia fashiste, se «nuk luftohet 1 milion kundër 40 milionëve», ide që e propagandonin dhe e frynin «kolona e pestë», bashkëpunëtorët, kuislingët e pushtuesit, prania e divizioneve dhe e tankeve që kishte përqendruar ai në çdo anë të vendit.

Populli duhej bindur me fakte, me aksione, me politikë dhe me propagandë se as trimëria, as guximi, as atdhedashuria, as mendimi i qartë politik i shqiptarit, i të parëve tanë, nuk ishin shuar, por ishin më të zjarrtë se kurrë. Dhe Partia Komuniste e Shqipërisë, që ishte bartëse e të gjitha këtyre vetive të shquara të popullit tonë, do të lëshonte rrufetë mbi armiqtë pushtues.

Në të njëjtën kohë Lufta Nacionalçlirimtare që merrte përsipër të udhëhiqte Partia, duhej të kishte qëllime të qarta, një program të pranueshëm nga populli ynë, program që të ishte mobilizues dhe gjallërues i energjive të shëndosha. Populli, e në radhë të parë klasa punëtore dhe fshatarësia, duhej të dinte e të kuptonte përse luftonte dhe ç'do Vi sillte atij fitorja. E kaluara e hidhur, kur luftërat dhe kryengritjet e popullit shtypeshin me gjak nga feudalët, agallarët dhe fajdexhinjtë, ishte e freskët në kujtesën e tij. Populli nuk mund të ngrihej në luftë dhe të derdhte gjakun për shtypësit e tij të përhershëm. Partia Komuniste e Shqipërisë ishte një garanci që të mos përsëritej kurrë më e kaluara, por kjo duhej vërtetuar në jetë me program, me aksion, me luftë, me politikë.

Partia duhej që me programin e saj Vi bënte të qartë popullit se lufta do të ishte e ashpër, e madhe, e ndërlikuar dhe e vështirë, prandaj nevojitej organizim i madh politik dhe ushtarak. Të gjitha këto Partia ia bëri të qarta popullit dhe i tha (ashtu si e tregoi me vepra) se komunistët do të jenë në ballë të luftës, do të hidhen të parët në zjarr, do të japin jetën duke luftuar, por lufta nuk mund të bëhet vetëm prej tyre, pa masat.

Kjo rridhte nga mendimi se komunistët nuk mund të luftonin dhe të fitonin pa popullin. Revolucionin e bën populli.

Vendimtare në tërë këtë veprimtari do të ishin çështja e aleancave dhe përcaktimi i aleatëve. Dihet roli udhëheqës i klasës punëtore në bazë të parimeve -tona kryesore dhe aleanca e saj me klasën mike, fshatarësinë, veqanërisht me fshatarësinë e varfër pa tokë e me pak tokë. Pikërisht, kjo aleancë, së cilës ne i kushtonim rëndësinë e vëmendjen më të madhe, do të ishte kyçi i fitores edhe në Luftën tonë Nacionalçlirimtare.

Por dinim edhe anën tjetër: kjo aleancë e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore, që do të bëhej strumbullari i bashkimit të shtresave të tjera patriotike dhe përparimtare, duhej krijuar sipas kushteve e gjendjes sonë konkrete. Për këtë, Partisë sonë i është dashur të bëjë jo vetëm analiza të gjendjes ekonomiko-politike të klasave e të shtresave, por edhe të lidhjeve të veçanta specifike të grupeve, të fiseve, të ndikimeve pozitive e negative, të vjetra e të reja, në gjirin e shoqërisë shqiptare.

Ne e njihnim të vërtetën se klasa punëtore shqiptare ishte ende e vogël në numër dhe pa përvojë të madhe në luftën klasore, por qysh në fillim ishim të bindur se kjo klasë punëtore ishte e do të qe e para që do të përqafonte thirrjen dhe programin e Partisë e do të luante, siç luajti, rolin e madh që i takonte në revolucionin popullor, si klasa më pararojë e shoqërisë. Aleatja e saj më besnike do të ishte, pa dyshim, fshatarësia, e cila jo vetëm vuante nën një shfrytëzim mesjetar, por vazhdimisht, në të kaluarën, kishte qenë burimi i luftërave çlirimtare e shoqërore. Traditat e shkëlqyera patriotike e demokratike të fshatarësisë sonë, tashmë të gjallëruara në kulm nga gjendja e padurueshme e pushtimit, ishin argumenti më i fortë edhe për domosdoshmërinë e mundësinë e krijimit të aleancës

midis klasës punëtore e fshatarësisë, edhe për të hedhur poshtë ato pikëpamje reaksionare që e paraqitnin fshatarësinë si një turmë injorante e të shtypur, të padobishme e të pasigurt në luftë. Akoma më të domosdoshme e bënte punën tonë për afrimin e fshatarësisë me programin e Partisë, fakti që për kushtet e vendit tonë, kjo klasë do të ishte burimi dhe baza më e madhe e forcave të gjalla për Luftën Nacionalçlirimtare.

Të ndërgjegjshëm, pra, se klasa punëtore me fshatarësinë do të përbënin bazën kryesore të bashkimit luftarak të popullit, në të njëjtën kohë ne e dinim se e kaluara kishte lënë në shoqërinë tonë njolla të tilla që ishin pengesë për unitet dhe e vështirësonin krijimin e aleancave. Feja kishte bërë punën e saj dhe vazhdonte të helmonte shpirtin dhe mendjen e njerëzve. Klerikët, bejlerët e bajraktarët ishin përpjekur edhe ta shfrytëzonin, por edhe «ta shtronin», «ta urtësonin» popullin tonë trim e të papërkulur, të cilin regjimet e së kaluarës e kishin mbajtur në një obskurantizëm kulturor e politik.

Vërtet te ne, kur vendi u pushtua, nuk kishte parti reaksionare ose përparimtare, të majta etj., por faktorët që numërova më sipër e shumë të tjerë si këta vepronin sikur të ishin disa «parti» të panumërta, që ndrydhnin energjitë e popullit dhe e mbanin këtë të përçarë për ta robëruar dhe për ta shfrytëzuar më mirë.

Një rrezik tjetër, që i kanosej luftës dhe aleancës luftarake të popullit, ishte ajo pjesë e emigrantëve politikë, bij e përfaqësues të klasave shtypëse e shfrytëzuese, të cilët, ashtu si dhjetëra patriotë e demokratë revolucionarë, qenë larguar kur erdhi Zogu në fuqi, por, në dallim nga patriotët e demokratët e vërtetë, ata asnjëherë s'qenë të lidhur me hallet e atdheut e të popullit. Ata ndenjën jashtë vendit për 15 vjet dhe pothuajse shumica e tyre degjeneruan krejt politikisht e u bënë njerëz të besuar dhe aleatë e agentë të asaj fuqie të huaj që i ushqente dhe i furnizonte me rroga. Ata hiqeshin si antizogistë, por ishin edhe antikomunistë, dhe më 1939 u kthyen në Shqipëri tok me italianët. Pretendimet e tyre «për të qeverisur vendin» ishin kategorike. Ata ishin krejt të shkëputur nga populli, nga jeta, nga mendimet dhe nga aspiratat e tij. Mendonin se idetë e vjetruara të demokracisë borgjeze të bastarduar, që ushqenin ata, ishin aktuale dhe të aplikueshme në vend. Dhe kur? Pas ndryshimeve kaq të mëdha që kishte pësuar bota. Ata ishin kthyer në Shqipëri si «ajka e nacionalizmit shqiptar» dhe, pavarësisht se shumë nga ata merrnin rroga të majme nga pushtuesit dhe kishin hyrë në shërbim të plotë të tij, mbanin lidhje me ata elementë «antifashistë e antizogistë», të cilët mendonin se këta emigrantë të kthyer nga jashtë ishin politikisht si 15 vjet më parë (!). Rreziku që i kanosej Luftës Nacionalçlirimtare nga këta njerëz, u bë më i qartë më vonë, kur këta krijuan organizatën tradhtare Balli Kombëtar, e cila i ndihmoi deri në fund me demagogji e me armë okupatorët fashistë e nazistë kundër Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe udhëheqjes së tij, Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Duke qenë antikomunistë të tërbuar, ata në asnjë mënyrë nuk i pritën mirë formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe programin e saj të fiksuar në Rezolucionin e vet.

Partinë Komuniste të Shqipërisë këta elementë, tok me fashizmin, e quajtën «parti e të huajve dhe jo e shqiptarëve», «parti e sllavëve, e rusëve etj., dhe jo e shqiptarëve». Luftën Nacionalçlirimtare e quajtën «një luftë të marrë, pa perspektivë dhe të dëmshme për Shqipërinë». Sipas tyre, udhëheqësit e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të kësaj lufte antifashiste ishin «kalamanë, të rrëmbyer, që s'dinë të bëjnë politikë» e një mijë parulla të tjera shpifëse.

Kjo ishte gjendja e atëhershme në këtë grumbull njerëzish, gjendje që Partia Komuniste e Shqipërisë dhe udhëheqja e saj e morën në studim shumë herë, si gjatë vitit 1942, ashtu edhe më vonë.

Përpara një studimi të tillë ishte vënë Partia gjatë kësaj periudhe edhe për sa u përket besimeve fetare në Shqipëri. Besimet fetare i analizuam në dy drejtime: influenca konkrete e feve në masat e gjera të popullit dhe rrezikshmëria e hierarkisë fetare. Unë nuk do të zgjatëm shumë në këto analiza, por është e nevojshme të përcaktohen disa tipare kryesore, mbi të cilat u mbështet Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë në punën e vet me masat menjëherë pas themelimit e në gjithë periudhën e luftës.

Dihet se te ne ka pasur tri besime fetare: besimi mysliman, më i përhapuri, besimi kristian ortodoks, që vinte pas të parit, dhe besimi katolik romak, më pak i përhapur, me qendër në Shkodër e që shtrihej edhe në malësitë e saj, në Lezhë dhe kalonte pak deri në Durrës, ku kishte një ipeshkvi. Në Shqipëri ka pasur edhe disa besimtarë myslimanë të inkuadruar në sekte të parëndësishme, pa influencë në popull, me përjashtim të sektit të bektashinjve.

Për sa u përket hierarkëve fetarë, influenza e tyre ka qenë si vijon: hierarkët katolikë ishin njerëz pa atdhe, vareshin plotësisht nga Vatikani edhe për gjënë më të vogël, pavarësisht nga «urdhrat» e ndryshëm si jezuitë, françeskanë etj. Si në vende të tjera të botës katolike, edhe në Shqipëri kisha katolike kishte të njëjtin organizim piramidial, të njëjtin organizim kishash, qela, manastire, shkolla fetare ose edhe të subvencionuara nga shteti, të njëjtat rite e liturgji, të njëjtën metodë dhe stil pune në përgjithësi. Subvencionet e tyre, rrogat e çdo gjë tjetër dilnin nga grabitja që u bëhej besimtarëve në forme dhuratash e deri me detyrimin me force të besimtarëve për t'i lënë trashëgim kishës pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Të gjithë hierarkët e kishës katolike, nga më kryesori deri te xhakoi e te famullitari, ishin të mësuar, kishin kryer shkolla teologjike, me disiplinë të hekurt, me metodat dhe dredhitë e shtypjes së vullnetit të njerëzve me frikën e zotit, të Krishtit dhe të apostujve. Besimtarët katolikë duhej të ishin në duart e kishës «*perinde ac cadaver*»*. *(Latinisht - si një Crup i vdekur. Këtu ka kuptimin e të qenët i bindur verbërisht.) Rrjeta e merimangës i kishte mbështjellë besimtarët me ligjet e kishës, me kanunet dhe me ligjet e borgjezisë reaksionare dhe të gjitha këto ishin një grumbull zinxhirësh që i lidhnin dhe i shtypnin besimtarët. Kisha katolike dhe hierarkia e saj ishin në kulm obskurantiste, konservatore, si dhe të adaptueshme e të përkulshme kur ua donte puna, por gjithmonë në aleancë me regjimet reaksionare, si me atë të Princ Vidit, të Ahmet Zogut (bile nuk munguan të ngjyenin dorën edhe në regjimin borgjezo-demokratik të Fan Nolit), si dhe me çdo pushtues të huaj që zaptonte Shqipërinë, qofshin këta austro-hungarezë, fashistë italianë ose nazistë gjermanë.

Vetëm regjimi ynë i diktaturës së proletariatit i dha fund veprimtarisë keqbërëse, reaksionare e kolaboracioniste të kishës katolike.

Por të mos largohemi nga periudha që po analizojmë. Kjo ishte gjendja në hierarkinë e fesë katolike dhe në besimtarët në këtë periudhë historike. Priftërinjtë e mëdhenj ishin agjenturë e dyfishtë e Vatikanit dhe e pushtuesit italian. Por për ne, për Luftën Nacionalçlirimtare, ekzistonte fusha e gjerë e popullit të Veriut, e atyre që besonin në fenë. Kishte edhe disa priftërinj të vegjël e të varfër, të cilët, duke ecur në vazhdën e figurave të tilla të shquara të çështjes kombëtare e të kulturës sonë, që nga Budi e Bogdani e gjer te Ndre Mjeda e Shtjefën Gjeçovi, tash mund ta dëgjonin deri diku fjalën tonë, pse rronin më afër nje rimeve dhe halleve të popullit. Në këto drejtime do të punonim dhe do të çanim.

Feja myslimane dhe hierarkia e saj nuk ishin një pengesë serioze për luftën kundër pushtuesit italian, siç paraqitej feja katolike. Hierarkia e fesë myslimane edhe më parë, por akoma më shumë me pushtimin e vendit, ishte e dobët, pa kurrfarë eksperience shqetësuese. Xhamitë ekzistonin. Ato nga një hoxhë kishin, por praktikantë kishin shumë pak. Ritet ishin braktisur, asnjë martesë nuk bëhej sipas shariatit, çdo gjë tjetër, si mbajtja e ramazanit, festa e bajramit, kishin kaluar si zakone rutinë, që praktikoheshin aty-këtu në disa krahina, më shumë se ashtu «ishin gjendur». Hoxhallarët ishin që të gjithë injorantë, asnjë nuk ishte në gjendje të propagandonte filozofinë, etikën ose moralin kuranik, askush nuk e kuptonte Kuranin, pse thuhej përmendsh në gjuhë të huaj (arabisht). Hoxhallarët, pavarësisht se ishin konservatorë në zakone, nuk ishin as të zotë, as politikanë që të ushtronin influencë me mendimin islamik. Masat e gjera të popullit pothuaj ishin të çliruara nga ligamentet e fesë, zhvillimi i intelektit të besimtarëve myslimanë që më i zgjeruar, liberalizmi dhe toleranca shumë më të mëdha. Pra, përpara punës së Partisë në ngritjen e popullit në luftë në këtë drejtim nuk kishte pothuaj asnjë pengesë serioze.

Edhe në sektin bektashian një pjesë e madhe e myhibëve tradicionalisht kanë pasë treguar atdhedashuri dhe kanë luftuar për çlirimin e Shqipërisë.

E njëjta situatë ishte edhe me besimin kristian ortodoks, si te hierarkia e kishës, ashtu edhe te besimtarët.

Historikisht një pjesë e priftërinjve ortodoksë, sidomos priftërinjtë e thjeshtë të fshatrave apo edhe të qyteteve, ata që jetonin pranë popullit dhe që pas shërbesave fetare hiqnin kamillafin dhe merrnin shatën për të prashitur apo për të bërë ndonjë punë tjetër, kanë luftuar dhe janë përpjekur edhe për të fituar pavarësinë e kishës dhe sidomos për futjen e gjuhës shqipe në shërbimet kishtarë. Kuptohet që këto përpjekje të tyre do të binin ndesh me Patriarkanën e Stambollit e, më pas, sidomos me kishën reaksionare greke dhe nuk do të ishin të rralla krimet e saj të përbindshme ndaj priftërinjve patriotë, që e donin popullin, atdheun, gjuhën shqipe, që donin pavarësinë e kishës shqiptare, përpjekje e synime këto që, në kontekstin historik, kishin vlera të mëdha dhe ishin shprehje e pjesë e luftës për pavarësi që zhvillohej në tërë trojet shqiptare. Populli ynë i nderonte dhe i respektonte këta martirë jo thjesht të kishës, por të shqiptarizms. Të tillë ishin Papa Kristo Negovani, at Stath Melani, Dhimitër Misha, Papa Llambro Ballamaçi e të tjerë, të cilët, ashtu si patriotët e tjerë të shquar të fjalës e të shkollës shqipe: Naum Veqilharxhi, Petro Nini Luarasi, Koto Hoxhi, Pandeli Sotiri e dhjetëra të tjerë, Patriarkana Greke i helmoi e i vrau në mënyrat më barbare.

Ishin të habitshme e cinike «arsyet» se pse reaksioni kishtar grek vepronte kështu ndaj këtyre patriotëve! I vriste e i zhdukte vetëm e vetëm se këta bij shqiptarësh deklarorin se ishin shqiptarë, se donin që edhe në kishë, ashtu si në shtëpi, në rrugë, në arë e në shkollë të flitej shqip, i vritnin se mbronin të drejtat legjitime të popullit e të trojeve të tyre. Por, në të vërtetë, prapa «arsyeve» e «motiveve fetare» të dhespotëve, fshiheshin motive e synime politike, ambiciet territoriale të shovinistëve grekë ndaj Shqipërisë. Ky shovinizëm antishqiptar ishte aq i shfrenuar sa pretendimet territoriale «i lidhte» e «i bazonte» në shtrirjen e fesë ortodokse! Dhe verbëria shoviniste arrinte gjer aty sa dhespotët reaksionarë s'donin të shihnin se feja ortodokse shtrihej jo vetëm në disa zona të kufirit

tonë tokësor me Greqinë (ku bëjnë pjesë edhe fshatrat e minoritetit grek me rreth 20 000 banorë në vitet e para të Luftës Nacionalçlirimtare dhe afër 50 000 banorë sot), por kjo fe, ashtu si dhe ajo myslimane shtrihej anembanë Shqipërisë, në lagje e në krahina të tjera të Gjirokastrës, Sarandës, Përmetit, Korçës, Vlorës, Tepelenës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Elbasanit, Durrësit, Tiranës etj.! Pikërisht në bazë të kësaj logjike absurde edhe sot e kësaj dite disa dhespotë reaksionarë të megaliidesë na nxjerrin si grekë 400 000 shqiptarë, qytetarë të ish-fesë ortodokse. Kësisoj, nëse feja do të ishte baza për përcaktimin e identitetit kombëtar të një populli, atëherë, sipas kësaj logjike të marrë dhespoto-shoviniste, më se gjysma e Shqipërisë do të na i takonte Greqisë (!), gjë që gjithnjë e kishin ëndërruar e kërkuar shovinistët grekë, ithtarë të megaliidesë! Pikërisht në favor të këtyre ëndrrave pushtuese e aneksioniste ata i kishin ndjekur, vrarë e prerë patriotët tanë të nderuar, midis të cilëve edhe priftërinj e besimtarë patriotë që ngriheshin, bashkë me vëllezërit e tyre të feve myslimane e katolike, në mbrojtje të tërësisë territoriale të Shqipërisë nga orekset aneksioniste të shovinistëve fqinj.

Kjo pleksje e ngushtë e çështjes së kishës e të fesë me çështjen kombëtare, duke i dhënë prioritet kësaj të fundit, kishte bërë, pra, që jo vetëm besimtarët e fesë ortodokse, por edhe pjesa më e madhe e priftërinjve të thjeshtë të rriteshin e të edukoheshin me ndjenjën e atdhedashurisë.

Pra, çështjen e besimeve fetare Partia e pati në qendër të vëmendjes gjatë gjithë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe pas luftës, pse nuk duheshin prekur ndjenjat e njerëzve për të arritur ngritjen e popullit në luftë për çlirimin e adheut e ndërtimin e një Shqipërie të re.

Për sa i përket inteligjencies, natyrisht, duhej bërë një punë e gjerë, e kualifikuar, e diferencuar dhe në nivele të ndryshme. Në përgjithësi terreni i punës me intelektualët ishte i përshtatshëm. Bënin përjashtim nëpunësit me pozita të larta, të cilët jo vetëm e pranuan fashizmin, por siguronin edhe fitime materiale të mira prej tij. Kjo kategori nëpunësish «me kulturë», në përgjithësi ishte e korruptuar nga të gjitha regjimet dhe ata ishin nga të parët që, me dashje, u shkruan në partinë fashiste «shqiptare» të krijuar nga pushtuesi.

Kurse në përgjithësi inteligjencia e vendit tonë ishte patriote, antifashiste, kundër pushtimit të vendit, prandaj edhe kësaj shtrese të popullit Partia do t'i kushtonte rëndësi të madhe, sepse edhe nëpërmjet sai do të vazhdonte kurdoherë e më shumë të kalitej e të nxitej patriotizmi i të rinjve e i të rejave.

Analiza të tilla të gjera e të hollësishme të situatave, të raportit të forcave etj. ishin fryt i debateve që bënim qoftë në mbledhjet e udhëheqjes, qoftë edhe në takimet me shokët e Partisë në kryeqytet apo nga terreni. Ato ishin një ndihmë e madhe në punën tonë të përditshme dhe të perspektivës, sepse gjëja e parë e domosdoshme për ta kryer detyrën tonë si komunistë, domethënë si udhëheqës të masave, ishte të orientohesh drejt në ato situata të vështira robërie, terrori, intrigash, vuajtjesh e mjerimesh shpirtërore dhe fizike, që e kishin mbuluar popullin tonë.

Kështu, besnikëria dhe besimi i patundur në teorinë revolucionare të proletariatit si dhe njohja e thellë e realitetit të vendit tonë, qenë dy faktorë themelore që bënë të mundur të përcaktohej nga ana e Partisë sonë një vijë e drejtë, të jepeshin orientime të sakta ideologjike, politike, organizative, si për të gjitha problemet e tjera, edhe për bashkimin luftarak të masave rreth programit të Partisë.

Duke folur për këto analiza e studime mbi të cilat u mbështet Partia, kurrësi s'duhet menduar se ne, fillimisht, pritëm t'i bënim ato të plota e përfundimtare e pastaj të nisnim punën me masat, dhe as që ngarkuam grupe pune ose mobilizuam specialistë e studiues për kryerjen e tyre. Jo, «specialistët», «grupet e punës» ishim vetë ne, gjithë komunistët, nga anëtarët e thjeshtë e gjer tek udhëheqësit kryesorë, që i njihnim e i përgjithësonim situatat krahas punës konkrete të përditshme.

Të gjithë, pra, që nga udhëheqësit e kuadrot krye sorë të Partisë e gjer tek anëtarët e thjeshtë, iu futën me vendosmëri kësaj pune të madhe. Për të hyrë në kontakt më të gjerë me njerëzit e punës tash, pas themelimit të Partisë, na ndihmonte vetë gjendja në të cilën ishim të detyruar të jetonim e të luftonim. Thuajse që të gjithë ishim bij e bija të popullit punonjës, shumë prej nesh ishim ilegalë dhe, si të tillë, ditët e netët i kalonim në lagjet e varfra, nga njëra shtmpa në tjetrën, në mes njerëzve të thjeshtë, punëtorë, zanatçinj, të papunë ose shtëpiakë. Kudo ishim të rrethupur e të mbrojtur nga dashuria e merakut të njerëzve të thjeshtë për fatin tonë dhe e ndienim se në thelb kjo ishte shprehje e dashurisë dhe e merakut të popullit për fatet e vendit.

Duke u mbështetur në këtë gjendje, duke punuar e duke i orientuar të gjithë shokët të shfrytëzonin çdo rast e mundësi, njohjet e miqësitë personale, festat, hidhërimet, dasmat, takime të rastit ose të organizuara, ne hynim si të thuash, në një bashkëbisedim të natyrshëm e të përditshëm me masat, duke propaganduar çdo çast vijën dhe programin e Partisë. Dhe fakt është se fjala jonë zinte shpejt vend, për arsye se ne preknim atje ku ishte pika më e ndjeshme e kombit. Luftë kundër pushtuesit, luftë, luftë të pamëshirshme kundër tij dhe tradhtarëve! - propagandonin ditë e natë komunistët e simpatizantët dhe, doemos, nga kjo s'kishte si të mos i ngrohej zemra këtij populli, që gjith një ishte shquar si luftëtar i madh për çështjen e lirisë.

Kjo propagandë e madhe, e përditshme, me gojë, me trakte, me komunikata, me thirrje, bëhej më e qartë, më e besueshme dhe e pranueshme nga populli, ngaqë fjalë-t komunistët i shoqëronin me vepra. Ata ishin njëkohësisht propagandistë dhe luftëtarë, goditnin fashizmin dhe ndiqeshin nga fashizmi. Domosdo kjo bënte përshtypje të thellë në masat. Shokët tanë nëpër qytete luftonin, organizonin aksione, sabotazhe, atentate, në një kohë kur krismat e pushkëve të njësiteve guerile e të çetave partizane po ndiheshin e shtoheshin gjithandej. Urrejtja e tërbimi i fashistëve u lëshuan më me egërsi mbi komunistët dhe, doemos, dashuria e besimi i popullit do të anonin, siç anuan, përditë e më shumë nga ne, bijtë e tij, që bënim thirrje e punonim për krijimin e bashkimit patriotik të të gjithë popullit në luftë kundër fashizmit.

Këtu është e vështirë të përmendësh e të riprodhosh raste konkrete, sepse këto qenë biseda me popullin, me dhjetëra e qindra njerëz të lagjeve të varfra të qyteteve e të fshatrave, anembanë Shqipërisë. Duhet thënë se me këtë kategori njerëzish, pra, me njerëzit e thjeshtë, nuk na lindnin probleme gjatë bisedave, s'lindte fare nevoja për të bërë përpjekje të veçanta, se si do të parashtroheshin çështjet, ku do të dilte bashkëbiseduesi, si do t'i përgjigjeshim po u hodh degë më degë, po shtroi këtë ose atë çështje «delikate» etj. Jo, këtë stërmundim për parapërgatitje ne e rezervonim për një kategori tjetër njerëzish, për ata tipa që hiqeshin si «patriotë», si «politikanë» të mëdhenj, por që «luftën» e bënin kafeneve, me gjyzlykë mbi hundë e me kafe e kek përpara. Me popullin flitnim hapur, pa asnjë frikë se mos e preknim atje ku s'duhej dhe më tepër sesa një punë «për t'i mbushur mendjen», ky qe një kuvend me popullin për qarjen e halleve të përbashkëta. Në këto takime të paharrueshme ne mësonim nga njëri-tjetri; na mahniste dëshira e njerëzve të thjeshtë,

gjer në mospërmbajtje, për t'u ngritur në luftë, për të bërë që mundësisht që «nesër» të çlirohej vatani: .Natyrisht, nga ky bashkëbisedim i gjerë me popullin Partia vilte fakte, mësonte më mirë gjendjen, maste pulsën e kohës, shkallën e situatës revolucionare. Gjithnjë e më tepër kjo situatë piquej, gjithnjë e më tepër populli shfaqte hapur simpatinë e dashurinë ndaj komunistëve. Shpirti i popullit, i etur për Tiri e i gatshëm për luftë, na bindte se ishim në rrugë të drejtë, na shtynte që të punonim më me forcë për realizimin e programit të vendosur.

Në punën me popullin e ndienim veten të çlirët, e shihnim veten në terrenin tonë dhe i flisnim atij shumë thjesht e qartë: do të bëjmë luftën, në luftë e sipër do të organizohemi, do ta forcojmë këtë organizim dhe, kur të shporrim italianët e çdo pushtues tje tër, bashkë me të do të jenë shporrur gjithë ata tradhtarë që përgatitën pushtimin e që tash na shtypin, na luftojnë e majmen mbi kurrizin tonë. Do të vendosim NE se ç'do të bëjmë e, kur themi «NE», kemi para sysh jo thjesht veten tonë, si komunistë, por të gjithë ju, mbarë popullin që na lindi e na rriti.

Kështu zinte vend fiala jonë si guri në tabanin e vet dhe e ndienim se, kur na hapej çdo derë e popullit, na qenë hapur më parë zemrat e tij; bindeshim se kur na strehonin e na ruanin të gjithë, të njohur e të panjohur, kjo do të thoshte se ata, mijërat, populli, ishin me ne, me Partinë.

Kësaj pune, që erdhi vazhdimisht duke u rritur, Partia i kushtonte kujdesin e vëmendjen më të madhe. Në çdo mbledhje celule, ashtu si edhe në organet udhëheqëse të Partisë, puna me masat ishte çështje që do të raportohet e do të diskutohet, aio figuronte në çdo rend dite. Po të shohësh dokumentet e asaj kohe që u referohen mbledhjeve kryesore pas themelimit të Partisë, ose raporteve e informacioneve që kërkonim e na vinin nga të gjithë qarkorët e anët e vendit, do të vësh re se problemi i lidhjes me masat, për të bërë për vete masat, për Vi bashkuar në një njësi të ç'liktë, ishte ndër problemet kryesore që diskutoheshin. Nuk ishte e rastit, për shembull, që mbledhja e parë e më kryesore pas themelimit të Partisë, Konsulta e Parë e Aktiviteti të PKSH e prillit 1942, në qendër të saj kishte analizën e punës sonë për lidhjet me masat e punëtorëve, të fshatarëve, të rinjve, të grave, të të gjithë atyre që u dhimbsej çështja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut. Po kështu edhe në Konferencën e Jashtëzakonshme të Partisë, në qershor 1942; edhe në mbledhje të tjera në shkallë vendi, ashtu si edhe në mbledhjet e qarkorëve, ose në takime të shpeshta të Komitetit Qendror, e kishim bërë rregull të pacenuar që të raportonim një nga një, pa përjashtim, se ç'kishim bërë, ç'kishim arritur e ç'mbetej për më tej për bashkimin patriotik të masave rreth Partisë në luftën për liri. Kuptohet, mbetej shumë e shumë për të bërë. Nuk lejonim në këtë çështje jetike asnjë lëshim, asnjë shmangie. Si rezultat i kësaj pune të mençur e të organizuar që bënte Partia, fakt është se numri i punëtorëve në qytetet me njëfarë zhvillimi industrial që hynin në Parti apo lidheshin me të, shtohet vazhdimisht. Edhe në drejtim të fshatit ishin arritur rezultate dhe në disa krahina, sidomos në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, fshatarësia shprehej pro vijës së Partisë dhe po tregohet e gatshme për të rrokur armët.

Lidhur me futjen e fshatarësisë në Front dhe përfshirjen e saj në luftën e armatosur, na dilnin përpara, midis të tjerash, edhe dy vështirësi. Në radhë të parë, qëndronte çështja e influencës që kishin në fshat elementët bajraktarë e pseudopatriotë; nga una tjetër, ishte e domosdoshme të rrënjosej te çdo komunist bindja e plotë se baza e Frontit, për të cilin po luftonim, do të ishte aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, sidomos me fshatarësinë e varfër dhe të mesme. Megjithëse pjesa më e madhe e komunistëve e kishte të qartë këtë detyrë, prapë te ndonjëri ruhej pikëpamja e goditur prej kohësh se Fronti do të krijohej mbi bazën e një marrëveshjeje me krerët nacionalistë dhe nga kjo marrëveshje do të vinte automatikisht edhe pjesëmarrja në luftë e në iasave fshatare. Kishte raste kur këto pikëpamje silfaqeshin edhe hapur.

Kështu na ndodhi, për shembull, në dhjetor të vitit 1941 në Konferencën e Parë të Organizatës së Partisë të Tiranës, ku mora pjesë si i deleguar i Komitetit Qendror. Kësaj konference, që u mbajt, sigurisht, në ilegalitet në shtëpinë e Bije Vokshit e ku morën pjesë rreth 20 veta, Komiteti Qendror i vinte një rëndësi të madhe, sepse edhe peshja e organizatës së Tiranës do të ishte më e madhe.

Kur po diskutonim rreth problemeve të lidhjes me masat mes të tjerash u ngrit edhe një shok dhe shtroi çështjen se puna me fshatin kishte shumë vështirësi dhe, sipas tij, të bindje masat e fshatarëve të varfër e të mesëm për t'u hedhur në luftë kjo do të kërkonte një kohë të gjatë.

- Po atëherë, si mendon ti, - i ndërhyra, - ta realizojmë bashkimin e popullit pa fshatarësinë?
- Mendimi im, - u përgjigj ky shok, - është që ne si Parti të punojmë e të tërheqim me vete parinë e fshatit, nacionalistët që kanë influencë në fshat. Po të kemi parinë me vete, atëherë edhe fshatarësia do të na vijë pus.

Një shtrim i tillë i çështjes sot do të çudiste edhe një nxënës shkolle, por në atë kohë pikëpamje të tilla ishin akoma të përhapura. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në konferencë iu kundërvunë këtij mendimi të gabuar. Megjithatë, duke parë se edhe te ndonjë shok tjetër gjente jehonë ky mendim, gjithashtu duke e ditur se ç'rrezikshmëri paraqiste një pikëpamje e tillë për vijën e Partisë, e pashë të arsyeshme të bëja një ndërhyrje të gjatë, për të sqaruar në mënyrë sa më të plotë vijën ideologjike e politike të Partisë për Luftën Nacionalçlirimtare. Iu përgjigja pak ashpër shokut në fjalë, sepse vetë çështja ishte serioze.

- Ta shtrosh çështjen në këtë mënyrë, - thashë në esencë, - do të thotë të mos kesh të qartë ç'është një parti komuniste, një parti e klasës punëtore. Partia jonë është parti e masave dhe forcën e saj, e theksoj përsëri, e ka te masat. Partia jonë, patjetër që do t'u bëjë thirrje e do të punojë me durim të madh që edhe parinë, si gjithë elementët, shtresat e klasat shoqërore, ta bëjë të ndërgjegjshme e ta mobilizojë në luftën e madhe për lirinë e atdheut. Por është tjetër gjë të punosh për të mobilizuar në Front e në luftë si gjithë popullin edhe parinë e fshatit dhe tjetër gjë t'i mbështetësh shpresat për bashkimin e masave tek influencat e parisë. Prandaj ne nuk mund ta ndërtojmë punën me masat duke bërë marrëveshje e tratativa me krerët që kanë pak ose shumë influencë në fshat. Partia influencën dhe autoritetin e vet nuk e blen nga të tjerët e ca më pak nga paria, por e fiton me punë dhe me luftë, nga lidhjet e drejtpërdrejta me masat, duke u shpjeguar masave programin dhe qëllimet e veta. Në marrëdhëniet midis Partisë sonë Komuniste dhe fshatarësisë nuk ka vend për -të tretë», sepse baza sociale ku do të mbështetet Partia, në luftën çlirimtare dhe në revolucionin social, do të jenë punëtorët, fshatarët dhe intelektualët e ndershëm dhe jo agallarët e bejlerët, tregtarët e pronarët apo avoketërit pseudopatriotë.

Ja kështu, dulce ruajtur parimet dhe vijën e drejtë të Partisë, duke korrigjuar të metat e duke goditur pikëpamjet e shtrembra e, mbi të gjitha, duke punuar intensivisht, baza e Partisë shkoi duke u shëndoshur dhe lidhjet e saj me popullin duke u zgjeruar pareshtur.

Një vëmendje të veçantë i kushtoi Partia qysh në fillim sidomos punës me rininë shqiptare që me energjitë dhe entuziazmin e saj, me vitalitetin e saj të pashtershëm dhe me cilësitë e larta morale, do të ishte forca më e gjallë goditëse në luftën për çlirim. Jo rastësisht, me iniciativën e Komitetit Qendror Provizor, disa ditë pas themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, u krijua organizata e Rinisë Komuniste dhe jo rastësisht në krye të saj Partia caktoi një nga anëtarët e vet më të mirë, një nga udhëheqësit e saj më të pjekur, më të lavdishëm, Qemal Stafën. Objektivi i Partisë në punën me rininë ishte të afronte rininë sa më afër ideve komuniste dhe sa më pranë Partisë, ta përgatiste ideologjikisht e politikisht dhe ta organizonte atë për rezistencë e për luftë kundër pushtuesve. Këtë objektivi të madh ne komunistët ia kishim caktuar vetes që atëherë kur militonim në grupe të ndryshme, por tash që formuam Partinë, puna me rininë u vu në leaza më të shëndosha e më shkencore. Ne kishim parasysh faktin se rinia kishte edhe ajo përbërjen e saj klasore, se të rinjtë jetonin e binin në kontakt me familje e ambiente punëtore, fshatare dhe intelektuale dhe, për këtë arsye, ajo mund dhe duhej të bëhej një transmetuese e fjalës së Partisë, agjitore e programit të saj luftarak.

Pra, një tjetër objektivi i punës sonë ishte që nëpërmjet rinisë të përhapnim dhe të forconim në masat e gjera të popullit idenë e rezistencës e të luftës kundër fashizmit pushtues dhe bashkëpunëtorëve të tij, të forconim me anën e të rinjve e të rejave opinionin për domosdoshmërinë e rezistencës edhe brenda familjes, në mënyrë që të krijohej kohezioni i mendimit politik antifashist dhe të lidheshin të vjetrit, prindërit, me të rinjtë, me bijtë dhe me vajzat e tyre. Partia kishte besim dhe këtë e vërtetoi koha, se rinia, me prirjen e saj për të përqaftuar çdo gjë të re progresive, jo vetëm do të hidhej në radhët e para të luftës antifashiste, por do t'i kuptonte dhe do t'i mbronte me bindje, me guxim e me heroizëm idetë kurdoherë të reja të komunizmit militant dhe nga radhët e saj do të dilnin komunistët dhe kuadrot e Partisë, zbatuesit dhe propagandistët e programit të saj.

Komiteti Qendror i Partisë u dha udhëzime shokëve drejtues të rinisë që edhe në këtë drejtim të intensifikoheshin puna me masat, që, sikurse anëtarët e Partisë, patriotët e ndershëm, edhe të rinjtë të futeshin në masa, të njiheshin me to, të bënin çmos të merrnin kontakt, të bisedonin, të shpjegonin dhe të vlerësonin çdo gjë, deri edhe një punë shumë të vogël, që në dukje nuk kishte vlerë, por që krijonte tek individit, me të cilin punonin, ndjenjën se «diçka po bënte për atdheun». Të tilla këshilla u jepja Misto Mames, Mihal Durit, Perlat Rexhepit (kur ky u nis për në Shkodër nga shtëpia ku kishim formuar Partinë), si dhe shokë ve të tjerë.

Puna e Partisë pati një efekt kolosal. Duke realizuar këta objektiva të mëdhenj Partia çau rrugën dhe fitonte zemrat dhe mendjet e të rinjve, ashtu siç po fitonte dashurinë, respektin e besimin e punëtorëve, të fshatarëve, të të gjithë njerëzve të ndershëm.

Armiku e kuptonte qëllimin e Partisë dhe duhet njohur që u ndodh në hall. Ai përdori edhe demagogjinë, edhe terrorin, por gjithçka i shkoi kot. «Dopolavorot», klubet «kulturore», propaganda me shtyp, me radio, me filma e me libra, organizatat fashiste për rininë e për të vegjlit, gjithë ky arsenal diversiv ideologjik e politik, nuk qe i mjaftueshëm për ta shmangur rininë shqiptare, lulen e bukur të popullit, nga rruga e nderit dhe e trimërisë. Bijtë dhe bijat e Shqipërisë nuk shkuan pas premtimeve të fashistëve, por u shkuan pas Qemalit e Vojos, Perlatit e Margaritës dhe heronjve të tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare. Asnjë pjesë e rinisë shqiptare nuk mbeti jashtë sferës së punës edukuese e mobilizuese të Partisë që nga i riu punëtor, shkollor e intelektual, deri te të rinjtë e fshatit, ku puna në fillim na ecte me vështirësi.

Rinia punëtoresh dhe ajo fshatare ishin, pra, objektivi kryesor i punës së Partisë sonë, duke korrigjuar kështu tendencën e periudhës së grupeve, të cilët më tepër e kishin përqendruar punën te rinia shkollore. Natyrisht, Partia edhe me këta punoi, sepse këta jo vetëm do të jepnin kontributin e tyre në një luftë ku llogaritej çdo njeri e çdo pushkë, por do të ishin edhe kuadrot e ardhshëm intelektualë që do t'i duheshin atdheut pas Çlirimit. Në punën me rininë shkollore nuk u përqendruam vetëm te nxënësit e shkollave të mesme të vendit, që përgjithësisht ishin të lidhur fort me komunistët e qenë nga më aktivët në demonstrata e aksione, por një vëmendje të posaçme i kushtuam edhe asaj rinie studenteske që vazhdonte studimet jashtë vendit. Nëpërmjet anëtarëve të saj Partia u bëri thirrje studentëve të braktisnin shkollat fashiste, të bojkotonin BRUFSSH-in* («Bashkimi i Rinisë Universitare Fashiste Shqiptare», organizatë që u pënpoq ta krijonte pushtuesi fashist për korruptimin e rinisë universitare shqiptare.) e fabrikuar nga italianët, të hidheshin në luftë kundër fashizmit dhe rrogëtarëve të tij. Në shumicën e tyre këta iu përgjigjën thirrjes së Partisë, se edhe vetë qenë të lidhur me popullin, sidomos ata që vinin nga familje jo të pasura e që me ndonjë bursë të nxjerrë me një mijë mundime e me ndonjë napolon që u dërgonin nga shtëpia, vazhdonin studimet e larta në Itali ose në ndonjë vend tjetër. Lidhur me këtë që po them më kujtohet një takim që kam pasur me një të ri universitar në ato kohë.

Ndodhesha një ditë në një bazë në Rrugën e Shëngjergjit, në shtëpinë nr. 66, bashkë me Qemalin. Në mos gaboj, ka qenë prilli i vitit 1942 (pas përfundimit të Konsultës së Aktivit të Partisë), dhe une kisha shkuar atje i veshur si bojaxhi e i pajisur me furçat e veglat e tjera «të profesionit». S'kishte shumë që kishim filluar bisedën kur vjen Bije Vokshi, kërkon Qemalin e i thotë se një shok shkodran ka ardhur dhe kërkon ta takojë.

- Cili është? - pyeti Qemali dhe, kur Bija i tha emrin e shokut, e lejoi ta fuste në dhomë.

Kur hyri në dhomë shoku që kishte kërkuar Qemalin, na përshëndeti.

Qemali sapo e pa iu hodh në qafë dhe e pyeti kur kishte ardhur nga Italia, si ishin shokët, a ishte takuar me njerëzit e shtëpisë. Mbasi iu përgjigj edhe i porsaardhuri filloi ta pyesë Qemalin për njerëzit e tij, për Vasilin dhe të njohurit e tjerë, që për mua nuk ishin aspak të panjohur. Si u sigurua nga Qemali se mund të fliste pa druajtje në praninë time, i porsaardhuri nga Italia, ku studioonte për mjekësi, tha:

- Më ka dërguar një grup studentësh që studiojmë në Itali. Jemi mbledhur dhe kemi vendosur të kthehemi në Shqipëri.

Shoku i tregoi Qemalit se para pak kohësh një nga studentët shqiptarë, anëtar i Grupit të Shkodrës, kishte marre një kartolinë nga Hajdar Dushi me një tekst të çuditshëm «Nënë e ka marre malli per ty», në një kohë kur nëna e tij kishte kohë që kishte vdekur.

- Atëherë, - i tregonte shoku Qemalit, - thamë se diçka e rëndësishme kishte ndodhur në Shqipëri. Thirrëm edhe disa shokë nga Firencja, Parma, Siena dhe vendosëm që une të vija këtu e të vendosja lidhje me grupin. Né Romë, - vazhdoi, - takova Sami Bahollin, i cili më lexoi Rezolucionin per krijimin e Partisë. Shokët më porositen t'ju them që janë të gatshëm të vijnë e të hidhen në ilegalitet. Qemali, që dëgjonte me vëmendje, u gëzua per gatishmërinë e këtyre shokëve të rinj. Edhe une u gëzova, por, per ta ngacmuar, i them shokut:

- Edhe para ca ditësh na premtuan nja pese a gjashtë intelektualë këtu në Tiranë se do të hidheshin në ilegalitet, por shpejt ndërruan mendje.

Qemali qeshi nën buzë, se e kuptoi shakanë time, por shoku i tij u kthye nga unë dhe një çikë i prekur m'u përgjigj

- Unë nuk ju njoh dhe as ju nuk më njihni. Por Qemali më njeh edhe mua, edhe mjaft nga shokët tanë atje. Këto nuk janë premtime boshe. Na thoni dhe ju garantohem me kokë për rreth tridhjetë veta, mundet edhe më shumë. Vetëm një gjë duam, që kur të vijmë këtu të na siguron bazat e lidhjet e nevojshme, se nuk dimë si të orientohe mi e ku të strehohemi.

I shtrëngova fort dorën këtij të riu që quhej Nikolla Shurbani, shok i vjetër i Qemalit dhe ish-anëtar i Grupit të Shkodrës, dhe fillova ta pyesja për aktivitetin që kishin zhvilluar studentët shqiptarë në Itali, për gjendjen e tyre shpirtërore, për situatën në atë vend etj. E pyeta, gjithashtu, për disa studentë, që kishin qenë anëtarë të Grupit Komunist të Korçës, të cilët i kisha njohur personalisht. Pastaj i thashë:

- Ne nuk dyshonim në gatishmërinë e shokëve tanë dhe jemi të sigurt se ata do të japin një kontribut me vlerë në çështjen e çlirimit. Për çështjen që ngritet ju për t'u kthyer në ilegalitet në Shqipëri, unë mendoj që kjo të bëhet gradualisht, sipas porositve e udhëzimeve konkrete që ne do t'ju japim në kohën e duhur.

Biseduam dhe pak, pastai u ndamë me Nikollën, kurse unë e Qemali vazhduam bisedën që kishim lënë në mes. Shoku nga Shkodra nuk ishte gabuar: pjesa më e madhe e studentëve tanë në Itali, si bij të denjë të popullit të vet, iu përgjigjën thirrjes së atdheut e të Partisë, u kthyen në Shqipëri e luftuan me trimëri për çlirimin e vendit.

Kështu, puna propagandistike dhe organizative e Partisë po gjente mbështetje të gjerë te punëtorët, te zanatçinjtë, te populli fukara nëpër qytete, te fshatarët e te rinia. Hap pas hapi e në mënyrë të sigurt po krijohet rreth Partisë bashkimi patriotik antifashist i masave.

Ky bashkim i popullit rreth Partisë qysh në fillim nisi si një bashkim luftarak që edhe po krijohet, edhe do të çelikej përmes veprimeve, duke filluar nga më të thjeshtat e gjer te kryengritja e përgjithshme e armatosur.

Nëpër aksione, atentate e sabotazhe u dha orientimi që bashkë me komunistët të merrnin pjesë njerëz pa parti, nga radhët e simpatizantëve e të aktivistëve të njohur, sidomos të rinj e të reja. Po ashtu iu kushtua rëndësi e madhe organizimit kudo të demonstratave masive, ku populli, duke dalë nëpër rrugë e sheshe, i prirë nga komunistët, duke iu kundërvënë fashizmit e duke u përleshur me forcat e rendit, edhe të shihte ç'forcë kolosale mbarre në vetvete, edhe të kaliste më tepër ndjenjën e bashkimit e të shpirtit luftarak, edhe t'i bënte të qartë kategorisë së pseudopatriotëve që të mblidhnin mendjen e të vendosnin: o me popullin në luftë kundër fashizmit, o me fashizmin në luftë kundër popullit.

Demonstrata të tilla u zhvilluan pas themelimit të Partisë në të gjitha anët, ashtu siç nasi të ndihej gjithnjë e më tepër pushka partizane, ashtu si po shtoheshin gjithnjë e më tepër çetat dhe radhët e tyre me forca që vinin nga fshati e qyteti.

Doemos, forcimit të luftës sonë fashizmi do t'i përgjigjej e iu përgjigj me terror më të madh, me egërsi më të papërmbajtur. Por ne s'trembeshim nga kjo. Lufta s'bëhej ndryshe.

Tamam kur me punën e palodhur të komunistëve, kur me veprimet e shumëllojshme ne po lidheshim gjithnjë e më tepër me popullin, na hyn Koço Tashkoja «i pizmosur» në një mbledhje e na lëshon një «protestë»:

- Partia po priret nga sektarizmi! - tha «i indignuar». - Po marrim né qafë veten dhe popullin.

- Ç'thua? - e pyeta. - Ç'është ky sektarizëm?!

- Demonstrata e 7 prillit né Tiranë nuk duhej të qe bërë. Po ashtu né Durrës e kudo gjetkë. E çfarë fituam? Mos e përmbysëm fashizmin?! Aspak! Përkundrazi, ai u egërsua më shumë e me terrorin që ka shpërthyer do ta trembë popullin. Jakëni né vete, shokë! Po prishim me sektarizmen e disave, atë punë të madhe që bëjmë ditë e natë me gojë, me agjitacion, me propagandë!

E qartë: oportunisti e «komunisti» i salloneve nuk mund ta kuptonte ndryshe e më thellë punën me masat, veçse, e shumta, nëpërmjet agjitacionit gojor, agjitacion që, për sa i përket atij vetë e tipave si ai, bëhej né mënyrë të vakët, rutinë, bile kufizohej né ca intelektualë borsalinash e né ca politikanë kafenesh.

- Jo, - i thashë i zemëruar, - ne s'do të veprojmë kurrë sipas logjikës tënde. Ne luftojmë për ta bërë popullin për vete jo thjesht me llafe dhe aspak sa për Vi marrë një miratim gojor. Neve s'na duhet thjesht urata e popullit, neve na duhet forca e popullit, shpirti i tij i papërkulur e luftarak. Duke e hedhur këtë forcë kolosale né veprim, duke e kanalizuar drejt e duke e udhëhequr né aksione, vetëm kështu do të bëhet lufta, vetëm kështu do të shporret fashizmi.

- Dakord né parim, por është herët për veprime demonstrative! - vazhdoi më tej Koço Tashkoja. T'i mbushim një herë mendjen popullit se diç jemi, të na besojë, pastaj ta nxjerrim shesheve. Ndryshe na iku që tani nga duart.

- Populli nuk largohet prej nesh ngaqë e udhëheqim né aksione, né demonstrata e né luftë, - i thashë.

- Ai do të largohet nga ne vetëm po ta shohë se jemi njerëz të llafeve. Sa për atë se trembet populli, ky është një gjykim trashanik dhe jashtë së vërtetës. A s'më thua, ku strehohemi ne kur na ndjekin fashistët, kush na ruan, kush na shoqëron nga baza né bazë? Populli, ai popull që po na njeh e po na vjen pas pikërisht se e sheh që ne ndeshemi me pushtuesin. Populli largohet nga frikacakët, nga fjalamanët, por jo nga trimat.

Vazhduam gjatë debatin dhe né tërësi të gjithë shokët iu kundërvunë me forcë pikëpamjeve të Koço Tashkos. Duhet të them se brenda radhëve të Partisë, për fat té miré, me tipa e pikëpamje të tilla, që kërkonin një lloj «luftë të qetë», pa «krisma», pa veprime, nuk na u desh të merreshim gjatë, sepse të tillë ishin të rrallë. Populli na ndoqi ne né demonstrata e përleshje, populli, sidomos rinia, më tepër se nga çdo gjë, na besuan e u bashkuan né rrugën e Partisë, pikërisht se kjo ishte rruga e luftës, e veprimit.

Pa marrë akoma format e veta organizative, pa u përcaktuar ende në mënyrë të plotë programi, themelet e Frontit Antifashist të popullit shqiptar po hidheshin.

2. Patriotë dhe pseudopatriotë

Partia jonë me të drejtë përcaktoi që në fillim se në luftën për shpëtimin e vendit duhej përfshirë i gjithë populli, të gjitha klasat e shtresat shoqërore pa dallim pikëpamjesh politike, ideologjike, fetare etj. Kryesorja që mund e duhej t'i bashkonte këto forca ishte qëndrimi ndaj pushtuesit të huaj, lufta pa kompromis kundër tij. Mbi këtë bazë do të organizohej edhe Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë përveç masave punonjëse të qytetit e të fshatit, edhe gjithë forcat e elementët e tjerë, të gjithë ata që ishin të interesuar për lirinë dhe ekzistencën e Shqipërisë e të kombit shqiptar. E, në këtë mes, një punë e madhe, e gjerë, shpesh tepër e ndërlikuar, e vështirë dhe e lodhshme, ishte ajo që na u desh të bënim me elementët patriotë ose ata që hiqeshin si të tillë, pra, me gjithë ata që atëherë quheshin nacionalistë.

Termi «nacionalist», siç e përdornim ne në atë periudhë, nuk duhet konfunduar me përmbajtjen që ka marrë sot ky term në literaturën politike për të emërtuar elementët me pikëpamje nacionaliste

borgjeze në kundërshtim me parimin marksist-leninist të internacionalizmit proletar. Termi «nacionalist» ishte një apelacion për ata luftëtarë që në kohët e kaluara kishin luftuar kundër pushtuesve të huaj, që synonin të na zhduknin edhe si komb. Pikërisht nga fjala «nacion», e marrë nga gjuhët latine e që i përgjigjet fjalës sonë «komb», doli edhe termi «nacionalist», të cilin ne e kemi përdorur edhe gjatë luftës e që gjendet edhe në shkrimet e mia të asaj kohe.

Ç'është e vërteta, ky ishte një emërtim që përfshinte një kategori të gjerë njerëzish, që nga elementët me të kaluar e me veprimtari patriotike, deri tek intelektualët që njiheshin apo afishoheshin si njerëz me ndjenja patriotike e demokratike. Kështu që me termin «nacionalist» në njëfarë kuptimi ne bënim edhe diferencimin midis komunistëve, nga njëra anë, dhe njerëzve të tjerë me të cilët kishim kontakte e punonim. Qysh në kohën e grupeve, por sidomos pas themelimit të Partisë, puna me «nacionalistët» ishte një sektor që u takonte të gjithë komunistëve. Natyrisht, kjo bëhej sipas mundësive që kishte gjithsecili, sipas rrethit shoqëror, të njohurve e të afërmeve. Në celulatat ku bënim pjesë jepnim llogari për të gjitha punët, por edhe për punën me intelektualët e me patriotët, shkëmbehim me njëri-tjetrin mendime dhe këshilloheshim në veprime. Kur ndonjëri gjente vështirësi me personin me të cilin ishte caktuar të punonte, ia kalonte një shoku tjetër dhe gjente mënyrën si t'ia prezantonte.

Një problem më vete ishte edhe ana formale e punës: t'i njihje, pastaj të hyje në rrethet e tyre, të merrje pjesë në bisedat që zhvillonin dhe të arrije sa të ishte e mundur të kuptoje, për shembull, ç'prirje politike kishte njëri në kokë, deri ku mund të shkohej me të, kur duhej të ecej përpara dhe kur duhej të qëndrohej në biseda të përgjithshme për t'u maskuar riga spiunët. Pse, të mos harrojmë se regjimi i Zogut dhe, më pas, regjimi fashist ishin regjime të spiunëve, të cilët vëzhgonin e shikonin me kë shkoje, me kë bisedoje e gfarë bisedoje dhe të vinin «damkën». Nga kjo anë, në atë kohë duhej edhe një strategji, edhe një taktikë e veçantë, sepse në mes të intelektualëve, mësuesve, profesorëve, tregtarëve, nacionalistëve kishte njerëz të mirë, por kishte edhe të vagët, kishte pastaj edhe lloj-lloj biçimesh deri edhe spiunë e bashkëpunëtorë të armikut.

Në bisedat që bënim me ta, pasi bindeshim për predispozicionin e tyre, pozonim qëndrimin tonë si komunistë dhe si Parti Komuniste. Teza jonë themelore ishte se në këto situata të rënda për atdheun të gjithë shqiptarët kishin një qëllim të përbashkët, luftën kundër pushtuesit për glirimin e Shqipërisë. Përpara kësaj detyre imperative duhej të kalonin në plan të dytë të gjitha ndryshimet në bindjet ideologjike e në simpatitë politike, ndasitë fetare e krahinore. Është momenti, theksonim ne komunistët, që të mendojmë thellë për fjalët e poetit patriot se «feja e shqiptarit është shqiptaria».

Kjo ka qenë një riga punët më të vështira që u është dashur të bënin Partia dhe anëtarët e saj, që riga udhëheqja deri te komunisti i veçantë. Nuk kam parasysh këtu vetëm rrezikun që ria kërcënonte në këtë punë, mundësinë e tradhtisë e të spiunimit, probabilitetin e futjes së ndonjë elementi agjent e provokator -në radhët tona. Këto, sigurisht, ekzistonin, por cilën punë komunistët dhe patriotët e ndershem e bënin pa rrezik? Këto rreziqe ata i kishin marrë parasysh, përderisa iu futën luftës me një armik të egër, mizor e dinak.

Vështirësitë më të mëdha qenë në një drejtim tjetër, ku nuk pinte shumë ujë trimëria, por duhej takt, nuhatje politike, gjakftohtësi e maturi. U është dashur shokëve të Partisë të përballojnë një tension të madh jo vetëm fizik, por edhe nervor e psikologjik, ria është dashur të bisedonim e të grindeshim për orë të tëra, disa herë me radhë, me lloj-lloj tipash kokëngjeshur që jo vetëm nuk bindeshin riga argumentet tona të drejta e të qarta si drita e diellit, por përpiqeshin me «argumente» qesharake e me sofizma avoketërisht të ria bindnin ne për të kundërtën! Duhej, veç të tjerave, edhe një durim e përmbajtje e fortë e vetvetes, që të mos ua përplasje në fytyrë e t'u thoshe «sikter» këtyre -patriotëve». Por puna e Partisë dhe qështja e luftës kërkonin tjetër gjë. Ndodhte që ndonjë shok i revoltuar vinte për të ria raportuar për takimin që kishte pasur e kërkonte ta lironim riga ajo barrë, kërkonte edhe aprovimin tonë që ta damkoste iksin apo ipsilonin me emrin e tradhtarit. «Jo! - i thoshim ne. - Do të vijë dita, kur ta mbushë kupën, që edhe këtë do ta bëjmë. Por ti vazhdo punën, hidhja poshtë argumentet, demaskoje dhe, kur të bindesh që ai vërtet nuk dëshiron të luftojë, atëherë da të heqim dorë prej tij».

Lexuesit e sidomos të rinjtë mund të hapin sytë e të thonë pse duhej kaq ceremoni me këta elementë, këtyre u duhej treguar vendi. Sigurisht, do të vinte momenti dhe Partia e populli do t'u vinin edhe pushkën të gjithë atyre që me fjalë e me vepra u bashkuan me nazifashistët, por përpara duheshin bërë përpjekje për t'i shmangur nga rruga e tradhtisë, për t'i hedhur në luftë kundër pushtuesit.

Partia, duke punuar me nacionalistët, kishte parasysh qëllimet strategjike të luftës që udhëhiqte, interesat e mëdhenj të popullit dhe të atdheut. Në radhë të parë, Partia nisej nga pikëpamja se sa më i gjerë e më masiv të ishte Fronti Popullor, aq më e furishme do të zhvillohej lufta dhe aq më e sigurt do të ishte fitorja përfundimtare. Pastaj, nuk duhet harruar që shumë nga nacionalistët e njohur në atë periudhë, kishin, në shkallë të ndryshme, influenca të caktuara në krahina e në qytete të ndryshme të vendit ose në qarqet e inteligjencies. Qenë fitore të politikës së Partisë inkuadrimi në Front i dhjetëra e dhjetëra patriotëve të shquar, të njohur në popull për ndjenjat e mendimet e tyre përparimtare e demokratike dhe si luftëtarë antizogistë, sepse këta, veç kontributit të tyre, me aftësitë dhe kapacitetet personale, posedonin një autoritet të madh në popull, të cilin e vunë në dispozicion e në shërbim të Luftës Nacionalçlirimtare.

Po të njëjtat rezultate dha lufta e Partisë për të demaskuar e për t'u nxjerrë bojën pseudopatriotëve të tillë, si: Lumo Skëndoja, Ali Këlcyra, Qazim Koculi e të tjerë. Shumë prej këtyre nuk ishin as budallenj e as pa influencë. Disa spekulonin me emrat e familjeve që mbanin, disa me dy-tri pushkë të hedhura në Vlorë më 1920, disa me qëndrimet opozitare të mbajtura kundër Zogut apo me një pjesëmarrje të rastit në Revolucionin e Qershorit të 1924-ës.

Do të ishte miopi politike t'u vije pushkën të gjithë këtyre që më 1941, siç mund të mendojë ndonjë. Kjo do të ishte e dëmshme edhe për luftën, edhe për Partinë. Ky «mineral» njerëzor duhej seleksionuar dhe prej tij, përveç fëlliqësive që do të flakeshin tej, do të dilte edhe metal i pastër dhe këtë seleksionim do ta bënin koha dhe lufta. Vija e Partisë që e drejtë: të tërhiqen elementët patriotë në luftë dhe të përdoret influenca e tyre në masat në të mirë të luftës; demagogët, veglat e maskuara të okupatorit të demaskohen duke u vënë pyetjen: «Do të luftoni ju për Shqipërinë, apo jo?». Dhe populli do të shihte, sikurse pa, se cilët ishin patriotë të vërtetë e cilët pseudopatriotë.

Në kuadrin e punës së gjerë me nacionalistët, një kujdes i madh e vëmendje e posaçme iu kushtua, në atë kohë, sidomos punës me inteligjencien, duke synuar që elementët patriotë e demokratë të saj vi bënin pjesëtarë të luftës.

Inteligjencia shqiptare në atë kohë ishte e vogël numerikisht dhe kjo ishte rrjedhim i zhvillimit të ulët ekonomik e kulturor dhe i politikës obskurantiste të regjimit të Zogut. Mbreti -august- dhe rrethi i tij, veç gjithë plagëve të tjera që i shkaktoi vendit, bëri çmos ta unte Shqipërinë në errësirë e në padituri, sepse errësira dhe injoranca e masave janë aleati më i mirë për shtypjen dhe shfrytëzimin. As nuk bëri Zogu dhe regjimi i tij për kulturën, artin dhe shkencën, sado që hiqej si përkrahës i tyre, bashkë me motrat e veta të degjeneruara e të korruptuara, që për ironi, me gjithë injorancën e tyre merrnin në «patronazh» artet, kulturën e sportet, të cilat thuajse s'ekzistonin në Shqipëri.

Sidoqoftë, me përpjekjet e popullit, të bijve dhe bijave të tij, dhe kundër dëshirës së regjimit feudo-borgjez, u bë e mundur të ngrihej një sistem arsimor me shkolla të ulëta e të mesme, ku të mësonin djemtë dhe vajzat e popullit që ky me intuitën e vet të pagabueshme e me horizontin e gjerë të historisë, i përgatiti për ditët e reja. Me vështirësi të mëdha e duke përballuar privacione të shumta ekonomike, disa prej tyre vajtën edhe jashtë vendit, ku ndoqën studimet e larta. Të gjithë këta përbënin pjesën më të shëndoshë të inteligjencies shqiptare, që i kundërvihej asaj pjesa antipopullore e reaksionare, me origjinë nga bejlerët, fajdexhinjtë e tregtarët.

Në masën e intelektualëve, në kohën për të cilën flas, mësuesit dhe profesorët përbënin shumicën, ndërsa nga profesionet e tjera, si mjekë, inxhinierë e juristë, këta ishin në një numër më të paktë. Inteligjencia nuk ishte një masë homogjene, qoftë nga prejardhja shoqërore, qoftë nga bindjet politike që i kishte të papërcaktuara. Veç kësaj, me përjashtim të një pjese, sidomos të mësuesve të fshatit, inteligjencia nuk ishte aq e lidhur me popullin, dhe hallet e tij i njihte përciptas, me të dëgjuar. Kjo nuk do të thotë se ajo nuk ishte patriotë. Jo, inteligjencia shqiptare, në përgjithësi, ishte

patriote e antizogiste dhe më vonë e vërtetoi patriotizmin e saj në qëndrimin e luftën e vet kundër pushtuesit.

Më afër popullit ishin mësuesit, të cilët qenë më të lidhur me të, me mjerimet dhe me hallet e tij. Në piramidën e vogël të arsimit në regjimin e Zogut këta ishin në fund, përbuzeshin nga «aristokracia» intelektuale, shikoheshin me dyshim nga regjimi dhe paguheshin shumë pak. Por edhe rrogën e tyre të vogël e merrnin një herë në 5 muaj, kishte raste edhe një herë në 9 muaj dhe, për të jetuar, venin e shitnin rrogën te sarafët, duke marrë sigurisht më pak. Kështu bëja edhe unë gjatë disa muajve që punova në Gjimnazin e Tiranës në fund të vitit 1936 e në fillim të vitit 1937 e që paguhesha vetëm me orë dhe nuk kisha një rrogë fikse dhe, kur sëmuresha ose në pushimet e shkollës, nuk merrja asnjë lek.

Në përgjithësi mësuesit kishin mbaruar një shkollë ose gjysmë shkolle brenda vendit. Rrallë ndonjëri dinte ndonjë gjuhë të huaj, por edhe literaturë të huaj që të lexonin e të zhvilloheshin, nuk kishte. Kjo kategori intelektualësh ishte me popullin, e urrente në kulm regjimin e Zogut dhe funksionarët e lartë të tij. Pjesëtarët e saj ishin shumë të lidhur me nxënësit dhe me familjet e tyre, ishin patriotë e demokratë dhe, kur Shqipëria u pushtua, ata u bashkuan me punëtorët e me nxënësit në demonstrata kundër pushtuesve dhe shumica u hodh në luftën partizane.

Një shkallë më të lartë zinin në hierarkinë e arsimit, dhe në përgjithësi të inteligjencias, «profesorët», siç quheshin në atë kohë mësuesit e shkollave të mesme. Ndryshe nga mësuesit, këta, në përgjithësi, ishin më larg popullit dhe puna me ta ishte më e ndërlikuar. Sigurisht, ndër profesorët kishte edhe mjaft nga ata që e donin atdheun, popullin, që e urrenin regjimin feudo-borgjez, që urrenin pushtimin fashist dhe u lidhën me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe me Partinë. Por shumica e tyre u integruan në sistemin shtypës të Zogut e të fashizmit, ishin të kënaqur me gjendjen e vet, se, sa për gjendjen e masave, për këtë

s'e bënë qejfin qeder. Këta lloj intelektualësh mbahe-shin me të madhe si «elita» e arsimit, mburreshin se ishin «inteligjencia e vendit» dhe se «regjimi kishte nevojë për ta». Mjaft prej tyre kishin dalë jashtë, ku kishin mbaruar shkolla të larta, kush në Itali, kush në Francë, kush në Austri e Gjermani, kush në Greqi, disa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kishte dhe nga ata të vjetrit, që kishin bërë shkollën turke.

Pjesëtarët e «elitës intelektuale» ishin edhe mjekët, inxhinierët, arkitektët, agronomët e të tjerë, pa harruar si ata që mbaronin drejtësinë dhe bëheshin avokatë ose gjyqtarë, ashtu edhe gazetarët, në radhët e të cilëve kishte edhe disa të njohur, një pjesë me prirje e pikëpamje demokrate e përparimtare, pjesa tjetër e vënë kokë e këmbë në shërbim të regjimeve reaksionare e antipopullore. Sigurisht këtu përjashtoj intelektualë të tillë, si: Medar Shtylla, Omer Nishani, Xhafer Kongoli, Gaqo Tashko e dhjetëra të tjerë, që i përmend në këto shënime, të cilët e njihnin gjendjen dhe situatën e vështirë të masave e që u treguan me vepra demokratë e patriotë të atdheut të tyre. E kam fjalën këtu për ata intelektualë që, pasi kishin marrë arsimin e lartë me paratë që baballarët e vet ua kishin rrjepur punëtorëve e fshatarëve, vinin në Shqipëri me pretendimin se sillnin kulturën e qytetërimit, por, në fakt, vinin për të marrë edhe ata pjesën e vet nga shfrytëzimi i masave. Asgjë reale s'kishin marrë ata prej qytetërimit evropian, veç ndonjë gjuhe të huaj, ca njohurive nga zanati që kishin mësuar dhe «etiketës moderne» e ndonjë cilindri a papijoni që nuk i ndanin as në rrugë, as në kafene. Dhe këta intelektualë të qytetëruar s'e kishin për turp të dilnin në ankand për t'u martuar, se thuajse të gjithë qenë të pushtuar nga mania e prikës. Është e natyrshme që mjaft prej tyre borgjezoheshin, «pistonoheshin» në ofiqe të larta, bëheshin «shembuj» për të tjerët me më pak fat. Këta njerëz ishin të humbur për çështjen e popullit, ishin «demokratë» të përciptë, «liberalë» vetëm nga disa shfaqje që qenë mbeturina nga vendet ku kishin mësuar.

Intelektualët me shkolla të larta dhe me pozita të larta, në përgjithësi, ose ishin integruar dhe ishin bërë shtylla të regjimit, ose edhe kur ishin demokratë dhe antizogistë, nuk e shihnin qartë të ardhmen e vendit. Kishte nga ata që nuk e donin Zogun dhe regjimin

e tij dhe që thellë në ndërgjegje ishin antizogistë, por këta jo vetëm që nuk vepronin, por edhe të shfaqnin hapur pikëpamjet e tyre nuk guxonin. Numëroheshin ata të paktë që flisnin hapur, sigurisht jo në mes të rrugës, kundër Zogut dhe regjimit të tij. Por edhe këta tirnin biseda «akademike» rreth ligjeve, masave, çmimeve, ministrave etj., por që të gjeje në ta një frymë konsekuente rezistence ose, aq më pak një tentativë rezistence, ishte shumë e zorshme, për të mos thënë e pamundur. Sigurisht, kjo ndodhte edhe nga fakti se Zogu, të cilin e shanin, ua kishte zënë gojën, sepse në një kohë kur në popull mbretëronte mizerja ekonomike, kur punëtori punonte tërë ditën, duke çarë gurë në mes të vapës dhe merrte 2-3 lekë në ditë, kjo kategori njerëzish merrte 10-15 napolona ar në muaj dhe visheshin mirë, kishin shtëpi komferte, me mobilie e me radio. Kështu që edhe ata elementë me ndonjë cipë demokratike e antizogiste e gjenin më të udhës të zinin një pozicion komod: edhe të mirat që u jepte regjimi t'i gëzonin, edhe të lëshonin ndonjë kritikë vesh më vesh kundër tij.

Në përgjithësi, këta intelektualë sapo ktheheshin nga jashtë synonin të zinin punë të mira, veçanërisht në Tiranë. Në atë kohë edhe për agronom, edhe për inxhinier të kishe mbaruar, vendin e kishe në ministri dhe, në qoftë se nuk kishte vend, krijohej, sepse as agronomët, as inxhinierët s'kishin ku të punonin; bujqësia ishte në një nivel fare të ulët dhe asnjë investim nuk bëhej në favor të saj; për t'u ndërtuar nuk ndërtohej gjë veç ndonjë burgu dhe shtëpive për pasanikët. Kështu që agronomi rregullohej në ndonjë zyrë, kurse inxhinieri e bënte planin e shtëpisë së tregtarit të madh që nga Tirana. Mjekët, nga ana e tyre, fillonin të nxirrnin paranë, kurse profesorët konkurronin me njëri-tjetrin kush të zinte një vend në Tiranë ose në ministri dhe, në qoftë se nuk arrinin dot, shkonin në disa qytete ku kishte shkolla të mesme, por që ishin të pakta.

As që mund të bëhej fjalë për organizim në radhët e inteligjencies. Sigurisht, mes pjesës më të shëndoshë të saj kishte përpjekje për të bërë diçka për të ndryshuar gjendjen ekzistuese, një pjesë u lidhën me grupet komuniste, por këto lidhje qenë të pakta e mbi baza individuale. Në radhët e intelektualëve, tek «elita», ku hynin profesorët, mjekët, juristët, gazetarët e njerëz të profesioneve të tjera, ekzistonte një lloj ndarjeje, e mbështetur në lidhjet dhe afinitetet e krijuara nga lloji i kulturës dhe nga vendi ku e kishin marrë. Pra, qarkullonin opinione të tilla, si «filani është i doçkulturës», pse kishte mësuar në Austri ose në Gjermani, «filani është i kulturës franceze», pse kishte mësuar në Francë, ai që kishte mësuar në Itali ishte «i kulturës italiane» e kështu me radhë. Kjo tendencë që krijonte afinitete formale në mes grupeve, nxiste një frymë ksenomane dhe sillte shkëputjen e inteligjencies nga problemet kryesore që preokuponin atdheun dhe popullin.

Kur isha në Tiranë, para pushtimit të vendit nga Italia fashiste, përveç lidhjeve me intelektualë përparimtarë e demokratë, më ishte dhënë rasti të bija në kontakt edhe me ambientet, mendimet e psikologjinë e asaj pjese të intelektualëve, që regjimi e përkëdhelte. Në «Rrugën mbretërore» ndodhej një kafene e vogël, por që në atë kohë dukej e madhe dhe quhej «Bela Venecia». Në lokalet e kësaj «Bela Venecia» vinte «elita» e kryeqytetit dhe spiunët e mëdhenj të regjimit që nga Fuat Asllani, ministër i Jashtëm e ministra të tjerë deri te «personalitetet e larta të kulturës». Mblidheshin atje, sipas zakonisht anglez, në *five o'clock** *(Anglisht - ora shtatëmbëdhjetë.). Nja dy herë më mori me vete një shok dhe shkova edhe unë në këtë klub të «elitës» intelektuale. Dhe ç'pashë atje? Një rreth kozmopolitësh, arrogantësh e mendjemëdhenjsh. Ishte diçka e neveritshme t'i shihje kur hanin kek e pinin çaj me mënyra «aristokrate» e me naze si damat në sallone. Atje dëgjoje të fliteshin lloj-lloj gjuhësh, sipas klaneve dhe shqipja flitej përzier me fraza të tëra në gjuhë të huaja, ashtu siç kemi lexuar te Tolstoi për aristokracinë ruse, e cila përziante rusishten me frëngjishten. Në këto rrethe flitej për «politikë të madhe» e bisedohej për artin. Aty dëgjoje gjykime të dhëna me një «kompetencë absolute» për Çembërlenin, për Tituleskun, për Hitlerin, për «Zarathustrën» e Niçes, për «Faustin» e Gëtes, për Nibelungët, por asnjë fjalë nuk flitej për mjerimin e fshatarit të Myzeqesë që e rripnin Zogu, Vrionët e Vërlacët dhe e vdiste malarja.

Këtyre njerëzve ishte e rrezikshme t'u hapeshë, këta të dorëzonin te Zogu dhe te pushtuesi, në mos drejtpërdrejt, të kallëzonin tërthorazi. Por, siç trashë, nuk ishte e tërë inteligjencia kështu.

Këtë të vërtetë, personalisht e dija nga lidhjet që kisha krijuar me një rreth të tërë mësuesish e intelektualësh të profesioneve të ndryshme gjatë viteve të punës në Gjymnazin e Tiranës e në Liceun

e Korçës. Por fakt është se lidhjet tona me intelektualët u zgjeruan më tepër dhe u vunë në baza më të shëndosha pasi Grupi i Korçës e kaloi qendrën e gravitetit të punës së vet në Tiranë, në fillim të vitit 1940 e, sidomos, pas themelimit të Partisë, kur punën me intelektualët e vlerësuam si një ndër sektorët më të rëndësishëm të punës së Partisë me nacionalistët.

Unë, sikurse edhe shokë të tjerë, vazhdoja të zgjeroja lidhjet me ish-kolegët e mi mësues, antizogistë e antifashistë, si me vëllezërit Tashko (Aleko e Gaço), me Aleks Budën, Minella Karajanin, Nonda Bulkën. Sotir Angjelin. Baltadorin, Nexhat Peshkëpinë (i cili më vonë u bë ballist dhe u arratis në pragun e Çlirimit), me Vangjel Gjikondin, me Selim Shpuzën dhe me shkrimtarin e IDublicistin, Shevqet Musarain, i cili më vonë u bë anëtar aktiv i Komitetit Qarkor të Partisë të Tiranës dhe me punët e shkrimet e tij dha një kontribut të snquar për propagandën e Partisë e të Luftës Nacionalçlirimtare.

U afruam edhe me shumë intelektualë të tjerë, si me mjekët Xhevdet Asllani. Fejzi Hoxha, Enver Zazani, Hasan Jero, arkitekt Luarasin, me inxhinierë si Andon Lufi. Llazar Treska, Rrapin (nuk e di ç'u bë më vonë), me ekenomistin Pasko Milo, me Naum Strallën e disa të tjerë. Pati mjaft prej tyre që u bashkuan që në ditët e para me popullin e me Partinë në luftë kundër pushtuesve. Një ndër këta ishte edhe shoku im i luftës dhe i punës, Haxhi Kroji, i cili është nipi i Avni Rustemit dhe ndoqi me besnikëri të madhe rrugën patriotike të mësuesit të madh të popullit dhe luftoi e punoi si sekretari im me kompetencë dhe me një besnikëri shembullore si një anëtar nga më të vjetrit të Partisë.

Afruam edhe Abaz Xhomon, një shok të vjetër, të cilin e kisha njohur në Lice dhe në Francë, si dhe elementë të tjerë antifashistë, si Ali Bakiun dhe Syrja Selfon, të cilët, megjithëse tregtarë, e ndihmuan luftën. Sidomos Syrjai nuk kurseu asgjë për Luftën Nacionalçlirimtare dhe ishte gati të na gjente e të paguante qiratë për shtëpitë që na duheshin si baza për shokët ilegalë. Bile ai edhe familjen time, e cila gjatë luftës nuk kishte asnjë të ardhur, e ndihmoi dhe e mbajti materialisht.

Kështu rrethet tona po zgjeroheshin edhe me intelektualë të tjerë. Ca nga këta i njihja unë, ca Koço Tashkoja, megjithëse ky punonte veçanërisht me pleqtë nacionalistë të arratisur në kohën e Zogut e që u kthyen me «vagonët» e Italisë fashiste.

Një nga përfaqësuesit më të mirë të inteligjencies dcmckratike shqiptare, i cili qysh në fillim e lidhi jetën e ti; me çështjen e çlirimit je atdheut ishte edhe doktor Medar Htvlla. Medari ishte një njeri patriot e për parimtar, i lidhur me popullin, kishte mbaruar Liceun e Korçës, por më parë se unë, pse mbaj mend që kur shkova atje nga Liceu i Gjirokastrës, atë nuk e gjeta në bankat e shkollës. Pastaj kishte shkuar në Francë, më duket, në Tuluzë, ku mësoi për veterinari. Vetë drejtimi i studimeve të larta që kishte zgjedhur, të linte të kuptoje se ai ishte njeri popullor, i afërt me fshatarësinë, me tokën, me kafshët dhe nuk kishte zgjedhur një profesion të modës dhe me fitim si mjek ose avokat.

E njoha mirë Medarin kur u ktheva nga Franca dhe më pëlqeu, e doja dhe u lidha me këtë njeri me njohuri e kulturë të gjerë, të thjeshtë, të qetë, të ndershëm, që të ngjallte respekt. Ishte i heshtur, nuk bënte «bujë», nuk i pëlqenin mburrjet, dukjet. Disa intelektualë që hiqeshin të zgj uar, ironizonin e thoshin për të: «Është i heshtur, se merret me kafshë». Por Medar Shtylla ishte një burrë me karakter, me kurajë, i mençur, i dashur. Ai e donte me gjithë shpirt atdheun dhe popullin dhe këtë gjë e provoi në momentet më të vështira.

Më kishin folur shokët e të njohurit për simpatinë e respektin që gëzonte Medari në fshatrat e Durrësit. Dhe s'kishte si të mos e donin fshatarët e Durrësit, Kavajës, Shijakut dhe punëtorët e fermës së Xhafzotajt Medar Shtyllën, i cili ishte lidhur ngushtë me hallet dhe shqetësimet e tyre. Ai luftonte për të drejtat e punëtorëve, që nuk paguheshin rregullisht, i nxiste të ngrinin zërin dhe të protestonin edhe deri në Ministrinë e Bujqësisë të asaj kohe. Medari e njihte mirë forcën e punëtorëve, të fermës dhe të fshatarëve, por ai njihte mirë edhe frikën që kishin nga kjo forcë qeveritarët e shitur. Kështu, të trembur nga shpërthimi i ndonjë revolte, pavarësisht se nuk u vinte mirë, autoritetet ishin të detyruara t'i plotësonin qoftë edhe pjesërisht kërkesat punëtorëve të fermës. Në kufi me fermën e Xhafzotajt shtrihej shoqëria italiane «Italba», e cila synonte të fuste në kthetrat e veta dhe tokat e kësaj ferme. Medar Shtylla, që e njihte mirë karakterin shfrytëzues të imperializmit italian dhe që i dhimbej jeta e fshatarëve të varfër, toka e atdheut të tij të dashur, luftoi me mish e me shpirt që synimet e shoqërisë italiane të mos realizoheshin. Me këto veprime ai

fitonte zemrën e popullit dhe armiqësinë e autoriteteve. Ai jo vetëm që sillej me punëtorët e fermës si i afërt, por mundohej që t'u krijonte edhe kushte jetese. Medari ngulte këmbë që punëtorët e Xhafzotajt të paguheshin më tepër dhe, në fakt, ata merrnin më shumë se punëtorët që punonin në shoqërinë italiane. Por kjo nuk u shkante për shtat shfrytëzuesve që majmeshin me djersën dhe gjakun e popullit fukara, prandaj ata kërkonin që punëtorët e Xhafzotajt të paguheshin njëllor si ata që punonin në shoqëritë italiane. Medari protestoi dhe luftoi për të kundërtën. Të gjitha këto e kishin afruar Medar Shtyllën me fshatarët dhe punëtorët, të cilët i hapeshin atij për çdo hall që i shqetësonte. Por ajo që i lidhte më fort ishte ndjenja e madhe e dashurisë për atdheun dhe lirinë, ishte ndjenja e urrejtjes që donte të shpërthente për të luftuar dhe për të shpërrur nga trojet tona të huajin.

Pushtimi italian e gjeti doktor Medarin veteriner në Durrës. Ishte periudha kur komunistët e grupeve intensifikuan punën për krijimin e Partisë. Në këtë kohë unë, si dhe shokët e tjerë, - merrja vazhdimisht kontakt me shokë komunistë, me punëtorë, me inter lektualë të njohur, me «nacionalistë», siç i quanim atëherë dhe më pas patriotët pa parti. Shkova një ditë në Durrës dhe u poqa me shokun tonë Telat Nogën për të biseduar me të për disa probleme të punës sonë dhe, mes të tjerash, edhe për çështjen e inkuadrimit në lëvizjen çlirimtare të elementëve intelektualë patriotë. Aty i thashë Telatit:

- Dua të vete të takoj një mikun tim, Medar Shtyllën, që ta aktivizojmë. Nuk di, a e njeh?

Telati më thotë:

- Sa mirë ke menduar, Enver, se të gjithë flasin me respekt për të. Nëpërmjet tij ne do të depërtojmë më tepër në fshat, pse fshatarët e duan.

Në këtë kohë Medari kishte filluar, si të thuash, rezistencën, duke demaskuar okupatorin, tradhtarët dhe kuislingët, aparatit shtetëror fashist, pseudopatriotët dhe pseudoantizogistët, të cilët i njihte mirë dhe e kishte parë me sytë e tij kur këta putheshin dhe përqafoheshin me fashistët. Isha i bindur se ky do të ishte qëndrimi i Medarit. Nga njohja që kisha me të si dhe nga fjalët e Telatit isha i sigurt se ne do të kuptoheshim fare mirë dhe se do të lidheshim fort me njëri-tjetrin, si dy ushtarë të thjeshtë të popullit dhe të çështjes së tij.

E kërkova dhe e gjeta të ulur në një kafene, në rrugën që të çonte në port. Sa i shkova afër, më pa dhe, me atë të sjellurën e tij aq të ëmbël, u ngrit e, si u përshëndetëm, më ftoi të rrija:

- Hajde Enver, ulu të pish një kafe nga unë.

E falënderova dhe u ula. Shkëmbyem pyetjet e përgjithshme në takime të tilla, pastaj më preti a më dilte ndonjë çikë dhe a fitoja gjë me shitjen e cigareve në dyqanin «Flora» dhe mbasi iu përgjigja se nxirrja aq sa për të jetuar e pyeta edhe unë si shkante me punë.

-- Ja, - më tha, - përpiqem të bëj diçka, se nuk e duroj dot këtë mbytje.

- Na kanë zënë në grykë, o Medar, prandaj duhet t'u tregojmë vendin këtyre pipinove të pispillosur, i thashë duke i treguar disa oficerë italianë që po shëtisnin duke folur e duke qeshur me zhurmë.

- *Les salauds!** *(Frëngjisht - maskarenjtë!), - tha Medari dhe vazhduam bisedën me zë të ulët në frëngjisht, pse kështu s'kishte rrezik që ndonjë spiun të na kuptonte. Edhe ajo kafene, si gjithë kafenetë në atë kohë, me siguri që i kishte spiunët e vet permanentë.

- Duhet të luftojmë, - i thashë Medarit. - Ne po riorganizohemi, populli na dëgjon dhe duhet të ecim drejt luftës çlirimtare. Sigurisht që ka rreziqe kjo luftë, mund të lëmë edhe kokën, por për çlirimin e atdheut çdo sakrificë duhet bërë, prandaj ne e kemi marrë parasysh vdekjen.

Kështu vazhduam bisedën ndonjë gjysmë ore, kokë më kokë.

Medari, mbasi më dëgjoi me vëmendje, më tha me vendosmëri:

- Jam gati të luftoj, asnjë pengesë nuk kam. Gruaja ime, Maria, që ti e njeh, - vazhdoi ai, - vërtet është italiane, por ajo e urren fashizmin si edhe ne: (Dhe ajo dha prova të ndjenjave të saj antifasciste e të dashurisë për Shqipërinë, si bijë populli që ishte, duke qëndruar në ilegalitet në Tiranë gjatë gjithë kohës që Medari ishte me ne në male.) - Më thuaj, Enver, ç'duhet të bëj, - kërkonte Medari, - ç'veprime duhet të kryej, me kë do të mbaj lidhje?

- Eja në «Flora», - i thashë, - bëj sikur vjen të blesh ndonjë paketë cigare dhe atje bisedojmë më qetë, - dhe pasi shtrënguam duart fort me njëri-tjetrin, u ndamë.

Me sa mbaj mend nuk arritëm të takohemi në «Flora», sepse unë u detyrova të largohem që andej e të hidhem në ilegalitet, por lidhjet me Medarin i ruajtëm nëpërmjet shokëve të tjerë. Ai u lidh ngushtë me luftën dhe Partia e Fronti Nacionalçlirimtar e ngarkuan atë të punonte me fshatarët, me intelektualët etj. Më vonë, kur veprimtaria e tij filloi të binte në sy, Medari u hodh në ilegalitet e u bë organizator i palodhur i këshillave nacionalçlirimtarë, në qytete dhe në fshatra. Bashkë u takuam prapë në Labinot, në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare, ku Medari u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm. Edhe në këtë funksion ai qe ndër më aktivët. Ai dërgohej me detyra dhe vinte na raportonte atje ku ndodheshin Këshilli dhe Shtabi i Përgjithshëm, në Çermenikë, në Shmil, në Gurakuq, në Orenjë, në Shtyllë etj. Si kurdoherë i dashur, i buzëqeshur dhe i thjeshtë, Medari raportonte, merrte detyrat, drejtimit dhe ikte.

Ndërkohë shokët e tjerë në të gjithë vendin punonin dhe arrinin rezultate si në punën me intelektualët, ashtu edhe me patriotët dhe me elementët e tjerë përparimtarë. Kështu, duke punuar me durim po zgjeroheshin radhët e simpatizantëve të lëvizjes çlirimtare, po rritej numri i elementëve patriotë e demokratë të vërtetë, që shprehnin gatishmërinë për të luftuar krahas gjithë popullit shqiptar, krahas komunistëve për të çliruar tokën e shtrenjtë të atdheut nga çizmja e fashistëve të Musolinit. Komiteti Qendror ngarkoi edhe njerëz, të cilët do të merreshin posaçërisht me këtë drejtim të punës së Partisë dhe këta ishin Koço Tashkoja, Anastas Lula e Mustafa Gjinishi. Por e vërteta është se puna kryesore në drejtim të nationalistëve u bë nga takimet e kontaktet e të gjithë shokëve të Komitetit Qendror dhe e shokëve të tjerë në bazë e në qendër. Anastas Lula e kishte mendjen jo të rriste influencën e Partisë, por ta minonte atë dhe të krijonte fraksionin e vet bashkë me Sadik Premten. Koço Tashkoja me pleqtë e tij mbyllej nëpër kafene e bënte me ta - politikë të madhe», kurse Mustafa Gjinishi ishte më aktiv, por në kontaktet e lidhjet e tij kishte gjithmonë gjëra të dyshimta e mistere. Kështu që në të vërtetë kjo «ndarje pune» nuk pati jetë të gjatë dhe, faktikisht, të gjithë merreshim me këtë problem. Në Tiranë dhe në qytetet e krahinat e tjera të vendit u zhvillua një aktivitet i dendur nga shokët komunistë, duke u takuar e duke biseduar me elementë që jepnin shpresa.

Kam folur hollësisht në kujtimet e mia për takimet e shumta e lidhjet e fuqishme që krijova qysh pas pushtimit fashist me patriotin demokrat e revolucionar, Myslim Pezën, i cili ishte ndër të parët që u lidh ngushtë me Partinë e me programin e saj dhe dha një kontribut të shquar për realizimin e këtij programi. Po ashtu, si unë dhe shokët e tjerë, para e pas themelimit të Partisë, kishim hyrë në lidhje e kishim gjetur gjuhën e përbashkët, gjuhën e luftës, për liri e pavarësi me elementë të tjerë patriotë. Një ndër këta ishte edhe Baba Faja Martaneshi, të cilin do ta takoja në ditët e Konferencës së Pezës, por që shokët më kishin informuar qysh më parë për pikëpamjet e tij antiitaliane, për influencën e tij në popullin e krahinës së Martaneshit. Baba Faja ishte nga ata klerikë që mbante taçin dhe xhyben e dervishit, por në zemër kishte Shqipërinë dhe në dorë pushkën për çlirimin e saj. Veprimtaria e tij, bisedat që bënte ai me miqtë e me shokët dhe me besimtarët e hallexhinjtë që i vinin në teqe, mbledhjet nën pamjen e gostive fetare, u kishin rënë në vesh këmishëzinjve. Siç më tregonte më vonë Baba Faja, kur kishte ardhur njëherë në Tiranë, i kishte vajtur në hotelin ku grinte Hilmi Leka me një makinë të karabinierëve, e kishte marrë me vete dhe e kishte çuar te gjeneral Agostinuçi. Baba Fajën e kishin pyetur, e kishin kërcënuar, e mbajtën dhe pak ditë të arrestuar, po, meqë s'kishin fakte të shumta dhe, meqë ishte njeri me influencë në popull, e liruan.

Baba Faja u kthye në Martanesh dhe vazhdoi punën në teqetë e tij, se kishte dy teqe në Martanesh, një poshtë në fshat dhe një më sipër, ku Babai grinte gjatë verës. Për ta pasur nën kontroll, italianët ngritën edhe një postë karabinierësh pranë njërës nga teqetë, por Mustafai një të ngritur bëri dhe shkoi u vendos në teqenë tjetër.

Partia dërgoi njerëz të takoheshin me Mustafa Xhanin. Që pas themelimit të Partisë, Qemal Stafa dhe Sami Baholli u takuan me Mustafa Xhanin, kurse më pas në teqenë e tij kanë shkuar të dërguar nga udhëheqja e Partisë Ramadan Çitaku, Kadri Hoxha e të tjerë.

Babai patriot qe en;uziast dhe optimist për luftën që kishim filluar dhe nuk kaloi shumë kohë dhe në krye të martaneshasve rrëmbeu armën, krijoi çetën dhe filloi luftën e armatosu°. Por xhyben dhe taçin nuk i hoqi Baba Faja dhe mirë bëri, se kështu i shërbente akoma më shumë vijës së Partisë dhe të Frontit Nacionalçlirimtar për bashkimin në luftë të të gjithë njerëzve pa dallim krahine, bindjesh politike, fetare. E kam parasysh portretin e këtij njeriu të mirë, trim e të ndershëm: një burrë i pashëm, me vetullat e zeza të trasha, me syrin pishë dhe me mjekrën që i shkante shumë fytyrës së tij të gjerë.

Nëpërmjet Myslimit u vumë në kontakt edhe me Haxhi Lleshin, i cili, pasi qe kthyer ilegalisht nga Jugosllavia, rrinte i fshehur në krahinën e Dibrës. Haxhiu shkante shtëpi më shtëpi në Zerqan, në Homesh e në zona të tjera, bënte propagandë antifashiste, i nxiste fshatarët të mos paguanin taksat e të ngriheshin në kryengritje të armatosur. Autoritetet fashiste bënë çmos të shtinin në dorë Haxhiun, por populli e ruante birin e vet, sepse i njihte mirë traditat patriotike të familjes së Haxhiut, por edhe qëndrimin që kishte mbajtur vetë Haxhi Lleshi para okupacionit fashist.

Po kështu shokët e Partisë në Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë, Dibër, Skrapar, Shkodër, Tropojë, Berat, Kurvelesh, Kukës, Myzeqe etj. zgjeruan lidhjet e tyre me patriotët e këtyre krahinave, me popullin trim e lirisdashës të tyre. Në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare u bashkuan kështu qysh në fillim elementë patriotë, si: Spiro Moisiu, Zylyftar Veleshnja, Riza Kodheli, Hysen Zaloshnja, Sinan Ylli, Hasan Pulo, Rexhep Sulejmani, Ali Niman Doçi, Hasan Gërzhalliu, Shaban Arra e shumë të tjerë.

Në kuadrin e gjithë kësaj pune, në këtë periudhë ne, jo vetëm humbëm ndonjë iluzion që kishim pasur për disa elementë që kishin ruajtur artificialisht namin e patriotit, por kuptuam se në skenën e luftës ideologjike, politike e ushtarake, që po zhvillohej e do të rritej gjithnjë e më tepër, po dilte një rrezik i ri: krahas kuislingëve të hapur që Jakomoni i kishte bërë kryeministra e ministra, senatorë e prefektë, po kristalizohej në forma më të maskuara një gardë pretoriane e regjimit fashist, më e rrezikshme dhe më e pabesë se Vërlacët e Merlikat, sepse pjesëtarët e saj, si: Mithat Frashëri, Ali Këlcyra, Kolë Tromara blonin në mënyrë të paturpshme me rolin e demokratit, patriotit, bile edhe të antiitalianit.

Ky rol e nam prej «patriotësh demokratë», këtyre elementëve u kishte mbetur nga një e kaluar disi e largët, nga koha kur Shqipëria, pasi fitoi pavarësinë, me mundime e përpjekje të mëdha përpiquej të futej në rrugën e përparimit e të zhvillimit dhe të konsolidonte pavarësinë. Në mënyrë të veçantë në jetën e këtyre elementëve një ndikim të dukshëm do të luanin sidomos ngjarjet e shumta e tepër komplekse të viteve 1920-1925.

Kjo qe një periudhë e një lufte të fortë politike, në të cilën po evidencohej një brez i tërë revolucionarësh e demokratësh që bënë thirrje e luftonin për të shkatërruar feudalizmin e për ta shpëtuar vendin tonë nga kthetrat e fuqive imperialiste. Demokratët revolucionarë, si: Avni Rustemi, Halim Xhelo e të tjerë ishin bij të vërtetë të popullit fukara, antifeudalë, luftëtarë për një demokraci të vërtetë revolucionare konsekuente. Këta donin dhe luftonin për çlirimin e bujkut nga zgjedha e feudalëve dhe e borgjezisë, ishin dhe luftuan për Reformën Agrare dhe për pavarësinë ekonomike të vendit. Kështu elementë e kuptonin rrezikun që i kanosej vendit nga fuqitë imperialiste dhe e mbështetnin Luigj Gurakuqin që ishte kundër dhënies së koncesioneve të vajgurit fuqive të huaja, si Anglisë, Italisë etj. Por hëvizja demokratike e asaj periudhe nuk ishte kompakte dhe në gjirin e saj kishte elementë e grupe me prirje e pikëpamje të ndryshme politike. Avni Rustemi cShe shokë si ai ishin përfaqësues të krahut radikal në këtë lëvizje dhe nuk kishin shumë besim në «reformat» që gjoja kërkonin «demokratët» e tjerë, ndaj me të drejtë mendonin se duheshin organizuar masat popullore dhe duhej përdorur edhe dhuna, po të paraqitej nevoja. Avni Rustemi ishte themeluesi dhe shpirti i organizatës «Bashkimi», programi i së cilës ishte mjaft përparimtar për kohën dhe kishte një aktivitet të gjërë e të shtrirë në të gjithë vendin. Me idetë revolucionare dhe me aktivitetin politik kjo organizatë po merrte tiparet e një partie demokratike revolucionare, ku brezi i ri do të përbënte forcën kryesore. Përkundrazi në fakt shoqëria «Bashkimi» e themeluar nga Avni Rustemi pati sukses e krijoi edhe degët e saj në qytete të ndryshme të vendit, fitoi influencë dhe

autoritet. Ishte kjo organizatë që organizoi në Fier demonstratën e popullit, i cili kaloi përpara konakëve të bejlerëve feudalë Vrionas me një arkivol përpara, duke hedhur parulla revolucionare, si «Feudalizmin do ta vari-osim» dhe «Tokën do t'ia ndajmë fshatarësisë».

Feudalët, bejlerët dhe agallarët, duke parë V-rezikun që u turrej, bënë çmos që ta shuanin këltë lëvizje dhe një nga aktet e dëshpëruara të reaksionit që vrasja e Avni Rustemit në Tiranë. Me këtë veprim koalicioni feudal mendonte ta trembte popullin dhe elementët demokratë e revolucionarë dhe t'i hiqte lëvizjes një nga udhëheqësit e vet më të shquar. Por nuk ndodhi ashtu. Populli u revoltua edhe më tepër nga vrasja e birit të vet. Trupin e Avniut e çuan në Vlorë, ku e varrosën me nderime të mëdha dhe me pjesëmarrjen e një numri të madh njerëzish. Si tani më kujtohet sa na tronditi lajmi i vrasjes së Avniut. Po rrinim një ditë me shokë në krye të Pazarit, kur vjen Bahri Omari, burri i motrës sime të madhe, Fahrijes, më heq mënjandë dhe më thotë:

- Shko shpejt në shtëpi, më merr valixhen dhe ma sill e u thuaj se do të nisem për Vlorë, se bejlerët na vranë Avni Rustemin.

Unë u shtanga. U nisa me vrap, mora valixhen dhe ia solla me një frymë. Bahri Omari në atë kohë ishte deputet i Gjirokastrës, përfaqësues i «Opingës», i grupit demokratik, i cili ishte në kundërshtim me Myfit Libohovën dhe mbështetësit e tij.

Me të ardhur lajmi, dega e organizatës «Bashkimi» në Gjirokastrë mobilizoi anëtarët e saj, të cilët, të armatosur me pushkë, hipnin në kamionë për të marshuar mbi Tiranë. U sulmëm edhe ne më të rinjtë dhe donim t'u qepeshim kamionëve, por na penguan se gjoja ishim akoma të rinj, se nuk kishte armë etj. Më kujtohet se mua dhe Kiço Karajanin na pengoi dhe na tërhoqi dr. Karajani, babai i Kigos.

Vrasja e Avni Rustemit e zemëroi popullin. Nga Vlora u dha kushtrimi dhe Revolucioni i Qershorit shpërtheu. Që nga Kruima e Dragobia, nga Vlora e Gjirokastra, nga Korça je nga të katër anët e vendit, u nisën për të sulmuar feudalët në Tiranë me mijëra vullnetarë. Këta i udhëlniqnin, në radhë të parë, anëtarët e organizatës «Bashkimi».

Revolucioni fitoi dihe forcat kryengritëse, pasi shpartalluan mercenarët e Ahmet Zogut që u arratis në Jugosllavi, hynë në Tiranë ku u formua qeveria demokratike borgjeze e INolit. E dimë fatin e qeverisë së Nolit, njohim punën dhe veprimtarinë politike, aspak në favor të reformaive politike dhe ekonomike të elementëve «demokratë» të asaj kohe. Nuk do të zgjatëm këtu, por dua të theksoj vetëm se qeveria e Nolit nuk u mbështet në masat, nuk zbatoi reformat e mëdha që ishin premtuar, elementët borgjezë që e formonin dhe e mbështetnin atë nuk u treguan konsekuentë dhe luftarakë për të realizuar programin që kishin shpallur. Noli vetë pati frikë ta gonte revolucionin përpara duke përdorur edhe dhiunën, ai nuk u mbështet në vrullin revolucionar të rmasave dhe të patriotëve e revolucionarë të shquar, si: I]3ajram Curri, Luigj Gurakuqi, Halim Xheloja, Riza Cerrova e të tjerë. Edhe forca e gjallë revolucionare e sh(ogërisë «Bashkimi», duke mos pasur më në krye udhëheqësin e saj revolucionar, Avni Rustemin, u venit. Elementët demokratë borgjezë, në parlament dhe në qeveri, filluan të luanin me kartat parlamentare si marioneta të fuqive të huaja «demokratike», por në fakt imperialiste, dhe e gjithë kjo lodër tragjike dhe maskradë demokratike përfundoi, siç përfundoi. Zogu dhe klika e tij, me ndihmën e Serbisë dhe të bjellogardistëve (të Vrangelit, hynë në Tiranë dhe udhëheqësit e Revolucionit të Qershorit, demokratë e elementë të ngjyrave të ndryshme, kaluan në mërgim, ku formuan emigracionin politik antizogist, i cili u shpërnda në të katër anët, që nga Bashkimi Sovjetik, në Amerikë, Francë, Itali, Zvicër etj.

Do të flas edhe më poshtë për emigracionin antizogist dhe për rolin që luajti ai në ngjarjet e mëvonshme, por këtu dua vetëm të theksoj karakterin heterogjen të tij qoftë nga pikëpamja e prejardhjes shoqërore, qoftë nga tendencat politike, nga aktiviteti dhe konsekuenca në rrugën e demokracisë. Në gjirin e tij pati edhe elementë demokratë e bile edhe komunistë, të cilët në ato vite punuan për përhapjen e ideve përparimtare e luftuan regjimin zogollian. Kështu, pëi shembull, në KONARE* *(Kowniteti Nacional Revolucionar, organëzatë e emigrantëve politikë shqiptarë, e krijuar në Vjenë në viti.n 1925.), hynë mjaft elementë me prirje demokratike, si: Fan Noli, Halim Xhelo, Riza Cerrova, Omer Nishani, Hasan Prishtina e të tjerë.

Veç KONARE-së, që pas dy vjetësh mori emrin Komiteti i Çlirimit Nacional dhe orientohej drejt një vije konsekuente demokratike, ekzistonte edhe grupi i quajtur «Bashkimi Kombëtar», i cili vërtet vetëshpallej si antizogist, por ishte për ruajtjen e Shqipërisë ekzistuese, por pa Zogun.

Pikërisht në këtë grup emigrantësh u përfshi pjesa më e madhe e elementëve jokonsekuentë të Revolucionit të Qershorit, pinjoj familjesh të pasura, borgjezë ose çifligaro-borgjezë, nëpunës të lartë e ish-deputetë të opozitës kundër Zogut, të cilët ishin bashkuar me lëvizjen demokratike të viteve 1920-1924 jo se donin popullin e demokracinë e vërtetë, por një pjesë për interesat e tyre klasorë, si përfaqësues të borgjezisë së re shqiptare, që donte zhvillim e pasurim, një pjesë tjetër si kundërshtarë të A. Zogut e të rrethit të tij, të tjerë sepse «i rrëmbeu» vala e fryma revolucionare që sundonte në atë periudhë në Shqipëri etj., etj. Fare i afërt nga përbërja klasore dhe nga pikëpamjet me «Bashkimin Kombëtar» ishte edhe i ashtuquajtur «Grupi i Zarës», që mori emrin nga qyteti dalmat, ku Benito Musolini mbante si rezervë Mustafa Krujën me shokë e ia tundte përpara Ahmet Zogut sa herë donte t'i bënte presion. Mustafai hiqej sikur ishte në armiqësi me krerët e «Bashkimit Kombëtar», si Ali Këlcyra me shokë, se këta në vend të liretave preferonin frangun francez dhe dinarin jugosllav.

Por, pavarësisht nga këto, fakti që këta elementë kishin marrë pjesë në lëvizjen demokratike të viteve 1920-1924 e, sidomos fakti që, pas ardhjes së Zogut në fuqi, thuajse të gjithë kishin emigruar e kishin ndenjur larg atdheut ose, më mirë të themi, larg pronave të tyre 15 vjet me radhë, u kishte dhënë atyre namin e «demokratit», të «patriotit», të «politikanit». Tash që ata ishin kthyer në Shqipëri, neve na duhej t'u afroheshim edhe atyre me qëllim që patriotizmin t'ua vinim në provë e t'ua nxirrnim në shesh të mejdanit.

Në të kundërtën ata, me kompleksitetet që kishin për veten e që ua ushqente fashizmi, do të bëheshin një pengesë e madhe, bile nga më të rrezikshmet për Luftën Nacionalçlirimtare, për bashkimin e popullit në luftë e sidomos për të ardhmen e Shqipërisë.

Ndaj ashtu si me elementët e tjerë patriotë, intelektualë, nacionalistë etj. qysh në fillim vendosëm t'i kontaktonim e t'u bënim thirrje për luftë edhe këtyre «patriotëve politikanë».

Ndër përfaqësuesit më tipikë e më të rrezikshëm të kësaj kategorie ishte edhe Mithat Frashëri, apo Lumo Skëndoja, siç ishte prezantuar shpesh në «krijimtarinë» e tij letrare e politike. Them nga më të rrezikshmit se ky, jo vetëm e kishte veshur veten gjatë viteve me aureolën e një «patrioti» të madh, por ishte treguar aq i zgjuar sa të mos komprometohej hapur në bashkëpunimin e tij me okupatorin, bile nuk zinte asnjë post zyrtar në aparatit administrativ të «shtetit shqiptar». Ky bastard i familjes së dëgjuar të Frashërllinjve, duke përfutur nga emri i familjes dhe nga fakti se ishte biri i Abdyl Frashërit, patriotit e politikanit të madh të vendit tonë, e mbante veten si trashëgimtarin e frymës së Rilindjes, si arbitri absolut i fateve të popullit shqiptar. Jeta e tij kishte kaluar në kafenetë e Lindjes dhe të Perëndimit, merrte rroga e subvencione majtas e djathtas dhe derdhte lot krokodili për Shqipërinë, të cilën e «donte» vërtet, por për ta pasur të vetën, që ta shiste e të bënte tregti me të. Ndryshe nga shumë të tjerë, që. ndonëse më vonë tradhtuan, dikur i kishin hedhur dy pushkë, Lumo Skëndoja asgjë s'kishte bërë për Shqipërinë përveç dy-tri broshurave pa vlerë letrare e politike dhe ca muhabeteve «të stërholluara». Lufta e popullit dhe veprimtaria e tij aktive në shërbim të okupatorit ia nxorën kallajin edhe këtij «atdhetari», i cili kaptoi detin me anijet e armikut të mundur.

Lumo Skëndon e kisha njohur që më parë nga disa miq të tij në rrethet intelektuale të kryeqytetit. Herë pas bere më binte rasti të shkëmbeja ndonjë fjalë me të, kur veja të blija ndonjë libër në librarinë që mbante në «Rrugën mbretërore», sot Rruga e Barrikadave. Të them të drejtën kisha dëgjuar të flitej edhe mirë, edhe keq për të; ca e përmendnin me respekt Mithat Beun si «kokë të shqiptarizmes», ca të tjerë e quanin demagog e të pabesë, bile flitej se edhe Avni Rustemi e kishte demaskuar si të tillë dhe si bashkëpunëtor të Esat Pashës. Megjithatë namin Mithat Beu e kishte të madh, pale pastaj që nuk mungonte të lëshonte ndonjë fjalë kundër regjimit dhe kundër pushtuesit e të fliste i përmalluar për «vatanë që na e shkeli dushmani». Sidoqoftë, duke pasur parasysh edhe emrin e familjes, kisha mendimin se ky njeri mund t'i shërbente vendit. Edhe me shokët kishim vendosur që nuk do. të ishte keq ta afronim një element të tillë.

Një mëngjes, në atë kohë isha ende legal, i shkova në librari. Ishte vetëm. Më dha dorën.

- Ç'kemi, mor djalë? - më tha.

- Ç'të kemi Mithat Bej, - i them, - mynxyra na ka mbuluar dhe ne të rinjve nuk na rrihet, duam të luftojmë, të organizohemi. Ne jemi të bindur se do të na ndihmoni.

- Unë jam gati t'ju ndihmoj, por po të më dëgjoni, - më tha.

- Urdhëroni e flisni, zoti Lumo, ju e dini që unë ju respektoj.

- Eja këtej, - më tha e nga dera që kishte në shpinë më futi në njëfarë magazine ku mbante libra, ca revista e gazeta të vjetra.

- Ulu, - më tha e më tregoi një karrige, kurse vetë u ul në tjetrën, përballë.

Ndenjëm ca çaste ashtu pa folur dhe unë po prisja. Lumoja dir, bluante në mendje, hoqi syzet e i fshiu me një copë fanellatë, pastaj i vuri prapë.

- Dëgjo more djalë, - ia nisi Lumoja dhe prapë hoqi syzet, - unë do të flas me ty dhe do të të ndihmoj në rast se ti ndjek rrugën e xhaxhait tënd, patriotit Hysen Hoxha.

- Rrugën e atij po ndjek, - iu përgjigja, -dhe me besnikëri.

- Jo, - m'u kthye Mithat Beu, - nuk është ashtu. Ai ishte nacionalist i flaktë, ishte me Ismail Benë në Vlorë kur u ngrit flamuri, ai luftonte bashkë me Çerr.izin e me të tjerë, kurse ti, nipi i tij, ke marrë një rrugë të keqe antishqiptare, ti je bolshevik dhe bolshevizmi është armiku i Shqipërisë.

U shtanga, m'u duk sikur më hipi gjaku në kokë, por e mbajta veten dhe i thashë:

- Zoti Lumo Skëndo, ju po më ofendoni në r,ka kam më të shenjtë, në dashurinë ndaj atdheut dhe popullit tim. Unë jam komunist shqiptar dhe i tillë do të mbetem derisa të vdes. Komunistët janë besnikë të popullit deri në vdekje dhe unë jam kryelartë për veprën e xhaxhait tim dhe jo vetëm të atij, por edhe të babait tuaj, Abdyl Frashërit. Ata luftuan kundër pushtuesve të huaj dhe ne komunistët po luftojmë kundër pushtuesit të atdheut tonë. Me ç'po shoh, ju, zoti Lumo, nuk qenkeni i dispozuar të ecni në rrugën e babës suaj dhe të vëllezërve Frashëri, domethënë nuk jeni për lirinë e Shqipërisë. Kjo do t'i gëzojë shumë pushtuesit dhe qëndrimi «neutral» në këto kohë të vështira të rëndë tradhti!

Dola i zemëruar nga dyqani dhe e lashë Mithat Frashërin tek përpiquej më kot të më përgjigjej, se nga kjo e papritur po i merrej goja më shumë se zakonisht.

Ishte periudha kur këta «patriotë demokratë» i lejonin vetes një ton prej mësuesi fodull në bisedat me ne komunistët. Ideja e «elitës së kombit» që u qe rrënjësuar në mendje dhe e propagandonin edhe vetë, nuk i lejonte të kuptonin as forcën e madhe e të pashtershme të popullit, as të shihnin se kohët kishin ndryshuar dhe ata kishin mbetur mbrapa zhvillimit të shoqërisë, e cila, sipas tyre, kishte ngelur në vend, sir, kishte qenë njëzet vjet më parë. Ata jo vetëm e mendonin, por deri diku edhe e shprehnin se komunistët dhe Partia jonë, që kishin marrë mbi supë barrën e organizimit të luftës, ishin kalamanër, të pazotë për të drejtuar e për të udhëhequr. Ata, sigurisht, kishin një urrejtje të madhe për komunizmin, megjithatë e qetësonin veten me mendimin se «Shqipëria nuk është Rusi» dhe «bolshevizmi nuk është për katundarët dhe rrjepacakët shqiptarë».

Gjatë takimeve dhe debateve të zjarrta me përfaqësuesit e kësaj kategorie të nacionalistëve, ne komunistët i njohëm nga afër pikëpamjet dhe qëllimet e tyre të vërteta. Më poshtë do të shkruaj më hollësisht për prejardhjen, tiparet dhe aspiratat e kësaj kategorie pseudopatriotësh, por këtu dua të vë në dukje se qysh në kohën e grupeve e, sidomos, më pas, kur Partia na ngarkoi të bisedonim me ta për Vi sqaruar e, mundësisht, për Vi bindur për rrugën e gabuar që kishin zënë, ne kemi pasur biseda të gjata, të alambikuara e të lodhshme me «baballarët patriotë» që nuk përtonin të thurnin ligjëratat e tyre pa fund, plot sofizma, kurthe e dredhira.

Kur erdha në Tiranë dhe bashkë me Esat Dishnicën hapëm dyqanin «Flora», shkoja shpesh te Bahri Omari. Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit të 1924-ës, edhe Bahriu, si shumë të tjerë, kishte qëndruar në mërgim dhe, më 1939, me karvanet e ernigrantëve politikë, u kthye dhe ai në Shqipëri, u vendos në Tiranë, kështu që, më qëllonte t'i shkoja he-rs pas bere, sidomos derisa zura shtëpi dhe solla babanë, anenë dhe motrën e vogël, Sanon, në Tiranë. Bahriu ishte një borgjez liberal, me sjellje korrekte në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore, kurse në mendimet politike ishte në kundërshtim me ne. Por pas debateve për çishtë politike që ndodhnin në mes nesh, ai përpiquej që

këto të mos acaroheshin tej mase. Né atë kohë unë akoma shpresoja se Bahriu mund të afrohej me ne, sepse me gjithë lidhjet që mbante me tregtarë, agallarë e nëpunës të lartë fashistë shqiptarë, ai hiqej si antifashist dhe nuk mungonte të hidhte ndonjë fjalë kundër pushtuesit. Veç kësaj, me anë të Bahriut unë kisha mundësi të krijoja lidhje të shumta për të kontaktuar me elementët nacionalistë, si dhe për të n,i,ohur më mirë e nga afër «rrymat», «tendencat», «grupet» apo organizimin e tyre, detyrë kjo e rëndësishme për punën e Partisë.

Né fakt, né periudhën para formimit të Partisë, bile edhe më vonë, kur as Konferenca e Pezës nuk ishte thirrur, as Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar s'që formuar dhe as ata nuk e kishin formuar Ballin Kombëtar, ishte e vështirë për ne të dallonim prirjet dhe afinitetet e krerëve të ardhshëm të kësaj organizate tradhtare. Dinim që Ali Këlcyra, Kolë Tromara, Bahri Omari, Sheh Karbunara, Sejfi Vilamasi e të tjerë ishin të një «rryme». Nuk e kisha dëgjuar kurrë Bahriun të fuste me simpati as për Lumo Skëndon, as për Mehdi Frashërin e të tjerë njerëz të këtij kallëpi. Mudet që i kishin ndarë rolet, mundet që Ali Këlcyra merrej me ta, ndonjë tjetër, si për shembull, shokun e tyre, Xhevat Korçën, e lanë të futej ne qeverinë kuislinge e, ndërkaq, vetë Ali Këlcyra, dhëndri i Vrionasve, aleati i tyre, natyrisht dhe i Vër lacëve, nuk mori nëpunësi, me sa di unë, né mënyrë që të mund të hiqej edhe për ca kohë si «patriot i kulluar».

Pra, kur veja te Bahriu, e bëja këtë jo thjesht për një vizitë familjare, por edhe për të biseduar me të, për ta bindur atë të lidhej me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Bahriu, jo vetëra nuk bindej nga argumentet tona, por pretendonte se ai dhe shokët e tij, me Ali bej Këlcyrën né krye, ishin nga më antifashistët, nga më antiitalianët, nga më demokratët që ka parë Shqipëria! Natyrisht, ishte e lehtë për mua dhe faktet e veprimet e tyre më jepnin armë t'ua rrëzoja «arsyetimet» e tyre njëren pas tjetrës.

- Kjo është politika jonë, - thoshte Bahri Omari, - kjo është një taktikë jona.

- Po kujt i shërben kjo politikë dhe kjo taktikë? - e pyesja.

- Popullit dhe demokracisë!

- Mirë, por a keni arsye? Populli nuk mund të je- kurre me ju dhe as :ne politikën tuaj, sepse ai e urren okupatorin dhe e dënon bashkëpunimin me të.

- Kështu thoni ju, komunistët, - përgjigjej hahriu.

- Këtë nuk e themi ne. Të gjithë e shikojnë se «taktika» juaj është antipatriotike. Ju pretendoni se popullin e keni me vete, po ju gaboheni. Populli është me ne, sepse ne nuk bëjmë politikë «të madhe» e diplomaci «të hollë», por, ama, luftë për çlirimin e vendit bëjmë.

Bahriu, si shumë pseudopatriotë të tjerë, ishte bërë anëtar i «Këshillit të shtetit», i krijuar apostafat për këta lloj njerëzish, që regjimi fashist i kishte nëpër këmbë dhe i mbante edhe si rezervë për kohët e këqija që do t'i vinin. Bënim çmos ne «miqtë», kushërinjtë dhe të njohurit e tyre që t'i largonim nga nëpunësia fashiste, përdornim edhe satirën, gjoja si me të qeshur, por me të ngjeshur, megjithatë më kot.

Në këtë organ të ngritur nga Luogotenenca, që ishte një nga detajet e dekorit të «shtetit shqiptar», ishte futur edhe doktor Omer Nishani, që ne e kishim njohur si një njeri demokrat, anëtar të KONARE-së, bashkëpunëtor të Halim Xhelos në gazetën «Liria Icombëtare». Por doktor Nishani nuk qe i taborit të këtyre kolaboracionistëve. Futja e tij në «Këshillin e shtetit» qe vërtet një gabim, por shpejt ai do ta ndreqte dhe, siç do të tregoj më pas, doktori u bë një nga militantët e shquar të Frontit dhe të Luftës Nacionalçlirimtare.

Më kujtohet se si një mbasdreke hymë në kafe «Kursal» me Esat Dishnicën dhe i shohim të gjithë këta «këshilltarë» të grumbulluar në tryeza, duke biseduar në mes tyre.

- Hajde, - më thotë Esati, - t'u futemi në mes e t'u prishim muhabetin.

- Vemi, - i them dhe u afruam.

Esati ishte njeri me humor. Pasi i përshëndetëm, ai u tha:

- Dolët nga shkolia? Na falni që ju prishëm qetësinë se mbase ishit duke përsëritur mësimet.

Doktor Nishani, qci ishte simpatizanti ynë, ndaj edhe e quanin «kuqalashi», ia dha një të qeshuri të fortë, siç e kishte zakon, dhe na ftoi të uleshim. Ne u ulëm. Kolë Tromara, i drejtohet Esatit dhe i thotë:

- Mirë këta, se jknë të rrjepur dhe s'kanë ç'të bëjnë tjetër veçse të jenë komunistë, po ti që je nipi i Ali Beut, që sundontë~ fshatarësinë e Korçës, mend do të na shesësh?

- Pikërisht, - i tlla Esati, me atë gjakftohtësinë që e karakterizonte, - pse jam, nipi i Ali Beut kërkoj të laj sadopak gjynahet dhe të këqijat që ka bërë gjyshi im.

Në kafe «Kursal» takohesha ndonjëherë me Kolë Tromarën dhe Sheh Karbunarën dhe bisedat që bëheshin ishin nga më të rëndomtat. Kur shikoheshim rrugës, përshëndeteshim. Kolë Tromara për mua nuk ishte fytyrë e panjohur, sepse e kisha parë disa herë në Paris dhe më kishte bërë përshtypje arroganca e megalomania e tij. Kokën e mbante lart dhe mbante syze «ala amerikane», vishej me rroba të zeza si «kuakerët»* *(Anëtarë të një sekti protestant.) dhe ecte, shikonte e fliste sikur «e mbante botën mbi supe». Sheh Karbunarën e kisha takuar që në Bari. Kolë Tromarën nuk e kisha parë kurrë në shtëpi të Bahriu, kurse Shehun e kisha takuar edhe tek ai. Sheh Karbunara ishte një djall i zgjuar dhe dinak që ruhej e nuk hapej shumë. Ai rrinte në Lushnjë ose më saktë në Karbunarë, në shtëpinë-teqe, dhe atje i venin e i vinin të njohurit nga Lushnja, Berati, Durrësi, nga Tirana dhe nga krahina të tjera. Shehu, nën petkun e demokratit dhe me atë mënyrën e tij autoritare të një «politikani» që i di e i kupton mirë problemet, me siguri shfrytëzonte edhe mistikën fetare të «taçit e të xhybes» dhe me siguri merrte para nga të gjithë. Ai, nga sa kisha marrë vesh, lëvizte edhe vetë andej-këtej, shkonte jo vetëm në Tiranë të miqtë e tij të vjetër të mërgimit, por edhe te miqtë e tjerë, tregtarë të njohur. Ky ishte shurnë i rrezikshëm me *bonhomiei*-në* *(Frëngjisht - babaxhanllëk.) e tij, që fshihte një natyrë djallëzore.

Sa takime e biseda pa fryt kam bërë në atë kohë me këta njerëz kokëngjeshur e të bindur në rrugën e tyre të tradhtisë. Nuk do t'ia vlente t'i përmendja (dhe në fakt nuk i përmend dot të tëra), por shumë prej tyre, për të mos thënë të gjithë, u bënë ndër eksponentët e reaksionit, kuislingë ose udhëheqës të Ballit Kombëtar.

Rastësisht isha njohur dhe me Vehip Runën, i cili në periudhën para Revolucionit të vitit 1924 hiqej si demokrat. Kisha dëgjuar të flitej për të edhe nga plaku im. Vehip Runa ishte nga anët tona të Labërisë, në mos gaboj nga Kurveleshi. Fakt është se familja e Vehipit ishte e njohur në Kurvelesh, si një familje e pasur dhe me influencë, por edhe Vehipit e të vëllait të tij u kishte dalë nami si trima të pushkës. Pas rrëzimit të qeverisë së Nolit, kur u vendos regjimi i Zogut, Vehip Runa si kulak dinak e i zgjuar ndërroi menjëherë këmbishë dhe influencën e tij e vuri në shërbim të Zogut, i cili edhe ky diti ta shfrytëzonte. Kështu, «demokrati» Vehip Runa na kishte pësuar një me tamorfozë dhe që kthyer në një bajraktar të Jugut. Natyrisht, «ushtria» e tij nuk ishte fort e madhe dhe influenca e tij nuk mbështetej shumë në popullin e Kurveleshit dhe të qytetit të Gjirokastrës, por mbështetej në stanarë të mëdherlj dhe, sidomos, në lidhjet familjare e krushqie që nLik mund të mos merreshin në konsideratë. Në sajë të kthyre lidhjeve dhe si shpërblim për shërbimet që i bënte; e Ahmet Zogut, Vehip Runa arriti të bëhej edhe prefekt, u largua nga fshati dhe u kthye në një «personalitet të qytetëruar» qyteti.

Kur Zogu e braktisi Shqipërinë, Vehip Runa, natyrisht, e la Zogun dhe i dha dorën Italisë. Prapë ndërroi këmbishë, prapë u bë prefekt, nën regjimin kuisling.

Ishte një burrë i gjatë, as i trashë, as i hollë, me sy të zgjuar në një fytyrë karakteristike të gjatë, të verdhë dhe me lëkurë plot rrudha. Kishte marrë pamjen dhe mënyrat e sjelljes së njerëzve të lartë të regjimit; edhe pamjen e tyre të urrejtshme, por edhe djallëzinë e fshatarit të pasur e kishte ruajtur. Në sytë e tij që shkëlqenin dukej edhe egërsia, dhe «xhentileca» e një «të qytetëruari», edhe dinakëria e agait. Ai fliste me një zë të ulët, «të butë», me fjalë të tilla si «zoti Enver», «more djalë» e plot shprehje të kësaj natyre, me të cilat donte të tregonte epërsi dhe influencë në masat.

Tani Vehip Runa kishte lidhur fjetet me miqtë e vjetër të kohës së «demokracisë» që ishin kthyer nga mërgimi dhe Vehipi ishte bërë prapë «antizogist» e «demokrat». Ishte funksionar i lartë i regjimit fashist dhe pëshpëriste andej-këndeje sikur gjoja «s'kishte ç'të bënte», ashtu sikurse «s'kishin ç'bënin» edhe miqtë e tij. «Duhet të punojmë nga brenda, që të rrëzojmë në mënyrë paqësore fashizmin», pra, «ta marrim kalanë nga brenda» dhe, medemek, kur të ngordhte kali, këta myteberë të ishin gati t'i hiqnin potkonjtë, të merrnin fuqinë e «të vendosnin demokracinë»! Kjo ishte teza që Vehipi me qetësi, me zë të ulët, ma zhvilloi mua, «zotit Enver», «djalit të mikut tiro, Halilit», siç

shprehej, se të tjerët ishin në një mendje me të. Kjo bisedë zhvillohej gjatë një dreke te Bahri Omari, ku ishte ftuar Vehip Runa e ku ishim edhe unë e Skënder Pojani.

Skëndo Pojani ishte një bej i hallakatur, topolak, me syze dhe me mustaqe, njeri që ndiqte gratë, pavarësisht nga mosha e kaluar. Ky bej ishte pjesëtar i «Stamlesit», kuletën e kishte plot, me italianët po hynte e dilte, ishte mik me ta, ishte mik me bejlerët e tjerë, që vinin rreth «qypit me mjaltë» të fashizmit. Ishte mik, natyrisht, edhe me këta të ashtuquajtur demokratë, të cilët i furnizonte me cigare «speciale», si dhe me të holla, kur i kërkdpin. Ishte një bej aventurier, por për Kolë Tromarën, Sheh Karbunarën me shokë ishte «popullor dhe demokrat».

Gjatë bisedës i thashë Vehip Runës se nuk mural të isha dakord me mendimet dhe me veprimet e tij. Tërë kohën që nderja me ta edhe unë përdora po ashtu tonin e qetë dhe tezës së tyre u përpoqa t'i kundërvë argumente bindëse. Unë nuk kisha asnjë shpresë te Vehip Runa dhe Skëndo Pojani, por më pëlqente t'ua rrëzoja argumentet e tyre e t'i vija me shpatulla pas murit. Kur flisja unë, Vehip Runa. që i njihte me kohë idetë e mia, bënte të habiturin dhe më kundërpërgjigjej edhe ai.

- Zoti Vehip! - i them. - Pse doni t'i komplikoni çështjet që janë të qarta? Italia fashiste ne na ka okupuar, ajo po na kolonizon dhe kërkon të na zhdukë si komb, si popull. Këtë gjë nuk e shihni apo nuk doni ta shihni? Këtë synim e ka pasur përherë Italia dhe të gjithë ata që na kanë okupuar. Populli ynë kurdohej-ë ka luftuar për lini dhe tash do të luftojë për t'u çliruar një herë e përgjithmonë. Prandaj problemi për ne është i qartë: Ose do të luftojmë tok me popullin. ose do të luftojmë tok me okupatorët kundër popullit. Kështu e shtroj unë problemin, zoti Vehip, zgjidhni e merrni. N e kemi zgjedhur r rugën e parë.

- Edhe ne, zoti Hoxha. - kërceu Vehipi. - kemi zgjedhur rrugën e parë.

- Atëherë, - i them, - braktisni të dytën!

- Kjo është taktikë, biri im, - tha Vehipi, - këtu ndahemi. Ne mendojmë ta mbytim regjimin fashist :ne njerëzit tanë, të hedhim në dorë çdo gjë, duke punuar nën rrogë, me një fjalë «urtë e butë e plot tigan».

I preva fjalën dhe i thashë:

- Zoti Vehip, ne jemi në kundërshtim me politikën tuaj «urtë e butë e plot tigan», sepse me okupatorët nuk round të jetë kurrë plot «tigan» i popullit. por do të jetë i zbrazët, prandaj ne nuk round të jemi Gs të butë, as të urtë me armikun, por do të jemi të egër e të pamëshirshëm, pse v etëm kështu do ta shpitojnë popullin.

Pas këtvre fjalëve të mia, edhe Skëndo Pojani. që deri atëherë heshte e merrej me te ngrënë e me të p:re, kërceu e ndërhyri në bisedë:

- Ah jo, zoti Enver, - tha ai, - ne nuk mund të jemi dakord me ju që të vritet populli, të digjen qytete e fshatra, të digjen krahina.

- Mirë thotë zoti Skëndo, - i mbajti anën Vehipi, duke m'u kthyer mua. - Po të ndjekim rrugën që thoni ju, populli ynë, që edhe kështu është një grusht, do të pësojë humbje të mëdha. Ju këtë gjë doni? Fol, more Bahri? - iu drejtua Bahri Omarit që nuk ishte përzier në bisedë.

- Unë, - u përgjigj Bahriu, - tram biseduar vazhdimisht me Enverin, por nuk merrem vesh me të. Përpiquni ju të merreni vesh, - dhe prapë heshti.

- Ne, - u thashë, - e duam shumë popullin dhe atdheun dhe nuk duam kurrë që të na vritet dhe të na digjet. Përkundrazi duam që atdheun ta tremi të lira dhe popullin sovran e zot në vendin tonë. Por kjo, - vazhdova, - nuk arrihet as duke qëndruar me duar të lidhura, as duke e marrë «kalanë nga brenda», siç mendoni ju. Vetëm me luftë mund të arrihet liria dhe lumturia e popullit, prandaj tremi vendosur t'i kundërsulmojmë ata që na sulmuan dhe na grabitën lirinë dhe sovranitetin e atdheut, që t'i shporrim dhe të çlirojmë popullin.

- Po ne nuk e duam këtë gjë, zoti Enver? pyeti Skëndo Pojani.

- «Taktika» që përdorni ju tregon se edhe strategjia juaj nuk synon për një gjë të tillë.

- Pse, biri im, - m'u kthye Vehip Runa, - strategjia jonë nuk e do çlirimin e Shqipërisë?

- Të më falni që ju flas një çikë ashpër, - iu përgjigja, - por shprehjet tuaja «urtë e butë e plot tigan», taktika juaj për ta «marrë kalanë nga brenda» dhe pa çak e pa bam, të bën të mendosh se ju

mendoni jo si do t'u vejë halli atdheut e popullit, por kur të thyhet fashizmi zotëria juaj të merrni fuqinë dhe të veproni me Shqipërinë sipas qejfit tuaj.

Në dhomë ra një moment heshtjeje, u dëgjua vetëm piruni i Skëndos që trokiti mbi pjatë, po Vehipi e pa me inat dhe Skëndoja e la.

- Dëgjo, djalë, - m'u drejtua pastaj Vehipi me një zë ku butësia po i linte vend kërcënimit të hapur. - Ne e dimë mirë ç'është demokracia dhe tremi luftuar për të. Ti tre qenë i vogël, kur Bahriu, unë e mulla Halili kemi votuar për «Opingën», kemi qenë demokratë.

- Mund të kem qenë i ri në atë kohë, zoti Vehip, - i them, - por tash nuk jam më i ri dhe populli e unë bashkë me të, si bir i tij, e vuajti dhe e vuan në kurriz «demokracinë» tuaj, nën regjimin e Zogut dhe tash nën fashizmin.

- Po, - kërcëu Bahriu, - vetëm këtu jam dakord me ty Enver, që nën Zogun si dhe nën fashizmin nuk ekzistoi e nuk ekziston demokraci!

- Atëherë, - ia ktheva, - tërhiquni nga bashkëpunimi me fashizmin, jini konsekuentë siç nuk iu përulët Zogut.

I hodha një sy ish-prefektit të Zogut, Vehip Runës. Po ky bëri sikur s'e kuptoi aluzionin dhe uli kokën dhe po merrte me pirun një qofte.

- Pastaj, - vazhdova, - duhet të treni parasysh se populli do të luftojë, dëshirën e tij për liri s'mund ta frenosh gjatë me taktika, prandaj them se ne duhet të bashkohemi dhe të luftojmë. Po të jemi të bashkuar, të organizuar, atëherë edhe humbje do të tremi më pak, edhe lirinë do ta fitojmë më shpejt.

- Zoti Enver, - ngriti kokën Vehipi, - ne e njohim më mirë popullin dhe ai na njeh më mirë ne. Prandaj nuk është tamam ashtu si thoni ju. Të mos shkoj larg, por të flas për Labërinë, që unë e njoh si në pëllëmbë të dorës. Unë dhe Zenel Gjoleka kemi shkuar atje dhe vetë populli na ka thënë se duhet të presim, se s'kemi armë, se do të na djegin po të hapim zjarr.

- S'jam dakord as me ju, zoti Vehip, as me Zenel Gjolekën, i cili po bën të kundërtën e asaj që bëri dikur kundër pushtuesve otomanë trimi me fletë Zenel Gjolekë Labi, - e kundërshtova. - Edhe ne e njohim Kurveleshin ashtu si edhe ju, mundet edhe më mirë se ju, pse ne atje njohim popullin dhe patriotët e vërtetë. Atje zien urrejtja kundër armikut, njerëzit duan të luftojnë dhe po luftojnë. Natyrisht disa pasanikë të tillë, si: Shuko Qanët, Bilal Nivicat, Hasan Zagarët, ata po, nuk duan të luftojnë e jo vetëm kaq, por ata luftojnë kundër popullit të Kurveleshit. Kurveleshi është një vend heroik dhe do të vazhdojë të ecë në traditat e tij heroike.

- Kujt ia thoni këto tradita, zoti Hoxha? - më pyeti Vehipi me ironi dhe vazhdoi: - Ne jemi andej dhe këto tradita na përkasin neve; ne mund të flasim për Gjolekën, për Celo Picarin e për të tjerë.

- Po ne ç'jemi? - iu ktheva i inatosur. - Jemi italianë? Apo bashkëpunëtorë të italianëve? Traditat heroike të Gjolekë Labit dhe të të gjithë heronjve të vendit, të të gjitha kohëve i përkasin popullit. Ne jemi djem të këtij populli heroik dhe kemi të drejtë të mburremi me këta heronj dhe e kemi për detyrë të ndjekim rrugën e tyre. Por një gjë duhet të dini: Gjolekë Labi, Celo Picari qenë trima dhe të fortë, sepse ishin patriotë dhe luftëtarë kundër pushtuesve, sepse mbështeteshin te populli. Keni dëgjuar, besoj, si u këndon populli këtyre patriotëve, gai i ngre në qiell njerëzit e thjeshtë, por trima me fletë, të cilët vetë i ka lindur dhe i ka bërë trima të rrallë. Pra, ky popull, që lirinë e ka quajtur gjënë më të shërujtë dhe trimërinë e ka pasur gjithnjë në gjak, nuk murld të mendojë si ju. Pretendimet dhe pikëpamjet tuaja janë të dëmshme. Historia nuk ju jep hak juve, por neve.

- Po ju s'keni njeri në Kurvelesh, more zoti Hoxha, keni ca djelmuri që nuk i njeh kush.

- Besoj të keni dëgjuar për Balil Neshën, - iu përgjigja. - Asnjëri nuk e njihje Balilin, por ai luftoi me taborët e Turqisë dhe populli e njohu, e nderoi dhe i ngriti këngë, - dhe u citova disa vargje popullore:

*Kuç, Kallarcut e Bolenë
Gjithë me Balilë u ngrenë
Në lumë e zunë dufenë
Mandata derë më derë*

Balilo, Balil nuri

- Të tillë shokë, - vazhdova t'i përgjigjem Vehipit, - kemi ne në Kurvelesh, meqë fole për atë krahinë. Këta do të luftojnë dhe, po qe se ju do të vazhdoni «taktikën» tuaj, influenza që keni atje e që ju duket dominuese, do të zhduket. Të mos shkojmë larg,

por vetë vëllai yt, zoti Vehip, është me ne dhe jo me ty, është në luftë me okupatorët. Prandaj zoti Runa, e përfundova unë bisedën, - kam dëgjuar të flitet për trimërinë tuaj dhe e di se ju influencë keni në Kurvelesh, por e mira është që këto Via vini në dispozicion luftës për çlirimin e atdheut: braktisni rrugën që keni zënë, se është e gabuar, mos u futni më thellë në greminë, bashkohuni me luftën tonë popullore dhe vëreni veten në shërbim të çështjes së madhe të çlirimit.

Por përgjigjja e Vehip Runës qe:

-- Edhe kështu ne luftojmë për çlirimin e Shqipërisë. Nuk kemi pikëpamje të njëjta.

- Është e drejta juaj të qëndroni në ato pikëpamje që keni, - u thashë prerë. - Por po jua përsëris: populli dhe historia nuk do t'juja falin këtë që po bëni. Ne ju dolëm borxhit. E shoh, ju na dekonsideroni, por ne s'e matim vlerën tonë me metrin e me konsideratat tuaja. Me ne është populli, ai na do e na përkrah, ju pa popullin dhe pa ne do të rrëshqitni keq e më keq.

Pas këtyre fjalëve u ngrita duke i dhënë fund takimit me Vehip Runën, i cili ishte dhe qëndroi në luftë kundër nesh, i ndihmoi pushtuesit deri në fund, derisa populli i dha dënimin e merituar.

Veç të tjerave, në bisedat me këta njerëz të bënte përshtypje besimi absurd që kishin ata në «autoritetin» që gjoja gëzonin në popull. Ky besim prej megalomanësh në «vlerat» e tyre, sigurisht, e kishte burimin në faktin se ata s'e njihnin fare popullin, ndryshimet që kishte pësuar ai në botëkuptim, në psikologji, në pjekurinë politike. Ata akoma mendonin se meqenëse kishin qenë «deputetë» e «kishin punuar» në emigracion, ruanin ende reputacionin e politikanëve antizogistë, «demokratë të kulluar» dhe, si rrjedhim, ishin edhe njerëz me influencë. Midis tyre qenë ndarë edhe sferat e influencës. Kolë Tromara, si korçar që ishte, mendonte se kishte pas vetes Korçën dhe, mjaft të bënte një thirrje Kola dhe Korça «fap» në këmbë pas Kolës (!), Ali Beu nuk kënaqej vetëm me Këlcyrën e Dangëllinë, por mbahej si njeri me influencë në të gjithë «demokracinë» e vendit. Bile mendonte se edhe fshatarësinë e kishte në xhep, pavarësisht se ishte këlysh i një familjeje bejlerësh nga më barbarët që kishte bërë dhe vrasje, duke i hedhur fshatarët nga shkëmbi, ku kishte sarajet, drejt e në Vjosë. Me sa duket Ali Beu mendonte se këto detaje të biografisë familjare si dhe fakti që ishte edhe dhëndri i Vronasve, ia rritnin autoritetin dhe ishte i bindur se fshatarësia do ta ndiqte pas këtë farë demokraci! E kështu me radhë, Qazim Koculi, «heroi i Vlorës», mendonte se kishte me vete popullin e Vlorës kur të donte, Sejfi Vllamasi ishte ai që do të zëvendësonte Zylyftar Podën në Kolonjë, kurse Rexhep Mitrovica mendonte se ishte vetë Kosova, për të cilën këtyre myteberëve gjoja u digjej shpirti.

Por historia tregoi se titujt e tyre dhe fuqia e tyre ishin vetëm ëndrra të tyre, sepse populli jo vetëm nuk u vajti pas, por, përkundrazi, i fshiu me fshesë të madhe dhe i hodhi atje ku e kanë vendin plehurat, në kosh.

Kishte edhe nga ata që nuk merrnin mundimin Vi kamuflonin qëllimet dhe interesat e vërtetë që i lidhnin me pushtuesin italian. Këta edhe në bisedë qenë kërcënues e agresivë, sepse përpjekjet tona, luftën tonë e konsideronin si një rrezik direkt për postet e fitimet e tyre.

Reiz Selfoja, tregtar i madh gjirokastrit, më fliste një ditë për të «mirat» që i kishte sjellë Italia fashiste Shqipërisë. Sigurisht, nuk munguan ca lot krokodili për «lirinë e humbur», për «vatanin e gjorë», por thelbi i diskutit të Reizit qe se «kjo e keqe që na erdhi, ka edhe të mirat e saj, se po hapen punëra, ka mallra në treg, shkollat shqipe nuk u mbyllën» e të tjera e të tjera si këto.

Natyrisht, unë ia hodha poshtë këtë «tezë», duke i thënë se armiku na zaptoi atdheun, na robëroi, na burgos njerëzit tanë, po na kolonizon dhe po na shfrytëzon edhe ekonomikisht.

- Kush mbron pushtimin e vendit nga të huajt, ai është tradhtar, - i thashë Reiz Selfos. - Përfitimet dhe të mirat që na thua, Reiz, janë për bashkëpunëtorët e fashizmit. Ju, tregtarët e mëdhenj, po, keni vërtet fitime përralore, kurse populli bluan koçanët e misrit për bukë dhe goditet nga plumbat e

armikut. Pse të ankohet nga Italia miku yt, Qemal Vrioni, apo pse nxjerr fitime duke u shitur tokat e vendit shoqërive bujqësore italiane? Ju, tregtarët e mëdhenj, i mbytët tregtarët e vegjël e rroni si mbretër. Shih sa ma ke xhevahirin jeshil në gisht (kishte një unazë që sigurisht ishte shumë e kushtueshme). Ju jeni miqtë e Jakomonit e të Shuk Gurakuqit, ministrit të Financave, ju merrni lejet e majme për import dhe na hiqeni si patriotë. Çfarë patriotizmi i thoni ju këtij?

Bahri Omari, në shtëpinë e të cilit bëhej ky takim, hapi një herë gojën dhe tha:

- Reiz, më mirë lëreni këtë muhabet.

- Jo, - tha Reizi, - nuk e lë, se këta kuqalashët rrjepacakë po na shesin mend për patriotizëm, sikur këta do ta bëjnë Shqipërinë.

- Ne do ta bëjmë, ne kuqalashët, tok me popullin, dhe populli do të jetë me ne! - ia ktheva.

- Ne s'do të lëmë kurrë që fara juaj të mbijë në tokën tonë, - tha i egërsuar Reiz Selfoja.

- Mbaje mend mirë këtë fjalë Reiz Selfo, - i thashë, - se unë, nga ana ime, nuk do ta harroj. Kur nesër të marrë populli fuqinë, ti nuk do të flasësh më me këtë gjuhë, por do të mbushësh pantallonat, - dhe i kërkova ndjesë Bahriut për termin që përdora.

Bahri Omari prapë na u lut ta mbyllim këtë muhabet. Reizi e mbylli «titkën», unë u ngrita dhe u largova. S'di a i ka kujtuar tregtari tradhtar Reiz Selfo këto fjalë të miat, por, kur pushteti popullor i konfiskoi mallin dhe pasurinë, apo më vonë, kur gjyqi i popullit i dha dënimin kapital për veprimtarinë e ti j kriminale gjatë pushtimit nazifashist dhe pas Çlirimit të atdheut, ky armik i tërbuar nuk kishte mësuar asgjë nga fati i miqve të vet sepse, veç të tjerash, u implikua edhe me veprime terroriste. Në vitet e para pas Çlirimit ky qe një ndër organizatorët e terroristëve që hodhën një bombë në ambasadën sovjetike në Tiranë.

Jam zënë keq njëherë edhe me Abaz Omarin, një kushëri i Bahriut nga i ati, por edhe yni, sepse xhaxl:ai im, Hysen Hoxha e kishte nip. Njiheshim që fëmijë, kur qemë të rinj, vinte shpesh në shtëpinë tonë. Qemë pothuajse moshatarë (mundet që Abazi të ishte nja dy-tre vjet më i madh nga unë), edhe ai kishte bërë Liceun e Korçës dhe kishte vajtur për studime në Paris. Por si kishte ndenjtur nja 4 vjet me paratë e babait, që e kishte tregtar dhe pronar tokash në Fier, ishte kthyer pa diplomë në Shqipëri dhe ca kohë ushtroi zanatin e të atit. Më vonë mori një grua me prikë të madhe dhe me të hollat e saj u kthye në Francë, mori diplomën në drejtësi dhe erdhi e u bë avokat. Kishte kohë që nuk isha pjekur me të, derisa një ditë, pas pushtimit të vendit, e gjeta te motra ime Fahrije. U puthëm e u ngalasëm, e urova dhe pas bisedave të zalkonshme, si gjithmonë filluam diskutimet për problemet politike. Mbaja mend që dikur Abazi në diskutimet shfaqej si antifeudal, demokrat e i majtë. Por ç'të shihja: kur i folja për luftën, për domosdoshmërinë e saj e të tjera, na doli që Abazi nga «i majtë» na qe bërë «i djathtë», nga demokrat na qe bërë një mbrojtës i zjarrtë i të pasurve, me një fjalë kishte ndërruar lëkurën. U grindëm dhe kushedi si do të kishte mbaruar grindja, po të mos kishte hyrë në mes motra ime. Më nuk e pashë këtë njeri që u bë një qen zinxhiri i Ali Beut, u bë ballist dhe bashkëpunëtor i hapur i pushtuesve gjermanë.

Nuk do të zgjatem më me të gjitha bisedat e debatet që kam pasur me këta njerëz, por dua të them se me gjithë përpjekjet tona për t'i bindur, ata ishin të vendosur në udhën e tyre sikurse ishim të vendosur ne në tonën. Edhe me kaq kishim humbur shumë kohë, energji e nerva me këta elementë: kishim plot punë për të bërë dhe do t'i bënim edhe pa këta, se e dinim dhe e shihnim që popullin e kishim me vete. Natyrisht edhe në të ardhmen do të bënim përpjekje për t'i kthyer këta elementë në rrugën e drejtë të luftës popullore kundër fashizmit, por gjithnjë të ndërgjegjshëm e të qartë se fatin e luftës nuk e kishim mbështetur tek ata. Pavarësisht nga «vendimi» i tyre, lufta kishte filluar dhe rritej çdo ditë, le të rrinin ata e të filozofonin për taktikën e «tiganit plot». Patriotët e ndershëm në të katër anët e Shqipërisë po rrëmbenin armët. Më kryesorja, masat popullore, punëtorët dhe fshatarët e, në mënyrë të veçantë, rinia, shpreheshin gjithnjë e më hapur në favor të programit të Partisë Komuniste për luftë kundër pushtuesit fashist.

Kjo qe, si të thuash, një punë përgatitore në drejtim të realizimit të objektivit tonë për formimin e një fronti të të gjithë shqiptarëve të ndershëm. Natyrisht, do të kalonin edhe ca kohë derisa më 16 shtator 1942 Fronti Nacionalçlirimtar tës vihej në baza të plota organizative e politike, si bashkim luftarak i masave që, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, do të realizonte çlirimin e

atdheut. Vetëm se këtu dua të theksoj rëndësinë e kësaj faze të parë përgatitore kur ne hodhëm themelet e Frontit, sepse pa këtë fazë nuk do të ishte e mundur të arrihej te Konferenca historike e Pezës.

3. Drejt Konferencës së Pezës

Puna e Partisë në të gjitha zonat e vendit për forcimin e saj ideologjik, politik e organizativ dhe për ngritjen e popullit në luftë, po jepte frytet e veta. Nga aksionet politike e demonstrative po kalohej në një shkallë më të gjerë, në luftën e armatosur dhe, veçanërisht në pranverën dhe në verën e vitit 1942, një numër i madh njësitësh e çetash partizane vepronin në krahina të ndryshme të vendit. Nën udhëheqjen e Partisë bashkimi monolit i popullit në betejën për çlirimin kombëtar po bëhej kështu një realitet gjithnjë e më i dukshëm. Komiteti Qendror Provizor, që i ndiqte me vëmendje situatën dhe lufta që po zhvillohej gradualisht, arriti në deduksionin logjik se po kalohej në një situatë më të zhvilluar dhe me horizont më të gjerë, prandaj, u konkludua se, krahas organizimit e zgjerimit të Luftës Nacionalçlirimtare, kishte ardhur jkoha të mendohej edhe për organizimin politik të kësaj lufte.

Për Partinë tonë, e cila e kishte të qartë arakterin dhe objektivin final të Luftës Nacionalçlirimtare, ishte e kuptueshme që organet dhe organizimi i të pushtetit të vjetër, format dhe brendia e tij, nuk do të ishin më të përshtatshme e të dobishme. Lufta jonë do të mobilizonte masat e gjera popullore dhe këtë detyrë nuk mund ta kryenim dot me format e vjetra të regjimit zogollian. Partia, që shihte larg, ishte e sigurt re Lëvizja Nacionalçlirimtare do të zgjerohej e do të fuqizohej, nga radhët e popullit do të dilnin çrtat, batalionet e brigadat, do të krijoheshin një ushtri e vërtetë e popullit kryengritës. Por lufta nuk bëhej dhe nuk u bë vetëm në mal, ajo bëhej kudo, në mal, në dytë, në fshat, në lagje. Ajo do të ishte dhe qe një lufte popullore, ku jepte kontributin e vet edhe ai pionieri i vogël, që ngjiste trakte e çonte një copë kartë, edhe ajo nëna që priste e përcillte ilegalë e partizanë, edhe luftetari që me armë në dorë godiste armikun. E gjithë fto luftë në prapavijën e armikut duhej organizuar e drejtuar dhe këtë nuk do ta bënin organet e pushtetit kuisling, por organe të reja politike që duhej t'i lindte vetë lufta popullore.

Kështu, detyrat e shumta për bashkimin e masave, për organizimin e zgjerimin e Luftës Nacionalçlirimtare dhe perspektivat e zhvillimit të revolucionit, shtruan domosdoshmërinë e krijimit në luftë e sipër të pushtetit të ri, të pushtetit popullor, i cili s'do të kishte asgjë të përbashkët me pushtetin e feudalëve dhe të borgjezisë. Format konkrete të realizimit të këtij pushteti do të krijoheshin gradualisht, por një gjë Partia e kishte të qartë që në fillim: lbaza sociale e tij do të ishin masat e gjera popullore.

Dihet se bazat e pushtetit popullor gjatë luftës u hodhën me këshillat nacionalçlirimtarë, të cilët qenë një formë e re që përdori Partia si më e përshtatshme për vendin tonë. Ka qenë çraditë e vjetër e fshatrave dhe e krahinave tona që problemet e rëndësishme të jetës së katundit, në mungesë të një pushteti politik të centralizuar, të rriheshin në kuvendet popullore dhe vendimet që merreshin atje bëheshin ligj. Këtë formë të vetëqeverisjes popullore e gjejmë të realizuar edhe në ngjarje të mëdha të historisë sonë, kur, me iniciativën e patriotëve të shquar, u thirrën kuvende të mëdha i ër të mbrojtur atdheun. Në fillim qenë Kuvendi i Lezhës, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Kuvendi i Gërçes, Kongresi i Lushnjës etj., ku populli dërgoi përfaqësuesit e vet për të zgjidhur hallet e për të mbrojtur tekën dhe lirinë e vet nga shtypja imperialiste dhe lakmitë shoviniste.

Traditën e shëndoshë popullore tash duhej ta përdornim, sigurisht, duke e pasuruar në përmbajtje dhe në formë, në përputhje me detyrat e luftës dhe të perspektivës.

Për herë të parë Komiteti Qendror Provizor dha orientimin për ngritjen e këshillave qysh në fillim të vitit 1942, në muajin shkurt. Mbaj mend që me shokët' diskutuam gjerë e gjatë për këtë problem, sidomos për të përcaktuar detyrat që do të kryenin këta këshilladhe për mënyrën si do të krijoheshin. Diskutime të tilla, sigurisht, ishin të natyrlshme, sepse të gjithë nuk kishim as eksperiencë, por as edhe njohuritë e nevojshme lidhur me funksionet dhe prerogativat e organeve të

pushtetit. Sidoqoftë, u ec me kujdes në këtë drejtim, u caktuan ato funksione në përputhje me nevojat e luftës dhe me mundësitë reale që do të kishin këta këshilla në atë periudhë. Themelore dhe me mjaft rëndësi në direktivën e Komitetit Qendror ishte që këta këshilla u quajtën shprehimisht embrioni i pushtetit të ri. Për herë të parë në historinë e popullit tonë lufta çlirimtare pleksej me luftën për vendosjen e një pushteti të ri politik pas fitores. Kjo i dedikohet vetëm e vetëm udhëheqjes së drejtë, marksiste-leniniste të Partisë sonë, në sajë të së cilës Lufta Nacionalçlirimtare mori karakterin e një revolucioni demokratik popullor.

Drejtuesit e organizatave të Partisë në terren u udhëzuan posaçërisht që në këta këshilla të hynin ata që me fjalë e me vepra ishin përkrahës e aktivistë të iuftës për çlirim, ata që kishin fituar respektin dhe dashurinë e popullit. Fillimisht këta këshilla do të shërbenin për të grumbulluar masat në luftën kundër pushtetit, do të nxirrnin vullnetarë për në çetat partizane dhe do të ushtronin pushtetin gjyqësor e do të ruanin qetësinë e popullatës në zonat e çliruara, do të organizonin propagandën, mbledhjen e ndihmave për Lëvizjen Nacionalçlirimtare etj. Puna filloi shpejt edhe në këtë drejtim dhe në disa krahina të vendit, sidomos në Jug, filluan të ngrihen këshillat e parë në zona të çliruara.

Të gjitha këto suksese që po arrinim hap pas hapi

po ndiheshin gjithnjë e më tepër në jetën e vendit dhe po e lëkundnin seriozisht «sigurinë» e «qetësinë.. që proklamoni pushtetit.

Ndërsa komunistët dhe populli shqiptar gëzoheshin nga këto suksese, nga rruga e drejtë dhe e sigurt që po merrte Lufta Nacionalçlirimtare nën udhëheqjen e PKSH, krejt ndryshe reagoi takëmi i «baballarëve» të patentuar të kombit. Stani i «patriotëve» e i «demokratëve», i «antizogistëve» e i «antiitalianëve» që, në fakt, të gjithë subvencionoheshin nga kasa e Jakomonit, duke qenë antikomunistë të tërbuar, u turbulluan e u tronditën seriozisht nga drejtimi që po merrnin ngj ar j et.

Fër habinë dhe tmerrin e tyre, pikërisht ata «kalamanë» që gjer dje i nënçmonin e u vinin lloj-lloj epitimesh, po merrnin vërtet në duar udhëheqjen e luftës, po bënin për vete popullin dhe po e bashkonin rreth programit të tyre. Për «më keq» akoma, po përmbysnin organet e pushtetit fashist e po krijonin organe të reja, këshillat nacionalçlirimtarë! Këto, sidomos çështja e këshillave, s'kishte si të mos i preknin në kockë e në gjak baballarët e kombit. Po të vazhdonin ngjarjet kështu, kishte rrezik të mbeteshin me gisht në gojë. Prandaj, erdhi një moment kur, tamam ata që gjer dje s'linin gjë pa thënë kundër nesh e na dekonsideronin, u detyruan, si nga nuhatja e vet, ashtu edhe me urdhër të Jakomonit, të kërkonin vetë, natyrisht, me politesën e tyre fodulle, të takoheshin me ne «kalamanët» për të «kuvenduar e për të gjetur llafnë».

Ne, sigurisht, në bazë të vijës së përcaktuar e të platformës së Partisë, nuk refuzuam t'i prananim e të bisedonim me ta, por ishim të bindur dhe u bindëm akoma më shumë, se qëllimi i tyre nuk ishte të binin dakord për të bashkëpunuar në luftë kundër fashizmit, por «të gjenin llafnë» me ne, domethënë të na devijonin nga rruga që kishim nisur e të na integronin në politikën e vet kapitulluese e kolaboracioniste!

Një ditë, aty nga fillimi i verës së vitit 1942, ndërsa po punoja në një bazë, më lajmërojnë se një shok kërkonte të më takonte, sepse kishte një lajm për mua personalisht. E njihja atë shok, ishte nga Korça dhe u thashë ta sillnin. Kur erdhi u përqaftuam, e pyeta si venin punët, a kishte ditë që kishte ardhur nga Korga, pyeta për shokët e mi të vjetër. Pastaj shoku më tha:

- Para dy-tre ditësh më gjeti Fazlli Frashëri e më tha: «Të lutem, të gjes mundësinë të lajmërosh zotin profesor, që zoti Fazlli Frashëri dëshiron të ketë një takim me të. Jam gati të shkoj ku të dëshirojë zoti profesor». Unë, - vazhdoi shoku, - i thashë se nuk e di ku ndodhet profesori, por po ta takoj do t'i them.

- Dhelpra plakë! - i thashë, pastaj iu drejtova shokut: - Hajde nesër se të jap përgjigje.

Fazlli bej Frashëri, që hiqej si demokrat, ishte nga ata elementë të feudo-borgjezisë me njëqind flamurç~ në xhep, që vërtitej nga frynte era. Kisha dëgjuar për të, por edhe vetë e kisha njohur kur isha në Korçë, sidomos në ditët kur përpiqeshim të organizonim rezistencën kundër pushtimit italian. Si një njeri pa skrupuj e parime, përpiquej të shtonte autoritetin e tij në shtresat e intelektualëve korçarë, në radhët e borgjezisë tregtare të qytetit, ta kishte mirë me bejlerët, pronarë të tokave, si me Maliq bej Frashërin dhe me shumë agallarë korçarë, të ruante influencën në të

gjithë politikanët zogistë dhe pseudodemokratë, duaxhinj të tiranit. Hiqej si liberal antizogist, por në fakt ishte një zogist i kamufluar. Në Korçë qarkullonin zëra, dhe këto ishin në interes të regjimit, se Zogu e thërriste në pallat herë pas here dhe këshillohej me të. Kjo «famë» ushqej nga njerëzit e tij dhe të regjimit, të cilët shpreheshin: «Zogu ecën me dy këmbë në Korçë; me këmbën myslimane të Fazlli Frashërit dhe me këmbën e krishtere të Koço Kotës e të Pandeli Evangjelit». Këta dy të fundit ishin këshilltarë të hapur të Zogut, emëroheshin edhe kryeministra, kurse Fazlliu qëndronte në hije, ishte «l'émence grise» e mbretit satrap. Në kohën kur më njohën edhe mua me të në Korçë, ai shkonte rrallë në Tiranë, por në Korçë ishte miku i të gjithë prefektëve që vinin e iknin.

Fazlli Beu i kishte ndarë rolet me vëllanë e tij, Qazimin, apo Qazkën, siç i thoshte populli, një nga sipërmarrësit dhe tregtarët më të mëdhenj e më shfrytëzues të Korçës. Influenca e Fazllit te Zogu, te Krosi e te Koço Kota kanalizohet nëpërmjet Qazkës, i cili merrte favoret e regjimit, sipërmarrjet, bënte allishverishe me tregtarët e mëdhenj të Korçës, me bejlerët dhe me agallarët, kurse Fazlli Beu luante rolin e atij që nuk përzihej në këto punë, se gjoja çështjet materiale nuk i interesonin. Fazlliu hiqej si idealist, si politikan i madh, si njeri me kulturë e filozof. Aa, në këto drejtime «ai ishte i pari»!

Në shtëpi te Qazka, pse Fazlliu ishte beqar, me siguri jepte këshilla, lidhte e zgjidhte intriga me Tefik Mborjen, që pas pushtimit u bë ministër i partisë fashiste «shqiptare», dhe me të vëllanë, Selim Mborjen (tregtar i madh, që bashkë me një italian që pronar i fabrikës së birrës), me Petraq Katron, tregtar i madh edhe ky, fashist i orëve të para. Këta dhe shokët e tyre qenë miqtë e vërtetë të Fazlli Frashërit, por ky ruhej të ekspozohet, të luante kumar e të vinte me gra, si këta. Fazlliu, si një dhelpër dinake e borgjezisë që ishte, rrallë shkonte në qendrat ku mblidheshin këta borgjezë të degjeneruar. Shkonte vetëm te kafeneja afër kishës së Shëngjergjit, ku mblidheshin patriotë të vjetër korçarë, si: Gavril Pepoja, Idhomené Bratko e të tjerë. E ndiqte me kujdes dhe «këtë vijë», që të krijonte emrin e «patriotit».

Fazlli Frashërin e shihje pasdreke, dimër e behar, t'i binte poshtë e përpjetë bulevardit duke biseduar gati me të njëjtët profesorë të Liceut të Korçës, sidomos me Stavri Skëndin, që u bë ndër eksponentët e Ballit Kombëtar në Korçë, me njëfarë Niko Stralla, me agjentin e italianëve, Vili Jatrunë, të cilit i bënë atentat, në emër të popullit, njësitet tona guerile, me Andonaqkën e Frashërit, agjent i amerikanëve dhe imoral. Këta ishin shoqëria e tij «intelektuale» e zgjedhur dhe e përherëshme. Shumë rrallë e shihje në publik me tregtarë, me bejlerë ose me agallarë; sa për studentë, punëtorë e zanatçinj, për ta as që bëhej fjalë.

Fazlli Frashëri hiqej si një filozof *péripatéticien*,* *(Përkrahës i doktrinës së Aristotelit.) po jo se ishte pasues i Aristotelit, se filozofinë e tij nuk e njihte; nga mendimtari i njohur i antikitetit Fazlliu kishte marrë vetëm zakonin që «mendimet» e veta ua shtjellonte «dishepujve» gjatë shëtitjeve të gjata në bulevard. Kur lodheshin ca nga rruga, ca nga arsyetimet e mësuesit, pjesëtarët e këtij grupi «filozofësh» ktheheshin në kafenenë e Nandos dhe atje shtroheshin, pinin çaj e hanin kek. Fazlli Frashëri edhe këtu vazhdonte «leksionin», me atë fytyrë plot dregëza, që e fërkonte nganjëherë sikur kashaiste kalin, fliste e nxënësit dëgjonin. Stavri Skëndi e Foto Bala, profesor në Lice, simpatizant i flaktë i Duçes e fashist i orëve të para, ishin «bilbilat» që këndonin, sigurisht pas Fazllit. Këta të dy ishin «dishepujt» e Fazllit, por mundet dhe diçka tjetër. I pari, Stavri Skëndi, armiku ynë i betuar dhe agjent i amerikanëve, në prag të Çlirimit të Shqipërisë, u arratis dhe shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ku vazhdon luftën kundër Shqipërisë socialiste, kurse Foto Bala u burgos si agjent i Italisë fashiste dhe babai i tij, Dhimitër Bala, edhe ky armik aktiv i pushtetit tonë, u pushkatua nga gjyqet e popullit.

Dy herë, e shumta tri, pata rast të takohesha me Fazlliu, edhe këto gjatë shëtitjeve, sepse nuk kisha si të bëja ndryshe, mbasi qëllonte që dilja me kolegët e mi të Liceut për të shëtitur në bulevard, kur Fazlliu na dilte përpara dhe e vazhdonte rrugën me ne. Gjatë këtyre shëtitjeve dëgjoja bisedat që bëheshin në këto rrethe. Kur «kolegët» më prezantuan me Fazlliu, ky bëri sikur u gëzua; ai më njihte, natyrisht, nga pamja, kurse ne, të Grupit Komunist të Korçës, e njihnim Fazlliu edhe nga përmbajtja. Gjatë këtyre shëtitjeve të shkurtra dëgjoja se si beu «filozof» zhvillonte politikën «

madhe» të Anglisë, të Amerikës, të Gjermanisë e të Italisë. Njëherë, në bisedë e sipër, i ndërhyra dhe e pyeta

- Po për politikën e Ruisë ç'mendoni zoti Fazlli? Ju jeni liberal, demokrat dhe unë e di se nuk treni frikë të na flisni, - dhe ia theksova këto fjalët e fundit që edhe vetë kishte qejf t'i përsëriste. Te të tjerët pyetja ime ra si bombë, shikuan njëri-tjetrin në sy dhe po pritnin me kureshtje se si do të dilte «profesori» nga situata. Fazlliu bëri një pauzë, fërkoj mjekrën dhe rëndë-rëndë m'u përgjigj

- S'dimë shumë gjëra, zoti Hoxha, se soljetikët dhe Stalini bëjnë një politikë të mbyllur e konsDirative.

- Pse? - e pyeta. - Politika e Leninit dhe e Stalinit ka qenë gjithmonë e qartë, kurse Amerilca, Anglia, Franca e të tjerat kanë bërë traktate e marrëveshje të fshehta në dëm të popujve, edhe në dëm të Shqipërisë. Ne shqiptarët e dimë mirë se që L~--nini ai që i bëri publike këto prapaskena. Kurse sot, nga sa dëgjojmë, gjithë borgjezia dhe fashizmi e sUlmojnë Bashkimin Sovjetik dhe kanë arsyet e tyre, se e dinë që politika e sovjetikëve do t'u sjellë disfata.

- Ky është mendimi juaj, - më tha Faÿlliu, por ne mendojmë ndryshe. Ne jemi demokratë; por jo ekstremistë.

- E shoh, - ia ktheva me një ton irorlik dhe s'fola më.

Fazlli Beu u përpoq deri në fund të luante rolin e «demokratit». Me të ardhur Zai Fundoja në Korçë, pak para pushtimit, takimin e parë e bëri me Fazlli Frashërin, me fashistin Petraq Katro, me agentin e amerikanëve, Stavri Skëndin, dhe pseudokorhunistin Koço Tashko. Grupi i Korçës e hodhi poshtë t)ropozimin e Koços për bashkëpunim me trockistin Zai. Fundo, i cili kishte ardhur në Shqipëri për të sabotuar themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe luttën kundër armikut. Por nuk mundi dot. Më vonë ai u bashkua me anglezët e me Gani Kryeziun dhe mori dënimin e merituar.

Ky, pra, ishte Fazlli Frashëri, përfaqësues i borgjezisë tregtare dhe arrogante të asaj pjese të inteligjencies korçare, e cila, e korruptuar në kulm, u korruptua edhe më keq e u fut kokë e këmbë në shërbim të padronëve të rinj, pushtuesve fashistë.

U konsultova me shokët, që e njihnin po aq sa unë se kush ishte Fazlliu, dhe vendosëm ta prisja. Të nesërmen e thirra shokun tonë dhe e porosita:

- Takoje Fazlliuin e i thuaj : «Në ora kaq e aq ju pret në një shtëpi zoti profesor». Merre, sille rrotull rrugicave dhe fute te shtëpia e Gabranit.

Njerëzit e shtëpisë së shokut tonë të paharruar Sabaudin Gabrani ishin miqtë e mi dhe shtëpia e tyre Gjë nga bazat tona të luftës. Plaku i Gabranit ishte :ibohovit, njeri shumë i mirë dhe shok me plakun tim. Djemtë dhe vajzat e tij ishin të gjithë me ne, luftëtarë shumë aktivë të rinisë. Të gjithë u hodhën pa ngurrim në zjarrin e luftës çlirimtare. Sabaudini ra dëshmor, ndërsa vajzat dolën shëndoshë e mirë nga lufta dhe sot janë komuniste e punëtore të dalluara partie. Edhe plaka e Gabranit ishte një nënë shumë e mirë, gojëmbël, e urtë, e heshtur dhe trime. Na priste e na përcillte pa kurrfarë frike. Këta dy pleq ishin nga ata mijëra e mijëra patriotë, që jo vetëm fëmijët e tyre ia dhanë Partisë dhe Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe vetë u vunë në shërbim të saj. Megjithatë ata na thoshin: «Çfarë po bëjmë ne? Asgjë. Vetëm ju të na dilni gjallë». Ishin njerëz të thjeshtë dhe nuk e çmonin sa ndihmë të madhe i jepnin luftës së çlirimit. Ata ishin populli, pa të cilin ne nuk mund të luftonim, pa të cilin ne, luftëtarët e armatosur, mbeteshim «si peshku pa ujë».

U ndamë me shokun që dërgova për të gjetur Fazlliuin dhe shkova te shtëpia e miqve të mi. Gjeta babanë e Sabaudinit, i cili më priti si gjithmonë me dashuri.

- Mbas pak do të vijë këtu një njeri të piqet me mua, - i thashë. - E quajnë Fazlliu Frashëri. A do të më lejoni?

- Shtëpia jonë është jotja, - tha plaku i mençur. Dhe vazhdoi: - Unë e kam dëgjuar emrin e Fazlli Beut, por ruajuni nga bejlerët, mos e harro beun e anëve tona, Myfit Libohovën. Nuk u duhet zënë kurrë besë atyre.

- Mos ki merak, - i them, - se e njohim mirë këtë dhe të gjithë shokët e tij. Janë ashtu si më thua ti, por ne sytë i kemi hapur dhe mendtë në kokë.

- Kur të vijë ai, - tha plaku, - do t'ju sjell kafënë e do të më falni se do t'ju pres muhabetin.

E falënderova dhe po prisja Fazlli Beun. Dëgjova zhurmën e portës që u hap dhe pashë të hynin në oborr shoku ynë me gjithë Fazlliun. E prisja ulur në divan. I dhashë dorën, u përshëndetëm dhe u futëm në dhomë.

Si zuri vend, Fazlli u fërkoj një herë lkërcat e fytyrës dhe pasi më pyeti për shëndetin, filloi bisedën.

- Na erdhën kohë të këqija, zoti profesor, i huaji na okupoj atdheun, - dhe tundi kokën i vrerosur.

- Është vepra e Zogut dhe e miqve të tij, - i them. - E rropën mirë e mirë popullin dhe më në fund e shitën vendin tek Italia. Besoj se të kujtohet mbledhja në Bashkinë e Korçës, Fazlli Bej ? Ishte miku juaj, prefekt Vasjari, i cili, pikërisht kur ne kërkonim armë, na kërcënoi dhe mbrojti rrugën e Kapshticës, prej nga do të arratisesh Zogu me arin e popullit, apo jo?

- E mbaj mend, zoti profesor, - pohoi Fazlli, babanë e Sabaudinit, i cili më priti si gjithmonë me dashuri.

- Mbas pak do të vijë këtu një njeri të piqet me mua, - i thashë. - E quajnë Fazlli Frashëri. A do të më lejoni?

- Shtëpia jonë është jotja, - tha plaku i mençur. Dhe vazhdoi: - Unë e kam dëgjuar emrin e Fazlli Beut, por ruajuni nga bejlerët, mos e harro beun e anëve tona, Myfit Libohovën. Nuk u duhet zënë kurrë besë atyre.

- Mos ki merak, - i them, - se e njohim mirë këtë dhe të gjithë shokët e tij. Janë ashtu si më thua ti, por ne sytë i kemi hapur dhe mendtë në kokë.

- Kur të vijë ai, - tha plaku, - do t'ju sjell kafënë e do të më falni se do t'ju pres muhabetin.

E falënderova dhe po prisja Fazlli Beun. Dëgjova zhurmën e portës që u hap dhe pashë të hynin në oborr shoku ynë me gjithë Fazlliun. E prisja ulur në divan. I dhashë dorën, u përshëndetëm dhe u futëm në dhomë.

Si zuri vend, Fazlli u fërkoj një herë lkërcat e fytyrës dhe pasi më pyeti për shëndetin, filloi bisedën.

- Na erdhën kohë të këqija, zoti profesor, i huaji na okupoj atdheun, - dhe tundi kokën i vrerosur.

- Është vepra e Zogut dhe e miqve të tij, - i them. - E rropën mirë e mirë popullin dhe më në fund e shitën vendin tek Italia. Besoj se të kujtohet mbledhja në Bashkinë e Korçës, Fazlli Bej ? Ishte miku juaj, prefekt Vasjari, i cili, pikërisht kur ne kërkonim armë, na kërcënoi dhe mbrojti rrugën e Kapshticës, prej nga do të arratisesh Zogu me arin e popullit, apo jo?

- E mbaj mend, zoti profesor, - pohoi Fazlli, - por ju e dini që unë jam demokrat dhe e dua vendin të jetë i lirë.

- Ç'keni ndër mend të bëni zotëria juaj për ta çliruar vendin? - e pyeta. - Kjo neve na intereson shumë dhe, po të gjejmë gjuhë të përbashkët, atëherë do t'i harrojmë të kaluarat. E tashmja na preokupon, se e kemi armikun në vatër, prandaj më parë duhet të heqim qafe atë, pasta mosmarrëveshjet që kemi, i zgjidhim në mes nesh. Se kemi dhe mosmarrëveshje, është kështu, zoti Fazlli?

- Kështu është, zoti profesor, por edhe unë jam i mendimit që të përqendrohemi dhe të shkëmbejmë mendime pikërisht për situatën.

- Urdhëro zoti Fazlli, po ju dëgjoj, - i thashë, kurse me vete mendoja: «Kushedi ç'do të grijë tanfi». Dhe ai filloi të më tjerë arsyetimet e veta për situatën e jashtme. Theksoi forcën dhe egërsinë e fashistëve italianë, foli për ngjitjen e Hitlerit, për sulmin kundër Bashkimit Sovjetik, i thuri një ditiramb të tërë forcës së madhe të Anglisë e të Amerikës dhe nuk harroi të më përmendë, po ashtu, edhe «forcën e sovjetikëve që po luftojnë», sikurse u shpreh.

Pasi më bombardoi kështu ndonjë gjysmë ore të mirë, i kënaqur nga analiza që i kishte bërë situatës, arriti, më në fund, te qëllimi i misionit të tij:

- Duke i pasur parasysh të gjitha këto, - vazhdoi Fazlli, - ne gjejmë se jemi në situata të rënda, se jemi vend i vogël dhe kemi mbi kokë fuqi të mëdha që, një çikë të ngresh gishtin për të thënë një fjalë, të grijnë.

- Domethënë, zoti Fazlli, - s'm'u durua mua, - ne të vegjlit të mos pipëtimë?!

- Jo, - nxitoi beu, - kuptohet që ne duhet të luftojmë, se pa luftuar nuk fitohet gjë dhe, deri këtu, jam dakord. Por për ne, meqë jemi një popull i vogël, ka një rëndësi të madhe të bëjmë një politikë të zgjuar. Politika, zoti profesor, - ngriti zërin Fazlli me një ton mësuesi, duke fërkuar fytyrën si

zakonisht, tash ka rëndësi të madhe për ne. Duhet ta fillojmë me një politikë të zgjuar me Italinë, t'i dredhojmë, ta vëmë në gjumë dhe javash-javash ta ngremë edhe ne zërin në mënyrë që, siç thotë patrioti i shquar Mithat Beu, «edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet».

- Flisni edhe në emër të Mithat Beut? - e pyeta.

- Posi, - tha, - të atij dhe të shumë të tjerëve.

- Urdhëroni, - i them, - vazhdoni!

- Ja, më falni, por do t'ju flas sinqerisht: Ju jeni komunistë, ne jo; ju formuat një parti, ne s'kemi dhe nuk jemi për krijimin e ndonjë partie; ju po bëni propagandë të madhe në popull ta ngrini menjëherë në luftë, ne kemi tjetër taktikë; ju po hidhni hapa edhe për pushtetin, ne kemi tjetër mendim për të nesërmen. Neve nuk na pëlqen që ju bëni gjithë këto, por kjo është puna juaj. Vetëm se, kuptomëni drejt zoti Hoxha, e keni marrë punën, na duket neve, si majë më majë me italianët. Ju vrisni, por edhe ata vrasin e burgosin me mijëra. Ne, zoti Hoxha, qajmë hallin e djalërisë, lules së vendit tonë. Si të na e grijë atë armiku, a menjoni ç'dëm i madh i shkaktohet së ardnmes së Shqipërisë? Këtu na dhëmb, zoti Hoxha.

- Por ç'duhet të bëjmë sipas jush, zoti Fazlli? e pyeta me një zemërim të papërmbajtur që më vlonte përbrenda.

- Ja, zoti profesor, ne mendojmë që hëpërhë të mos veproni; të organizojmë disa takime, për të studiuar një politikë të përbashkët që duhet të ndjekim ndaj italianëve, sepse jem? shumë edhe ne, zoti Hoxha dhe më falni, por jemi në pleq e na njeh më shumë populli. Kështu edhe të dy palët merremi vesh, por edhe populli do të jetë dakord, se do ta shpëtojmë nga vrasjet, djegiet etj.

- Qazka, velai juaj, vazhdon akoma të bëjë tregti me italianët? - e pyeta.

- Ç'hyn në këtë çështje tregua e Qazimit? kërceu si i habitur Fazlli Beu, se i dogji pyetja ime.

- Ta bëra këtë pyetje zoti Fazlli, - i thashë duke buzëqeshur, - se dua të përmbledh mendimin politik që më parashtrove. Të bësh politikë të zgjuar e të matur, për ju do të thotë të bëjmë tregti me Italinë fashiste, se për ju fiala «politikë» mund të përkthehet me fjalët «tregti e Qazkës».

- Qazimi, - u përgjigj Fazlliu, - merret me tregti dhe jo me politikë. Këto dy gjëra janë të ndara, zoti profesor.

- Nuk janë dhe kaq të ndara, sikurse thoni ju, - i thashë. - Por, në qoftë se mbaruat, mund t'ju them dhe unë mendimin e Partisë sonë.

- Ju lutem, - tha Fazlliu, - unë mbarova.

- Ne komunistët kemi qenë të sigurt se formimi i Partisë sonë Komuniste ishte një plumb në zemër të pushtuesve italianë dhe të miqve të tyre, të cilët e dinë mirë vlerën e madhe që ka për një popull që do të luftojë ekzistenca e një force udhëheqëse dhe, veçanërisht, partia komuniste. Por ne tash u siguroam nga goja juaj së edhe juve, që e quani veten nacionalistë, s'ju erdhi mirë që ne komunistët formuam Partinë tonë e po luftojmë për zbatimin e programit të saj për çlirimin e atdheut. Ju këtë ma thatë vetë, por asnjë argument nuk më dhatë se q'gabim bëmë ne komunistët që krijuam Partinë.

- Ne mendojmë, zoti profesor, se nuk është ko

ha për të formuar partira. Ja, ju formuat Partinë Komuniste, ne mund të formojmë një parti tonën. t~tjerë një të tretë e kështu me radhë. Ç'na sjellin këto, përveq përçarjes së popullit? A nuk është kjo në dëm të luftës dhe në dobi të atyre që i duan të keqen Si:qipërisë?

- Jo, - iu përgjigja Fazlli Beut. - Po të ishte kështu, nuk do të shqetësoheshin kaq shumë fashistët dhe miqtë e tyre. Ne e ngritëm Partinë, pikërisht, që ta bashkojmë popullin dhe jo ta përçajmë dhe k'o do të arrihet patjetër, se programi ynë është ai që do populli. Por, zoti Fazlli, - vazhdova, - ju na dënioni ne komunistët që formuam një parti, por nuk më thatë gjë a jeni kundër partisë fashiste «shqiptare» që krijuan miqtë tuaj?

Fazlliu kruajti faqen dhe tha:

- Dhe për atë jemi kundër.

- Jeni kundër vetëm me fjalë, - i thashë. - se

të gjithë miqtë tuaj shpejtuan të shkruanin errrat në listat e saj.

- Duan të hanë bukë, zoti Hoxha, se përrndryshe s'i mbajnë në punë.

- Po populli, po ne djemtë e tij, nuk duan të hamë? Edhe ne hamë, por krodhën e popullit e jo

franhollën e fashistit Xhiro e té miqve té tij. Ju thatë vetë se ju nacionalistët nuk doni té krijoni parti. Pse nuk doni? Po jua themi ne: Ju nuk jeni né gjendje ta bëni këtë, sepse, sado që té hiqeni si me influencë, po^ulli nuk ju beson dhe nuk ju ndjek. Veç kësaj, ju, n uk them vetëm për ju personalisht, nuk doni t'i prishni qejfin pushtuesit. S'ju lë ai té krijoni parti tuajën, .randaj ju tregon rrugën, té futeni né partinë fashiste.

Arsyeja tjetër kryesore që ju nuk doni té keni pari. është se nuk doni dhe as që keni ndër mend té lufto ni kundër pushtuesit. Ju lëshoni parullat reaksionare: «Stan me lepuj nuk bëhet», «dy shqiptarë nuk mbliëihen kurrë tok» etj. Kurse ne kemi besim té plotë tek uniteti i popullit tonë, i cili kurdoherë është ngritur né uftë kundër té huajve. Popullin e kanë përçarë vazhúimisht feudalët, bejlerët, tregtarët e spiunët. Edhe

tash po këta përpiqen té luajnë té njëjtat letra. Por 'ani populli shqiptar ka udhëheqjen e tij besnike, Partinë Komuniste. Ju dëshironi që populli té mos ketë udhëheqje. té mos ngrejë krye, té mos dijë nga té zhkojë. Pa partinë komuniste s'ka luftë dhe pa luftë s'ka parti komuniste. Zoti Fazlli, - vazhdova, - Paria jonë Komuniste është né luftë deri né vdekje me italianë fashiste dhe me bushkëpunëtorët e saj. Për fashistët italianë ne kemi vetëm pushkë dhe bomba, s'ka diplomaci dhe kompromis me ta. Ne edhe juve, ty dhe miqve té tu, ju kemi bërë kaq herë thirrje që té bashkojmë forcat për luftë k undër fashizmit, por ju jeni për té bërë «politikë» mie ta. Pra, nuk jemi dakord, ndahemi kështu né gjënë! kryesore, né gështjen bazë.

Tani ne e quajmë té nevojshme t'ju paralajmërojmë. Rruga e parë: té bashkoheni né luftë me ne kundër pushtuesit dhe tradhtairëve dhe, kur them té bashkoheni, jo me gënjeshtria ie me dredhira, sig keni bërë gjer tani, por me fakte. Kjo duhet té merret seriozisht nga ju dhe té jeni té bindur se nuk do té na mashtroni dot. Kjo rrugë është rruga e nderit, e vetmja rrugë patriotike që na kanë mësuar té parët tanë.

Rruga e dytë: është té lidhni duart, té neutralizoheni, as me ne, as me italianët. Kjo rrugë nuk është e ndershme, aspak patriotike dhe zor té mbahet një qëndrim i tillë në këto kohë, kur gjithë bota është në zjarr dhe populli ynë po lufton. Këtë qëndrim e mbajnë vetëm frikacakët.

Rruga e tretë: është ajo e tradhtisë, e bashkëpunimit të fshehtë ose té hapët me pushtuesit, kundër popullit që lufton., Tradhtarët mund té vënë çdo maskë, por ato do t'ua çjerrim. Tradhtia do té dërmohet pa mëshirë nga forca e popullit.

Partia Komuniste e Shqipërisë ka zgjedhur rrugën e parë dhe nuk mund té ndodhë ndryshe. Ju na propozuat neve një rrugë: «Bëni politikë me italianët!». Ne jua hedhim poshtë këtë propozim dhe ju propozojmë juve rrugën tonë që është e vetmja rrugë e patriotëve té vërtetë.

- Ju jeni kokëfortë dhe s'dini té bëni politikë, tha Fazlliu.

- Këtë na e ka thënë edhe Mithat Beu, - i thashë, - qysh kur vendi u pushtua dhe unë akoma isha legal e kisha dhe një dyqan ku shisja cigare.

- Mithat Beu donte té vinte vetë té takohej me ju, - më tha Fazlliu, - dhe do t'i vijë keq kur t'i raportoj bisedën tonë.

- Mithat Beu, - i thashë, - e kishte zor té vinte té më takonte mua dhe nuk kishte pse té takohej, sepse urat i preu ai dhe jo unë. Megjithatë, ja, té ka dërguar ty, dhe unë té prita, té dëgjova e më dëgjova, e ç'u tha këtu, me siguri, do t'ia transmetosh edhe zotit Mithat. Por, - vazhdova, - dua té theksoj, dhe flas në emër té Partisë Komuniste, se ne do té jemi me té gjithë ata që do té ndjekin rrugën e luftës. Lufta do té na bashkojë edhe me Lumo Skëndon e me shokët e tij, në rast se ata hyjnë në luftë me italianët dhe me kuislingët. Dëshiroja t'ju thosha, gjithashtu, zoti Fazlli, edhe diçka në lidhje me atë që thatë se populli është me ju, se «ju ju njohin e ne nuk na njeh dhe nuk na dëgjon njeri». Së pari, ky është mendimi juaj, por jo yni. Së dyti, dhe kjo është kryesorja, dijani mirë se mendimi juaj është i gabuar. Bile ju e kërkuat këtë takim, sepse po e shihni që populli është dhe do té jetë i tëri me ne, me Partinë Komuniste të Shqipërisë. Me ju do té mbeten bejlerët e degjeneruar, agallarët, tregtarët gjakpirës, spiunët dhe kuislingët. Kjo është dhe do té mbetet «ushtria» juaj, nëse do té vazhdoni rrugën që keni nisur. Mos e merr këtë që them si kërcënim. Merre si ndihmën e fundit që po ju japim. Kuptojerii mirë situatën tuaj; s'jemi ne që kemi nevojë për ju, por ju keni nevojë për ne, se me ne është populli, e drejta dhe fuqia.

The, zoti Fazlli, se do të na vritet djalëria e do të na digjet vendi. Çdo luftë çlirimtare do të ketë edhe therorët, heronjtë dhe dëshmorët e saj. Edhe vendi do të na digjet, kurse populli dhe djalëria nuk do të shuhet, por do të shuhet fashistët. Pas luftës populli dhe djalëria do të jenë çelik, do të lëshojnë shkëndija si strall. Partia dhe lufta do t'i kalitin dhe do t'i mësojnë ata të mos gënjen nga njerëzit me njëqind flamurë në xhep. Populli do ta marrë vetë fuqinë në dorë dhe do të ngjasë ajo që ka thënë Naimi për Shqipërinë: «Lum kush të rronjë/ Ta shohë zonjë»!

Kjo është përgjigjja jonë, zoti Fazlli. Ju kërkoj ndjesë, në rast se kjo bisedë ka qenë ca e nxehtë, por ishte e sinqertë. Ne ju themi: Mendohuni lidhur me propozimet tona dhe mirupafshim në luftë kundër pushtuesve.

U ngrita në këmbë për t'i lënë të kuptonte se biseda nga ana ime kishte marrë fund. U ngrit edhe Fazlli Frashëri, u ndamë dhe s'ia pashë më sytë.

Si iku Fazlliu, hyri në dhomë i zoti i shtëpisë dhe siç më pa të lodhur, më hodhi dorën mbi supet e më tha dulce treguar nga filxhanët e kafesë që ishin mbi tavolinë:

- Kjo kafe që ke pirë me beun nuk quhet. E pimë një bashkë me plakun, se të heq mërzinë.

- E pimë, - iu përgjigja plakut të mirë. Dhe ndenjëm e biseduam një copë kohë së bashku. Kur erdhi koha që më duhej të shkoja, e kisha harruar edhe beun politikan, edhe tërë skotën e fëlliqur të tij.

Ky takim me përfaqësuesit e Partisë Komuniste, i kërkuar nga elementët pseudopatriotë, nuk ishte as i pari e as i fundit në atë periudhë. Siç thashë, politikanëve të kafeneve, që bënin lodrën e fashizmit, u kishte hyrë frika nga rritja e forcës sonë në popull dhe do të bënin gjithfarë përpjekjesh për të na devijuar nga rruga që kishim nisur. Ne vetë, te ky «zell» i papritur i tyre për «t'u marrë vesh» me komunistët, shihnim një tjetër tregues të rritjes së rolit e të autoritetit të Partisë sonë. Megjithatë, prudentë e konsekuentë në vijën që kishim përcaktuar, ne do t'i pritnim dhe do t'u jepnim kurdoherë përgjigjen që meritonin.

Ndërkohë vazhdonim me vrull punën për zgjerimin e forcimit e lidhjeve me masat e gjera të qytetit e të fshatit, me intelektualë e patriotë të të gjitha moshave dhe, ç'është e vërteta, ky «sektor pune», më i rëndësishmi e më kryesori, ishte edhe më i suksesshmi për ne.

Personalisht, midis dhjetëra e dhjetëra njerëzve me të cilët u lidha gjatë kësaj kohe, e paharruar dhe e dashur do të mbetet edhe figura e një mësuesi të vjetër patriot, tek i cili nuk ishte shuar dhe nuk do të shuhej kurrë zjarri i patriotizmit dhe i urrejtjes ndaj feudalëve, tradhtarëve dhe pushtuesit. E kisha parë dhe kisha mësuar disa gjëra për jetën e tij që kur isha mësues në Gjimnazin e Tiranës.

Po rrija duke pirë kafe, me një kolegun tim, edhe ai mësues në gjimnaz, në një kafene të vogël afër Pazarit të Vjetër, kur na kalon pranë një burrë disi i kaluar nga moshja, i paktë nga trupi, me një kostum blu të vjetruar dhe me një borsalinë, së cilës i kishte dalë fare boja. Ai e përshëndeti kolegun tim, i cili u ngrit nga karrigia dhe ia ktheu përshëndetjen me shumë respekt; instinktivisht u ngrita dhe unë. Kur burri u largua, e pyeta kolegun:

- Kush ishte ai që përshëndete?

- Nuk e njeh? - më tha kolegu. - Është Xhafë Zelka, mësues patriot i shkollës shqipe këtu në Tiranë. Atë e kanë cilësuar «Xhafë Rebeli», sepse ka qenë «qatip» dhe luftëtar me Haxhi Qamilin.

M'u ngjall menjëherë kureshtja për Xhafë Zelkën apo «Xhafë Rebelin» si e kishin cilësuar dhe i thashë kolegut:

- Qenka interesant, më fol ç'di për të dhe po munde dua të më njohësh ndonjë ditë.

Kolegu dinte diçka mbi jetën e thjeshtë, luftarake dhe plot përpjekje të Xhafës. Më tregoi se qe antifeudal, kishte luftuar kundër Toptanasve e kundër Vërlacit dhe, më vonë, si demokrat që ishte, mbështeti qeverinë e Nolit. Kur erdhi Zogu, Xhafës i nxorën një mijë belara, e pushonin nga puna, e emëronin, e pushonin prapë derisa e qitën në lirim.

- Duhet ta dëgjosh vetë kur tregon hiqajetet e babë Qamilit, - më tha shoku, - por një ërën po ta tregoj unë ashtu siç ma ka thënë Xhafa:

Babë Qamili dhe ushtarët e tij kishin dalë në breg të Shëngjinit. Aty ai ngriti dylbinë e gjatë që mbante me vete dhe filloi të shohë detin. Në horizont u duk një anije mjaft e madhe, që po afrohej. Ishte një nga ato anijet e mëdha tregtare që vozitnin në portet e Adriatikut.

- Xhafë, - i bërtiti babë Qamili Xhafë Zekës. Ja i çik këtu, Xhafë, nxirr letrën dhe mereqepin e i shkruaj atij bir kurve që drejton anijen, të mos afrohet në brigjet e Shqipërisë, se po u afrua, i rashë me top, dhe do ta bëj përsesh që as peshqit të mos kenë ç'të hanë.

Xhafa e kishte parë në sy babë Qamilin, por ai me një shikim të rreptë e kishte bërë të ulte kokën dhe të shkruante ato që dëgjo. Babë Qamili pastaj u dha urdhër tre luftëtarëve të merrnin një varkë të vogël me rrema, që ndodhej atje, dhe të venin t'ia dorëzonin letrën në dorë kapedanit. «Po ju mbajtën rob, - u tha babë Qamili, - përpikuni të vrisni nja dy dhe bini në «shehadet», pse do t'ju grijë gjylja e babës, armiqtë dhe ju, shokë të mi. S'kam ç'baj, duhet mbrojtur ky millet, ju në xhenet do të shkoni». Por ata nuk shkuan në xheneit, se mbërritën përsëri shëndoshë e mirë në breg, kurse mauna një t'u kthyer e shkoi prapa diellit.

Ja këtë më ka treguar Xhafa, por ai duhet të dijë shumë nga këto histori, - e përfundoi «hiqajenë» kolegu im.

- Di ndonjë tjetër, - i thashë kolegut, kur ai heshti, - se më intereson shumë çështja e rebelizmit, sidomos Kryengritja e F'shatarësisë së Shqipërisë së Mesme.

- Më gjatë, - tha ai, - pyete vetë Xhafën. Do të të njoh ndonjë ditë mea të, por mos mendo se sa ta pjekësh ai do të fillojë dhe të të rrëfejë, duhet t'ia fitosh besimin pa të të flasë për këto gjëra, ndryshe ai hesht.

Kaluan kohë. Xhafë Zekën kolegu nuk mundi të ma prezantonte, por unë, kur e shihja ndonjëherë në Rugën e Dibrës, për t'i tërhequr vëmendjen i flisja me zë të lartë duke e përshëndetur me respekt.

Ai më shikonte me labi, pastaj më përshëndeste dhe vazhdonte rrugën. Me gjithë dëshirën e madhe për t'u njohur nga afër Bne Xhafiën, nuk munda dot, sepse u transferova në Korçë. Vetëm pas pushtimit, kur fillova punën në dyqanin «Flora» arrita të njihem dhe të bisedoj me të. Gjatë kësaj kohe vazhdimisht rrëmoja për të mësuar sa më shumë rreth Kryengritjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme, të udhëhequr nga Haxhi Qamili. Shoku ynië erudit, Selim Shpuza, m'i tregonie me hollësi fazat e asaj epoke që bejlerët, feudalët dhe borgjezia që pio lindte e quanin «epoka e rebelëve».

Pas Çlirimit mendimet e mia për këtë periudhë të rëndësishme të kryengritjes fshatare i kam hedhur në një shkrim,* *(Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 11, f. 128.) ku, nën dritën e filozofisë marksiste-leniniste, jam përpjekur të shpjegoj arsyet objektive që e shkaktuan atë si dhe të hedh poshtë si të pabaza dhe antishkencore qoftë pikëpamjet e teorizimet e shtrembra e denigruese të përhapura mbi «rebelizmin» nga esadistët, zogistët dhe borgjezia fajdexheshë, e cila zuri vendin e feudalëve, pra i hipi në zverk fshatarësisë së varfër, ashtu edhe mendimet e padrejta të disa elementëve përparimtarë të kohës, që nuk e kuptonin thelbin klasor dhe kompleksitetin e kësaj lëvizjeje.

Por këtu e karq fjalën te Xhafë Zelka.

Një ditë nga vitrina e dyqanit «Flora» shoh Xhafën që po vinte në dyqan. Ngrihem në këmbë dhe i them

- Ç'urdhëroni, zoti Xhafë?

- Ku ma di emrin tim, mor djalë? - më thotë ai.

- Mësuesit ua dinë emrin dhe kanë respekt për mësuesit e vjetër e patriotë si ju.

- Pse, mësues je ti apo duhanshitës? - më tha Xhafa, i cili nuk e fshehu dot kënaqësinë që ndjeu kur dëgjo se respektohej dhe cilësohej si mësues patriot.

- Mësues kam qenë, por pushtuesit më pushuan nga puna dhe tash shes cigare, - iu përgjigja.

Më pa në sy dhe tha:

- Mund të më japësh një paleo cigare?

- Dy, po të duash, - i them.

- S'kam pare për dy, por për një.

- Të më falësh, zoti Xhafë, - i them, - por miqve u japim edhe me kredi. Kur t'i kesh, m'i sill paratë.

Ke dyqan zotrote? - e pyeta.

- Jo, mor bir, por i shes në këmbë, se dua të rris fëmijët.

I vura përpara tri paleo cigare dhe i thashë t'i merrte e paret t'i sillte mbasi të shiste cigaret.

Më shikoi përsëri në sy dhe më tha:

- A duhet ta pranoj këtë mirësi që më bën?

- Kur ia bën nxënësi mësuesit, kjo duket një gjë aq e vogël sa nuk pranoj të më falënderosh.

Xhafë Zelka vuri dorën në kapele, mori pakot, më tha .<Mirupafshim, djalë» dhe doli.

Tani nuk kisha vetëm interes të mësoja nga Xhafë Zelka mbi kryengritjen fshatare të udhëhequr nga Haxhi Qamili, por edhe ta lidhja atë me luftën që kishim nisur. Një mësues e patriot i nderuar si Xhafa, do të bënte shumë punë në rrethet që njihte. Fjala e tij, e frymëzuar nga lufta jonë, do të bënte efektin e saj sidomos te të rinjtë, kur këta të shihnin se edhe të moshuarve kjo luftë u kishte ripërtërirë energjitë. Fjala dhe shembulli i njerëzve të tillë si Xhafë Zelka, me atë bagazh të pasur jetësor e luftarak që kishin, me siguri do të shërbente edhe për të demaskuar ata «patrioti» që donin të jetonin me hijen «e lavdishme» të së kaluarës, pa pasur as edhe një të dhjetën e veprimtarisë së Xhafë Zelkës. S5gurisht nuk mund t'i hapësja që ditën e pari. Do ta mbaja pranë, do ta prisja ashtu si e meritonte dhe më vonë njohja jonë do të merrte rrugën e saj të natyrshme.

Pas disa ditësh ai erdhi dhe më solli të hollat. Unë i nxora tri paleo të tjera.

- Prapë ti po këtë avaz, mor zotni?! - më thotë Xhafa.

- Jo, - i them, - nuk është më i njëjti avaz, ti këtë herë i pagove, ja, të hollat i vure mbi tryezë.

- Si të quajnë ty, mor djalë? - më pyeti Xhafa, duke m'i ngulur sytë e tij të gjallë dhe të vëmendshëm.

- Më quajnë Enver Hoxha, - i them, - dhe jam nga Gjirokastra. Ja dhe babai im.

Plaku rrinte i heshtur në një karrige dhe dëgjonte. Xhafa u drejtua nga ana e tij dhe e përshëndeti.

Plaku im që ishte i thjeshtë, u ngrit në këmbë dhe i bëri temena.

- Të të rrojë djali, - i tha Xhafa.

- Ejvalla, - i tha plaku dhe, si kurioz që ishte, e pyeti: - Nga të kemi zotrote, a ke fëmijë?

Xhafa iu përgjigj se kishte vajza dhe djem dhe si mori pakot, iku dulce na përshëndetur e falënderuar.

Kur doli nga dera, xhaxhai më pyeti:

- Kush ishte ky? A ka dyqan?

- Çfarë dyqani, ai është kripë, - i them. - Ky plak ka qenë tek me Haxhi Qamilin kur u vunë zjarrin pallateve të Esat Toptanit.

- Jo more! - tha plaku. - E po jemi fit e fit, ky i vuri zjarrin pallatit të Esat Pashës, Avni Rustemi ia mbylli përgjithmonë derën Pashës së poshtër, - dhe xhaxhai ra në heshtje e në mendime.

- Po ku i gjen ky plaku paret, që blen nya tri paleo?

- Ia jap veresie, - i them.

- Mos e zgjat, - tha xhaxhai, - e kuptova.

Kur Xhafa erdhi herën tjetër, jo për të marrë palco me cigare, po thjesht se i kishte rënë rruga, nuk e lashë të largohej menjëherë, por e ftova të pinim një kafe. Xhafa nuk më refuzoi.

- Or zoti Enver, - më tha Xhafa, - vetëm pse karn qenë mësues dhe ke qenë dhe vetë mësues. më respek ton dhe më nderon kështu?

- Edhe për këtë, zoti Xhafë, por sidonnos për da shurinë që ke për atdheun dhe për luftën që ke bërë për të mirën e popullit fukara. Ju e keni ndier thellë pushtimin që na ka hedhur mbi shpinë Italia dhe me siguri keni menduar se populli nuk do ta durojë, por do të ngrihet e do ta flakë poshtë atë. Shpirti kryengritës i shqiptarëve nuk ka reshtur kurrë së qeni i tillë. Sigurisht kohët kanë ndryshuar, armiku është më i egër, më i armatosur, po mos do të tutemi nga kjo? Unë them jo, zoti Xhafë dhe nuk e di si mendoni ju, luftëtari i kryengritjes së Haxhi Qamilit?

Burri i urtë dhe i ndershëm, patrioti Xhafë Zelka u mendua pale e tha:

- Xhafë Zelka nuk është më i ri, zoti Enver, se po të ishte i ri, nuk do të sorollatej kështu.

- Lufta për atdhe zoti Xhafë, nuk njeh moshë.

Secili mund të kontribuojë, - dhe si e vështrova në sy i thashë duke i theksuar fjalët, - e duhet të kontribuojë për lirinë e atdheut. Prandaj më erdhi keq kur ju dëgjova që thatë se jeni plakur. Nuk plaket kollaj Xhafë Zelka dhe ai do të gjejë ilaçin me të cilin do të luftojë pleqërinë e moshës, por jo të shpirtit.

Xhafa piu kafen pa folur dhe bënte ç'bënte m'i hidhte sytë sikur mc, hetonte. Për atë ditë m'u duk n:jaftueshme biseda. Shpirti rebel i Xhafë Zelkës ishte i tillë, që dente vetëm një ngacmim për të shpërihYer.

- Më bëre të mendohem me fjalët që më the, tha Xhafa dhe si uli kokën shtoi me një zë që më bëri të dridhem nga emocioni: - Mirë të gjetça, bir!

Mezi munda t'ia kthej përshëndetjen dhe për një kohë të gjatë e ndoqa me sy si ecte ashtu ngadalë.

Xhafë Zelka ishte një patriot i shquar, demokrat, atij i dukej se po «rëndohesha» me «ndihmën- që i jepja. Ai, i ndershmi plak Xhafë Zelka, kujtonte se unë bëja ndonjë sakrificë.

Një ditë erdhi në dyqan dhe unë i thashë:

- Sa pako do sot?

- Asnjë, zoti Enver, - më tha.

- Pse kështu, zoti Xhafë, - i thashë, - mos më kurse.

- Jo, bir, - më tha, - por jam lodh, tash më jep vetëm një kafe.

I thirra të na bënte një kafe Malit, kafexhiut tiranas, mikut tonë që na lajmëronte kur në kafenenë e tij të vogël vinin spiunët për të na përgjuar. Mali ishte burrë i shkuar, veshur tirançe dhe, kur solli kafen, Xhafa, që me siguri e njihte, i tha:

- Malo m'i ruaj me kujdes çunat.

- Mos ki merak babë Xhafë, - iu përgjigj Mali.

Duke pirë kafen Xhafë Zelka më tundi kokën:

- Tash unë e di se ç'bluan ajo kaptina jote.

Me të qeshur i them:

- Pse unë nuk e di se ç'bluan jotja?

Qeshëm të dy.

- Dëgjo bir, - tha Xhafë Zelka, - tash nuk ju ndihmoj dot sa duhet, se më janë pre kambët, por goja nuk më pushon dhe nuk do të më pushojë kurrë kundër këtyre qenve fashistë.

- Zoti Xhafë, - i thashë, - gjuha pret hekurin, ti ke qenë luftëtar i vegjëlisë dhe vazhdon të jesh, ne ecim në rrugën tuaj për të shpëtuar atdheun.

- Ju dini më shumë nga ne si të luftoni, ju lumtë! Dëgjo, avitu, - më tha Xhafa dhe më foli me zë të ulët: - Unë nuk bëhem dot komunist, por fëmijët e mi dua të m'i mësoni që ata medoemos të bëhen të Partisë.

- S'ka asnjë dyshim, - i thashë, - ata, si gjithë fëmijët e popullit, do të ndjekin rrugën dhe mësimet e babës së tyre, lufta do t'i mësojë dhe Partia do t'i mbajë kurdoherë pranë e do t'i edukojë të bëhen njerëz të vlefshëm.

Dhe me të vërtetë njëri nga djemtë e tij u bë një anëtar i vendosur partie dhe gazetar, kurse njëra nga vajzat, siç më ka thënë Nexhmija që e kishte shoqe klase në Institutin e atëhershëm Femëror të Tiranës, ishte mësuese aktive si gjatë viteve të luftës, ashtu edhe më vonë. Edhe tre fëmijët e tjerë të Xhafë Zelkës, siç kam dëgjuar, u bënë njerëz të thjeshtë dhe punëtorë të nderuar, ashtu si i deshte babai i tyre, patrioti Xhafë Zelka, që gjithë jetën luftoi për popullin fukara, për përparimin dhe lirinë e që pas Çlirimit të atdheut për vite me radhë, derisa vdiq, kaloi një pleqëri të lumtur e të gëzuar.

Patriotë të tillë, që pavarësisht nga mosha e thyer, i vunë të gjitha forcat në shërbim të atdheut dhe të Partisë, që u bënë krahas djemve e vajzave luftëtarë, agjitorë e propagandistë të flaktë për lirinë dh-- pavarësinë e vendit, ishin të shumtë, anëmbanë Shqipërisë. Kështu që, pavarësisht nga lodrat e tentativat e pseudopatriotëve, ne po e vazhdonim më me zell punën për bashkimin e organizimin e masave, për ta ngritur këtë bashkim në shkallë më të lartë e për ta vënë në baza më të shëndosha.

Në një mbledhje që organizuam në qershorin e vitit 1942, ku ishin të pranishëm Ramadan Çitaku, Nako Spiru, Koço Tashkoja, Mustafa Gjinishi dhe ndonjë tjetër që ndoshta s'më kujtohet, ndërsa po bisedonim për lidhjet tona me elementët nacionalistë, u thashë shokëve:

- Puna po zgjerohet dhe lufta po merr hov, por a nuk duhet menduar se ka ardhur koha që e gjithë kjo të organizohet e të centralizohet?

- Të organizuar e kemi! - u hodh Koçoja.

- Ashtu është, - ia ktheva. - Në njëfarë kuptimi, puna bëjmë ne si Parti me masat, me nacionalistët, është e organizuar dhe e centralizuar, sepse këtë e udhëheq Komiteti Qendror Provizor. Por në këtë drejtim ka akoma për të bërë, sepse ka shokë që nuk e mbajnë në korent udhëheqjen për lidhjet, lëvizjet e kontaktet e ndryshme, - dhe pashë nga Mustafai, po ky s'bëri zë. - E kam fjalën, - vazhdova, - që masat e gjera të popullit, patriotët duhet të organizohen, të kenë një drejtim unik, politik dhe ushtarak, që Fronti Nacionalçlirimtar apo popullor, s'ka shumë rëndësi si do të quhet, të cilin faktikisht po e krijojmë, të mishërohet konkretisht në disa forma organizative të vetat, të ketë organet kompetente që do të drejtojnë në punën për mobilizimin e popullit në luftë.

- Luftën dhe masat i udhëheq Partia! - tha rëndë-rëndë përsëri Koço Tashkoja.

- Kjo, - iu përgjigja me qetësi, - është një parim themelor yni. Edhe Frontin do ta udhëheqë Partia edhe rininë po ashtu. Por duhet të kemi parasysh se në luftë nuk marrin pjesë vetëm komunistët dhe simpatizuesit e Partisë. Edhe parimisht, edhe taktikisht kemi nevojë për një organizim të masave në një organizatë luftarake, me një program i cili të bashkojë të gjithë ata që do të luftojnë.

- Drejt e ka Tarasi, - më mbështetën Baca e Nakoja, por edhe Mustafai u shfaq pro mendimit tim. Kjo për të qe një mundësi që i hapej për të punuar për qëllimet e veta e për të shmangur kontrollin e Partisë.

- Të mblidhemi e të vendosim sa më shpejt për këtë punë, - propozoi Gjinishi. - Të krijojmë një shtab drejtues dhe ta shpallim nëpërmjet një proklamate.

- Jo, - i thashë, - në këtë punë nuk duhet të nxitojmë. Neve nuk na duhen shtabe e kryesi në letër, këto s'do t'i njihte njeri. Mendimi im është të organizojmë një mbledhje me përfaqësues të Partisë sonë, si e vetmja parti në vend, dhe me patriotë të ndryshëm dhe atje të vendoset si e qysh.

- Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut jua sjell unë këtu! - thirri me mburrje Mustafa. - Myslim Peza mua s'ma prish, po kështu.. .

- Dëgjo Mustafë, - e vura në vend Gjinishin e ekzaltuar nga «influenca e vet», - Myslimi nuk ia prish Partisë, se me të është lidhur ai dhe jo me ty, apo me këdo tjetër. Sidoqoftë, ky qe një mendim që do ta diskutojmë dhe për këtë do të vendosë Komiteti Qendror.

Në të vërtetë ky mendim kishte kohë që më rrihte si çekan në kokë dhe në njërën ose në tjetrën mënyrë qysh më parë ua kisha shfaqur disa shokëve.

Isha i bindur dhe këtë po e vërtetonte koha se Partisë sonë Komuniste, pas punës që kishte bërë për afro 6-7 muaj, i takonte të merrte iniciativat konkrete për ta mishëruar bashkimin e popullit shqiptar politikisht dhe organizativisht. Bisedova edhe me shokë të tjerë që i takova ato ditë dhe vendosëm që në një mbledhje të rregullt të Komitetit Qendror të diskutonim më gjerësisht dhe të vendosnim e të përcaktonim masat që duheshin marrë për përmbajtjen e mbledhjes, si dhe për vendin dhe kohën ku do të mbahej.

Menjëherë pas kësaj orientuam që kontaktet dhe puna që do të zhvillonin shokët me nacionalistët e me elementët e tjerë të ishin edhe në funksion të idesë që po konkretizonte udhëheqja e Partisë, për organizimin e një mbledhjeje ku të viheshin bazat politike të bashkimit të popullit shqiptar në luftë kundër fashizmit. Shokëve në qarqe iu dhanë udhëzime të posaçme që të studionin, të mblidhnin e të na dërgonin të dhëna për ata elementë që mendohej se mund të merrnin pjesë në një mbledhje të tillë.

Te shumë nga këta elementë nuk kishim besim, megjithatë bënim përpjekje me ta, sepse synimi ishte që të organizohej një mbledhje e gjerë, ku të përfaqësoheshin të gjitha shtresat dhe forcat politike që shprehnin gatishmërinë për luftë. Ishte e rëndësishme që organet dhe vendimet që do të dilnin të kishin një bazë sa më të gjerë përfaqësuese e forcë vepruese. Edhe unë, si gjithë shokët, u angazhova direkt në realizimin e detyrës së re e të rëndësishme që morëm përsipër dhe, për këtë qëllim, shkova në Pezë për t'u takuar me babë Myslimin.

Si në të gjitha rastet e tjera, Myslimi u shpreh dakord dhe i gatshëm të merrte pjesë në mbledhjen që propozonte Partia Komuniste. Jo vetëm kaq, por me lidhjet e njohjet e tij, me influencën që kishte në elementë të ndryshëm nacionalistë, na ndihmoi për të zgjeruar më tej lidhjet tona. I kërkova Myslimit dhe ai më dha disa rekomandime për njerëzit që mund të ftonim në mbledhje dhe u tregua i gatshëm që, kur të vendosej përfundimisht kjo çështje, po ta ngarkonim, të bisedonte edhe vetë me

ta. Ndër të parët që u përmendën ishin Haxhi Lleshi e Mustafa Xhani, të cilët prej kohësh ishin shprehur dakord me programin e Partisë, prandaj i kërkova Myslimit të na vinte në lidhje me ta dhe mundësisht t'i sillte paraprakisht në Pezë për t'u takuar.

Nuk kaloj shumë kohë nga kjo bisedë, kur Myslimi më dërgoi fjalë se në Pezë kishte ardhur Haxhi Lleshi. Të nesërmen ose të pasnesërmen u nisa për në Pezë dhe arrita në shtëpinë e Myslimit, ku kishte qëndruar ato ditë Haxhiu.

U përqafova me të dhe me Mustafa Kaçaçin, i cili kishte ardhur në Pezë bashkë me Haxhiun. Haxhiu akoma ishte i ri nga mosha, por jeta dhe hallet e bënin të dukej më i vjetër nga ç'ishte. Vishte një xhakëtë lëkure, ishte i shkurtër nga shtati, por ndihej se kishte një trup të fortë. Më pëlqeu qetësia dhe matura në të folur.

I thashë se më kishin folur Myslimi e shokë të tjerë për aktivitetin e tij në dobi të popullit, si kundër regjimit të Zogut, ashtu edhe kundër pushtuesve italianë. I foli më gjerësisht për programin e Partisë, për organizimin e luftës derisa të arrinim në kryengritjen e përgjithshme të të gjithë popullit shqiptar, për përpjekjet që kishim bërë deri atëherë, për sukseset dhe të metat e punës sonë, i tregova lfiu kishim pasur rezultate e ku jo, i theksova se, sidomos në Veri, Partia dëshironte ta forconte më shumë punën dhe këtë synim të saj ajo do ta mbështeste te populli i Veriut dhe te patriotët e ndershëm të këtyre krahinave. Pastaj, në bisedë e sipër i tregova dhe kërkova edhe opinionin e tij për idenë e organizimit të një mbledhjeje të gjerë të përfaqësuesve të popullit shqiptar.

Haxhiu më dëgjoi i përqendruar, duke iu përgjigjur herë pas here ndonjë pyetjeje që bëja unë në mes të bisedës. Me përgjigjen e tij ai, sikurse e pritja, u shpreh edhe një herë në favor të programit të Partisë për luftë dhe aprovoi mendimin e një konference për bashkëpunimin e popullit shqiptar në këtë luftë.

Duke plotësuar kërkesën që i drejtova ai më bëri, gjithashtu, një tablo të situatës në Dibër, më foli për influencat e ndryshme atje, dhe nënvizoi se, me gjithë veprimtarinë përçarëse të parisë, të bajraktarëve, populli i Dibërës nuk do të vononte të fillonte një luftë të armatosur, të organizuar. Gjykimet dhe informacioni i saktë që më dha Haxhi Lleshi që një ndihmë e madhe për punën tonë. Në mes të tjerash i kërkova Haxhiut të na rekomandonte nga elementët nacionalistë që njihje për t'u vënë në kontakt e për t'u përpjekur t'i futnim edhe ata në luftë.

Haxhi Lleshi më përmendi disa emra e në mënyrë të veçantë më fori për Mustafa Xhanin.

- E njohim Baba Fajën, - i thashë, - shokët tanë kanë biseduar me të dhe gëzohem që edhe ti ke të njëjtin mendim.

- Po Bazi i Canës, o Haxhi? - pyeti babë Myslimi që gjer atëherë kishte ndenjur si mënjane duke ndjekur bisedën tonë.

- Vërtet, - i thashë Haxhiut. - Ne e dimë se Abaz Kupi është një ish-oficer i Zogut dhe me ndjenja zogiste, por thuhet se është nga ata njerëz që do të luftojë.

- Në Pezë, - tha Haxhiu pasi u mendua pak, erdha duke kaluar nga Kruja. E takova Bazin, se kam një lloj miqësie me të; kur hyri Italia, ky qëndroi disa javë në shtëpinë time bashkë me familjen e disa miq të tij. I foli dhe ai m'u shpreh kundër pushtimit të vendit, shau Merlikën, Jakomonin, por, kur e pyeta se ç'mendim kishte për luftë të organizuar, m'u përgjigj

«Është shpejt Haxhi, italianët ka në dorë gurin dhe arrën. Do të na përvëlojë». T'i bie shkurt, - tha Haxhiu, - Bazi nuk m'u duk ta kishte me qejf këtë punë.

Ndenjëm gjatë duke biseduar me Haxhiun dhe me Myslimin dhe, pasi kaluam një natë në Cikallesh, te fshatarët patriotë Arif Xhafa e Qerim Shima, miq të Myslimit, të nesërmen në mëngjes u nisa për në Tiranë. Po atë ditë Haxhiu me Kaçaçin u nisën për në Martanesh, me porosinë tonë, ku do të takoheshin me Baba Fajën për t'i parashtruar idenë e Partisë Komuniste për organizimin e mbledhjes. Baba Faja, mbasi e kishte dëgjuar Haxhiun me vëmendje, kishte ngritur ngadalë postiqen e vet, i kishte treguar armën e i kishte thënë:

- Nuk i keni rrëmbyer vetëm ju pushkët, për të luftuar të huajin që na ka zaptuar vendin, por edhe unë nuk e duroj dot zgjedhjen që na e solli Zogu, duke ia shitur Italisë vendin tonë. Më keni me vete mua dhe tërë Martaneshin.

Rasti i Baba Fajës, i këtij kleriku patriot, nuk do të ishte i vetmi. Më pas pati edhe të tjerë klerikë, të cilët me shpirt e zemër, edhe me armë, u bashkuan me Luftën Nacionalçlirimtare. Veprimet e Mustafa Xhanit patën një rëndësi të madhe propagandistike në popull, se i tregonte atij se bindjet fetare janë tjetër gjë, kurse të qenët patriot shqiptar është gjë tjetër. «Pavarësisht se je mysliman, ortodoks apo katolik, detyra e parë jotja është lufta për lirinë e Shqipërisë». Këtë u thoshte me luftën e vet Baba Faja të gjithë shqiptarëve. E kjo ishte plotësisht në përputhje me vijën e Partisë sonë Komuniste për bashkimin e mbarë popullit shqiptar në luftën për Tiri.

Ndërsa shokët anembanë vendit, në bazë të orientimeve e udhëzimeve që u kishim dërguar, vazhdonin punën duke studiuar gjithçka me thellësi e gjakftohtësi komuniste, udhëheqja e Partisë vendosi që në një mbledhje të posaçme të saj të analizonte rezultatet e arritura dhe të përcaktonte detyrat e masat konkrete për organizimin e Konferencës Kombëtare të përfaqësuesve të popullit shqiptar. Kjo u bë në ditët e para të korrikut 1942, pikërisht në atë mbledhje të Komitetit Qendror Provizor të PKSH, ku u morën edhe një sërë vendimesh të rëndësishme për likuidimin e punës armiqësore e fraksioniste të Anastas Lulës e të Sadik Premtes.* *(Shih më gjerësisht: Enver Hoxha. «Kur lindi Partia (Ku,jtime)», botim i tretë, f. 317.) Në këtë mbledhje, pra, ne shtruan idenë e rrahëm mendime edhe për organizimin e një Konference Kombëtare që do të vendoste zyrtarisht për bashkimin e popullit shqiptar në një organizatë lufta rake, e cila do të ishte Fronti Nacionalçlirimtar. Për këtë, shokëve që ishin në mbledhje, mbi bazën e një konspekti në formë pikash, u bëra një parashtrim mbi përcaktimin e platformës politike, me të cilën Partia Komuniste e Shqipërisë do të shkonte në Konferencë si iniciatore e saj, mbi domosdoshmërinë e një programi të peshuar me kujdes dhe tepër të saktë, si dhe për masat që duhej të merrnim që Konferenca të zhvillohej normalisht.

- Duhet të kemi parasysh dy gjëra, - u theksova shokëve, - e para: platformën, programin tonë, ne do t'ia paraqesim Konferencës, por në fakt ia paraqesim popullit dhe ai do ta aprovojë; s'na prishet puna se do t'u vijë thartë dy-tre vetave. Së dyti, - vazhdova, - atyre që mund të pyesin për çështjen e regjimit të ardhshëm në Shqipëri, do t'u themi se atë do ta vendosë vetë populli pas Çlirimit, me zgjedhje të rregullta demokratike. Gjithashtu, - theksova, - ne duhet të vemë në Konferencë si Parti dhe jo si individë, me një delegacion që do ta caktojmë bashkërisht, kurse të tjerët do të jenë nacionalistë që luftojnë aktualisht ose mendohet se do të luftojnë në të ardhmen. Në Konferencë duhet të vijnë, gjithashtu, edhe përfaqësues të Rinisë Komuniste dhe të Grave Antifashiste.

Pas meje diskutuan të gjithë shokët dhe në vija të përgjithshme u pranua platforma e Konferencës, u vendos të mbahej një referat kryesor, të cilin u ngarkova ta hartoja unë, si dhe dy nënreferate, njëri për rininë dhe tjetri për gruan. Për sa i përket pjesëmarrjes në Konferencë ramë dakord në parim për kriteret dhe u caktua një grup shokësh që do të përgatiste listat e të ftuarve.

Në këtë mbledhje u diskutua, gjithashtu, edhe për vendin ku do të mbahej Konferenca. Kisha menduar edhe më parë për këtë çështje dhe, së bashku me disa shokë, kishim arritur në mendimin që Konferencën ta bënim në Pezë të Madhe. E bëra këtë propozim në këtë mbledhje të Komitetit Qendror duke u mbështetur në disa argumente.

- Mbajtja e një mbledhjeje të tillë në Pezë, fare pranë Tiranës, - theksova në mes të tjerash, - do të jetë një sfidë e fortë ndaj okupatorëve dhe Merlikës. Duke e zhvilluar këtë eveniment në Pezë, do t'u themi atyre: KJa, nën hundën tuaj, ne organizuam një konferencë të të gjithë popullit, për të kuvenduar rreth kryengritjes së armatosur». Kështu do t'i tregojmë armikut pushtues e tradhtarëve forcën politike, organizative dhe ushtarake të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kjo do ta tmerrojë e do ta tërbojë armikun, kurse popullit do t'i japë guxim e besim.

Ky ishte aspekti politik i çështjes; për sa i përket anës tjetër: sigurimit të pjesëmarrësve dhe zhvillimit pa incidente të Konferencës, edhe në këtë drejtim Peza i plotësonte të gjitha kushtet. Peza ishte vendlindja dhe fusha e luftës e babë Myslimit. Atje, në Pezë të Madhe, forcat luftarake partizane, të përbëra nga komunistë e patriotë fshatarë, si dhe e gjithë krahina e Pezës, e cila kishte hyrë në luftë të armatosur kundër pushtuesve, do të siguronin qetësinë që i nevojitej mbledhjes për të zhvilluar punimet dhe për të marrë vendimet historike.

Shokët ranë dakord qe u vendos që mbledhja të mbahej në Pezë të Madhe, kurse çështja e kohës, në mos gaboju, u la për nga mesi i gushtit.

Menjëherë pas kësaj iu futëm punës për përgatitjen dhe organizimin e Kozlferencës. Ishim të ndërgjegjshëm se Konferenca për të cilën punonim do të ishte një ngjarje e madhe me rëndësi historike, një nga konkretizimet e vijës marksiste-leniniste të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Reperkusionet e saj do të ishin të pallogaritshme.

Qysh në mbledhjen e korrikut kishim vendosur që njerëzve patriotë dhe «nacionalistëve» do t'u merrnim pëlqimin nëse pranonin të ishin pjesëmarrës në Konferencë e do t'u parashtrhnim në vija të përgjithshme qëllimin e saj, për t'u dhënë mundësi të përgatiteshin për të folur, por nuk do tu tregonim as ditën, as vendin, për arsye konspiraci:ni. Mbledhja duhej të ishte e gjerë, por kjo duhet kizptuar jo në sensin numerik, por në shkallën e përfaqësimit, sepse edhe për arsye konspiracioni një mbledtje me 50 apo 100 veta nuk do të ishte e përshtatshme. Rëndësi kishte që pjesëmarrësit të ishin njerëz ,ne peshë e influencë në popull, patriotë dhe të përfkqësonin vendin nga Veriu në Jug. Emrat e disa prej patriotëve të shquar, si: Myslim Peza, Haxhi Lleshi e Mustafa Xhani ishin shënuar prej kohësh në listë dhe bri emrit të tyre nuk kishte asnjë pikëpyetje për qëndrimin e tyre ndaj Luftës Nacionalçlirimtare dhe Partisë Komuniste. Për të tjerët diskutonim vazhdimi--ht.

- Abaz Kupi duhet të ftohet patjetër, - më thotë një ditë Mustafa Gjinishi.

- Pse patjetër? - t pyeta më tepër për t'ia ftohur pak entuziazmin, sepse në fakt kishim vendosur t'i bënim ftesë Bazit.

- Është patriot i madh, - e zbuti tonin Mustafai. - Ai ka luftuar në Durrës më 7 prill.

- Që ka qenë në Durrës, - iu përgjigja, - e di. Mbase edhe ka luftuar. Po a luftoi për Shqipërinë, apo për Zogun, këtë nuk e di. Di gjithashtu, - i thashë, - se qysh se është kthyer, Bazi jo vetëm nuk lufton, por, për çudi, edhe italianët nuk e ngasin. Di gjë ti për këtë?

- Ka influencë në Krujë dhe Merlika ia ka frikën, - u përgjigj Mustafai.

- Koha do ta tregojë, - iu përgjigja dhe ula kokën mbi materialin që kisha përpara, duke i lënë të kuptojë se isha i zënë.

Mustafai u nis të dalë, por, kur iu afrua derës, i fola:

- Dëgjo Mustafa, si mendon ti, po t'i bënim ftesë Abaz Kupit, a do të vinte në Konferencë?

Gjinishi u gjallërua menjëherë dhe u afrua te tavolina ku po punoja.

- Ma lër mua në dorë këtë punë, shoku Taras!

- Mirë, - i thashë, - ti bisedoje një herë me Bazin, por nga ana jote, pa i treguar gjë konkrete. Dhe, kujdes, - e porosita, - të mos mendojë Bazi se ne i lutemi të vijë. Në dashtë të vijë, mirë, në mos dashtë, udha e mbarë.

- Të siguroj që do të vijë! - Me këto fjalë u largua Mustafa Gjinishi e, me siguri, siç u qartësua më vonë, vajti të koordinonte punët me rezidentin tjetër të Intelixhens Servisit, Abaz Kupin. Ndërkohë ne kishim bërë sondazhet dhe e dinim që Bazi dhe elementë të tjerë prozogistë ishin shprehur se do të vinin.

Pikërisht, në valën e këtyre përgatitjeve, shokët e Vlorës na propozuan të ftonim në Tiranë Skënder Muçon dhe të bisedonim me të. Skënder i luços ia kisha dëgjuar emrin, por personalisht nuk e njihja. Në rrethet intelektuale të Tiranës kisha dëgjuar të flitej mirë për të, thuhej se ishte avokat i zoti dhe i bëhej reklamë si njeri i mësuar, erudit, i zgjuar dhe jo i korruptuar. Në Tiranë, në Vlorë e gjetkë i kishte dalë nami se ishte demokrat dhe shokët e Vlorës na e rekomandonin si një element me perspektivë. Ai duhej të ishte disa vjet më i rradh nga unë, kishte mbaruar studimet për drejtësi në Itali. Nuk ishte nga ata që tregoheshin antizogistë të hapur, por edhe të afishohej pro regjimit nuk e bënte. Ishte, si me thënë, një konformist «me zor» dhe flitej se pikërisht për këtë arsye kishte preferuar të bëhej më mirë avokat sesa gjykatës dhe të ishte «i lirë dhe i paangazhuar».

Duke i ditur të gjitha këto si dhe informatat e veçanta që na dërguan Hysni Kapoja dhe shokë të derë të Vlorës, ne e pranuan, pra, propozimin për t'u tatuuar me të dhe i lajmëruam shokët që ai të nisej për në Tiranë. Skënder Muçon e shoqëronte «Mentori»* *(Pseudonimi i Ibrahim Dervishit.) një nga shokët më aktivë në qarkun e Vlorës.

Në kohën e caktuar Skënder Muçoja, i shoqëruar nga Mentori, u paraqit në bazë. Kishim zgjedhur, më duket, shtëpinë e një miku patriot legal, me qëllim që edhe ta impresiononim ca këtë avokat të

borgjezisë, edhe t'i jepnim mundësi ta shihte realitetin ashtu siç ishte, të bindej se ne kishim lidhje të forta edhe me patriotë të tjerë të njohur dhe se nuk kishim frikë nga raprezaljet e pushtuesit.

U takuam, shkëmbyem përshëndetjet e pyetjet e rastit dhe, kur pashë që Skënderi po priste të filloja unë, i fola:

- Zoti Skënder, as ju dhe as ne nuk kemi kohë për të humbur, prandaj mendoj që në fillim të parashtrij unë pikëpamjet e Partisë Komuniste për situatën dhe ç'duhet bërë në të ardhmen. Pastaj unë, si përfaqësues i saj, do të dëshiroja të dëgjoja mendimin tuaj.

- Dakord, - m'u përgjigj Skënder Muçoja.

Atëherë e mora fjalën dhe i bëra një përmbledhje të gjendjes politike dhe të luftës, i vura në dukje barbarizmat dhe natyrën agresive të fashistëve gjermanë e italianë, pastaj hyra në gjendjen tonë të brendshme dhe parashtrova gjerësisht se si e gjykonim ne këtë.

- Mendimi ynë është, dhe këtë ne kemi filluar ta vëmë në zbatim, - i thashë në konkluzion të kësaj çështjeje, - se duhet të ngrihemi të gjithë në luftë kundër pushtuesit, të përsëritim epopenë e Vlorës të 1920-ës dhe të të gjitha luftërave heroike që tra bërë shqiptari kundër pushtuesve të ndryshëm, që nga koha e Skënderbeut.

- Por, zoti Hoxha, - ndërhyri papritur Skënder Muçoja, - më lejoni t'ju kujtoj se Italia e sotme nuk është më ajo e 1920-ës. Tani. . .

- E di ç'doni të thoni, - e ndërpreva, - por ne nuk duhet të frikësohemi nga forca e Italisë fashiste. Po të studiojmë historinë e luftërave të popullit tonë, do të shohim se në të gjitha kohët armiqët tanë kanë qenë shumë më të mëdhenj, më të fuqishëm, dhe fortë armatosur, por populli ynë i vogël asnjëherë nuk është trembur. Ky është një fakt historik. Ai tra ngritur krye, tra luftuar dhe tra fituar në betejat kundër tyre, pra, ndonëse i vogël, i tra mposhtur, ashtu sikurse Davidi luftoi dhe e mposhti Goliatin. Dhe të mosharrojmë, zoti Skënder, se në të kaluarën në luftërat tona kemi qenë kurdoherë vetëm kundër armiqve.

Asnjë shtet nuk na tra përkrahur jo vetëm materialisht, por as politikisht dhe as moralisht. Do të gjejmë në histori vetëm disa shkrimtarë ose poetë që më vonë të bënin ndonjë shkrim ose poezi për trimëritë e Skënderbeut dhe të shqiptarëve dhe për rolin e tyre të madh në mbrojtjen e qytetërimit perëndimor nga invadimi i osmanllinjve. Kurse aktualisht, - vazhdova,

- puna qëndron ndryshe: E gjithë bota demokratike, të gjitha shtetet përparimtare, Bashkimi Sovjetik, në radhë të parë, po edhe Anglia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. janë ngritur në luftë kundër bishës së egër nazifashiste gjermano-italiane. Pra, në këtë luftë ne nuk jemi vetëm si më parë. Por ne duhet të mendojmë si të organizohemi se, siç thotë populli, «po nuk qau foshnja, nuk i jep sisë nëna»; po nuk u organizuam për luftë dhe të ngrihemi të luftojmë, nuk mund të fitohet as uria, as pavarësia dhe as sovraniteti i atdheut.

Kështu tra gjykuar Partia jonë Komuniste dhe prej kohësh po punojmë të grumbullojmë popullin tonë në një unitet luftarak, po i sqarojmë atij qëllimet e luftës, po e bindim se vetëm nëpërmjet kësaj do të çlirohet atdheu e do të realizohen dëshirat dhe aspiratat e tij.

Siç ju kanë thënë edhe shokët tanë në Vlorë, ne po punojmë për bashkimin e popullit në një organizatë antifashiste dhe jemi përpjekur e po përpiqemi që me

këtë platformë të Partisë Komuniste të Shqipërisë të bashkohen edhe gjithë patriotët e ndershëm, kudo që janë, pa marrë parasysh krahinat, besimet fetare ose botëkuptimet politike. Nga ky Front duhet të përjashtojmë fashistët shqiptarë dhe tradhtarët. Ky do të jetë një Front lufte, një bashkim i madh i tërë popullit për ta hedhur fashizmin në det. Ju këto besoj i kuptoni mirë, zoti Muço, se jeni me origjinë nga Vlora heroike.

- I kuptoj, - më tha avokati, - vetëm se për të bërë këtë luftë, që thoni ju, duhen armë. Ku do t'i gjejmë armët?

- Shumë na e kanë bërë këtë pyetje, - iu përgjigja, - por të mos harrojmë se as baballarët, as gjyshërit tanë dhe as ne nuk kemi pasur e nuk kemi fabrika armësh, por armë kemi pasur dhe do të kemi. Do ta nisim me ata dyfekë të vjetër që kemi, pastaj armët do t'ia marrim armikut duke luftuar, duke e vrarë, dulce i sulmuar depot.

- Ja pse, zoti Skënder, - vazhdova, - ne e shikojmë situatën të favorshme dhe optimiste për luftën. Atdheu është i të gjithëve, prandaj duhet ta mbrojmë të gjithë dhe të luftojmë të gjithë për çlirimin e tij. Çështja e çlirimit, mendojmë ne, nuk është monopol vetëm i Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe i anëtarëve të saj, por detyrë e të gjithë popullit. Prandaj Partia jonë dhe anëtarët e saj po takohen e po bisedojnë hapur me një numër patriotësh demokratë dhe antifashistë në të gjitha anët e vendit, për të organizuar një mbledhje, natyrisht, në fshehtësi të madhe nga armiku, të cilën mund ta quajmë kuvend a konferencë, ku do të bisedojmë si vëllezër, si shokë të një çështjeje të madhe, siç është çështja e luftës kundër pushtuesit për çlirimin e atdheut. Të bisedojmë në këtë Konferencë dhe të vendosim të luftojmë së bashku, të rrahim mendimet si të luftojmë me armë, me politikë, me penë, si ta organizojmë dhe si ta drejtojmë këtë luftë, ç'organe ushtarake dhe politike duhet të krijojmë që t'ia arrijmë suksesit të madh të çlirimit. Partia jonë, siç ju thashë më lart, tra një varg idesh, por në vija të përgjithshme ato që ju thashë përbëjnë esencën dhe bazën kryesore të këtyre ideve. Unë jua parashtrova që të shkëmbejmë mendime në parim për ta realizuar këtë mbledhje historike. Sigurisht ju do të shfaqni edhe mendimin tuaj dhe unë do t'ju dëgjoj me kujdesin dhe me dashamirësinë më të madhe.

Skënder Muçoja dëgjoji me vëmendje ekspozenë time, unë e falënderova për këtë dhe, dulce përfunduar, i thashë:

- Kemi bindjen se ju, si patriot dhe demokrat, do të jeni në parim pro për këtë mbledhje dhe shpresojmë se do të vini autoritetin tuaj në balancën e kësaj vepre të shenjtë. Tani po jua lë juve fjalën, për të shprehur mendimin që treni për këto që ju parashtrova.

Skënder Muçoja e filloi dhe e mbaroi bisedën e tij si avokat që ishte, me një logjikë gjoja të shkëlqyer, por që nuk shkëlqente aspak. Ishte në emfazë, kalonte në bisedë të qetë, afirmonte, rikthehej me metafora, përdorte frazeologjinë e simboleve, diskutonte duke pyetur, pa vënë pyetje direkte, tërhiqej me marifet nga ato që thoshte pak më parë, për të mos u komprometuar në ndonjë vendim të përcaktuar. Dulce biseduar me të, e kuptova që të vetmet «argumente» që mbështetnin namin e tij si «njeri i zgjuar dhe i zoti» ishin dredhitë, inkoherenca né gjykime, avancimet e tërheqjet pa parim. «Zotësia» dhe «zgjuarsia» e tij ishin fiktive, ishin cilësi të një avokati, i cili, me dinakëri dhe retorikë boshe, mbronte fajtorët përpara një trupi gjykues borgjez, që s'përfaqësonte tjetër veçse një borgjezi me hajdutë e me kriminelë, nga gjiri i të cilëve dilnin ata fajtorë që mbronte Skënder Muçoja. Edhe né bisedën me mua, me fjalë të zgjedhura e të limuara, ai u përpoq të shkëlqente, por retorika dhe fjalët e tij nuk mund as të na bindnin, as të na impresiononin ne që kishim logjikën marksiste-leniniste.

Né esencë biseda e tij ishte kjo: Pranoi gjendjen e vështirë të vendit dhe dënoi pushtuesin fashist, u hoq si demokrat antifashist, por nuk mungoi të më bënte një tiradë të gjatë, megjithëse nuk ishte as vendi, as momenti për të më mbushur mendjen se populli italian ishte «i talentuar, i mirë, punëtor e demokrat» dhe se ky nuk duhej konfunduar me fashistët italianë (!). Unë i ndërhyra, duke i thënë:

- Ne na ka pushtuar Italia fashiste dhe këtu kemi né zverk armata të tëra që duhet t'i luftojmë. Ç'është populli italian né parim, ajo është tjetër punë, por aktualisht Musolini e ka hedhur né luftë kundër nesh, prandaj ne duhet të luftojmë.

- Né përgjithësi jam dakord, - pretendoi Skënder Muçoja, - por nuk mund të jem plotësisht me argumentet tuaja që Gjermania dhe Italia do të thyhen aq kollaj. Shihni si i kanë vënë përpara edhe Bashkimin Sovjetik, edhe Anglinë, Francën etj. Shtetet e Bashkuara të Amerikës akoma nuk angazhohen si duhet, prandaj duhet të mendohemi mirë pa të hedhim çapin dhe Vi shtrijmë këmbët sa kemi jorganin.

- Nuk mund ta pranoj këtë vlerësim që i bëni ju situatës, - i thashë. - Është e vërtetë që vendet e Boshtit kanë një supremaci të përkohshme, por të mos harrojmë se «blic krugu» i Hitlerit dështoi dhe armatat e tij po angazhohen né një luftë të gjatë e të vështirë. Faktori kohë punon për aleatët. Pastaj,

prapavijat e pushtuesve, këtu flas edhe për Shqipërinë, po bëhen e do të bëhen akoma më të shqetësuara. Unë jam i sigurt që koalicioni antifashist i popujve do të fitojë.

Skënder Muçoja më dëgjonte me buzëqeshjen e një njeriu që «i di mirë këto punë».

- Zoti Hoxha, - më tha, - ju e dini se jam demokrat dhe si i tillë unë uroj fitoren e Anglisë dhe të Amerikës, shtoj edhe të Rusisë, por ne duhet, mendoj unë, të presim akoma dhe të evitojmë goditjet shkatërrimtare, duhet të presim që aleatët tanë të konsolidojnë frontet dhe të kundërsulmojnë me fitore. pastaj të futemi edhe ne në valle.

- Mirë, zoti Skënder, - i them, - por edhe nga pikëpamja e solidaritetit me aleatët nuk është e drejtë që ne të mos luftojmë, kur ata luftojnë. Ju kërkoni stabilizimin e frontit nga aleatët dhe, nga ana tjetër, kërkoni që prapavijat e fashistëve të jenë të qeta. Kjo nuk është logjike. Ca më keq nga ana kombëtare. Ne e kemi armikun në vatër, na shtyp, na g jakos dhe ne të mos luftojmë e të mos mbrohem? Skënderbeu iku nga Anadoli, u kthye në atdhe dhe filloi luftën kundër turqve, kurse ne, duke qenë brenda në at dheun tonë, të mos luftojmë? Ky do të ishte një gabim tragjik e i pafalshëm.

Skënder Muçoja ndërhyri:

- Mos më keqkuptoni, unë dua të luftoj, por jemi të paorganizuar.

- Thirrja jonë është pikërisht që të organizohemi dhe, që të organizohemi, duhet të mblidhemi, të diskutojmë e të vendosim. Këtë propozojmë ne.

- Por në atë mbledhje që propozoni, - tha Skënder Muçoja, - nuk do të vemi të barabartë, ju do të vini si Parti, ne do të vijmë si persona.

- Ka parti tjetër në vend, zoti Skënder? - e pyeta dhe ia mbërtheva sytë.

- Jo, s'ka, - mërmëriti avokati.

- Atëherë, jemi të detyruar t'u bëjmë thirrje personave. Ne dimë se personat, të cilëve u drejtohem, kanë influencë në njerëzit e tjerë dhe kjo na gëzon, siç duhet t'ju gëzojë edhe ju ekzistenca e Partisë sonë.

- Ashtu është, - tha Skënder Muçoja, - por ne nuk mund të jemi dakord me programin e Partisë suaj, ju jeni për vendosjen e sovjetëve.

- Gaboheni, - i thashë, - Partia jonë ka programin e vet, ku flitet qartë për qëllimet e saj. Atje nuk flitet se ne do të vendosim sovjetët si në Bashkimin Sovjetik; ne kemi deklaruar dhe e deklarojmë se çështjen e pushtetit do ta zgjidhë e do ta vendosë vetë populli, kur të çlirohet. Në fakt, zoti Skënder, unë mund t'ju them se elementë zogistë kanë pranuar të vijnë në mbledhje, prandaj ajo që thoni ju nuk është një arsye e shëndoshë që ta refuzoni ardhjen.

- Të më kuptoni, zoti Hoxha, unë nuk e kam thënë fjalën akoma, vij apo nuk vij, por disa sqarime dhe pyetje po bëj.

- Jo, - i thashë, - nuk jam aspak kundër pyetjeve dhe sqarimeve.

- Ja, për shembull, - vazhdoi Skënder Muçoja, - pse ju komunistët vini në kapela yllin dhe jo shqiponjën, pse në krye të shqiponjës në flamur i vini një yll të kuq? Zogu, më falni, - tha Skënderi, - kishte vënë kurorën, Italia shqiponjës i vuri dy sëpatat, ju i vini yll të kuq?

- Zoti Skënder Mugo, - i them, - ne komunistët kemi luftuar, jemi vrarë e burgosur nga Zogu, prandaj e urrejmë atë dhe kurorën që ai i kishte vënë flamurit dhe shqiponjës. Askush nuk mund ta errësojë luftën e ashpër që Partia jonë i bën Italisë fashiste dhe fashiove të Liktorit.

Ylli ynë është ylli i lirisë, i asaj lirie që fitohet me gjak duke luftuar, është simboli i një bote të re, i një Shqipërie demokratike. Ylli i kuq është shenja dalluese e partizanëve që luftojnë me të në ballë dhe me flamurin e Shqipërisë në dorë, me yllin e kuq mbi shqiponjën. Populli ynë, kur flet për një trim që do ta përcaktojë si të tillë, i vë epitetin shqiponjë, trim me yll në ballë. Kjo është një e drejtë jona dhe nuk duhet të jetë një pengesë për të ardhur në mbledhje. Atje edhe këtë çështje mund ta ngrini, jeni të lirë dhe si jurist ju duhet të dini se Mbledhja Kushtetuese, që duhet të mblidhet kur të çlirohet vendi, do të caktojë edhe formën e regjimit, edhe flamurin dhe ajo do të vendosë nëse do të ketë flamuri yll apo jo.

- Jam i qartë, - tha Skënder Muçoja. - Ju falënderoj për ekspozenë dhe ftesën që më bëtë, unë nuk mund t'ju jap dot aprovimin që tash, se më luhet të kthehem në Vlorë, të konsultohem me shokë dhe do t'ju përgjigjem.

- Besoj, - i thashë, - se brenda dhjet; ditëve do të kemi një përgjigje pozitive.

- Oh, brenda dhjetë ditëve, patjetër.

Kështu u ndamë me Skënder Muçon. Ngx biseda që pata, dhe këtë ua thashë dhe shokëve, krijova bindjen . se populli dhe Lufta Nacionalçlirimtare nuk mund të prisnin gjë të mirë prej tij. Ai ishte një borgjez intelektual që, nga brenda, në shpirt, qe mbrujtur me tiparet .e asaj borgjezie që gjykonte dhe të atyre fajtorëve që mbronte, por mbante dhe ruante një maskë prej demokraci dhe, meqë me zanatin e tij siguronte të ardhura, afërshohej si një njeri i profesioneve të lira, i pavarur nga çdo pushtet, me një «pavarësi në mendime» që u përpoq ta tregonte edhe me mua.

Më vonë, Skënder Muçoja «demokrat», i vuri pushkën partisë dhe popullit, por ne iu përgjigjëm me pushkë këtij tradhtari.

Pikërisht në këtë kohë, shokët më ngarkuan t'u propozoja të merrnin pjesë në Konferencë edhe Bahriut e grupit të tij.

-- 1Kam biseduar shumë me Bahri Omarin dhe me tarafin e tij, - iu përgjigja shokëve, - dhe jam i bindur se të gjithë ata e kanë zgjedhur tashmë rrugën e tyre.

- Të provojmë edhe një herë, Enver, - më thanë, - dhe ti mund ta bësh më mirë këtë.

- Nleqenëse po ma ngarkoni këtë detyrë, - u thashë, - po e pranoj.

Shkova, e takova dhe i thashë se «ne mendojmë që duhet të shkëmbejmë mendime me njëri-tjetrin, se duhet të sheshojmë mosmarrëveshjet dhe të arrijmë në interes të atdheut, në ndonjë mbledhje të përbashkët kundër armikut pushtues, ashtu siç kanë vepruar edhe patriotët e vendit tonë në të kaluarën» etj. Bahriu, ashtu siç prisja, nuk pranoi një propozim të tillë. Unë nuk ia zgjata më.

U tregova shokëve për rezultatin e takimit me Bahriun dhe vendosëm të çanim nga ana e Kolë Tromarës dhe e Sheh Karbunarës. Me gjithë dyshimin që kisha për suksesin edhe të këtij «misioni», e mora përsipër edhe këtë barrë. Vendosa të lidhesha me Shehun, me të cilin mbaja marrëdhënie «të mira», sepse me Kolë Tromarën, që nuk e honepsja dot, e dija që nuk mund të bisedohej.

Sheh Karbunara nuk ishte në Tiranë. Ai qëndronte në rezidencën e vet fetare në Lushnjë, prandaj mendova të vihesha në kontakt me të nëpërmjet djalit të tij Hysenit, me të cilin kisha njohje, sepse ishte .baxhanak me Syrja Selfon. Marrëdhëniet e mia me të qenë të mira dhe tek ai kisha qenë edhe më parë, por edhe më pas, kur isha hedhur në ilegalitet, sepse Hyseni në atë kohë hiqej se ishte me ne. Po kështu, edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ai hiqej si simpatizanti i luftës, por pas Çlirimit filloi të lëvizte bishtin dhe u përzie me armiqtë e popullit, si me Shefqet Bejën e të tjerë.

I shkoj Hysenit në shtëpi dhe i them:

- Dëgjo Hysen, do të vesh në Lushnjë te baba Shehu dhe do t'i thuash: «Enveri kërkon një takim me ty dhe me Kolë Tromarën dhe, po të dëshirojnë ata, edhe me Sejfi Vllamasin».

Hyseni hapi sytë, megjithatë pranoi ta kryente porosinë. Siç dukej, digjej të merrte vesh edhe vetë ndonjë gjë, prandaj më pyeti:

- Po të më pyesë Shehu se për ç'takim është fjala, ç't'i them?

- I thuaj, - iu përgjigja, - se Enveri ka diçka me rëndësi për të biseduar me ju. Vetëm kaq.

E dija se Shehu do të bëhej kurioz dhe do ta pranonte takimin. «Qorri», kështu e thërritnim Hysenin, se kishte një sy të dëmtuar, u nis për në Lushnjë.

Pas disa ditësh, më erdhi lajmi në bazën ilegale ku rrija se Hyseni kërkonte të takohej me mua. Shkoj një natë në befasi në shtëpinë e tij dhe ai më thotë se Shehu pranonte në parim të takohej, por kur të vinte në Tiranë do të bisedonte me shokët e tij dhe do të më lajmëronte.

Më në fund erdhi lajmi se Sheh Karbunara, Kolë Tromara dhe Sejfi Vllamasi pranonin takimin dhe këtë takim do ta bënim te shtëpia e Kolë Kuqalit, mikut tonë të përbashkët. Rashë dakord. Në datën dhe në orën e caktuar vajta. Gjykatë Kuqali ishte shoku ynë, kurse babai i tij, Kola, po ashtu ishte simpatizanti ynë. Kur hyra në dhomë, i gjeta që të tre, se kishin vajtur më parë.

- Të largohem unë? - pyeti Kolë Kuqali.

- Jo, - i them unë, - ti nuk je i tepërt për mua, vetëm po të mos duan miqtë.

- Bah, - u hodh Kolë Tromara, - ju mbaheni nga degët, kurse trangu është yni, - duke bërë aluzion për Gjykatën dhe për Kolën. - Ne, - vazhdoi Kolë Tromara, - jemi miq me Kuqalët që në Amerikë, jemi nga ata të «Vatër».

- Sa mirë që Kuqali është mik edhe juaji edhe yni, - i them Kolës, - dhe unë mendoj se më i fituari është ai që ka me vete edhe trungun, edhe degët.

- E, - tha Kolë Tromara, - ç'do të na thuash shoku kuqalash që na mblodhe?

Atëherë fillova t'u flisja për nevojën e luftës kundër pushtuesve e kuislingëve, për nevojën e një takimi të përbashkët, ku të shfaqim lirisht mendimet mbi organizimin e kësaj lufte etj., etj.

Pasi mbarova unë, e mori fjalën Kolë Tromara dhe më zhvilloi një «leksion» ku spikatnin po ato mendime që i njihja nga Bahriu e nga të tjerë, por më me fodullëk, më me arrogancë, bile nuk mungonte edhe forma fy ese, me shprehje si «ju njoh mirë unë ju kuqalashët», «kam pasë të bëj me ju», «ju dëgjoni Stalinit» etj.

I ndërhyra dhe i thashë:

- Zoti Tromara, këtu nuk kam ardhur të diskutoj çështje ideologjike, unë nuk zura në gojë pikëpamjet tuaja politike, pse kam edhe unë të them boll për ju.

- Fol, - tha Kola, - ne ballin e kemi të hapët.

- Kurse ne, - i thashë, - e kemi edhe të hapët, edhe të pastër e pa njolla, por unë kam dashur të piqem me ju, jo për t'u grindur, se, po të doni, edhe atë jam gati ta bëj, por kam ardhur të merremi vesh, të lëmë mënjane mosmarrëveshjet për hir të çështjes së madhe të çlirimit.

- Po kush mendoni ju se do ta çlirojë këtë atdhe dhe si do ta çlirojë? - pyeti ai.

- Populli, - i them, - dhe ne të gjithë bashkë me të, me luftë dhe pa kompromis.

- Ha! Ha! Ha! - qeshi me ironi Kolë Tromara, - pa kompromis! Po ajo që bëri Stalini me Hitlerin ç'ishte, zoti kuqalash?

Tromara e kishte fjalën për Traktatin e mossulmimit që kishte përfunduar më 1939 Qeveria Sovjetike me Gjermaninë, pasi ishin refuzuar të gjitha propozimet që u kishte bërë ajo Anglisë e Francës, për të përballuar së toku rrezikun nazist. Ky veprim i mençur i Stalinit, që ua dogji kartat në duar atyre që donin të bënin sehir shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik nga Gjermania hitleriane, i tërboi reaksionarët, të cilët filluan të shpifin, dhe jehonën e këtyre shpifjeve e dëgjojmë edhe në ditët tona, se gjoja Stalini bëri kompromis me Hitlerin, se Bashkimi Sovjetik ndau zonat e influencës me Gjermaninë e të tjera, e të tjera si këto.

- Stalini, - i them, - i nderi dorën Çembërlenit dhe Daladiesë suaj, mikut të idhullit tuaj, Heriosë, dhe ata jo vetëm që ia refuzuan dorën, por u përpoqën dhe ndërsyen Hitlerin kundër Bashkimit Sovjetik.

- Ohu, - tha Kola, - sa herë i kam lexuar unë këto dëngla nga Moris Torezi në Paris!

- Zoti Kolë Tromara, - iu përgjigja, duke u përpjekur të ruaja qetësinë, - më bëre një pyetje, t'u përgjigja. S'është faji im që ti nuk e njihke mirë historinë, ndonëse të afërt. Më mirë të kthehem atje ku e zumë bisedën. Unë të thashë se luftën do ta bëjë populli dhe ne tok me të. Ti ç'thua për këtë? Më duket se këto mënyra që përdor për ta ndërruar thelbin e bisedës e për t'u hedhur degë më degë jo vetëm nuk janë të mira, por tregojnë se ti nuk do t'i përgjigjesh pyetjes sime. Do të luftojmë apo jo kundër Italisë fashiste, të cilën bashkë rae aleaten e saj, Gjermaninë naziste, i lufton gjithë bota?

Kolë Tromara turfulloi e s'bëri zë. Kur pa që Kola mbeti keq, hyri në bisedë Sheh Karbunara.

- Do të luftojmë, - tha Shehu. - Derisa inglizi lufton, edhe ne do të luftojmë.

- Atëherë, - u them, - gjëja kryesore na bashkon dhe kjo është kryesorja.

Kërceu Kolë noprani dhe tha:

- Pse, me pesë rupe në xhep do të vemë në luftë? Ku i keni armët?

- Ç'thotë kështu zoti Kolë, o baba Sheh, - i drejtohem këtij, - ky as në parim më duket se nuk do që të luftojë.

Mendoja ta futja një «pykë» në mes Kolës dhe Shehut. Por kjo nuk pati sukses, pse Shehu, duke kruajtur mjekrën, tha:

- Po, ajo që tha KOLA është e vërtetë. Ku i kemi armët ne? Italia i ka plot depot.

- T'ia marrim Italisë dhe, që t'ia marrim, duhet të guxojmë të luftojmë, - iu përgjigja. - Zoti Kolë, - i them, - ju i dini fjalët e Dantonit «Guxim, guxim dhe prapë guxim».

- Ne, - tha Kola, - jemi kartezyanë dhe mbi gjithçka vëmë arsyen, logjikën.

- Më duket se karteziianë jeni vetëm me fjalë se, po të kishit njëfarë arsye dhe ta analizonit gjendjen, të paktën siç bënte Dekarti, bisedimet tona do të kishin njëfarë rezultati. Të paktën spastroje tryezën, zoti Kolë, - i them, - nëse je racionalist, siç pretendon, mos e ngarko siç po bën dhe tregohu të paktën nacionalist.

Por Kola e kishte lëshuar fjalën «karteziian» vetëm për të impresionuar Shehun dhe Sejfiun, që as ia kishin dëgjuar ndonjëherë emrin Dekartit. Kërceu Sejfi Vllamasi dhe përsëriti avazin e vjetër të «baballarëve» pseudopatriotë:

- Mirë, mor Enver, por a keni menduar se të luftosh, do të thotë të vritet populli, të digjet vendi? Ne kemi përgjegjësi të madhe për këtë.

- Zoti Sejfi, - i thashë, - kur vendos të luftosh, edhe do të vritesh, por edhe do të vrasësh, edhe armiku do të të djegë, por edhe ne do ta djegim. Gjithë bota po digjet. Po pse digjet? Pse lufton? Sepse kërkon të çlirohet nga robëria nazifashiste. Përrjashtim mendoni të bëni zotëria juaj nga ky ligj i luftës?

- Jo, - tha Sejfiu, - ne mendojmë edhe të luftojmë, edhe të bëjmë politikë, domethënë të dredhojmë, që edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet.

- Kjo është rruga më me mend, - tha Shehu, dhe këtë rrugë duhet ta ndjekim.

- Po kësaj i thonë të mos luftosh, por të bashkëpunosh me okupatorin, more baba Sheh. Kjo rrugë është vetëvrasje! - i thashë. - Jo, ne komunistët jemi për një rrugë krejt të kundërt nga kjo juaja.

- Atëherë ç'kërkoni nga ne, - tha Kola duke ngritur kokën, i skuqur nga inati, - shkoni dhe luftoni, s'ju mban njeri.

- Jo, leje nga ju ne as tremi kërkuar, as kërkojmë për të luftuar, por Partia ju bën thirrje që të luftojmë së bashku dhe këtë e quajmë një detyrë patriotike.

- Zoti Enver, - pyeti Sejfi Vllamasi, - si do të vemë në këtë mbledhje?

- Në mënyrë ilegale, - iu përgjigja dhe i shpjegova në përgjithësi pikëpamjet kryesore që Partia jonë do të shtronte në këtë vend për diskutim. Ndërsa unë po bëja këto sqarime, ndërhyri Kola:

- Ju si do të veni në mbledhje, si individë, si ne, apo si Parti?

- Si Parti, kuptohet.

- Sa bukur e kanë menduar kuqalashët! Ata venë si Parti, ne të vemi si derrat dhe të na heqin prej hunde, - iu drejtua Tromara shokëve të tij.

- Nuk është e vërtetë ajo që thoni, - i përgjigjem Kolës, - nuk është faji ynë, pse ju s'keni parti.

Kola më ndërpreu dhe tha:

- Pritnani edhe ne të formojmë parti dhe të jemi baras.

- Më lejoni të mbaroj, - i them Tromarës. - E dyta, as nuk tremi ndër mend të heqim njeri prej hunde dhe nuk ia lejojmë kurrë vetes një gjë të tillë. Sa për të pritur që ju të krijoni parti, do të krijoni apo nuk do të krijoni, kjo nuk mund të jetë një arsye që ne të mos mblidhemi.

- Po kush do të jenë të tjerë në atë mbledhje? pyeti Shehu.

- Ne, - iu përgjigja, - u kemi bërë ftesë të gjithë atyre patriotëve, të cilët mendojmë se do të jenë të gatshëm të luftojnë për atdheun. Disa prej tyre kanë pranuar të vijnë, me të tjerët po bisedojmë. Ja, unë jam ngarkuar të marr aprovimin tuaj.

- Mirë, Enver, - kërceu Shehu, - por të presim edhe ca, të shohim si do të rrokulliset gjendja, shohim e bëjmë. Ç'na duhet që të mblidhemi? Bile na propozoni edhe në ilegalitet!

- Baba Sheh, - i thashë, - vendimet historike, populli ynë nuk i ka marrë kurrë në këmbë. S'të kujtohet Kongresi i Lushnjës, që u bë afër teqesë tënde? A mund të them pse u bë ai kongres, ç'na duhej ai kongres e pse nuk u prit edhe ca të bëhej ai kongres? Jo, baba Sheh, nuk është i arsyeshëm ky mendimi juaj.

Tromara i egërsuar, duke parë se shoku i tij e shkeli, tha:

- Zoti Enver, do përgjigjen nga ne? Po e them:

Ne nuk e pranojmë propozimin tuaj, nuk jemi dakord dhe nuk do të bashkëpunojmë me ju.

- Kjo është e qartë, - i thashë, - por po merrni

një përgjegjësi të rëndë përpara popullit dhe historisë. Ne ju dolëm borxhit. Po ju themi se do të luftojmë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, mbledhjen do ta bëjmë edhe pa ju, se populli është

dhe do të jetë me ne! - (Më kishte ardhur në majë të hundës, por mbajta gjakftohtësinë gjatë gjithë kohës që vazhdoi biseda, nja 5 orë.) U ngrita dhe falënderova mikun tonë, Kolë Kuqalin, u dhashë dorën ftohtë të tjerëve dhe u largova. Nga të tillë elementë s'kishte ç'prisje tjetër. Por, ndërsa këta patriotë të rremë kërkonin kohë «për t'u menduar», apo gjenin një mijë e një «justifikime» për ta sabotuar bashkimin e popullit dhe luftën e tij pa kompromis, vetë populli, bashkë me të edhe komunistët, nuk humbiste kohën «dulce u menduar», apo me biseda akademike. Realiteti po tregonte me shembuj të shumtë se, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, lufta e armatosur dhe organizimi politik i masave po ngriheshin në një nivel më të lartë, po realizohej një nga hallkat kryesore të programit të Partisë, krijimi i Frontit Nacionalçlirimtar. Momenti për ta sanksionuar de jure themelimin e tij kishte ardhur.

4. 16 shtator 1942

Populli me komunistët në ballë po shënonte faqe të lavdishme në historinë e tij shekullore. Në Vlorë, Skrapar, Kurvelesh, Elbasan, Përmet, Dibër, Shkodër, Mat etj. bëheshin aksione, ngriheshin njësi e çeta; në Tiranë gratë demonstironin me forcë e përlesheshin me fashistët kundër dërgimit të djemve të tyre në ishujt e Italisë; më 24 korrik 1942 tz prenë linjat telefonike e telegrafike; lufta popullore po bëhej një realitet, ashtu si po bëhej realitet edhe paniku që i kishte hyrë armikut.

Gjatë kësaj kohe ne clo të ndienim së bashku me gëzimin e fitoreve edhe dh:imbjen e madhe për shokët e rënë në fushën e betejës d:he të nderit. Do të përsëritej në Shkodër historia e Oso, Kukës nga Perlat Rexhepi, Branko Kadija dhe Jordarl Misja, më lart do ta çonin heroizmin popullor dhe partizan komunistë të tillë, si: Myzafer Asqeriu në Gjirokastër, Teli Ndini në Vlorë, Misto Mame e Mihal Duri në Tiranë.

Lajmet për rënien e tyre heroike më gjenin në valët e punës për përgatitjÉ'n e Konferencës së Pezës. Mposhtja dhimbjen dhe ulesha përsëri mbi referatin: Në çdo frazë të tij duhej të ushtonte gjëmimi i luftës që populli me komunistët në krye kishte shpërthyer dhe që pas Konferencës duhej të fuqizohej edhe më shumë. Askujt, më shumë se komunistëve, koha nuk i jepte të drejtën për t'i bërë thirrje popullit për luftë të pamëshirshme kundër armikut që kishte pushtuar vendin, asnjëri përveç komunistëve, nuk mund të dilte ballëlart e ndershmërisht para historisë së re që po shkruhej me gjakun e djemve më të mirë të popullit.

Referatin që do të mbaja në Konferencën e Pezës e përfundova aty nga fillimi i gushtit e, ndërkohë, kisha hedhur në letër edhe një projekt të Rezolucionit që do t'u paraqitej për aprovim pjesëmarrësve në Konferencë. Ndërkohë kishim marrë përgjigje pozitive nga një numër i madh të ftuarish. Ne, nga ana jonë, caktuam delegacionin që do të përfaqësonte në Konferencë Partinë Komuniste të Shqipërisë, si dhe Rininë Komuniste dhe Gratë Antifashiste Shqiptare dhe ishim gati e kishim marrë të gjitha masat; babë Myslimi priste vetëm datën e saktë, po kështu edhe Haxhi Lleshi, Mustafa Xhani e ndonjë tjetër. Vendosëm që një ditë, nga mesi i gushtit ose diçka më vonë, ta caktonim si ditën e fillimit të punimeve, por shumë «nacionalistë», si Lumo Skëndoja me shokë, ose «vonoheshin» të na jepnin përgjigje, ose kërkonin të shtyhej edhe ca data se «s'ishin përgatitur» dhe, kështu, hë sot, hë nesër, ditët iknin.

Sigurisht, ne nuk mund ta shtynim mbledhjen për në kalendat greke.

- Do t'u lëmë edhe një kohë zotërinjve «baballarë të kombit», - u thashë një ditë shokëve. - Po s'erdhën, do ta bëjmë pa ta.

Kështu vendosëm dhe caktuam përfundimisht që Konferencën ta zhvillonim në mesin e muajit shtator.

Që në dhjetëditëshin e parë të shtatorit unë dhe shokë të tjerë u vendosëm në Pezë dhe lëvizim vetëm në raste të domosdoshme. Aty kishim vendosur edhe një shtypshkronjë të vogël, ku do të shtypeshin materialet që do të aprovonte Konferenca, Rezolucionin, ndonjë thirrje, trakt a komunikatë. Edhe ato ditë qenë plot tension, sepse, ndonëse masat qenë marrë me kohë, probleme

kishte deri në çastin e fundit. Këtu, në prag të Konferencës, zhvilluam edhe një mbledhje të Komitetit Qendror, ku diskutuam kryesisht për evenimentin politik që po organizonim. Përveç anëtarëve të Komitetit Qendror Provizor, Kristo Themelkos, Ramadan Çitakut, Tuk Jakovës dhe meje, merrnin pjesë edhe Nako Spiru, si sekretar politik i Rinisë Komuniste të Shqipërisë, dhe Koço Tashkoja, si i ngarkuar në punën me nacionalistët. Në mbledhje aprovuam referatin që do të mbaja unë dhe dy referatet e tjera.

Në mënyrë të veçantë u morën masa nga celula e Partisë e çetës, si dhe nga komandanti i çetës, Myslim Peza, për sigurimin e Konferencës nga çdo sulm i mundshëm i armikut. Për këtë qëllim në të gjitha pikat e shtigjet, nga ku mund të vrojtoheshin ose të pengoheshin lëvizjet e forcave të armikut, ishin vendosur patrulla partizane.

Një problem më vete ishte siguri i ushqimit. Shokët e Tiranës, si dhe vetë fshatarët patriotë të Pezës, ia arritën që gjatë atyre ditëve asgjë të mos u mungonte pjesëmarrësve. Kur them «asgjë», nuk duhet kuptuar sikur shokët kishin siguruar mishra të pjekura e ëmbëlsira, por buka, gjella, bile edhe ndonjë copë djathë, nuk na munguan.

Që pas dhjetëditëshit të parë të shtatorit filluan të vijnë të ftuarit, kurse më 15 në darkë shumica kishin ardhur. Vendosëm të mos pritnim më. Kush të vinte gjatë natës, mirë, në mëngjes do të fillonte Konferenca.

Në Pezë u takova për herë të parë me Baba Faja Martaneshin, i cili kishte ardhur së bashku me Haxhi Lleshin. Më bëri menjëherë për vete fytyra e sinqertë e Baba Fajës dhe e folura e tij e qetë. Në një nga ato pak ditë që ndenji në Pezë, Haxhi Lleshi pati edhe një takim të papritur.

Në një nga pushimet e mbledhjes Haxhiu po më fliste për gjendjen në Dibër, për influencën e bajraktarëve, si Fiqri Dinja e Selim Kaloshi, për fanatizmin që sundonte sidomos ndaj vajzave e grave në atë krahinë.

- Do të thyhet, - i thashë, - kjo influencë dhe populli patriot dibran do të vijë me luftën dhe me Partinë. Edhe gratë e vajzat dibrane do të zgjohen e do të shpërthejnë energjitë e tyre.

- Para ca kohësh, - më tha Haxhiu, - më ka folur Haki Stërmilli për një vajzë që i kishte shkruar një letër të bukur për librin «Sikur të isha djalë». Ma lexoi letrën, që vajza e nënshkruante me pseudonimin «Flaka» dhe më tha: «Shih Haxhi sa zjarr fshihet te femra shqiptare».

Unë, që tashmë e dija kush qe Flaka, dulce qeshur i thashë Haxhiut:

- A dëshiron të takohesh me Flakën?

- Ku është? - u habit ai.

Dërgova një shok dhe pas pak erdhi Nexhmija.

- Ja, - i thashë Haxhiut. - Njihu! Shoqja është Nexhmije Xhuglini, apo «Flaka», për të cilën të ka folur Haki Stërmilli.

- Po ti je dibrane, - i tha me gëzim Haxhiu, i cili e njihte mirë familjen e Nexhmijes.

U gëzuan të dy nga ky takim dhe pashë që Haxhiut iu bë qejfi që një vajzë nga Dibra merrte pjesë aktive në punët e luftës e të Partisë.

Të nesërmen në mëngjes, më 16 shtator 1942, filloi mbledhja që ka hyrë e do të mbetet në histori me emrin Konferenca e Parë Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, apo shkurt, Konferenca e Pezës. Për gjithë popullin shqiptar dhe për ne komunistët në veçanti, kjo ishte një ditë e shënuar. Vitet që kanë kaluar jo vetëm që nuk e kanë zbehur kuptimin dhe rëndësinë historike të kësaj ngjarjeje, por, përkundrazi, nga majat ku e ngriti Partia atdheun tonë të dashur, spikat edhe më qartë vlera kolosale e kësaj ngjarjeje historike.

Konferencën e zhvilluam në një sallë, apo më mirë në një dhomë (se ç'sallë ishte aio!) të madhe të shtëpisë së Babës me një tavolinë në krye dhe të mbushur me karrige e stola. Shokët që ishin marrë me organizimin kishin bërë çmos për zbulimin e dhomës. Në hyrje, mbi derë, kishin vënë një karton të trashë me fjalët «Mirë se vini delegatë!». Brenda, në mur ishin vendosur flamuri ynë kombëtar dhe portretet e heronjve e figurave të shquara të historisë së popullit tonë, Skënderbeut, Ismail Qemalit, Naim Frashërit, Luigi Gurakuqit, Bajram Currit, Avni Rustemit, duke nënvizuar kështu vazhdimësinë e luftërave për Tiri që kishte bërë populli ynë në shekuj kundër çdo pushtuesi e robëruesi.

Zumë vend në karriget e stolat, duke u ulur gjithsecili krahas miqve e të njohurve të vet. Sigurisht, nuk kishte asnjë protokoll në uljen e pjesëmarrësve, por në mënyrë të vetëdijshme vetë vendet që zinte njëri e tjetri, flisnin për pozicionin e tyre. Baba, Haxhiu, Mustafa Xhani ishin ulur pranë nesh, delegatëve të Partisë Komuniste, Abaz Kupi ishte ulur pranë Ndoc Çobës, që të dy përfaqësues të «rrymës zogiste», «nacionalistët» e shkDilës së Mithat Beut, diku mënjane e kështu me radhë. Gjithsej në Konferencë merrnin pjesë 17 delegatë. Delegacionin e Partisë Komuniste të Shqipërisë e përbënin: Enver Hoxha, Ramadan Çitaku, Ymer Dishnica, Koço Tashkoja dhe Mustafa Gjinishi. Nako Spiru përfaqësonte në Konferencë Rininë Antifashiste, kurse Nexhmije Xhuglini Gruan Antifashiste. «Rinë nacionaliste» e përfaqësonte Halim Begeja, i cili ishte, gjithashtu, i dërguar i «babait» të patriotizmit, Lumo Skëndos, që vetë nuk erdhi. Veç delegatëve, gjatë seancave të mbledhjes morën pjesë si të ftuar, pa të drejtë vote, shokë të tjerë, si Mustafa Kaçaçi, Pandi Dardha, që ishte përgjegjës i celulës së Çetës së Pezës, dhe partizanë të kësaj çete.

Në hapje të mbledhjes unë, në emër të delegacionit të Partisë Komuniste, që ishte iniciatore e Konferencës, falënderova delegatët për pjesëmarrjen e tyre dhe propozova që mbledhjen ta drejtonte Ndoc Çoba, si më i vjetër në moshë. Ndoc Çoba kishte qenë anëtar i qeverisë që doli nga Kongresi i Lushnjës dhe që atëherë gëzonte namin e një patrioti të flaktë. Më vonë ky u bë një nga eksponentët e Legalitetit dhe u vu hapur në shërbim të pushtuesit.

Një delegat tjetër propozoi Nexhmije Xhuglinin si sekretare të mbledhjes, për të mbajtur procesverbalin etj.

Propozimet u aprovuan dhe Ndoc Qoba zuri vend në krye. Mbledhja u deklarua e hapur. Konferenca historike e Pezës filloi.

Në fillim të gjithë pjesëmarrësit të ngritur në këmbë kënduan Himnin e Flamurit, pastaj u mbajt heshtje në kujtim të të rënëve në Luftën Antifashiste. Në këto momente hyri në dhomë një partizan i Qetës së Pezës me një aparat fotografik për të bërë disa fotografi, por, me këmbënguljen e Ndoc Qobës, nuk u lejua të fotografoheshin pjesëmarrësit e Konferencës.

Pas disa diskutimeve, ku u aprovua rendi i ditës, fjala m'u dha mua për të mbajtur referatin kryesor për këshillat nacionalçlirimtarë. Meqë ky referat ka humbur, do të përpiqem të jap në mënyrë të përmbledhur çështjet kryesore që u trajtuan në të e që përbënin parimet bazë e mobilizuese që Partia i parashtrroi Konferencës së përfaqësuesve të popullit shqiptar. Këto parime tash janë bërë historike. Lufta Nacionalçlirimtare dhe jeta e vërtetuan katërcipërisht drejtësinë e tyre.

Ideja kryesore bazë që u shtrua nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë në Konferencën e Pezës, ishte bashkimi i gjithë popullit shqiptar dhe organizimi i tij në luftë kundër pushtuesve. Kjo ishte pika kardinale që unë, i ngarkuar nga Komiteti Qendror, shtjellova përpara Konferencës në raportin kryesor mbi këshillat.

Në mënyrë të veçantë në raport theksova:

- Momentet janë tragjike për fatet e atdheut dhe të popullit. Përpara mizorisë fashiste okupuese, populli duhet të bashkohet si një trup, duhen lënë mënjane gjërat që mund të na ndajnë në bindjet tona ideologjike, fetare, etj., dhe të mobilizohemi e të lidhemi me njëri-tjetrin për një çështje të madhe: për çlirimin e atdheut, shpëtimin e tij si komb i formuar e për t'u prerë rrugën synimeve grabitqare të armiqve, të cilët në çdo kohë kanë vepruar për të na copëtuar e për të na mohuar si komb. Ai që i do me të vërtetë popullin rihe atdheun të lirë, të pavarur e sovran, duhet ta tregojë tashmë këtë, pavarësisht nga bindjet politike, nga besimet fetare, pavarësisht nga ç'krahinë është.

Lufta kundër zaptuesit fashist italian dhe bashkëpunëtorëve të tij, - nënvizohej në raport, - është e vetmja alternativë për patriotët e vërtetë, tjetër rrugë nuk ka. Çdo rrugë tjetër të çon në robëri, në skllavëri, në inxerim si komb dhe si individ. Armiku italian dhe kuislingët duan të na ndajnë, të na përçajnë, dhe synimi i tyre kryesor është të izolojnë Partinë Komuniste të Shqipërisë nga populli dhe nga lufta. Për armikun pushtues ky objektivi është vendimtar. Por edhe për çlirimin e popullit dhe të atdheut qenia dhe lufta e Partisë Komuniste të Shqipërisë në krye të popullit që po fufton e reziston, është vendimtare.

Kur arrita në këtë pjesë të referatit tim, vura re se disa pjesëmarrës reáguan me ndonjë lëvizje të shqetësuar apo me ndonjë pëshpëritje të këmbyer mes tyre. Sigurisht, unë é prisja se disa prej tyre,

si Bazi, elementët «nacionalistë», si Halim Begeja e ndonjë tjetër, nuk e kishin fort për zemër rolin udhëheqës të Partisë, por ne kishim vendosur ta theksonim me forcë këtë moment dhe ishim përgatitur edhe për t'iu përgjigjur reagimeve të tyre të hapëta. Por nuk pati asnjë reagim të tillë dhe vazhdova raportin, duke pasur për qëllim që të sqaroja ata elementë të cilët mund të kishte zënë vend, në një shkallë a në një tjetër, propaganda e ndyrë antikomuniste e pushtuesit dhe e kuislingëve.

Në vazhdim trajtova problemet e organizimit konkret politile dhe ushtarak të luftës sonë e, në substancë, thashë:

- Lufta jonë është një Luftë Nacionalçlirimtare, e cila ka për objektiv çlirimin e plotë të atdheut dhe vendosjen e një regjimi demokratik, formën e të cilit do ta vendosë vetë populli pas Çlirimit. Pra, lufta jonë do të jetë një luftë politike dhe ushtarake.

Për të realizuar këto dy qëllime të mëdha duhet të organizohen Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili do të ketë këshilla nacionalçlirimtare në të gjithë vendin dhe çetat partizane, të cilat janë forcat e armatosura të Frontit Nacionalçlirimtar. Më pas do të kalojmë në njësi më të mëdha dhe do të krijojmë edhe Shtabin Madhor.

Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar do të shtahet kudo në vendin tonë në zonat e çliruara e të paçliruara dhe veprimtaria e tij do të realizohet nëpërmjet këchillav e nacionalçlirimtarë. Këshillat nacionalçlirimtarë, - u tha në raport, - do të kryejnë punën politike, propagandistike, mobilizimin e njerëzve për luftë e për rezistencë, furnizimin me materiale të çdo lloji për çetat, kurse në vende e zona të çliruara, ku do të likuidohet nga themeli pushteti i vjetër shtypës, këta këshilla do të jenë dhe do të afirmohen si pushteti i ri demokratik popullor, që as nga forma dhe as nga brendia nuk mund t'iu përngjasin as administratës shtetërore feudo-borgjeze dhe as këshillave të vjetër të pleqësisë. Këta do të jenë këshilla me përmbajtje e frymë të re, pse në ta do të bëjnë pjesë njerëz të popullit, luftëtarë nga të gjitha shtresat dhe besimet fetare ose politike, por që të jenë antifashistë dhe të luftojnë kundër pushtuesit.

Më poshtë fola konkretisht për organizimin dhe drejtimin e çetave partizane që do të ishin embrioni i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

- Çetat partizane, - thashë mes të tjerash, do të udhëhiqen nga komandantë komunistë e patriotë pa parti, do të udhëhiqen njëkohësisht nga komisarë politikë, të cilët duhet të jenë komunistë. Vendimet duhet të merren nga komandanti e komisari së bashku dhe në harmoni të plotë; në marrëdhëniet e tyre e ndaj tyre nuk duhet të ketë e nuk duhet të bëhet asnjë diskriminim. Çetat partizane do të luftojnë me flamurin tonë kombëtar në ballë, me flamurin e Skënderbeut, me flamurin që ngrihet Ismail Qemali në Vlorë. Partizanët në kapelet e tyre do të kenë yllin e kuq pesëcepësh, që simbolizon një periudhë të re, të ndritur, që po u hapet atdheut dhe popullit tonë.

Gjithashtu, në raportin për këshillat nacionalçlirimtarë, theksova si një çështje kryesore se Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar e udhëhreq Partia Komuniste e Shqipërisë, e vetmja parti në vend, dhe Fronti do t'i ketë dyert të çelura për çdo njeri që do të luftojë kundër armikut, i cili si individ duhet ta konsiderojë Frontin të tijin, ku të shprehë lirisht mendimet dhe sugjerimet e tij në favor të Luftës Nacional çlirimtare.

Për sa i përket çështjes së pranimit në Front të partive të tjera, kjo as që shtrohej në ato momente, sepse të tilla nuk ekzistonin. Asnjë klasë, asnjë shtresë ose grupim politik nuk kishte dalë me ndonjë parti të vetën e as me ndonjë program për çlirimin kombëtar. Edhe ndonjë organizatë që u krijua pas Konferencës së Pezës, si Balli Kombëtar, nuk ishte tjetër veçse krijesë e pushtuesve fashistë dhe e të huajve të tjerë për të penguar çlirimin e atdheut.

Në mënyrë të veçantë në raport u ndala në rolin dhe në detyrat konkrete të këshillave nacionalçlirimtarë dhe për organizimin praktik të punës sonë për ta intensifikuar ngritjen e këshillave në të gjithë vendin.

Pasi tregova për punën që qe bërë deri në atë kohë dhe për rezultatet që ishin arritur, theksova mes të tjerash:

- Këshillat, që duhet të krijohen lirisht nga po pulli, të ngrihen edhe në zonat e çliruara dhe në ato

të paçliruara. Në fshatrat dhe në qytetet që janë në duart e armikut, sigurisht, është e pamundur të bëhen zgjedhje të hapëta e të gjera, por ne do të punojmë, që këto zgjedhje konspirative të kenë një përfaqësim sa më të gjerë, në mënyrë që në këshill të futen pikërisht ata njerëz që populli i njeh dhe i do.

Pas raportit që mbajta unë, u bënë diskutime. My slimi mbështeti fuqimisht tezat e Partisë. Duke iu përgjigjur dredhive të «nacionalistëve», të cilëve s'ua kishte qejfi të angazhoheshin konkretisht për luftë kundër pushtuesit, ai shtroi pyetjen:

- Kur do të luftojmë ne? Nuk kemi ç'presim ma.

Sot ka dy rrugë: ose me luftu kundër pushtuesit bashkë me popullin, ose me luftu kundër tij. Nji gja asht e vërtetë: populli s'po u beson ma atyre «nacionalistëve» që na bëjnë thirrje me prit.

Po të njëjtin qëndrim mbajtën edhe Baba Faja Martaneshi dhe Haxhi Lleshi e të tjerë. Shokët e tjerë të delegacionit të Partisë Komuniste, nëpërmjet diskutimeve të tyre, bënë edhe një pasqyrë të gjendjes ndërkombëtare dhe treguan reperkusionet e saj ndaj situatës së brendshme.

Veç shokëve tanë, folën në mbledhje edhe pjesëmarrës të tjerë, të cilët, siç tregoi koha, kishin ardhur në Pezë me të tjera qëllime. Në përgjithësi ata u shprehën dakord me raportin, si dhe me luftën kundër pushtuesit, por përipiqeshin që nëpërmjet objeksioneve formaliste ta shmangnin Konferencën nga vendimet konkrete e luftarake.

Një pjesëmarrës «demokrat» nationalist, që më vonë u bë ballist, u shpreh për Frontin, por nga konceptet e tij të ngushta e të shtrembra deshi ta kufizojë rolin e Konferencës së Pezës, duke e krahasuar me Kongresin e Lushnjës, që u mbledh kundër qeverisë së Durrësit. Shquanin te ky person më tepër tendencat për krijimin e një «qeverie demokratike», duke rrëzuar atë të Mustafa Krujës dhe «harronte» të theksonte luftën kundër pushtuesit.

- Kjo që propozoni ju, - iu përgjigja unë, është një nonsens ngado që ta zësh. Si mendoni ju, do të lejojë pushtuesi t'i rrëzosh Merlikën dhe të vendosësh një qeveri demokratike? Përkundrazi, Merlikën ai mund ta rrëzojë vetë dhe të vërë një tjetër Merlikë në vend të tij. Hallet e popullit e të atdheut sot nuk i zgjidhin kombinacionet qeveritare, por lufta kundër pushtuesit dhe tradhtarëve. Kur të zgjerohet lufta, kur të kemi ushtrinë tonë, kur të ngremë e të forcojmë këshillat, atëherë do të ngremë edhe qeverinë tonë, por jo me aprovimin e firmën e Duçes e të Hitlerit, por të firmosur me pushkën e popullit.

Halim Begeja, që vinte si përfaqësues i «rinisë nacionaliste», por në fakt ishte syri dhe veshi i Mithat Frashërit e i taborit të tij, foli edhe ky gjoja pro luftës dhe pro Frontit, por në fakt kërkonte t'u hiqte këtyre udhëheqjen e Partisë, e cila do t'u jepte shpirtin e frymën luftarake.

- Pohojmë, - tha ai, - se Partia Komuniste po zhvillon një aktivitet të gjerë...

Pikërisht ky fakt i trembte pushtuesit e tradhtarët, prandaj këta, nëpërmjet veglave të tyre, do të përipiqeshin ta minimizonin, bile ta asgjësonin rolin e Partisë në Frontin Nacionalçlirimtar. Prandaj edhe megafoni i Mithat Beut propozonte:

- Në Front të mos ketë parti udhëheqëse. Me zhvillimin e luftës, kush të afirmohet duhet të udhëheqë. Po të fitojë komunizmi, s'ka forcë që ta ndalojë. Po kështu edhe nacionalizmin.

Ky «udhëheqës rinie» që u bë një nga eksponentët e rinisë balliste, ky «patriot» që braktisi atdheun dhe ua mbathi këmbëve bashkë me pushtuesit gjermanë, dulce dashur të shmangë pjesëmarrjen e rinisë sonë në luftë, tha gjithashtu:

- Jemi të mendimit dhe insistojmë që mosha e re të tërhiqet nga veprimet luftarake, sepse mosha e njomë nuk është në gjendje të kontrollojë veprimet ose mendimet e saj.

- Po kush do të luftojë atëherë? - pyeti një nga shokët tanë, - vetëm pleqtë?

Në dhomën ku ishim mbledhur u krijua një ambient ilariteti, sepse të gjithë e kuptonin se pa rininë nuk mund të mendohej lufta për çlirimin e atdheut. Duke e kapërcyer pak radhën që u ndoq në Konferencë, dua të përmend këtu se ky problem u trajtua gjerësisht në referatin «Rinia në luftë kundër okupatorit». Në këtë referat, si dhe në atë të Nexhmijes mbi gjendjen e mjeruar e veprimtarinë patriotike revoludonare të grave dhe të të rejave, u ngrit dhe u argumentua rëndësia e madhe e rinisë punëtore, fshatare e shkollore, e grave punëtore, fshatare dhe shtëpiake në këtë luftë të madhe. Në këto dy referate u argumentua se, pa zgjimin dhe bashkimin e rinisë, të grave e të

vajzave rreth qëllimit të madh të çlirimit, pa i hedhur këto në luftë e në rezistencë aktive, çdo gjë do të dilte e dobët, forcat e shëndosha dhe jetike të atdheut nuk do të kaliteshin, por do të zbeheshin. «Asnjë grua, asnjë i ri dhe e re nuk i duhet lënë armikut që ta korruptojë politikisht», u nënvizua në Konferencë.

Shumica e pjesëmarrësve në Konferencë, në diskutimet e tyre, aprovuan me entuziazëm gjykimet dhe propozimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë rreth problemeve themelore që u shtruan.

Edhe Abaz Kupi, përfaqësues i rrymës zogiste, e ndonjë tjetër e aprovuan platformën e Pezës, jo se e donin, por sepse mendonin të maskoheshin për të vepruar, siç vepruan, në kundërshtim me Frontin dhe me Luftën Nacionalçlirimtare.

Në Konferencë u ngrit edhe çështja e regjimit që do të vendosej në Shqipëri pas luftës. Kjo ishte një çështje nevrologjike dhe Partia e kishte të qartë perspektivën. Lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste kishte si objektiv jo vetëm çlirimin e plotë të atdheut, por edhe rrëzimin e regjimeve shtypëse feudo-borgjeze. Populli nuk do të luftonte që t'i pastrohej rruga Zogut apo shërbëtorëve, miqve e «armiëve» të tij. Historia ecte përpara, populli qe zgjuar dhe aspiratat e tij, që i përfaqësonin bijtë e bijat më të mirë, komunistët e patriotët e vërtetë, ishin për një Shqipëri të lirë nga shtypja, qoftë e jashtme, qoftë e brendshme.

Prandaj në diskutimin e kësaj çështjeje shfaqta mendimin e Partisë sonë që të shpallnim si qëllim të luftës çlirimin e vendit dhe krijimin e Shqipërisë demokratike e popullore. Për formën e regjimit, kjo le të vendosej nga vetë populli pas luftës. Dikush, në Konferencë u shpreh që ne të shpallnim si formë të regjimit «republikën demokratike», por kjo u hodh poshtë nga ne përfaqësuesit e Partisë Komuniste, si jo e përshtatshme për çastin. Hedhja e një parulle të tillë nuk do t'i shërbente bashkimit të të gjitha forcave në luftë dhe, qysh në fillim, do të krijonte një opozitë të dëmshme e të panevojshme ndaj Frontit.

Edhe Abaz Kupi u solidarizua me formulimin tonë.

- Unë, - deklaroi «solemnisht» Bazi i Canës, dua njëherë Shqypninë e mandej Zogun. Pas lufte, n'e dashtë poplli, ka me u vendosë.

Por ne e kishim psikologjisur gjendjen shpirtërore të Abaz Kupit dhe të zogistëve të tjerë dhe nuk u habitëm kur ata hodhën hapin e parë kundër nesh. Bazi u bashkua me parinë bajraktare të vendit dhe bashkë punoi me pushtuesit gjermanë. Ai nuk e pranoi yllin, simbolin partizan (për këtë si dhe për fjalën «partizan» u diskutua edhe në Konferencë), dhe kjo nuk ishte thjesht se gjoja cenohej diçka simbolike e kombit, por sepse për të ishte çështje parimore: çfarë do të ishte Shqipëria e pasluftës, një demokraci e re e vërtetë apo regjimi i vjetër i Zogut dhe i feudalëve e i bajraktarëve? Sigurisht, Abaz Kupi mendonte dhe punonte për ardhjen e Zogut; ne e kishim parasysh kompleksitetin e këtij personi, kishim dyshimet e rezervat tona e, me kohë, do ta njihnim më mirë e do të bindeshim plotësisht se ai qysh në fillim ishte një agjent dhe njeri i Zogut, i futur ilegalisht në Shqipëri nga Intelixhens Servisi anglez, i financuar e i udhëzuar prej tij. Ai kishte marrë udhëzime të pranonte ftesën tonë, të bënte pjesë në Front, të hiqej si luftëtar, por të mos hidhte asnjë pushkë kundër pushtuesit dhe të priste kohën kur të urdhërohej dhe si të urdhërohej për të vepruar.

Diskutimet vazhduan deri natën vonë si dhe të nesërmen në mëngjes. Pas diskutimeve, Nexhmije Xhuglini, me cilësinë e sekretares së Konferencës, u lexoi pjesëmarrësve projektin e Rezolucionit që ne kishim përgatitur që më parë. Nuk pati ndonjë vërejtje esenciale dhe Rezolucioni u aprovua. Ky dokument është i botuar dhe i njohur, prandaj nuk do të zgjatem me përmbajtjen e tij. Pastaj u procedua me zgjedhjet. Konferenca zgjodhi Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar të Përkohshëm të përbërë prej 7 vetash. Nga ana e Partisë Komuniste të Shqipërisë u zgjodhën Enver Hoxha, Ymer Dishnica e Mustafa Gjinishi. U zgjodh, gjithashtu, si anëtar i këshillit Myslim Peza dhe nga «nacionalistët» Abaz Kupi, Ndoc Çoba e Kamber Qafmolla (ky i fundit u zgjodh në mungesë).

Çdo gjë në organizimin e Konferencës shkoi mirë. Banorët e Pezës u kujdesën për gjithçka dhe, në mënyrë të veçantë, konspiracioni qe i përsosur. Mes fshatarëve e partizanëve kishte entuziazëm, sidomos, kur në kohën e ndonjë pushimi delegatët rrinin e bisedonin me ta. Në një nga këto

pushime ndodhi një episod që na bëri të qeshnim ca ne të tjerët, por që Abaz Kupin na e mërzi fort.

Po bënim një garë kush të qëllonte në një shenjë të vendosur tutje, kur vjen edhe Abaz Kupi, merr pushkën e zbraz dy a tri herë por nuk qëllon dot në shenjë. Atëherë, për ta ngacmuar, hidhet Nexhmija dhe i thotë:

- Ta provoj edhe unë njëherë, zoti Abaz, se me pushkë nuk kam qëlluar ndonjëherë.

Do ti që me shkrepjen e parë e qëlloi shenjën.

Abazi u nxi në fytyrë që një burri «katërqind dërhëmë» ia kaloi një vajzë e re. Dhe Haxhiu i thotë:

- Mos u mërzi Abaz. Kështu e kemi ne dibranët, edhe cucat dinë ta mbajnë pushkën.

Dhe si për ta vrerosur edhe më shumë Bazin, Myslimi i thotë me të hedhur:

- Të qenka ndryshkur pushka, o babë!

Kështu përfundoi Konferenca e Pezës, e cila sanksionoi formimin e organizatës luftarake të popullit shqiptar, të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Vetë emri i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar kishte kuptim të thellë politik dhe ushtarak; ato tri fjalë përmbledhnin idenë e bashkimit të popullit. Po përse? Për të krijuar një front lufte. Ideja dhe aksioni do minonin në fjalën «Front». Kjo fjalë shprehte kuptimin e rreshtimit të forcave të gjalla të popullit të organizuar në një front lufte ku duheshin guxim, heroizëm, politikë, strategji dhe taktika të ndryshme kundër një armiku të egër. Por për çfarë lufte krijohej ky Front? Përgjigjja vinte menjëherë: për çlirimin e kombit. Ishte, pra, një Front Nacionalçlirimtar, që do të mobilizonte e do të grumbullonte në gjirin e tij gjithë forcat antifashiste që do të luftonin për të çliruar atdheun. Pas kësaj atdheu ynë do të merrte një formë të re, do të kishte një regjim të ri, që do ta caktonte vetë populli i armatosur, vetë populli, që, duke luftuar me armë dhe duke bërë sakrifica të mëdha, do të kishte të drejtën të përcaktonte edhe formën e regjimit që do t'i pëlqente. Askush tjetër, asnjë armik i jashtëm e i brendshëm nuk do të lejohej e nuk do të ishte në gjendje t'i impononte popullit shqiptar vullnetin e tij. Kjo situatë që po krijohej, ishte vepra e lavdishme e Partisë Komuniste të Shqipërisë, rolin udhëheqës të së cilës e afirmoi Konferenca e Pezës.

Kur Konferenca i kishte mbaruar punimet, erdhën «dasmorët» e vonuar, Skënder Muçoja, Azis Cami, Musa Puka e Kamber Qafmolla. I pritëm me përzemërsi, biseduam me ta dhe u folëm me hollësi për zhvillimin e Konferencës dhe për vendimet që ishin marrë atje. U dhamë të lexonin edhe Rezolucionin që kishim aprovuar. Ata u treguan të kënaqur, shprehën keqardhjen që nuk kishin arritur në kohë, por aprovuan edhe vendimet, edhe Rezolucionin e Konferencës.

Sikurse thashë edhe më lart, ne kishim marrë të gjitha masat për shtypjen e materialeve të Konferencës. Bile, ato ditë punonim për një numër të «Zërit të popullit»*,*(Është fjala për nr. 3-4 të «Zërit të popullit» (tetor 1942), në të cilin, veç të tjerash, u botuan artikulli: «Populli shqiptar në luftën për tiri» ~ (f. 7-11), ku jepej si-hariqi për zhvillimin me sukses të Konferencës së Pezës dhe shtjellohej gjerësisht rëndësia e kësaj mbledhjeje; dhe «Thirrja e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar» (f. 11-13), përmes së cilës i bëhej thirrje popullit shqiptar të ngrihej i bashkuar në luftën për liri, për një Shqipëri të lirë, demokratike e të pavarur.) që do të jepte lajmin për këtë ngjarje his torike dhe do t'i bënte jehonë Rezolucionit të Konferencës së Pezës. Rezolucioni u shtyp shpejt dhe të gjithë pjesëmarrësit e morën me vete për ta punuar e për ta shpërndarë në popull. Sigurisht, pjesa më e madhe do të shpërndahej nga shokët tanë në Tiranë, në qytete e në fshatra të vendit.

Ndërkaq unë me disa shokë pasi mbaruam punët që kishim, vendosëm të ktheheshim në Tiranë. Udhëtimi duhej bërë në mënyrë tepër konspirative, sepse dyshohej se armiku mund të kishte marrë vesh për mbledhjen dhe të kishte forcuar kontrollin. Veç kësaj, do të merrnim me vete një Basi jo të vogël materialesh për t'ua çuar shokëve në Tiranë e për t'i dërguar në drejtime të tjera.

Babë Myslimi na premtoi se do të na gjente një makinë me një shok të sigurt, i cili kishte kryer misione të tilla edhe më parë, sidomos në periudhën e përgatitjeve për Konferencën e Pezës. Ky ishte një shofer, i lidhur ngushtë me Partinë e me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, që më duket se e thërritnin Meti [Muhamet Qoli].

Një ose dy ditë më pas, aty nga dreka, Meti erdhi me një «mileçento», që ia kishte marrë borxh një miku të tij, dhe, pasdite, u nisëm për në Tiranë së bashku me Y. Dishnicën e M. Gjinishin. Të tre ishim veshur si «intelektualë». Unë kisha vënë edhe një palë syze dielli të errëta. Në brez, nën jelek

mbaja nagantin, kurse né çantë kisha futur një «njëzetëshe». Né makinë, siç thashë, kishim edhe nja dy thasë me materiale, trakte dhe Rezolucionin e Konferencës.

Rrugën nga Peza deri né hyrje të Tiranës e kaluam pa incidente, por tamam kur kaluam postbllokun e menduam se s'kishte më rrezik, Tafari* *(Pseudonimi i Mustafa Gjinishit.), pa u konsultuar fare me ne, i thotë shoferit:

- Ktheje andej!

- Për ku? - e pyeta i habitur. - Do të na çosh tek italianët si cjamin te kasapi? - dhe i tregova me gisht kazermat që ngriheshin afër atij vendi ku atij i shkrepri të futnim makinën.

- Kazermat janë larg, - m'u përgjigj qetë-qetë, - kurse fare afër prej këtej është hani i një mikut tim. Thasët me dokumente do t'i lëmë atje që né qytet të hyjmë pa asgjë të rrezikshme!

Nuk arrita dot t'i kundërshtoja, sepse makina frenoi para njëfarë hani të qelbur e thujse të shkatërruar. S'mbetej tjetër veç të zbritnim me shpejtësi, i fshehëm thasët né një qoshe të hanit dhe u futëm né makinë.

Me sa duket qëndrimi ynë prej disa minutash aty tërhoqi vëmendjen e ushtarëve e të milicëve që s'ndodheshin larg dhe, kur ne u nisëm né drejtim të rrugës së Kavajës (sot «Konferenca e Pezës»), dy-tre karabinierë na bëjnë shenjë me dorë që té ndalójmë.

Ishte ditë e shtunë dhe këtë ditë fashistët italianë e festonin; ushtarët e sidomos oficerët dilnin né qytet e kalonin kohën nëpër kafene e restorante. Për shkak të lëvizjes së madhe né rrugë ne manovronim me vështirësi. Ndërkohë vumë re që dy motoçikleta na ishin vënë prapa. Por Meti nuk ndali dhe me shkathtësi diti t'u humbiste atyre nga sytë. Kështu i shpëtua edhe këtë herë rrezikut të madh dhe arritëm te Kodra e Kuqe.

Të tërbuar që s'na kapën dot, fashistët ishin kthyer né palo hanin e Gjinishit, kontrolluan dhe i gjithë materiali që sollëm nga Peza (Rezolucioni dhe traktet) ra né duart e tyre. Ndonëse e kishim për tjetër destinacion, «ngushëlluam» veten me faktin që fashistët ishin ndër të parët që mësonin sihariqin e madh: populli shqiptar kishte vendosur të bashkohej i tëri né luftën për shfarosjen e tyre! Më vonë mësuam se edhe Nako Spiru me dy shokë të tjerë, pasi ishin larguar nga Peza dhe shkonin né drejtim të Durrësit, ishin ndeshur né Ndroq me patrulla të armikut dhe ishin arrestuar. Me sa më kujtohet, Nakoja ndenji pak kohë né burg, sepse mundi të arratisëj që andej.

Dy-tri ditë pas largimit tonë nga Peza, italianët dhe forcat e qeverisë kuislinge filluan operacionin ndëshkimor né këtë zonë. Fashistët, që tashmë kishin mësuar mbi mbledhjen e mbajtur atje, dhe dulce e kuptuar rrezikun e një baze të tillë të Luftës Nacionalçlirimtare pranë Tiranës, kishin vendosur ta spastronin Pezën nga partizanët dhe simpatizantët e lëvizjes. 3 000 forca italiane e kuislinge formuan një darë të fortë dhe u sulën mbi Pezë. Çeta jonë partizane, nën komandën e Myslim Pezës, bashkë me fshatarët që ishin bashkuar me të, me goditje e lëvizje të papritura i shpëtoi rrethimit me fare pak humbje. Armiku i egër e zbrazi dufin e tij mbi banorët, gratë, fëmijët dhe shtëpitë e pezakëve. U dogj ndër të parat edhe shtëpia e Myslimit, shtëpia e Konferencës së Pezës, që sot është ngritur prapë mbi ato themele, siç ka qenë, për t'u ruajtur si një kujtim i lavdishëm për brezat që do të vijnë.

Ne në Tiranë e ndiqnim me vëmendje e shqetësim zhvillimin e ngjarjeve në Pezë, ndonëse kishim besim të patundur se komunistët, partizanët dhe populli i Pezës do ta përballonin me guxim e zgjuarsia këtë situatë. Dhe ashtu ndodhi, armiku dështoi dhe u tërhoq nga Peza.

Në popull Konferenca bëri një efekt kolosal, ngjalli shpresa e besim te Partia Komuniste e Shqipërisë, besim në luftë dhe në fitore. Tek armiqtë ajo ngjalli zemërimin, frikën, tmerrin. Organizimi i Konferencës dhe vendimet e saj ishin për ta një shuplakë e rëndë politike dhe ushtarake. Pozitat e tyre në Shqipëri po tronditeshin. Pas kësaj ata do të intensifikonin terrorin, vrasjet, burgimet kundër komunistëve, patriotëve, popullit, do të digjnin fshatra e krahina të tëra, do të thurnin e do të zbatonin manovra të reja me krerët e reaksionit shqiptar, pseudopatriotët, pseudodemokratët. Po të gjitha do t'u shkonin kot. Lufta e popullit, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, tash do të bëhej më e organizuar, më e ashpër dhe hap pas hapi do t'i flakte tej pushtuesit, ndërsa plehrat që u shërbenin atyre do t'i hidhte në koshin e historisë.

II

NGA PEZA NË LABINOT

(Shtator 1942 - shtator 1943)

Suksesi që arritëm në Konferencën e Parë Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar na dha krahë. Ishte bërë kështu një hap i madh përpara në arritjen e fitores finale mbi pushtuesit dhe kuislingët. Sidoqoftë, ne ishim plotësisht të ndërgjegjshëm se kishim hapur e hedhur vetëm themelet, kurse tash na duhej që mbi to të ngrinim kështjellën. Përpara kishim luftën e punët më kryesore, më të vështira e më komplekse për të përballuar e për të kryer. Në bazë të vijës së PKSH dhe të mbështetur te programi luftarak që aprovoi Konferenca, popullit, komunistëve dhe patriotëve të vërtetë u duhej, pra, të qindfishonin përpjekjet për ta bërë Frontin Nacionalçlirimtar një forcë të çeliktë goditëse, dhe këshillat nacionalçlirimtarë, organe të vërteta të mobilizimit luftarak, të mbrojtjes dhe të përfaqësimit të popullit kryengritës.

1. Në ballë të luftës

Qysh kur ishim në Pezë ne kishim përcaktuar dhe kishim ndarë detyrat për punën tonë në periudhën e mëvonshme. Unë do të punoja kryesisht në Tiranë ku, veç detyrave në linjën e Partisë (natyrisht kjo s'u tha e s'kishte pse të thuhej në mbledhjen e Këshillit), do të kryeja detyra të ndryshme që i takonin Këshillit Antifashist të zgjedhur në Pezë, do të punoja për organizimin e këshillit nacionalçlirimtar ilegal në kryeqytet dhe, veç këtyre, do të kisha në qendër të vëmendjes edhe punën me inteligjencien; Ymer Dishnica do të punonte me ata nationalistë që premtinin, por ende nuk ishin lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare; Mustafa Gjinishi kishte në «patronazh» Shqipërinë e Mesme; Abaz Kupi, po dihet, kishte Krujën e Matin e kështu me radhë. Myslim Peza nuk u ngarkua me detyra të veçanta, meqenëse ishte komandant i Qetës së Pezës dhe kjo detyrë, sigurisht, ishte mjaft me përgjegjësi dhe ia vështirësonte lëvizjet.

Të gjithë anëtarët e Këshillit si dhe pjesëmarrësit e tjerë të Konferencës u porositën që, me t'u kthyer në qytetet e në fshatrat e tyre, të fillonin punën për të çuar në popull frymën dhe vendimet e Konferencës së Pezës, të punonin Rezolucionin, të bënin thirrje e të drejtonin punën konkrete për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtarë, të njësiteve dhe të çetave partizane. Populli duhej ta kuptonte mirë rëndësinë e Konferencës dhe të mobilizohej për të zbatuar vendimet që ishin marrë në të. Veç kësaj, shokët u porositën që të shtoheshin kontaktet me elementët nationalistë me influencë, t'u flitej atyre për platformën që kishim aprovuar dhe t'u bëhej thirrje që, mbi bazën e kësaj platforme, të bashkoheshin me të gjithë popullin shqiptar në Luftën Nacionalçlirimtare. Natyrisht, suksesi i madh që arritëm në Pezë, zgjedhja e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe nisja e punës prej tij, në asnjë mënyrë nuk do të thoshte se tash e tutje me problemet e Frontit e të këshillave nacionalçlirimtarë do të merrej e do të -përgjigjej vetëm Këshilli i Përgjithshëm. Të gjykohej e të veprohej kështu, pra, ta quanim të mbaruar punën tonë për Frontin me ato që u arritën në Pezë e çdo gjë më pas t'ia linim në dorë Këshillit të Përgjithshëm, ky do të ishte nga gabimet më të rënda e më fatale, si për çështjet kardinale të luftës e të popullit, ashtu edhe për vetë fatet e Partisë sonë Komuniste. Kjo jo thjesht për faktin se në përbërjen e Këshillit, përveç përfaqësuesve të Partisë Komuniste e disa patriotëve të vërtetë e konsekuentë, të tjerët ishin elementë të lëkundur, të pasigurt ose të bashkuar me ne për qëllime të largëta sabotuese. Jo, edhe sikur të gjithë anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të qenë elementë të sprovuar, konsekuentë e luftëtarë të vërtetë, puna dhe roli i Partisë përsëri duhej patjetër të mbeteshin të pazëvendësueshëm.

Vetëm Partia Komuniste me vijën e saj të drejtë, me programin e saj të qartë, me kombativitetin e të gjithë anëtarëve të saj, me konsekuencën e saj për t'i çuar gjërat gjer në fund, do të bënte të mundur që edhe Këshilli i Përgjithshëm t'i kryente më mirë detyrat e funksionet e tij, edhe Fronti të shtrihej, të zgjerohej e të forcohej në baza sa më të shëndosha, edhe këshillat të krijoheshin e të vepronin siç duhej në gjithë vendin e, për pasojë, vetë lufta të zgjerohej pareshtur, të merrte karakterin e një lufte të vërtetë e të përgjithshme popullore e të kurorëzohej me sukses.

Kjo normë e maksimë e marksizëm-leninizmit për punën e Partisë Komuniste në Front, që të gjente një zbatim të drejtë e konsekuent në kushtet konkrete të vendit tonë, na ngarkonte ne me detyra e me përgjegjësi të shumta.

Është i vërtetë fakti se Konferenca e Pezës e afirmoi rolin udhëheqës të Partisë sonë në Luftën Nacionalçlirimtare, por s'duhet menduar aspak se, pas kësaj, gjithçka ishte zgjidhur përfundimisht. Kishte zona të tëra, sidomos në Veri, ku ende nuk kishte depërtuar sa duhej as programi e fjala jonë për luftën dhe as ishin arritur rezultatet e duhura për bashkimin dhe mobilizimin e popullit. Po ashtu, edhe atje ku sukcesi ynë ishte i dukshëm, prapë mbeteshin shtresa e grupe të caktuara që ende s'po i kuptonin rolin e detyrat që kërkonte momenti. Na mbetej, pra, të punonim e të luftonim që emri i Partisë, fjala dhe vepra e anëtarëve të saj të njiheshin kudo, të futeshin kudo e të bënin krejt popullin për vete. Ndryshe, pa luftë konkrete, pa përpjekje të mëdha e të vazhdueshme, roli udhëheqës nuk fitohet. Atë as ta jep, as ta fal kush.

Gjithnjë e kemi përmendur dhe e përmendim si një faktor ndihmës e pozitiv për punën tonë faktin që Partia Komuniste e Shqipërisë ishte e vetmja parti politike që vepronte në Shqipëri. Por, dulce e afirmuar këtë të vërtetë, në asnjë mënyrë s'duhet menduar se roli udhëheqës në luftë, në Front etj., i takonte Partisë sonë e do t'i jepej vetvetiu, meqë s'kishte me kë «të konkurronte», apo meqë ky rol s'kishte se kujt t'i jepej tjetër! Jo, realiteti ka qenë krejt ndryshe, tepër kompleks, i vështirë, me probleme të mëdha.

Vërtet te ne mungonin partitë politike borgjeze të ngjyrave të ndryshme, por ekzistonin lloj-lloj grupesh e grupimesh, rrethe e rryma të ngjyrave e tendencave më të ndryshme, të cilat kishin, kush më shumë e kush më pak, influencat e lidhjet e tyre. Këto grupe e rryma vërtet s'ngriheshin e nuk shpreheshin kundër pushtuesit, por inaktive, jashtë politikës, jashtë veprimit as ishin dhe as i lejonte njeri të ishin. E meqë në tërësi nuk ishin kundër fashizmit, doemos do të ishin kundër nesh, kundër Partisë sonë, kundër programit e vijës së saj për Frontin, për këshillat nacionalçlirimtarë, për luftën etj.

Me të gjithë këta ne duhej të ndesheshim dhe kjo ndeshje bëhej tepër e ndërlikuar për faktin se shumica e këtyre në fillim, ashtu siç nuk dilnin hapur kundër pushtuesit, s'dilnin hapur as kundër nesh, përkundrazi, dredhonin, manovronin.

Të mos harrojmë, gjithashtu, se armiq të mëdhenj në punën tonë ishin e do të mbeteshin prapambetja e injoranca e trashëguar, mentalitetet prapanike, që nga ato feudale e gjer te zakonet borgjeze e, në kuadrin e këtyre, edhe propaganda e ethshme e shumëvjeçare e Zogut dhe e fashizmit kundër komunizmit.

Të gjitha këto grupe, tendenca e mentalitete, pra, qëndronin, krahas fashizmit, përballë Partisë sonë Komuniste si shprehje të partishmërisë borgjeze e feudale. Ndaj, edhe pse ne në punën tonë s'kishim përballë parti të organizuara politike të borgjezisë e të reaksionit, kishim përballë po aq të ashpra e komplekse, po aq minuese, të rrezikshme, dinake interesat klasorë të borgjezisë e të reaksionit, synimet e tyre për ruajtjen e pozitave sunduese, bashkë me mentalitetet dhe prapambetjen e sé kaluarës. E me to dul-ej të ndesheshim, të luftonim, të sqaronim mendjet e zemrat e popullit për ta bërë të ndërgjegjshëm për rrugën e drejtë që duhej ndjekur.

Ishte e domosdoshme që Partia të qindfishonte luftën e përpjekjet, me qëllim që rolin e saj udhëheqës në Front e në këshillat nacionalçlirimtarë jo vetëm ta shtrinte në gjithë vendin, por, kryesorja, ta ruante e ta forconte pareshtur, të mos lejonte në asnjë mënyrë që Via rrëmbenin të tjerët. Ne e dinim mirë dhe e parashikonim se edhe ajo pjesë e reaksionit të brendshëm që ende s'qe afishuar si e tillë, do të organizohej e do të përpiqej t'i shkatërronte Frontin dhe këshillat nacionalçlirimtarë me qëllim që të sabotohej lufta e popullit për Tiri e demokraci. Merret me mend,

pra, se ç'katastrofë do të ndodhte në këto situata të reja, sikur Partia jonë, pas Konferencës së Pezës, ta quante «të kryer» detyrën e saj për Frontin e këshillat dhe, pas kësaj, forcat e veta t'i përqendronte, ta zëmë, vetëm si «forca sulmi» e «veprimi». Me Abaz Kupët e Halim Begetë jo vetëm që s'do t'u nxirrej kurrë kallaji Ali Këlcyrëve me kompani, por, përkundrazi, Balli Kombëtar që do të krijohet me tërë kriminelët dhe afendikojtë e tij, do të merrte frenat në duar dhe Partia do të ndodhej papritur përballë sulmit të organizuar e vdekjeprurës të forcave të fashizmit e të reaksionit. Qenia e Partisë në udhëheqje ishte e domosdoshme edhe për perspektivat e luftës që po organizonim me pjesëmarrjen e gjerë të masave, të punëtorëve, fshatarëve, rinisë, grave, patriotëve etj. Patriotizmi, shpirti liridashës i popullit tonë kishin qenë e ishin një faktor e forcë e madhe lëvizëse e që luante rol të madh për bashkimin e mobilizimin në luftë, por vetëm kjo tash s'mjaftonte. Duheshin llogaritur edhe elementët e kërkesat e tjera, interesat jetikë të punëtorit e të fshatarit për të ardhmen. Nëse ne do t'i siguronim, pra, se këto pas Clirimit do t'i zgjidhnim drejt e në favor të tyre, pa dyshim bashkimi do të kryhej më shpejt dhe gatishmëria për luftë do të qe më e madhe.

Elementi bazë e themelor që do t'i siguronte masat për një të ardhme të re, ndryshe nga e kaluara, ishte pikërisht qenia e Partisë Komuniste në krye të Frontit e të luftës, roli i saj udhëheqës. Në këtë çështje ne s'lejuam asnjë shkelje apo kompromis, asnjë marrëveshje apo tentativë për ndarje rolesh. Nuk duhet menduar kurrësi se kjo ishte një gjë e qartë për të gjithë e se mund të kryhej me lehtësi. Përkundrazi, vështirësitë, pengesat ishin të mëdha, sulmet, akuzat e presionet na vinin nga të gjitha anët. Jo vetëm fashistët dhe bashkëpunëtorët e tyre, Merlika me kompani, por dhe shumë nga ata që ende rrinin si «mënjanë» e pritnin të «vinte dita» (!), na akuzonin ne, Partinë tonë, ideologjinë tonë me tërë arsenalin antikomunist të përpunuar prej vitesh, Veçanërisht pas fitores që arritëm në Pezë kjo fushatë, antikomuniste -në parim» dhe kundër PKSH në praktikë, mori përmasa të egra. «Gogoli i komunizmit» vërtitej në çdo fjalim të Merlikë tradhtarit, popullit i «qahej halli» se po çoroditej nga ca «të shitur» të Moskës e të Stalini, se ne gjoja qenkëshim për prishjen e nderit, të familjes, të fesë, të vëllazërisë, të Shqipërisë etj., etj. !

Kuptohet se pse shpërtheu kjo fushatë: armiqtë tani, më tepër se kurrë i tmerronte fakti që PKSH po bëhej forca kryesore që hap pas hapi po grumbullonte rreth vetes masat, popullin e po i hidhte në luftë. Si rezultat i këtij sulmi antikomunist, pati bile edhe ndonjë nga shokët tanë (s'po flas për pseudopatriotët që ishin plotësisht në një mendje me Merlikën), i cili, si nga presioni antikomunist i reaksionit të hapur e të fshehtë, ashtu edhe nga paqartësia, mungesa e formimit ose nga bagazhe të vjetra oportuniste, «kërkoi» që të mos e afishonim emrin dhe rolin e Partisë Komuniste në masat e në Front, se gjoja kjo sillte dëme e na largonte nga populli, sidomos nga nacionalistët!

- Po si mendoni ju? - e pyeta njërin nga këta elementë. - Të fshehim faktin që Partia jonë Komuniste ekziston, që lufton, që krijoi Frontin, thirri e organizoi Konferencën e Pezës dhe është në ballë të luftës?

- Brendapërbrenda nesh, në linjë partie e të simpatizantët mund t'i përmendim këto, por në ma sat, hëpërhë, jo! - u përgjigj ai. - Të mos u japim armiqtë mundësinë të na akuzojnë e të shpifin për ne. Të qëndrojmë brenda Frontit dhe të afishojmë si udhëheqës vetëm Këshillin Antifashist.

E ndjeva se jo vetëm shoku kishte shkuar tepër larg, por edhe shokët e tjerë, megjithëse e kundër, shtuan atë, kishin nevojë për një sqarim e kuptim të thellë e të drejtë të këtij problemi, prandaj vazhdova:

- Në parim një parti komuniste në asnjë rrethanë nuk e fsheh ekzistencën e saj. Ndryshe përse u krijua, përse ekziston? Partia duhet të ruajë e të mbajë të fshehtë nga armiku mënyrën e organizimit të saj, bazat, dokumentet e brendshme, planet e aksioneve e të veprimeve, por kurrësi ekzistencën e saj, kurrësi parullat e saj kryesore për një fazë e moment të caktuar. Parulla jonë kryesore tani është: Luftë kundër pushtuesit e tradhtarëve për çlirimin e vendit! S'ka asnjë arsye pse të fshehim që jemi ne komunistët që e hodhëm të parët, e mbajmë lart dhe e zbatojmë me konsekuencë, me gjakun e shokëve tanë, këtë parullë. Nga kjo parullë lufte tremben fashistët, prej saj largohen tradhtarët, por jo populli, as nacionalistët e vërtetë. Parulla jonë tjetër është bashkimi i gjithë popullit në Frontin

Antifashist! Dhe nga kjo s'ka pse largohen as populli, as nacionalistët e vërtetë, përkundrazi, pikërisht se ne kemi në plan të parë këto parulla, ndaj na do e na afrohet populli.

Por s'janë vetëm këto arsye përse ne duhet të afishojmë emrin dhe veprën e Partisë, - vazhdova më tej. - Shikoni çfarë shpifjesh, çfarë akuzash të ndyra po derdh reaksioni kundër nesh, kundër komunizmit në tërësi. Nëse ne do të tërhiqemi, do të fshihemi, do të heshtim, vetvetiu u japim armiqve të hapur e të fshehtë satisfaksionin që ëndërrojnë, kurse njerëzit e paqartë i lëmë në mëshirën e akuzave të Musolinit e të Merlikëve. Prandaj me të gjitha mjetet, me të gjitha forcat ne, më tepër se gjer tani, duhet të sqarojmë popullin se ç'është komunizmi e ç'jemi ne komunistët, përse luftojmë, cilat janë qëndrimet tona për atdheun, për familjen, për shoqërinë, për të sotmen e për të ardhmen e vendit.

- Dakord, në popullin e thjeshtë këto kanë efekt, por nacionalistët s'do ta ndiejnë veten të sigurt, - u «mbrojt» e sulmoi prapë shoku. - Mbase duhet të kufizohemi, të paktën për sa i përket popullarizimit të Bashkimit Sovjetik.

- E përse?

- Sepse indirekt ose direkt bëjmë të kuptohet se ne jemi për rendin sovjetik, pra, që tani shprehemi për formën e regjimit të ardhshëm. Kjo është në kundërshtim me platformën e Konferencës së Pezës për këtë pikë.

- S'duhet ngatërruar e stërholluar gjërat! - i thashë. - Të popullarizosh Bashkimin Sovjetik, luftën e madhe që po zhvillon ushtria e lavdishme e Stalinit është tjetër gjë, dhe të kërkohet rendin sovjetik, është gjë tjetër. Si duket, - iu drejtova, - nuk i keni lexuar mirë artikujt që botojmë në «Zërin e popullit». Ne atje, si në gjithë propagandën tonë, as e kemi shtruar dhe as e shtrojmë tani çështjen e rendit që do të vendoset pas Çlirimit. Por Bashkimin Sovjetik, Stalinin, bolshevizmin, i mbrojmë e do t'i mbrojmë hapur, sepse armiq të i akuzojnë hapur. Ne duhet. të themi të vërtetën për këtë gjë që populli, patriotët ta dinë se përkrah tyre kanë një aleat të fuqishëm, siç është populli sovjetik i udhëhequr nga Stalini. Nga ana tjetër, - vazhdova, - ne vërtet i qëndrojmë konsekuentë platformës së Konferencës së Pezës për Luftë Antifashiste Nacionalçlirimtare, dhe ky është qëllimi ynë imediat, por asnjëherë s'duhet të harrojmë se klasat e varfra, punëtorët e fshatarët po ngrihen në këtë luftë për çlirimin e atdheut, por edhe për çlirimin e tyre nga çdo zgjedhë. Se si e kur do të arrihet kjo, është tjetër gjë. Popullit, kur të vijë koha, ne do t'i krijojmë mundësitë që të shprehet vetë lirisht për regjimin që do t'i pëlqejë. Por, si komunistë, si armiq të çdo zgjedhë, ne e kemi për detyrë që në rrugët e dhura, në përshtatje me problemin themelor të momentit, t'i përgatitim e t'i bëjmë të ndërgegjeshme masat për të zgjedhur të ardhmen më të sigurt. Ne nuk u themi atyre tani se do të zhduket prona private e klasat e pasura, si në Bashkimin Sovjetik, por, thjesht, u tregojmë si është ndërtuar jeta në Bashkimin Sovjetik, si jetojnë atje punëtorët, kolkozianët. Nga këto, - përfundova, - s'ka asgjë që del jashtë kuadrit dhe parullave të momentit. Prandaj, Partia jonë, me vijën e saj, me punën konkrete të anëtarëve të saj jo vetëm është e duhet të jetë më aktivja në Front e në luftë, por, më kryesorja, të jetë promotori i Frontit, i luftës, shpirti dhe forca e vërtetë udhëheqëse.

Në të njëjtën kohë ne bënim kujdes të madh dhe goditnim me ashpërsi çdo shfaqje të ekstremizmit e të sektarizmit, çdo kapërcim nga detyrat dhe parullat e momenteve në të cilat ndodheshim. Pasojat e qëndrimeve dhe të veprimeve të tilla, nëse ne do të tregoheshim të butë ndaj bartësve të tyre, do të ishin të hidhura e sabotuese për figurën dhe rolin e Partisë në veçanti, për punën e saj me masat në tërësi.

Për fat të keq, para një rreziku të tillë u ndodh për një moment organizata e Partisë e Tiranës menjëherë pas mbarimit të Konferencës së Pezës. Ishte koha kur Jakomoni, Merlika e reaksioni pseudopatriotik, të tërbuar nga suksesi që ne sapo arritëm në Pezë, po intensifikonin e koordinonin fushatën për të diskredituar Partinë tonë Komuniste, për ta akuzuar atë si «terroriste», «mbjellëse të përçarjes», se gjoja po e «shtynte popullin në një luftë shfarosëse», se po «prishte qetësinë», po «merrte në qafë masat e sidomos rininë» etj., etj.

Tamam në një nga këto ditë më vjen një nga kuadrot e atëhershëm të qarkorit të Tiranës (pak më pas atë, për gabime të rënda, do ta përjashtonim nga Partia), e më thotë se kishin vendosur të kryenin një aksion të madh sabotazhi, si përgjigje ndaj raprezaljeve të fashistëve.

- Në parim dakord, - i thashë. - Konkretisht, cili do të jetë ky aksion?
- Do të hedhim në erë një shkollë, - m'u përgjigj serbes-serbes shoku.
- Shkollë? Në erë? - thuajse thirra i tronditur, por për të parë se gjer ku arrinte puna, shtova me «të qetë»: - Po, po! E cila është kjo shkollë?!

- Është mu në aeroportin e Tiranës dhe ka rëndësi se një pjesë të ambienteve të saj fashistët i kanë kthyer në magazina, - më tha ai dhe po mundohej të më orientonte për pozicionin ku ndodhej shkolla.

- Në asnjë mënyrë! - e ndërpreva. – Përditë po flasim për rëndësinë e aksioneve e të sabotazheve, kurse juve ju paska shkrepur të bëni diçka që është tamam në dëm të çështjes sonë.

- Mund të ketë brenda mbi 100 metra kub dërrasë pishe, dulce llogaritur dhe bankat e dërrasat e zeza, - u përpoq të më mbushte mendjen tjetri. Lëre dëmi material, por përfytyro ç'zjarr e flakë do të shpërthejë! Do të llamburitë Tirana tërë natën dhe në popull kjo do të ketë efekt të madh!

- Po! - i thashë me Troni. - Natën do të ngrihet flaka e dërrasave, kurse në mëngjes do të shpërthejë «flaka» e Merlikëve: «Shih o popull, do të thërrasë tradhtari, ja ç'bëjnë komunistët! Po djegin shkollat e kalamanëve! Shyqyr që u bëmë pengesë ne, fashistët, se ata kishin planifikuar të përvëlonin brenda edhe nxënësit».

- Ajo është shkollë fashiste! - vazhdoi tetri në të tijën.

- E pastaj, mos fashistët do të rrinë të sqarojnë njerëzit se kush mësonte atje?! Ata do të kapen pas faktit që u dogj një shkollë e do të çirren:

«Komunistët janë kundër shkollave, kundër fëmijëve, kundër çdo gjëje të mirë...». E sheh, pra, se ç'aksion të bukur keni planifikuar të bëni! - i thashë dhe, ndërsa po vazhdoja t'i shpjegoja dëmet që do të na sillte një aksion i tillë, pashë se atë s'po e mbante vendi.

- Ç'ke? - i thashë. - S'je dakord?!

Ai heshti pakëz, përpëliti buzët dhe me gjysmë zëri shqiptoi:

- Halli është se njësitit e ka marrë urdhrin. Unë mendova se ju do të ishit dakord dhe ua aprovova planin.

- Vrapo, - i thirra, - aksioni të ndalbet menjëherë dhe të na raportoni për përfundimin.

Prita me shqetësim, por as ai s'erdhi, as flakë s'pamë të «llamburitnin» natën e Tiranës. Më pas mësuam se aksioni që bërë dhe kishte përfunduar për turp: ishte plagosur e kapur njëri nga anëtarët e njësitit e, nga kjo, armiku nisi një valë tjetër- arrestimesh e bastisjesh.

Lidhur me këtë veprim të dëmshëm, afëlrishit po në atë periudhë, u ndodhëm edhe para një veprimi tjetër të shëmtuar: më njoftojnë se dy-tre shokë të organizatës së Tiranës, midis tyre aventurierë e fraksionistë të tillë, si: Biverbruku, Fiqret Sanxh, aktari (e fejuara e aventurierit Agron Corati para se të', bëhej e fejuara dhe gruaja e Mehmet Shehut) etj., gjoja për të na «shpëtuar» nga burgu një shok të sapoarrestuar, rrëmbyen vajzën e vogël të komandantit të xhandarmërisë së Tiranës, Man Kukaleshit, dhe i dërguan të atit një pusullkë: «O shokun, o vajzën».

Kur ma thanë këtë hyner, s'desha kurrësi të besoja se një gjë e tillë mund t'i shkonte ndër rrlend një shqiptari, pale një komunisti shqiptar, por sholtët e verifikuan menjëherë dhe më siguruan se veprimi që kryer.

- Ky është aventurizëm e terrorizëm! -- thirra e brofa në këmbë. - Të lirohet menjëherë e rrëmbyera, kurse terroristët të vihen para gjylykimit të Partisë. Masa më e vogël, të flaken nga radhët tona! Kjo, nëse kanë vepruar kështu nga budallallaku, nga miopia politike e ideologjike. Por, nëse kanë vepruar për motive të tjera (dhe lkëtu kisha parasysh mundësinë e ndonjë kurthi ose lprovokacioni), gjykimi e dënimi do të jenë ndryshe.

Si rezultat i ndërhyrjes sonë të menjëhershme ky incident i shëmtuar, i vetimi i llojit edhe në historinë e armiqve tanë të brendshëm (se me këtë akt s'kishte pse të përlyhej aspak Partia), u mënjanua.

Pak ditë më pas do të mësonim se spiuni kriminel Man Kukaleshi, «kërkesës» ala terroriste të Biverbrukut e të Fiqret Sanxhaktarit për «shkëmbim» i që përgjigjur aty për aty, me një ultimatum ala fashist: «Nëse për kaç orë niuk më lironi vajzën, 10 nga shokët tuaj që kemi arres,tuar do të varen në mes të Tiranës». Dhe për të vërte-tuar se në çështje krimesh fashistët e shërbëtorët e tyre s'i

ndanin fjalët nga veprat, qysh atë ditë u dha urdhri e në qendër të Tiranës nisën të ngriheshin trekëmbëshat e zinj.

Ja, pra, se ç'pasoja të hidhura do të sillte veprimi aventuror që përmencia, nëse ne s'do ta kishim ndaluar e dënuar rreptë e menjëherë! Jo vetëm do të humbitnim jetën e 10 shokëve, por armiqve do t'u jepej një «shkak» e «argumnt» i ri, që të shpërthenin një valë tjetër terrori fasllist dhe demagogjie antikomuniste në popull! Megjithatë, edhe pse komplikacionet e mëtejshme u mënjanuan, ne e analizuam thellë e rreptë këtë rast duke theksuar se veprime e tentativa të tilla jo vetëm janë të huaja e të urryera për komunistët, por edhe shurnë dëmprurëse për unitetin e Partisë me popullin. I porositëm të gjitha celulat e njësitet guerile të ishin të matura në veprimet që bënin, ta goditnin pareshtur armikun, Via bënin ditësa më të zezë, por kurrsesi si t'i tekej e kur t'i tekej njërit apo tjetrit.

- Aksionet që bëjmë tani për tanfi në qytete, u theksova shokëve, - kanë për qëllim edhe ta dëmtojnë e t'ua bëjnë jetën të pasigurt armiqve, por kanë edhe një qëllim tjetër të madh: në to populli të shohë forcën tonë, aftësinë e guximin tonë për t'i dhënë armikut goditje edhe në çerdhet e tij më kryesore. Prandaj, aksionet, atentatet, sabotimet të jenë sa më të studiuara, sa më të matura dhe të përgatiten e të kryhen në mënyrë që të kurorëzohen vetëm me sukses. Ndryshe, pasojat, veçanërisht në popull, do të kenë efekt negativ. Ne s'duhet të lejojmë në asnjë rast që një aksion, sado dëmprurës të jetë për armikun, në të njëjtën kohë t'i japë rast këtij të flasë e të shpifë kundër Partisë sonë dhe vijës së saj.

Këto dy veprime të dëmshme që pasuan njëri-tjetrin brenda një periudhe shumë të shkurtër, si dhe fakti që po në këto momente armiku mundi të kapte disa shokë të organizatës së Partisë e të Rinisë Komuniste në Tiranë, jo vetëm që na penguan në punën e saponisur për zbatimin e vendimeve të Konferencës së Pezës, por, siq thashë, na krijuan një moment të rëndë e të mbarsur me rreziqe. Ishte e nevojshme të kapërcehej menjëherë kjo gjendje e papëlqyeshme, të evitohej qdo pasojë e dëmshme dhe të gjallërohej e të shëndoshej më tej puna e Partisë në të gjitha drejtimet.

Në një mbledhje të Komitetit Qarkor të Tiranës që organizuam ato ditë e ku diskutuam detyrat që na dëlnin për zbatimin e platformës së Konferencës së Pezës, shtrua me forcë edhe problemet që na kishin lindur dhe u bënë kritika të rrepta e u morën masat e duhura ndaj atyre që kishin gabuar*.* (Në këtë mbledhje, veç të tjerash, u vendos. që Agron Çorati, Biverbruku, Fiqret Sanxhaktari të përjashtoheshin nga Partia, si elementë grupashë e fraksionistë, si dhe për pikëpamjet e veprimet aventuriere e terroriste që kishin manifestuar. (Shih edhe: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, botim i dytë, f. 130.) Për forcimin e punës në qarkor e të krejt punës së organizatës së Tiranës, midis të tjerash vendosëm të shkarkohej sekretari organizativ i mëparshëm (pikërisht ai i «aksionit» të dërrasave, por që kishte manifestuar edhe raste të tjera gabimesh e shtrembërimesh) e në vend të tij propozova të zgjidhej shoku e bashkëluftëtari im i paharruar, punëtori komunist i orëve të para, Kozma Nushi. Po ashtu, si anëtar i qarkorit të Partisë, në vend të Misto Mames, i cili kishte rënë heroikisht në fushën e betejës në muajin gusht, u zgjodh sekretarja politike e qarkorit të Rinisë për Tiranën, Nexhmije Xhuglini.

- Ne jemi Parti e veprimit, e aksionit të pandërprerë, - u thashë shokëve, - por gjithçka ne e bëjmë me maturi, e llogaritim mirë që të kemi vetëm fitime. Të mos harrojmë se populli i ka sytë te ne. Ai nuk i beson shpifjet e akuzat e Merlikëve e të sahanlëpirësve të tjerë ndaj komunizmit e komunistëve, por merrni me mend se q'efekte negative do të shkaktonte ndonjë veprim ose qëndrim i gabuar nga ana e shokëve tanë. Jo vetëm në radhët tona s'duhet lejuar asnjë aksion i gabuar, asnjë veprim sektar e terrorist, por të hapim sytë e të ruhem nga provokatorë e provokacione që mund të kurdisin armiku e agjentët e tij.

I theksova këto, sepse na dukej i çuditshëm e i dyshimtë fakti që, qoftë aksioni i dërrasave, qoftë veprimi i rrëmbyesve të një kalamani, ndodhën njëri pas tjetrit, menjëherë pas Konferencës së Pezës dhe në kohën kur kishte shpërthyer vala e egër e terrorit dhe demagogjia fashiste kundër Partisë sonë dhe vijës së saj.

Na duhej, pra, të ishim përherë në veprim, vigjilentë e të matur, për të përballuar problemet e shumta të asaj periudhe e për të bërë që figura e Partisë sonë në popull dhe roli i saj udhëheqës të mbeteshin të pastër, të rriteshin e të forcoheshin përditë si kusht vendimtar për bashkimin e popullit e për mobilizimin e tij në luftë.

Dhe e vërteta është se emri dhe roli i Partisë u rritën pareshtur, duke fituar dashurinë e besimin e masave. Akti heroik i rënies në një betejë të përgjakshme që zgjati 6 orë, i shokëve tanë trima, Vojo Kushi, Sadik Stavaleci e Xhoxhi Martini, në tetor të atij viti i pikëlloi zemrat tona, por, në të njëjtën kohë, e ngriti më lart në ndërgjegjen e popullit emrin e Partisë e të anëtarëve të saj.

Pikërisht në këto momente e në valën e këtyre ngjarjeve na u desh të punonim për zbatimin e vendimeve të Konferencës së Pezës. Siç theksova edhe më lart, vëmendjen kryesore ne edhe pas kësaj do ta përqendronim sidomos te klasa punëtore, te fshatarësia dhe te pjesët e tyre përbërëse, gratë e rinia, të cilat përbënin bazën sociale të Frontit, natyrisht, pa lënë aspak mënjanë edhe punën me nacionalistët, me aktualët etj.

Ne vërtet theksonim se klasa punëtore dhe fshatrësia ajihnin PKSH si Partinë që shprehte e mbronte interesat e tyre, por në asnjë mënyrë s'duhet menduar se të gjitha kontingjentet e punëtorisë e të fshatarësisë ishin bërë që në ato momente të ndërgjegjshme si për rolin e Partisë, ashtu edhe të Frontit Nacionalçlirimtar. Mbetej akoma shumë e shumë për t'u bërë për afrimin dhe aktivizimin e këtyre klasave në Front e në luftë e për këtë ne qemë më se të ndërgjegjshëm.

Veganërisht në drejtim të fshatit e sidomos në disa zona të Veriut, qoftë Fronti, qoftë këshillat nacionalçlirimtarë po hynin më me vështirësi e më me zor. Pa dyshim këtu ndikonin bajraktarët dhe influenca e tyre, ndikonin prapambetja e theksuar ekonomik-shoqërore e kulturore, një sërë mentalitetesh të vjetra etj., etj., por, në të njëjtën kohë, në këtë gjendje ndikonin edhe dobësi të punës sonë e, konkretisht, të qarkorëve e të organizatave të Partisë -që vepronin në ato anë. Komiteti Qendror i Përkohshëm i Partisë, i preokupuar seriozisht për këtë gjendje, disa herë e analizoi punën e vet, të qarkorëve e të të dërguarve në këto zona, dhe dha vazhdimisht orientime e udhëzime për përmirësimin e gjallërimit e punës. Kuptohet, ne as pritnim, as mendonim që gjendja kudo të kthehej në favorin tonë për një muaj apo për gjashtë, por këmbëngulnim që punë të bëhej, të depërtonin kudo komunistët, fjala e Partisë, vendimet e Konferencës së Pezës e, bashkë me to, krisma e pushkës partizane.

Mbaj mend se në një takim me disa shokë që sapo ishin kthyer nga zonat e Veriut, ndërsa po bisedonim për rezultatet e arritura dhe për vështirësitë që paraqiteshin, njëri na thotë:

- Është e vështirë të merresh vesh për çështje politike me malësorët e zonave të thella. Injoranca e konservatorizmi janë aq të mëdha sa as të dëgjojnë se ç'u thua.

- Pa dyshim, - i thashë, - nëse verri te fshatari për të bërë «politikën e madhe», nëse zëmë dhe e futim në lloj-lloj qorrsokakësh, ai ka të drejtë të mos na dëgjojë, bile të na mbyllë derën. Tërë jetën ia kanë rrangallisur kokën me «politikë të madhe», deputetët, zyrtarët e regjimeve antipopullore, kalemxhinjtë reaksionarë e sharlatanë. Të tillë fshatari as i dëgjon, as ka pse t'i dëgjojë. Por nëse ne i ulemi këmbëkryq në vatër, nëse i flasim hapur e troç për bereqetin, për hallet, për mjerimet, për vatanin e robëruar, për maskarallëqet, për vrasjet, për grabitjet që bëjnë pushtuesit dhe njerëzit e tij, këtë fshatari s'e quan politikë, e quan bisedë për hallet e përditshme dhe do të shohësh se di të flasë për këto gjëra më mirë sesa ti. Stërhollimet politike le t'i lëmë për ata që merren me «politikë», njerëzit e thjeshtë, punëtorët e fshatarët janë për veprimin, janë për atë që u dhemb dhe dhimbja më e madhe, burimi i të gjitha dhimbjeve, task është robëria që i ka zënë atdheut frymën. Si t'ia bëjmë që ta flakim tej këtë robëri, për këtë duhet të flasim me fshatarin e me punëtorin, aty e ka ai zemrën dhe kjo zemër rreh për atë çështje për të cilën luftojmë ne!

Megjithatë, justifikime e «argumente» të tilla, që po t'i merrje për bazë do të thoshte të lidhje duart e t'i vije vizën punës, për fat të mirë, ishin të pakta e të rralla. Në çdo rast e në çdo formë që të shfaqeshin tendencat e nënvleftësimit të punës në fshat, ose në qytet, ne i kritikonim rreptë dhe fakt është se, hap pas hapi, edhe në zonat më të largëta, nisën të duken rezultatet e luftës sonë, Puna e komunistëve, e qindra patriotëve që tashmë ishin lidhur ngushtë me vijën e Partisë e me programin e Frontit, bëri që qysh në muajt e parë pas Konferencës së Pezës të rritej akoma më tepër roli dhe autoriteti i Partisë sonë Komuniste dhe të forcohej e të konsolidohej më tej bashkimi luftarak i popullit.

Muajt që kaluan hga Konferenca e Pezës vërtetuan edhe një herë drájtësinë e vijës së Partisë sonë të re, të strategjisë dhe të taktikave të saj. Rezultatet ishin të dukshme: radhët e Partisë ishin shtuar,

ndërsa në organizatën luftarake që ajo udhëhiqte, në Frontin Nacionalçlirimtar, çdo ditë e më shumë derdheshin masat e gjera popullore, punëtorët, fshatarët, intelektualët, patriotët, rinia shqiptare.

Lëvizja Nacionalçlirimtare ishte bërë tashmë një lëvizje e gjerë e masave me një bazë të fuqishme politike që ishin këshillat nacionalçlirimtarë dhe me një forcë ushtarake në rritje. Në qytete dhe në fshatra, në zonat e pushtuara dhe në ato të çliruara këshillat realizonin funksionet e tyre dhe gjithnjë e më shumë rritej autoriteti i tyre në popull. Në Jug e në Veri po përhapej zjarri i luftës së armatosur, çetat dhe njësitet partizane e guerile u digjnin tokën nën këmbë pushtuesve e tradhtarëve kuislingë. Nën goditjet e paprera ideologjike, politike e ushtarake regjimi i zi që kishin vendosur këmishëzinjtë po jetonte një krizë të thellë. Pas Vërlacit, u flak si një limon i shtrydhur xhelati Merlika, në fuqi u soll Eqrem Libohova, por as Beu i Libohovës dhe as të tjerët që do të zinin pas nuk do të mund ta futnin në limane të qeta anijen e kalbur të regjimit fashist; rreth saj ziente oqeani i luftës dhe i urrejtjes popullore.

Situata të tilla doemos e tronditën armik, in pushtues, i cili u detyrua të bënte përpjekje të dtshpëruara për ta ndryshuar situatën në favor të tij. Në këto përpjekje, përveç ndryshimit të marionetave në qeverinë dhe në administratën «shqiptare», përveç shtimit të masave ushtarake e policore, një kapitull më vete përbënte mobilizimi total dhe grumbullimi i reaksionit, sidomos i asaj pjese që deri atëherë t'alia fashiste e kishte lejuar të qëndronte në «skalica të dytë». Në këtë grumbullim, siç e kishte të qartë Partia Komuniste dhe historia e vërtetoi, do të kishte rolin e vet kryesor organizata «nacionaliste» tradhtarë e Ballit Kombëtar. Lufta jonë me këtë grupim të reaksionit do të përbënte një kapitull tjetër të përpjekjeve heroike të Partisë e të Frontit Nacionalçlirimtar të popullit shqiptar.

2. Balli i tradhtarëve

Në momentet kur ne ishim në valën e punës për vënien në jetë të vendimeve të Konferencës së Pezës, sidomos nga muaji nëntor, një numër informacionesh nga shokët e Tiranës, po edhe të rrethëve të tjera na njoftonin për lëvizje të shumta, mbledhje e takime të disa krerëve «nacionalistë», mes të cilëve shquhej Mithat Frashëri. Ishim të sigurt se diçka po përgatitej dhe porositem që të tregohet vigjilenca më e madhe e të mbaheshim në korent për çdo gjë.

Nuk vonoi shumë dhe nga fundi i nëntorit ose në fillim të dhjetorit, nëpërmjet numrit të parë të fletushkës «Lufta e çlirimit kombëtar», që ishte botuar e ishte shpërndarë «ilegalisht», mësuam lajmin për krijimin e një organizate «nacionaliste» të quajtur Balli Kombëtar. Sapo morëm njoftimin për këtë organizatë, për udhëheqësit e saj si dhe, ca më vonë, kur u njohëm me programin e saj, me «dekalogun» famëkeq, ne u bindëm se kishim të bënim me një pjellë të armikut okupator, që e lëshonte këtë «rezervë» të tij në luftë kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë, kundër Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, kundër Luftës partizane Nacionalçlirimtare.

Vetë emri i Ballit Kombëtar shpjegon gjithë planin e reaksionit feudo-borgjez të vendit dhe qëllimet e pushtuesve. «Balli» nuk është thjesht përkthimi literal i «Frontit», po kështu dhe «Kombëtar» nuk është thjesht përkthimi i fjalës «nacional». Jo, termi nuk ka karakter patriotik ose gjuhësor, por ka kuptim të thellë ideologjik. Për reaksionin «Balli» nuk do të thoshte «luftë», siç kishte kuptimin për ne «Fronti». «Balli» për ta do të thoshte «kryet», «udhëheqësja e predestinuar kombëtare», pra, bota e vjetër «e amshueme», e palëvizshme, bota konservatore me shtypës e të shtypur, bota «shqiptare kombëtare», që hedh tej dhe lufton progresin, komunizmin. Kjo ishte domethënia e Ballit Kombëtar e krijuar nga pushtuesit italianë dhe që krerët e reaksionit shqiptar nëpërmjet saj ëndërronin si të organizohej dhe të drejtohej Shqipëria e ne sërme. Fjala «luftë» nuk ekzistonte në emërtimin e kësaj organizate dhe as në brendinë e saj, pse përfaqësonte një botë në agoni që jepte shpirt. Luftë Balli do të bënte si me propagandë, ashtu edhe me armë, veçse jo kundër pushtuesit, por kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë, kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare, kundër pushtetit të ri të këshillave nacionalçlirimtarë.

Në krye të këtij grumbullimi tradhtarësh u vu Mithat Frashëri, një kryetradhtar, dhe rrotull tij elementë të tillë famëkëqij, si: Ali bej Këlcyra, Kolë Tromara, Faik Quku, Nuredin Vlora, dhe

elementë të tjerë, si: Fuat Dibra, Hasan Dosti, Lef Nosi e të tjerë, por në fakt Ballin Kombëtar e udhëhoqte Jakomoni, mëkëmbësi i mbretit Viktor Emanueli III, dhe komandanti i ushtrisë italiane në Shqipëri, gjenerali Dalmaco.

Për sa u përket fundërrinave vendase që krijuan e drejtonin këtë organizatë e që na e afishuan si «patriotike» (!), shumica ishin pikërisht ata elementë nacionalistë e pseudopatriotë me të cilët ne për mbi dy vjet rresht ishim përpjekur e kishim bërë ç'është e mundur t'i afronim me luftën, me Frontin Nacionalçlirimtar, me çështjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut.

Kur fola më lart për takimet e debatet e ashpra që patëm me ta, unë përmenda edhe diçka për karakterin e tyre, për origjinën dhe bagazhin e tyre politile e ideologjik. Por tash është vendi të ndalem diçka më gjerë në këtë aspekt, për të treguar se ç'ishin në thelb e nga vinin këta farë burrash që në fund të 1942-shit po afishoheshin si «balli», «ajka» e kombit dhe ç'mund të priste Shqipëria nga organizata e tyre, Balli Kombëtar. Pjesën më të madhe të këtyre «patriotëve të diplomuar» e përbënte karvani i elementëve «antizogistë» që, pas një azili prej pesëmbëdhjetë vjetësh në dhera të huaja, ishin kthyer në Shqipëri pas ushtrive italiane e nën mbrojtjen e bajonetave fashiste. Në të kaluarën këta kishin qenë deputetë në parlamentin shqiptar para ardhjes së qeverisë së Fan Nolit, kishin qenë të pranishëm në varrimin e Avni Rustemit dhe kishin marrë pjesë në Revolucionin e 1924-ës. Këta nuanconin në bindjet e tyre politike dhe shprehnin mendime nga më të ndryshmet në një sërë gazetash që nxirrnin në regjimin demokratik borgjez, të cilin e rrëzoi koalicioni i bejlerëve dhe i feudalëve, në krye të të cilit ishte Ahmet Zogu. Pikëpamjet demokrte të një pjese prej tyre ishin të cekëta dhe u venitën shpejt, kurse pjesa më e madhe e tyre që ishin hequr si «partizanë të Opingës», në fakt, kishin qenë mbrojtësit e agallarëve dhe të borgjezisë tregtare që po ngrihej dhe rrëmbente dulce blerë tokat e feudalëve të deklasuar. Të gjithë këta, përfshirë këtu edhe ata që hiqeshin si më «të majtë», ishin mjaft larg demokratëve revolucionarë, si Avni Rustemi, Halim Xhelo e të tjerë bij besnikë të popullit e luftëtarë konsekuentë për demokraci.

Të gjithë elementët e emigracionit «antizogist», me përjashtim të komunistëve ose «kuqalashëve», siç i quante emigracioni «antizogist e demokrat», hiqeshin si fanolistë.

Por vetë Fan Noli, shkrimtar erudit, pas dështimit të Revolucionit të 1924-ës, shkoi andej-këndej, vizitoi Bashkimin Sovjetik, foli dhe shkroi mirë për të, qëndroi në Gjermani, shkroi vjersha të bukura e të Pjesën më të madhe të këtyre «patriotëve të diplomuar» e përbënte karvani i elementëve «antizogistë» që, pas një azili prej pesëmbëdhjetë vjetësh në dhera të huaja, ishin kthyer në Shqipëri pas ushtrive italiane e nën mbrojtjen e bajonetave fashiste. Në të kaluarën këta kishin qenë deputetë në parlamentin shqiptar para ardhjes së qeverisë së Fan Nolit, kishin qenë të pranishëm në varrimin e Avni Rustemit dhe kishin marrë pjesë në Revolucionin e 1924-ës. Këta nuanconin në bindjet e tyre politike dhe shprehnin mendime nga më të ndryshmet në një sërë gazetash që nxirrnin në regjimin demokratik borgjez, të cilin e rrëzoi koalicioni i bejlerëve dhe i feudalëve, në krye të të cilit ishte Ahmet Zogu. Pikëpamjet demokrte të një pjese prej tyre ishin të cekëta dhe u venitën shpejt, kurse pjesa më e madhe e tyre që ishin hequr si «partizanë të Opingës», në fakt, kishin qenë mbrojtësit e agallarëve dhe të borgjezisë tregtare që po ngrihej dhe rrëmbente dulce blerë tokat e feudalëve të deklasuar. Të gjithë këta, përfshirë këtu edhe ata që hiqeshin si më «të majtë», ishin mjaft larg demokratëve revolucionarë, si Avni Rustemi, Halim Xhelo e të tjerë bij besnikë të popullit e luftëtarë konsekuentë për demokraci.

Të gjithë elementët e emigracionit «antizogist», me përjashtim të komunistëve ose «kuqalashëve», siç i quante emigracioni «antizogist e demokrat», hiqeshin si fanolistë.

Por vetë Fan Noli, shkrimtar erudit, pas dështimit të Revolucionit të 1924-ës, shkoi andej-këndej, vizitoi Bashkimin Sovjetik, foli dhe shkroi mirë për të, qëndroi në Gjermani, shkroi vjersha të bukura e të «akademike» për problemet ndërkombëtare që shoqëroheshin nga disa të shara për Zogun. Kur mbaronte rezerva e fjalëve dhe shteronte fryma «opozitare», fillonte pokeri, brixhi dhe secili përpiquej kush e kush t'i grabiste paret tjetrit në kumar.

Krerët, natyrisht, bënë politikën e parave, i ndanin ato edhe sipas urdhrave të qendrës nga i merrnin, por edhe sipas simpatisë personale. Disa nga ata e kishin xhepin plot, por kishte edhe nga ata që, për ditë të tëra, nuk kishin të hanin. Kjo, pa dyshim, krijonte edhe zënka në mes grupeve të

të njëjtit grazhd e të së njëjtës kafene. Me siguri kishte edhe nga ata që hanin në më tepër se në një grazhd, dilnin mbi ujë dhe, kur e pyetnin se ku i gjente këto para, përgjigjej : «I fitova në bakara». Kurse, në fakt, ai ishte bërë spiun i agjenturave të ndryshme.

Këto nuk janë të ekzagjeruara. Kur isha student në Francë, qoftë kur vija për pushime në Shqipëri, qoftë kur kthehesha, ndaloja si në Bari, ku merrja vaporin, ashtu edhe në Paris. Gjatë këtyre ndalesave tranzit më ka rastisur të jem dëshmitar okular i jetës së tyre. Kam qenë disa herë, bie fjala, në kafe «Stopani» në Bari, që ishte ndër kafenetë me «nam» të këtij emigracioni, ku mblidheshin «onorevolet», ish-deputetët dhe pjesëtarë të tjerë të «opozitës zogiste», si Bahri Omari, Sheh Karbunara, Muharrem Vllamasi, Qamil Çela që e mbanin si «kuqalash», një oficer i quajtur Lekë Margjini e të tjerë si këta. Kishte në Bari edhe të tjerë emigrantë që vinin rrotull, por këta ishin kryesorët, «epigonët e politikës antizogiste» dhe kafe «Stopani» ishte «parlamenti» i tyre. Këtyre «onorevoleve» qeveria italiane, gjoja për t'u siguruar jetën, u kishte vënë hapur edhe nga një polic zyrtar, përveç të tjerëve, që u vinin nga pas si hije. Kur kaloja në Bari rrugës nga Shqipëria për në Francë, ata më pyetnin: «C'kemi andej, ç'bëhet? E duan apo s'e duan Zogun? Kur do të vdesë ky?» e plot pyetje të tjera si këto. Asnjëherë nuk mbaj mend të më pyetnin për hallet e popullit, të punëtorëve e të fshatarëve, të revoltoheshin për grabitjen dhe shfrytëzimin e tyre. Kur unë u flisja për këto gjëra, më dëgjonin me indiferencë, sepse për këta «partizanë të Opingës» nuk kishte rëndësi gjendja e masave, lëvizjet e tyre; për ta ishte lajm i mirë po t'u thoshe se Zogu ka qenë sëmurë, se u dukej se hapej rruga që të merrnin pushtetin në Shqipëri.

Në kafe «Stopani» bëhej politikë «e madhe». Në bisedat e tyre shfaqeshin edhe prirjet e simpatitë e secilit. Sheh Karbunara, për shembull, siç dukej, hante bukën e Italisë, por admirim të veçantë kishte për «inglizin». Shehu që i gjallë në bisedë, binte në sy dhe me të folurit e tij në dialektin e Myzeqesë dhe me të qeshurit e hapët. Ishte i zgjuar dhe dinak, po nuk kishte asnjë çikë kulturë. Ai priste Bahri Omarin t'i lexonte gazetën, sepse ky dinte disa gjuhë, të Lindjes dhe të Perëndimit. Megjithëkëtë, kultura e Bahriut ishte «pak nga të gjitha» dhe e pathelluar. Në pikëpamjet politike e hiqte veten si radikal socialist dhe kjo sepse kishte një admirim të madh për Eduard Herionë, një nga liderët e radikal-socialistëve francezë. «Le Temps», një gazetë liberale me mjaft influencë në Francën e asaj kohe, që burimi i informacionit dhe i interpretimeve të Bahriut. Sheh Karbunara dhe të tjerë e pritnin në kafe «Stopani», me gazetën «Le Temps» përpara.

– Hë, lexoje! - i thoshte Shehu.

- Dale, - i thoshte Bahriu, - të pi një kafe

alla panna' - dhe pastaj fillonte lexonte shkarazi titujt dhe u thoshte nga disa fjalë për lajmet ose artikujt e gazetës.

Kurse Shehu nuk mungonte t'i thoshte:

- Mirë, mirë, po shih ç'mendon inglizi për këtë problem, pa lëri të tjerët. Inglizi llogaritet.

Në bisedat e tyre hiqeshin si antizogistë e, si rrje

dhim, me zë të ulët thoshin edhe ndonjë fjalë kundër Musolinit, kurse Zogun e «bombardonin» me fjalë, por Zogu as çante kokën fare për ta, jo vetëm s'ua kishte frikën, por i injoronte se e dinte se rreziku nuk vinte nga këta.

Kur kthehesha nga Franca për të shkuar në Shqi

përi i pyesja «onorevolet»: «Q'kemi nga Shqipëria?». Por asgjë për të qenë nuk mësoja nga ata veç thashethemeve e kronikave skandaloze të regjimit.

Mbjaj mend, njëherë i gjeta në humor të madh.

- Punët shkojnë birinxhi! - më thonë.

- Cfarë ka ngjarë? - i pyes.

- Zogu, - thotë Shehu, - është duke vdekur.

Kemi lajme të sigurta se ka kancer dhe dy doktorë të mëdhenj kanë shkuar nga Vjena ta ekzaminojnë.

- Or baba Sheh, - i them, - kemi ndonjë or ganizim nga brenda Via ngremë këmbët, pa lëre
1 Italisht - me ajkë qumështi.

- këtër

Shehu më pa né sy dhe tha:

- Po... edhe kemi, por ju kuqalashët të tëra do

ri Vi dini dhe neve ato tuajat na i fshihni! - dhe shihte nga Qamil Cela që e mbanin si komunist.

Këtyre pseudopolitikanëve, këtyre përkrahësve të borgjezisë tregtare dhe agallarëve, urrejtja për komunizmin u ishte futur në gjak dhe këtë e treguan edhe më vonë. Sa për organizimin brenda vendit nga ana e tyre, ky le që nuk ekzistonte, por këta asnjë gazetë, broshurë, bile asnjë fije trakti nuk kishin futur në Shqipëri. «Aktiviteti» i tyre nuk mund të krahasohej, j o më me veprimtarinë e militantëve komunistë e revolucionarë, si: Ali Kelmendi, Halim Xhelo e Riza Cerova, që punonin jashtë, por hynin edhe në Shqipëri. legalisht apo ilegalisht, e punonin nën kërcënimin e burgosjes, internimit e vrasjes, por as me atë të elementëve demokratë të emigracionit, si Omer Nishani apo vetë Fan Noli, dishepuj të të cilit hiqeshin ata. Po për çfarë organizimi mund të pretendonin klientët «Stopanit», kur lidhjet e tyre me vendin ishin inekzistente? Askush nuk i kujtonte këta në Shqipëri, veç disa të njohurve të dikurshëm, njerëz të borgjezisë. agallarë, nëpunës të lartë apo disa intelektualë të vjetër.

Këta të fundit e kishin parë më të leverdishme të pajtoheshin me Zogun, sesa të sorollateshin qyteteve të Evropës, i qenë nënshtruar regjimit, rronin dhe zhvillonin veprimtarinë e tyre nën hijen e Krosëve dhe ministrave të Zogut, kishin marrë edhe ndonjë post në kryeqytet apo si prefektë nëpër krahina. Të tillë ishin Skënder Pojanët, Reiz Selfot, Vehip Runët, Qemal Vrionët e shumë si këta. Edhe opinionet e tyre tashmë qenë unifikuar, ishin bërë zogistë të bindur, megjithëse disa hiqeshin si apolitikë, disa si neutralë, por, kur dilnin jashtë, sidomos në Itali, se atje u binte rruga më shumë për allishverishe dhe për tregti, nuk i harronin miqtë e vjetër. Vinin i takonin në kafe «Stopani», bënë ca llogje me ta, u hiqeshin si demokratë, u thoshin disa kronika të zeza të regjimit dhe, si «miq e të njohur», u futnin në xhep ndonjë ndihmë në të holla.

Lidhjet e «politikanëve» emigrantë me Shqipërinë, pra, realizoheshin nëpërmjet njerëzve të regjimit zogist që shkonin jashtë, nëpërmjet zyrtarëve, tregtarëve të mëdhenj, latifondistëve e agallarëve dhe këto farë lidhjesh mbaheshin jo për të konspiruar apo për të bërë diçka kundër regjimit, por për të marrë ndonjë ndihmë ekonomike dhe për të gënjyer veten e për të mos thënë që i kishin këputur lidhjet me Shqipërinë. Kjo nuk qe për t'u çuditur. Edhe në kohën e qeverisë së Fan Nolit, kur këta ishin pjesëtarë të saj ose të zgjedhur si deputetë, lidhjet e tyre i kishin jo me masën e popullit, por kryesisht me parinë liberale të qytetit dhe deri diku me atë të fshatit. Me këtë të fundit i lidhte jo ideja e përparimit të Shqipërisë, por ishin lidhjet fisnore, krushqitë, miqësitë e rastit, që gjenin zhvillim të gjerë në jetën shoqërore të asaj kohe.

Një grup tjetër të kësaj kategorie të emigracionit politik përbënin «demokratët antizogistë» të Parisit. Këtu bënë pjesë Ali Këlcyra, Kolë Tromara, Qazim Koculi, Sejfi Vllamasi, Rexhep Mitrovica e të tjerë, por Tromara, Ali Beu, Koculi e Mitrovica hiqeshin si kapot. Në fakt asnjëri nuk e njihje tjetrin për udhëheqës, sepse të gjithë «udhëhiqnin», por këta ishin udhëheqës të erës, komandantë pa ushtarë.

Nuk kam pasur rastin t'i njoh mirë këta se isha një student i lënë pa bursë e pa para, mezi përballoja shpenzimet për ushqim, për fjetje dhe rrallë e tek më dilte të veja në ndonjë muze, në ndonjë shfaqje a për të pirë një filxharl kafe. Herë më dërgonte plaku ndonjë napolon, ngarljëherë më jepnin ndonjë monedhë shokët, ca kohë gjeta vend dhe jepja mësim shqip me disa franga orën. Per aq pak sa i njoha dhe me ç'dëgjoja nga shqiptarë të tjerë, ata e kalonin kohën në kafene, në klubet e kumarit, duke bërë sehir në garat e vrapimeve me huaj, në kinema etj. Dukej që kishin para boll.

- Ku i gjejnë, mor Remzi? - e pyesja Remzi Ficon, një student në mjekësi që e njihje Kolë Tromarën.

- Marrin pale të mëdha nga qeveria franceze si politikanë që janë, - më thoshte Remziu.

Qendrat e tyl'e qenë «La Coupole», «La Source» dhe kafene të tjera me nam. Atje luhej edhe kumari, bëhej politika, «rfëzohej Zogu», «ngrihej populli shqiptar», ndaheshin edhe frangat e dollarët që ua siguronin rruga e tradhtisë ku qenë futur. «Antizogistët» e kafe «Stopanit» ishin në

marrëdhënie të mira me këtë grup, ndërsa grirdeshin me grupin e Mustafa Merlikës që e mbante Musolini në Dalmaci dhe e stërviste për planet e ardhshme të pushtimit.

Me t'u futur Italia fashiste në Shqipëri, të gjithë këta u kthyen nga kafehanet e Evropës. Natyrisht, u çmallën me miqtë e tyre, vendosën lidhje politike me «antizogistët» e tjerë që ishin brenda apo ishin kthyer më parë. Këta të ashtuquajtur demokratë antizogistë tash, me pushtirnin e vendit, ose mbanin vendet që kishin pasur në kohën e Zogut, ose ishin ngritur në «rytbe» dhe me ndihmën e fashizmit po pasuroheshin më shumë në kurriz të popullit.

Patriotët e shquar» të kthyer nga Evropa tatonin terrenin, nuhatnin nga vinte dhe si vinte lireta, tatonin kuislingët, hierarkët fashistë italianë dhe shqiptarë, hiqeshin si njerëz të «panjollosur» politikisht, si «njerëz dhe politikanë të zotë», si «njerëz që kishin bërë sakrifica për këtë popull» dulce «u dergjur» në dhe të huaj, prandaj tash «që u bë deti kos» këtyre u duhej dhënë jo luga, por luharja. Ata u instaluan me banesa, rroga u vazhdonte, por se në ç'rrugë, nuk dihej. Pushtuesit i interesonte që kjo rrogë të legalizohej, por «baballarët» rezistonin në këtë drejtim se kjo do të thoshte që këta pseudopatriotë të komprometoheshin në popull, të futeshin në valle. Por Italia fashiste do t'i lejonte këta ta ruanin maskën për aq sa i interesonte asaj, sepse në planet e veta për pushtimin e Shqipërisë, kishte llogaritur edhe rolin e krerëve reaksionarë të emigracionit politik. Jo më kot «mikja e madhe» e Zogut kishte punuar me kohë për organizimin e tyre, i kishte mbajtur dhe i kishte subvencionuar, gjoja në mënyrë sekrete, sepse Zogu nuk guxonte të pipërinte. Fashizmi këta i kishte konsideruar dhe do t'i përdorte si rezervë për sundimin e Shqipërisë dhe ishin një kartë e rëndësishme në lojën italiane të «çlirimit të Shqipërisë nga Zogu». Këta elementë qenë bërë marioneta, dhe, si të tillë, askush nuk do t'i pyeste se ç'rol do të luanin në mizanskenën e përgatitur. Dhe fashizmi i ndau rolet mes taborit të këtij farë emigracioni politik. Një pjesë të tyre, si Mustafa Krujën e ca të tjerë, i përdori drejtpërdrejt për të qeverisur «koloninë e vet» dhe pjesën tjetër e mbante rezervë.

Italia fashiste jo se nuk kishte nevojë për ta, por e dinte se nuk mund t'i përdorte përpara Vërlacëve Mustafa Merlikës, Eqrem bej Libohovës, Maliq Bushatit e të tjerëve. Këta ishin «violinat e para», të tjerët duhej t'u nënshtroheshin regjimit kuisling e pushtuesit dhe të punonin për ta, bile, fillimisht qoftë edhe duke derdhur ndonjë pikë lot për Shqipërinë e shqiptarizëmën. E tëra kjo ishte një lojë marionetash, por që Italia zaptuese nuk e kishte inskenuar kot. Kështu, këta pseudopatriotë, pseudodemokratë dhe fashistë u futën në vallen e pushtuesve fashistë italianë. Një pjesë u fut në «Këshillin e shtetit», i krijuar apostafat për ta, të tjerët, siç thashë, u bënë federalë, disa të tjerë merrnin «pensione» e ryshfete, pa zënë poste të caktuara në mënyrë që ta ruanin edhe ca kohë namiri e «patriotit të panjollosur», por duke bërë akoma një propagandë të maskuar kundër rezistencës së popullit. Elementët e kësaj pjese të lënë hëpërhë në rezervë ishin të lidhur ngushtë me Italinë fashiste, por roli i tyre ishte të zhvillonin një veprimtari subversive në luftën e popullit shqiptar, të bashkërendonin demagogjinë e tyre me kërbacin që mbante haptas në dorë Mustafa Merlika. Misioni i tyre ishte të lidhnin sa më shumë njerëz pas qerres së fashizmit, me gënjeshtër e me kërcënime, të bënin për vete fshatarësinë dhe intelektualët. Kjo veprimtari e tyre e rrezikshme, në fund të fundit, pati rezultate sidomos në elementët e lëkundshëm e frikacakë. Pra, fashizmi pushtues, për të shtypur popullin dhe luftën e tij, punonte me të dyja anët: me anën e qeveritarëve hierarkë shqiptarë të afishuar dhe të vendosur nëpër funksione nga ku ushtronin shtypjen e shfrytëzimin e popullit, dhe me anën e pseudopatriotëve, pseudodemokratëve, zogistëve, gjoja të rënë në fatkeqësi. Këta të fundit ishin «politikanët» e kafenesë «Kursal», të klubeve ku luhej kumari, si klubi «Savoja» e të tjera lokale famëkëqija.

Agjencia fashiste, që ishte kudo dhe regjistronte çdo gjë, bënte një sy qorr dhe një vesh shurdh, kur ndonjëri nga këta «politikanë» lëshonte ndonjë «kritikë» kundër personave në fuqi dhe kundër regjimit fashist në vend. Të gjithë këta përbënin një llum të ndotur, që zor se mund të nxirrej andej një «peshk» sado i vogël, por i pamolepsur.

Natyrisht, përveç njohjes që kishim nga periudha para pushtimit, një mendim më të saktë e më të plotë për ta ne e krijuam gjatë përpjekjeve të shumta që bëmë për ta «ndezur» patriotizmin e tyre, pra, për t'i bashkuar me luftën, me Frontin, me çështjen e madhe të atdheut. Por ata, siç shkrova

hollësisht më lart, fillimisht na dekonsideronin, bile-bile jepnin të kuptonim, sikur mezi begenisnin të bisedonin me ne «të rinjtë», «kuqalashët e papërmbajtur». Dy ishin arsyet kryesore të këtij qëndrimi të tyre ndaj nesh, në fazën e parë të kontakteve me ta:

Së pari, te këta «nacionalistë-demokratë», që hanin në grazhdin e fashizmit, që nuk ishin as nacionalistë, as demokratë, dominonte ideja se ishin më «të zotët», ishin «politikanë të sprovuar», se «ata i donte dhe i respektonte populli» dhe, pra, mendonin se ishin të destinuar që në një moment të favorshëm të merrnin fuqinë dhe të qeverisnin vendin. Kështu, me këtë delir iluziv e absurd që kishin për veten e tyre, ata s'mund të mendonin, pale të pranonin se koha e tyre kishte mbaruar e se tash, nga radhët e vegjëlisë, po dilnin njerëz të rinj, të gatshëm për të marrë përsipër fatet e atdheut. Së dyti, qëndrimin «mospërfillës» ndaj nesh në këtë fazë të parë të luftës, atyre ua diktonte pushtuesi fashist dhe reaksioni i hapur me qëllim që ne, «të rinjtë» të stepeshim para «arsyetimeve të tyre të thella», të dekurajoheshim, pra, të «mblidhnim mendjen», siç na këshillonin ata, të pajtoheshim me gjendjen dhe, duke e gëlltatur fatkeqësinë e atdheut, «të gëzonim të mirat e rendit fashist»!

Por, të mësuar vite të tëra me llogje e ëndrra kafenesh, llogaritë e tyre shkonin edhe më larg: për ta pushtimi i vendit nga Italia fashiste ishte një fenomen kalimtar për Shqipërinë dhe mendonin që, edhe kur të ikte, «prapë do ta kemi si mbështetje, në rast se nuk i biem në qafë, siç po bëjnë këta kalamanë». Mendimet e tyre shtriheshin edhe më tej: «Po ta zërë vendin e Italisë Gjermania naziste, ca më mirë, edhe ajo do të na ndihmojë; nga ana tjetër, po të thyhen që të dyja, si Italia dhe Gjermania, atëherë Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të fitojnë, ato do të bëjnë ligjin dhe në këtë rast ne do të jemi më të fituar».

Këto pikëpamje të rrezikshme dhe interesat e tyre ekonomikë e politikë i bënin ata të shihnin me tmerr luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesit, për të cilën ne bënim thirrje e përpjekje. Ata në asnjë mënyrë nuk donin të luftohej kundër pushtuesit fashist, prandaj bënë çmos e përdornin çdo mjet që ta mbytnin revolucionin që në vezë.

Natyrisht, ne vazhduam punën tonë, pavarësisht nga «deksideratat», «thumbat» e «aman»-et e këtyre pleqve të mbrehur në parmendën e fashistëve dhe do të shihnim gjithë metamorfozat e tyre, të cilat dukeshin si qesharake, por në fakt ishin të komanduara. Kur panë se, për çudinë e tyre, ne po merrnim vërtet frenat e luftës në dorë, u detyruan dhe u urdhëruan që të vinin vetë e të na kërkonin, të na mbushnin mendjen të mos ecnim më tej «në aventurizëm» që kishim zënë «për hatër të së mjerës Shqipëri». Ne u thamë përsëri fjalën tonë, bile me shumë durim e urtësi dhe vazhduam rrugën tonë.

Por kur të gjitha këto marifete e përpjekje të tyre për të na «zbutur» s'pinë ujë, kur ne organizuam Konferencën e Pezës dhe arritëm njërën fitore pas tjetrës, atëherë «baballarët e kombit» morën urdhër të ndërronin menjëherë taktikat: lindi, ose më saktë, u prodhua në ofiçinat e Luogotenencës famëkeqi Balli Kombëtar. si kundërpeshë ndaj Frontit Nacionalçlirimtar, ndaj këshillave e Luftës Nacionalçlirimtare që udhëhiqte Partia jonë Komuniste.

Pikërisht për këtë problem, rreth dy vjet më vonë, kur ne ndodheshim në pragun e Çlirimit të Shqipërisë dhe në luftë e sipër po laheshin përfundimisht llogaritë me pushtuesit dhe me krejt reaksionin e brendshëm, do të dëgjonim, midis shumë e shumë të tjerash, edhe këtë paradoks absurd:

Balli Kombëtar na paskësh lindur si rezultat i punës goja të pamjaftueshme të PKSH (!), bile-bile, si pasojë e një qëndrimi sektar që ne paskëshim mbajtur ndaj atyre elementëve që më pas do të bëheshin krerë të Ballit (!).

Tamam këtë «xhevahir», që fillimisht e kishim dëgjuar nga goja e Tempos në marsin e 1943-shit në Labinot, na e lëshoi në Odriçan e, më pas në Berat, edhe i dërguari tjetër i Titos, Velimir Stoiniçi, dhe shpejt e shpejt e bënë të vetën e u munduan ta «argumentonin» Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe e të tjerë.

- Kë quani sektarizëm?! - i kundërshtova me zemërim e tronditje bashkë. - Faktin që ne, të gjithë pa përjashtim, kemi zhvilluar takime pas takimesh, shpesh me net e ditë të tëra me të gjitha ato

fundërrina të historisë e të patriotizmit? Faktin që i kemi dëgjuar e duruar edhe kur meritonin t'u thoshim «sikter» për insinuatat e akuzat e pështira që na bënin?!

- Po atëherë pse s'erdhën me ju, po u organizuan e dolën si organizatë më vete? - deshi të më «kapte» Stoiniçi dhe vazhdoi: - Ç'i shtyu në krahun e djathtë? Pse iu kundërvunë Frontit dhe Partisë?

- Mund t'ju përgjigjem, - i thashë, - por më përpara mirë do të që të dëgjonim mendimin tuaj, si më me eksperiencë që jeni: përse Mihajloviçët, ustashët, qetnikët e turli mostrash të tilla, u bënë armiq të Frontit Nacionalçlirimtar e të PK të Jugosllavisë? Ç'i hoqi ata nga krahët e «patriotizmit» dhe i hodhi në të djathtën?

Stoiniçi më mbërtheu sytë me një tendosje prej të trulllosuri. Nuk ishin thjesht zemërimi e ironia e fjalëve të mia që e stepën. Nuk dinte nga të dilte. Në krah u mundua t'i dilte Sejfullai:

- Çdo problem konkret duhet parë e analizuar në kushtet e rrethanat konkrete të secilit vend. Tjetër është Jugosllavia, tjetër Shqipëria. Fjalën e kishim për te ne...

- E njoh këtë parim të marksizmit, - ia ktheva Sejfullait, - por ju, të paktën në rastin konkret, po bëni sofizma. Megjithëse nuk i kam njohur nga afër as kushtet konkrete të Jugosllavisë, as punën e PKJ me elementët «nacionalistë» e të tjerë, në parim mund t'ju them me bindje: po ata faktorë, po ato kushte, po ato forca sociale, diktate, interesa që lindën në Jugosllavi çetnikët e ustashët, ose në Greqi zervistët, lindën e krijuan në Shqipëri ballistët! Megjithatë nuk dua të hyj në përvojën e të tjerëve, sepse nuk e njoh nga afër. Por një gjë e afirmoj me bindje: Partia jonë veprroi ndaj elementëve nacionalistë me pjekurinë më të maghe. Mund të ketë pasur, në marrëdhëniet e në punën tonë me ta, në fazën para se të dilnin si organizatë, edhe iluzione, edhe dëshira të tepruara, edhe ndonjë farë mbivlerësimi ndaj ndonjërit prej tyre, por sektarizëm në asnjë mënyrë jo!

Pa qenë nevoja të zgjatem në këto debate të gjata të atyre ditëve të vështira (shumë prej tyre i kam përmendur më hollësisht te libri «Titistët»), këtë fragment të vjeshtës 1944 më tepër e solla për ta ballafaquar me kohën e situatën konkrete që i referohej, pra, me periudhën kur sapo doli në skenë Balli Kombëtar, në fundin e vitit 1942. Nga ky ballafaqim, midis akuzës titiste për «sektarizëm» dhe qëndrimin tonë konkret, kushdo, edhe më i keqinformuari, edhe më keqdashësi, e sheh qartë se ç'qëndrim të drejtë, ç'punë e përpjekje të mëdha bëme me turlinë e pseudopatriotëve, ç'urtësi e durim treguam me ta për t'u mbushur mendjen të hidheshin në luftë, bashkë me popullin. Dhe të mos harrojmë: më sipër unë përmenda kryesisht ato përpjekje, takime e debate (natyrisht, jo të gjitha e jo në krejt detajet), që më takoi të bëja unë personalisht me nacionalistët. Por sa e sa takime të tilla zhvilluan me elementë të tillë shokë të tjerë të Komitetit Qendror, të komiteteve qarkore, kuadro e komunistë, patriotë të ndershëm e revolucionarë anembanë vendit!

Balli Kombëtar, pra, doli në skenë jo për fajin apo shkakun e punës sonë me ta, por për «fajin» se në skenën e historisë, shumë më përpara, kishte dalë PKSH me një vijë të drejtë, me një program të qartë, me vullnet, vendosmëri e aftësi për të hyrë në masat e për t'i bërë ato për vete. Po të mos kishte ekzistuar Partia jonë, po të mos qenë arritur ato suksese që arritëm në më pak se një vit jetë e veprimtari, pra, po që se ne do të kishim heshtur, atëherë po, ndoshta reaksioni s'do ta kishte bërë përpjekjen për t'u grumbulluar e për t'u organizuar! Shkurt, ata dolën si reaksion jo kundër pushtesit, por si reaksion kundër nesh, kundër PKSH, kundër Frontit Nacionalçlirimtar dhe këshillave nacionalçlirimtarë, kundër çetave, njësiteve e reparteve partizane që po mbushnin vendin. Për këtë «zhvillim» të reaksionit ne ishim të qartë qysh në fillim, bile edhe më parë se të mësonim krijimin e Ballit kishim diskutuar dhe i kishim parasysh mundësitë e një organizimi të reaksionit pseudopatriot për të na u kundërvënë.

Tani na duhej të përcaktonim e të mbanim një qëndrim të tillë, të matur, vigjilent e të drejtë, në sajë të të cilit të bënim që çështja jonë të ecte sa më përpara, drejt fitores, pavarësisht nga organizimet e grupimet që po merrte e mund të ndërronte në të ardhmen reaksioni i brendshëm.

Është meritë e Partisë sonë se edhe këtë detyrë të vështirë e tepër komplekse e kreu me nder, pa lejuar të bihej as në sektarizëm, as në oportunizëm e, si pasojë e kësaj, të arrihej në zgjidhje e në rezultate të tilla, të cilat ishin më të mundshmet e më të pranueshmet për vitet e luftës, por, mbi të

gjitha, zgjidhje që ishin shpëtimtare për të ardhmen e atdheut, të popullit e të socializmit në Shqipëri.

Puna e Partisë sonë edhe për këtë problem, përbën një përvojë të pasur, me vlera e rëndësi shumë të madhe politike e ideologjike. Historia për këtë përvojë e ka thënë fjalën e saj, unë vetë shumë herë, qysh nga ajo periudhë e gjer më sot, shpesh kam shkruar e kam folur për atë luftë të ashpër, komplekse, por me të vërtetë shpëtimtare, që na u desh të zhvillonim krahas luftës kundër pushtuesit.

Në radhë të parë, të ndërgjegjshëm që në fillim se reaksioni po organizohej jo kundër pushtuesit, por kundër nesh, të bindur se ai po të bënte ndonjëherë luftë me armë, këtë do ta bënte vetëm kundër PKSH, Frontit, ushtrisë e këshillave nacionalçlirimtarë (edhe kjo ndodhi), ne përcaktuam e zbatuam ndaj organizmave të reaksionit një vijë dhe taktika të tilla, të cilat bëjnë të mundur që të evitohet lufta vëllavrasëse në radhët e popullit shqiptar, të evitohet përçarja e çoroditja e bashkimit patriotik të masave.

Së dyti, duke e detyruar reaksionin që ato duar, të cilat i mbante lidhur ndaj pushtuesit, të mos i hapte (sa të qe e mundur më gjatë), as kundër Partisë e popullit, ne, në të njëjtën kohë, nuk lejuam asnjë çast që për hatër të «qetësisë midis nesh» të zbehej apo të cenohej sadopak Lufta Nacionalçlirimtare e popullit, roli udhëheqës i Partisë në Front, në këshillat, në Ushtrinë Nacionalçlirimtare; nuk lejuam të devijohet nga programi i Partisë, nuk pranuan e nuk bëmë, pra, asnjë bashkim apo «vëllazërim» oportunist, socialdemokrat etj., as me Ballin, as me këdo tjetër.

Së treti, në sajë të vijës së drejtë, as sektare, por as oportuniste ndaj reaksionit e në rastin konkret ndaj Ballit, ne arritëm të bënim diferencimin e madh e të thellë në radhët e tij : të mënjanonim e të shpëtonim të gënjyerit duke i hedhur në anën tonë; të neutralizonim e të mënjanonim nga përpjekja me ne ata të parimit «as andej, as këtej»; dhe të evidencionim e të nxirrnim lakuriq para popullit figurën e urreyer dhe veprën kundërrevolucionare të krerëve tradhtarë të reaksionit. Dhe, kur punët arritën në atë fazë që ne kishim në duar një bagazh të tërë faktesh demaskuese nga veprimtaria e këtyre kolaboracionistëve të pushtuesit e kur ata ishin diskredituar në sytë e masave, vetë tradhtia e tyre do t'i detyronte të luanin aktin final: të mbetur një grusht fundërrinash, pa asnjë përkrahje e shpresë, pa asnjë bazë në popull, u hodhën hapur përkrah reparteve naziste kundër forcave tona partizane edhe kundër popullit të ngritur në kryengritjen e përgjithshme.

Tashmë diferencimin e qoi gjer në fund lufta me armë. Çlirimi i atdheut nga pushtuesit nazifashistë përkoj kështu, në sajë të vijës së ndjekur nga Partia jonë, edhe me zhdukjen nga skena e jetës shqiptare të të gjithë këtyre kriminelëve, ish-përfaqësues të klasave shfrytëzuese. Qe arritur një rezultat final: Lufta Nacionalçlirimtare ishte shndërruar në revolucion popullor dhe po shkonte drejt kurorëzimit.

Pikërisht këtu, te kjo përvojë e veçantë e Partisë sonë për të përballuar e për të shpartalluar reaksionin, qëndron një ndër meritat më të mëdha të Partisë Komuniste të Shqipërisë, meritë që pati reperkusione të thella e vendimtare si për zhvillimin e luftës, ashtu edhe për të ardhmen e sigurt të revolucionit në Shqipëri.

Si munda, pra, PKSH që në ato vite të vështira të përcaktonte e të zbatonte edhe një vijë të tillë shpëtimtare ndaj reaksionit të brendshëm, ndaj organizmave e grupimeve të tij kundërrevolucionare?!

Mbi të gjitha, në këtë vijë e në rezultatet e më dha që u arritën ne na çoi mbështetja në një politikë të drejtë e konsekuente, e cila si kryefjalë të saj, nga fillimi në fund, kishte: luftë e pamëshirshme, pa kompromis kundër pushtuesit të huaj e bashkëpunëtorëve të tij, bashkimi i gjithë forcave vitale të kombit në këtë luftë për jetë a vdekje!

Pikërisht me këtë kryefjalë e pritëm edhe daljen në skenë të Ballit Kombëtar e me këtë do ta mbërthenim atë me shpatulla për muri gjer në fund, gjer në shkatërrimin e degjenerimin e tij të plotë.

Kështu, pasi morëm vesh krijimin e Ballit Kombëtar dhe pasi u njohëm edhe me të ashtuquajturin dekalog të tij, ku Balli shpallte programin e vet, ne diskutuam gjerësisht dhe vendosëm ta atakonim tamam atje ku ishte pika e tij më e dobët: te demagogjia që bënte, te betimet për «patriotizëm».

Ndër pikat e «dekalogut» ballist flitej për «Shqipërinë e lirë» e për «zhdukjen e shfrytëzimit», bile në ndonjë cep lëshohej me frikë edhe ndonjë fjalë për «luftën kundër pushtuesit», por, siç dukej, Balli përgatitej për luftë kundër «marsianëve», se pushtuesit italianë nuk ziheshin në gojë! Me këto, krerët e Ballit Kombëtar ishin përpjekur të ruanin ngjyrat nacionaliste, sepse kështu do të mund të luanin më mirë rolin e kalit të Trojës në gjirin e popullit shqiptar që e urrente dhe e luftonte pushtuesin.

Pikërisht te kjo «rrëshqitje nga halli në patriotizëm» e Ballit, u kapëm ne dhe, në momentin e duhur, në një takim të organizuar në Tiranë u thamë përfaqësuesve të kësaj organizate:

- Kemi dëgjuar për organizatën tuaj dhe e tremi lexuar programin që shpallët. Ju atje shpreheni edhe për «Shqipërinë e lirë», për shporrjen e të huajit etj. Këto janë gjërat që na bashkojnë, sepse ne tash dy vjet për këto luftojmë e derdhim gjak. Sig e dini, prej kohësh është krijuar Fronti Nacionalqllirimtar i popullit shqiptar që bashkon në radhët e veta gjithë masat, rrymat e organizatat nacionaliste antifashiste. Në bazë të platformës së luftës edhe ju duhet të aderoni në këtë Front.

- Ne s'e njohim Frontin tuaj! - u përgjigjën përfaqësuesit e Ballit.

U folëm me durim për Konferencën e Pezës, pjesëmarrjen e vendimet e saj, por njerëzit e Ballit prapë u hodhën përpjetë:

- Nuk e njohim as Konferencën e Pezës, as vendimet e saj !

Meqë po bënim shumë rolin e të paditurit, ne pa e humbur gjakftohtësinë, u thamë se për këtë Konferencë kishin dijeni edhe krerët e tyre, si: Mithat Frashëri, Kolë Tromara, Ali Këlcyra e të tjerë, se vetë zoti Mithat kishte dërguar përfaqësues të tij, se vetë Skënder Muqoja, megjithëse me vonesë, kishte ardhur në Pezë dhe e kishte pranuar platformën etj., etj.

Meqë s'kishin nga Via mbanin përpara këtyre fakteve, përfaqësuesit e Ballit hodhën në veprim kartën tjetër:

- Po, po, këto i dimë, - thanë, - por ju shkuat në Konferencë si Parti, kurse ne nacionalistët na thirrët si individë. Ne s'morëm pjesë atje si organizatë, ndaj s'e njohim as Konferencën e Pezës, as Frontin Nacionalqllirimtar!

- Nuk do të mungonim t'u thërrisnim edhe si organizatë, - u thamë. - Por si mund t'ju ftonim kur organizata juaj, në kohën kur u mbajt Konferenca e Pezës, nuk ekzistonte?!

- Ekzistonte Balli, si s'ekzistonte! Ne gjallë qemë! - u hodh një nga përfaqësuesit e pseudopatriotëve.

- Që ju ishit gjallë, këtë e dinim, ndaj dhe ju ftuam, - ishte përgjigjja jonë. - Por ne s'mund të hidhnim fall në filxhan për ekzistencën e një organizate e cila s'qe bërë e gjallë, lëre me pushkë që jo se jo, por as me ndonjë trakt a shpallje, bile as na e zuri ndonjëherë askush nga ju në gojë!

Po delegatët e Ballit Kombëtar nuk dëgjonin nga ky vesh. Atëherë përfaqësuesit e Frontit u thanë:

- Kundërshtimet tuaja janë pa baza dhe fare formale. Për mendimin tonë nuk tra asnjë rëndësi a ishit apo s'ishit ju në Pezë. Rëndësi tra që të merremi vesh për të luftuar së bashku kundër të njëjtit armik. A jeni ju për luftë?

- Jemi! - «pranuan» përfaqësuesit e Ballit.

- Atëherë ç'ju pengon? Ne po ju paraqesim një platformë konkrete lufte e bashkimi, të cilën tash prej muajsh e kanë përqafuar mijëra e mijëra veta anembanë vendit dhe, mbi bazën e saj, të diskutojmë. Ne ju themi: futuni në Front dhe merrni pjesë në luftë.

- Fronti Nacionalqllirimtar për të cilin na flitni ju është vetë Partia juaj Komuniste e kamufluar me emrin Front. Duke na thënë të futemi në Front, dashur padashur, ju kërkoni të na bëni pjesë të Partisë suaj !

- Jo, edhe të na luteshit, këtë juve as jua kërkujmë, as do t'jua lejojmë kurrë, - u thamë. - Kot i ngatërroni gjërat që janë të qarta si drita e diellit: Partia Komuniste është një parti politike, dyert e së cilës janë të hapura vetëm për ata që përqafojnë një ideologji të caktuar, ideologjinë komuniste; për ata që pranojnë dhe zbatojnë parime e norma të caktuara, tepër shkencore e tepër rigorozë. Këto ju as i bëni dot, e as ju kërkoni njeri t'i bëni. Kurse Fronti, zotërinj, - vazhduam, -- është një organizatë e gjerë masash, dyert e së cilës janë të hapura për tërë patriotët e vërtetë, për tërë rrymat

e organizatat antifashiste, që janë të gatshme të luftojnë me armë kundër pushtimit. Kryesorja tani është të bashkohemi të gjithë për të fituar lirinë. Ky bashkim luftarak është Fronti.

- Edhe sikur të jetë kështu, ne s'mund të hyjmë, sepse Fronti lufton me programin dhe parullat e Partisë Komuniste! - u munduan të gjenin shteg përfaqësuesit e Ballit.

- Po cilat janë programi dhe parullat tona konkrete? - i pyetëm dhe vazhduam: - Ajo që e thotë vetë Himni ynë Kombëtar: «Rreth flamurit të përbashkuar, me një dëshirë, për një qëllim». Luftë kundër pushtuesit për çlirimin e vendit! Urdhëroni e paraqisni ju ndonjë program ose parullë më luftarake, që t'i shërbejë më mirë qëllimit të atdheut e të popullit dhe, dakord, ne do t'ju pranojmë.

Përfaqësuesit e Ballit u turbulluan nga sugjerimi ynë, panë njëri-tjetrin në sy, pastaj njëri prej tyre, si më plaku, me një ton të qetë e prej babloku, nisi të na «mësojë» politikën «e madhe», «rrafinato». Në esencë «mësimi» ishte ky:

- Ne e njohim Partinë Komuniste si parti që s'e do fashizmin, edhe ne Balli s'e duam, por ndryshojmë në mënyrën se si do të luftojmë. Ju komunistët jeni të nxituar, po nxehni gjakrat, po i tërboni italianët që janë shumë të fortë dhe ky tërbim po bie e do të bjerë mbi popullin, mbi djemurinë. Duhet t'i ruajmë këto forca se na duhen për pasnesër; është dhe gjynah, xhanëm, derdhet tërë ky gjak, - tha përfaqësuesi i Ballit dhe konkludoi: - Balli është për të pritur kur të vijë koha, pra, të mos bëhen veprime të nxituara.

- Për cilën kohë e keni fjalën? - i pyetëm.

- Kur fashizmi të jetë leqendisur keq, të jetë bërë me një këmbë në varr. Atëherë ngrihem, i japim një të shtytur dhe e fitojmë lirinë pa gjak të shumtë! - u përgjigj përfaqësuesi i Ballit.

- Strategji e çuditshme! - u thamë. - Por një gjë s'kuptojmë: nëse ne duhet të presim duarkryq, nëse të gjithë popujt e robëruar do të presin duarkryq, atëherë kush do ta leqendisë fashizmin e të na e përgatitë që ne t'i japim shtytjen e fundit?!

Përfaqësuesit e Ballit pas pyetjes sonë mbetën si të ngurosur. Diçka mërmëritën me njëri-tjetrin, pastaj, papritur, njëri ngriti zërin:

- Me ju nuk mund të bisedohet. Ju ku e ku të zini në llaf! Ky është qëllimi juaj!

- Jo, qëllimi ynë është t'ju bëjmë thirrje e t'ju mbushim mendjen që edhe ju, gjersa pretendoni se fieni organizatë nacionaliste që s'e do fashizmin, të bashkoheni në luftën kundër fashizmit. Jashtë kësaj vije, jashtë kësaj logjike, ne s'njohim asnjë vijë e logjikë tjetër. Prandaj mendohuni dhe vendosni. Fronti i ka dyert të hapura, ai ju pret, veçse edhe pritja ka një kufi.

- Jo, jo, - këmbëngulnin në të tyren ballistët. Ne pranojmë vetëm ekzistencën e Partisë suaj dhe jemi dakord të bisedojmë parti me parti se ç'duhet të bëjmë.

- Se ç'duhet të bëjmë, Partia Komuniste e ka vendosur që kur u krijua: luftë kundër pushtuesit! Askush s'na lejon të rikthehem në atë fazë e cila ka kohë që ka mbaruar. Edhe të duam ne, historia s'kthehet më pas. Ndaj, nëse jeni vërtet për atë që thoni, një rrugë ka: ose përfshihuni dhe ju në atë bashkim luftarak që është krijuar me kohë, ose kot që bisedojmë.

Ja, kështu filloi e mbaroi në esencë takimi i parë i përfaqësuesve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar, takim që u organizua me iniciativën e PKSH në Tiranë, në janar të vitit 1943.

Ne e kishim parashikuar dhe e pritnim këtë qëndrim të tyre; ata erdhën në takim me synim të na tërhiqnin ne në një fushatë të pafund bisedimesh e «pleqërimesh», ku të rrihej ujë në havan dhe, ndërkohë, të vepronin me djallëzi e demagogji për të shthurrur radhët e Frontit, për të minuar autoritetin që kishte fituar Partia në masat e, për pasojë, të shuhej Lufta Nacionalçlirimtare që ne po e forconim nga dita në ditë. Kjo që kërkesa që fashizmi i kishte vënë këtij grupimi kundërrevolucionar, ndaj; në fazën e parë, qëllimi i Ballit ishte të neutralizonte veprimet tona dhe ta spostonte «me të mirë» Partinë nga vija e drejtë dhe nga roli që kishte fituar. Kjo do të ishte një fitore e dhuratë e madhe për Jakomonin e Merlikën e, në të njëjtën kohë, edhe një fitore për krerët tradhtarë të Ballit: mënjanonin nga skena pengesën e armikun më të betuar të synimeve e të interesave të tyre jetikë.

Por, kuptohet, këto ishin synime e llogari të pushtuesit e të reaksionit, të cilat ne jo vetëm i kishim parashikuar me kohë, por dhe u qemë kundërvënë e do t'u kundërviheshim me të tëra forcat pa lëshuar asnjë fije peri nga programi e qëndrimet tona.

Ndokush mund të pyesë: kur puna qenkësh kështu, pra, kur qysh në fillim Partia e kishte të qartë se ç'përfaqësonte Balli dhe për ç'qëllime të errëta u krijua, atëherë përse duhej biseduar me përfaqësuesit e tij? Përse qysh në fillim Partia dhe forcat partizane nuk iu kundërvunë me rreptësi kësaj organizate të pushtuesit?!

Natyrisht, ta shpallje Ballin en bloc armik që në fillim e t'i vije pushkën, kjo, në pamje të parë, mund të duket si një punë më e thjeshtë dhe më e lehtë për t'u bërë. Por gjërat s'duhën parë e vlerësuar as nga ato maskarallëqe e poshtërsi të Ballit që populli mësoi e pa në verën ose në dimrin e vitit 1943 e 1944, as nga ato që dinë tani të gjithë. Gjërat duhen parë nga situata e gjendja konkrete e vjeshtës 1942 dhe e fillimit të vitit 1943. Këto ishin muajt e parë të daljes në skenë të Ballit dhe, ndonëse në realitet qe dimër, për Ballin këto muaj ishin pranvera e parë dhe e fundit e «lulëzimit» të tij.

Ndonëse shtylla vertebrore e Ballit përbëhej kryesisht nga elementët e borgjezisë reaksionare të lidhur me pushtuesit si dhe feudalë dhe intelektualë antipopullorë, s'duhet harruar se këta, qoftë me namin e së shkuarës, ashtu edhe me dallavere, para, dredhi, mundën të mashtronin e të rreshtonin me Ballin një numër njerëzish si nga shtresat e prapambetura, ashtu edhe elementë të tjerë të paqartë. Këtë realitet Partia jonë e kishte parasysh dhe nuk mund ta nënvleftësonte. Né të njëjtën kohë Balli, që të kompensonte atë çka kishte humbur, e nisi me «vrull» punën: ngriti «çeta», «këshilla», organizoi edhe ai «qarkorët», nxori gazetë e trakte gjoja né ilegalitet, por né fakt me dijeninë dhe aprovimin e kuislingëve e të pushtuesve. Për t'i dhënë organizatës sé tyre, të mbushur me turli mostrash të tradhtisë e të pseudopatriotizmit, edhe nuancat të një çikë «revolucionit», u rregullua që né këtë limer banditësh me borsalina e papijon, krahas kriminelëve e kusarëve ordinerë, të shtronin jatakun edhe «komunistët» e «Zjarrit», si Hysni Lepenica me shokë!

Jo vetëm kaq, por nuk kaloi shumë kohë dhe prijësit e Ballit nisën të proklamonin pretendimin absurd se e paskëshin krijuar organizatën e tyre më parë se të krijohej Fronti Nacionalçlirimtar dhe, si rrjedhim i të gjitha këtyre, né shtresa të caktuara të pamirinformuarish u krijuan edhe iluzione, edhe mendime se nuk ishte një, por qenkëshin dy organizata nacionaliste, antifashiste.

T'i shpallje menjëherë luftë të hapur Ballit, do të thoshte, gjithashtu, ta çoje Luftën Nacionalçlirimtare dhe fatet e saj né shtigje tepër të rrezikshme: do të kishim përballë edhe një armik të ri të hapur, né kohën kur armik të shpallur kishim pushtuesin e huaj. Për më keq akoma, do të ndizej e do të acarohet një luftë e vërtetë vëllavrasëse, gjë që e ëndërronte dhe bënte çmos ta shpërthente pushtuesi né mes popullit tonë.

Këto e të tjera arsye neve na diktuan që të përcaktonim e të ndiqnim një vijë sa më të drejtë e të kujdesshme ndaj këtij grupimi të reaksionit. Ngà kjo vijë do të varej shumë edhe shpëtimi i të gënjyerve e neutralizimi i një pjese tjetër elementësh, por edhe vetë forcimi e konsolidimi i Frontit, i këshillave dhe i Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

Pikërisht për këto ne i orientuam drejt gjithë organizatat e Partisë dulce theksuar që të ndiqeshin taktika të matura e elastike né drejtim të Ballit Kombëtar, pa lejuar shkarje as ne oportunistem, por as né sektarizem, rrezik ky që né ato çaste paraqitej si më i mundshmi.

Dihet se Balli u krijua né momente kur prestigji i PKSHE dhe i Frontit qenë rritur, kur ishte zgjeruar e po shtohej vazhdimisht numri i çetave e njësiteve partizane, kur populli po shikonte dhe po bindej çdo ditë e më tepër me fakte se këto ishin të vetmet forca reale të luftës kundër pushtuesit. Ishin forcuar edhe pozitat ndërkombëtare të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, sidomos pas dhjetorit të vitit 1942, kur ministrat e jashtëm të tri fuqive të mëdha të koalicionit antifashist, Bashkimit Sovjetik, SHBA-së dhe Britanisë sé Madhe, me deklaratat e tyre publike njohën luftën e popullit shqiptar dhe pavarësinë e Shqipërisë pas luftës. Ky qe një grusht edhe për reaksionin brenda vendit, i cili çirrej se gjoja fuqitë e Boshtit do të garantonin lirinë e sovranitetin e Shqipërisë, ndërsa krerëve të Ballit kjo njohje nuk u shkonte për hosh, sepse rritej autoriteti i Frontit Nacionalçlirimtar.

Né një bisedë me një nga shokët kryesorë të qarkut të Gjirokastrës (né mos gaboj kur kishte ardhur né Labinot për të marrë pjesë né mbledhjet e takimet që organizuam në prag të Konferencës së Parë të Vendit të PKSH), ndërsa po flitnim për qëndrimin ndaj Ballit, ky na thotë:

- Ne s'ua zgjatim shumë ballistëve. O me ne, o tërci-fërci s'ka. Kjo na ndan me ta, - dhe i ra qytës së pushkës me pëllëmbën e dorës.

- Se ç'keni parasysh me atë «tërci-fërcin»; - i thashë, - nuk e di, por vija jonë është kjo: të bëjmë të gjitha përpjekjet për ta tërhequr Ballin në luftë efektive kundër pushtuesit, duke mos rënë për asnjë çast në «taktikën» e tyre të bisedave pa fund, pa përmbajtje e pa bereqet. Sa për pushkën, atë do t'ua drejtojmë vetëm nëse ata do të vihen hapur përkrah pushtuesit kundër nesh.

- E pse, i mbushet mendja Ali Këlcyrës me biseda! - këmbënguli shoku. - Ai llafet i ka pa fund, si çifligjet.

- Po të ishte fjala për një Ali Këlcyrë a për dhjetë të tillë, - i thashë, - besoj se s'do të lindë nevoja as për bisedime. Por ne kemi parasysh ata elementë të gënjyer që ai dhe shokët e tij i kanë mashtruar e i kanë bërë për vete. Këtë bazë, këta elementë ne duhet t'i tërheqim, t'i fitojmë dhe ata s'fitohen as me llafe e thirrje të zbrazëta, as duke u vënë pushkën. Pastaj, - vazhdova, - të mos harrojmë se Balli Kombëtar e paraqet veten si një organizatë nacionaliste, me një program demagogjik dhe, ndryshe nga kuislingët, nuk ka dalë hapur kundër luftës për çlirimin e atdheut. Se përse paraqiten kështu Ali Këlcyrët me të tjerët, ne e dimë mirë, por s'duhet menduar se të gjithë, veçanërisht shtresa të caktuara të popullit, i kanë gjërat po aq të qarta Sa ne. Një qëndrim i gabuar sektar e ekstremist ndaj Ballit tani do të na sillte dëm të madh.

It7endime «të avancuara» ose, më saktë, të ngutura, lidhur n:e këtë problem ishin manifestuar në ato momente edhe në organizatën e qarkut të Korçës. Sigurisht shokëve të Korçës, ku Balli Kombëtar paraqitej me një influencë relativisht të madhe, u kishte ardhur. siç thonë, në majë të hundës nga aktiviteti i eksponentëve ballistë, nga çetat bashibozuke e kriminale të Safet Butkës me shokë që bënë propagandë kundër Partisë e Frontit Nacionalçlirimtar, që përpiqeshin të sabotonin luftën dhe punën tonë në atë qark. Zemërimi i shokëve që i kuptueshëm, por këtu kishim të bënim me një çështje delikate politike dhe, në çështje të tilla, analiza e drejtë e situatës, perspektiva e qartë, taktika elastike duhej të zinin vendin e zemërimit dhe të revoltës, që në shumë raste janë këshilltarë të këqij. Komiteti Qendror, pra, jo vetëm që nuk mund të jepte aprovimin për të goditur Ballin Kombëtar, sepse një veprim i tillë do të kishte reperkusione negative për luftën tonë, por, përkundrazi, në një letër që u drejtuam drejtuesve të Partisë në Korçë u tërhiqim vëmendjen dhe i sqaronim për vijën ndaj Ballit Kombëtar.

Pozicioni ynë do të ishte ky: duke njohur strategjinë dhe taktikat e Ballit Kombëtar, detyra jonë ishte t'i kundërv inim atyre strategjinë dhe taktikat tona të drejta e largpamëse. Këto do ta demaskonin e do ta dobëson:n Ballin Kombëtar, ky do të kalonte një proces erozioni dhe, në një kohë që lufta jonë do të forcohej, eksponentët ballistë do të afishoheshin hapur si kolaboracionistë, radhët e organizatës do të shturrreshin e do të rralloheshin, pra, baza e tij, elementët e ndershëm, por të gënjyer, do ta braktisnin, siç e braktisën. Gjithashtu u porositën shokët nëpër qarqe që të intensifikohej akoma më tepër puna e Partisë dhe e Frontit dhe të organizoheshin takime, mbledhje e konferenca me popullin, me intelektualët etj. për të propaganduar e për të sqaruar më mirë e pandërprerë vijën e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe programin e Frontit Nacionalçlirimtar.

Kështu, duke ndjekur një strategji të drejtë e taktika të zgjuara e elastike ndaj Ballit, ne qysh nga fillimi kishim iniciativën në dorë dhe hap pas hapi i detyruam krerët e Ballit t'i nxirrnin gjithnjë e më në shesh kthetrat e tyre. Pas mospranimit të tyre kategorik për të hyrë në radhët e Frontit e në luftë kundër pushtuesit, ne u drejtuam një propozim tjetër «më të leverdishëm» për ta

-Të krijojmë një komision iniciator me delegatë të Partisë Komuniste, të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe të Ballit Kombëtar e të bëjmë një konferencë të madhe ku ju të thoni mendimet tuaja për organizimin e luftës e ne tonat.

- Jo, - na thanë, - se dhe atje ju do të jeni shumica.

- Në përcaktimin se kush e ka drejt e kush jo, u thamë, - s'ka të bëjë shumica e pakica. Por, meqë ju keni frikë nga një konferencë midis nesh, le të shkojmë në popull. Të dalim para popullit, të shprehë secili mendimet e veta dhe populli le të na gjykojë!

Ose nga besimi i verbër në forcat e në influencën e tyre në masa, ose ngaqë i gjykonin masat me metrin e vet, ata, për çudi, fillimisht këtë propozim tonin e pranuan. U organizuan bile edhe disa takime e kuvende të tilla ku krerët e Ballit erdhën para popullit të krekosur e të përgatitur me panegjirike pa fund, gjithë përbetime, lot e ofshama, por në fund u detyruan të iknin me bisht në shalë. Shokët tanë, komunistë e kuadro, ndonëse s'kishin shkolla e akademi oratorie, u ngritën para popullit dhe me fjalën e thjeshtë, por të zjarrtë të Partisë, me fjalën e luftës për liri e dashurinë për atdheun, i ngritën zemrat peshë, e bënë popullin që aty për aty t'i qesëndiste demagogët e tradhtarët e t'u vinte hunë. Menjëherë, me urdhër «të qendrës» Balli hoqi dorë nga kjo «formë pune» dhe vendosi ta bënte «s qarimin» e popullit vetë, pa «opozitë»!

Nisi një fazë e re në «zhvillimin» e Ballit, faza e shpifjeve dhe e akuzave kundër Frontit, kundër këshillave nacionalçlirimtarë dhe kundër vijës së Partisë sonë Komuniste. Por për të e kishte marrë ferra uratën. Populli s'kërkonte përbetime e «shprehje merak», por donte organizim e zgjerim konkret të luftës me armë kundër pushtuesit dhe, doemos, u shpreh e do të shprehej pro vijës së Partisë, pro Frontit Nacionalçlirimtar. Ca më tepër, në këto «takime të vetat me masat», Balli po i shfaqte hapur tiparet e tij jo vetëm si një organizatë tradhtare, por dhe si një grumbull hajdutësh ordinerë që vidhnin që nga pulat e gjer te fustanet e grave. Procesi i demaskimit e i vetëdemaskimit tash visi të merrte proporcione më të gjera. Jo vetëm populli, por dhe elementët e gënjyer që kishin hyrë gabimisht në këtë çerdhe fundërrinash, nisën të distanco hen nga krerët e nga hajdutët kriminelë. Ndërkohë, ne me të gjitha mjetet e format e propagandës, me trakte, thirrje, në takime me popullin, në shtyp, etj., pa e atakuar ende me emër Ballin Kombëtar, mbronim e përhapnim vijën e drejtë të Partisë për luftën, u përgjigjeshim ashtu si e meritonin akuzave e shpifjeve të Ballit e, mbi të gjitha, demaskonim parrullat e tij atantiste e demagogjike.

Por propaganda jonë më e mirë ishin njësitet, çetat e batalionet partizane që ia bënë jetën ferr armikut, ishin këshillat nacionalçlirimtarë në zonat e çliruara, nga aktiviteti i të cilëve populli shihte të lindte pushteti i ri, pushteti i vet. Kjo propagandë ishte mjaft efikase dhe populli, masat e gjera të tij, çdo ditë e më shumë afroheshin me luftën, me Frontin, me Partinë. Kjo për ne kishte një rëndësi kolosale.

Veçanërisht pas Konferencës së Parë të Vendit të PKSH, të marsit 1943, lindi nevoja e një pune më të dendur e më të shpejtë për thellimin e diferencimit në radhët e Ballit. Kryesorja që na diktonte dendësimin e punës sonë ndaj kësaj organizate, ishte orientimi i Konferencës për të konsoliduar e për të çelikosur më tej bashkimin e popullit, këshillat dhe repartet e armatosura partizane, tash që ndodheshim në prag të kryengritjes së përgjithshme të armatosur. Siç u vendos në konferencë dhe siç orientonte Komiteti Qendror, theksi në punën me Ballin do të vihej sidomos tek ata njerëz të thjeshtë që, veç influencës së trashëguar të krerëve ballistë dhe paqartësive politike, asgjë nuk i lidhte me veprimtarinë tradhtare të krerëve. Në këto përpjekje do të përdroeshin të gjitha mjetet, propaganda, bisedat e marrëdhëniet direkte me këta njerëz, puna bindëse dhe e duruar. Gjithashtu u vendos të bëheshin edhe përpjekje të tjera nëpërmjet bisedimeve me udhëheqjen e Ballit.

Platforma e këtyre bisedimeve, theksonte vazhdimisht udhëheqja e Partisë, do të kishte si kurdoherë në bazë luftën pa kompromis kundër pushtuesit dhe tradhtarëve, pranimin e platformës së Frontit Nacionalçlirimtar. Nëpërmjet këtyre bisedimeve që, siç po bindeshim çdo ditë e më tepër, ishin nga fundi, synonim t'i ndiznim më shumë kontradiktat që ekzistonin brenda kësaj organizate deri në udhëheqje dhe, nga ana tjetër, ta thellonim procesin e demaskimit të Ballit në popull, që ky ta humbiste fare edhe atë çikë kredie që mund t'i kishte mbetur.

Edhe unë vetë, siç kishim vendosur në Byro, zhviilova në këtë kohë 2-3 takime me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar. Një takim, me sa më kujtohet, është bërë në shtëpinë e Bahri Omarit në Tiranë. Kisha me vete Ymer Dishnicën dhe Mustafa Gjinishin, kurse Ballin e përfaqësonin Bahri Omari e Kolë Tromara. Kur shkuam në këtë shtëpi qe gati natë. U futëm brenda dhe i gjetëm të dy që na pritnin. U përshëndetëm dhe zumë vend.

- Urdhëro e fol, - m'u drejtua Bahriu.

- Dakord, - u thashë dhe, si ndeza një cigare, mora fjalën. Në fillim u parashtrova përfaqësuesve të Ballit pikëpamjen tonë për zhvillimin e gjendjes në vendin tonë, për sukseset që kishte arritur Lëvizja Nacionalçlirimtare, për krizën e rëndë ekonomike, politike e ushtarake që po jetonte koalicioni fashist jo vetëm te ne, po kudo në botë.

- Siç e shihni, - u theksova mes të tjerash, - zhvillimi i situatës na dha të drejtë neve dhe jo juve. Ndryshe nga ç'keni thënë ju në bisedat tona të mëparshme, lufta jonë jo vetëm që filloi dhe në të populli po merr pjesë çdo ditë më shumë, por kjo luftë e ka vënë pushtuesin në vështirësi të mëdha dhe po e çon drejt disfatës. Populli na dëgjoi ne dhe kjo ndodhi jo për sytë tanë të bukur, por sepse programi ynë u përgjigjej interesave dhe shpirtit të tij patriotik që nuk është shuar kurrë në zemrat e çdo shqiptari të ndershëm.

Qerrja e fashizmit, - vazhdova, - po gremiset dhe nuk ka forcë në botë ta shpëtojë nga shkatërrimi përfundimtar. Hitlerit po i kërcasin brinjët nga dajaku që po ha nga ushtritë e Stalinit, kurse imperos së Duçes po i shkërmoqen themelet. Pra, nuk është e largët ajo ditë kur popujt do të fitojnë dhe atëherë ai do të gjykojë se cilët kanë qenë patriotët e vërtetë dhe cilët qenë tradhtarët e frikacakët.

1 VË tej fola për perspektivat e zhvillimit të luftës sonë dhe theksova se në këto momente, pasiviteti, përçarja e popullit ishin të barabarta me tradhtinë. Si konkluzion, në emër të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, u bëra edhe një herë thirrje të shkëputeshin nga rruga ku ishin futur, të bashkoheshin me Frontin Nacionalçlirimtar në luftë për ta shpërrur armikun nga trualli i atdheut.

- Kjo s'bëhet kurrë, - kërcëu nga kolltuku Kolë Tromara. - Ne e kemi thënë, në Front nuk futemi.

- Po mirë, - iu përgjigja me gjakftohtësi, - mos u futni në Front. Le të bashkëpunojmë në luftë, ju si Ball Kombëtar dhe ne si Front. Vetëm se ne duam luftë dhe jo llafe, dhe nuk do të lejojmë askënd t'i vërë shkopinj nën rrota luftës sonë.

- Ne nuk jemi kundër bashkëpunimit, - foli Bahri Omari dhe pyeti: - Ju këtu vini si përfaqësues të Frontit apo të Partisë Komuniste?!

- Ne, - iu përgjigja, - jemi delegatë të K-,shillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, domethënë përfaqësues të Frontit.

- Jo! E kemi thënë. kështu nuk jemi dakord të bisedojmë! - m'u përgjigj ai. - Ne e kemi vënë kushtin: bisedojmë vetëm me Partinë Komuniste, si partia me partinë.

- Po ju s'jeni parti, - tha Ymer Dishnica.

- Po ç'jemi ne? - kërcëven përpjetë të ofenduar edhe Bahriu. edhe Kola.

- Për ne. - u thashë, - Balli është një organizatë me nacionalistë të tendencave të ndryshme- politike. Partia. sipas konceptit tonë, ka një platformë ideologjike e politike unike e n.ë program me a-'at imediat e perspektiv. Fronti nuk është e s'mund të jetë parti. por është një organizatë ku merr pjesë gjithë populli, aty ka komunistë, por ka edhe elementë nacionalistë që, për shumë gjëra. mund të mendojnë ndryshe nga ne.

- Por, ama, gjithë bota e di se Frontin e drejtojnë komun istët.

- Ne këtë s'e kemi fshehur ndonjëherë dhe juve jua ketni deklaruar hapur, - u thashë. - Kaq frikë paskeni ju nga Partia Komuniste? Ju, deri dje, na quanit çiliminj që s'na vjen njeri pas, kurse tani, qenia e Partisë nc: krye të Frontit ju tremb kaq shumë. Pastaj, - vazhdova, - as sot e asnjëherë ne nuk ju ftojme të luftoni për komunizmin, por për lirinë e Shqipërisë.

- Ne për Shqipërinë luftojmë, - tha Bahriu, çetat tona janë kudo. Por ne dimë të bëjmë edhe politikë dhe të bësh politikë do të thotë «shtatë hile e një trimëri».

T'u japim hakun krerëve të Ballit: për hile nuk ua hante qeni shkopin. Për trimëri, edhe atë që e kishin, e përdorën kundër popullit shqiptar. Ja kështu vazhdoi kjo bisedë: ne fol ata dredho, deri natën vonë, pa arritur asnjë rezultat.

Në një nga takimet e mia të fundit me Bahri Omarin, pas një debati të ashpër, i thashë i nevrikosur (se me të tillë njerëz me zor mund ta mbaje gjakftohtësinë):

- Populli kurrë nuk mund të ndjekë tradhtinë dhe tradhtarët, ai do të luftojë kundër okupatorit e tradhtarëve dhe do të fitojë!

Bahri Omari e kuptoi sulmin e drejtpërdrejtë që i bëra dhe m'u përgjigj

- Do të shohim kush janë tradhtarët, ju apo ne.

- Do ta shohim, - i them, - por dua të precizoj se ata që do të pengojnë luftën e popullit dhe do të bashkëpunojnë me armikun, janë tradhtarë.

- Të lutem Enver, - më tha Bahriu, - nuk dua të bisedoj më me ty për politikë. Është e qartë se ne jemi kundërshtarë.

- Ashtu është, - iu përgjigja, - por dua të të shpëtoj nga kjo rrugë që është një greminë e tmerrshme. Mua më vjen keq për ty, por, po ta them haptazi, më vjen akoma më keq për motrën time dhe për dy djemtë tuaj.

Fahrija e mjerë kishte ulur kokën dhe qante; ishte në një luftë tragjike: nga një anë burri, nga ana tjetër vëllai. Asnjëri nuk i lëshonte rrugën tjetrit. Fahrija ishte një nga motrat e mia më të mira, grua e mençur dhe e dashur me të gjithë. E doja shumë dhe më vinte keq për të.

Një mbrëmje, kur u vajta në shtëpi, Bahriu nuk ishte, Fahrija më thotë:

- Aman Enver, më thuaj si do të vejë kjo punë?

- Duhet të shpëtojmë Bahriun nga kjo rrugë, i them, - se kjo është rruga e tradhtisë. Ilaç tjetër nuk ka, ose me popullin e me luftën e tij kundër okupatorëve, ose me këta të fundit.

- Por ç'duhet të bëj unë? - më thotë ajo. - I them përherë: «Hiq dorë nga Ali Këlcyra, ai është një bej, hiq dorë nga puna në shtet, do të rrojmë si të rrojmë, siç rron gjithë dynjaja». Por ti e di që ai e ka kokën gur.

- E ka si e ka kokën burri yt, kjo nuk i hyn njeriu në punë. Sot ka rëndësi vetëm jeta dhe liria e popullit që duhet ta shpëtojmë. Unë, motër, po të dal borxhit dhe, sa të mund, do të luftoj akoma se mos e shpëtojmë Bahriun, por, po vazhdoi rrugën e tij, pushka na ndan, po të paralajmëroj.

Motra dulce qarë më tha:

- Enver, Luani le të vijë me ty në luftë, Bahriun s'e bind dot. - Dhe në fakt Bahriu s'u bind as nga e shoqja, as nga unë dhe shkoi larg, duke marrë pjesë në qeverinë kuislinge gjatë pushtimit gjerman. Kurse Luani ishte lidhur që në fillim me Luftën Nacionalçlirimtare, punonte aktivisht në organizatën e rinisë komuniste, bashkë me Gjikë Kuqalin e të tjerë. Kur ndodhesha në shtëpinë e tyre, me anën e tij jepja e merrja Tetra nga shokët; ai doli partizan dhe më vonë u bë anëtar partie e kuadër me formim të gjerë. Fatosi gjatë luftës ishte i vogël, por dhe ai më vonë mësoi e punon si inxhinier.

Po në këtë periudhë bëmë edhe dy takime me përfaqësues të Ballit, një në shtëpinë e Nexhat Peshkëpisë, ku ishin Bahri Omari dhe Halim Begeja, dhe tjetri në shtëpinë e Muharrem Vllamasit, ku, veg Bahriut e Kolë Tromarës, merrte pjesë, si «ndërmjetës», Sheh Karbunara që, si dinak që ishte, përpigjej të ruante ekuilibrin, edhe të mbante lidhje me Ballin Kombëtar, por edhe me Lëvizjen Nacionalçlirimtare t'i ruant2 urat.

Në shtëpinë e Nexhat Peshkëpisë kisha qenë disa herë në të kaluarën, sepse kishim lidhje familjare: gruaja e Nexhatit ishte mbesë nga Hoxhatët e Gjirokastrës. Prandaj, në shtëpinë e Nexhatit, që e konsideronim si shtëpinë tonë, kisha vajtur shpesh për drekë e për darkë dhe në këto raste vlonin diskutimet politike. S'kishim shumë kundërshtime politike me njëri-tjetrin dhe as me vëllanë e Nexhatit, Manushin, i cili hiqej si shkrimtar, si poet dhe kishte miqësi me Shevqet Musarain. Në kohën kur unë isha pa punë dhe nuk kisha të ardhura, kishte qëlluar që Nexhati më huante ndonjë lek, derisa më emëruan mësues. Feroja, gruaja e Nexhatit dhe mbesa jonë, ishte një grua e mirë dhe popullore. Por edhe vetë Nexhati, në atë kohë, shprehej si antizogist, antifashist, bile, hiqej si «i majtë» dhe pikëpamjet e tij ishin ca anarkiste. Kur dola në mal i bëra disa herë thirrje të bashkohej me lëvizjen, por ky, sikurse edhe Bahriu, nuk u bind dhe u bë ballist. Në prag të Clirimit të vendit Nexhat Peshkëpia, bashkë me tradhtarë të tjerë, u arratis e shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku na luftoi egërsisht derisa vdiq.

Edhe këto dy takime të fundit që organizuam me krerë të Ballit në Tiranë vazhduan e përfunduan si takimet e mëparshme, me të njëjtat dredhi nga ana e tyre dhe me të njëjtin qëndrim të drejtë e pa lëshime nga ana jonë. Por këtë radhë, si konkluzion, u theksuam

- Duke e lënë mënjanë të kaluarën e hidhur, ne përsëri ju zgjatëm dorën e shpëtimit, por ju përsëri s'doni të ndiqni rrugën që duhet ndjekur. Mirë, koha po provon se kush ka të drejtë. Por një gjë kijeni miro parasysh: Nëse s'doni të luftoni kundër pushtuesit, të paktën mos luani politikën e tij, mos u përpiqni t'i kundërviheni luftës sonë, luftës së popullit shqiptar kundër fashizmit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ndërpritni menjëherë fushatën e shpifjeve e të sulmeve kundër Frontit e këshillave nacionalçlirimtarë, ndërpritni vjedhjet dhe grabitjet që po bëjnë njerëzit tuaj nëpër fshatra. Merrini këto si të doni, qoftë si këshilla, qoftë si paralajmërim. Ne e dimë mirë sa mund të durohet e sa mund të tolerohet.

Pak ditë pas këtyre takimeve, që u zhvilluan në Tiranë në gjysmën e parë të majit 1943, u nisa urgjentisht për në Vlorë për të goditur e për të shpartalluar përfundimisht fraksionin e rrezikshëm antiparti që kishte kurdisur atje Sadik Premtja. Gjatë ditëve që ndodhesha në malësitë e Vlorës e në Mallakastër, shfrytëzoza rastin dhe nëpërmjet Hysni Kapos organizuam një takim me Tahir Hoxhën (një nga krerët e Ballit Kombëtar në Vlorë) dhe Hysni Lepenicën, oficer dhe «zjarrist» që, bashkë me njëfarë «çete» prej 10-15 vetash, i qe atashuar Ballit si «forcë sulmi». Qëllimi i këtij takimi ishte po ai nga qemë nisur për rastet analoge që përmenda më sipër: t'u bënim edhe një herë thirrje elementëve kryesorë të Ballit, që vepronin nëpër krahina, të mblidhnin mendjen e të vendosnin përfundimisht nëse do të nisnin rrugën e luftës e të patriotizmit të vërtetë, apo do të zhyteshin më tej në rrugën e tradhtisë e të bashkëpunimit me arnikun.

Por edhe ky takim, që u zhvillua në shtëpinë e Gani Alikos në fshatin Shkozë, siç kam shkruar hollësisht te libri «Kur lindi Partia»* *(Shih: Enver Hoxha. «Kur lindi Partia (Kujtime)», botim i tretë, f. 429.), nisi e përfundoi pa ndonjë rezultat.

Thirrjes dhe argumenteve të forta e të patundura, që paraqitëm unë dhe Hysni Kapoja, për domosdoshmërinë e përfshirjes së Ballit në luftë, si Tahir Hoxha, ashtu edhe Hysni Lepenica u munduan t'u rrëshqitnin duke i rënë zurnasë po në atë vrimë ku i binin edhe krerët e tjerë të Ballit: «nuk luftohet kështu si bëni ju», «s'bëhet lufta me çunakë», «t'i ruajmë forcat që t'i kemi gati për t'i dhënë pushtuesit goditjen e fundit», «nuk janë pjekur situatat» etj., etj.

Pas disa orë debatesh, ndërsa Tahir Hoxha mundohej t'i hidhte zjarrin ujë, u duk qartë se edhe krerët ballistë të krahinës do të vazhdonin vijën e krerëve të qendrës. Prandaj, në përfundim, u thashë:

- Lufta po gjëmon, Tahir Hoxha, dhe ju këtë e dini fort mirë, por nuk doni ta pranoni! Kjo luftë është e organizuar dhe e drejtuar nga Partia Komuniste e Shqipërisë, nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, i cili përfaqëson popullin dhe pikërisht kjo është arsyeja që okupatorëve italianë po u vjen fundi. Edhe këtë e dini, tjetër gjë se nuk doni ta pranoni. Ne ju bëjmë thirrje të hidheni pa rezerva, sa nuk është vonë, kundër okupatorëve e tradhtarëve, se interesi i Luftës Nacionalçlirimtare e kërkon të jemi të bashkuar. Ju jeni të lirë të zgjidhni rrugën tuaj, ne e kemi për detyrë t'ju themi se, po ecët kundër interesave të popullit, jeni të humbur!

U çuam në këmbë dhe kur po përgatiteshim për të shkuar, Hysni Lepenica na tha:

- Dua të kem një bisedë të veçantë me ju.

Ne pranuan, u ndamë me Tahir Hoxhën dhe që të tre, unë, shoku Hysni Kapo e Hysni Lepenica u nisëm për në Dushkarak, në shtëpinë e xha Muratit, ku filluarn bisedën me Hysni Lepenicën. Nga disa gjoja lëkundje që shfaqte Lepenica gjatë debatit me Tahir Hoxhën si. dhe nga fakti që ishte «zjarrist» dhe kishte njëfarë çete e hiqej sikur kishte hedhur edhe ca pushkë, menduam se ky do të shkëputej nga Balli e do të bashko-hej me Frontin e me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Si duket, gjykuam për një çast, i erdhi zor ta braktiste Ballin në sytë e Tahir Hoxhës, ndaj kërkoi takim të veçantë me ne. Por qysh në fillim të bisedës u duk qartë se Hysni Lepenica kishte të tjera qëllime. Ai na. shtroi dy gjëra: e para, çështjen e Grupit të «Zjarrit».; «pjesëtar i të cilit kam qenë dhe unë me Fëtah Butkën e të tjerë», - siç tha, - dhe, e dyta, çështjen e Sadik Premtes.

Hysni Lepenica ishte kundër trajtimit dhe luftës që i kishte bërë Partia jonë grupit arqiomarksist dhe «kundër trajtimit që i bëtë ju dhe qarkori i Vlorës çështjes së Sadik Premtes».

I dhashë përgjigjen e merituar për të dyja këto, çështje duke i theksuar se «nga ato çka thatë ju, zoti; Lepenica, asnjë nuk pranojmë, pikëpamje të tilla i hedhim poshtë e do t'i luftojmë».

- E keni gabim, - m'u përgjigj Hysni Lepenica.

- Ju do të humbitni e do të jeni shkakuar të gjakderdhjes.

- S'gabohemi ne, por ju, - i thashë. – Vëlla vrasjen po e filloni ju dhe jo ne. Ne kemi filluar e do të vazhdojmë deri në fund luftën kundër pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ne ju bëjmë eadhe një herë thirrje, zoti Lepenica, që të bashkoheni pa hezitim me ne në Luftën Nacionalçlirimtare.

- Atëherë, - tha Lepenica, - e mbaruarn bisedën. Me ju nuk u morëm vesh në asnjë çështje. Ju më vutë pushkën.

- Nuk është e vërtetë, - i thashë, - varet nga ju në rast se do të shkëmbejmë pushkë, por rrugën tonë ne nuk e ndërrojmë. S'ka forcë që të na lëkundë nga parimet dhe nga qëllimet e shenjta që i ka caktuar vetes Partia.

- As ne, - tha Lepenica, - nuk e ndërrojmë rrugën tonë.

Kështu u ndamë edhe me këtë ballist arrogant, pseudonacionalist dhe bashkëpunëtor të italianëve, që u vra në Gërrhot të Gjirakastrës po nga miqtë e tij fashistë, menjëherë pas kapitullimit të Italisë. Për mua personalisht këto qenë takimet e fundit me elementët e Ballit tradhtar. U ndava me ta për të mos i parë më kurrë.

Ndërkohë, ne vazhdonim me vrull punën në të gjitha drejtimet e tjera për të vënë në vend programin e Partisë në tërësi, e në mënyrë të veçantë, për të zbatuar vendimet e detyrat e rëndësishme që na caktoi Konferenca e Parë e Vëndit e PKSH. Dhe fakt është se puna e Partisë ecte përpara, lufta zgjerohej, populli organizohej e armatosej. Në flakët e saj po lindte ushtria e popullit kryengritës dhe pushka e saj ishte dëgjuar tashmë në një varg betejash ku armiku kishte ngrënë grushte dërrmuese.

Përpara na pritnin ngjarje të tjera të mëdha.

3. Një mbledhje historike (Labinot 4-10 korrik 1943)

Evenimentet që kishin ndodhur nga Konferenca e Pezës e këtej dhe detyrat e mëdha që dilnin përpara na diktuan në fillim të verës së vitit 1943 nevojën e një mbledhjeje të rregullt të forumit drejtues të Frontit Nacionalçlirimtar, Këshillit të Përgjithshëm Provizor. Një mbledhje e tillë ishte e domosdoshme, qoftë për të analizuar punën e bërë nga Këshilli dhe nga çdo anëtar i tij i veçantë, qoftë për të marrë një sërë vendimesh të cilat momenti historik i sugjeronte me forcë. Midis këtyre vendimeve më kryesori kishte të bënte me propozimin e KQ të PKSH për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe organizimin e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, detyrë kjo e shtruar në Pezë në shtator 1942 e që tash ishin pjekur plotësisht kushtet për realizimin e saj.

Duke pasur parasysh këto vendosëm që mbledhja e Këshillit të zhvillohej në ditët e para të korrikut dhe të lajmëroheshin me kohë anëtarët e tij. Ndonëse kjo do të ishte mbledhja e parë e plotë dhe e rregullt e Këshillit që nga shtatori 1942, duhet të theksohej se gjatë gjithë kësaj kohe ky organizëm i rëndësishëm nuk kishte qëndruar duarlidhur e në pasivitet. Përkundrazi, anëtarët e veçantë të tij kishin punuar, ishin mbledhur e kishin diskutuar sipas mundësive që ofronin situatat. Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm ose shokë të tjerë të ngarkuar prej tij kishin ndjefkur punën e këshillave ekzistues në terren, kishin, punuar për ngritjen e këshillave të rinj, kishin dhërlë udhëzime e kishin nxjerrë trakte e thirrje drejtuar popullit. Ndërkohë, përvoja po tregonte se një nurnër anëtarësh të Këshillit të Përgjithshëm Provizor të zgjedhur në Pezë, jo vetëm nuk po e justifikonin besimin, por, përkundrazi, edhe po e pengonin ose po e saboxonin punën.

Por tanfi çështja shtrohej për ta drejtuar punën me një horizont më të gjerë dhe për të ndihmuar në mënyrë sa më efektive në zhvillimin e luftësi dhe në forcimin e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë.

Ajo që na gëzonte ishte edhe fakti se në Iradhët e Frontit, të këshillave e të njësive tona partizane, krahas punëtorëve e fshatarëve, po hynin me shumicë edhe intelektualë e patriotë të ndershmë, të cšlët po e kuptonin se nuk mjaftonin vetëm urrejtja ndaj pushtuesit e mospajtimi me të, por lypsej edhe kontributi aktiv i secilit në luftën e madhe që kishte shpërthyer.

Pikërisht në këtë fazë, në zbatim të orientimit të Konferencës së Parë të Vendit për pjesëmarrjen sa më të gjerë të rinisë shkollore në luftën e organizuar partizane, nisi braktisja masive e shkollave të rresme të vendit. Të parët ishin 100 nxënës të viteve të fundit të Normales së Elbasarit, të cilët, në mënyrë të organizuar e demonstrative, më 1 maj 1943 lanë bankat e shkollës dhe shkuan djejt e në mal, ku i inkadruan në radhët e çetave e të batalioneve partizane. Pak më pas të njëjtin veprim do të kryenin edhe liceistët e Korçës, në një kohë qe nga të gjitha shkollat e tjera të vendit grupe të tërd nxënësish e mësuesish hidhe

shin në rreshtat partizane. Kështu, sa më tepër rritej e ashpërsohej lufta, aq më i thellë bënej diferencimi i madh midis masave punonjëse të qytetit e të fshatit, intelektualëve, patriotëve e demokratëve të ndershëm e të sinqertë, nga njëra anë, dhe pseudopatriotëve e pseudodemokratëve, nga ana tjetër.

Qe merita e Partisë, zgjuarsia cihe trimëria e saj, vija e saj e drejtë, që patriotë e njerëz përparimtarë nga Jugu e Veriu, si: Abaz Bekteshi, Musa Ohri, Avni Kapinova, Tvilitiadh Papa Haki Fejzo, Bal Marku, Hasan Xhiku, Xhevdet Nepravishta, Mahmut Bedalli, Rasim Guri e të tjerë, u grumbulluan rreth programit të saj në luftën për Tiri. Qindra patriotë e intelektualë përparimtarë i dhanë shumë Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe Partia u dha shumë atyre, i rriti e i kaliti, i edukoi gjithnjë e më sliumë në pikëpamjet dhe botëkuptimin e tyre. Ata u bënë të aftë të kuptonin e të pranonin jo vetëm programin aktual të Partisë, por edhe strategjinë e saj të ardhshme, për të vendosur në Shqipëri sistemin socialist. Ata u bënë një me Partinë dhe shumë prej tyre u futën në radhët e saj, ku milituan e militojnë si bij besnikë e kuadro të zotë të saj.

Si tani më kujtohet ajo ditë kur Mustafa Xhani më shfaqti dëshirën e tij për t'u pranuar në radhët e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ishim në teqenë e Martaneshit (kam vajtur disa herë atje në stinë të ndryshme) dhe, pasi kishim biseduar me njëri-tjetrin gjerë e gjatë, Mustafai më thotë:

- Shoku Taras, unë dua të bëhem anëtar i Partisë.

U gëzova shumë nga këto fjalë të Baba Fajës dhe menjëherë iu përgjigja:

- Ti e meriton plotësisht të bëhesh anëtar i Partisë, o Mustafa Xhani, prandaj bëj lutjen dhe u thuaj shokëve të celulës që edhe Enveri është pro pranimit tënd. Unë do të të mbështes në këtë kërkesë, pse jam i sigurt që ti nuk beson te feja, por beson vetëm te Partia.

- Për Partinë, - tha Baba Faja Martaneshi, unë i zhvesh rrobat.

- Jo, rrobat që ke, t'i mbash, - i thashë. - Këtu nuk është çështja për të gënjer popullin, por rrobat fetare të babait ti i kishe edhe para luftës, edhe para formimit të Partisë, prandaj i ruaj ato, pse ne duhet t'i respektojmë sentimentet e besimtarëve dhe të shfrytëzojmë simpatinë që ka populli ndaj teje dhe ndaj teqesë së Martaneshit. Pra, derisa ti je i vendosur për luftë dhe e do Partinë, respekton dhe zbaton vijën e saj, atëherë ne të pranojmë anëtar partie.

Dhe celula e çetës e pranoi Mustafa Xhanin anëtar të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ky ishte një gëzim i madh për Baba Faja Martaneshin. Ai më përqafohte fort, më puthte e më xiniste me atë mjekër të zezë që e krihte me gishtërinjtë e tij.

Kam shkruar në këto shënime diçka më gjatë për Baba Faja Martaneshin, për vetë rolin e tij të shquar në ato vite dhe për lidhjet e shumta që pata me të, por duhet të them se klerikë patriotë të tillë, që u lidhën ngushtë me Lëvizjen Nacionalçlirimtare e me programin e Partisë dhe dhanë gjithçka për lirinë e pavarësinë e atdheut, pati me dhjetëra anëmbanë vendit. Një ndër këta ishte edhe Ismail Tufa në Tiranë, apo si e thërritnin dhe e njihnin të gjithë, Hoxhë Tufa.

E kisha njohur këtë plak të mirë e patriot në ditët e rënda të ilegalitetit në Tiranë, kur shtëpia e tij u bë një nga bazat e teknikës së Partisë dhe vetë Hoxha bënte rojë e na këshillonte t'i zinim me jorganë tërë dritaret apo vrimat, nga mund të dilte ndonjë zhurmë.

- Ti vërtet je hoxhë, - i thosha, - por ama nuk po të shoh ndonjëherë Kuranin nën xhybe. Në vend të tij ke revole, pra je hoxhë me revole.

Hoxha qeshte ëmbël dhe më thoshte:

- Kemi përpara luftën, Enver, dhe luftën, na më

soni ju djemtë, nuk do ta bëjmë me Kuran, por me revole.

Dhe me të vërtetë, kështu i kaloi gjithë vitet e vështira të luftës patrioti Ismail Tufa. Vetën e tij, shtëpinë, djemtë i vuri në dispozicion të Partisë e të luftës çlirimtare. Njëri nga djemtë e tij, komunisti dhe shoku ynë Meti, dha jetën në altarën e lirisë, vetë plakë 75-vjeçar Hoxhë Tufa u kap nga gjermanët, u torturua, por gojën s'e çeli. Ai ishte gati të vdiste sesa të tregonte atë që i kërkonin xhelatët e popullit.

Ishte meritë e madhe e Partisë sonë që me vijën e politikën e saj të drejtë afroi, bëri për vetë e i vuri në shërbim të çështjes së popullit e të atdheut, klerikë të tillë patriotë, si Baba Lazen e Baba Fejzon, hafëz Halil Tophanën e hafëz Zagonjorin, at Pashko Vodicein e at Kokoneshin, papa Ilia Zagalin, dervish Mugon e shumë të tjerë anëmbanë Shqipërisë.

Duke u ndarë me urrejtje e përbuzje përfundimisht nga fretërit e lartë të kishës katolike, nga ata dhespotë e kryemyftinj reaksionarë që bekuan me temjan pushtuesit dhe skllavëruesit e Shqipërisë, klerikët përparimtarë e patriotë që kishin dalë nga populli e jetonin më pranë popullit me fjalën, qëndrimet e veprimet e tyre, me pushkën që hodhën krahut e me yllin partizan që vunë në ballë, dhanë një kontribut të vlefshëm sidomos për bashkimin e popullit rreth programit të Partisë e të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar.

Po gjatë kësaj kohe u aktivizuan dhe dhanë kontributin e tyre për forcimin e Frontit dhe të lëvizjes edhe intelektualë e patriotë të tjerë, midis të cilëve do të shquhej sidomos Omer Nishani.

Omer Nishanin e kisha njohur kur ishte kthyer nga emigracioni pas pushtimit italian, por për të kisha dëgjuar që kur isha nxënës në Gjirokastër, ngaqë vëllanë e tij, Beso Nishanin, e kisha pasur mësues. Gjithashtu kisha shokë edhe nipërit e tij, Emin dhe Ferik Shtinon, djemtë e teto Alos, motrës së doktorit, një plakë me shumë humor, si dhe i vëllai. Për këtë plakë kam shkruar diku në kujtimet e mia të vegjëlisë. Këta të gjithë më flisnin ndonjëherë për doktorin, por unë në Gjirokastër s'e kisha parë kurrë.

Kur në dhjetor të 1924-ës Zogu, i vënë në krye të forcave kundërrevolucionare, erdhi në fuqi, dëgjova të flitej për doktor Nishanin se ishte politikan, kurse, kur ishim nxënës në Liceun e Korçës na thoshin se ai ishte edhe komunist. Vite më pas ne të Grupit të Korçës mësuam se doktor Nishani e kishte qendrën në Gjenevë dhe se atje nxirrte gazetën «Liria kombëtare», ku bashkëpunonin Halim Xheloja, Naun Prifti, Ali Kelmendi, Riza Cerova, Selim Shpuza dhe shokë të tjerë revolucionarë, të majtë dhe komunistë. Ky grup kishte pikëpamje politike më të qarta se të gjithë të tjerët dhe ishin këta që organizuan KONARE-në, të cilën e minuan dhe e luftuan grupi i Ali Këlcyrës, i Mustafa Krujës dhe i Azis Çamit me shokë. Ne, që në moshë të re, kishim simpati të madhe për Halimin dhe dr. Nishanin, të cilët quheshin prej grupit nacionalist të Ali Këlcyris, të Qazim Koculit e të tjerë, «kuqalashët».

Nuk e di me saktësi nëse doktori emigroi më parë në Greqi, në ishullin e Zantes, apo shkoi më vonë nga Zvicra në Greqi. Sidoqoftë, ai ndenji për një kohë në Zvicër, në Gjenevë, ku doktori, siç më thoshte më vonë, kur bisedonim bashkë në kohën e luftës, në Labinot e në Orenjë, kishte mik një udhëheqës të socialdemokratëve «të majtë» të Zvicrës, të quajtur Nikol.

Kur, pas pushtimit fashist, dëgjova se kishte ardhur në Shqipëri doktori (ai kishte mbaruar për mjeksi, por nuk e ushtroi kurrë profesionin), pata dëshirë ta takoj, ndonëse më kishte ardhur keq që ai, tok me të tjerët, ishte futur në «Këshillin e shtetit». Nuk ishte e vështirë për mua të njihesha me doktorin. Më njohu me të Bahriu.

- Ja, doktor, po të prezantoj një «kuqalash» si ti, - i tha ai, - është Enveri, vëllai i Fahrijes, djali i Halilit.

- U, - tha doktori duke qeshur, - djali i Halilit je ti? Ke një baba të mirë.

- Bëmë baba të të ngjaj, - i thashë. - Kështu themi ne në Gjirokastër.

- Hi, hi, hi! - qeshi doktori me të madhe, nxori majën e gjuhës, se e kishte zakon, siç mësuam më vonë, dhe bëri «pëst-pëst», sikur pëshytynte. - Për një gjë nuk i ke ngjarë Halilit, - më tha, - nuk të merret goja si ai.

Më bëri disa pyetje për familjen dhe për gjendjen time, u interesua në kisha gjetur punë dhe pse jo etj. Pastaj më tha:

- Ne pleqtë vamë, u bëmë për të na pirë lëngun. Të rrojë djalëria, se ju jeni shpresa e vendit. Unë s'kam bërë ndonjë gjë të madhe, por Zogun e luftova aq sa munda. Kisha dhe shokë të mirë në gazetë, që më ndihmonin në këtë drejtim. Nuk u dorëzova, por ç'të bëja, të vdisja në mërgim? Më kishte marrë malli për vendin, për njerëzit. Erdha, por këta fashistë e okupatorë dhe të gjithë maskarenjtë, që i shërbejnë atij si qenër, i urrej për vdekje. Por do të thuash ti (dhe më pyeti prapë si më quanin), pse u fute në «Këshillin e shtetit»? Nga balli, s'kam me se të rroj, kam edhe gruan. Ja, kështu u katandisëm.

- Doktor, - i thashë, - unë sot për herë të parë të njoha si person, kurse për idetë dhe luftën tënde unë dhe shokët e mi kemi dëgjuar me kohë, prandaj të kemi dashur dhe të duam. Ti më the se hyre në - Këshillin e shtetit», mbasi doje të jetoje. E mira do të ishte të mos kishe hyrë, por ne e ndiejmë se ti me mendje e me zemër je jashtë tij, se ti je me popullin, me djalërinë antifashiste dhe nuk u ngjan Kolë Tromarëve e Ali Këlcyrëve me shokë.

- Ama i paskeni njohur se ç'janë këta, more djalë? - më pyeti doktori. - Kjo ka rëndësi, prej tyre mos pritni gjë.

- Ne do të bëjmë përpjekje, doktor, që të tërheqim në luftë kundër pushtuesit këdo, edhe këta po që se do të jenë për luftën çlirimtare të popullit, i thashë.

- Bëni përpjekje, në kini durim, se mua më ranë leshtë e kokës me ta. Ata s'dinë gjë tjetër veçse të marrin rroga, të hanë e të pinë mirë, të hiqen sikur ata janë e s'ka njeri tjetër, por ju vazhdoni punën Enver, se mundet që ju t'i bindni.

- Zoti doktor, - i thashë, - lufta kundër pushtuesit fashist kërkon grumbullimin dhe organizimin e të gjithë popullit. Që ta flakim jashtë truallit tonë pushtuesin, duhet të bëjmë sakrifica shumë të mëdha. Në radhë të parë këto duhet t'i bëjmë e do t'i bëjmë ne komunistët, se edhe unë jam komunist, zoti doktor, - vazhdova. - Ne jemi gati të sakrifikojmë edhe veten për çlirimin e atdheut e të popullit.

- Enver, - më tha doktori, - të faleminderit për besimin që tregove ndaj meje, duke më thënë që je komunist, kur dihet se komunistëve fashizmi u pret kokën. Unë nuk jam komunist, kam jetuar e kam punuar me ta, i kam respektuar dhe më kanë respektuar. Do të të them një gjë: rruga për ju nuk është shtruar me lule, por luftoni, se vetëm me luftë do ta shpëtojmë Shqipërinë.

- Shoku doktor, - iu përgjigja, - më fal, por nuk më bëhet të të them «zoti doktor». Ne komunistët jemi akoma të paktë, por të vendosur. Radhët tona, në luftë kundër pushtuesve, do të shtohen, sepse ne tremi dhe do të tremi me vete gjithë rininë dhe popullin. Kur të formojmë Partinë tonë, i madh e i vogël do të jetë me të, sepse ajo do të jetë Partia e vegjëlisë. Vetëm në një gjë, - shtova, - nuk mund të jem dakord me ju, me mendimin që shprehët se «ne të moshuarve na iku koha». Jo, lufta, populli kanë nevojë për të gjithë. Njerëzit si ju janë një ndihmë e madhe për luftën, pse ju keni pjekurinë dhe një të kaluar patriotike. Unë ju bëj thirrje t'i vini këto cilësi tuajat në balancën tonë, në shërbim të popullit.

- Enver, - m'u përgjigj doktori, - më prekën thellë fjalët e tua dhe besimi që tregoni ndaj meje. Ti je i pari që po më flet kështu që kur tram vënë këmbët në tokën e atdheut.

- Jam djalë i popullit tonë, që e do aq shumë lirinë dhe pavarësinë, - iu përgjigja.

- Dëgjo, Enver, vetëm një fjalë po të them dhe fute në xhep: Doktor Nishani është me ju derisa të vdesë. Kur ta shihni të nevojshme, më lajmëroni dhe unë do të jem gati të bëj ç'të më caktojë djalëria.

Me këto fjalë i dhamë fund bisedës sonë të parë.

Vura në dijeni shokët e Grupit të Korçës për bisedën me dr. Omerin dhe u thashë se ky ishte një element me perspektivë për punën tonë. Ata u gëzuan, e aprovuan mendimin tim dhe më ngarkuan të mbaja lidhje me të, ta informoja herë pas here për gjendjen e përgjithshme, për rritjen e rezistencës dhe për zgjerimin e lëvizjes.

Unë u takova dica herë me doktorin dhe m'u shtuan simpatia e respekti për të. Orner Nishani ishte njeri me kulturë të gjerë e njihte mirë disa gjuhë të Perëndimit e të Lindjes. Në takimet që patëm i flisja atij për domosdoshmërinë e bashkimit të madh të të gjitha forcave, të popullit, njerëzve e mundësive tona në luftën e vështirë, por të lavdishme që kishim përpara. Doktori shprehte hapur

gëzimin e tij për këtë rrugë që kishim nisur dhe nuk mungonte të shfaqte mendime të urta e të pjekura, të cilat na vlenin në punën tonë. Kështu ai u bë krejtësisht njeriu ynë me mendime e qëllime dhe m'u forcua bindja se me të tillë patriotë lufta e popullit do të ecte më përpara.

Kur formuam Partinë, pata një bisedë të gjatë me të. I fola për rëndësinë e saj, për rolin që do të luante në fatet e vendit, në zgjerimin e mëtejshëm të Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Gjithashtu i tregova se paskëtaj na duhej të bënim edhe një punë të gjerë me masat e popullit si dhe me elementë patriotë e nacionalistë për t'i tërhequr në anën tonë kundër fashizmit. Ai ishte entuziast për çka i thosha, u gëzua shumë, më uroi dhe ma ripërsëriti gatishmërinë e tij.

Kur përgatitëm Konferencën e Pezës, prapë pata takim me të, ia shpjegova gjerë e gjatë qëllimet, kë kishim ftuar dhe kush kishte pranuar. Kishim menduar që doktorin të mos e ftonim në Konferencë, sepse mendonim të mos e zbulonim (dhe këtë ia shpjegova doktorit); lidhjet e tij, propaganda që bënte ai për lëvizjen, i maskuar si njeri i regjimit, duke u shoqëruar me «baballarët» e «Këshillit të shtetit», do të na ishin të dobishme edhe për ca kohë.

Doktor Nishani u shpreh plotësisht dakord me iniciativën e Partisë Komuniste dhe me platformën e Konferencës, më uroi sukses për Konferencën dhe më tha:

- Edhe unë do të bëj propagandë për vendimet që do të merrni, armiqtë do t'i çakërdis me mënyrën time dhe miqtë do t'i afrojnë me Frontin. Dhe ta dini, theksoi në fund, - kur të keni nevojë për mua, gati më keni.

Omer Nishani e kishte mbajtur fjalën dhe kishte punuar në Tiranë si një aktivist i zellshëm i Lëvizjes Nacionalçlirimtare. E, ja, kur momentet e donin, biseduam me shokët dhe menduam që ai do të ishte i vlefshëm në punët e Këshillit të Përgjithshëm si një njeri i pjekur, patriot e me kulturë, për punët e propagandës, për organizimin e pushtetit etj. I dërguam fjalë dhe doktori iku nga Tirana e u hodh në mal, ku qëndroi derisa u çlirua vendi.

Omer Nishani na solli me vete edhe një tjetër simpatizant të Luftës Nacionalçlirimtare, Kostë Boshnjakun. Kostë Boshnjakut ia kisha dëgjuar emrin, por nuk e njihja personalisht. Në qoftë se nuk gabohem, ai si emigrant kishte qëndruar në Vjenë, kurse në rini kishte qenë edhe në Rusinë cariste, ose për të punuar, ose me familjen, prandaj, në mos gabohem, e dinte mirë edhe rusishten.

Kishte pamjen e një burri hijerëndë, fliste si një «politikan i regjur», i jepte rëndësi të madhe vetes, natyrisht, shante Zogun, Ali Këlcyrën, mbronte komunizmin, Leninin, Stalinin dhe Partinë tonë.

Kështu, pra, ngaditë e më tepër, po dukeshin frytet e punës së madhe që kishte bërë Partia me nacionalistët. Në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, në Front e deri në rreshtat e çetave e të batalioneve partizane ishin futur e po futeshin një numër i madh njerëzish patriotë, të cilët e kishin kuptuar vijën e Partisë dhe të Frontit Nacionalçlirimtar. Të tillë qenë, për shembull, ndër të tjerë Qirjako Haritoja, Ali Shtëpani në Tiranë; Hasan Puloja, Jaho Gjoliku në Vlorë; Spiro Bakalli në Durrës; Gavril Pepoja në Korçë; dr. Petraq Popa, Fetah Ekmekçiu, hafëz Musa Basha në Elbasan; Pasho Hysi në Skrapar, të cilët i njihja personalisht e ruaj kujtimet më të mira për ta. Po ashtu në Jug e Veri, krahas luftëtarëve e patriotëve të tillë të nderuar, si: Shpend Balia e Sali Mani në Tropojë, Gjon Marashi, Hajdar Alia e të tjerë në Shkodër, Llazi Bo

zo në Myzeqe, Haki Stërmilli në Dibër, Muharrem Butka në Kolonjë, Siri Shaplllo e Kadri Baboçi në Gjirokastrë, Stefan Thomagjini në Sarandë, Haxhi Seseri, babë Rexha e të tjerë në Krujë, Ollga Plumbi, dr. Jorgji Jorgoni, Ela Gjikondi e të tjerë në Tiranë, Hoxhë Deliu në Elbasan, Ali Kame e Koço Stefani në Përmet, Tafil Tërpani në Berat e të tjerë, u bashkuan me Frontin e Lëvizjen Nacionalçlirimtare edhe dhjetëra mësues, mjekë, inxhinierë, agronomë, shkrimtarë e nëpunës të tjerë anëmbanë vendit.

Edhe me ish-oficerët e ushtrisë së vjetër Partia qysh në fillim bëri një punë të kujdesshme, sepse ishte e bindur se, ndonëse midis tyre do të kishte nga ata, sidomos oficerë të lartë të ish-ushtrisë zogolliane që do të ishin të predispozuar për t'u vënë në shërbim të pushtetit, një numër i madh, elementë patriotë e përparimtarë, do të hidheshin me luftën tonë. Sigurisht,

ne njihnim faktin se puna me këtë kategori njerëzish paraqiste vështirësi, sepse në të kaluarën këta kishin formuar një kastë të privilegjuar, të edukuar me koncepte antipopullore e që paguhej mirë për të siguruar sundimin e «sovranit-august». Megjithatë, ne i njihnim qëndrimet opozitare kundrejt

Zogut në radhët e oficerëve të gradave të ulëta. Një pjesë e këtyre kishin pasë krijuar edhe një organizatë të fshehtë, «Grupin e oficerëve» me Bedri Spahiun në krye, ku flitej e diskutohej për komunizmin, bile ky quhej edhe grup komunist, por që në fakt më tepër ishte një organizatë tepër e mbyllur ushtarakësh, pa kurrfarë lidhjeje në popull dhe e destinuar të dështonte, siç dështoi në veprimet e veta. Dinim, gjithashtu, se në radhët e tyre kishte elementë me inspiracione patriotike e demokratike dhe detyra jonë ishte t'i lidhnim ata me luftën tonë.

Kur u pushtua vendi, ndërsa të gjithë oficerët reaksionarë u bënë veglat e pushtuesit, ruajtën gradat e morën rroga të majme prej tij, shumë të tjerë, veçanërisht «vegjelia» e oficerëve, u bashkuan me Luftën Nacionalçlirimtare. Disa prej tyre, si: Mustafa Matohipi, Reshit Çollaku, Memo Meto, Asim Zeneli, Pano Xhamballo e të tjerë luftuan, u bënë drejtues batalionesh e brigadash partizane dhe ranë heroikisht në luftën e shenjtë për Tiri. Nga radhët e ish-oficerëve dolën edhe shokë si Spiro Moisiu, të cilin Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Përgjithshëm e emëruan komandant të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ose si Shefqet Peçi që u bashkua që në ditët e para të pushtimit në luftën kundër okupatorit dhe, pas themelimit të Partisë, u bë një ndër kuadrot më të shquar të formacioneve të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

Edhe Dali Ndreu, Tahir Kadareja, Hulusi Spahi u të tjerë luftuan dhe Partia gjatë luftës e më pas u ngarkoi përgjegjësi të ndryshme, por, veçanërisht pas Çlirimit, qoftë barërat e egra të kohës së oficerllëkut zogist, ashtu edhe sëmundje të tjera politike, ideologjike e morale, i shtynë në rrugë të shtrembër, disa bile u hodhën edhe në krahët e agjenturave të huaja e mbaruan si armiq të Partisë e të popullit. Sidoqoftë, këto do të vërtetoheshin më vonë. Ajo që doja të theksoja është fakti se Partia diti të bënte një punë të mirë e të frytshme si me gjithë shtresat e tjera, edhe me oficerë të ushtrisë së vjetër dhe mudi të bënte për vete e të mobilizonte në luftë të gjithë ata që mund të mobilizoheshin. Pjesa më e mirë e tyre tash, në pranverën dhe në fillimin e verës së vitit 1943, kur ndodheshim në valën e organizimit të formacioneve të mëdha të ushtrisë partizane, do të përbënin, siç përbënë, një fond me vlerë për Partinë dhe luftën.

Pikërisht në këto momente, pra, në fillimin e verës së vitit 1943, kur ne po përgatiteshim për mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm, na vjen në Shqipëri si «shtegtar i vonuar» edhe Sejfulla Malëshova. Nuk e kisha njohur kurrë personalisht Sejfullain, por për të më patën folur Ymer Dishnica e Koço Tashkoja që e kishin njohur në emigracion, i pari në Francë dhe tjetri në Bashkimin Sovjetik. Megjithatë ishte e vështirë të krijoje një përfytyrim koherent nga ç'më thoshin Ymeri me Koçon, se gjykimet e tyre për Sejfullain ishin diametralisht të kundërta. Koço Tashkoja që, siç dukej s'e kishte pasur qejf, më tregonte se Sejfullai ngulte këmbë që qendra e grupit të komunistëve shqiptarë, që kishin organizuar të rinjtë me prirje demokratike kur vajtën në Bashkimin Sovjetik, pas ardhjes së Zogut në Shqipëri, të vendosej jo në Bashkimin Sovjetik (në Shqipëri jo e jo), por në Evropë, në Paris, Vjenë a Gjenevë. Kur e njoha më mirë Sejfullain, e besova këtë dhe e kuptova se, doemos, Sejfulla Malëshovës i pëlqente më shumë jeta e kafeneve të Parisit sesa puna e lufta e vërtetë në atdhe. Krejt ndryshe më kishte folur Dishnica për Sejfullain. Ai e kishte njohur në Francë, ruante një admirim të veçantë për të dhe kishte borxh të më fliste orë të tëra për «mençurinë» e «talentet» e Sejfullait e për «aktivitetin» e tij.

Të them të drejtën, disa gjëra nga ato që na tregonte Ymeri sikur na impresionuan dhe mendonim se një shok i tillë që «kishte punuar në Komintern», që «kishte qenë profesor» në Moskë, me një lloj eksperience e njohuri teorike, pastaj edhe njeri i penës dhe poet, do të na ishte i nevojshëm.

Biseda e parë që pata me Sejfullain kur ai erdhi në Shqipëri aty nga qershori i 1943-shit, nuk më la ndonjë përshtypje të madhe, bile, pata njëfarë deziluzioni nga përgjigjet që më jepte kur i bëja ndonjë pyetje për Rusinë Sovjetike, për ndonjë çështje të eksperiencës së Partisë Bolshevike apo edhe të Partisë Komuniste të Francës. Në këto raste Sejfullai merrte pamjen e një filozofi të rënduar nga pyetjet e dishepujve dhe lëshonte rreth vetes një tym misterioziteti e një «do të bisedojmë». I shkurtër e rondokop, me një zë që e trashte apostafat, dëgjonte e shikonte me një pamje prej njeriu të bezdisur nga vogëlsira. Nuk mungoi që në ditët e para të jepte «këshilla» e të bënte kritika, duke lënë të kuptonte që «tani që erdha unë, do t'i ndreqim këto gjëra». Nga ana ime e pyeta për gjendjen në Francë, për disa miq e të njohur komunistë atje, por dukej që Sejfullai dinte pak gjëra.

- Hë, - më pyeti doktor Dishnica pas bisedës së parë, - si t'u duk?

- Besoj se do të na ndihmojë, - iu përgjigja, por me sa duket pa entuziazmin që priste Ymeri dhe, kur pashë që doktori shtangu, shtova:

- Në punë e në luftë do ta njohim më mirë.

- Është shok i mirë dhe i përgatitur, Enver.

- Do ta shohim, - përsërita dhe s'e zgjata më.

Po, siç u kuptua, nuk qeshë unë i vetmi që «u rezervova» në vlerësimin e «profesor» Malëshovës. Ca kohë pas ardhjes së tij në Shqipëri bisedoja një ditë me doktor Nishanin e, kur ra fjala për Sejfullain, doktori qeshi e tha:

- Unë do ta kem keq me Sejfullain, ose ai do ta ketë keq me mua.

- Po pse? - e pyeta i interesuar, se e dija që doktori e kishte njohur Sejfullain në emigracion dhe dija që Omer Nishani ishte njeri i drejtë në gjykime.

- Kemi ca historira të vjetra të gazetës, - më thotë doktori dhe vazhdoi tregimin: - Kur nxirrnim në emigracion «Lirinë kombëtare» i kërkoja edhe Sejfullait ndonjë artikull të na dërgonte nga Moska. Po tundej Sejfullai? Pas pesë letrave që i dërgoja unë, bënte kabull e më dërgonte «materialin»: titullin e dy-tri pika plani, medemek «tezat» e artikullit. Prapë pesë letra të tjera me të shara vendçe e më në fund na dërgonte artikullin. Herë s'ia botoja fare, herë, bashkë me Halimin, ia shkruanim nga e para. Një koqe dembeli që ç'të të them, - vazhdoi doktori e përsëri qeshi «hi-hi-hi». - Më shkruante dokrra, «proletariati kështu, proletariati ashtu...».

- Pse ishe kundër proletariatit ti? - e ngacmova unë doktor Nishanin.

- .To, more jo, nuk isha kundër proletariatit unë, po ato që shkruante Sejfullai qenë broçkulla. Se nga kopjonte nga ndonjë gazetë sovjetike dhe shkruante në artikullin e destinuar për Shqipërinë : «Proletariati industrial, sidomos ai i uzinave dhe i kantierëve, duhet të jetë në Shqipëri në krye të masave», e ku e di unë se ç'gjepura të tjera. «Cilit proletariat m'i drejtohe more Sejfulla, - i shkruaja unë me inat, - proletariatit industrial të Malëshovës tënde, apo atij të Dunavatit të Gjirokastrës sime? Pika neve me ç'budallenj do ta mbajmë gazetën». Për ideai, Enver, kështu i kam shkruar. Ja pyete, po s'ka qenë kështu, - dhe doktori qeshte e qeshja dhe unë me ato që më tregonte.

Ndërkohë Sejfullai «njihej me gjendjen», bënte biseda akademike, sidomos me Ymerin e me Koçon, përpiqej të dukej sikur mezi e kishte pritur ditën të vinte për të marrë pjesë në luftë (edhe sot e kësaj dite më ka mbetur e errët se pse ai priti verën e 1943-shit për t'u kthyer në Shqipëri) dhe ne, qoftë për garancitë që na jepnin Ymeri e Koço Tashkoja për të, qoftë për faktin se «vinte nga Kominterni», vendosëm ta kooptojmë edhe në Komitetin Qendror, natyrisht, si kandidat e jo si anëtar i Komitetit Qendror.

Të tilla, pra, ishin kushtet e rrethanat në të cilat ne u përgatitëm dhe më 4 korrik 1943 filluam mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, e cila u mbajt në Labinot në shtëpinë, ku në mars kishte zhvilluar punimet Konferenca e Parë e Vendit e Partisë. Përveç anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Provizor që ishte zgjedhur në Pezë, kishim ftuar në këtë mbledhje edhe Haxhi Lleshin e Sejfulla Malëshovën, të cilët do t'i paraqiteshin Këshillit si kandidatura për t'u kooptuar në përbërjen e tij. Kështu, gjithsej bëheshim tetë veta, sepse dy nga anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, Ndoc Çoba e Kamber Qafmolla, ndonëse ishin lajmëruar, nuk kishin ardhur.

Për drejtimin e punimeve të kësaj mbledhjeje propozova luftëtarin e shquar, Mustafa Xhanin, dhe pjesëmarrësit e tjerë të mbledhjes u shfaqën plotësisht dakord me propozimin tim. Pastaj u aprovua rendi i ditës, i cili përmbante si pikë të parë një referat për situatën e jashtme dhe të brendshme, të cilin e mbajti Ymer Dishnica.

Mbasi dëgjua referatin e Ymerit, diskutuam rreth zhvillimit të situatës politike dhe ushtarake në Evropë, sidomos për vonesën e hapjes së frontit të dytë nga ana e anglo-amerikanëve. Në diskutimin tim thashë se aleatët mund të bëjnë një zbarkim në Itali me qëllim që të shkëputin Italinë dhe Ballkanin nga Gjermania dhe, pas kësaj, kishte të ngjarë që Gjermania të sulmohej edhe nga Franca, por edhe nga gjetiu.

- Për sa i përket Ballkanit, - theksova, - kam mendimin që fronti i dytë në këtë sektor t'u lihet vetë forcave nacionalçlirimtare të vendeve ballkanike. Rritja e lëvizjeve nacionalçlirimtare, sukseset e tyre në Shqipëri, Jugosllavi e Greqi tregojnë se këto lëvizje janë në gjendje ta mbajnë me sukses këtë barrë.

Më kujtohet që për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe Sejfullai, i cili kishte vendosur të na mahniste me diskurin e tij të parë publik, duke pro fetizuar dhe dulce na bombarduar me citime të agjencive e radiove të ndryshme. Bile, na përmendi edhe emrin e një gjenerali të Afrikës së Jugut, që na paskësh folur për zhvillimin e ngjarjeve në teatrin evropian të luftës!

Në vazhdim të diskutimit për këtë çështje të rendit të ditës u sugjerova shokëve të bënin një përshkrim të shkurtër të gjendjes në krahinat nga vinin. Mbjaj mend se një diskutim i zjarrtë u ndez kur Haxhiu foli për situatën në Dibër. Pasi përmendi sukseset e luftës sonë atje, ai u ndal në qëndrimin që mbante paria e këtyre krahinave ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe me fakte demaskoi lodrën që bënin elementë të tillë të parisë, si: Fiqri Dinja, Ali Maliqi, Myftar Kaloshi e të tjerë.

- Puna e tyre mban erë të fëlliqur, more shokë, - tha copë Haxhiu. - Lidhjet me ne i mbajnë për të na penguar, që të mos bëjmë aksione. Këto dallavere të parisë populli ka filluar t'i kuptojë, s'futet rrena në thes; mjaft njerëz të thjeshtë nga radhët e tyre kanë ardhur vullnetarisht në aksionet tona. Edhe punën për shtrirjen e këshillave nacionalçlirimtarë në gjithë zonën ata e kanë penguar. Tani i ranë gjethet fikut, dolën sheshit. Pa dëgjoni se si duan të na trembin, - tha në fund Haxhiu dhe lexoi dytri letra ultimatum të Fiqri Dines drejtuar Çetës partizane të Dibrës për të ndaluar goditjet kundër armikut.

- Durim do të bëjmë, por në luftë t'i bëjmë hesapet pa ata, bile një ditë mund t'i kemi përballë, tha Haxhiu dhe u ul.

- Kadal, he burra, - u ngrit Bazi i Canës. S'pritet lisi nga dega me një trame të sopatës. Ne luftojmë me u bashkue e jo me u përça. A mos po dum qarin e hasmit?

- Hasmi do plumin, vallahi, - tha Myslimi, s'ka llafe!

Bazi luajti vendit e u mbështet më mirë.

- Allahile, s'po mujt me e kuptue mikun tem, Haxhiun. Ai asht nga oxhak me një barrë ner në Dibër të Madhe. Po ne jena vllazën, mor jahu, duhet të jena bashkë. Po të jena na bashkë edhe populli bahet bashkë.

Ky farë burri, duke e ditur fare mirë se ç'ishte reaksioni dibran, kërkonte bashkëpunim me të për të shtyrë, në fakt, goditjen e pushtesit me armë për në kalendat greke; në fund të fundit, kjo ishte detyra që i kishin ngarkuar. Ai vetë vepronte njëllë si paria e Dibrës, nuk e kishte zbrazur një herë; ndryshimi i vetëm ishte se, për qëllime të caktuara, kishte ardhur në Pezë e merrte pjesë në Këshill.

- E ç'na hyjnë në punë fjalët e mëdha, zoti Abaz, - thashë unë, - bashkimi i vërtetë duket në luftë, këtu është kuvendi i burrave sot. Ç'kuptim do të kishin këto që po thuhet sot këtu, nëse nuk na ndihmojnë që nesër të forcojmë goditjet kundër armikut?

- Po a ka besë, bre? - nguli këmbë në dhelprëtitë e veta Bazi. - Burri lidhet për fjalësh...

- Shqiptari sot lidhet prej kësaj, - tha Myslimi dhe rrahu me pëllëmbë patllaken e futur në brez. Unë them, or babë, se lufta po na i difton burrat e vërtetë. Në Pezë e në Shijak krerët s'i bëra me vete, po fukaranë, ama, e bëra. E kena goditë fashizmin dhe ja ku jena, ma të fortë, populli na beson, por pse? Se po luftojmë, jo llafe. A po flas drejt, or babë?

- Të lumtë goja, - u hodh Baba Faja. - s'ka ilaç tjetër. Në Martanesh këshillat i kemi në çdo katund, populli është mbledhur rreth tyre si bleta. E goditim armikun ku të mundemi e sa të mundemi. Kush të dojë të bashkohet me ne, bujrum i themi, një armë më shumë !

Kjo ishte përgjigjja më e mirë kundër pikëpamjeve të Abaz Kupit.

Mbasi diskutuan edhe shokët, sidomos për zhvillimin e luftës në krahinat e tyre, bëjnë një pushim të shkurtër, për të kaluar në pikën tjetër të rendit të ditës, mbi veprimtarinë dhe detyrat e këshillave nacionalçlirimtarë. Për këtë pikë isha ngarkuar të referoja unë.

Në referat nënvizojë rëndësinë e Konferencës së Pezës dhe tregojë për punën e bërë deri atëherë për ngritjen kudo të këshillave dhe për funksionimin e tyre si organe të luftës dhe të pushtetit politile, si

dhe për pengesat që kishim hasur në këtë punë jo vetëm nga pushtuesit dhe nga autoritetet kuislinge, por edhe nga «nacionalistët» e grumbulluar në Ballin Kombëtar.

Fola pastaj konkretisht për gjendjen dhe punën e këshillave nacionalçlirimtarë në krahina e në qytete të ndryshme të vendit, si në Tiranë, Durrës, Vlorë, Mallakastër, ku puna e tyre, me gjithë vështirësitë, kishte ecur mirë si dhe për krahina të tjera, si në Shkodër, Mat, Dibër e Krujë, ku akoma vazhdonim të hasnim pengesa të mëdha nga reaksioni. Në referatin tim kritikova disa të meta të punës sonë për një drejtim të centralizuar të këshillave nga Këshilli i Përgjithshëm e nënvizova se lidhja me bazën nuk kishte qenë aq e vazhdueshme sa ç'e kërkonte situata dhe lufta jonë.

- Grupimi i forcave, - theksova, - është duke u kristalizuar. Rritja e luftës sonë do ta shpejtojë akoma më shumë këtë proces, prandaj është detyrë e ditës për Këshillin e Përgjithshëm që ta ndihmojë akoma më shumë bazën, të organizojë popullin në Frontin Nacionalçlirimtar, të forcojë këshillat në fshat, në lagje, në qytet e në krahinë.

Që kjo punë të bëhej më mirë ishte ndër nevoja e një dokumenti ku të përcaktoheshin qartë të drejtat, kompetencat e funksionet e tyre. Prandaj shtrova çështjen e një statuti të këshillave nacionalçlirimtarë, projektin e të cilit e kishim përgatitur paraprakisht e tash do t'i lexohej Këshillit të Përgjithshëm për diskutim. Përfundimisht, ky Statut bashkë me Rregulloren e këshillave nacionalçlirimtarë do të aprovohej në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare që do të mbahej më pas.

Më tej, duke u ndalur në punën që kishte bërë Këshilli i Përgjithshëm Provizor, nënvizova se jo të gjithë anëtarët e këtij organi me rëndësi të Luftës Nacionalçlirimtare ishin treguar në lartësinë e detyrës me përgjegjësi që u kishte ngarkuar Konferenca e Pezës.

- Inaktiviteti i plotë i dy pjesëtarëve nacionalistë në Këshillin e Përgjithshëm, Ndoc Çobës e Kamber Qafmollës, - theksova në referat, - e ka penguar punën. Gjithashtu, në zonën ku është Abaz Kupi puna me këshillat nuk ka ecur mirë, bile, ata janë penguar.

Kurse Ramazan Jarani, i cili nuk është anëtar i Këshillit, por që ishte ngarkuar si ndihmës i Myslim Pezës për punët e Këshillit, marrim vesh se e ka kthyer pllakën dhe është bashkuar me Ballin. Kështu, pra, praktikisht me punët e Këshillit nuk janë marrë si duhet gjithë anëtarët.

Ramazan Jarani ishte një mësues tiranas me të kaluar të mirë si antizogist dhe antiitalian. Unë nuk e kisha njohur nga afër, vetëm isha prezantuar me të nga miqtë e mi mësues. Në kohën kur punonim për përgatitjen e Konferencës së Pezës, kërkoja të takohem me të dhe këtë takim e organizoi Mustafa Gjinishi, që ishte edhe rekomanduesi më i flaktë i Ramazanit. Bisedova dy herë me këtë, i shpjegova qartë pikëpamjen tonë në lidhje me mbledhjen që kishim në plan të bënim me nacionalistët dhe për platformën që do të shtronim. Meqenëse Xan Jarani u shfaq plotësisht dakord me ne dhe premtoi se do të na mbështeste në çdo gjë, i ngarkuam si detyrë që të bënte propagandë kundër pushtuesve në gjirin e nacionalistëve të Tiranës. Ai e pranoi këtë detyrë, bile më tha se në kohë rreziku mund të shkoja edhe në shtëpinë e tij, një shtëpi e thjeshtë tiranase në rrugën ku ndodhej edhe shtëpia ku u vranë Vojo Kushi dhe shokët e tij. Gatishmëria e Ramazanit më gëzoi, sepse çdo element i fituar për luftën për çlirim ishte një sukses i punës së Partisë. Për një kohë u duk se ky element do t'i tubante premtimet; ai mori pjesë në Konferencën e Pezës, u solidarizua me vendimet e saj dhe u tregua i gatshëm të punonte për realizimin e tyre. Mirëpo nuk kaloi shumë kohë dhe entuziazmi i Jaranit u ftoh dhe Myslimi m'u ankua se ky jo vetëm që nuk kryente asnjë nga detyrat që i caktoheshin, po pothuajse i kishte ndërprerë kontaktet me Babën.

- Si është kjo puna e Xan Jaranit? - e pyeta një ditë Mustafa Gjinishin.

- Unë e njoh për burrë të mirë, - më përgjigjet Tafa. - Do ta takoj dhe do t'i flas.

Nuk kaloi shumë kohë, kur në Labinot më erdhi lajmi nga shokët e Tiranës që Xan Jarani kishte ndërruar «këmishë», kishte braktisur Frontin dhe ishte bashkuar me Ballin.

Kjo ishte metamorfoza e këtij renegati, të cilën ua shpjegova edhe anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm që ishin të pranishëm.

Në lidhje të ngushtë me këto probleme e me krejt stadin që kishte arritur lufta jonë, mbledhja e korrikut 1943 diskutoi gjerësisht rreth nevojës që kishte lindur për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të të gjitha forcave të armatosura të popullit kryengritës.

Qysh në Konferencën e Pezës ishte diskutuar dhe

që vendosur që në momentin e duhur, me zgjerimin e rezistencës së armatosur kundër pushtuesit fashist e sidomos me rritjen e numrit të çetave e njësiteve partizane, të krijohej një shtab qendror, i cili do të ishte qendra drejtuese e operacioneve ushtarake të ushtrisë së re që do të krijonte populli.

Dhe ja, pas një viti luftë e përpjekjesh të gjithanshme ne gjykuam se ky moment kishte ardhur.

Në verën e vitit 1943, lufta e armatosur e popullit shqiptar kishte marrë përpjesëtime të gjera. Numri i çetave partizane që shtuar në mënyrë të pakrahasueshme me disa muaj më parë, që rritur e forcuar përbërja e tyre, aktiviteti luftarak që zhvillonin ato në të

gjithë vendin i jepte armikut goditje dërrmuese. Vetëm në këto çeta, që quheshin njësi të rregullta, sepse funksiononin në mënyrë të përhershme, merrnin pjesë rreth 10 000 veta, përveç afro 20 mijë luftëtarëve të çetave territoriale dhe të njësiteve guerile. Me porosi të Komitetit Qendror të Partisë ishte kaluar në organizimin e batalioneve, si njësi më të mëdha e më të fuqishme, të afta për të kryer operacione inë shkallë më të gjerë kundër armikut dhe qenë dërguar orientimet e po merreshin masat për krijimin në një të ardhme fare të afërt të brigadave të partizane.

Për të gjitha këto, i ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë, në një nga seancat e mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, u ngrita e u thashë shokëve:

- Komiteti Qendror i Partisë Komuniste, nga analizat që u ka bërë situatave dhe forcave tona, ka arritur në konkluzionin se proporcionet që ka marrë Lufta Nacionalçlirimtare dhe arritja e fitores përfundimtare mbi armikun, e bëjnë të domosdoshme dhe urgjente bashkimin organik të të gjitha njësteve partizane në një ushtri kombëtare të drejtuar nga një qendër e vetme. Ne i propozojmë këtij Këshilli që të shqyrtojë e të miratojë propozimin e KQ të PKSH për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Duke realizuar këtë detyrë, lufta e armatosur e popullit tonë do të jetë më e organizuar e do të zgjidhë më me sukses objektivat politikë e ushtarakë në të ardhmen.

Në vazhdim nënvizova se krijimin e këtij organi të specializuar në drejtim ushtarak të luftës sonë e kërkonte edhe nevoja e koordinimit dhe e bashkëpunimit të Luftës sonë Nacionalçlirimtare me atë të vendeve të koalicionit antifashist, sidomos me aleatët e mëdhenj, Bashkimin Sovjetik, SHBA-në dhe Britaninë e Madhe dhe në mënyrë të veçantë me lëvizjet nacionalçlirimtare të popujve të Ballkanit.

Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm e përsëritën propozimin për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe shprehën besimin se ekzistenca e një organi të tillë do ta forconte akoma më shumë Luftën Nacionalçlirimtare dhe do ta afronte ditën e fitores sonë mbi armikun. Pas marrjes së këtij vendimi historik, u diskutua për përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm dhe u vendos që Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të përbëhej prej 12 vetash dhe konkretisht nga: Spiro Moisiu, Enver Hoxha, Myslim Peza, Haxhi Lleshi, Mustafa Xhani, Ramadan Çitaku, Abaz Kupi, Ymer Dishnica, Dali Ndreu, Mustafa Gjinishi, Sejfulla Malëshova dhe Bedri Spahiu. Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi, gjithashtu, që ndërtimin e strukturës organizative të Shtabit të Përgjithshëm Via linte vetë këtij, në mbledhjen më të parë.

Të nesërmen u mbledh Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili përcaktoi strukturën e vet organizative dhe ndau përgjegjësitë midis anëtarëve të vet. Shtabi do të kishte një komandant si dhe komisar politik të tij, ashtu sikurse kishin edhe të gjitha repartet tona partizane. Propozova që me detyrën e komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të ngarkohej shoku Spiro Moisiu, si një njeri patriot dhe specialist i çështjeve ushtarake. Majori, siç e quanim zakonisht shokun tonë, ishte një ndër ata oficerë patriotë, të cilët dashuria për atdheun dhe për popullin e urrejtja për robëresin e huaj qenë më të forta se dëshira për poste e grada me të cilat Zogu dhe fashizmi u përpoqën të joshnin.

Pikërisht për meritat patriotike si edhe për faktin se Spiro Moisiu ishte një ushtarak i vjetër dhe me eksperiencë, Shtabi i Përgjithshëm e caktoi atë si komandant të vet. Unë u caktova komisar politik i Shtabit të Përgjithshëm.

Më 10 korrik 1943 ne e shpallëm publikisht vendimin historik për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Pikërisht kjo ditë ka mbetur e do të mbetet si një ndër ngjarjet më të shënuara jo vetëm të Luftës Nacionalçlirimtare, por të krejt epokës së Partisë, si dita e Ushtrisë sonë Popullore, çlirimtarja dhe mbrojtësja e lavdishme e atdheut tonë socialist.

Krahas vendimeve të tjera që kishin të bënin me organizimin e ushtrisë sonë, me krijimin e komandave të qarqeve dhe të Zonës I Operative, me organizimin e pushtetit ushtarak partizan në prapavija etj., në mbledhjen e korrikut 1943 një vëmendje të veçantë i kushtuam edhe çështjes së qëndrimit ndaj Ballit Kombëtar në të ardhmen.

Në referatin që unë i paraqita mbledhjes analizoja me hollësi edhe punën e përpjekjet që kishim bërë gjer në ato momente për ta bindur Ballin të hidhej në luftë kundër fashizmit dhe të pranonte vijën politike që kishim aprovuar në Konferencën e Pezës. Me këtë analizë të gjerë që i bëja problemit kisha parasysh dy synime kryesore. Së pari, të informoja hollësisht ata anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm që nuk kishin qenë në lidhje të vazhdueshme me Këshillin për vijën e ndjekur dhe veprimet konkrete që ishin bërë dhe, së dyti, të përcaktonim platformën e bisedimeve që parashikonim të zhvillonim me Ballin Kombëtar, dulce i bërë thirrje për herë të fundit që të futej realisht ri luftë duke hequr dorë nga bashkëpunimi me armikun dhe nga lufta kundër Frontit Nacionalçlirimtar dhe Partisë Komuniste.

Diskutuesit që morën fjalën pas meje aprovuan vijën e ndjekur dhe i vlerësuan të drejta të gjitha përpjekjet e gjeratëhershme. Përfundimisht u vendos të bëhej një takim tjetër me përfaqësuesit e kësaj organizate, ku të kërkohej prej tyre një përgjigje e shkoqur dhe përfundimtare nëse Balli do të merrte apo jo pjesë në luftë.

Në diskutimin e kësaj çështjeje, me sa më kujtohet, e mori fjalën Ymer Dishnica.

- Mendoj, - tha në fund të diskutimit Ymeri, që në bisedimet që do të bëhen t'u thuhet ballistëve: «Me ju, pa ju - luftën do ta bëjmë deri në fund», dhe t'u bëhet edhe një herë thirrje për një bashkim luftarak, për shkatërrimin e okupatorëve, për një Shqipëri të lirë e demokratike.

E përmend diskutimin e Ymer Dishnicës për të nënvizuar se Ymeri, i cili do të vihej në krye të delegacionit të Këshillit të Përgjithshëm në Mukje, jo vetëm ishte i sqaruar që më parë për pozicionin që duhej të mbante, por edhe vetë, të paktën në fjalët që thoshte, dukej që kishte një pikëpamje të drejtë për Ballin Kombëtar dhe për qëndrimin që duhej mbajtur në takimin me përfaqësuesit e tij.

Pas Ymerit e mora fjalën unë dhe në substancë thashë:

- Qëllimi ynë është që të hedhim në luftë ata që nuk e kanë kuptuar akoma luftën që bëjmë ne Edhe në krerët e Ballit Kombëtar të diferencojmë ata elementë që nuk janë komprometuar dhe të përpiqemi edhe një herë t'i bindim të luftojnë, duke u folur haptazi dhe dulce ua shpjeguar qartë karakterin e Luftës Nacionalçlirimtare.

Për bisedimet që mendojmë të bëhen me Ballin t'u dërgojmë një letër me propozimin tonë dhe t'u japim një afat të shkurtër, jo më shumë se 5-6 ditë që të na përgjigjen nëse duan apo jo të takohen me delegacionin tonë. Nuk do ta zgjatim më tej këtë afat dhe, po nuk erdhën në këtë mbledhje a konferencë, nuk do të presim më, por ta botojmë letrën tonë në gazetën «Bashkimi» që populli të shohë edhe një herë se kush është kundër bashkimit dhe luftës çlirimtare.

- Me Ballin Kombëtar, - vazhdova, - nuk do të bëjmë më ceremonira. Bazat e marrëveshjes që do t'u propozojmë të jenë këto: luftë e armatosur, e organizuar dhe pa kompromis kundër okupatorit; Balli Kombëtar të njohë këshillat nacionalçlirimtarë si i vetmi pushtet popullor e demokratik; të spastrojë nga radhët e veta kolaboracionistët, kriminelët, spiunët e spekulatorët; të pushojë menjëherë luftën dhe propagandën kundër Frontit dhe Partisë Komuniste, elementët pozitivë të Ballit të marrin pjesë në Front, të shpërndajnë «këshillat» e tyre etj. Kjo, pra, - përfundova, - të jetë platforma e bisedimeve që do të zhvillojë delegacioni ynë, të cilin do ta caktojmë këtu.

Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm dhe ata të Shtabit që ishin ftuar në mbledhje, aprovuan propozimet e mia, të cilat u pranuan si bazë e bisedimeve që do të bëheshin së afërmi me Ballin Kombëtar. Dukej se gjithçka ishte e qartë edhe për Ymer Dishnicën e Mustafa Gjinishin, të cilët vetëm pak ditë pas kësaj mbledhjeje do të luaniz një rol prej kapitulluesi në arritjen e marrëveshjes famëkeqe të Mukjes.

4. Një grackë dhe n, tradhti e rrezikshme

Menjëherë pas mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm, i ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe vështirësitë e takimit të fundit të delegacionit tonë me përfaqësuesit e Ballit, thirra e bhedova disa herë me Ymer Dishnicën e Mustafa Gjinishin jo vetëm që këta ta kuptonin mirë misionin e tare delikat, por edhe për të saktësuar dhe precizuar ieri në imtësi pikat kryesore, mbi të cilat do të zhvilloheshin bisedimet.

- Në asnjë mënyrë' në sjelljen dhe parashtrimin tuaj nuk duhet të ketë as edhe nuancën më të vogël të lëkundjes nga platforma jonë. Gjithashtu, duhet të treni parasysh që në asnjë mënyrë të mos i lutemi Ballit të bashkohet me w: lutje ne s'u treni bërë kur ishim pak, në fillim, dhe jo të bëjmë tani. Tonin e bisedimeve, - u thashë, - duhet ta japim ne dhe ata ta kuptojnë mirë që xre këtë ne po u nderim dorën për herë të fundit, që të dalin nga qorrsoaku e të shlyejnë fajet.

- Sigurisht, sigurisht, - aprovonte Dishnica, kurse Mustafa Gjinishi tuldte kokën e shtonte:

- Mos trini meral~ do të veprojmë siç duhet!

Mbasi diskutuam gjatë me shokët e udhëheqjes së Partisë, që ndodheshin ato ditë në Labinot, vendosëm që në delegacionin e Frontit Nacionalçlirimtar të hynte edhe Abaz Kúpi.

- Abazi, - i thashë Ymerit, - si e pe dhe vetë, e aprovoi platformën e bisedave që do të udhëheqësh ti në krye të delegacionit të Frontit me krerët e Ballit, por si ti, ashtu dhe Mustafai duhet të bëni kujdes me të dhe të kontrolloni veprimet, që të mos na e luajë bishtin.

- Mos ki merak, - përsëriti Mustafa Gjinishi, që mezi e mbante gëzimin ngaqë edhe Bazi do të ishte në delegacion, - Bazi mund të ndikojë te delegatët e Ballit.

- Ne jemi të informuar se midis krerëve të Ballit ka fërkime, ju duhet t'i shfrytëzoni ato. Se sa do të ndikojë Bazi, do ta shohim. Me të do të bisedoj edhe vetë. Në qoftë se të lind nevoja, - i thashë Ymerit, mund të tërheqësh edhe shokë të Partisë e të Frontit nga Tirana dhe Durrësi.

- Ndoshta nuk lind kjo nevojë, - tha i sigurt Ymeri.

- Nuk i dihet, - i thashë. - Ti kije parasysh!

Para se të largohesh nga Labinoti unë bisedova edhe me Abaz Kupin.

- Ti, zoti Abaz, - i thashë, - do të jesh në delegacion dhe besojmë se autoriteti dhe njohjet e tua me krerët e Ballit Kombëtar do të influencojnë për mirë.

- Unë do ta baj temen, - «premtoi» Bazi dhe pastaj shtoi: - Kam vetëm një kërkesë. . .

- Urdhëro, - i thashë.

- Due me marrë me vete edhe major Jahjain!

- S'kam asnjë ktndërshtim, - iu përgjigja.

Unë e njoh edhe perschalisht Jahja Çaçin. Bisedo me doktorin [Y. Dishnicën], dhe vendoseni vetë këtë punë.

Kush ishte ky Jah;a Çaçi? Në kohën e regjimit të Zogut Jahjai kishte qer,ë oficer madhor, por pas pushtimit flitej se ishte njëEri patriot që donte të luftonte. prandaj kishim punuar për ta hedhur me lëvizjen. Na ndihmonte në këtë drejtim edhe fakti se gruaja e tij ishte simpatizante e Pirtisë dhe një aktiviste e Luftës Nacionalçlirimtare dhe e tillë mbeti gjer në fund. Edhe djali i tyre, Hektori, ishte plotësisht me ne, aktivizohej në organizatën e rinisë, më vonë luftoi në 'legalitet, doli partizan dhe u bë një komunist e kuadër i mirë. Duke pasur parasysh ato që diheshin për Jahjain si dhe pjesëmarrjen e gruas dhe të djalit të tij në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, i vajta një ditë në shtëpi dhe bisedova me të: «Zoti Enver, - më tha, - unë nuk mund të ndahem as nga gruaja, as nga djali, pastaj edhe unë mendoj se e keni drejt këtë rrugë dhe do të luftoj tok me ju».

Mirëpo në realitet nuk bëri kështu; ai nuk ndoqi as rrugën e gruas, as të djalit dhe as të Luftës Nacionalçlirimtare. QëndrDi me ne sa për sy e faqe, dukej që anonte gjithmозë e më shumë nga Bazi i Canës dhe, kur ne u ndamë me këtë dhe e përjashtuam nga Fronti, Jahja Çaçi e ndoqi prapa, u fut përfundimisht në radhët e Abiz Kupit dhe ky e emëroi «shef të shtabit të forcave zogiste» që na u kundërvunë me armë dhe ne i likuiduim kur kaloi Divizioni I në Veri. Kështu mbaroi edhe Jahja Çaçi. Por në kohën për të cilën flas, në verën e vitit 1943, nuk kishim ndonjë gjë kundër Jahjait, veç rezervave për afrimin e tij me Bazin, tek i cili, sikurse kam thënë, nuk kishim pasur besim e iluzione.

Sado që të gjitha çështjet u rrahën mbarë e prapë dhe çdo gjë ishte e qartë, prapë meraku nuk më linte, sepse e dija se ç'kurthe ishin në gjendje të ngrinin «diplomatët» ballistë. Prandaj para se të nisej Ymeri për në Tiranë, bisedova edhe një herë me të.

- Nuk është e rastit që u caktove ti në delegacion, bile, edhe në krye të tij, - i thashë Dishnicës. Disa herë kemi qenë bashkë në bisedime me nacionalistë të ndryshëm, pra, ke njëfarë përvoje dhe e di ç'kurthe mund të ngrenë ata; nga ana tjetër, nuk je i panjohur për rrethet e tyre. Por, më kryesorja, ti je anëtar i Byrosë, pra, ke përgjegjësi të madhe partie. Dy gjëra të kesh mirë parasysh: E para, se Fronti Nacionalçlirimtar është e vetmja forcë që ka luftuar dhe lufton pushtuesin, e dyta, mos barro kurrë se Partia jonë është e do të jetë kurdoherë organizatorja dhe udhëheqësja e Luftës Nacionalçlirimtare...

- Pa dyshim, pa dyshim, - aprovonte herë pas here doktori.

- Nëse ngulim këmbë në pozitat tona, sipas platformës që kemi vendosur, puna e delegacionit dhe jotja është e thjeshtë, ndryshe situata do të ndërlikohet. Prandaj të mos lëshoni asnjë fije nga tezat që kemi aprovuar. Duhet të ruhesh nga të papriturat dhe për çdo gjë, - vazhdova, - merr kontakt me qarkorin e Partisë të Tiranës dhe nëpërmjet shokëve të atjeshëm na mbaj në korent të vazhdueshëm. Nga ana jonë, brenda rëndësive, do të r)dhmojmë, megjithëse ti Cështjet i ke të qarta. Mos barro se ky është një takim paraprak dhe kjo ta lehtëson mjaft punën, sepse në këtë takim nuk do të Inerren vendime, vetëm do t'i shtrosh Ballit Kombëtar ato çështje për të cilat kemi folur aq herë sa me siguri i ke mësuar përmendsh.

- Po në qoftë se delegatët e Ballit Kombëtar de klarojnë se i pranojnë pikat tona? - shtroi pyetjen Dishnica.

- Nuk besoj që kr?rët e Ballit Kombëtar t'i pranojnë këto, - iu përgj:gja. - Mund të kenë mbetur dhe në fakt kanë mbetur akoma elementë në radhët e Ballit Kombëtar që duan të luftojnë, po besoj se, në mos të gjithë, shumica e atyre që do të vijnë në takimin me ju nuk do t'i ptaojnë kërkesat tona. Sidoqoftë ne e shpallim hapta:i platformën tonë dhe kjo do të ketë reperkusione qoftë brenda Ballit, qoftë në populi. Kur ata të mos i pranojnë kërkesat tona, atëherë ne i demaskojmë haptazi si tradhtarë dhe populli do të kuptojë edhe një herë se fajin për «vëllavrasjen-, siç u pëlqen të shprehen tradhtarët, e kanë Lumo Skëndot me shokë.

- Dakord, - më tha Ymeri. - Po le të supozoj më se delegacioni i Ballit e pranon platformën tonë.

- Në këtë rast ju do ta quani punën tuaj të përfunduar, se kjo është detyra juaj dhe do t'i thoni delegatëve të Ballit që atd të shpallin publikisht se pranojnë të hidhen në luftë kundër armikut, se i njohin këshillat nacionalçlirimtarë si pushteti i vetëm politik i popullit në Shqipëri. Pastaj, do t'u thoni atyre, të fillojnë konkretisht lupën, domethënë çetat e tyre të godasin italianët dhe xhandarmërinë e ushtrinë e qeverisë së Tiranës, të përzënë kriminelët nga çetat, të tërheqin të gjithë anëtarët e Ballit Kombëtar nga institucionet kuislinge, të shpërndahen «këshillat» e Ballit. Kur ne të shikojmë praktikisht se sa i zbatojnë ata këto, se kanë gënjyer mjaft deri tani, atëherë mund të bëhet fjalë për një konferencë kombëtare, siç e biseduam, në të cilën do të marrë pjesë edhe Balli, ku do të shtrohen e do të zgjidhen të gjitha çështjet e bashkimit. Po kjo i takon së ardhmes dhe do t'u thuash delegatëve ballistë se për këtë nuk do të bisedohet tani, se nuk tremi kompetenca nga Këshilli.

- Të siguroj se gjithçka do të shkojë mirë, - tha Dishnica.

- Ashtu qoftë, - qesha unë, - veç mos harro se «kush fle me qentë, gdhihet me pleshta». Do të kesh të bësh me skile të vjetra...

- I kanë proverbiale hilet, - qeshi edhe doktori, - por kësaj radhe do të jenë vetë në kotec, s'kanë ku ta luajnë bishtin.

- Mbaj lidhje me Gogon në Tiranë e na informo për çdo gjë, - i përsërita edhe një herë në fund.

- Patjetër, - premtoi Ymeri.

Kështu, ai u nis në drejtim të Tiranës, kurse ne të tjerët morëm rrugën për në Korçë. Atje qëndruam në Shtyllë, Kucakë, Vithkuq, duke ndjekur nga afër përgatitjet përfundimtare për inaugurimin e formimit të Brigadës I Sulmuese.

Pas disa ditësh nga nisja e Ymerit, nëpërmjet një korrieri të dërguar nga Gogoja, vjen një letër e doktorit në emrin tim. Në letër Ymeri më jepte një informacion të shkurtër për gjendjen në Tiranë dhe në rrethet «nacionaliste», na shkruante për entuziazmin që kishte ngjallur në popull proklamata e Këshillit të Përgjithshëm mbi formimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë, për tronditjen që kishte shkaktuar ajo në ambientet e Ballit Kombëtar e të reaksionit; njoftonte për krijimin e një komiteti antifashist të universitarëve e të tjera lajme, që, sigurisht, ishte e nevojshme të njiheshin nga rie. Po për çështjen kryesore për të cilën kishte shkuar në Tiranë, kishte vetëm pak fjalë. Në letër flitej fare shkurt për një takim që kishte pasur Mustafa Gjinishi me Lumo Skëndon e Hasan Dostin, po se ç'ishte thënë atje, asnjë fjalë. «E po, sigurisht, mendova me vete, do të jetë biseduar për takimin e delegatëve tanë me të tyret».

Më 25 korrik, në mbrëmje, nga një radio me bateri që nuk e ndaja kurrë nga vetja, dëgjuam lajmin e grushtit të shtetit që kishte sjellë në fuqi Badolion e të arrestimit të Musolinit. Kjo ishte një ngjarje që fliste qartë për krizën e thellë politike, ekonomike e ushtarake të regjimit fashist, i cili duke sakrifikuar Duçen e tij, kërkonte të shpëtonte veten. Sidoqoftë, kjo ngjarje do të kishte reperkusione edhe në vendin tonë dhe për këtë duhej të ishim të përgatitur. Disa ditë pas këtij lajmi, duke qenë se edhe nga Ymeri, edhe nga qarkori i Tiranës nuk kishim asnjë lajm, i dërgova një letër Gogos, ku tërhiqja vëmendjen për mungesën e informacionit si për punën e takimit me Ballin Kombëtar, ashtu dhe për reagimet që kishte shkaktuar rënia e Musolinit në popull, në qarqet kuislinge dhe te Balli Kombëtar. Gjithashtu, në emër të Komitetit Qendror, jepja porosi për organizimin e gjallërimit e punës së Partisë, të shtypit e të propagandës, për vieprime të shpejta e të shkathëta në përputhje me kushtet e rrethanat. «Në lëvizje, - theksoja në letër, - të shkundim burokracinë, ndryshe do të humbasim».

Më në fund, në ditët e para të gushtit na vjen një letër nga Shafingoja,* *(Pseudonimi i Ymer Dishnicës) ku më «informonte» për takimin e parë që kishin pasur me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar. E lexova letrën menjëherë dhe, kur arritë në fund, mendova se mos e kisha lexuar pa kujdes, se, të them të drejtën, pak gjëra kuptova nga ajo. E lexova prapë dhe u binda se informacioni i Ymerit, megjithëse kishte edhe një «procesverbal» për një takim që qe bërë në fshatin Tapizë, pranë Tiranës, e megjithëse përmendeshin emra e fakte ku s'harrohej të flitej për Lumon e Dostin, për Bazin e Mustafain e ku përshkruhej edhe exodi i ballistëve të Tiranës për në «mal» etj., nuk na fliste shkoqur për ato që pritnim. Çështjet themelore për të cilat Dishnica duhej të raportonte, në letër kaloheshin përciptazi, me dy-tri pika të mjegullta që s'thoshin asgjë.

Më tërhoqi veçanërisht vëmendjen një pikë, ku flitej për idenë e krijimit të një «Komiteti të përbashkët». Nuk ishte e vështirë të ndieje se në idenë e krijimit të këtij «komiteti» fshihej një kurth dhe grackë.

- Në Tapizë po na u projektoka një krijesë e çuditshme, - thashë dhe vështrova nga shokët që kisha pranë.

- Çfarë? - tha Sej fullai ngadalë, si të shkëputej me zor nga pesha e mendimeve.

- Doktorin na shkruan se në Tapizë na kanë hartuar një procesverbal në formën e një marrëveshjeje me katër pika dhe një riga pikat qenka dhe krijimi i një -Komiteti të përbashkët».

- Ashtu, - tha Sej fullai, dhe si u mendua pak shtoi : - megjithatë. . .

Nuk m'u durua dhe e ndërpreva:

- Tanfi për tanfi, përderisa Balli Kombëtar nuk i plotëson kushtet tona për bashkim, përderisa ai nuk Qshtë hedhur realisht në luftë dhe përderisa nuk i ka spastruar radhët e veta nga kriminelët, as që mund të bëhet fjalë për asnjë lloj organi apo «komiteti» të Frontit dhe të Ballit Kombëtar.

- Më falni, - ndërhyri Sejfullai, - a e sqaron Ymeri se si është diskutuar, ar çështja e këtij komiteti?
- Jo, - i thashë, -- por Ymeri nuk ka përse të hyjë në bisedime të tilla, për të cilat nuk e ka autorizuar njeri, bile e kam paralajmëruar posaçërisht për këtë gjë.

- Po për reagimin ndaj rrëzimit të Duçes ç'shkruan? - pyeti Nakoja.

- Kjo, siç duket, - u thashë shokëve, - ka ngjallur edhe më shumë oreksin e ballistëve për të kapur sa më parë kolltukët e qeverisë, sepse, siç shkruan Ymeri, krerët e Ballit kanë lënë kolltukët e Tiranës e po «vrapojnë» në mal.

Është fjala për atë episod në historinë tragjikomike të krerëve tradhtarë të Ballit, të fundit të verës 1943, që tashmë e njohin të gjithë e që aq bukur, saktë e me humor e përshkroi pak më vonë shoku dhe bashkëluftëtari ynë, shkrimtari revolucionar Shevqet Musaraj në të famshmen «Epopeja e Ballit Kombëtar».

Sapo mësuam lajmin e rrëzimit të Duçes, bile pasi u siguruan mirë e mirë se kalit fashist i ranë vërtet potkonjtë, «kapedanët» e Ballit kërcyen nga euforia, menduan se u bë deti kos dhe gjykuan se u erdhi vakti për ndarjen e kolltukëve qeveritarë. Por, që t'i hidhnin tradhtisë së tyre të gjertanishme një andër prej «çlirimtarësh», ballistët, të mbërthyer nga zjarrllëku i pushtetit, i braktisën për disa ditë zyrat «ilegale» dhe kafenetë e Tiranës dhe dolën «në mal» në mënyrë demonstrative, natyrisht, pa harruar të merrnin me vete edhe takëmet e kafesë, raki e shurupra, pizhama e shtretër portativë. Të veshur e të ngjeshur me rripa fishekësh të kryqëzuar në gjoks, me revole, dylibi, bomba dhe çanta oficerësh nga të shtabeve, çetat e Ballit, të thirrura posaçërisht në zonën ku bëhej takimi midis delegacionit të Frontit dhe atij të Ballit, demonstroi «forcë». Kjo lukuni ujquish jetonte akoma me të vjetrën dhe mendonte se, megjithëse nuk kishin zbratur asnjë pushkë, u takonte atyre të qeverisnin vendin akoma të pushtuar. Punë e madhe, mendonin ata, se populli, partizanët e komunistët kanë derdhur e po derdhin gjakun për liri, i fortë është ai që i nxjerr gështenjat me mashën e të tjerëve. Sipas tyre, në çastin e duhur mjaftonin disa poza patriotike, paradat dhe, me të ikur Italia, pritnin të futeshin si «çlirimtarë» në Tiranë e gjetkë dhe të merrnin frenat në dorë. «Elita», sipas tyre, mbetej «elitë» dhe ç'punë tjetër mund të bënin ata veçse të sundonin e të qeverisnin!! Sa për popullin që i kishte parë e dëgjuar hyneret e Ballit Kombëtar, këtij, mendonin udhëheqësit ballistë, ia mbyllim sytë me «trimërirat» që do të bëjmë në aksham dhe, në s'mjaftofshin këto, inskenojmë edhe një «akt historik»: shpallim pavarësinë dhe rrëzojmë vendimet e «asamblesë» të 12 prillit 1939 që shpalli bashkimin e Shqipërisë me Italinë dhe i ofroi Viktorit të Savojës kurorën e Skënderbeut!

Se si përfundoi kjo «dalje» e parë e Ballit në mal, dihet mirë: sapo hynë autobлиндat gjermane në Tiranë, «trimave» të akshamit u ranë pendët, hynë me vrap në «ilegalitet» kafenesh dhe i çuan fjalë komandaturës naziste se në mal s'kishin qenë për tjetër punë, por për verim!

Por këto do të ndodhnin pak më pas; le të kthehemi te momentet kur në duar kishim letrën e parë të Y. Dishnicës e mundoheshim të merrnim me mend se ç'bëhej e ç'thurnin atje të dërguarit tanë me krerët tradhtarë Mithat Frashëri, Hasan Dosti e të tjerë.

Nga toni ironik me të cilin Y. Dishnica na përshkruante propozimin e Hasan Dosit për «shpalljen e indipendencës», m'u krijua përshtypja se, të paktën për këtë gjë, delegacioni ynë s'do të binte në grackën e Ballit. Megjithatë u thashë shokëve:

- Asgjë konkrete e të qartë s'marrim vesh nga mënyra si na shkruan Ymeri, por duhet t'i theksojmë këtij që t'ua hedhë poshtë me forcë propozimin që bëjnë. «Pavarësia e Shqipërisë, t'u thuhet ballistëve, nuk fitohet me karta e me marrëveshje. Me këtë propozim, t'u thuhet, ju zotërinj doni të mbuloni e të lani aktin e pushtimit të 7 prillit 1939, ku ju dpe shokët tuaj ishit pjesëmarrës e u dhatë bekimin fashistëve italianë. Tani doni që edhe ne të bëhemi pjesëmarrës në mbulimin e atij akti të rëndë. Jo! T'u thubet: pavarësinë do ta fitojmë me luftë, prandaj për këtë e vetëm për këtë do të bisedojmë».

Këto e shqetësime të tjera që më lindët nga informacioni i mjegullt i Y. Dishnicës, na shtyrlë të kërkonim sa më shpejt sqarime të hollësishme, pdaj vendosëm t'i dërgonim atij një letër urgjente. Por s'arrita ta përfundoja përgjigjen për letrën e parë, kur na vjen një letër tjetër, e cila më shqetësoi dhe, ç'është e drejta, edhe më nervozoi.

- Doktori më duket se po humbet kohën kot atje, - u thashë shokëve dhe u dhashë letrën e Ymer Dishnicës.

Sejfullai e mori në dorë dhe i hodhi një sy nga fillimi në fund me një shprehje si të merakosur.

- Çështjet janë me rëndësi; Enver, dhe s'ka ndonjë të keqe që diskutojnë, rrahin mendimet, - ishte përgjigjja e tij.

- Ç'na përrallis, Sejfulla! - s'm'u durua mua. Për të tjera gjëra i porositëm ne Ymerin dlie Mustafain, për të tjera gjëra po diskutojnë. Dëgjo se ç'shkruan, - i thashë, - dhe mora prapë në dori letrën e Ymerit e lexova: «Në bisedime na ngatërrni ideja e shpalljes së independencës dhe e Shqipërisë etnike!». Unë s'po e marr dot vesh ç'i duhet atij të nRatërrohet me këto çështje.

- Do t'i ketë ngritur Balli këto probleme, - u hodh Nakoja.

- Doemos që Balli i ka ngritur, po Ymeri bashkë me Mustafain nuk duhej t'i kishin qasur fare në tryezë këto çështje. Ata duhej të kishin shtruar platformën tonë dhe të kërkonin përgjigje për to.

- Të drejtë ke, - më tha Nakoja, kurse Sejfullai nuk foli më.

Letra e dytë e Ymer Dishnicës, përsëri nuk thoshte ndonjë gjë të madhe dhe, siç kuptova pak ditë më vonë, nuk informonte me saktësi për zhvillimin e bisedimeve. Vetëm një gjë linte të kuptohej qartë: në Mukje, pranë Tapizës, ku qe zhvilluar «faza e dytë» e bisedimeve, orkestrën e kishte dirigjuar Balli Kombëtar dhe, në vend që delegacioni ynë dhe veçanërisht Ymeri e Mustafa Gjinishi t'i jepnin tonin mbledhjes e të kërkonin përgjigje për ështëjet që shtronim ne, dilnin Mithat Beu e Hasan Dosti që devijonin platformën e bisedimeve aslitu siç donin ata. Mjaftonte vetëm ky fakt që të konk:ludohej se delegatët tanë nuk po zbatonin udhëzimet që u ishin dhënë nga udhëheqja e Partisë dhe nga Kr;yesia e Këshillit të Përgjithshëm. Ymeri nuk na shkruante se ndërkohë marrëveshja ishte bërë; ai jo vetëm qe ngatërruar, por kishte rënë kokë e këmbh në grackën që i kishte ngritur Balli Kombëtar.

Brenda ditës u ula dhe shkrova një letër të gjatë, e cila është botuar,* *(Shih: Enver Hoxha. V7epa, vëll. 1, botim i dytë, f. 419.) priandaj do të përmend vetëm çështjet kryesore që i shtroja Ymer Dishnicës.

- Na duket, - thelksjoja në letër, - se zhvillimi i bisedimeve ka marrë Injë rrugë të gabuar. Ju nuk treni vajtur atje për të diskutuar për indip(ndencën dhe për Shqipërinë etnike, por që Via vini .3allit dy këmbët né një këpucë dhe t'i shtroni delegatve të tij këto çështje: të futet menjëherë né luftë, të pranojë bashkëpunimin né këshilla dhe, mbasi të kett luftuar, mund të futet né shtab dhe të marrë pjesë né një konferencë kombëtare, ku do të vijnë patriotë nga të gjitha anët.

Këto duhet të jenë thelbi i bisedimeve che jo të diskutohet për marrëzi të tilla si shpallja e independencës pa e zbuar okupatorin. Dhe më e bukura, - i vija né dukje Dishnicës, - është se këtë e ngrenë ballistët, të cilët as kanë luftuar dhe, si po duket, as kanë ndër mend të luftojnë.

Né letër u sugjeroja delegatëve tanë që i.isistimin e Ballit Kombëtar për «shpalljen e pavarë:isë», dhe «rrëzimin e vendimit të asamblesë të 12 prillii» të mos e trajtonin thjesht si një këmbëngulje të n~ë juristi formalist e skolastik.

«Po t'i hidhni një sy listës sé pjesëmwrësve të asaj «asambleje», - i shkruaja né esencë Y:nerit, do të gjeni atje të gjithë Ballin Kombëtar. NE dhe populli nuk e kemi njohur ndonjëherë atë <wendim», prandaj s'kemi pse të bëhemi ortakë me Ballin, i cili, me një akt gjoja juridik, kërkon të lajë gjynahet që tra bërë».

Më poshtë e udhëzoja që të mos hynte hë diskutime për çështjet që ngrinte Balli Kombëtat, të mos merrej më me sofizmat juridikë të krerëve të tij dhe i përsërisja edhe një herë, bile né formë pikash, se ku duhej të konsistonte objektivi i bisedimeve që po zhvilloheshin.

Né fund të letrës e këshilloja Ymerin të ruante mprehtësinë dhe gjakftohtësinë né gjykime, të mos rrëmbehej nga evemmentet, po ato Vi përdorte né favorin tonë; hidhja poshtë parullën që kishte lëshuar Mustafa Gjinishi se «fashizmi vdiq» dhe theksoja se kishim akoma luftë për të bërë kundër tij. Veç këtyre i shkruaja për veprimet armiqësore të bandave të Ballit Kombëtar kundër forcave tona dhe i futa né zarf edhe disa materiale që dëshmonin se Balli vazhdont, luftën kundër nesh dhe bashkëpunimin me armikun. Për të gjitha këto ata kishin fakte të shumta, por né letrën time i përshkruaja edhe episode që kishin ndodhur né zonën e Korçës, ku ishim vendosur ne né kohën që Ymeri e Mustafai flirtonin me delegatët ballistë né Tapizë e né Mukje.

Letrat dhe udhëzimet për Ymer Dishnicën u nisën menjëherë dhe arritën në destinacion në një kohë shumë të shkurtër për kushtet tona të ndërlikueshëm, po Ymeri e Mustafai ndërkohë kishin nxituar ta përfundonin akordin me Ballin Kombëtar, pa pritur mendimet dhe orientimet e udhëheqjes së Partisë.

Nuk kaluan as dy ditë dhe marrim vesh se kishte dalë një trakt në emër të «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë», ku flitej për bashkimin që ishte arritur midis Frontit tonë Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar! Ky lajm na alarmoi dhe menjëherë gjykoam se, pavarësisht nga përmbajtja e traktit, shpallja e një bashkimi me Ballin Kombëtar dhe krijimi i një «komiteti», në një kohë kur kjo organizatë nuk kishte dhënë asnjë provë, ishte një veprim shumë i gabuar, shumë i dëmshëm dhe në kundërshtim të plotë me vijën tonë. Kërkuam nga shokët e Tiranës, që na dërgonin urgjentisht një kopje të traktit dhe menjëherë shkrova një qarkore drejtuar organizatave të Partisë për dënimin e marrëveshjes së Mukjes.* *(Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, botim i dytë, f. 428.) Në këtë qarkore në emër të Komitetit Qendror të Partisë, urdhëroja të grisej marrëveshja, të mos flitej për të dhe në propagandën tonë të shpjegohej vija dhe kushtet tona në bazë të të cilave ishte e mundur të arrihej një bashkim i vërtetë.

Pasi e shkrova qarkoren ua dhashë ta lexonin edhe Nakos e Sejfullait.

- Sikur të pritnim njëherë, të na vinte edhe trakti e pastaj të gjykonim, - më thanë.

- Në asnjë mënyrë! - theksova në fjalë kategorike. - Edhe me qaq sa dimë, ajo marrëveshje duhet denoncuar sa më parë, ndryshe do të shkaktojmë konfuzion në Parti e në popull. A jeni dakord, që delegatët tanë kanë shkëlur vijën?

- Kështu duket, - tha Nakoja, ndërsa Sejfullai lëvizti vetëm kokën.

- Po për përmbajtjen e letrës a keni vërejtje?

- Jo, - thanë të dy.

- Atëherë ta dërgojmë, pastaj, kur të na vijë trakti, do të shohim se sa thellë janë shtyrë Ymeri me Mustafain.

Dhe kështu u bë.

Kur na arriti të nesërmen një kopje e traktit famëkeq, të aprovuar nën ulla të Mukjes, e kuptuam edhe më mirë se çfarë çorbe kishin gatuar Ymeri e Mustafai, ç'tradhti e dënueshme dhe ç'grackë e rrezikshme u qenë ngritur Partisë, popullit, Luftës sonë Nacionalçlirimtare.

I rashë tavolinës me grusht, në zyrën e Shtabit në Vithkuq, dhe i shkrova në çast Ymerit një letër,* *(Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, botim i dytë, f. 432.) pa e mbajtur dot inatin për këtë tradhti të ulët që i bëhej luftës sonë; gjakut që kishim derdhur, privacioneve, fitoreve të arritura, idealit të lartë që kishim ngjallur në zemër të popullit dhe të partizanëve. Duke i ditur pasojat e rrezikshme që mund të kishte akordi i Mukjes, nuk e mbaja dot zemërimin që ziente brenda meje. E dija, gabimi i Mukjes nuk ishte gabimi i Partisë sonë, po gabimi i një-dy personave, veçse Balli këtë gabim do ta shfrytëzonte, siç po e shfrytëzonte, gati pa u tharë ajo bojë me të cilën Ymeri kishte nënshkruar marrëveshjen e turpshme të Mukjes. Ky hap i pafalshëm, ky gabim i rëndë, nëse s'do të mënjanohej urgjentisht, do të kishte pasojat të paimagjinueshme në masën e popullit, në fatet e luftës e të revolucionit tonë.

- Ti, - i shkruaja mes të tjerash Ymer Dishnicës, - ke rënë kokë e këmbë në pozitat e Ballit, i cili përpiqet të fshijë të kaluarën. Në traktin tuaj flitet për Shqipërinë etnike dhe nuk flitet aspak për luftën tonë kundër fashizmit, nuk thuhet asnjë fjalë për Partinë Komuniste. Keni vënë shenjën e barazimit në mes Ballit Kombëtar, që është një shportë karavidhesh, një organizatë me një numër të kufizuar njerëzish, dhe Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, që përfaqëson Frontin Antifashist të popullit.

I vija në dukje, gjithashtu, se me atë akt kompromisi, me një të rënë të penës ishin fshirë këshillat, Shtabi dhe ushtria, që i kishim ngritur me aq shumë gjak -e sakrifica, dhe në vend të gjithë këtyre na doli një «Komitet për shpëtimin e Shqipërisë» që, në fakt, do t'i bënte varrin Shqipërisë!

Si konkluzion, e vija në dijeni Ymer Dishnicën se Komiteti Qendror e dënonte ashpër marrëveshjen oportuniste të Mukjes si një shkelje të rëndë të vijës politike të Partisë. Në fund të letrës e urdhëroja të ndërpriste çdo lloj bisedimi e të mos bëhej asnjë marrëveshje tjetër; u theksoja Ymerit, Mustafait

e të tjerëve se ishin të zhveshur nga çdo kompetencë për të përfaqësuar Frontin Nacionalçlirimtar; Partia, nëse ishte e nevojshme, do të dërgonte atje një delegat tjetër.

Ishte e domosdoshme të veprime në mënyrë kaq urgjente në atë situatë, sepse çdo ditë që kalonte pas shpalljes së marrëveshjes së Mukjes, të cilën propaganda balliste nuk vonoi ta reklamonte me të madhe, do t'i shkaktonte dëme punës dhe luftës sonë, do të shkaktonte konfuzion e hutim tek anëtarët e Partisë dhe te pjesëmarrësit e tjerë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Prandaj pa pritur një mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror apo të Byrosë Politike, të cilat në kushtet e luftës do të donin kohë të bëheshin, çështjen e diskutova me ata anëtarë të udhëheqjes së Partisë që ndodheshin në Kucakë. Veç Nakos, që ishte anëtar i Byrosë Politike, Sejfullait që ishte i ooptuar kandidat i Komitetit Qendror dhe disa shokëve të tjerë të udhëheqjes së Partisë që ndodheshin në zonën e Korçës gjatë kësaj kohe thirra edhe Koçi Xoxen, që, pas shoqërimit që i kishie bërë Tempos në Greqi, ishte kthyer dhe sorollatej në për-fshatrat dhe merrej me gjëra të vogla. Lidhur me qëndrimin për veprën e Ymer Dishnicës e të Mustafa Gjinishit nuk pati kundërshtime. Bile edhe Sejfullai, mik për kokë me Ymerin, nuk mundi t'i dilte në mbrojtje dhe u solidarizua me pikëpamjen e përba,,hkët. Vetëm Koçi Xoxe, si pa qëllim, hodhi një pilulë të helmatisur, dulce thënë:

- Të mos i kishim bërë fare këto bisedime, se ja ç'na doli.

Sejfullai i ngriti veçhët.

- Méndon gabim, - ia ktheva Koçit. - Vendimi që morëm për të biseduar edhe një herë me Ballin Kombëtar ishte i drejtë dhe në vijën e Partisë. E drejtë ishte edhe platforma e bisedimeve që aprovuam, po Ymeri dhe Mustafai ë gjitha i shkelën.

- Po ja që këta e komprometuan vijën! - tha

Koçi Xoxe.

- Ata komprometuan bisedimet, po jo vijën e Partisë dhe të Frontit. Ne denoncojmë aktin e Mukjes, pikërisht se shkel vijën tonë politike.

Koha vërtetoi se sa i drejtë e shpëtimtar ishte qëndrimi i prerë e intrasigjent që vendosëm e mbajtëm ndaj asaj çka u kurdin në Mukje. Po të pranonte tradhtinë e Mukjes, Partia do t'i kishte duart e lidhura, do të ishte e detyruar të bënte lëshime të tjera oportuniste, do të përfshihej nga konfuzioni e do të përçahet, do të humbiste gjithçka kishte fituar e, në mes tyre, edhe besimin e masave. Pranimi i kësaj marrëveshjeje dhe i të ashtuquajturit Komitet për shpëtimin e Shqipërisë do të kërcënonte e do të vinte në një pikëpyetje tragjike të ardhmen e atdheut. Ky «komitet», i cili, siç nënshkroi Ymer Dishnica, do të kishte një numër të barabartë përfaqësuesish, do të synonte të bëhej organ epror i luftës dhe i pushtetit; anëtarët ballistë të tij do të bënin çmos të eliminonin Këshillin e Përgjithshëm, Shtabin e Përgjithshëm dhe, mbi të gjitha, rolin udhëheqës të Partisë Komuniste. Vetë krijimi i këtij organizmi do të thoshte ndarje e pushtetit me borgjezinë e madhe dhe me feudalët, të cilët, nëpërmjet përfaqësuesve të vet, si Ali Këlcyra, Mithat Frashëri e të tjerë, do të tentonin të realizonin interesat e vet. Fillimisht këta ishin të detyruar të na njihnin si partnerë dhe luftonin të viheshin në një radhë me ne, por nesër do të tentonin të na hiqnin nga mesi, për të marrë veto frenat e pushtetit, për të vendosur në Shqipëri një regjim feudo-borgjez të moderuar, me një maskë demokratike.

Nuk mungojnë rastet nga historia që vërtetojnë se sa shtrenjtë kushtojnë gabimet oportuniste në momentet kyç të luftës dhe të revolucionit. Shtrenjtë i kushtuan popullit grek dhe Partisë Komuniste Greke aktet kapitulluese të udhëheqësve të kësaj partie me organizatat e grupimet reaksionare vendase, simotrat greke të Ballit Kombëtar. Deri atëherë Partia Komuniste ishte në Greqi forca më e madhe organizuese e drejtuese në luftën për çlirimin e vendit nga pushtuesit gjermanë. Ishin komunistët iniciatorët e krijimit në shtator 1941 të EAM-it, të Frontit të Çlirimit të Greqisë. Partia greke në këtë front, ku mori pjesë edhe Partia Demokratike Popullore dhe pa'riotë të tjerë, luante një rol udhëheqës dhe arriti të ngrinte popullin në luftë për çlirimin kombëtar e shoqëror, filloi dhe rriti luftën e armatosur, krijoi ushtrinë nacionalçlirimtare, ELAS-in. Por më pas udhëheqësit e PK Greke e humbën toruan, iu nënshtruan presionit të reaksionit dhe «miqve» anglo-amerikanë. Siantosi, sekretari i përgjithshëm i partisë, në mungesë të Niko Zahariadhisit që ishte në një kamp përqendrimi, veprroi si një provokator dhe agjent i anglezëve, por edhe të tjerët nuk reagueshan ndaj marrëveshjeve që u bënë në Liban e në Kazerta, ku u bë pajtimi me reaksionin dhe u formua një

qeveri e përbashkët. Se si vajti filli i ngjarjeve në Greqi dihet dhe s'është vështirë të kuptohet faji i rëndë i udhëheqësve të partisë greke. Dua të shënoj këtu se qysh në atë kohë, Partia jonë ka shfaqur mendimin e saj për Varkizën dhe marrëveshjet e tyre të tjera, dulce i konsideruar ato akte si tradhti ndaj Partisë Komuniste dhe popullit grek. Këtë mendim, bashkë me të tjera rezerva për pikëpamjet e veprimet e udhëheqjes së kësaj partie, ua kam shprehur edhe Zahariadhisit e Parcalidhisit, qoftë kur jam takuar vetë me ta, qoftë në takimin e përbashkët që kemi bërë me Stalinin dhe Molotovin në janar të vitit 1950.* *(Shih: Enver Hoxha. «Me Stalinin (Kujtime)», botim i dytë, f. 157.)

Partia jonë nuk ra në gracka të tilla dhe nuk lejoi të luhej me interesat e popullit ë të atdheut. Ajo veproi me guxim dhe me pjekuri, ndonëse ishte një Parti e re dhe e vogël në numër. Ajo kishte forcën e madhe të popullit që e lindi, besimin në drejtësinë e teorisë së pagabueshme marksiste-leniniste, kishte guximin, mençurinë dhe aftësinë për të mënjanuar në kohën e duhur çdo gabim ose akt tradhtie të personave të veçantë, siç ishte edhe rasti i rëndë i tradhtisë së Mukjes.

III

KËSHILLAT NACIONALÇLIRIMTARË - PUSHTETI I VETËM NË SHQIPËRI

Agonia e qartë e pushtuesve italianë dhe e bashkëpunëtorëve të tyre të hapur, në fundin e verës së vitit 1943, po shoqërohej jo vetëm me egërsimin gjer në çmenduri të vetë atyre që po mbyteshin, por edhe me gjallërimin e orekseve e me intensifikimin e përpjekjeve të reaksionit «në rezervë», që shpresonte të shfrytëzonte situatat për të marrë pa çak e pa bam frenat e Shqipërisë në dorë. Partia jonë, e vetmja forcë e brendshme politike e organizuar, që në krye të popullit kishte dhënë kontributin maksimal për ta çuar pushtuesin në agoni, tash ndodhej përballë detyrash e provash të tjera, të rënda e vendimtare.

S'duhej lejuar në asnjë mënyrë që mbi gjakun dhe sakrificat e popullit, të komunistëve, të të gjithë patriotëve të vërtetë të fitonin ata që gjer tani kishin ngrohur kolltukët. S'duhej lejuar në asnjë mënyrë që në këto momente decizive të humbitnin e të zaptuhe shin nga të tjerë ai rol dhe ai autoritet i padi.skutueshëm që kishin fituar në luftë e sipër Partia, Fronti Nacionalçlirimtar e këshillat nacionalçlirimtarë. Përkundrazi, këto duheshin ruajtur e konsoliduar më tepër jo vetëm de facto, përmes luftës me armë por edhe de jure, përmes vendimeve të patundura të përfaqësuesve të popullit. Kushtet për një hap të rëndësishëm e vendimtar drejt këtij konsolidimi ishin pjekur. Kishin ardhur çastet për organizimin e Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

1. Moment vendimtar drejt marrjes së pushtetit (Konferenca e Labinotit 4-9 shtator 1943)

Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, ose, siç i themi shkurt. Konferenca e Dytë e Labinotit, zë, pa dyshim, një nga vendet më të shquara në vargun e ngjarjeve historike të Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Veçanërisht në historinë e krijimit, të forcimit e të gelikosjes së pushtetit popullor në Shqipëri, organizimi i kësaj Konference dhe vendimet e saj kanë pasur e do të kenë rëndësi dhe vlera të jashtëzakonshme.

Duke theksuar rëndësinë e kësaj ngjarjeje, s'duhet menduar kurrsesi se ideja për organizimin e kësaj Konference lindi papritur, në fundin e gushtit 1943 dhe as se për të ne na shtynë ato që ndodhën në Mukje. Jo, situatat e gushtit 1943 dhe ngjarjet në Mukje do të shërbenin e shërbyen si përshpejtues e

si faktorë që të mblidhej sa më shpejt kjo Konferencë, por ideja e nevoja për organizimin e saj kishin lindur e qenë shtruar shumë më parë.

Qysh në Konferencën e Pezës në shtator 1942, ku hodhëm themelet e Frontit e të këshillave nacionalçlirimtarë, ne theksuam se në të ardhmen, kur këshillat të qenë ngritur e shtrirë në pjesën më të madhe të territorit të vendit, kur të që rritur e konsoliduar roli e autoriteti i tyre në popull, duhej të organizohej Kon

ferenca e Dytë Nacionalçlirimtare për të bërë bilancin e asaj ç'që arritur e për të përcaktuar detyrat për të ardhmen. Konferenca e Parë e PKSHP e marsit 1943, duke vlerësuar punën e madhe që ishte bërë në këtë drejtim të rëndësishëm të luftës, konkludoi se kushtet për Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të popullit

shqiptar po piqueshin, kurse pak muaj më pas, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Provizor të korrikut 1943 në Labinot, u vendos përfundimisht për thirrjen në një të ardhme të afërt të mbledhjes së përfaqësuesve të popullit shqiptar. Bile «Kryesisë» ose «sekretariatit» të Këshillit të Përgjithshëm që ne zgjodhëm në korrik në Labinot, i ngarkuam si detyrë kryesore e urgjente pikërisht përgatitjen e Konferencës së ardhshme dhe, menjëherë pas kësaj, nisëm nga puna përgatitore.

I theksova këto për të nënvizuar edhe njëherë një të vërtetë të madhe: asnjë mbledhje, sidomos kur ishte fjala për mbledhje të përmasave kombëtare, ne nuk lejuam të bëhej, si i thonë fjalës, në këmbë, ngaqë «doli rasti», ngaqë «kështu rrodhën punët». Jo, Partia, ashtu siç mori iniciativën për Konferencën e Pezës, kur gjykoj se ishin pjekur kushtet e mundësitë për atë Konferencë, po të njëjtën gjë bëri edhe për Konferencën e Dytë. Mbledhje e konferenca kot, të shpejtuara, sa për numër ose për të vendosur gjëra që s'u kishte ardhur dita, ne as lejuam e as pranuan të zhvillonim ndonjëherë.

Problemi themelor ku do të përqendronte vëmendjen Konferenca do të ishte ai i forcimit e i konsolidimit të rolit të këshillave nacionalçlirimtarë, i njohjes së këtyre këshillave nga të gjithë ata që shpreheshin dhe ishin për luftë të vërtetë e konkrete kundër pushtuesit dhe, lidhur me këtë problem kryesor, do të diskutoheshin edhe detyrat për zgjerimin e organizimin e mëtejshëm të luftës së madhe e të përgjithshme kundër zgjedhës së huaj.

Pikërisht, në kuadrin e këtyre detyrave e përgatitjeve u bë edhe tentativa jonë e fundit për bisedimet me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar në Mukje. Siç shkrova hollësisht më lart, kërkesat që ne vendosëm t'u shtronim përfaqësuesve të Ballit ishin plotësisht në përputhje e në funksion të problemeve që do të diskutonte Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare. Nëse Balli do t'i pranonte kërkesat tona (gjë që krerët e tij tradhtarë s'do ta bënin kurrë), ne do t'i linim kohë të vërtetonte e të provonte në luftë se sa i kishte seriozisht e, pastaj, da t'i ftonim dhe ata të merrnin pjesë në Konferencë. Në të kundërtën, ne do t'i raportonim Konferencës se ç'përpjekje e punë të madhe kishim bërë me krerët e kësaj organizate, do të jepnim provat e argumentet se Balli ishte një organizatë tradhtarë dhe Konferenca e përfaqësuesve të popullit do të vensoste përfundimisht edhe për qëndrimin e mëtejshëm ndaj saj.

Kështu, pra, në momentin e duhur në bazë të një analize e gjykimi të pjekur, vendosëm për organizimin e Konferencës së Dytë të rregullt Nacionalçlirimtare dhe qysh në korrik, krahas detyrave të tjera, nisëm punën edhe për përgatitjen e saj.

Ngjarjet që do të ndodhnin e situatat që do të krijoheshin menjëherë pas kësaj, vërtetuan se sa i drejtë e i peshuar kishte qenë vendimi ynë për organizimin e kësaj Konference.

Ngjarja e parë e me reperkusionet më të thella në zhvillimin e ndërlikimin e situatave në këto momente ishte rrëzimi nga fuqia më 25 korrik 1943 i diktatorit fashist Benito Musolini. Ky lajm, që fliste qartë për kapitullimin e shpejtë të Italisë fashiste, edhe na gëzoi pa masë, sepse populli ynë, krahas popujve të tjerë, kishte dhënë kontribut të madh për këtë fund të fashizmit italian, -edhe na shtroi detyra të reja. Nga njëra anë, duhej të mobilizonim e të udhëhiqnim më me hov masat popullore për ta bërë sa më të afërt aktin e kapitullimit të fashizmit, nga ana tjetër, të tregoheshim vigjilentë e të vendosur për të bërë që frytet e fitores t'i merrte vetëm ai që i takonin, populli luftëtar.

Rreziqet e vështirësitë në këto drejtime po shtoheshin e po bëheshin më komplekse. Rënia e Musolinit i bëri fare papritur marionetat e kombit të nxirrnin në skenë një farsë të re «antifashiste». Ata që gjer tani trashnin tulet në grazhdin e imperos e luteshin për Musolinin, morën malet dhe akshamin e fashizmit u përpoqën ta kthenin në «7 ditët e kiametit»; duke na u tundur si «trima luftëtarë», menduan se kishte ardhur vakti për të marrë në dorë pushtetin e amëshuar e të destinuar vetëm për ta! Nga kush do ta merrnin në dorë pushtet? Për llogari e pazar kgta matrapazë politikë s'e kishin shokun: nëse s'do të kishte implikime të huaja, ishin siguruar se pushtetin do t'ua lëshonin, si bakshish, në borsalinën e kthyer përmbys, fashistët italianë; nëse hynin gjermanët, ashtu sic po tregonin bathët, do të dilnin para tyre si «clicrimtarë të brendshëm» dhe, nën bajonetat naziste, do të bënin ç't'u kërkonte Gestapoja gjersa të binte edhe Hitleri e, pastaj, pushteti u mbetej në dorë. Po aq të fituar, bile faqe më me pder (!), do të dilnin edhe nëse vakuumin e krijuar pas ikjes së italianëve do ta zinin, sic po flitej, aleatët anglo-amerikanë. E dinin mirë se Çërcilli s'qe më pak antikomunist sesa Musolini e Hitleri. Vërtet anglezët e amerikanët, si pjesëtarë të koalicionit antifashist, po të hidhnin këmbët në Shqipëri pas lufte do t'i mbanin vetë frenat, por për ballin e tradhtisë kombëtare kjo «e keqe» e vogël, ishte edhe një e mirë e madhe: Nën mbrojtjen angleze bota e vjetër do të siguronte e do të konsolidonte pushtetin; haract le t'i paguante kush të donte.

Pra, sido që të paraqiteshin situatat, kushdo i huaj të vinte në Shqipëri, për «baballarët e kombit» s'kishte rrezik: ata qenë të të gjithë flamurëve të turpit. Për ta mbetej vetëm një armik i madh, i rrezikshëm e Ydekjeprurës: Lëvizja Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar e udhëhequr nga Partia Komuniste. Në situatat që u krijuan, pra, pas rënies së Musolinit, krerët e Ballit panë më qartë se kurrë te PKSH, te Fronti e te këshillat nacionalçlirimtarë rrezikun më kryesor, imediat e perspektiv për ëndrrat e tyre për pushtet. Prandaj me dallavere e me një mijë e një dredhi ata tash mobilizuan gjithë. forcat për të rrëmbyer atë pushtet që populli, i udhëhequr nga Partia, e kishte krijuar e po e forconte me sakrificë e gjak.

Na duhej, pra, te përballonim me çdo kusht këtë rrezik të madh që kishte dëkzistuar prej kohësh, por që tani kishte dalë hapur përballë nesh me tërë egërsinë dhe dinakërinë e vet. Duhej që me çdo kusht të afirmonim e të centralizonim atë pushtet real që c kishim krijuar e po e forconim me një luftë- të përgjakshme, për të mos lejuar ne asnjë mënyrë të zinte vend loja «çlirimtare» që po inskenonin bandat balliste.

E, pikërisht kur ne dërguam përfaqësuesit tanë me pomsinë e' qartë e të prerë që Via vinin Ballit këmbët në një këpucë, veprim që do ta forconte shumë autoritetin tonë e dë të na ndihmonte. në qëndrimet e mëtejshme, në Mukje ndodhi ajo që ndodhi: Y. Dishnica e M. Gjinishi, në vend, që t'i vinin Ballit këmbët në një këpucë; mbathën vetë pantoflat e Ballit. Ky akt i rëndë e i pafalshëm kapitullimi e tradhtie i ndërlikoi pa =sé situatën e detyrat tona dhe, për një cast, u dha në~ dorë krerëve të' Ballit një armë të ré për- ta çuar më tej lodrën e tyre kundërrevolucionare për pushtet.

Ndonëse ne e dënuam dhe e denoncuam menjëherë marrëveshjen e Mukjes, prapëseprapë, kjo s'do të thoshte aspak se reaksioni i brendshëm e, sidomos, krerët e Ballit Kombëtar tradhtar, do të hiqnin dorë nga manovrai dhe përpjekjet e ethshme për të rrëmbyer frytet e luftës së popullit. Mundësia e një zbarkimi të anglo-amerikanëve në brigjet tona, veçanërisht në këto momente komplekse, si qëllim kryesor nuk do të kishte luftën kundër italianëve, tashmë në grahmat e fundit, por pikërisht mbështetjen dhe sigurimin e pozitive të reaksionit të brendshëm, me qëllim që nëpërmjet tij imperializmi të ruante në Shqipëri botën e vjetër, lidhjet e vartësitë e vjetra skllavëruese.

Shtrohej, pra, më tepër se kurrë, domosdoshmëria e demaskimit të manovrave «antitaliane» të reaksionit të brendshëm dhe bërja pluhur e hi e përpjekjeve dhe e synimeve të të gjithë atyre që donin t'i rrëmbenin popullit nga duart ato fitore historike për të cilat kishte derdhur e po derdhte gjak me okë. Shtrohej domosdoshmëria e forcimit dhe e zgjerimit të mëtejshëm të bashkimit të popullit shqiptar në Luftën Nacionalçlirimtare, sidomos domosdoshmëria e forcimit nga çdo pikëpamje e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë, si i vetmi pushtet politik i ligjshëm i popullit në Shqipëri.

E, më mirë se kushdo, për këto nevoja historike, mund e duhej të diskutonte e të vendoste vetë populli, nëpërmjet përfaqësuesve të tij të ligjshëm. Momenti për thirrjen e Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare, për të cilën ne kishim kohë që përgatiteshim, tashmë kishte ardhur.

Sapo inauguroam Brigadën I Sulmuese, u nisa menjëherë bashkë me disa shokë të tjerë nga Vithkuqi dhe, pas një marshimi të pandërprerë përmes Gorë-Oparit e zonave të Librazhdit, në dhjetëditëshin e fundit të gushtit, arritëm në Labinot, ku ndërkohë ishte kthyer edhe Ymer Dishnica. Aty bëmë një mbledhje të Byrosë Politike ku merrnin pjesë ata shokë që ishte e mundur të vinin dhe i kërkua Ymerit të bënte një raport të hollësishëm për veprimtarinë e delegacionit në Mukje. Ymer Dishnica, ndonëse e pranoi fajin, u përpoq të justifikohet me «situatat e papritura», me gjoja mungesën e udhëzimeve etj., etj. Në këtë mbledhje propozuam përjashtimin e tij nga Byroja dhe shqyrtimin e vendosjen e kësaj çështjeje e lamë për në mbledhjen e rregullt të Komitetit Qendror të Partisë, që parashikonim të bënim në muajt e parë të vjeshtës. (Rrethanat u shtjelluan në mënyrë të tillë që plenumi të mbledhej në maj të vitit 1944.)

Po ato ditë, në një mbledhje të tij, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e hodhi poshtë marrëveshjen oportuniste të Mukjes dhe vendosi që Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare, për të cilën tani thuajse ishin bërë përgatitjet e duhura, të fillonte punimet më 4 shtator. Kjo Konferencë nuk do të ishte një mbledhje e elementëve të veçantë, por një kuvend i gjerë i përfaqësuesve të popullit të krahinave të ndryshme dhe i or ganeve të tij të pushtetit, këshillave nacionalçlirimtarë. Këta përfaqësues do të ishin delegatë të rregullt të një mbledhjeje që do të merrte vendime të rëndësishme për fatet e atdheut.

Me kohë ishin marrë edhe masat e duhura për të siguruar një organizim sa më të mirë të Konferencës. Ishin njoftuar këshillat nacionalçlirimtarë në krahina e në qarqe për këtë ngjarje të rëndësishme, për problemet kryesore që do të shtroheshin dhe ishin udhëzuar për procedurën që do të ndiqej në zgjedhjen e delegatëve. Organizatat e Partisë nëpër qarqe, gjithashtu, u porositën nga Komiteti Qendror për ta vlerësuar seriozisht këtë çështje, për të marrë të gjitha masat që zgjedhja e delegatëve, nisja dhe arritja e tyre në destinacion, të bëhej pa asnjë incident. Numri i delegatëve për çdo qark do të ishte në proporcion me numrin e këshillave ekzistues në këtë apo atë qark. Kështu që ato qarqe e krahina ku puna për ngritjen e këshillave nuk kishte vajtur mirë, kishin një përfaqësim më të paktë. Sipas udhëzimeve çdo delegat do të pajisej me një mandat të dhënë nga këshilli nacionalçlirimtar i krahinës apo i qarkut, futur ky në një zarf të mbyllur. Mandati duhej ruajtur me kujdes. sepse pa të nuk do të lejohej asnjë delegat të merrte pjesë, në punimet e Konferencës.

Pikërisht në këtë periudhë përgatitore të Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare, ose pak më parë, nëpërmjet shokëve të Tiranës na vjen një ftesë nga Ali Këlcyra, i cili na komunikonte për një mbledhje të «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë».

Më kishte rënë njëherë rasti të takohesha me feudalën «demokrat» përpara luftës, kur isha student në Francë. Më duket se kthehesha nga Shqipëria, ku kisha qenë për pushime dhe në Bari kisha takuar Bahriun, i cili më kishte dhënë një letër për Ali Këlcyrën që banonte në Paris. Sipas adresës që më kishte dhënë Bahriu, i vajta beut në shtëpi. Kishte një apartament shumë të mirë, gjë që më bëri përshtypje e më duk e çuditshme për një emigrant. Aliu më priti ftohtë e me fudullëk e mezi më futi në sallën. Vetëm kur mori vesh se kush më kishte dërguar, e ndryshoi tonin, më dha një cigare e i ra ziles për të thirrur shërbëtoren franceze, së cilës i tha të më bënte një kafe. Gjatë kohës që piva kafënë më pyeti për çfarë studioja e ç'kishim nga Shqipëria. Beu i Këlcyrës më dëgjonte me indiferentizëm e si me bezdi. Atëherë dhe unë i qëndrova akull dhe pyetjeve të tjera iu përgjigja fare shkurt dhe, me të pirë kafënë, u ngrita e ika. Që atëherë nuk ia kisha parë fytyrën as jashtë, as në Shqipëri, kur erdhi bashkë me pushtuesin. Po për bëmat e tij, ama, kishim dëgjuar. Ali Këlcyra ishte ndër propagandistët e shquar të reaksionit e të Ballit, ishte nga ata që vllte vrer më shumë kundër luftës për çlirim, kundër komunistëve e partizanëve. Jo vetëm kaq, se tradhtari Ali Këlcyra nuk mbetej vetëm te llafet; ai bashkë me bashibozukët e vet u qëndronte përkrah trupave italiane në operacionet ndëshkimore kundër krahinave, ku luftonin çetat e batalionet tona, ai digjte e vrste, godiste pas shpine. Për të gjitha veprimet e tij ne ishim në dijeni dhe e kishim paralajmëruar, dikur edhe e arrestuam, po e lamë të lirë duke i thënë që të kishte mendjen, se herë tjetër nuk do të

shpëtonte mirë. Në prag të Konferencës së Labinotit, pra, në kohën kur Ali bej Këlcyra na ftonte në «komitet», ne kishim shtënë në dorë një dokument të ri të tradhtisë së Bëj dhe të Ballit Kombëtar. Ky ishte «protokolli» i turpër, që Ali Këlcyra kishte nënshkruar në hotel «Dajti» me gjeneralin Renco Dalmaco, ku merrej zotim i hapur bashkëpunimi i ballistëve me trupat fashiste.

Ishte e qartë se ç'përgjigje do t'i jepej ftesës së Ballit Kombëtar, megjithatë lajmërova edhe shokë të tjerë që ndodheshin ato ditë në Labinot. Nuk thirra ndonjë mbledhje të veçantë për këtë çështje, por shfrytëzoja një rast kur në dhomën ku punoja, ishin mbledhur disa shokë. Më duket se qenë Spiro Moisiu, Nakoja, Omer Nishani, që kishte ardhur ato ditë pranë nesh, mbase edhe ndonjë tjetër. U tregova për ftesën e Ali Këlcyrës dhe u thashë:

- Ashtu siç e kemi vendosur, do t'i shkruaj Hysenit* *(Pseudonimi i shokut Gogo Nushi, në atë kohë sekretar politik i Qarkorit të PKSHP për Tiranën.) t'i bëjë edhe njëherë të qartë Ballit Kombëtar se për Mukjen dhe për të ashtuquajturin Komitet për shpëtimin e Shqipërisë as duhet folur e jo më të marrim pjesë në të. Besoj se jemi të një mendjeje.

Të gjithë shokët ranë dakord. Në bisedë e sipër hyn në dhomë Sejfullai e ia shpjegua edhe këtij qëndrimin tonë.

- Kështu vendosët? - pyeti Sejfulla Malëshova dhe pa rreth e qark për të peshkuar ndonjë disaprovim për çka kishim vendosur.

- Pse s'je dakord ti? - e pyeti Spiro Moisiu.

- Dakord jam në parim, - shpejtoi Sejfullai të përgjigjej, - por po vras mendjen pse e kanë dërguar këtë ftesë?

- Mos e vrit mendjen hiç, - i thashë aty për aty, duke ia prerë dëshirën për diskutime. - Për mendimin tim ftesa e Ali Këlcyrës që, në fakt, është ftesë nga Balli Kombëtar, është provokacion. Ata e dinë mirë që ne e kemi hedhur poshtë Mukjen, po duke na ftuar në «komitetin» e famshëm, mendojnë që ne të mbledhemi edhe një herë, të diskutojmë, të grindemi me njëri-tjetrin e të shkaktohet përçarje. Kjo është njëra anë. Ana tjetër është që ata duan të shiten në opinion si njerëz që u qëndrojnë marrëveshjeve e të flasin lart e poshtë se «Ja, ne donim bashkim, por komunistët e shkelën fjalën».

- Ja, këtu ta kam llafin, - u hodh Sejfullai, që ne ua japim një okazion të tillë.

- Rri o Sejfulla, - i foli Nakoja. - Po qe për të shpifur e për të llapur gjen okazion sa të dojë Balli. Mos e ki atë merak ti.

Sejfullai heshti dhe kështu u mbyll edhe puna e «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë».

Ndërkaq vazhdonim me vull punën për pritjen e delegatëve të Konferencës dhe marrjen e masave të fundit organizative. Fillimisht menduam ta mbanim Konferencën jo në Labinot, por më thellë, në Shmil, meqenëse Labinoti ishte ekspozuar një herë dhe ekzistonte rreziku i ndonjë sulmi të armikut apo të reaksionit. Lajmëruam Sami Bahollin për këtë mendim dhe i sugjeruam, si një vend të përshtatshëm, ndërtesën e shkollës në lagjen Qafë të Shmilit. Por Samiu me një shok tjetër, pasi shkuan në vend, konkluduan se ndërtesa e shkollës nuk ishte e përshtatshme për një mbledhje të tillë se qe e vogël, e mbajtur jo mirë dhe përfundimisht vendosëm që edhe kjo Konferencë të mbahej në shtëpinë e Bahollëve në Labinot.

Shokët e ngarkuar me sigurimin e kushteve për delegatët bënë një punë të madhe. Këta, me ndihmën e shokëve të Elbasanit e të fshatrave përreth, sollën ushqime, batanije, bile, gjetën edhe një kuzhinier të mirë. I palodhur ishte kudo Samiu, i cili lëvizte sa andej-këtej, nëpër fshatrat e afërta. Dorën e fundit këtyre përgatitjeve, sidomos nga ana estetike, ua dhanë Nexhmija, Ollga Plumbi dhe Ela Gjirkondi, të cilat mbërritën në Labinot 2-3 ditë para delegatëve të tjerë.

Sikurse në Konferencën e Parë të Vendit të PKSHP, adoptuam si sallë mbledhjeje një pjesë të sallorit të katit të sipërm të shtëpisë, të cilën e ndamë me një perde të kuqe nga presa tjetër. Pas perdes dukeshin shkallët e çonin poshtë, ndërsa në dy anët e shkallëve, kishte dy dhoma të vogla që i përdornim për punë dhe për fjetje. Mbi perde u vendosën portretet e Skënderbeut dhe të Ismail Qemalit.

Që më datën 2 pasdite filluan të vijnë delegatët dhe gjatë ditës tjetër erdhën pothuajse të gjithë. Të nesërmen, më 4 shtator 1943, filloi punimet Konferenca e Labinotit. Në Konferencë kishin ardhur

rreth 50 delegatë, të zgjedhur nga Vshillat nacionalçlirimtare' nga i gjithë vendi, delegatë të organizatave antifashiste që kishin aderuar në Frontin Nacionalçlirimtar nga Shtabi i Përgjithshëm, si dhe anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm Provizor. Nga këta mungonte Abaz Kupi, të cilit ia kishim dërguar ftesën e problemet që do të diskutoheshin në kohë, por, siç do të thoshte, «do punë e kishin penguar të vinte». Nisi kështu punimet Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare ku, nga data 4 gjer më 9 shtator, delegatët nga i gjithë vendi, me një rend dite mjaft të ngarkuar (shpesh punimet që nisnin në mëngjes vazhdonin gjer afër mesnatës), diskutuan e vendosën për probleme me rëndësi historike.

Problemi kryesor që kapi e trajtoi Konferenca ishte çështja e pushtetit politik në Shqipëri, duke e parë këtë të lidhur ngushtë me arritjet reale të këshillave nacionalçlirimtarë që nga momentet e krijimit të tyre dhe, pa dyshim, në lidhje të ngushtë me gjendjen e re që ishte krijuar në verën e 1943-shit e me detyrat që dilnin. Të 6 referatat që u mbajtën në Konferencë dhe diskutimet e shumta që u bënë rreth tyre, pavarësisht se secili kapte e trajtonte më në gjerësi aspekte ose probleme të veçanta, i lidhte e i përshkonte një ide e përbashkët: pushteti real që ne kishim mundur të arrinim përmes një lufte të gjithanshme me armë, me propagandë me punë konkrete me masat etj., etj., tash duhej të centralizohej, të shpallej pushteti i vetëm i popullit në Shqipëri dhe të bëheshin të gjitha përpjekjet që ky pushtet, edhe të ushtronte sa më mirë detyrat e rolin e tij në gjithë vendin, edhe të forcohej e të mbrohej si pushtet i pacenueshëm i popullit kryengritës.

Kështu, për shembull, referati për situatën e brendshme e të jashtme, hie të cilin nisi punimet seanca e parë, çështjet e zhvillimit të luftës antifashiste në shkallë ndërkombëtare - i pa të lidhura ngushtë me zhvillimet e Luftës sonë Nacionalçlirimtare e sidomos me rezultatet e mëdha të kësaj lufte.

- Lufta jonë, - u tha midis të tjerash në Konferencë, - u ka dhënë armikut fashist e bashkëpunëtorëve të tij goditje të pandërprera, ua ka bërë jetën skëterrë dhe ne jemi krenarë se në disfatën përfundimtare që po e kanos Italinë fashiste, populli ynë ka dhënë e po jep kontributin e vet të madh. Tamam kjo ka bërë që autoriteti e prestigji i Lëvizjes sonë Nacionalçlirimtare të njihet e të rritet edhe në arenën ndërkombëtare.

- Njohjen tonë në arenën ndërkombëtare, - u shpreh njëri nga diskutuesit, - ne as e kemi kërkuar as e kemi arritur me ambasadorë e me misione diplomatike, por me luftën kundër pushtuesit. Lufta çlirimtare është e do të jetë ministri i Jashtëm i popullit shqiptar.

Shoku preku kështu në mënyrë poetike një të vërtetë të madhe e të pakontestueshme: njohja në arenën ndërkombëtare e luftës me armë të popullit tonë përbënte, në të njëjtën kohë, një faktor të rëndësishëm e një garanci edhe për njohjen e afirmimin e arritjeve e të rezultateve të tjera të mëdha të kësaj lufte. Veçanërisht në momentet aktuale ky aspekt i problemit merrte rëndësi të veçantë. Siç thashë, po flitej e paraqitej evidente mundësia e një zbarkimi të anglo-amerikanëve në Ballkan dhe ne vërtet i njihnim dhe flitnim për rolin e tyre në aleancën antifashiste, por, në të njëjtën kohë, i dinim edhe qëllimet e interesat e tyre të fshehtë e të errët sipë - në Shqipëri dhe në vendet e tjera. Kishte, pra, rëndësi që edhe nëse ata do të zbarkonin në këto momente, të na gjenin ne jo vetëm në krye të luftës kundër fashizmit, por edhe në krye të punëve tona, zotër në vendin tonë. Ata duhej të shihnin e të detyroheshin të njihnin, pra, jo vetëm një popull të mobilizuar në luftë, por dhe një popull që, si rezultat i luftës, tash kishte arritur të ushtronte efektivisht pushtetin e tij nëpërmjet këshillave nacionalçlirimtarë.

Akoma më qartë e më direkt u rrah në Konferencë ky problem kur u diskutua rreth referatit mbi gjendjen, veprimtarinë dhe detyrat aktuale e perspektive të këshillave nacionalçlirimtarë. Delegatë nga Tirana, Shkodra, Durrësi, Vlora, Gjirokastra, Elbasani etj. folën konkretisht për shtrirjen dhe për forcimin e këshillave nacionalçlirimtarë në qarqe, qytete e fshatra, për rolin e tyre të madh në mobilizimin e popullit në luftë, për ndihmën ndaj reparteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe për zgjidhjen e problemeve jetike të popullit, veçanërisht në zonat e çliruara.

- Populli në këshillat nacionalçlirimtarë, - tha midis të tjerash Medar Shtylla, - po sheh veten e tij jo vetëm në luftë, po edhe në fuqi. Sa më tepër të rritim rolin e veprimtarinë e këshillave, aq më tepër do të shtohet mobilizimi i popullit në luftë, sepse njerëzit e thjeshtë binden që gjaku e sakrificat nuk do t'u venë dëm.

Midis të tjerëve e mori fjalën edhe Koço Tashkoja dhe e nisi diskutimin me një kritikë për «vërejtjet» e «pakënaqësitë» që kishte shprehur në referat Sejfulla Malëshova për gjendjen dhe aktivitetin e këshillave në terren.

- Të mos harrojë Sejfullai, - tha Koçoja, - se as Roma nuk u ndërtua për një ditë!

Por, pas kësaj aforizme, e pa me vend të lëshonte edhe vetë një «kritikë», veçse jo për këshillat «poshtë», po për organet e tyre «lart».

- Né Këshillin e Përgjithshëm tra lokalizëm, tha ai (vetë nuk bënte pjesë në këshill), - Baba Faja interesohet për Martaneshin, Myslimi për Pezën, Haxhi Lleshi për Dibrën.

- Ne tremi punuar atje ku luftojmë e do të shkojmë ku të ketë nevojë, - iu përgjigj Haxhiu.

Kuptohet, Koço Tashkoja nuk e kishte hallin të «lokalizmi» i Haxhiut, i Myslimit apo i Mustafa Xhanit. Qëllimi i tij ishte të denigronte shokë të tillë aktivë që bënin pjesë në Këshillin e Përgjithshëm, ku Koçoja mendonte se duhej të ishte anëtar sine qua non, ashtu siç pretendonte se duhet të ishte patjetër në përbërjen e udhëheqjes së Partisë.

- Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm dhe të dërguar e të ngarkuar me cilësitë e kompetencat e anëtarëve të Këshillit, - iu drejtova Koço Tashkos, - ne kemi pasur e kemi në të gjitha zonat. Le ta bëjmë secili sa më mirë punën në zonën e sektorin e vet dhe askush s'ka për të na kritikuar për lokalizëm. Sepse vërtet Myslimi interesohet më tepër për gjendjen e rolin e këshillave në zonën ku lufton, - vazhdova, - por atje ai nuk interesohet për pushtetin e tij, por për pushtetin e këshillit nacionalçlirimtar të zonës. Po kështu Haxhiu në Dibër, Hasan Puloja në Vlorë, tjetri në Korçë, në Gjirokastër etj. Puna e të gjithëve bashkë, në bazë të platformës së Konferencës së Pezës, në bazë të orientimeve e direktivave kolegjiale, bën të tërën. Dhe e tëft, e përgjithshmja, kryesorja, mendoj se ka ecur e po ecën mirë.

Sidoqoftë, si «vërejtjet» e «pakënaqësitë» e tepruara të Sejfullait ndaj veprimtarisë së këshillave në terren, ashtu edhe «vërejtja» e Koços për «lokalizmin», ishin dy episode që, megjithëse shkaktuan njëfarë debati e ilariteti, nuk ndikuan aspak në diskutimin e drejtë e të pjekur të problemeve, për të cilat

ishim mbledhur. Më tepër ato i morëm si mosnjohje të gjendjes reale nga këta dy shokë, si pasojë e pakënaqësive personale dhe si dëshirë e mani e nxituar e tyre për ta arritur brenda disa muajve apo një viti, atë që në realitet kërkon punën, mundin e përvojën e viteve e të dekadave të tëra.

Nuk them, pra, se në veprimtarinë e këshillave në ato momente nuk kishte edhe të meta e dobësi. Përkundrazi ne i njihnim edhe të metat, luftonim ta përmirësonim punën sa më shumë të qe e mundur, por gjithnjë të ndërgjegjshëm se jo çdo gjë do të arrihej menjëherë, të ndërgjegjshëm, gjithashtu, se çdo manjak do të kishte plot raste edhe më pas «për t'u kapur» në kërkimin e «perfeksionit» absolut! Kryesorja për ne ishte se këshillat ekzistonin, se zhvillonin veprimtari, se faktikisht njiheshin nga populli dhe luanin rolin e pushtetit të popullit në Shqipëri!

Kjo rezultante tash duhej ligjëruar e duhej shpallur, me qëllim që këtë pushtet real, që populli e kishte krijuar në zjarrin e luftës, të mos e rrëmbenin të tjerë. Rreziqet në këtë aspekt thelbësor, siç thashë, nuk ishin hipotetike. Kishte ardhur koha të mbahej një qëndrim tjetër, i prerë e i vendosur ndaj reaksionit që tash shitej si «antifashist», kishte ardhur koha t'u bëhej e qartë se populli s'do t'i lejonte të luanin më në kurriz të tij.

Rreth këtij problemi të një rëndësie të dorës së parë unë kisha përgatitur dhe mbajta në Konferencë referatin «Mbi qëndrimin kundrejt rrymave të ndryshme jashtë Lëvizjes Nacionalçlirimtare». Nuk do të ndalem në shtjellimin e këtij referati, sepse përmbajtja e tij njihet e është botuar,* *(Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, botim i dytë, f. 451.) por dua të ritheksoj vetëm disa momente themelore që kanë të bëjnë më tepër me arsyet se pse u përgatit e iu paraqit Konferencës ky dokument dhe ç'diskutoi e vendosi Konferenca rreth problemeve të ngritura në të.

Ndonëse në epiqendër referati kishte qëndrimin ndaj rrymave të ndryshme e organizatave nacionale, në fakt, në tërësinë e vet, ai ishte një pasqyrë e krejt vijës dhe e punës së Partisë sonë për krijimin dhe forcimin e Frontit Nacionalçlirimtar e të këshillave nacionalçlirimtarë. Në mënyrë historike e problemore i shtjellova Konferencës gjithë procesin e zhvilluar si para Konferencës së Pezës, ashtu edhe pas saj, duke theksuar se, ndërsa masat e thjeshta të popullit dhe patriotët e ndershëm e të

vërtetë u bashkuan në Frontin Nacionalçlirimtar e u hodhën në luftë, gjithnjë e më tepër u distancuan e iu kundërvunë Frontit e Luftës Antifashiste një grumbull i tërë elementësh pseudopatriotë të ngjyrave e tendencave më të ndryshme.

Në mënyrë të veçantë në referat shtjellova çështjen e Ballit Kombëtar, kushtet e arsytet përse lindi, punën e madhe, durimin e përpjekjet që kishim bërë për ta hedhur në luftë e, në përfundim të kësaj çështjeje, konkludova:

- Balli Kombëtar ka bërë një luftë të gjithanshme ideologjike, politike e ushtarake ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Ai është përpjekur ta përçajë atë, të ngrejë popullin kundër komunistëve e patriotëve të vërtetë. Jo vetëm kaq, por krerët e tij shpirtërisht kanë qenë e mbeten me Italinë e me Gjermaninë, mbështetnin kuislingët që nga Mustafa Kruja e deri te Maliq Bushati, të cilin vetë ata ia rekomanduan Jakomonit. Balli Kombëtar ka qenë përkrahës i të gjitha manovrave politike të pushtesit që nga «Shqipëria etnike» e deri tek «ushtria shqiptare» e «xhandarmëria shqiptare». Krerët e Ballit hiqen si patriotë, por, - theksova, - patriotizmin e tyre e dëshmojnë fshatrat e djegura të Vlorës, të Mallakastrës e të krahinave të tjera ku ata u siguruan qetësinë legjioneve fashiste e, bile, bashkëpunuan me to. Dhe këta bashkëpunëtorë të fashizmit, që kanë lyer duart me gjakun e bijve më të mirë të popullit, kanë paturpësinë të na bëjnë thirrje «kthehuni në shqiptarizëm!».

Në kuadrin e kësaj ekspozijeje, në referat trajtova hollësisht çështjen e mbledhjes së Mukjes, arsytet se pse ne vendosëm të shkonim në këtë takim të fundit me krerët e Ballit, për kompromisin e turpshëm e të palejueshëm në të cilin ranë përfaqësuesit tanë dhe, në mënyrë të veçantë, u ndala në pasojat e rënda politike që rridhnin prej tij dhe argumentova arsytet se pse ne e denoncuan menjëherë dhe e çorëm, si të pavlefshme, marrëveshjen e Mukjes.

- Shokët e ngarkuar me këtë detyrë nuk kanë ditur të mbrojnë vijën e Këshillit të Përgjithshëm, por kanë rënë në prehrin e Ballit Kombëtar, kanë pranuar platformën e tij dhe Balli Kombëtar papritur e pakujtuar na doli si një parti e organizuar, sikur gjoia kishte luftuar barazi, në mos më tepër, me Frontin Nacionalçlirimtar.

Në momentet e veqanta që po kalon vendi, theksova më tej, - krerët e Ballit që gjer tani s'kanë ftedhur asnjë pushkë kundër pushtesit dhe që e shohin se q'forcë ka pushteti i krijuar nga ne, bëjnë sikur pranojnë edhe rolin e partnerit në këtë pushtet, por gjithnjë me synimin që ta rrëmbejnë të tërë pushtetin në duart e tyre. Neve s'na lejohet kurrsesi të biem në këtë gabim tragjik. Pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë është pushtet i popullit kryengritës dhe io i bandave tradhtare e kundërrevolucionare. Tash që ne e hodhëm poshtë ujdinë e Mukjes ata po përpiqen për të gjetur shtigje të tjera drejt pushtetit. Ne duhet t'ua mbyllim të gjitha ato shtigje e mundësi dhe ndër aktet e para e më kryesoret në këtë drejtim është vendimi që i propozojmë të marrë kjo Konferencë: t'i shpallim këshillat nacionalçlirimtarë pushtet të vetëm të popullit në Shqipëri. Marrja e këtij vendimi është io vetëm një hap që e hedhim kur janë pjekur plotësisht kushtet, por dhe një nevojë e domosdoshmëri.

Në fund të fundit ne ligjëro~më një realitet të arritur, të konfirmuar nga lufta e puna jonë, të njohur nga populli e që vepron efektivisht në Shqipëri. Me këtë akt ne u mbyllim shtigjet si reaksionit të brendshëm dhe atij të jashtëm në manovrat e në synimet e tyre për pushtet.

Pjesëmarrësit e Konferencës e pritën me duartrokitje këtë referat që mbajta në emër të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Kjo tregonte se ata, sikurse i gjithë populli që përfaqësonin, e apr ovanin vijën e drejtë politike të Partisë sonë e të Frontit Nacionalçlirimtar, sepse kjo vijë e drejtë dhe konsekuente ishte burimi i tërë rezultateve e konkrete që kishim arritur. Dhe një nga fitoret më të mëdha ishte pikërisht pushteti i ri që po lindte, pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë, pushteti i popullit. Ishim në agimin e një epoke të re për Shqipërinë.

Aprovimi i qëndrimit që kishte mbajtur Këshilli i Përgjithshëm ndaj Ballit Kombëtar e rrymave të tjera, në përgjithësi, si dhe ndaj Mukjes, në veçanti, qe pothuajse unanim nga të gjithë diskutuesit. Për këtë çështje folën mjaft përfaqësues të popullit në këtë Konferencë. Ata mbështetën vijën e ndjekur nga Këshilli i Përgjithshëm, dënuan oportunitizmin e Ymer Dishnicës e të Mustafa Gjinishit, sollën fakte e argumente se Balli Kombëtar kishte kaluar përfundimisht në pozitat e tradhtisë.

- Balli, - tha njëri nga diskutuesit, - pret rënien e Italisë dhe si «djalë i madh» kërkon trashëgimin. Qëllimi i tij është grumbullimi i forcave që të jetë më i fortë në luftën për pushtet.

- Balli Kombëtar, - tha një tjetër, - është marrë vesh edhe me gjermanët, duke e konsideruar atë si okupator eventual.

Ymer Dishnica, në diskutimin e tij, në përgjithësi, e pranoi fajin e madh që kishte bërë, ndonëse u përpoq ta justifikonte atë me rrethanat.

- Kur morëm vesh rënien e Duçes, - tha në mes të tjerash Ymeri, - u hutuam dhe nuk e vlerësuam si duhet këtë moment. Ne e kujtuam sukses të madh faktin që Balli pranoi zyrtarisht të pajtohej me Këshillin Nacionalçlirimtar.

Kurse Mustafa Gjinishi edhe këtu u mundua t'i bënte bisht përgjegjësisë me lloj-lloj justifikimesh, si: «nuk patëm lidhje», «na mungonin faktet» etj., etj. Gjinishi nuk mungoi të atakonte në Konferencë edhe qëndrimin e Partisë e të Frontit Nacionalçlirimtar ndaj Ballit Kombëtar, bile edhe ta merrte këtë në mbrojtje:

- Shokët, - tha ai, - tani flasin me bindje të prerë që Balli është formuar për të na luftuar ne. Atëherë pse vajtëm? Por nuk është kështu, ata më parë nuk e kishin këtë qëllim. Edhe për çështjen e parullës së Ballit «Vdekje tradhtarëve», të mos e marrim për keq, sikur drejtohet kundër nesh. Mendoj, tha Gjinishi, - se do të ishte më mirë që ne të mos kishim bërë fare bisedime me Ballin Kombëtar.

- Vetëm ti, - i ndërhyra unë Mustafa Gjinishit, - s'e paske marrë vesh që Balli Kombëtar është një organizatë që u krijua për t'iu kundërvënë Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Shokët e tjerë dhe populli e kanë kuptuar këtë, po unë besoj se qëllimi yt është të bësh ortak në gabimet e tua e të Ymerit Këshillin e Përgjithshëm. Këshilli e tra pasur të qartë ç'ishte Balli dhe ti tre qenë vetë në mbledhjet kur tremi diskutuar për këtë problem. Nuk bëmë gabim që dërguam delegacionin në Mukje, gabimin e bëtë ju dhe Këshilli ju disaprovoi.

Edhe shokët e tjerë që diskutuan për këtë pikë, direkt apo indirekt, i dhanë përgjigjen e merituar këtij agjenti të maskuar të anglezëve, të Abaz Kupit dhe të gjithë forcave reaksionare.

- Vija e ndjekur nga ne, - u tha në diskutime, - ka qenë e drejtë dhe rezultatet e saj duken në jetë; Balli është demaskuar në popull, shumë njerëz të gënjyer janë hedhur me lëvizjen. Edhe Mukja do t'i kishte shërbyer Luftës Nacionalçlirimtare, po qe se delegacioni ynë atje do të kishte qëndruar në pozita të forta.

Për këtë pikë të rendit të ditës, veç atyre që përmenda më sipër, u prononcuan edhe Nako Spiru, Sejfulla Malëshova, Haxhi Lleshi (i cili u ndal veçanërisht në punën e bërë me krerët bajraktarë të Dibrës), Abdyl Agalliu (delegat nga Vlora), Mustafa Xhani, Omer Nishani e të tjerë. Që të gjithë, dulce sjellë zërin dhe vullnetin e popullit të zonave që përfaqësonin, argumentuan e afirmuan rolin e madh që po luanin këshillat nacionalçlirimtarë dhe u shprehën njëzëri për shpalljen e këtyre këshillave si i vetmi pushtet politik i popullit.

Në përfundim të këtyre diskutimeve e mora përsëri fjalën dhe, dulce nënvizuar detyrat e mëdha e të shumta që u dilnin këshillave nacionalçlirimtarë, midis të tjerash theksova:

- Tani që pushteti i këshillave po centralizohet e po shpallet pushteti i vetëm i popullit, është e domosdoshme që Këshilli i Përgjithshëm, që do të zgje dhe kjo Konferencë, të krijojë kudo një rrjet organesh e seksionesh të ndryshme për të organizuar punën në çdo fushë, në ekonomi, në arsim, në propagandë etj. Në asnjë fushë të mos çalojë puna, kudo të ndihet e të afirmohet roli i këshillave, ndryshe do të çalojë vetë lufta dhe e ardhmja e popullit.

Problemet që kishin të bënin me forcimin e pushtetit Konferenca i shqyrtoi në lidhje të ngushtë me forcimin e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, me forcimin dhe përfshirjen në radhët e tij të të gjitha organizatave të masave të krijuara nga Partia.

Shoqet Nexhmije Xhuglini, Ollga Plumbi dhe Ela Gjickondi folën në Konferencë me hollësi për luftën e grave dhe theksuan nevojën e një organizimi më të mirë të grave antifashiste shqiptare.

Ymer Dishnica, që nuk linte pikë të rendit të ditës pa diskutuar, bile edhe dy-tri herë, u ngrit edhe për këtë problem e deklaroi:

- Gruaja shqiptare nuk mban shamiçka dashurie, por fletë konspirative!

Më poshtë ai pasi u shpreh pro mendimit për krijimin e organizatës së Gruas Antifashiste, shprehu idenë që kjo organizatë të merrte pjesë në Këshillin e Përgjithshëm si një seksion i veçantë. Ky mendim i Dishnicës që i gabuar në themel dhe unë u ngrita dhe ia hodha poshtë:

- Lufta dhe Fronti Nacionalçlirimtar, - i thashë, - pranojnë në radhët e veta çdo njeri që lufton kundër armikut e, midis tyre, edhe gratë. Por nuk ka asnjë arsye që gratë të hyjnë në Këshill si një seksion i veçantë, nuk mund të krijojmë seksione të veçanta në Këshillin Nacionalçlirimtar për burrat e për gratë, për pleqtë e për të rinjtë. Po ta bënim këtë, nesër do të pranohet në këshilla edhe seksione për grupime njerëzish sipas tendencave politike, fetare etj., gjë që është në kundërshtim me vetë frymën e vendimeve që po merr kjo Konferencë.

Ramadan Çitaku e përkrahu mendimin tim dhe shpjegoi se këshilli do të ketë seksione për sektorë të ndryshëm të jetës së vendit, për financat, arsimin etj., por jo për organizata të veçanta.

Rreth referatit që mbajti Nako Spiru për rininë antifashiste shqiptare u zhvilluan shumë diskutime që kishin të bënin me organizimin, shpirtin e saj luftarak, entuziazmin dhe aspiratat e saj revolucionare.

- Rinia, - u tha në Konferencë, - po merr pjesë në mënyrë masive në luftë dhe kërkon që në Shqipërinë e lirë, ajo të jetë e lirë dhe të realizojë dëshirat e veta. Lufta për çlirim do të nxjerrë një rini të tillë, e cila ka zhvilluar e do të zhvillojë më tej virtytet më të mira të kombit tonë. Vetë atdheu do të përfitojë nga kjo.

Në lidhje të ngushtë me boshtin qendror dhe me çështjet e tjera që u rrahën atje, në Konferencë u analizuan edhe problemet që kishin të bënin me forcimin e mëtejshëm të luftës së armatosur e, në këtë kuadër, të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Fakt është se qysh nga fillimi, qysh kur u krijuan këshillat e parë nacionalçlirimtarë, kishte ekzistuar e që forcuar një lidhje e natyrshme dhe organike midis këshillave dhe çetave, reparteve e njësisive më të mëdha të ushtrisë sonë. Ndërsa këshillat, në gjithë këtë periudhë, si edhe më pas, një pjesë të madhe të punës e të veprimtarisë së tyre ia kushtonin mobilizimit e hedhjes së masave në luftë, repartet e njësitë partitane, nga ana e tyre, kudo që luftonin e vepronin, tregonin një kujdes e vëmendje të posaçme për këshillat, për formimin, mbrojtjen e fuqizimin e tyre. E, tani që këshillat po shpallehin pushteti i vetëm i popullit në Shqipëri, vetë Ushtria jonë Nacionalçlirimtare ishte rritur e fuqizuar, përbëhej nga dhjetëra çeta e batalione që luftonin anembanë vendit, ishte krijuar e kishte nisur nga betejat Brigada I Sulmuese, ishim në formim e sipër të brigadave II e III sulmuese, të zonave operative ushtarake etj. dhe në krye të të gjitha këtyre vepronte Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë sonë.

Shokët që morën fjalën rreth këtij problemi, si: Haxhi Lleshi, Spiro Moisiu, Ramadan Çitaku, Ethem Barhani, Hulusi Spahiu e të tjerë theksuan domosdoshmërinë e zgjerimit të radhëve e të numrit të batalioneve e të brigadave partizane, të organizimit e të aftësimit më të mirë të këtyre njësisive për të shkatërruar pushtuesin e huaj nazist që po hynte në Shqipëri e për të mbrojtur fitoret që po arrinin.

Një nga diskutuesit, më duket Ethem Barhani, foli për luftën që ishte bërë në Burrel në fillim të gushtit. Në këtë sulm bashkë me partizanët kishin ardhur edhe vullnetarë nga Mati e Kruja dhe «për çudi» edhe çetat e Abaz Kupit, të cilit, tani që Italisë fashiste .po i binin potkonjtë, i ishte ngjallur një vrull i çuditshëm «luftarak». Por tamam për shkak të pjesëmarrjes së tyre, nuk u arrit që të çlirohej qyteti.

- Çudi, mor i dashur, - i tha me qesëndi Kadri Hoxha diskutuesit, - ne në qarkun e Elbasanit, me tërë këto çeta e s'po mundemi të nxjerrim me shumicë njerëz të tjerë, kurse në Mat paskan dalë 2 500 vullnetarë.

- Vullnetarët, - iu përgjigja aty për aty Kadriut, - nuk nxirren duke u struktur në Orenjë e në shtëpinë e Beg Ballës siç bën ti. Pastaj, mos e mat vërshimin e vullnetarëve në ushtrinë tonë, me një apo pesë veta që përpiqesh të mobilizosh ti. Elbasani, Librazhdi e Gramshi janë kryesisht çerdhe të partizanëve!

Kështu vazhduan debatet edhe për këtë problem e, si për t'i vënë kapakun «e artë», në fund të seancës përkatëse, na ngrihet Ymer Dishnica e me një zë solemn thotë:

- Kërkoj prej poetit nacional të na bëjë një vjershë, një himn për ushtrinë! - dhe i mbante sytë nga Sejfullai.

Poeti «nacional» u krekos pak dhe, më në fund, «u dorëzua»:

- Pranoj ! - tha, po s'di pasta] ç'u bë me vjershën e Lame Kodrës, e bëri a jo, apo e la siç e kishte zakon t'i linte punët që i ngarkoheshin. Po një gjë e di me siguri, se ushtria jonë e vazhdoi luftën pa u bërë merak e bëri a s'e bëri «himnin» Sejfullai.

Kuptohet, gjatë ditëve e netëve që zhvilloi punimet Konferenca, midis diskutimeve të pjekura, plot përmbajtje e përgjegjësi për ato që thuheshin e vendoseshin, do të kishte në ndonjë rast edhe ndonjë sentencë të tillë ose notë humori. Por kulmin në këtë aspekt e arriti propozimi «origjinal» i Hulusi Spahiut, i cili kërkoi që të krijohet një dekoratë, propozim që shkaktoi ilaritet në sallë. I kishte vajtur mendja për dekorata e medalje Hulos, i cili akoma s'kishte filluar të luftonte në Shqipëri.

- Nga të vajti mendja te dekorata? - e pyeta në pushim Hulusiun.

- Duhet, - tha, - për të dalluar ata që luftojnë më mirë, që...

- Do të vijë koha që edhe ne të tremi dekoratat tona, - i thashë, - po tani tremi të tjera halle. Vetëm një gjë të dish, - shtova me të qeshur dhe pashë nga shokët që ishin rrotull, - se ty nuk të japim as edhe një.

- Pse? - më pyeti.

- Se do ta lësh në bixhoz, - i thashë dhe u tregova shokëve, natyrisht me shaka, një histori të vjetër bixhozi midis Hulos e Tahir Kadaresë, të cilën, diku edhe e tram shkruar.

Pasi mbaruan diskutimet rreth referateve, Konferenca zgjodhi komisionin për hartimin përfundimtar të Rezolucionit dhe të një thirrjeje drejtuar popullit shqiptar. Ne kishim përgatitur një projekt të Rezolucionit që më parë, por tani ai duhej pasuruar në frymën e diskutimeve e të vendimeve të Konferencës me qëllim që t'i shërbente sa më mirë sqarimit të popullit, të këshillave nacionalçlirimtarë etj. U mbyllëm në një dhomë me doktor Nishanin, Nakon, Sejfullain, Medarin dhe, dulce pasur parasysh referatet e diskutimet e Konferencës, hartuam Rezolucionin, i cili është i botuar.* (Dokumente të organeve të larta të Pushtetit Revolucionar Nacionalçlirimtar (1942-1944), f. 54.)

Ndërkohë që komisioni i ngarkuar punonte në një nga dhomat e katit të dytë, një nga anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm u lexonte delegatëve Statutin dhe Rregulloren e këshillave nacionalçlirimtarë. Këto qenë dokumente të rëndësishme, qenë aktet e para themeltare, si të thuash «Kushtetuta» e parë e pushtetit të ri popullor.

Ishte bërë vonë, kishte kaluar ora dhjetë e natës dhe pati një mendim që Konferenca t'i përfundonte punimet të nesërmen, por, meqenëse kishin mbetur edhe pak punë për t'u bërë, vendosëm të vazhdonim. Kështu të nesërmen në mëngjes delegatët do të niseshin për në vendet e tyre. Atëherë lexuam Rezolucionin dhe thirrjen që përgatitëm dhe kaluam në zgjedhjet. Nga Konferenca u caktua një komision për të përgatitur listën e kandidatëve dhe, ndërsa komisioni filloi punën, pjesëmarrësit e Konferencës bënë pushim. Kështu salla u zbraz, delegatët zbritën poshtë. Brenda mbetën vetëm 2-3 veta, mes tyre Spiro Koleka dhe një shok tjetër i sekretarisë, Dhimitër Evangjeli, që jepnin e merrnin me një radio «Filips» që ishte vendosur në një qoshe në fund të sallës, mbi një tavolinë; pranë ballkonit.

Përgatitëm listën që do t'i paraqitej Konferencës dhe u thashë shokëve:

- Nuk dalim edhe ne të freskohemi pakëz e të pimë një duhan jashtë me delegatët, se doktori [Omer Nishani] na mori shpirtin e s'na la të pimë sipas qejfit.

Zbritëm poshtë në oborr e po bisedonim me delegati e me partizanë, kur befasi në ballkon del Koleka cthe shumë i emocionuar thërret:

- Shoku Enver! Shokë! Italia kapituloi!

Ajo që pritej kishte ndodhur. Italia fashiste kishte mbaruar. «Tetë milioni bajoneta» që do t'i siguronin imperializimit italian spazio vitale, që do të ringjallnin Perandorinë Romake, kishin hedhur flamurët në këriubët e fitimtarëve. Dhe ndër këta fitimtarë ishim edhe ne, partizanët e luftëtarët shqiptarë, që me pushkën me gjalmë i thyem legjionet e Musolinit.

Lajmi u prit me entuziazëm nga të gjithë shokët. Përqafoheshin, hidheshin në erë bustina, kasketa e borsalina, dëgjoheshin edhe pushkë, me gjithë ndërhyrjet tona. Në grupin ku ndodhesha unë, dy-tre

shokë filluan të diskutojnë për zbritjen në qytete, për të marrë pushtetin e për të filluar punën për Shqipërinë e re demokratike.

- Po gjermanët? - i pyeta.

- Gjermanët?! - thanë ata me njëfarë habie, por shpejt e mblodhën veten dhe shtuan: - Edhe ata do të ikin një ditë se ne në luftë jemi!

- Këtë duhet ta kemi të qartë të gjithë, - u thashë. - Nazistët nuk do ta lënë Shqipërinë të papushtuar, bile edhe Italinë do ta pushtojnë atje ku nuk janë futur aleatët. Çlirimi i Shqipërisë do Vu kërcënonte atyre pozitat në Greqi e në vende të tjera të Ballkanit. Prandaj, pushtetin ta forcojmë, por të mos mendojmë se lufta ka mbaruar, një luftë më e ashpër na pret. Armët Vi kemi gati.

Kapitullimi i Italisë krijonte kështu një situatë të re për të cilën ne duhej të ishim të përgatitur. Prandaj vendosëm që atë natë të përfundonim me zgjedhjet dhe, të nesërmen, më 9 shtator të diskutonim për masat që duheshin marrë në situatën e re politike dhe ushtarake.

Konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të përbërë prej 62 anëtarësh. Këshilli, nga ana e tij, zgjodhi kryesinë të përbërë prej 16 anëtarësh dhe pikërisht: Mustafa Xhani, Myslim Peza, Omer Nishani, Enver Hoxha, Kostë Boshnjaku, Ymer Dishnica, Ollga Plumbi, Liri Gega, Haxhi Lleshi, Fetah Ekmekçiu, Medar Shtylla, Nako Spiru, Sejfulla Malëshova, Ramadan Çitaku, Abaz Kupi dhe Spiro Moisiu.

Menjëherë pas zgjedhjeve shokët filluan nga diskutimet për situatën. Të gjithë ishin të gëzuar e të preokupuar, por ora kishte vajtur 4 e mëngjesit. Kishim nevojë për pushim e për gjumë. Atëherë, si u konsultova edhe me shokët e presidiumit, u ngrita dhe u thashë pjesëmarrësve të Konferencës:

- Presidiumi mendon që t'i ndërpresim diskutimet, sepse u bë vonë dhe shokët duhet të pushojnë. Do të vazhdojmë nesër, ose më mirë të themi sot, në orën dhjetë.

U shpërndamë dhe shkua për të fjetur. Por edhe për ca kohë vazhdova të bisedoja me Omerin, Medarin e me të tjerë për këtë ngjarje. Edhe të tjerët, sigurisht, kështu bënë.

Të nesërmen zhvilluam seancën e fundit të Konferencës. I pari e mori fjalën Omer Nishani:

- Logjika e do, - tha doktori, - që dorëzimi i armikut të bëhet para forcave tona të armatosura, domethënë para Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që është e lidhur me aleatët. Prandaj propozoj t'u dërgojmë një notë gjeneralëve italianë, ku të kërkojmë dorëzimin pa kushte të njerëzve, armatimeve e pajisjeve. Veç kësaj, të bëjmë një trakt apo thirrje drejtuar ushtarëve italianë.

Diskutuan edhe shokë të tjerë dhe vendosëm që të bëhej një thirrje drejtuar popullit shqiptar, ku të theksohej se tani ishte në rend të ditës kryengritja e përgjithshme e armatosur kundër pushtuesit gjerman dhe tradhtarëve dhe vendosja në të gjithë vendin e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë. Gjithashtu u pranua propozimi i doktor Nishanit për një trakt drejtuar ushtarëve italianë për të luftuar kundër nazistëve dhe iu ngarkua Shtabit të Përgjithshëm t'i paraqiste komandës italiane në Shqipëri kërkesat tona.

Pasi u përcaktuan këto vendime, Ramadan Çitaku, në emër të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, foli për organizimin e seksioneve dhe për funksionet e tyre. Këto seksione do të ishin: seksioni social për ndihmë krahinave, familjeve e individëve të dëmtuar rëndë nga lufta dhe për sigurimin e jetesës normale, seksioni i shëndetësisë, i ekonomisë dhe i financave, i shtypit dhe i propagandës dhe seksioni i arsimit. Po hynim në rrugën e ndërtimit të shtetit të ri demokratik.

Ja kështu i përfundoi punimet Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare, e cila mori vendime nga më të rëndësishmet për luftën e armatosur të popullit shqiptar dhe për pushtetin e tij. Kryengritja e përgjithshme e armatosur dhe pushteti i këshillave, i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri, ishin dy parullat më kryesore e me rëndësi jetike për vendin tonë e për të ardhmen e tij, që aprovoi kjo Konferencë e që delegatët i morën me vete për t'i përhapur e për të punuar për zbatimin e tyre anëmbanë Shqipërisë.

2. Përballë provës së madhe

Situata e krijuar pas kapitullimit të Italisë fashiste kërkonte veprime të shpejta e masa urgjente. S'duhet të lejonim të na rrëshqiste asgjë nga duart, sidomos tanfi që iniciativa po anonte tërësisht në anën tonë.

Prandaj vendosëm dhe menjëherë u dhamë urdhër forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare që të zinin të gjitha zonat dhe qytetet që kishin qenë në duart e pushtuesit italian dhe në to të vendosej pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë. Veç kësaj vendosëm që, ashtu si në Barmash e gjetkë, të vazhdonte pandërprerë goditja e reparteve naziste që akoma nuk ishin dislokuar plotësisht në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë kishte rëndësi të çliroheshin ato qendra të banuara, të cilat forcat tona kishin mundësi- t'i merrnin dhe të vendosej edhe atje pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë.

Pavarësisht se si do të zhvilloheshin ngjarjet më pas (sidomos kjo do të varej nga shkalla e ndërhyrjes ushtarake të nazistëve ose të aleatëve anglo-amerikanë), vendosja e pushtetit të këshillave në qytete e në qendrat e tjera të banuara do të kishte një rëndësi shumë të madhe politike. Populli do të shihte e do të ndiente forcën, autoritetin dhe aftësinë e pushtetit të vet, kurse reaksioni pseudopatriot dhe reaksioni i jashtëm anglo-amerikan do ta kuptonin më mirë se lodrat e tyre politike u kishin dalë huq e s'kishin për t'u pirë më ujë. Prandaj shtrohej si një detyrë jetike forcimi kudo i pushtetit, i këshillave dhe i ushtrisë, mobilizimi i popullit rreth këshillave nacionalçlirimtarë dhe në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, diskreditimi i Ballit Kombëtar, për të mos i lënë atij asnjë lloj influence në popull. Në këtë mënyrë do të kishim forcën e të drejtën t'u thoshim edhe aleatëve nëse do të zbarkonin: ju keni ardhur në Shqipëri vetëm për të luftuar Gjermaninë hitleriane, por qeverisja e vendit është e do të jetë në duart e Lëvizjes Nacionalçlirimtare!

Në kuadrin e gjithë këtyre masave e detyrave, Shtabi i Përgjithshëm planifikoi, në përshtatje me situatat, edhe një sulm të mundshëm mbi kryeqytet, në mënyrë që ky të çlirohej dhe të vendosej edhe atje, në të gjitha hallkat, pushteti ynë.

Për këtë, menjëherë pas përfundimit të Konferencës së Dytë Nacionale:çlirimtare, ndërsa delegatët u nisën në qarqet e zonat që përfaqësonin, një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare u largua nga Labinoti dhe u vendos pranë kryeqytetit, në Arbanë, ku ishte vendosur ato ditë edhe komanda e Grupit të Pezës. Këtu do të bëhej edhe organizimi e inaugurimi i formimit të Brigadës III Sulmuese, ngjarje në të cilën do të merrnim pjesë edhe unë e Spiro Moisiu si dhe shokë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm. Por, siç thashë, ardhja dhe vendosja jonë në këtë zonë, kondicionohej sidomos nga situata politike e ushtarake që mund të krijohej në vendin tonë në rast të ndonjë zbarkimi eventual të aleatëve në Ballkan e, veçanërisht, në Shqipëri.

Sapo u vendosëm në Arbanë, thirra shokun Gogo Nushi për t'u informuar mbi gjendjen e forcave tona e të armikut në kryeqytet dhe për të biseduar me të rreth detyrave të momentit.

- Si mendon, - e pyeta, - sa forca të armatosura mund të ngrihen nga Tirana për të mbështetur një sulm të koordinuar të forcave partizane nga kodrat përreth?

- Përveç të gjitha forcave të njësiteve guerile që janë të armatosura e të gatshme të hidhen në sulm në çdo moment, jam i bindur se në sulmin për çlirimin e kryeqytetit do të ngrihet me dëshirë rinia e populli,

- më tha Gogoja dhe vazhdoi: - E keqja është se na mungojnë armët.

- Ti i di vargjet e këngës së njohur: «Në mos trini armë gjeni / ia rrëmbeni atij qeni», - i thashë dhe vazhdova: - Për armët mos u bëj merak. Ne do t'ju ndihmojmë dhe populli di vetë ku t'i gjejë.

- Ashtu është, - tha Gogoja. - Nuk do të na mungojnë as guximi as trimëria. Populli mezi pret ta shohë Tiranën të lirë.

- Natyrisht, - vazhdova, - kjo është një çështje tepër delikate, tepër e rëndësishme e që mund të bisedohet vetëm në qarkor. Ne do ta kryejmë sulmin mbi Tiranën vetëm kur të jemi të bindur se ai sulm është i domosdoshëm, se prej tij do të tremi vetëm fitime dhe, kryesorja, për çastet e tanishme, vetëm në rast se në Shqipëri do të zbarkojnë aleatët për ta paraqitur veten si çlirimtarë. Ne e çmojmë luftën e tyre, por në Shqipëri çlirimtarët e vërtetë kemi qenë e jemi vetëm ne dhe pushteti do të jetë vetëm në duart tona.

Pasi biseduam hollësisht me Gogon për këto probleme, ai u nis menjëherë për në Tiranë për t'ia parashtruar gjithçka biseduam qarkorit, në mënyrë që populli dhe njësitet guerile të mobilizoheshin e të ishin në gatishmëri po qe se vendosej sulmi për çlirimin e kryeqytetit.

Ndërkohë, për këtë qëllim, në zonën rreth Tiranës ishin afruar një numër batalionesh e çetash, veç forcave të Grupit të Pezës dhe të Brigadës III Sulmuese që ishte në formim e sipër. Gjithashtu i dhamë urdhër Brigadës I të dislokohej në zonën rreth Tiranës e Elbasanit, duke bllokuar komunikacionin mes qyteteve e duke goditur autokolonat naziste. Në sulmin kundër italianëve do të merrnin pjesë edhe forcat partizane nën komandën e Haxhi Lleshit, pas çlirimit të qytetit të Krujës. Gjithashtu ne i bëmë thirrje ushtrisë italiane që t'i dorëzohej komandës partizane, të hidhej në mal në luftë kundër nazizmit dhe të mos shkonte më në shërbim të gjermanëve, sepse do të përfundonte në kampet e tyre të përqendrimit. Këtë ne e bëmë të njohur me anë të thirrjeve dhe nëpërmjet shokëve tanë që dërguam për të biseduar me ta, se, natyrisht, në atë kohë nuk dispononim aparate radioje. Thirrja jonë u dëgjua pjesërisht.

Kur ishim në Arbanë, na erdhën disa oficerë madhorë italianë, në mes të të cilëve ishte edhe komandanti i aviacionit që drejtonte aerodromin e Shijakut. Në mes tyre ishte edhe një kolonel, i biri i Pircio Birolit, gjeneral, që komandonte forcat italiane të operacionit në Mal të Zi. Ata erdhën të veshur me rroba verore të bardha, me këmisha të mëndafshta, u paraqitën në Shtabin tonë, dhanë emrat dhe, nga ana jonë, unë i përgëzoja që nuk u dorëzuan te gjermanët. Mirëpo një bateri italiane vazhdonte luftën kundër nesh, ajo godiste me artileri mbi Arbanë. Atëherë i them kolonelit, pra, djalit të Pircio Birolit:

- Gjithë ushtria italiane po dorëzohet, prandaj me nja dy oficerë të tjerë italianë shkoni e i bëni thirrje asaj baterie të pushojë zjarrin dhe të dorëzohet.

Ai pranoi, shkoi në një vend të hapët dhe iu drejtua baterisë:

- Dorëzohuni në komandat partizane shqiptare, se Italia tra kapitulluar! Ja, edhe ne, - thërriste ai, - jemi dorëzuar.

Atëherë kjo bateri, në vend që të qiste mbi Arbanë, qiti mbi djalin e Pircio Birolit me shokë dhe i bëri hi. Nuk e di ç'u bë babai i tij, por edhe ai mund të ketë gjetur vdekjen andej nga Mali i Zi, prej partizanëve jugosllavë.

Oficerët italianë, kur ndodheshin në kazermat e në vendqendrimet e tyre, natyrisht, ishin mësuar të merrnin nga një banjo çdo ditë. Njëri nga ata, një kolonel aviacioni, u kërkoi edhe partizanëve tanë t'i ngrohnin një banjo.

- Çfarë, çfarë do? - e pyeti partizani ynë.

- Banjo! - u përgjigj italiani qetë-qetë.

- Aa, dashka banjo zotria jote! - ia ktheu partizani e me të qeshur i tha: - Ja ku e ke banjon, në Erzen. Shko e futu sa të duash, banjo tjetër këtu s'ka. Tani jemi në luftë e këtu është fshat. Kur të çlirojmë Shqipërinë, edhe banjo do të kemi. Dakord sinjore?!

Italiani që kërkoi banjon, nuk ishte njeri i keq, ai qëndroi me forcat tona deri në fund. Siç më kanë thënë, në Itali ai u gradua pas luftës, pastaj e nxorën në pension dhe herë pas here shkonte në ambasadën tonë. Ai ishte bërë mik me ne.

Kështu, me kapitullimin e Italisë një numër njësitësh italianë, bile edhe një divizion, divizioni «Firence», i komanduar nga gjenerali Aci, u dorëzua te ne. Forcat tona e garmatosën efektivin e divizionit, kurse Acin me gjithë shtabin e tij morën urdhër ta dërgonin në Arbanë. Atje i prita edhe unë dhe, pas përhëndetjeve të rastit, u fola për ndryshimet dhe gjendjen në qeverinë italiane musoliniane, të cilën e kishte marrë në dorë Badoglio, si dhe për situatën e ushtrisë italiane e të komandës italiane. I thashë, gjithashtu, gjeneral Aci se mendimi ynë ishte që italianët, të cilët na u dorëzuan, të ndiqnin rrugën e nderit për të larë fajet e gabimet e tyre, duke marrë pjesë tok me ne në luftë kundër gjermanëve.

- Ne, - i thashë midis të tjerash, - mund të firmosim së toku edhe një deklaratë, me të cilën t'u bëjmë thirrje edhe forcave të tjera italiane, që nuk janë dorëzuar akoma, të bashkohen me ne. Pas kësaj, t'i pyesim një nga një dhe kush dëshiron të luftojë, le t'i mbajë pushkët, kush nuk dëshiron të luftojë, t'i

dorëzohë, por të qëndrojnë në thellësi të zonave tona të çliruara dhe atje të punojnë tok me fshatarët për të nxjerrë bukën për veten e vet, për të ndihmuar edhe luftën.

Ramë dakord me Acin për këtë gjë.

Një pjesë e italianëve të dorëzuar shprehën dëshirën të luftonin dhe luftuan. Ne ata i inkuadruam në disa njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare; një pjesë prej tyre i inkuadruam në Brigadën I Sulmuese, në një batalion, të cilit i dhamë emrin e themeluesit të Partisë Komuniste Italiane, Antonio Gramshi. Me çarmatosjen e njësisve italiane pas kapitullimit, vumë në dorë pushkë, mitraloza, bomba. Me këto arme pajisëm disa batalione partizane dhe batalione territoriale që organizuam në këtë kohë, mbajtëm edhe armë për forcimin e Brigadës III e sidomos të Brigadës II që ishte më e dobëta nga ana e pajisjes.

Po ashtu i boshatisëm me sa na ishte e mundur edhe depot italiane dhe shumë materiale, si ushqime dhe veshmbathje, i transportuam me shpejtësi në thellësitë e zonave tona të lira. Një pjesë të mirë të këtyre furnizimeve ia ndamë popullit të Pezës, i cili kishte luftuar dhe që djegur, kurse pjesën tjetër e ruajtëm për nevojat e luftës, për forcat tona partizane.

Kështu, pra, pas një lufte të ashpër e të përgjakshme disavjegare, populli ynë i vogël, por trim e i pamposhtur, i mobilizuar e i udhëhequr nga Partia jonë Komuniste, arriti të mposhte taborët e imperos e të triumfonte mbi to. Por edhe kur fitoi, ai diti të tregonte ndaj ish-vrasësve e pushtuesve vetitë e një populli të madh: ata që donin të lanin fajet e kryera e të kontribuonin në luftën kundër nazifashizmit i bëri vëllezër armësh, të tjerëve, që s'e morën dot këtë udhë nderi, u hapi dyert e shtëpive e të kasolleve të fshatrave e i mbrojti nga egërsia naziste, gjersa mbaroi lufta.

Pas Clirimit, në mars 1945, për të tërhequr trupat italiane që u dorëzuan te ne, erdhi nënsekretari i shtetit për Luftën, Mario Palermo. Ai ishte komunist, pse në atë kohë në qeverinë italiane kishin marrë pjesë edhe komunistët, bile vetë Toliati ishte ministër i Drejtësisë. Ne e pritëm mirë këtë njeri, jo më tepër si personalitet qeveritar, sesa si shok komunist, biseduam me të për qëndrimet e Partisë sonë, për qëndrimet e shtetit tonë të ri, për të ardhmen e vendit

dhe për perspektivën e tij. I folëm, gjithashtu, për luftën e ashpër që bëri fashizmi italian në vendin tonë, për dëmet e mëdha që na shkaktoi, i folëm se si edhe ne nuk lamë kusur kundër tij dhe ushtrisë fashiste. Pastaj i treguam që megjithatë, pas kapitullimit, ne vepruam në mënyrë njerëzore me ushtrinë italiane, u bëmë thirrje ushtarakëve italianë të hidheshin në mal dhe kush të dëshironte, të luftonte dhe, në fakt, një pjesë e vogël e tyre luftoi. Me Palermon nënshkruam edhe një protokoll, i cili përcaktonte procedurën e transferimit të trupave italiane që gjendeshin në Shqipëri për në Itali. Të gjithë ata që nuk kishin armë hipën në vaporët që erdhën nga Italia, kurse partizanët që kishin luftuar në radhët e batalionit «Gramshi», i nisëm në Itali me nderime e që të gjithë të armatosur. Nuk di nëse ish-nënsekretari i shtetit italian për Luftën rron akoma apo jo, por megjithëse ishte plak dhe megjithëse bënte pjesë në partinë revizioniste italiane, kurdoherë kur piqej me shokët tanë, u fliste me simpati dhe me dashuri për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për takimet dhe bisedimet që ka pasur me ne. Ai ka botuar më vonë edhe një libër për ardhjen e tij në Shqipëri, në të cilin flet miqësisht për bisedimet që ka pasur me mua dhe me shokët e mi lidhur me problemin e riatdhesimit të ushtrisë italiane. Këtu është fjala për riatdhesimin e të gjallëve, pse riatdhesimi i ushtrisë së vdekur u bë shumë më vonë. Edhe kur do të transferoheshin kockat e ushtrisë së vdekur erdhi një gjeneral, por ai ishte një fashist dhe mori kockat e fashistëve.

Por le të kthehemi te vjeshta e vitit 1943, që filloi me kapitullimin e Italisë fashiste dhe që u bë një nga periudhat më intensive të veprimtarisë sonë politike e luftarake; periudhë kur ne do të kapërcenim vështirësi e rreziqe nga më të mëdhatë e prova nga më të rëndat.

Në veçanti dua të theksoj se gjatë kësaj kohe thuajse në gjithë vendin u ngrit në këmbë një strukturë e organeve tona të pushtetit: që nga lagjja, fshati, qyteti, qarku e deri në Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e në Kryesinë e tij. Në krahinat dhe në qytetet e çliruara, këshillat nacionalçlirimtarë u bënë të vetmet organe të pushtetit që administronin e qeverisnin në emër të Frontit Nacionalçlirimtar e të interesave të popullit. Ata rregullonin jetën normale, drejtonin ekonominë, arsimin, kontrollonin furnizimin e popullsisë, bënin propagandë dhe organizonin mbledhjen e ndihmave për lëvizjen e dërgimin e vullnetarëve për në repartet e Ushtrisë

Nacionalçlirimtare që i jepte goditje të paprera armikut të ri nazist. Kjo ishte prova gjenerale e shtetit të ri që po lindte në zjarrin e luftës. Nga të katër anët e vendit na vinin lajme të mira që tregonin për punën dhe luftën e shokëve tanë, për entuziazmin e popullit dhe vendosmërinë e tij për të ecur në rrugën që i tregonte Partia.

Pikërisht në këtë atmosferë të tendosur, por optimiste, si një disonancë e papëlqyer tingëlluan lajmet që na erdhën nga Gjirokastra ku Bedri Spahiu, sekretari politik i qarkorit, kishte gatuar një përshesh politile të dënueshëm. Në kundërshtim me udhëzimet e qarta të Komitetit Qendror dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, shokët e Gjirokastrës, kishin lejuar që, pas kapitullimit të Italisë, të hynin në qytet bandat balliste dhe vetëm pas kësaj hynë në qytet njësitet tona. Në vend që t'u vinin drunë bashibozukëve të Ballit Kombëtar e të vendosnin në qytet pushtetin e vetëm e të pandarë të këshillit nacionalçlirimtar, Bedri Spahiu lejonte të bashkëjetonte krahas tij pushteti i Ballit dhe ushtronte oratorinë e tij, duke polemizuar me Ali Beun te Qafa e Pazarit. Kështu, Ali Beu me ballistë të tjerë kapardiseshin si zotër të Gjirokastrës nëpër sokakë e kafene, ballistët bënin poshtërsira e ndyrësira, kurse Bedri Spahiu i «demaskonte» me diskure. Ky ishte një flirt i dënueshëm politik, që shkelte rëndë vijën e Partisë dhe të Frontit Nacionalçlirimtar. Me të marrë lajmin u ula dhe shkrova një letër* *(Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, botim i dytë, f. 491..) të ashpër drejtuar Komitetit Qarkor për Gjirokastrën, ku dënoja veprimin e tyre dhe u sqaroja edhe një herë qëndrimin tonë aktual ndaj Ballit Kombëtar. Në thelb u theksoja shokëve të Gjirokastrës:

- Veç pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë nuk duhet të lejohet asnjë pushtet tjetër. Ju keni lejuar Ballin Kombëtar të shtrohet këmbëkryq dhe kënaqeni me gjoja demaskimin që i bëni. Duhet ta keni të qartë se tani nuk flitet më për bashkim me Ballin, po për shpartallimin e kësaj organizate reaksionare e tradhtarë. Duhet të veprojmë në mënyrë energjike, jo vetëm me punë politike, por edhe me veprime ushtarake. T'i spastrojmë me armë ato plehra dhe të vendosim kudo pushtetin tonë.

Edhe në Berat, siç qemë informuar, kishin ndodhur ngjarje analoge, për të cilat u tërhoqëm vëmendjen shokëve drejtues të Komitetit Qarkor të Beratit. Menduam se situata do të vihej në vend, kur, për çudi, pas disa ditësh, na vjen një lajm tjetër akoma më skandaloz se i pari, bile aq i pabesueshëm, sa që kërkuam me urgjencë të verifikohej. Rezultoi se komanda e trupave tona në qarkun e Beratit kishte hyrë në një kompromis të shëmtuar me forcat gjermane të pushtimit. Nuk mjaftonte që ballistët bënin ligjin në Berat, që kriminelin Abaz Ermeni bridhte si kapadai duke grisur me duart e veta të gjakosura shpalljet tona e buletinet e «Zërit të popullit», por Gjin Marku, që ishte i deleguar i Komitetit Qendror, dhe Mestan Ujaniku, ish-komandant i qarkut, lejonin edhe ushtarët gjermanë të hynin në qytet, pasi «kontrolloheshin» riga rojat tona në hyrje të Beratit! Nazistët hynin qetësisht, shikonin, merrnin informata, bënin sikur blinin nëpër dyqane, ndërsa komanda partizane bënte sehir. Po të njëjtat gjëra ndodhnin edhe në Lushnjë.

Në mënyrë urgjente i kërkuam shpjegime Gjin Markut, i cili, në letrën e përgjigjes dërguar Shtabit të Përgjithshëm, pranonte situatën, bile, ria shkruante se «gjermanët kanë hyrë edhe në zyrat tona!» Një qëndrim i tillë pa precedent në këto vite të Luftës sonë Nacionalçlirimtare kërkonte një qëndrim të prerë e të ashpër. Sé bashku me Spiro Moisiun hartuam një letër për komandën e qarkut, ku, pasi i tërhiqnim vërejtjen për mungesën e informacionit të rregullt për situatën, nënvizonim se sa i rëndë qe ky gabim në pikëpamje politike. Në një kohë kur ne luftonim me armë e me propagandë Ballin e reaksionin, kur i akuzonim ata për bashkëpunim me nazistët, një komandë partizane binte në ujdi me ta!

- Kurrë nuk duhej të binit në marrëveshje me armiqtë tanë më të egër, - shkruanim në letër, edhe silkur e gjithë ushtria të asgjësohej në luftë kundër tyre!* *(Shih: «Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm e të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH», vëll. I, botim i dytë, f. 144. Tiranë, 1976.)

Këtë veprim të rëndë, përgjegjës kryesor për të cilin ishte Gjin Marku, e diskutuam edhe në rrugë partie dhe vendosëm që në mbledhjen më të parë të plenumit të Komitetit Qendror, bashkë me kapitullimin e Y. Dishnicës në Mukje, të diskutohesh edhe çështja e Gjin Markut e të përjashtohesh edhe ky riga përbërja e Komitetit Qendror.

Ishte e rëndësishme në këto momente të goditeshin jo vetëm veprime të tilla oportuniste, të cilat ishin në kundërshtim të hapur me vijën e PKSHE dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, por edhe shfaqjet e euforizimit që u vunë re në ndonjë organizatë apo në shokë të veçantë. Komiteti Qendror duhej të porositur që të procedohej për vendosjen e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë në të gjithë vendin, theksonte, gjithashtu, që të ruhej konspiracioni i kuadrove të Partisë e të lëvizjes dhe të ekspozoheshin vetëm ata shokë që ishte e domosdoshme të dilnin hapur si drejtues të pushtetit. Në përgjithësi kjo porosi e Komitetit Qendror u zbatua drejt, por, në ndonjë rast, rreth u desh t'u tërhiqim vëmendjen disa shokëve për shkeljen e konspiracionit, për lëvizje të tepruara të ilegalëve, sikur të ishin legalë, me makina në mes të ditës etj.

Në mënyrë të veçantë kritikua fort Komitetin Qarkor të Elbasanit, i cili në këtë drejtim i lëshoi krejt frenat riga duart. Nuk kaluan shumë kohë dhe shokët e kësaj organizate për euforizim që kishin treguar morën një goditje të hidhur: një numër komunistësh e kuadrosh të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, në mes tyre edhe sekretari politik i qarkorit, Tomor Siriani, u arrestuan riga Gestapoja e ndihmuar riga ballistët.

Kështu, me luftë e me veprimtari të pandërprerë, me vigjilencë të lartë e me një qëndrim të drejtë e konsekuent në çdo hap, ne po kalonim me sukses njërin pas tjetrit provat e vështira në situatat e krijuara pas Konferencës së Dytë të Labinit. Për këdo po bëhej e qartë se autoriteti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare ishte rritur shumë, dhe, në këtë kuadër, edhe pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë jo vetëm ishte në gjendje e i aftë të mbante frenat e vendit, të vepronte e të diktonte në emër të popullit, por, më kryesorja, ishte i vendosur të mos lejonte askënd, që t'i prekte apo t'i cenonte fitoret e arritura.

Pikërisht në këto momente, në valën e këtyre punëve ne do të ndodheshim përpara një rreziku të ri e një përpjekjeje të re të reaksionit për të na goditur frontalisht, për të përçarë popullin e për t'i marrë nga duart ato që kishte arritur me luftë.

Ndodheshim në Arbanë kur na bie në dorë një trakt i hedhur nga një e ashtuquajtur parti nacionalzogiste e padëgjuar gjer ato çaste, por e firmuar nga bajraktarë të tillë «të dëgjuar», si: Fiqri Dine, Muharrem Bajraktari, Myftar Kaloshi, Abaz Kupi e të tjerë. Nëpërmjet kësaj fletushke e ashtuquajtura nacionalzogiste, duke dalë taze nga kuzhinat e fshehta të reaksionit, shpallte ekzistencën e saj dhe i jepte «gjindies» lajme sensacionale: nuk qenqesh shuar akoma «ylli i kombit», satrapi Ahmet Zogu, por rroate shëndoshë e mirë në Angli, bile na bënte muhabetë e përgatiste planet «e çlirimit» me vetë sër Çerçillin(!) dhe se vetë zbulimi anglez tash që mobilizuar t'i gjente ku i kishin humbur ato opinga të shkreta, që sovranit s'arriti t'i mbatte dot në prillin e 1939-s! Pra: Gëzohu, o komb, thërriste «nacionluzogistja», se shpëtimtari do të zbresë (nga qiejt, me balona angleze), e sa të gjenden opingat, bashkohuni të tërë: patriotë e millet, rreth partisë së mbretit «augizst», të luftojmë (natyrisht kundër Frontit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare) se të ardhmen e kemi të siguar: mbretërinë dhe mbretin!

Po u bëja shokëve që ndodheshin në Arbanë atë ditë këtë koment të shkëlqer për traktin e gomarllëqet që përmbante dhe u thashë:

- E gjitha kjo fle'; për një lodër të kurdisur kundër nesh nga reaksion: i brendshëm dhe nga ai i jashtëm. Të bindur se s'u qoli gjë me Ballin, tani reaksionarët nisën të ngrenë nga varri Ahmet Zogun, ta lyejnë kufomën e tij me pudër e me erurina, që të krijojnë përshtypjen se mbretëria e mbreti në Shqipëri ishin dhe mbeten në fuq: e të ligjshëm! Teju i goditjes duket qartë: në Shqipëri s'ka pse të krijohet pushtet tjetër, s'ka pse të njihen këshillat nacionalçlirimtarë. Pra: luftë kuniër këtyre, në emër të mbretërisë, e jo luftë kundër okupatorit në emër të Shqipërisë !

- Moment shumë të përshtatshëm kanë zgjedhur rrufjanët! - tha me një nënqeshje të thellë në cepat e syve Mustafa Gjilishi, i cili në atë periudhë ndodhej kryesisht në zorrën e Pezës. - Do të na hapin goxha punë e telash!

- Telashet e punët, pa dyshim që do të shtohen, - i thashë, - poe, sa për momentet që kanë zgjedhur, ato më tepër janë në disfavor të vetë reaksionit. Dalja e papritur e zogistëve në skenë do të turbullojë e do të përçajë më keq radhët e Ballit Kombëtar. Të mos harrojmë se krerët e Ballit vite të tëra, pavarësisht nga motivet, kanë qenë kundër Zogut dhe tash, qoftë edhe servirja e hyrjes së

Zogut për shpëtimtar e trashëgimtar të pushtetit, një pjesë të mirë do t'i trembë e do t'i bëjë ta braktidn Ballin e të afrohen me ne. Por, - vazhdova, - ijo është tjetër punë, koha do të tregojë ç'do të ncodhë me rrymat e me grupimet e ndryshme të reaksiorit. Për sa na përket neve, momentet kur dalin në skenë zogistët, janë më tepër në favorin tonë. Ne tash kemi Frontin Nacionalçlirimtar, kemi këshillat e ushtrinë ~onë anembanë vendit, kemi një autoritet e pushtet që njihet e vepron. Do të mbajmë ndaj kësaj «partie» r--aksionare po atë qëndrim të prerë që përcaktuam ndaj Ballit reaksionar!

- Këtu qëndron e keqja e telashi ynë i madh, ndërhyri Gjinishi i sigurt se këtë radhë s'kidta ku ta kapja, - Balli është diskredituar, por partia zogiste sapo doli. Po t'i godasim menjëherë do të r.a thonë: a jeni për luftë kundër okupatorit, siç deklaroni, apo jeni për luftë partish? Kjo do të na implikonte shumë! . .

- S'të marr vesh, - i thashë me një zemërim që mezi e përmbaja, - nga ç'pozita po flel?!

Ai heshti një moment, më pa si i ofenduar në sy dhe qetë-qetë vazhdoi:

- Unë dhe shokët ju kuptojmë drejt, shoku Taras, dhe në thelb gjërat janë siç i paraqitni ju. Por merakun e tram te taktikat e kujdesshme që duhet të ndjekim, pra, të mos shkelim atë platformë që tremi vendosur e shpallur në Pezë, e bile edhe në Labinot.

- Pse? - e pyeta. - Ku e sheh shkeljen?

- Ta godasësh partinë zogiste menjëherë, pa i lënë rast të diskreditohet në popull si bashkëpunëtore e okupatorit, kjo, mendoj unë, do të na merret si shkelje e platformës së Konferencës së Fezës. Ne kemi deklaruar se s'jemi kundër partive e organizatave të ndryshme nacionaliste. Apo jo?!

- Dy gjëra janë te ti, Mustafa, - i thashë. Ose s'e tre kuptuar platformën e Pezës e të Labinotit, ose nga nxitimi bie në gabime e në interpretime që s'i falen as një fillestari. Ne tremi qenë e jemi për bashkëpunim me çdo parti përparimtare, nacionaliste etj., që pranon platformën e Konferencës së Pezës, përfshihet në Frontin Nacionalçlirimtar, njeh këshillat nacionalçlirimtarë dhe, duke ruajtur pavarësinë e vet si parti, lufton në kuadrin e Frontit, kundër pushtuesit e tradhtarëve për çlirimin e Shqipërisë. Apo jo? - e pyeta.

- E drejtë! Kështu është! - belbëzoi Gjinishi.

- Atëherë, - vazhdova, - pa më thuaj, cilin nga këto kushte bazë plotëson «nacionalzogistja»?! Asnjërin! Përkundrazi, ajo jo vetëm s'plotëson asnjë nga këto kërkesa, por bën thirrje që Fronti Nacionalçlirimtar të vihet nën gunën e saj dhe, për më keq akoma, qysh tani ngre problemin e regjimit, bile na paska përcaktuar edhe formën e regjimit, edhe personin: mbretërinë si regjim e Ahmet Zogun si mbret! E pas këtyre, ç'gjë më pak «diskredituese» paska kjo farë partie sesa Balli Kombëtar, që, sipas teje, Mustafa, ne duhet t'i rrimë me temena e me dorë në zemër?!

- S'e luan topi, - ndërhyri Spiro Moisiu, - t'ia çjerrim maskën e fytyrën e zezë «nacionalzogistes» njëlloj si Ballit!

- Më bind logjika juaj, shoku Taras! - mblodhi lëmshet Mustafa Gjinishi. - I pashë gjërat në sipërfaqe ngaqë s'pata kohë të thellohem. Por më ngatërroi edhe ajo drejtë firmë që ka vënë poshtë Bazi i Canës, edhe ajo që thuhet për Çerçillin. «Bazin, - mendova, - e kemi anëtar të Kryesisë së Këshillit, Çerçilli po është kryetar i aleatit tonë të madh, Anglisë, ndaj gjykova që s'mund t'u kundërvihemi këtyre dot hapur si Ali Këlcyrëve e Mehdi Frashërve». Por, e shoh, ishte një gjykim i nxituar.

- Sa për Abaz Kupin, - u thashë shokëve, ai, me këtë që bëri, duhet të japë llogari si anëtar i Kryesisë së Këshillit dhe i Shtabit të Përgjithshëm_ Me këtë trakt që firmosi, ai hapur firmosi se gjer tani ka hyrë në radhët tona për të tjera qëllime e misione. Sa për Çerçillin e bisedimet e tij me Ahmet Zogun, ne s'kemi pse shqetësohemi. Populli Ahmet satrapin e njeh mirë. Ne hapur do t'i themi popullit se Çerçilli po të ketë kohë e qejf le të bisedojë ditë e natë me Ahmet Zogun për çështjen tonë, veçse jemi ne dhe vetëm ne ata që do të vendosim për të ardhmen e Shqipërisë.

Pas kësaj, duke e diskutuar e duke e rrahur mirë problemin, ne orientuam gjithë organizatat e Partisë në qarqe, e veçanërisht në Tiranë, për qëndrimin e prerë e konsekuent që duhej mbajtur ndaj zogistëve.

Në të njëjtën kohë i porositem si organizatat e Partisë, ashtu dhe këshillat nacionalçlirimtarë që lufta kundër zogistëve e krerëve të Ballit, në asnjë mënyrë të mos kuptohej e të trajtohej si luftë më vete apo si më kryesorja për ne.

- Atdheun tonë e ka zaptuar një armik i ri, nazizmi gjerman, - i porositim shokët, - ndaj të gji tha forcat duhet t'i përqendrojmë kundër pushtuesit

dhe, krahas tij, edhe kundër tradhtarëve ballistë e zogistë që bashkëpunojnë me të. Të mos harrojmë se dalja në skenë e «zogistëve» i ka fijet edhe në Londër, por mund t'i ketë edhe në kularët e Gestapos gjermane. Nazistët duan e përpiqen të mbjellin e të ndezin përçarjen, të na mashtrojnë e të bëjnë që ne ta përqendrojmë luftën kundër grupeve e partive reaksionare vendase që lindin e thahen si kërpudhat. Prandaj vigjilencë e pjekuri! Duke ua bërë tokën tonë zjarr nazistëve, bashkë me ta do të përvëlohen edhe veglat e tyre, bashibozukët vendas.

Ja, kështu, në mes kaq e kaq vështirësish e pro

vash, në vjeshtën e 1943-shit nisëm e vazhduam me konsekuencë e trimëri edhe përleshjen me veglën tjetër të okupatorit e të reaksionit vendas e të huaj, me zogistët. Pak më pas, kjo farë partie, çerdhe kriminelësh e mercenarësh të paguar, do të organizonte në Tiranë edhe një të ashtuquajtur kongres e prej tij do të dilte me një emër simbolik të nxjerrë nga sepetet e vjetra: Legaliteti. Medemek, fundërrinat që përbënin atë donin të thoshin se na qenkëshin përfaqësues e trashëgimtarë «legalë» të një regjimi «legal», që ekzistonte diku..., (në planet angleze e në ëndrrat e myteberëve të kombit) e që tash po dilte në skenë për të rivendosur në Shqipëri mbretërinë.

Por, si në rastin e Ballit Kombëtar edhe me Lega litetin reaksioni i kishte bërë llogaritë pa hanxhinë. Siç thashë, ne qysh në fillim i zbuluam dhe i përcaktuam drejt karakterin dhe qëllimet reaksionare të këtij grupimi dhe i kundërvumë menjëherë e kudo vijën e demaskimit e të goditjes së hapur. Qoftë nga qëndrimi i drejtë e i menjëhershëm i Partisë sonë, ashtu edhe nga urrejtja e përgjithshme që kishin masat e popullit për kohën e regjimit zogist, Legaliteti thujse s'hodhi rrënjë poshtë, ai mbeti më tepër një grupim krerësh agjentë të anglezëve e të regjimit të vjetër, të mbështetur nga banda bashibozukësh, midis të cilave në pararojë do të qëndronin forcat mercenare të Abaz Kupit e të disa krerëve të tjerë bajraktarë.

Ndërkohë dalja në skenë e Legalitetit, shpejt do të vërtetonte edhe atë që ne e kishim parashikuar: tronditjen dhe përçarjen në radhët e «krerëve të kombit», veçanërisht në një numër elementësh të Ballit Kombëtar. Të qartë se Balli e kishte humbur davanë, e tash të frikësuar nga mundësia e rishfaqjes së Zogut, elementë të ndryshëm pseudonacionalistë u detyruan më në fund t'i kthenin sytë nga Fronti Nacionalçlirimtar dhe po përpëliteshin për hapin që duhej të merrnin. U çuan bile fjalë shokëve tanë në Tiranë se kishin ndër mend të shkëputeshin nga Balli, të krijonin një «parti demokratike», të hynin si parti në Front, të njihnin këshillat e të luftonin me armë kundër pushtuesit!

- U thoni «bujrum», - u dërguam ne fjalë shokëve të Tiranës, - veçse t'i mbajnë e t'i zbatojnë ato që thonë. Fronti nuk është e sdo të jetë strehë dallaveraxhinjsh. Fronti është organizatë lufte.

Pritërn të vinin, natyrisht pa na prerë barku për ta, sepse në fund të fundit ishin ata që kërkonin ndihmë e shpëtim e jo ne, por s'po bëheshin më gjallë. Kishin marrë fund nga çdo pikëpamje. Disa u ripajtuan me gjendjen e mëparshme e me okupatorin e ridisa vendosën të «heqin dorë nga politika», ndonjë tjetër vazhdonte hiq e mos këput.

Ndonëse s'ia vien të flas më gjatë për këta afendikonj të kohës së vjetër, do të përmend vetëm edhe një moment që ka lidhje me ta, por sidomos me një «ide» e «projektiniciativë» të disa shokëve tanë. Ishim akoma në zonat rreth Tiranës, kur një ditë vjen nga qyteti Sejfulla Malëshova, i cili, duke mashtruar edhe Nako Spirun, më parashtroi një ide «të ndritur» e më thotë:

- Të lëkundurit në radhët e reaksionit s'po bëjnë dot gjë me forcat e tyre. S'po e krijojnë partinë demokratike me të cilën do të aderojnë në Front. Kemi menduar Vi nxitim e Vi ndihmojmë që të krijojnë një parti, por jo socialdemokrate; diçka më përparimtare, fjala vjen... demokratike, ose më mirë një parti republikane demokratike.

- Interesante! - i thashë me një ironi të lehtë për të mos ia prerë hovin. - Po përse duhet kjo ~<ndihmë» nga ana jonë?

- Të shfrytëzojmë kontradiktat në radhët e kundërshtarëve tanë, ta thellojmë përçarjen e të zgjerojmë diferencimin në radhët e tyre, - u përgjigj serbes-serbes Sejfullai.

- E për këtë, në anëtarët e kuadrot e Partisë Komuniste duhet Vi mësojmë e Vi nxitim ata të krijojnë një parti?!

- E kemi gjykuar si një rrugë me mundësi të mëdha! - vazhdoi në të tijën «profesori». - Merre me mend ç'efekte do të kishte të shpëruar një pjesë e Ballit në një parti më vete e kjo parti të shpallte publikisht aderimin në Front! Platforma e Konferencës së Pezës...

- Më ndje, Sejfulla, që po të ndërpres, - i thashë, - por në rastin konkret ju keni gjykuar tamam si socialdemokratët e debateve parlamentare, Në jemi anëtarë të Partisë Komuniste dhe nuk na lejohet e s'ka asnjë arsye as të marrim iniciativën, -,s të nxitim krijimin artificial të partive të tjera. Nëse elementë ose grupe elementësh të ndryshëm na -ionalistë

demokratë e të tjerë arrijnë të krijojnë vetë një parti, e cila pranon e hidhet realisht në luftën kundër pushtetit, aderon në Front e pranon këshillat nacionalçlirimtarë, atëherë në s'kemi asnjë kundërshtarim që ta

njohim këtë parti, ta respektojmë pavarësinë e saj, bile, po të jetë e zonja ajo e po të na mykeh e të na thartohen trutë neve, le të fitojë edhe rolin udhëheqës në Front! Këtë qëndrim të qartë e të drejtë në ua kemi bërë të njohur të gjithëve, dhe do t'u përmbahemi me konsekuencë këtyre parimeve leniniste. Por, të hyjmë në vetë në pazare e në përpjekje për t'i shtyrë të krijojnë parti ata që s'janë të zotët të bëjnë asgjë, kjo është antimarksiste në parim dhe shumë e dëmshme në praktikë!

Shkurt, qëndrimi ynë është e mbetet ky: Nëse duan e janë të zotët, ata le të krijojnë vetë partinë e tyre e le t'i vënë ç'emër të duan. Por në ua kemi thënë e ua themi: Nëse duan vërtet të luftojnë, s'ka pse të koten me përralla partish. Le të hyjnë në Front edhe individualisht ose në grupe, të nisin luftën dhe në do t'i respektojmë ata, siç do të kërkojmë që edhe ata si individë ose si parti, jo vetëm të njohin e të respektojnë pavarësinë e Partisë Komuniste në Front. por edhe rolin udhëheqës që Partia jonë e ka fituar me luftë e me përpjekje kolosale.

Sejfullai bëri sikur u bind nga argumentet e mia e për njëfarë kohe s'u fol më për këtë «parti.

Por, pas 5-6 muajsh, kur sapo kishim çarë rrethimin armik të dimrit e qemë vendosur në Panarit, më vjen një letër nga Nako Spiru ku, për habi, më përsëriste propozimin e Sejfullait për të nxitur krijimin e «partisë republikane demokratike» bile tash edhe me pjesëtarë të Frontit (!) në radhët e saj. I ktheva një përgjigje të rreptë e të prerë Nakos, e nëpërmjet tij, autorit kryesor për «krijime partish», Sejfullait,

dhe i porosita që me çështje të tilla të mos vritnin më kohën, por të merreshin me punë.

Më vonë kuptimin e vërtetë të propozimit të Sejfulla Malëshovës e kapa më mirë në kuadrin e gjithë pikëpamjeve të tij oportuniste të djathta. Sejfulla Malëshova e mendonte të ardhmen e Shqipërisë në vendosjen e një demokracie borgjeze, me një parlament ku do të luanin kartat e partive të ndryshme, do të bëheshin pazare për portofola e për reforma dhe Sejfullai në atë lodër, po që se Partia Komuniste nuk do të vepronte sipas vijës e orekseve të tij, mund të bëhej «fare mirë» kryetar i «partisë republikane demokratike», apo i një partie tjetër që do t'i pille mendja. Këto pikëpamje i manifestoi fare hapur pas

Çlirimit të vendit, derisa Partia e goditi përfundimisht atë si oportunist dhe mbrojtës të interesave të borgjezisë.

Kisha pasur edhe më parë një debat me Sejfullain, pak kohë pasi ky që kthyer në Shqipëri për t'i dhënë «mend» Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe

Lëvizjes sonë Nacionalçlirimtare. Në ato kohë Sejfullai kujtonte se në do ta pritnim si ujët e paktë dhe çdo fjalë të tij do ta pranim si flori të kulluar dhe nuk rezervohej fare të na tregonte për «aktivitetin» e tij. Ai nuk e njihte pjekurinë marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe mendonte se do t'i shiste lehtë mendimet e veta oportuniste. Kështu, në një nga bisedat që bëra me të, më tregonte me mburrje se si, kur ndodhej në Paris, me iniciativën e tij, kishte bërë përpjekje të pijej me Zogun, të bisedonte me të dhe të kurdiste aleancën me katilin. Sejfullai më foli me bindje të plotë për këtë «vijë gjeniale politike» të tij dhe u habit shumë kur i thashë se nuk kishte bërë mirë që kishte menduar të pijej me Zogun, se me atë në nuk bëjmë aleancë.

- Zogut, - i thashë ndër të tjera Sejfullait, kemi detyrë vetëm Via presim kokën, jo një herë, por dhjetë herë.

Sejfullai, me ato sy të vegjël që i mbante kurdoherë ulur se kishte frikë të të shihte në sy dhe me atë pozë të «njeriut të madh» që «vinte nga Moska», kompleks ky që ia ushqente edhe trupi i tij i vogël, më tha:

- Ç'flet kështu, shoku Enver, edhe unë jam kundër Zogut, por kjo është një taktikë politike dhe këtë ti nuk e kupton.

- E kuptoj, - iu përgjigja, - por taktikën unë nuk e kuptoj si ti, ashtu si edhe ti që nuk e kupton si unë.

Sejfulla Malëshova nxori «argumentin» bindës dhe më tha:

- Këtë politikë, këtë taktikë, ma ka rekomanduar Moska, prandaj duhet t'i bindesh.

- Thua ti, - ia preva Sejfullait, - që ta ka rekomanduar Moska, por unë jam i bindur se nuk është kështu dhe ti këtë e ncjerr nga mendja. Partia Bolshevike dhe Komintern. nuk mund të na këshillojnë të puthemi me xhelatin e popullit tonë, me atë që përgatiti 7 prillin dhe soli pushtuesit italianë, me atë që, kur populli kërkonte armë për të goditur pushtuesit, ua mbathi këmbëve si një hajdut i ndyrë. Jo vetëm kaq, por, edhe pas pushtimit, Zogu vazhdon të mbetet ai që qe - kat :1 i popullit e i atdheut tonë, armik i betuar i Luftës sonë Nacionalçlirimtare, prandaj e ke kot të vazhdos. i për këtë çështje, - i theksova atij, - dhe të urdhëroj të mos flasësh me kërrkënd, se do të të demaslojmë përpara Partisë si sabotator të Luftës Nacionalclirimtare.

Sejfullai, i skuqur nga inati, më tha:

- Do Vi shkruaj Mc)skës për qëndrimet e tua.

- I shkruaj kujt të duash! - iu përgjigja. Dhe mos mendo, - shbva, - se mund të më tre mbësh me ato që më thua! Mua le të më gjykojnë Partia dhe populli im, le të më gjykojë, po të duhet. edhe Kominterni.

Por le të kthehem përsëri te vjeshta e vitit 1943, e mbushur me kaq ngjarje, vështirësi e rreziqe, me të cilat u ndeshëm e i pzbballuam me sukses.

Siç thashë, qëndrimi dhe lufta jonë ndaj reaksionit ballist e zogist nuk ishin «një luftë më vetë», por pjesë përbërëse e luftës kryesore, të madhe e të rreptë që ne zhvillonim çdo ditë e çdo orë kundër pushtuesit të huaj nazist, i cil! menjëherë pas kapitullimii të Italisë vërsheu në Shqipëri me tërë egërsinë e tij.

Okupatorët e rinj, ashtu siç e pritnim, filluan ta shoqërojnë pushtimin ushtarak të vendit me një propagando të ethshme demagogjike. «Tezat- themelore të kësaj demagogjie nisën të interpretohen pastai nga propaganda kuislinge dhe balliste, të cilët në këtë mënyrë po i hidhnin një cipë të turpshme bashkëpunimit të tyre me pushtuesit e rinj. U nxorën përsëri nga sirtarët dhe kasafortat e pushtuesve italiane planet e «Shqipërisë etnike», u sajuan ushtria dhe xhandarmëria e shtetit «sovrani» shqiptar etj.

Pushtuesit e rinj nuk nxituan të krijonin menjëherë qeveri, por një komitet ekzekutiv provizor me Ibrahim Biçakun në krye dhe, si grumbulluan disa nga «baballarët» e kombit, në një të ashtuquajtur asamble, krijuan Regjencën me Mehdi Frashërin, të cilin e sollën me aeroplan nga Roma, Lef Nosin, Patër Anton Harapin e Fuat Dibrën. Ne bëmë përpjekje duke dërguar Omer Nishanin në Tirane që ta tërhiqte Mehdi Frashërin në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, por II\Iehdi tradhtari e kishte mbledhur mendjen që t'u Unte hyzmet parave që do të merrte nga gjermanët.

Balli Kombëtar u integrua haptazi në aparat

epresiv që ngriti pushtuesi, në dispozicion të Ballit u vunë godinat më të mira në qytete, komitetet e tij kr ahinore u jepnin rekomandime organeve e kuislinge për njerëzit që vendoseshin në punë etj. Nuk do të vononte edhe bashkëpunimi i hapur me arme gjermano-ballist. Propaganda kuislingo-balliste i aktivizoi në këtë kohë tërë forcat e sai.

Sigurisht, non rrebeshin e kësaj propagande, u gjetën edhe elemento nga njerëzit tane që u lëkundën e u thyen. S'kishte si të ndodhte ndryshe. Luf ta dhe revolucioni janë të vështirë, kërkojnë sakrifica e ve

tëmohim: né irugën e tij do té ketë edhe njerëz që castësisht janë bashkuar me të, që lodhen, trembën, kapitullojnë. Këta njerëz largohen dhe nga Ilio asgjë nuk humbet revolucionin, përkundrazi, bëhet in e i forto.

Kështu ndodhi edhe me Sotir Kondin; që bënte pjesë në Këshillin Nacionalçlirimtar të Tiranës. Sotir Kondi, me kapitullimin e Italisë dhe me hyrjen e gjermanëve, e kishte shpallur luftën të përfunduar! Sipas tij largimi i italianëve do të thoshte se Shqipëria tashmë kishte rifituar lirinë dhe independencën, kurse gjermanët ishin «kalimtarë» dhe jo pushtues. Kështu ai na e quante luftën të përfunduar!

Sigurisht, pikëpamje të tilla, që ne i kishim goditur dhe i goditnim çdo dite, bëheshin veçanërisht të rrezikshme, kur shfaqeshin nga një njeri që aderonte në lëvizje e, për më tepër, zinte një vend të rëndësishëm në të.

Thirra Medar Shtyllën, anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, dhe e vura në dijeni për këto pikëpamje.

- Do të vesh në Tirane, - i thashë, - si i delegua, i Këshillit të Përgjithshëm dhe do të provokosh një mbledhje të Këshillit Nacionalçlirimtar të Tiranës për këtë çështje.

- Dakord, - m'u përgjigj Medarici, i gatshëm si përherë.

- Në këtë mbledhje, - vazhdova, - ta dëgjosh me durim Sotir Kondin. Pastaj përpiqu ta bindësh atë për pikëpamjet e gabuara dhe shpjegoi vijën e Frontit Nacionalçlirimtar, tregoi me argumente e me fakte se ç'janë gjermanët dhe cila është detyra ime ndaj popullit dhe ndaj koalicionit antifashist. Ki parasysh që argumentet e tua të jenë të qarta, se veç Sotir Kondit, mund të ketë edhe ndonjë element tjetër që i kupton mbrapsht këto çështje.

- Ashtu do të bëj, shoku Enver, - më tha Medari.

- Veç kësaj, - shtova, - shfrytëzoje këtë rast për të biseduar me anëtarët e këshillit të Tiranës për detyrat aktuale, shpjego edhe një herë kuptimin e vendimeve që morëm në Labinot. Pasi të dëgjosh edhe shokët e tjerë të këshillit, edhe vetë Sotirin, në qoftë se ky nuk tërhiqet nga e vetja, atëherë ai s'duhet të ketë më vend jo më në këshillin e Tiranës, por as në Front.

Pas ca ditësh Medari më informoi për mbledhjen e Këshillit Nacionalçlirimtar të Tiranës që që zhvilluar në shtëpinë e Aleks Budës, njërit prej intelektualëve patriotë, që u lidh me Luftën Nacionalçlirimtare dhe është sot një nga njerëzit më të shquar të shkencës në vendin tonë. Përpjekjet dhe argumentet e Medarit dhe të shokëve të tjerë nuk e kishin bindur Sotir Kondin, i cili që nga këto momente u cilësua renegat i Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Siç na tregoi më vonë Qirjako Haritoja, njëri ndër shokët më të mirë e më aktivë të Këshillit Nacionalçlirimtar në Tirane, për të cilin ruaj kujtimet më të mira, arsyeja e vërtetë e largimit të Sotir Kondit ishte presioni që i ishte bërë këtij nga kuislingu Mehdi Frashëri, i cili e kishte kërcënuar, duke i, thënë se për veprimtarinë e tij ishte në dijeni Gestapoja.

Pas ndërhyrjes sonë dhe me veprimtarinë intensive udhëheqëse të qarkorit të Tiranës, Këshilli Nacionalçlirimtar në kryeqytet vazhdoi punën e tij normalisht dhe, në kushtet e terrorit të egër nazist, e afirmoi veten si një përfaqësues e mbrojtës i vendosur i popullit dhe i çështjes së madhe të luftës sonë.

Kaloi kështu afro një muaj që ne, nga zonat afër Tiranës, ndiqnim hap pas hapi situatat, punonim e luftonim për ruajtjen e Nordit për të mos lejuar që askund e për asnjë çast të dëmtohej vepra e madhe që e kishim arritur e po e konsolidonim përmes luftës, përpjekjeve e sakrificave pa fund. Ndërkohë ngjarjet vazhduan të ecnin me shpejtësi.

Aleatët anglezë, për arsyet e tyre, e shtynë zbarkimin në Ballkan dhe Tirana, ndërkaq, u bë qendra kryesore ku u grumbullua e u fortifikua ajka e naziballistëve; vetvetiu projektplanin për të çliruar kryeqytetin ra nga rendi i ditës. Në kushtet e reja që u krijuan, një sulm mbi kryeqytetin jo vetëm do të na kushtonte shumë gjak e humbje, por më kryesorja, ne ishim të bindur se edhe po ta çlironim, ishte akoma herët e jashtë mundësive tona për ta mbajtur kryeqytetin gjatë në duar. Të hynim atje sa për një apo dy dite e pastaj të detyroheshim të tërhiqeshim, kjo do të qe një aventurë e lodër

demonstrative me efekte shumë më tepër negative, sesa pozitive. Mbi Tirane ne do të mësynim kur të vinte koha dhe e ndienim se ajo dite s'do të qe e largët.

Hoqëm, pra, dorë nga plani i mësymjes mbi Tirane dhe po bëheshim gati të kalonim në thellësi, dr ejt Shëngjergjit e pastaj drejt «selisë» sonë kryesore, malëSiSë së Elbasanit.

Pikërisht në një nga këto dite, me sa mbaj mend në mëngjesin e 9 tetorit, kur ishim akoma në Arbanë dëgjojmë të shtëna pushjçësh e mitralozësh. Çohemi, pyesim nëse dinin gjëkafshë shokët që ishin roja jashtë dhe, ndërkohë që pushka vazhdonte, ne të tërë u armatosëm, u veshëm e u bëmë gati për sulm. Né këto e sipër shohim të vijë drejt nesh me shpejtësi një korrier i dërguar nga Myslimi. Ai na tha se Arbanën po e sulmonin gjermanët, të cilët, siç duket, nëpërmjet informacionit të tyre, kishin mësuar që ne ndodheshim né këtë fshat. Duhet thënë se forcat tona u gjendën né befasi né një kohë kur armiku kishte vepruar me shpejtësi të madhe dhe kishte përgatitur sulmin frontal si nga brigjet përballë Arbanës, po kështu edhe nga të dy krahët e lumit Erzen, nga veriu dhe nga perëndimi, nga Mulleti dhe nga ura e Beshirit. Nga ura e Beshirit dhe nga Mulleti nëpërmjet Erzenit ata vinin me tanke, kurse këmbësoria zbriste kodrat drejt lumit të Erzenit.

Ne zbritëm menjëherë poshtë, kapërcyem rrugën përmes mareve dhe u takuam me Myslimin, i cili na raportoi për situatën dhe rifuam me shpejtësi gjendjen e trupave tona. Këto veprime i bëmë gjatë zhvillimit të luftës. Myslimi kaloi né drejtimin e majtë të luftimeve, përballë gjermanëve dhe unë bashkë me disa partizanë, nga e djathta po kështu ballë për ballë gjermanëve te mulliri, të cilin gjermanët përpiqeshin ta rrëmbenin dhe të mund të sulmonin që andej Arbanën e të kalonin né këtë anë. Lufta vazhdonte e ashpër.

Neve na duhej ta likuidonim këtë aksion të gjermanëve, jo vetëm duke ruajtur pozicionet, por edhe duke kundërsulmuar. Kundërsulmin vendosëm ta bënim njëkohësisht nga e djathta, domethënë né drej timin e veriut, dulce il marrë krahët gjermanëve, pastaj frontalisht, duke kapërcyer Erzenin dhe dulce sulmuar rreptësisht nga mulliri. Për këtë qëllim kërkuam dhe gjetëm Kajo Karafilin, të cilit i dhamë ur

dhër që me një skuadër të kalonte prapa krahëve të gjermanëve, të kapërcente Erzenin, të ngjitej né shtigje kyç dhe, kur të kishte mbërritur né pozicionet që vendosëm, të shpërthenim sulmin nga të dy krahët. Dhe kështu bëmë.

Gjermanët, si rezultat i sulmit tonë të përqendruar, nuk mundën ta kapërcenin dot Erzenin, ata na qëlluan me mortaja, që i kishin vendosur nga ana e majtë e urës sé Beshirit, predhat e të cilave kalonin mbi kokat tona dhe binin nja 100-150 metra larg. Si rezultat i realizimit të këtij plani, gjermanët u tërhoqën dhe pasdreke lufta kishte mbaruar. Né këtë luftë

ndihmuan me armë né dorë edhe fshatarë të zonës, të cilët morën pjesë trimërisht né vijën e parë të zjarrit.

Si mbaroi lufta dola tok me disa shokë përtej Erzenit dhe vizituam vendin vetë. Me sytë e mi pashë nja 10 kufoma gjermanësh të vrarë, të cilat dhashë urdhër t'i futnin menjëherë né gropë, t'i mbulonin me gëlqere, pse kishim frikë nga ndonjë epidemi që mund të ngjiste.

Né këtë kohë shoh disa partizanë që po sillnin

një rob civil, i cili vinte nga Shijaku drejt Arbanës, nga Alitati.

- Ç'e keni këtë? - i pyeta shokët.

- Spiun gjerman, me kombësi çekosllloake.

- Merreni né pyetje! - u thashë.

Tanët, bashkë me ta edhe një shok që dinte një çikë gjermanisht, e pyetën spiunin dhe, sa e kërcënuan se do ta pushkatonin, ai tregoi se gjermanët e kishin çuar për të parë pozitat tona, pse mendonin që sulmin në Arbanë ta shoqëronin edhe prapa këtij fshati. Shokët tanë këtë agjent e çuan në gjyqin partizan dhe e pushkatuan.

Nazistët gjermanë lanë në këtë betejë rreth 40 të vrarë, disa mortaja, ca mitralozë të rëndë e të lehtë, pushkë e automatikë. Më vonë shokët më treguan se në një përleshje tjetër të përgjakshme në Pezë, midis nazistëve të vrarë, u gjet edhe një personalitet, identiteti i të cilit u mor vesh edhe nga një unazë që kishte në dorë dhe që partizanët ia dorëzuan Myslimit. Unaza e këtij nazisti tregoi se ai ishte nipi i Herman Gëringut. Doktor Nishani iu lut Myslimit t'ia jepte këtë unazë për shoqen e tij që

e kishte austriake dhe që donte ta mbante si kujtim të luftës së shqiptarëve kundër nazistëve gjermanë. Myslimi, natyrisht, ia dha.

Kështu përfundoi beteja e Arbanës, një luftë e ashpër, por që u kurorëzua me fitoren tonë.

Pas kësaj beteje na vjen një informatë nga shokët e qarkorit të Tiranës, se së shpejti do të mblidhej, nën egidën e pushtuesit, një asamble tradhtare! Shoku Gogo Nushi na propozonte, në emër të shokëve të Tiranës, që të goditej asambleja me artileri. E aprovuam menjëherë propozimin dhe porositëm që ky aksion të kryhej me sukses.

Në paraditen e 18 tetorit 1943 nga kodrat e Tiranës u qëllua me top pallati ku ishin mbledhur «baballarët», kurse trakti i Partisë i bënte jehonë entuziazmit të popullit: «Si i përgjigjet populli Asamblesë së Gestapos? Me TOP!». Vetëm pas nja dy ditësh e mblodhën veten «baballarët» dhe u grumbulluan përsëri në një kinema të Tiranës, nën mbrojtjen e bajonetave gjermane. Aty u morën vendime për «pavarësinë», gjithashtu iu thur edhe një mesazh «heroit kombëtar», Abaz Kupit!

Në të tërë këtë periudhë Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, si organi më i lartë i pushtetit të ri që po krijohet e konsolidohet nga pushka partizane, iu vu punës bashkë me gjithë shokët drejtues ose jo të Partisë, të ushtrisë e të Frontit për të realizuar direktivën historike të Konferencës së Labintit për vendosjen e këshillave nacionalçlirimtarë në të gjithë vendin. Në kujtesën time ngrihen të paharruar dhe të palodhur shokë të tillë, si: Medar Shtylla, Spiro Moisiu, Omer Nishani, Fetah Ekmekçiu, Haki Stërmilli, që lëviznin nga një fshat në tjetrin, nga një repart partizan në tjetrin, ngrinin dhe drejtonin këshillat nacionalçlirimtarë në bazë dhe, me gjithë shokët, e çonin përpara punën. Përballë kësaj veprimtarie të dendur dhe të frytshme, ose, si të thuash, përballë kësaj ofensive të Lëvizjes sonë Nacionalçlirimtare, Balli Kombëtar preferoi të dilte nga «ilegaliteti». Fillimisht u përpoq të zinte qytetet e të hidhte rrënjë atje, pastaj iu atashua karvaneve të ushtrisë naziste dhe eksponentët e tij dolën në dritë me gjithë shkëlqimin e tyre «patriotik» (!) si ministra, si prefektë, si kriminelë e xhelatë! Integrimi i hapur i Ballit në administratën dhe në aparatën represiv, propaganda e tij e ndyrë kundër Partisë sonë dhe Frontit, sulmet e armatosura të bandave balliste kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të gjitha këto na bënë që të arrinim në konkluzionin se Balli Kombëtar e kishte konsumuar plotësisht krimin e tradhtisë kundër popullit dhe atdheut. Me të nuk mund të bisedohej më me gjuhë tjetër, veç asaj të pushkës.

Duke shpallur luftën frontale kundër Ballit Kombëtar, në shtyp, me propagandë dhe me armë, Komiteti Qendror i udhëzonte organizatat e Partisë, në terren dhe në ushtri, që edhe pas kësaj të bënë kujdes dhe të ishin prudentë ndaj atyre elementëve të cilët nuk i kishin lyer duart me gjak dhe tregoheshin në gjendje të kuptonin rrugën ku i kishin futur injoranca, influencat e së kaluarës, naiviteti politile. Asnjëherë nuk duhej të pushonin përpjekjet për të nxjerrë nga batakut i tradhtisë të gabuarit dhe të gënjerit. Në asnjë mënyrë të mos viheshin në një balancë Lumo Skëndot, Kolë Tromarët, Safet Butkat e kriminelët e tjerë të Ballit, me fshatarë të varfër, të vuajtur që u vinin pas të gënjer. Dhe në përgjithësi kjo politikë u ndoq dhe na dha rezultate; shumë nga këta elementë të gënjer e panë me kohë ku i shpinte mushka e Ballit dhe e tradhtarëve të tjerë, u shkëputën prej tyre dhe e shlyen gabimin edhe duke luftuar krahas popullit. Siç thashë, po të njëjtin qëndrim si ndaj Ballit kuisling, ne mbajtëm edhe ndaj simotrës së saj, ala kuislinge e ala angleze, Legalitetit. Por në drejtim të kësaj «partie», na kishte mbetur akoma diçka pa përfunduar: një ndër krerët e saj, Abaz Kupi, duhej të jepte llogari për tradhtinë që i kishte bërë Frontit, Këshillit të Përgjithshëm dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë.

I kërkua, pra, Abaz Kupit të vinte të jepte llogari për veprimet e tij, por Bazi dredhonte dhe, më në fund, nga mbarimi i muajit tetor, na vjen një letër «zyrtare» drejtuar Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, ku «Zogu i vogël» na lajmëronte me «seriozitet» se «asht formue partia zogiste, i së cilës jam pjesëtar, me qëllim me luftue okupatorin, sikurse kemi ba der më sot» (!). Më poshtë Bazi shprehte gatishmërinë e «partisë» për t'u marrë vesh e «për të bashkëpunue në mënyrë të sinqertë e të pastër» me Frontin Nacionalçlirimtar dhe kërkonte t'i caktonim datën e venditi e takimit.

- Bazi, - u thashë shokëve, me të marrë letrën e bajraktarit të Krujës, - do ta hedhë lumin pa u lagur; të mos dënohet për tradhtinë që po bën dhe për më tepër t'ia njohim edhe «meritat patriotike» e të bisedojmë me të si palë të barabarta!

- Të vijë të japë llogari në Kryesi dhe në Shtab, - tha Spiro Moisiu. - Atje do të shohim se kur na paska luftuar Bazi kundër pushtuesit.

E rrahëm gjerë këtë problem dhe, më në fund, duke përmbledhur mendimin e përbashkët, konkludova:

- T'i themi Abaz Kupit të mos na shesë mendje e të kërkojë bisedime me Frontin. Të vijë të takohet me Kryesinë e Këshillit të Përgjithshëm e të japë llogari për këto që bën, ndryshe, t'i themi, do ta godasim pa mëshirë.

Ndërkohë që ne pritnim të takoheshim me Bazin e Canës, ai merrte sigurime nga Gestapoja dhe Vermahti, nga Mehdi Frashëri, nga Devisi dhe Maklini, forconte fijet me krerët e Ballit Kombëtar dhe organizonte edhe «kongresin e partisë zogiste», ku na merrte «vendime» për të ardhmen në Shqipëri. Pas insistimit tonë të ashpër, Bazi premtoi se do të vinte në Orenjë, më 25 nëntor. E pritëm në datën e caktuar, por Abaz Kupi nuk u duk. Pasi s'erdhi në datën që kishim caktuar dhe si i dërguam një ultimatum, ku e paralajmëronim se do ta sulmonim si një armik e tradhtar, Bazi u tremb dhe pranoi që më 7 dhjetor, në Shëngjergj, të paraqitej në Kryesinë e Këshillit të Përgjithshëm.

Kur arrita në Shëngjergj gjeta atje Ymerin e Sejfullain, të cilët kishin shkuar që në mbrëmjen e 6 dhjetorit dhe, siç më thanë, qenë takuar me Bazin dhe kishin rënë dakord që mbledhja të bëhej të nesërmen.

- Dakord, - u thashë, - ne për këtë kemi ardhur. I thoni Bazit se ne jemi gati dhe presim që ai të vijë të na japë shpjegime për veprimet e tij.

Dërguam një nga shokët që kishim me vete në shtëpinë ku qe strehuar Abaz Kupi dhe po pritnim. S'kaloi shumë dhe i dërguari ynë u kthye:

- Ç'tha Bazi? - e pyeta. - Kur do të vijë?

- Nuk pranon të vijë në mbledhjen e Kryesisë, - m'u përgjigj. - «Unë kam dhënë dorëheqjen nga Këshilli, më tha Bazi, prandaj jam dakord që të bisedoj me Nacionalçlirimtaren si delegat i partisë zogiste».

E kuptova ku e kishte hallin bajraktari dinak. Ai kërkonte që edhe përgjegjësia për shkeljen e betimit t'i shpëtonte, edhe të siguronte njohjen e «partisë» së tij nga Fronti Nacionalçlirimtar.

- Në mos dashtë, - u thashë shokëve, - të mos vijë në Kryesi, po llogari do të na japë se s'bën dhe mendimin tonë do t'ia themi në sy. Gjithashtu do ta paralajmërojmë që të rrijë urtë dhe të mos lozë bishtin me gjermanët e me Mehdi Frashërin, të lërë dashuriçkat me Ballin, se ndryshe do ta futim në një thes me të. Sa për dorëheqjen e tij, ia japim përgjigjen duke e përjashtuar nga Këshilli i Përgjithshëm dhe këtë vendim ta bëjmë publik, që populli t'i vërë damkën e tradhtarit. Kurse për njohjen e Legalitetit nga ana e Frontit t'i themi që s'ka për ta arritur ndonjëherë dhe t'i theksojmë se çdo parti jashtë Frontit do të goditet si tradhtarë dhe vegël e pushtuesit.

Ramë dakord dhe vendosëm që unë, Dishnica dhe Fetah Ekmekçiu të takoheshim me Abaz Kupin. Ky takim u bë në një shtëpi të Shëngjergjit, ishte një shtëpi dykatëshe, me sa më kujtohet, dhe kur arritëm ne atje, Bazi kishte vajtur më parë, kurse «trimat» e tij e kishin rr ethuar shtëpinë dhe na shikonin me kërcënim.

- Kërkon të na trembë Bazi, - u thashë shokëve dhe vazhduam rrugën pa u hedhur sytë rojave. U ngjitëm shkallëve të gjithë së toku, ne të tre u futëm në dhomën ku priste Abazi, kurse dy-tre shoqëruesit tanë partizanë qëndruan jashtë.

E kam përshkruar zhvillimin e bisedimeve në librin «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë»* *(Shih: Enver Hoxha. «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë (Kujtime)», f. 238.) dhe nuk do të zgjatem, aty kam folur për tezat absurde të Bazit se ai paskësh filluar luftën i pari, se paskësh çliruar Krujën, pretendimin e tij megaloman që të gjitha partitë (lexo: Fronti Nacionalçlirimtar) të shkriheshin në «partinë e naltmadhnisë së tij» etj., etj. Pasi në fund i dhamë paralajmërimin që po të guxonte të vepronte kundër forcave tona do të asgjësohej ai bashkë me larot e tij, u tremb ky farë burri dhe iku

duke thënë se «unë nuk ngas njeri, po nuk më ngau». U kthyem në shtëpinë e Ali Shtëpanit ku kishim qëndruar në Shëngjergj dhe aty bëmë mbledhjen e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm dhe e përjashtuam Abaz Kupin. Kështu u ndamë përfundimisht me Bazin e Canës dhe fati i tij dhe i shokëve të tij ishte ai i gjithë tradhtarëve: u ingranuan plotësisht në repartet e pushtuesit nazist për të gjetur e për të siguruar përmes tyre (pa lënë mënjanë tratativat me anglezët), mbështetjen gjatë luftës dhe pushtetin mbas luftës.

Natyrisht për periudhën e luftës ky bashkim nën armë i reaksionit me pushtuesit e huaj neve do të na i shtonte vështirësitë dhe gjakun e shokëve, por po ky akt do të na i lehtësonte disi punët në të ardhmen, kur të çlironim Shqipërinë: diferencimi midis popullit dhe reaksionit, midis klasave të shtypura e atyre shtypëse kishte arritur majën më të lartë. Llogaritë me shfrytëzuesit do t'i lanim, siç i lamë, më lehtë. Bile llogaritë nisën të lahen me rrënjë që nga këto momente: një pjesë e reaksionit u vra në përpjekjet me forcat tona, të tjerë ua mbathën këmbëve para e në prag të Çlirimit së bashku me gjermanët, të tjerë u zunë nga forcat tona dhe, për krimet e bëra, u dënuan nga gjyqet e popullit. Vetë Abazi iu përmbajt parimit të «këmbëve të lehta», mundi të ikte me ndihmën e anglezëve për t'u ngalatur me «yllin e ndritur» të kombit në mërgim.

Ne, pasi mbaruam punë në Shëngjergj, u kthyem në Çermenikë, ku na zuri dhe fillimi i ofensivës gjermane të dimrit 1943-1944. Pas kaq e kaq vështirësish e provash që kishim kapërcyer me sukses, tash populli, Partia Komuniste, Lëvizja jonë Nacionalçlirimtare, Fronti e këshillat u ndodhën përballë një prove tjetër, nga më të rëndat, më të vështirat, më të rrezikshmet. Por edhe këtë provë të madhe e të përgjithshme ne do ta kalonim me guxim, trimëri e qëndrësë të pashoqe. Se si vepruam e si dolëm nga ai dimër i rëndë, kur kundër nesh u derdh edhe egërsia naziste, balliste e zogiste; edhe egërsia e motit, edhe dhëlpëria e aleatëve anglezë, historia e ka thënë fjalën e vet, unë vetë disa herë kam shkruar për ato ditë e net të paharruara.

Këtu dua vetëm të rikujtoj edhe një herë kujdesin që bëmë në fillim të kësaj ofensive, midis shumë e shumë të tjerave, edhe për sigurimin e «pleqve», siç u thoshim Omerit, Kosta Boshnjakut e të tjerë, mbasi ishin më të moshuar. Kur pamë se ata nuk mund të na ndiqnin dot në shtigjet e vështira të rrethimit e të dimrit të egër, dërgova dy shokë për të çuar shtresa e mbulesa dhe një sobë te guva e Gurit të Muzhaqit dhe vendosëm të strehonim atje Omerin, Sejfullain dhe Kostë Boshnjakun, sa të kalonte vala e sulmit gjerman. Unë kisha qenë disa herë te Guri i Muzhaqit, guva e të cilit ishte si një dhomë. Në dimër kokojka e tij mbulohej me borë, rrugët të gjitha ziheshin, pastaj rrugë andej nuk kalonte, kështu që u morën të gjitha masat, u depozituan ushqime dhe u caktuan dy partizanë që do të rrinin me ta. Bisedova me Omer Nishanin dhe i shpreha mendimin tonë se do të ishte më mirë që në këto situata të luftës dhe të dimrit ata të vendoseshin te kjo guvë.

- Natyrisht, - u thashë, - nuk do të jeni si te shtëpia e mikut tonë, Ali Shtëpanit në Shëngjergj, por sa të kalojë vala e goditjeve të armikut, ju do të jeni më të sigurt. Është e pamundur të na ndiqni né këtë borë të madhe nëpër pyje dhe né qarrishte, e ca më tepër, né gjithë zonën të mbushur me gjermanë e me ballistët e Azis Biçakut.

- Po mirë, le të bëhet si të vendosni ju, - tha doktori.

I shoqërova një copë rrugë nëpër borë dhe pastaj u përqaftuam me njëri-tjetrin. Ata morën rrugën né drejtim të Gurit të Muzhaqit dhe ne, Shtabi i Përgjithshëm, filluam odisenë tonë.

Me Omer Nishanin si dhe me një pjesë të mirë të udhëheqjes së Partisë, të Frontit e të ushtrisë, do të takoheshim përsëri né pranverën e vitit 1944, kur populli dhe ushtria e tij, nën udhëheqjen e Partisë, e kishin kaluar plotësisht provën e fortë e të madhe. Vështirësitë e betejat na kishin ~alitur më tej, kishte ardhur momenti që të dërrmonim përfundimisht pushtuesit e tradhtarët, kishte ardhur momenti kur né qytetin e vogël, heroik dhe të paharruar të Përmetit, do të mbanim Kongresin Antifashist Nacionalçlirimtar të popullit shqiptar, vendimet e të cilit do të hapnin një faqe të re, një epokë të re né historinë shekullore të Shqipërisë.

IV

THEMELET E SHTETIT TË RI

Shpresat që armiqtë mbështetën tek ofensiva e dimrit 1943-1944, për të shkatërruar Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe për të asgjësuar udhëheqjen e saj, «deri kur të çelte gjethi i ri», u thyen përballë qëndresës heroike të popullit dhe të ushtrisë sonë. Fronti, ushtria, këshillat nacionalçlirimtarë në luftë të vështi

rë, në situata të rënda, jo vetëm kishin ruajtur ekzistencën, po qenë kalitur politikisht e ushtarakisht, kishin rritur radhët e tyre, kishin grumbulluar përvojë të çmuar.

Humbje e dëme gjatë kësaj prove të rëndë e të vështirë patëm: ranë në beteja e përlëshje të përgjakshme kundër naziballistëve, dimrit e urisë shoqe e shokë trima, na u vranë këshilltarë e aktivistë të njohur të Frontit e të Ushillave nacionalçlirimtarë, u organizuan në qytete masakra të egra si ajo e 4 shkurtit 1944 në Tiranë, por të gjitha këto, kurrsesi nuk dëshmonin për dobësimin, e ca më pak, për disfatën që synonin të na shkaktonin pushtuesit e huaj dhe reaksioni. Përkundrazi populli, komunistët, forcat partizane e kthyen dhimbjen për shokët e rënë në burim force, qëndrese e mobilizimi më të madh dhe iu përgjigjën egërsisë së armikut, me zgjerim e shtrëngim të mëtejshëm të radhëve tona. Ushtria jonë Nacionalçlirimtare, në radhët e së cilës tashmë bënin pjesë disa brigada sulmuese, dhjetëra batalione e çeta të rregullta partizane si dhe dhjetëra çeta e njësi me forca vullnetare anembanë Shqipërisë, e përballoi mësymjen e përgjithshme armike të dimrit me heroizëm të pashoq.

Bile tamam kur mësymja e përgjithshme e armikut ishte në kulmin e vet, kur ngado nazistët dhe reaksioni ballist e legalist trumbetonin zhdukjen e Lëvizjes sonë Nacionalçlirimtare, formacioneve të mëparshme luftarake të ushtrisë sonë u shtoheshin edhe tri njësi të tjera të mëdha, brigadat V, VI e VII sulmuese, të formuara në muajt e parë të vitit 1944, si dhe shumë batalione e çeta të tjera. U provua përfundimisht se Lëvizja Nacionalçlirimtare ishte e pamposhtur dhe e pathyeshme. Mbi të gjitha gjatë kësaj periudhe ishte rritur e kalitur më tej Partia jonë Komuniste, shtabi udhëheqës i luftës dhe i revolucionit. Ajo kishte funksionuar, kishte drejtuar e organizuar, kishte luftuar e udhëhequr me heroizëm, me pjekuri, me trimëri.

Kështu, pranvera e vitit të fundit të luftës, na gjente më të fortë. Do të kalonte fare pak kohë dhe më 5 prill Shtabi i Përgjithshëm do të lëshonte urdhrin e ditës për kalimin në mësymje të njëjste partizane, duke u djegur kartat në duar gjermanëve e reaksionit që kishin planifikuar një mësymje tjetër gjatë muajit prill.

Në të vërtetë kishte ardhur pasti të hidheshim në një «mësymje» më të përgjithshme e më të madhe në të gjitha drejtimet e fushat.

1. Në prag të ngjarjeve historike

Menjëherë pasi dolëm nga rrethimi i dimrit, preokupimi më i madh i çastit ishte të instaloheshim në një bazë të sigurt, të vendosnim lidhjet me organizatat e Partisë, me pushtetin në bazë, me repartet e ushtrisë kudo ku ishin dhe të intensifikonim punën. Fillimisht qëndruam pak kohë në Panarit, një fshat i madh i Korçës, në kufi me Skraparin, i lidhur me Partinë dhe me Luftën Nacionalçlirimtare. Në Panarit në atë kohë funksiononte kursi i Partisë, e para shkollë partie jona, ku quadro të Partisë e të Luftës Nacionalçlirimtare përgatiteshin ideologjikisht e politikisht, studionin .literaturë marksiste-leniniste, njiheshin me parimet dhe me normat e ndërtimit, të organizimit e të funksionimit të partisë së klasës punëtore të tipit leninist, siç ishte edhe Partia jonë. Qëndruam disa ditë në këtë fshat, u çlodhëm, u njohëm në .vija të përgjithshme me ç'kishte ndodhur gjatë rrethimit tonë, me veprimtarinë e shokëve, u takuam e biseduam edhe me kursantët e .pedagogët» e kursit të Partisë etj. Në Panarit kishim të gjitha kushtet për punë dhe fillimisht rënduam të qëndronim aty,

por, siç thashë, ky ishte një fshat i madh, të cilin e lakmonin shumë si gjermanët, ashtu edhe «trimat» e Ballit Kombëtar. Veç kësaj, pozita gjeografike e bënte Panaritin një objektiv që mund të kapej lehtë, bile në mënyrë të papritur nga armiku. Dhe këtu nuk ishte fjala vetëm për rrezikun që do t'u kërcënohej shokëve të udhëheqjes së Partisë, të Frontit e të Shtabit (që edhe kjo kishte rëndësi të madhe), por edhe se në duart e armikut mund të binin dokumente me rëndësi e sekrete. Ramë, pra, dakord që të mos rrinim në Panarit dhe menduam të kalonim në Skrapar, në fshatin Backë që ndahej nga Panariti vetëm nga Qafa e Martës.

Edhe Backa që një fshat i madh e i bukur, vendosur në luginën e një përroi, me njerëz të dëgjuar për trimëri, për mikpritje e për krenarinë e tyre. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare Backa që e tëra me Partinë dhe besoj se s'gaboj po të them se Balli Kombëtar nuk gjeti vend në Backë. Ky fshat, veç të tjerash, që vendlindja e Riza Kodhelit, shokut tonë të armëve, luftëtarit të guximshëm, birit besnik të Partisë dhe të popullit. Xha Rizai, siç e thërritnim ngaqë ishte i moshuar, kishte filluar të luftonte kundër të huajve që në fillim të shekullit dhe, kur Partia ngriti popullin në luftë për çlirim, ai u bashkua me Partinë dhe me popullin e u bë një nga komandantët trima të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Por, pasi arritëm në Backë dhe dolëm të bënim një shëtitje, diku tej shikoj një grumbull shtëpish të vendosura në një pllajë në faqen e një kodre karshi.

- Ç'fshat është ai atje? - pyes shokët që ishin me mua.
- Është Helmësi, - më përgjigjet një banor riga Backa.
- Është larg që këtej? - pyeta prapë.
- Ndonjë gjysmë ore më këmbë, - që përgjigjja.

Më pëlqeu pozicioni ku që vendosur Helmësi edhe nga fakti që ishte një fshat i vogël, i veçuar, ku prania jonë nuk do të binte në sy. Ua thashë edhe të tjerëve këto mendime dhe dërguam shokë të shikonin konkretisht gjendjen, mundësinë e strehimit etj. Shokët u kthyen të kënaqur nga «inspektimi» dhe na treguan se banorët ishin shprehur të gatshëm të na mbanin e të na strehonin sa të donim, «deri në çlirimin e vendit», siç ishin shprehur.

Kështu qysh të nesërmen u vendosëm në Helmës, një fshat i vogël me 10-12 shtëpi e me plot bahçe me mollë dhe këtu, mes mollëve, hapëm edhe çadrat ku u strehuan një pjesë e shokëve, rojat partizane etj., kurse ne u vendosëm në dy shtëpi dykatëshe, në të vërtetë të tilla në këtë fshat. Ndërkohë vendosëm lidhje me korrierë e me radio me terrenin dhe me ushtrinë dhe puna filloi përsëri me intensitet, ashtu siç e kërkonte situata që po zhvillohej e ndryshonte dita-ditës.

Në radhë të parë, gradualisht, shokët u njohën më mirë e më thellë me gjendjen dhe punën e bërë nga Partia, organet e Frontit Nacionalçlirimtar gjatë dimrit të kaluar, me bilancin e luftimeve të njësisive të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, me gjendjen aktuale të forcave të saj, të armatimit, të kuadrit etj., etj. Gjithashtu informacionet e raportet që na erdhën nga shokët në terren, na vunë edhe më mirë në korent për situatën politike brenda vendit dhe mbi bazën e gjithë këtyre krijuam një vizion pak a shumë më të plotë edhe për situatën e këshillave nacionalçlirimtarë. Ndonëse ata kishin qëndruar e kishin zhvilluar një veprimtari të dendur, prapëseprapë dallga e reuksionit që goditi mbi ta kishte pasur edhe pasojat e vieta, kishte pasur edhe elementë që qenë lëkundur e thyer, kishte pasur edhe raste kur në fshatra të ndrvshine ata nuk kishin funksionuar. Një ndër masat, e para që u morën në këtë drejtim që vendimi i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm për zhvillimin e zgjedhjeve të reja të këshillave nacionalçlirimtarë.

Ky vendim ishte i domosdoshëm sepse kishte kaluar një periudhë kohe relativisht e gjatë, me ngjarje e situata të vështira, ku ishin vënë në provë për të justifikuar besimin e popullit, të gjithë ata elementë që kishin qenë zgjedhur në këshilla. Por zgjedhjet e reja nuk do të ishin në asnjë mënyrë një ndryshim komplet i përbërjes së mëparshme të këshillave nacionalçlirimtari;. Populli do të vendoste nëse ky apo ai anëtar i vjetër i këshillit e kishte justifikuar besimin e tij. Në organet e luftës dhe të pushtetit të ri demokratik nuk do të kishin vend tradhtarët, frikacakët e oportunistët.

Gjithashtu u udhëzuan këshillat nacionalçlirimtarë në qarqe që të procedonin me organizimin e konferencave nacionalçlirimtare në qarqe dhe në qytete, atje ku këto nuk ishin bërë pas Konferencës së Labinotit. Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm i kushtonte një kujdes të veçantë këtyre

konferencave, të cilat do të ishin shlcolla për të gjithë delegatët nga fshatra, krahina e qytete të Shqipërisë.

Në gjithë këtë periudhë, pra, organet udhëheqëse të Partisë e të Frontit Nacionalçlirimtar po bënin një ekzaminim të saktë të situatave dhe, mbi bazën e analizave, po përcaktonin e do të konkretizonin më miri masa ! që duheshin marrë në planin politik, organizativ e ushtarak.

Mbi të gjitha ishte e domosdoshme që, krahas forcimit të sulmit mbi hordhitë naziste e bashkëpunëtorët e tyre, të bënim gjithçka duhej që të arrinim në çlirimin e vendit sa më të përgatitur politikisht. Kjo do të thoshte që fitoret e mëdha të arritura t'i konkretizonim e t'i sanksiononim në ligje e në forma të aprovuara nga populli. Kishte ardhur momenti që të konkretizohej parulla e Luftës sonë Nacionalçlirimtare «për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore». Vendime të tilla, që, natyrisht, do t'i diskutonte e do t'i përcaktonte udhëheqja e PKSH dhe Këshilli i Përgjithshëm Antifashist, përfundimisht mund t'i merrte e t'i sanksiononte vetëm një mbledhje e gjerë, një kuvend i madh kombëtar i përfaqësuesve të popullit shqiptar që do të shprehte aspiratat dhe dëshirat e popullit. Kështu lindi nevoja për përgatitjen dhe zhvillimin e Kongresit të Parë Antifashist të Përmetit.

Ky do të ishte një kongres kushtetues që do të ligjësonte pushtetin e këshillave nacionalçlirimtarë, si i vetmi pushtet në Shqipëri dhe, mbi këtë bazë politike, do të hidhte themelet e shtetit të ri demokratik, do të zgjidhte organet legjislativë e ekzekutive në bazë të vullnetit të popullit. Në këtë mënyrë do t'u pritej udha manovrave të reaksionit, brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe përpjekjeve të imperialistëve anglo-amerikanë për t'i imponuar popullit një regjim sipas dëshirave të tyre dhe një «qeveri» që eventualisht mund të krijonin Vota brenda vendit apo jashtë tij.

I denë për mbajtjen e Kongresit të Parë Antifashist, pasi e diskutuam dhe e shoshitëm në Byronë Politike, vendosëm t'ia paraqitnim Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, në një mbledhje të organizuar më 15 prill 1944 në Helmës, në një odë të shtëpisë së Mehmet Myslimit, që shërbeu në ata muaj si seli e organeve drejtuese të Partisë e të luftës dhe ku ishin vendosur edhe Ymer Dishnica, doktor Nishani e të tjerë. Unë bashkë me shokë të tjerë kisha zënë vend në shtëpinë e Novruz Bilimanit. Ruaj kujtime të mira për njerëzit e këtyre dy shtëpive që na rrinin në këmbë, si i thonë, të gatshëm për çdo gjë, sidomos për Nurihanin që kujdesej për ne, na bënte bukë e gjellë, e dashur e me fjalë të ëmbla në gojë. Në këtë mbledhje të Kryesisë kishin ardhur pothuajse të gjithë shokët. Mungonin Myslim Peza e Mustafa Xhani, që nuk mund të largoheshin nga fronti i luftës, Nako Spiru e Ollga Plumbi, që ndodheshin në Tiranë ngaqë ishte e vështirë të lëvizje, si dhe Fetah Ekmekçiu, për fatin e të cilit nuk dinim gjë të sigurt. Në emër të udhëheqjes së PKSH e mora fjalën unë për të parashtruar propozimin për thirrjen e Kongresit Antifashist Nacionalçlirimtar.

- Lëvizja jonë Nacionalçlirimtare, - u thashë në esencë shokëve, - është njohur sot në Shqipëri e në gjithë botën si e vetmja fuqi politike e ushtarake që përfaqëson interesat e lartë të kombit shqiptar. E kemi fituar këtë njohje me politikën tonë të drejtë, me luftën heroike të Partisë e të popullit tonë. Tash, në rrethanat e fazës së re, më të lartë, në të cilën ka hyrë Lufta jonë Nacionalçlirimtare, udhëheqja e PKSH ka arritur në konkluzionin se është e domosdoshme të kemi forma më të larta organizative në lëvizjen tonë dhe, më parë se çdo gjë tjetër, të kemi një asamble legjislativë dhe një qeveri provizore. Për t'i siguruar këto është e nevojshme të organizohet një kongres i përfaqësuesve të popullit shqiptar, të cilët do të vendosin lirisht për të ardhmen e atdheut, duke transmetuar dëshirën e popullit që i ka zgjedhur. Kongresi do të ketë brenda vendit një efekt të madh politik dhe vendimet e tij populli do t'i brohorasë, se për këto ka luftuar prej katër vjetësh. Gjithashtu, - nënvizova, - jehona e tij do të jetë e madhe edhe jashtë dhe do të influencojë në marrëdhëniet tona me aleatët. Kongresi do t'i japë vendit qeverinë e tij të ligjshme dhe me këtë do t'u jepet fund si manovrave të reaksionit të brendshëm, ashtu edhe punëve nën rrogoz të aleatëve.

Shokët e pritën me entuziazëm fjalën time dhe me diskutimet e tyre aprovuan njëzëri propozimin për thirrjen e Kongresit, si edhe procedurën e zgjedhjes së delegatëve.

Menjëherë pas kësaj filluan përgatitjet konkrete për Kongresin, i cili, siç do të flas më poshtë, u vendos të mbahej në qytetin e Përmetit. Të nesërmen, bashkë me Rezolucionin, këshillave nacionalçlirimtarë të çdo qarku iu dërgua një letër udhëzuese nga Kryesia e Këshillit të

Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, në të cilën tërhiqej vëmendja që delegatët të zgjidheshin nga radhët e militantëve e të luftëtarëve, përfaqësues të vërtetë të popullit, duke mos lejuar të futeshin kontrabandë armiqte e popullit etj.

Po atë ditë u dërguam një qarkore të posaçme komiteteve qarkore të PKSH, si dhe seksioneve politike të brigadave të UNÇSH lidhur me këtë ngjarje të madhe, ku theksohej rëndësia e këtij Kongresi dhe e vendimeve të tij që do të kishin reperkusione të thella, si brenda, ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Prandaj, në emër të Komitetit Qendror, shokët e Partisë të vinin të gjitha forcat e tyre që të sigurohej sukcesi i plotë i Kongresit Antifashist.

Ditët për të gjithë shokët ishin të zëna me punë nga mëngjesi në mbrëmje. Na duhej të merreshim me çështjet korente të Partisë e të pushtetit, të ndiqnim zhvillimin e situatës ushtarake, t'u përgjigjeshim letrave e informacioneve që na sillnin korrierët çdo ditë nga komitetet qarkore, nga këshillat, nga brigadat e batalionet etj. Plus këtyre punëve të përhershme, një mori çështjesh që duheshin zgjidhur e punësh që duheshin bërë na dënim përpara për përgatitjen e Kongresit Antifashist. Të gjitha këto kërkonin kohë dhe tension mendor e fizik, po atëherë qemë të rinj në moshë, mund të rrinim ditë të tëra duke punuar, bile, harronim edhe të hanim. Po kryesorja ishte se punonim me zemër të lehtë e me shpirt të gëzuar, se shihnim që puna dhe lufta jonë nuk kishin shkuar kot, se ishim të bindur që punonim për një të ardhme të lumtur të atdheut, të popullit.

Ç'është e vërteta, edhe shokë të tjerë, si: Omeri, Medari, Baca përpiqeshin të më lehtësonin dhe kishin marrë përsipër çështjet organizative, si të thuash, «teknike», që po hapnin edhe ato plot telashe.

Ndërkohë përcaktuam në parim se kë mund të thërritnim në Kongres si të ftuar dhe përgatitëm ftesat. Doktor Nishani, si i thonë, kishte përveshur mëngët dhe qe tepër serioz e i preokupuar në punë. Ai merrej personalisht me përgatitjen e ftesave, të «biletave», siç u thoshim atëherë mandateve të delegatëve, të cilat i firmoste në emër të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, verifikonte listat, emrat e plot e plot hollësira të tjera, të cilave Omer Nishani u kushtonte kujdesin e nevojshëm. Po kaq korrekt e skrupuloz ishte edhe doktor Medar Shtylla. Që të dy kishin një edukatë të mrekullueshme pune: atë që e zinin e bënë pastër.

Ndër ftesat e para që dërguam në emër të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar qe ajo që iu dërgua Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, vëllezërve tanë me të cilët, veç idealeve të luftës së përbashkët, na lidhte edhe gjuha, gjaku e kombi. Në ftesën e firmosur nga Omer Nishani u shkruanim vëllezërve kosovarë për vendimin me rëndësi të madhe historike që kishim marrë, për thirrjen e një Kongresi

Kombëtar Antifashist, i cili do të shënonte një etapë të re në luftën tonë dhe shprehnim dëshirën që një delegacion i Këshillit dhe i Shtabit kryesor të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit të vinte në këtë Kongres. «Ardhja e këtij delegacioni, - u shkruanim vëllezërve tanë, - do të jetë shenja më e gjallë për Kongresin tonë se si piqen vëllezërit dhe traditat tona të luftës për liri»* *(Kopja e këtij dëkumentj ruhet në AQP.)

Pritëm deri ditën që do të niste Kongresi përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, shpresuam se mund të vinin edhe gjatë ditëve kur Kongresi vazhdonte punimet, por më kot. Nuk dimë si rrodhën ngjarjet, po as delegacioni, as përgjigje nuk na erdhi. Në atë kohë të lirë që kishim, kur mblidheshim për pak momente në dhomën ku rrija, apo ku hanim bukën së toku në një mensë të përbashkët, bisedonim për shumë probleme e midis tyre dhe për përgatitjen e Kongresit, për zhvillimin e zgjedhjeve të delegatëve nëpër qarqe e zona, për masat që ishin marrë për ardhjen e tyre etj. Në teknikën që kishim në Lavdar, porositëm të shkruheshin parulla, të përgatiteshin flamuj, të siguroheshin portrete të rilindësve tanë, të heronjve të luftës etj., e midis të gjitha këtyre, nuk harruam që të sigurohej edhe një fotograf.

Shkurt, po merreshin të gjitha masat që gjithçka të ecte si sahat. Ndërkohë bëmë përgatitjen e nevojshme dhe në mesin e majit 1944 thirrëm Plenumin e Komitetit Qendror të PKSH, i cili midis problemeve më kryesore, diskutoi e vendosi për çështje që do të shtroheshin në Kongresin e Përmetit, për vendimet që Partia do të propozonte të merreshin atje etj., duke e konsideruar këtë

ngjarje një moment kyç në rrugën për thellimin e fitoreve dhe për perspektivën e zhvillimit të revolucionit që udhëhiqte Partia.

Duke folur për këtë problem themelor, në raportin që i paraqita Plenumit, midis të tjerash, nënvizova:

- Zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare dhe proporcionet që ka marrë ajo, gjendja politike e jashtme dhe rrethanat e brendshme sot kërkojnë të marrim vendime me rëndësi dhe të mbledhim një Kongres për të zgjedhur Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar që të ketë atributet e një pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, nga ku do të dalë Komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore.

Duke argumentuar me hollësi arsytet pse duhej thirrur e rëndësinë që do të kishte ky Kongres u tërhoqa edhe një herë vëmendjen shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror, se duhej të ishim të gjithë të përgatitur përpara evenimenteve që do të vinin.

- Në situatat që do të krijohen, - theksova, do të na duhet të marrim qëndrime vendimtare. Prandaj ta kemi Partinë të fortë, kuadrot t'i kemi të shëndoshë, të përgatitur politikisht dhe ushtarakisht, të forcojmë e të kalitim unitetin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë rreth Partisë Komuniste.

Në mënyrë të veçantë nënvizova dy zhvillime eventuale ndaj të cilave ne duhej të ishim të përgatitur: një zbarkim aleat në Ballkan dhe një largim të shpejtë të forcave naziste nga Shqipëria.

- Detyra jonë është, - u thashë shokëve, - të bëjmë kujdes të madh dhe në asnjë mënyrë të mos lejojmë që aleatët të përzihen në çështjet tona të brendshme. Për këtë një rol me rëndësi do të luajnë vendimet e Kongresit të Përmetit, i cili do t'i japë popullit organet e pushtetit legjislativ e ekzekutiv, do të hedhë themelet e shtetit të ri shqiptar demokratik e popullor. Nga ana tjetër, - vazhdova, - është e nevojshme të zhduket mentaliteti që bie në sy në shumë shokë e partizanë se me shfarosjen e gjermanëve ne i kemi mbaruar gjithë punët dhe na duhet vetëm të lëmë armët e të kthehemi në shtëpi. T'ua bëjmë të qartë gjithë shokëve e partizanëve se armët nuk do t'i lëshojmë kurrë, jo vetëm kur këmbë armiku të mos mbetet në vendin tonë e populli shqiptar të ketë fituar liritë e plotë, por edhe më pas. Shteti i ri që po krijojmë duhet mbrojtur dhe atë do ta mbrojmë ne që po e krijojmë.

Garancia më e madhe për fitoren tonë është uniteti i Partisë. Kemi detyra karshi Partisë, tremi detyra karshi popullit, prandaj t'i përvishemi punës e t'i kryejmë këto detyra deri në një me vendosmëri, duke mos kursyer as jetën tonë.

Gjithë punimet e Plenumit, raporti që mbajta atje në emër të Byrosë së KQ të Partisë, si dhe diskutimet e pjekura e plot entuziazëm të shokëve tregonin se tashmë kishim hyrë në fazën vendimtare të luftës, në periudhën kur Partia dhe populli do të korrnin frytet e luftës disavjeçare. Çlirimi i atdheut që i afërt, horizonte të reja i hapeshin përpara revolucionit.

Ndërkohë, jo vetëm në Përmet, por në të gjithë vendin përgatitej Kongresi, bëheshin zgjedhjet e delegatëve, merreshin masat për dërgimin e tyre në vendin e duhur. Sipas vendimit të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm në Kongres do të përfaqësoheshin zonat e lira dhe ato që ishin akoma të pushtuara, batalionet dhe brigadat e ushtrisë, Bashkimi i Rinisë Antifashiste dhe Bashkimi i Gruas Shqiptare. Në krahinat e çliruara delegatët për në Kongres do të zgjidheshin demokratikisht me vota të hapura nga populli, kurse në zonat e pushtuara delegatët do të caktoheshin nga këshilli nacionalçlirimtar i qarkut. Në batalionet dhe në brigadal partizane delegatët do të zgjidheshin me votim të hapët në mbledhjen e përgjithshme të luftëtarëve.

Zgjedhjet e delegatëve për në Kongres, në zonat e lira u kthyen në ditë të vërteta feste. Në to merrnin pjesë burra, gra, të rifj, të cilëve sipas zonave të banimit, u takonte të zgjidhnin një numër të caktuar përfaqësuesish të tyre. Kështu mbarë populli i zonave të lira shprehte mendimin e tij për bijtë më të mirë që do të çonin në kuvëdin e madh vullnetin dhe dëshirën, ëndrrat dhe beamin për një të ardhme të lumtur. Kudo mbledhjet zhvilloheshin të zjarrta, të pjekura dhe në fund konkludonin te delegatë patriotë, të ndershëm që kishin luftuar tërë jetën për Shqipërinë, te kuadro të rinj, që i kishte pjekur mendimi dhe Lufta Nacionalçlirimtare. Por mbi të gjitha, si një fitore e re, e madhe, m'is delegatëve kishte edhe gra, të cilat do të çonin në Kongres fjalën e tyre, zjarrin e madh të dashurisë për atdheun, popullin, Partinë.

Në një atmosferë hrej tjetër, më të heshtur nga pamja e jashtme, por .ne të njëjtin entuziazëm shpirtëror, në qytetet dhe zonat e paçliruara, mblidheshin anëtarët e këshillave antifashistë të qarkut për të caktuar cilët do të ish.n delegatët që do t'i përfaqësonin në Kongres. Një nga një ata shkonin, duke vigjiluar, në shtëpitë ba2a të luftës dhe aty, pas debatesh të zjarra, ku mbi të gjitha shkëlqente dashuria dhe respekti për shokët e luftës, caktonin delegatët.

Kështu, zgjedhja e delegatëve u bë në kohë dhe sipas udhëzimeve që u ahanë. Por para delegatëve tanfi dilte një vështirësi e mjdhe, sidomos për ata të zonave të Veriut, të Tiranës, të Korçës etj., ku armiku, i cili ndoshta kishte nuhatur diçka mbi mbajtjen në Shqipërinë e Jugut të një Kuvendi të madh, kishte shtuar rojat e hafijet në postbllloqe e në rrugë dhe kishte ndaluar lëvizjen me automjete të njerëzve, pa qenë këto të shoqëruara nga gjermanë. Por asnjë pengesë nuk do t'i ndalte delegatët në rrugën drejt Kongresit. Nën hundën e gjermanëve dhe të spiunëve, duke kapërcyer lumenj e duke çarë në shtigje të reja, pjesa më e madhe e tyre do të mbërrinin në Kongres.

Qyteti ku do të zhvillohej Kongresi u mbajt në sekretin më të madhë në mënyrë që armiku të mos mund të organizonte një goditje masive kundër Përmetit. Vetëm një numër i kufizuar shokësh e dinin vendin ku do të zhvillohej ky eveniment historik. Për dërgimin e delegatëve në Përmet kishim caktuar njerëz që do t'i drejtonin dhe do t'i shoqëronin delegatët nëpër male, repart më repart. Delegatët e krahinave të Jugut do të vinin direkt në Përmet, kurse për Veriun kishim ngarkuar shokët e Tiranës t'i grumbullonin në Pezë dhe që andej t'i shoqëronin për në Jug.

Për të siguruar qetësinë gjatë punimeve të Kongresit kishim diskutuar me kohë dhe, në emër të Shtabit të Përgjithshëm, kisha urdhëruar një numër brigadash e repartesh të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të zinin pozitat strategjike, të bllokoni rrugët që çonin në Përmet me porosinë e prerë: këmbë armiku të mos kalojë në drejtim të qytetit. Kështu kur po afronte koha që do të niste punimet Kongresi, nga Tri Urat e gjer në Berat, Skrapar, Tepelenë, Zagori e Lunxhëri, Kolonjë e Vithkuq, sypafjetur, me armë në dorë zunë pozicionet e zjarrit partizanët e brigadave V, XII, VII e VIII sulmuese. Krahas tyre, në një shtrirje më të gjerë në mbrojtje të Përmetit historik do të vepronin brigada të tjera të ushtrisë sonë. Shokët e Shtabit të Përgjithshëm ishin të bindur se partizanët tanë heroikë do të kryenin me devotshmëri detyrën e lartë që u ishte ngarkuar dhe, me të vërtetë, ashtu ndodhi. Kongresi historik i Përmetit u zhvillua në qetësi të plotë.

Kur çdo gjë ishte gati, u nisëm drejt Përmetit. Koha ishte e mirë, ndihej kudo pranvera dhe dulce zbritur drejt luginës së Vjosës, shikoje në faqe malesh e kodrash shtëpi e kasolle të ngritura në rrëpira. Njerëzit luftonin edhe me gurët për të fituar një copë tokë. Toka e klima e përshtatshme i donte pemët e bimët, por regjimet antipopullore të së kaluarës si në tërë Shqipërinë s'kishin bërë asgjë të mirë për këtë vend e për këta njerëz. Bisedonim me shokët se ç'pasuri të mëdha ka vendi ynë, ç'popull të mrekullueshëm kemi, trim, bujar e punëtor, i cili e meritonte të ishte i lumtur.

Përmetin, pas Çlirimit, Partia e ndërtoi që nga themeli dhe e bëri një nga qytetet më të bukura të atdheut, por në majin e vitit 1944 ne e gjetëm të shkatërruar e të djegur. Tri herë me radhë armiku e kishte bërë shkrumb e hi këtë qytet të vogël buzë Vjosës, por, kur ne hymë atje, na emocionuan thellë pritja plot entuziazëm, thirrjet e brohoritjet e njerëzve. Populli i Përmetit ishte i gëzuar që kishte midis tij bijtë e vet, luftëtarët, delegatët, partizanët, të rinj e të reja, të cilët i jepnin qytetit një gjallëri që s'e kishte parë kurrë. Ngjarja e madhe që po zhvillohej, vetë historia e bëri ato ditë Përmetin kryeqytetin e Shqipërisë së re që po lindte në luftë.

Fakti që Kongresi I Antifashist i popullit shqiptar do të bëhej në Përmet e jo në një vend tjetër nuk ishte rastësi. Kishim vendosur për këtë që në Helmës. Mund të mblidheshim edhe në vende të tjera, por ne zgjodhëm Përmetin për dy arsye kryesore: e para, për t'i treguar popullit se Partia dhe Ushtria Nacionalçlirimtare ishin në kulmin e fitores, se lufta jonë tashmë kishte kaluar në fazën e çlirimit të qyteteve, se fitorja ishte e afërt dhe ne mund të bënim një kongres të tillë të madh dhe me rëndësi historike jo vetëm në mal, por edhe në qytet. Veç kësaj, propozova Përmetin se ai përmblihte Dangëllinë, Frashërin, ku lindën burrat nga më të shquarit e më të lavdishmit e Rilindjes sonë Kombëtare. Partia i nderonte patriotët e mëdhenj që lindën në tokën e Përmetit, Naimin, Samiun dhe Abdylin, poetin, filozofin dhe politikanin e madh. Për ne ishin të njohura vjershat e Naimit, libri i Samiut «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë», përpjekjet e Abdylit për independencën dhe

tërësinë tokësore të Shqipërisë. Duke nderuar këta rilindës të shquar, luftëtarë të penës dhe të pushkës, ne i tregonim edhe një herë popullit, se bijtë e denjë të tij ishin partizanët, komunistët dhe jo tradhtarët, siç ishin Lumo Skëndoja, Mehdi Frashëri, qofshin këta edhe prej derës së Frashërllinjve. I tregonim popullit se Partia i (;monte dhe i nderonte traditat patriotike dhe patriotët dhe se trashëgimtarët e tyre ishin populli dhe komunistët e jo tradhtarët dhe të shiturit tek i huaji.

Që kur Partia nisi luftën në krye të popullit, ajo u mbështet në këto tradita të shquara të luftës dhe të heroizmit. Lufta Nacional(lirimtare nuk ishte për ne një hallkë e shkëputur në zinxhirin e betejave që kishte bërë populli ynë për të mbrojtur atdheun, për të siguruar ekzistencën e vet si komb, me gjuhën, kulturën e të gjitha tiparet e veta kombëtare. Ajo ishte vazhdim i tyre, po në një kohë tjetër dhe me një përmbajtje më të lartë. Heronjtë e luftërave të mëparshme në komunistët, sikurse edhe i gjithë populli, i nderonim dhe e propagandonim veprën e tyre. Kishte edhe ndonjë që nuk ishte dakord me këtë veprim të drejtë të Partisë, po ne këto pikëpamje i goditnim si të dëmshme e të gabuara.

- Ç'na duhen neve Skënderbeu e Naim Frashëri! Feudalë kanë qenë ata! - thoshte Kòçi Xoxe, «ndërgjegjja proletare» e Partisë, i cili, siç do të vërtetohej me vonë, me politikën e tij të egër, sektare e trockiste ishte për shkatërrimin e Frontit.

- Ata, - i thosha unë, - kanë qenë luftëtarë të mëdhenj të Shqipërisë. Emri dhe vepra e tyre do të mbeten në shekuj të shekujve në kujtesën popullore. Ne komunistët jemi vazhdues të veprës së tyre në kohë të reja.

Sikurse Rilindja jonë Kombëtare evokoi emrin e madh të Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe e bëri simbol të qëndresës e të luftës për Tiri, edhe Partia jonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare evokoi jo vetëm Heroin tonë Kombëtar, por edhe patriotë e burra të tjerë të dëgjuar, si: vëllezërit Frashëri, Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Bajram Currin, Avni Rustemin e të tjerë dhe i vuri heroizmin e veprën e tyre në pedestal.

Po le të kthehemi te Përmeti i atyre ditëve të paharruara, le të rikujtojmë Kongresin historik, i cili hapi një epokë të re në historinë e Shqipërisë, epokën e socializmit.

2. Kongresi historik i Përmetit

Gjithmonë e kujtoj me mall Përmetin e majit 1944 me pamjen e tij festive, sallën e Kongresit të zbuluar, mensën e pastër me tavolina të gjata, shokët që u kërcitnin tytat e armëve kur takoheshin me njëri-tjetrin. Të gjitha këto sfidonin gërmadhat e shkaktuara nga lufta dhe ishin një gëzim i madh që na mbushte zemrat. I shoh shokët, ashtu të rinj, siç kanë qenë atëherë, të gjallë, të qeshur, entuziastë, kujtoj Hysni Kapon, shtyllë e çeliktë e Partisë dhe e Luftës Nacionalçlirimtare, babë Myslimin, luftëtarin trim, të mençur e besnik, Gogo Nushin, fjalëpakë e punëshumë. Kujtoj bashkëluftëtarët e bashkëpunëtorët e tjerë të viteve të luftës: Spiro Moisiun, Medar Shtyllën, doktor Nishanin, Esat Dishnicën, Musa Ohrin, Hasan Pulon e shumë e shumë të tjerë që dhanë kontributin e tyre në rrugën e ndritur, ku na udhëhiqte Partia.

Kur kujtoj Përmetin e ditëve heroike, bëhem shumë më i ri se ç'jam sot që po shkruaj këto radhë. Është e natyrshme që kujtesa nuk është aq e freskët, sa të vijnë në mend të gjitha gjërat një për një, por ai Hfluid» i mrekullueshëm i atyre kohëve heroike por të vështira, ai entuziazëm i madh i ditëve të paharruara të Kongresit, ai zjarr që vlonte në zemrat tona, edhe tanfi, me po atë forcë më vlon e më përshkon gjithë trupin dhe e ndiej se jam akoma i ri.

Mbrëmjen dhe natën e 23 majit e kaluam në një atmosferë të gëzueshme. Zienin kënga dhe vallja, bisedat e përzemërta, skeçet luftarake që do të vazhdonin gjatë gjithë ditëve të zhvillimit të Kongresit e që i shfaqnin partizanët në skena të improvizuara mbi gërmadhat. Bile në Përmet ato ditë u zhvillua edhe java. e artit revolucionar. Këtu, nga aktorët më të mirë partizanë, u krijua grupi teatral dhe fillon edhe historia e teatrit tonë të realizmit socialist.

Darka për delegatët ishte shtruar në një ish-kazermë të armikut, pastruar e rregulluar më së miri, me tryeza të gjata, pjata e gota për secilin. Kishte në ndonjë rast edhe ndonjë kupë raki e ca meze të thjeshta. Çdo drekë kishim nga dy gjellë, bile disa herë provuam edhe hallvë!

Dhe ja, të nesërmen më 24 maj 1944 delegatët e të ftuarit, mes entuziazmit të popullit e të partizanëve, u drejtuan për në sallën historike ku do të zhvillonte punimet Kongresi. Në orën dhjetë hymë në sallë, ne shokët e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar dhe të Shtabit të Përgjithshëm. Delegatë e të ftuar, pleq e të rinj, partizanë e komandantë, gra, klerikë, patriotë, na pritën me duartrokitje e për minuta të tëra, në këmbë, brohoritnim sé bashku.

Salla ishte e porsalyer me gëlqere. Një flamur i madh i Shqipërisë mbulonte murin përballë, kurse anash tij ishin vendosur portretet e Skënderbeut e të Ismail Qemalit. Një metër mbi tokë, rreth sallës, ishte vendosur, një zinxhir i ndërprerë nga parulla: Vdekje fashizmit - Liri popullit.

Kongresin e hapëm me një minutë heshtje për të rënë në luftë dhe, pas këtij nderimi solemn për ata që kishin dhënë gjakun, rininë, dhe jetën për lirinë e atdheut, Omer Nishani mbajti fjalën e hyrjes. Duke bërë një përmbledhje të shkurtër të përpjekjeve lirishtetërore të popullit tonë, ai evokoi lëvizjet e popullit shqiptar për të mbrojtur tokën arbërore, theksoi padrejtësitë që i ishin bërë vendit tonë nga traktatet imperialiste, foli për luftën e popullit për mbrojtjen e trojeve shqiptare në Veri e në Jug, përmendi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Në fjalën e tij doktor Omer Nishani nënvizoi faktin se gjithnjë në momente kyç të historisë së vet populli kishte dërguar në kuvende kombiAare bijtë më të mirë, që të bisedonin e të vendosnin për fatin e atdheut. Kështu kishte ndodhur në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kështu edhe në Kongresin e Lushnjës më 1920, i cili mori vendime për ruajtjen dhe për forcimin e pavarësisë së Shqipërisë.

- Kështu ndodhi e po ndodh, - theksoi doktor Nishani, - edhe në këto vitet e fundit, kur atdheun tonë e sulmuan dhe e kërcënuan armiq e rreziqe nga më të mëdhatë. Përfaqësuesit e popullit u mblodhën në Pezë për ta vënë luftën në baza të shëndosha, u mblodhën më pas në Labinot për të centralizuar autoritetin e pushtetin që kishim fituar me luftë dhe sot jemi mbledhur këtu në Përmet, për të diskutuar e për të marrë vendime nga më të rëndësishmet e nga më historiket. Se si e qysh tremi arritur në këtë ditë të madhe, se ç'luftë, halle e vështirësi u kapërcyen dhe për vendimet që duhet të marrë ky kuvend i paparë në historinë tonë, - përfundoi doktor Nishani, - fjalën ia jap shokut Enver Hoxha. Në emër të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar ai do të mbajë raportin «Zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar në lidhje me ngjarjet ndërkombëtare».

Kisha marrë pjesë, kisha folur e kisha drejtuar mbledhje e konferenca të rëndësishme të Partisë, të Frontit e të pushtetit katër vjet me radhë; në të gjitha këto, bashkë me sigurinë e vendosmërinë që na jepte forca e Partisë dhe e luftës, kisha ndier edhe emocione të thella, por ndjenjat e emocionet që më përshkuan këtë radhë, ndërsa po bëhesha gati të nisja raportin, ishin të veçanta e që s'do t'i harroj kurrë.

Megjithatë, duartrokitjet dhe ovacionet e gjata të delegatëve, thirrjet e tyre entuziaste e të pandërprera, më dhanë kohë ta mblidhja veten e zëri të buçiste me atë siguri e atë forcë që e kërkonte vetë kjo ngjarje e madhe.

Raporti që mbajta në Kongres është i publikuar,* *(Shih: Enver Hoaha. Vepra, vëll. 2, botim i dytë, f. 299.) prandaj këtu do të përmend vetëm ndonjë fragment e pasazh, që, për momentet kur u mbajt, kishte rëndësi të veçantë.

Kështu, duke folur me hollësi për zhvillimin e situatave e të luftës sonë që nga 7 prilli i vitit 1939 e këtej, për etapat në të cilat kishte ecur kjo luftë, për vështirësitë që qenë kapërcyer etj., një rëndësi të veçantë i kushtova evidencimit dhe theksimit të rolit historik të Partisë sonë Komuniste si faktori themelor i bashkimit të popullit dhe i fitoreve të Luftës Nacionalçlirimtare.

- Partia Komuniste e Shqipërisë, - deklarova në Kongres, - vuri në shërbim të atdheut e të popullit jetën e anëtarëve të saj dhe çdo gjë që kishte të sajën. Ajo u bë organizuesja dhe udhëheqësja e vërtetë në kryengritjen me armë kundër okupatorit dhe reaksionit më të tërbuar, ajo ka qëndruar kurdoherë në krye të luftës dhe është përpjekur për të bashkuar masat e popullit dhe të gjithë nationalistët e ndershëm dhe patriotët në një front të përbashkët kundër pushtuesve.

Kjo deklaratë që u prit me brohoritje dhe me entuziazëm, pasqyronte një fakt historik të pakundërshtueshëm. Edhe më parë, gjatë luftës, ne kishim folur për rolin e Partisë Komuniste, për udhëheqjen e saj në Front e në Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe, më e rëndësishmja, e kishim zbatuar këtë në jetë. Por aktualisht kishte rëndësi të madhe afirmimi i Partisë si faktori vendimtar i

fitores në një ngjarje të tillë të madhe si Kongresi i Përmetit. Me këtë ne, në parim dhe në praktikë, riafirmim dhe ruanim edhe në të ardhmen rolin udhëheqës të Partisë.

Më tej në raportin tim fola për përpjekjet e reaksionit për të minuar e për të sabotuar Luftën Nacionalçlirimtare, për të larguar popullin nga Partia dhe nga Fronti. Edhe në këtë pjesë të raportit, tregoja historikisht për format që kishte ndjekur kjo veprimtari armiqësore, për taktikat demagogjike të grupimeve reaksionare e kolaboracioniste nga kuislingët e hapur, si: Kruja, Vërlaci, Bushati e Libohova, te Balli Kombëtar, tek Abaz Kupi e Legaliteti deri te kuislingët e rinj, si: Mehdi Frashëri, Ibrahim Biçaku e të tjerë. Me argumente e fakte në raport provohej tradhtia e tyre. Si një fakt «të freskët» përmendja përpjekjet e reaksionit për t'u futur në aleancë me reaksionin ballkanik, jo vetëm për të mbytur luftën tonë, por edhe për të shitur atdheun te shovinistët e vendeve fqinje.

Ato ditë neve na kishin rënë në dorë dokumente autentike që provonin një gjë të tillë dhe këto ne i kishim ekspozuar në një kënd të sallës ku bëhej Kongresi. Mes tyre gjendej një letër e firmosur nga «kryetari i Komitetit Qendror» ballist Mithat Frashëri, dërguar renegatit Dhimitër Fallo, me anë të së cilës ky ngarkohej të merrej vesh me anëtarët e tjerë të një «komisioni», i cili do të bisedonte me përfaqësues të reaksionit grek. Ky farë komisioni përbëhej nga Falloja, si përfaqësues i Ballit, Xhavit Leskoviku, përfaqësues i qeverisë kuislinge, Koço Kota i «partisë zogiste», bile na kishin gjetur edhe «përfaqësues të Kosovës»! Mes dokumenteve të kapura gjendej pasaporta, e marrë taze nga qeveritarët kuislingë, një letër rekomandimi e firmosur nga «ministri i Jashtëm» Bahri Omari për «qeverinë mike» si dhe një letër ku përcaktoheshin 8 a 9 «pika», mbi të cilat do të arrihej - marrëveshja» me reaksionarët grekë. Sipas këtyre «pikave», Balli Kombëtar, veç të tjerash, pranonte që forcat e armatosura shqiptare të shkriheshin me forcat reaksionare greke në një ushtri të përbashkët të komanduar nga grekët, e cila do të përdorej për të shtypur lëvizjet nacionalçlirimtare në Shqipëri e në Greqi. Jo vetëm kaq, por këta tradhtarë ishin treguar lë gatshëm të nënshkruanin një akord me qeverinë greke në Kajro që t'i jepnin Greqisë të ashtuquajturin Vorio Epir, ta futnin vendin tonë në suazën e mbretërisë greke, me të drejta «autonome», pra, ta shitnin atdheun te shovinistët grekë!* *(Këto dokumente ruhen në AQP.)

Por edhe kjo «kartë», si gjithë të tjerat, iu dogj në dorë reaksionit. Dhe iu dogj jo vetëm sepse ne e zbuluam në kohë tregtinë e tyre të ndyrë me fatet e atdheut, por sepse tashmë lodra të tilla nuk kishin më vlerë. Ato nuk mund ta kthenin nga rruga një popull që ishte ngritur në këmbë dhe kishte në udhëheqje Partinë e vet Komuniste. Dhimitër Fallos, si tradhtar e kriminel, i dhamë menjëherë dënimin e merituar dhe e ekzekutuam në mes të Korçës për hidhërimin e madh të kuislingëve e të reaksionit, që i mbushën muret e Korçës me afishe për vrasjen e tij dhe urdhëruan që varrimi t'i bëhej me «solemnitet madhështor» e «me shpenzimet e bashkisë». Më pas, pas Çlirimit, dhanë llogari edhe Xhavit Leskoviku dhe ish-kryeministri zogist Koço Kota, të cilin njerëzit tanë e gjetën atje ku ishte fshehur dhe të dy së bashku, bashkë me të tjerë kriminelë, i çuam në bankën e të akuzuarve, në gjyqin e popullit.

Pas ekspozesë që i bëra luftës sonë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, në raport trajtoja çështjen e masave dhe vendimeve të domosdoshme për çlirimin dhe të ardhmen e vendit, në dritën e evenimenteve të jashtme e ndërkombëtare.

- Situata e sotme është e tillë që populli ynë, i cili ka vuajtur, ka sakrifikuar e ka derdhur gjak, të ketë një sistem shtetëror, i cili do të sigurojë lirinë dhe demokracinë e vërtetë, - theksova në mes të tjerash në raport dhe, në këtë kuadër, parashtroja de tyrat që duhej të zgjidhte Kongresi historik i Përmetit.

- Delegatëve të këtij Kongresi, të zgjedhur nga vullneti sovran i popullit dhe që përfaqësojnë të gjitha shtresat e shoqërisë sonë, - thashë për këtë çështje, - u bie barra të marrin masat e duhura për zhvillimin e luftës deri në fitore dhe për të siguruar të ardhmen e atdheut. Kongresit tonë i ngarkohet të krijojë organe të tilla politike, legjislative dhe ekzekutive, të cilat do të jenë në gjendje të kapërcejnë çdo pengesë që do t'u dalë përpara, do të përfaqësojnë ashtu siç duhet popullin shqiptar, si brenda edhe jashtë Shqipërisë, dhe do të jenë të afta të ndalojnë çdo tentativë, të bërë

nga çdo anë qoftë, që do të ketë për qëllim të pengojë realizimin e dëshirave, për të cilat populli ynë po lufton dhe po derdh kaq gjak në këtë luftë të madhe çlirimtare.

Përfundimin e raportit që mbajta në Kongresin e Përmetit delegatët e pritën me duartrokitje e brohoritje të pareshtura, të cilat ishin shprehje të optimizmit revolucionar, të gëzimit dhe të vendosmërisë për të ecur përpara në rrugën që tregonte Partia.

Të paharruara do të mbeten për mua entuziazmi prekës i delegatëve, fjalët e tyre të zjarrta në diskutime. Përfaqësuesit e popullit flitnin për fitoret e ushtrisë sonë, për pushtetin popullor që vepronte gjallërisht, sillnin fakte të reja për veprimtarinë e reaksionarëve, aprovonin vendimet që propozoheshin. Është pak të thuash se salla që e elektrizuar. Atmosfera festive dhe entuziazmi i të pranishmëve gjente rastin të shpërthente kur doktor Nishani, në hapje apo gjatë seancave, njoftonte lajmet më të fundit për sukseset e reparteve partizane në frontin e luftës, apo lexonte letrat përshëndetëse që i vinin Kongresit. Mes tyre ishin edhe përshëndetjet e shokëve tanë Baba Faja e Haki Stërmilli që nuk kishin mundur të vinin në këtë kuvend historik.

Për gati dy ditë vazhduan diskutimet rreth raportit. U ngrit edhe Hysni Kapoja, të cilin Partia e kishte ngarkuar me detyrën e komisarit politik të Brigadës V Sulmuese dhe në diskutimin e tij foli për lindjen dhe zgjerimin e luftës së armatosur të popullit shqiptar, dulce theksuar faktin se ishte Partia Komuniste e Shqipërisë ajo që e bashkoi dhe e ngriti popullin në luftë.

- Luftën tonë, - tha mes të tjerash Hysni, që është një luftë e tipit të ri, që e përgatit popullin dhe e edukon politikisht, ne e nisëm me njësite të vogla dhe kaluam në çeta, batalione e brigada. Formimi i Shtabit të Përgjithshëm e forcoi organizimin tonë dhe ai, qëkurse është krijuar, e ka drejtuar më së miri Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Sot ne kemi 12 brigada dhe do të kemi edhe divizione e korparmata. Fitoret që kemi arritur kanë shtuar besimin e popullit për fitore dhe për një qeveri demokratike e popullore.

Edhe Spiro Moisiu në diskutimin e vet foli për Ushtrinë Nacionalçlirimtare, vuri në dukje organizimin e saj, pajisjet dhe armatimin, të cilin e siguronin vetëm dulce ia rrëmbyer armikut, sepse «ndihma» e aleatëve kishte qenë një hiç. Spiro Moisiu u solli delegatëve edhe një fakt që dëshmonte për rritjen e forcës goditëse të luftës sonë, por edhe për qëndrimin e vendosur parimor të Partisë, kundër çdo kompromisi tradhtar.

- Komanda gjermane, - tha ai, - na dërgoi një aficer dhe na propozoi që Shtabi ynë i Përgjithshëm të dërgonte përfaqësues në Tiranë për të biseduar e për t'u marrë vesh me hitlerianët. Por ne u deklaruam gjermanëve se do të luftojmë derisa të zhduket fashizmi. Ushtria Nacionalçlirimtare ka dalë të luftojë për popullin e për liri e do të vazhdojë luftën gjer në fitore, s'ka asnjë kompromis as me okupatorët, as me veglat e tyre. Ne e filluam luftën me besim te populli e ashtu do ta mbarojmë.

Një ligjëratë të zjarrtë për traditat përparimtare e përpjekjet e pareshtura të popullit tonë për liri e drejtësi popullore mbajti doktor Medar Shtylla. Ai theksoi të drejtën e popullit për të vendosur vetë për fatin e tij, të drejtë, që e kishte fituar me grykën e armëve.

Pikërisht këto tradita të mrekullueshme Partia jonë Komuniste, në luftë e sipër, i zhvilloi dhe u dha përmbajtje të re. Bashkimi luftarak i popullit, i edukuar e i kalitur nga Partia, me shembullin e komunistëve, garantonte lirinë. Në këto lidhje të shumanshme të popullit me Partinë, qëndronte forca jonë.

- Ne luftuam okupatorë e tradhtarë me sa mundëm, - u ngrit e foli Myslim Peza. - Na kanë vra, na kanë djegë, por askush nuk tha «e ka keq Partia», pse e dinë se rruga e luftës është rruga e drejtë e popullit, rruga e Partisë është edhe e Babës. Ne e filluam pa qenë të organizim, Partia na bashkoi e na organizoi. Populli i Pezës u ka hapë dyert natën e ditën të rinjve, djemve e vajzave. Të gjithë më thonë «Babë». Pse më thërrasin kështu? E kam dashë popullin ose jo, këtë mund ta thoni ju.

Shpërthyen duartrokitjet:

- E ke dashur! Rroftë Baba!

Ishte një gëzim e krenari e veçantë të shikoje gjithë këta burra, disa me thinja e të tjerë në moshë mesatare, në mes shumicës që ishin të rinj e të reja, por që të gjithë fati i vatanit i kishte ngritur në luftë, i kishte bërë një. Kongresi ishte shprehja më e gjallë e këtij bashkimi të fuqishëm që kishte krijuar Partia.

- Ky Kongres përfaqëson gjithë popullin shqiptar, - tha në diskutimin e tij Haxhi Lleshi, - prandaj të gjithë do t'i njohin vendimet e tij, do ta njohin qeverinë e re, se është qeveri e tyre. Misioni anglez, - tha më poshtë, - ka ndihmuar reaksionin. Ne do t'i quajmë edhe ata reaksionarë, se ne jemi aleatë me popujt, por jo me ata që ndihmojnë reaksionin. Në Dibër, Mat e Lumë ka çeta e batalione partizane që luftojnë okupatorë e reaksionarë dhe këto çeta i mban populli se e di që luftojnë për lirinë e tij. Kurse Radio Londra më shumë përmend emra të reaksionarëve sikur janë këta që luftojnë. Ne i themi Radio Londrës, që ka folur për Ballin Kombëtar sikur ka luftuar, të informohet më mirë. Po kështu anglezët duhet ta dinë mirë se Legaliteti, që ata e përkrahin, nuk përfaqëson asgjë. Populli edhe në Veri, në Dibër, Mat etj. ka urrejtjen më të madhe për Legalitetin e për regjimin e Zogut që vetëm burgje ngrinte, por jo shkolla e spitale. Populli i ka parë me sytë e vet se ata që quhen zogistë plaçkitën Burrelin, por sa për luftë, kurrë nuk kanë luftuar ndonjëherë me okupatorin.

Diskutimi më «i flaktë» kundër Bazit të Canës dhe Legalitetit ishte . . . i Mustafa Gjinishit! Kjo nuk më çuditi. Ne tanimë kishim prova se ai ishte agjent i anglezëve; siç kam shkruar edhe te libri «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», kur ne u nisëm nga Helmësi për në Përmet, Mustafa Gjinishi doli i fundit nga shtëpia e xha Mehmetit duke menduar se ne do të ishim me karvanin që kishte kaluar përpara. Sapo dolëm te një kthesë, nga nuk shihej më Helmësi, pamë një ushtar anglez që nxitonte për diku. Na bëri përshtypje shfaqja e papritur dhe nxitimi i anglezit, ndaj vëzhguam me kujdes dhe arritëm të shohim se si ushtari anglez i dorëzoi me shpejtësi Mustafa Gjinishit një letër. Kur i shkuam pranë dhe i kërkua letrën, Mustafa Gjinishi na tha se nuk e dorëzonte. E shamë rëndë, nuk i lamë gjë pa thënë, por ai vetëm përsëriste: «Bëni çfarë të doni, por letrën nuk jua jap». «Do të bisedojmë në Përmet», - i thamë agjentit të anglezëve, i cili kishte marrë urdhër nga padroni të sabotonte Kongresin. Por ishte tepër vonë, letra Mustafa Gjinishi ishte djegur një herë e përgjithmonë.

Pikërisht tani, i zënë si miu në dhokan dhe në prag të demaskimit të plotë, ai po mundohej me «ligjëratën e zjarrtë» të kamuflonte misionin që i qe ngarkuar nga padronët e të ruante veten për të ardhmen. U ngrit e tha se Bazi iku në Jugosllavi me dy torba florinj e u kthye me dymbëdhjetë (i dinte mirë këto, se ishte vetë në të njëjtën valle), se Legaliteti është pjellë e Mehdi Frashërit dhe e Gestapos, sepse ata vetë nuk kanë tru të organizojnë, bile tha se Bazi mban anglezë me vete që t'i presë aleatët me lule.

Te toni patetik, thirrjet plot «zemërim» të Gjinishit kundër Bazit e Legalitetit, te «përbetimet» e tij për Partinë Komuniste e veprën e madhe të saj (!), shihja qartë përpjekjet e dëshpëruara të agjentit të fshehtë, për të na hedhur hi syve. Por ishte tepër vonë për të. Tani asnjë taktikë s'kishte më vlerë, veçse nga mënyra të tilla veprimi ne mësuam shumë që në ato vite të vështira, të gjitha këto ishin si një shkollë e vyer për të ardhmen.

Koha do të provonte se edhe të tjerë Gjinishë me «thirrjet» e «besnikërinë» e tyre ndaj «çështjes», me «devotshmërinë» e tepruar gjer në një sektarizëm flagrant, nuk bënin gjë tjetër veçse mundoheshin të fshihnin kthetrat për të fituar besimin e Partisë dhe të popullit, për të zënë vende kyç në Parti e në pushtet dhe që atje, të fshehtë e dinakë, ta bënin më lehtë lodrën e ndyrë të zotërinjve të huaj që i kishin blerë. Por Partisë, syrit dhe vigjilencës së saj asgjë s'do t'i shpëtonte. Herët a vonë këta do të nxirrnin veshët dhe Partia e populli do t'ua pritinin.

Por këto ishin zëra të vetmuar që situata, lufta, vigjilenca e Partisë ua kishin nxjerrë dhe do t'ua nxirrte kallajin. Delegatët, me diskutimet e tyre të gjalla e të shëndosha, tregonin pozitën e mjerë të elementëve të tillë si Mustafa Gjinishi.

Megjithëqë tash e dinim mirë se nga ç'pozita «kishte gabuar» në Mukje dhe në favor të kujt punonte e «luftonte» Gjinishi, ne jo vetëm e lejuam këtë të merrte pjesë e të diskutonte në Kongresin e Përmetit, por edhe të ruante funksionet që kishte në organet e Frontit e të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Vepruam kështu, si të thuash, për oportunitet politik, veçanërisht për të mos u dhënë shkas e rast aleatëve anglezë që të acaronin qëndrimet ndaj Lëvizjes sonë Nacionalçlirimtare e, sidomos, tash që ne po krijonim Komitetin Antifashist me atributet e një Qeverie Demokratike popullore, e cila, veç të tjerash, do të kërkonte edhe njohjen e mbështetjen nga aleatët.

Diçka më ndryshe qëndronte çështja e Ymer Dishnicës dhe arsyet se pse edhe ky mori pjesë si delegat në Kongresin e Përmetit e u rizgjodh në organe drejtuese të Frontit e të pushtetit.

Për gabimin e rëndë të kapitullimit në Mukje, siç theksova më lart, ne e mënjanuam atë nga udhëheqja e Partisë qysh në shtator 1943, kurse Plenumi i Parë i KQ të Partisë i 15 majit 1944 vendosi zyrtarisht përjashtimin e tij nga funksionet e larta që kishte në Parti. Por, ndërkohë, ai i ruajti funksionet që kishte në organet drejtuese të Frontit e të pushtetit, mori pjesë në Kongresin e Përmetit, bile u zgjodh e punoi për një kohë edhe në përbërjen e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, si drejtues i dikasterit të Shëndetësisë. Vepruam kështu të nisur nga fakti se Ymer Dishnica ra në gabimin e rëndë të Mukjes, 'si pasojë e pikëpamjeve të tij jo të drejta, i papjekurisë ideopolitike dhe jo i shtyrë nga qëllime e motive agjenturore, siç ndodhi me Mustafa Gjinishin. Nëse Ymer Dishnicën, pra, e çuan në aktin kapitullues të Mukjes butësia mikroborgjeze dhe oportunitizmi, Mustafa Gjinishin çoi në atë akt roli agjenturor që i ishte ngarkuar nga Intelixhens Servisi.

Në një nga seancat e Kongresit foli edhe trimi nga Skrapari, Zylyftar Veleshnja. Zylyftarin, i cili para pak kohësh ishte plagosur rëndë në luftë, Kongresi e kishte vendosur në presidium dhe që aty ai u ngrit të fliste i mbështetur pas një shkopi.

- Shokë, - tha, - ju përshëndes me «Vdekje fashizmit!». Jam një katundar i pellgut të Skraparit, verie Demokratike popullore, e cila, veç të tjerash, do të kërkonte edhe njohjen e mbështetjen nga aleatët. Diçka më ndryshe qëndronte çështja e Ymer Dishnicës dhe arsyet se pse edhe ky mori pjesë si delegat në Kongresin e Përmetit e u rizgjodh në organe drejtuese të Frontit e të pushtetit.

Për gabimin e rëndë të kapitullimit në Mukje, siç theksova më lart, ne e mënjanuam atë nga udhëheqja e Partisë qysh në shtator 1943, kurse Plenumi i Parë i KQ të Partisë i 15 majit 1944 vendosi zyrtarisht përjashtimin e tij nga funksionet e larta që kishte në Parti. Por, ndërkohë, ai i ruajti funksionet që kishte në organet drejtuese të Frontit e të pushtetit, mori pjesë në Kongresin e Përmetit, bile u zgjodh e punoi për një kohë edhe në përbërjen e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, si drejtues i dikasterit të Shëndetësisë. Vepruam kështu të nisur nga fakti se Ymer Dishnica ra në gabimin e rëndë të Mukjes, 'si pasojë e pikëpamjeve të tij jo të drejta, i papjekurisë ideopolitike dhe jo i shtyrë nga qëllime e motive agjenturore, siç ndodhi me Mustafa Gjinishin. Nëse Ymer Dishnicën, pra, e çuan në aktin kapitullues të Mukjes butësia mikroborgjeze dhe oportunitizmi, Mustafa Gjinishin

çoi në atë akt roli agjenturor që i ishte ngarkuar nga Intelixhens Servisi.

Në një nga seancat e Kongresit foli edhe trimi nga Skrapari, Zylyftar Veleshnja. Zylyftarin, i cili para pak kohësh ishte plagosur rëndë në luftë, Kongresi e kishte vendosur në presidium dhe që aty ai u ngrit të fliste i mbështetur pas një shkopi.

- Shokë, - tha, - ju përshëndes me «Vdekje fashizmit!». Jam një katundar i pellgut të Skraparit, besimin që kishte ai te Partia Komuniste; e luta të më tregonte për luftimet ku kishte marrë pjesë, po këtu Zylyftari qe fjalëpaktë. E pyeta si e kishte këmbën dhe e këshillova:

- Duhet të kujdesesh edhe për vete, të mjekohesh.

- Do të më kalojë, - m'u përgjigj Zylyftar Veleshnja. - Vetëm se më vjen keq që ndodhi në këto kohë. Këmba më pengon pak, se mezi lëviz. Ja, në Çorovodë, ku bëmë zgjedhjet e delegatëve, vajta me katër këmbë, hipur në mushkë. Lëre ç'vajti, ishte mbledhur popull i madh, zbritur nga fshatrat. Flitnin a s'flitnin, bilbil fare, bënë vërejtje e rrëzuan dy kandidatë, i ranë pikës. M'u bë zemra mal dhe, sa për këmbën, e ç'ne o, as që më vajti mendja, më dukej se mund të fluturoja e jo të ecja! Kështu më duket edhe tani, prandaj them se do të shërohem.

Më vonë, pas nja dy muajsh, u kujdesëm që bashkë me misionin tonë ushtarak që do të bisedonte me Shtabin Aleat të Mesdheut në Bari, të shkonin për mjekim edhe një grup partizanësh të plagosur rëndë. Midis tyre ishte edhe Zylyftari.

Pas kësaj bisede të parë, u poqa edhe herë të tjera me të dhe bisedova me kënaqësi, se në bisedë ai ishte i shtruar e i këndshëm, bile edhe shakatar i thekur. Na tregoi një ditë një histori e na bëri të qeshnim me lot. Kur kishte qenë i shtruar në spitalin partizan të Zabëzranit, Zylyftari kishte parë edhe atje se si «i plotësonin» anglezët kërkesat tona. Neve na duheshin e u kërkonim armë, barut, si

dhe ilaçe, garza apo allçi, anglesët na hidhnin oturakë! Në spitalin partizan ku këta oturakë qenë me shumicë, të plagosurit u kishin vënë me tallje emrin «Çërçill». I përdornin për të hedhur garzat e leckat e ndotura kur ndërronin plagët, ndonjë mbeturinë ushqimore etj. Dhe ja, një ditë në spital na kishte vajtur për të parë të plagosurit një doktor anglez. Në kohën kur ky ecte mes shtretërve, një i plagosur i kishte thënë shoqes që shërbente:

- Më sill pak «Çërçillin».

Anglezi e dëgjo i dhe pyeti doktorin e spitalit, që e shoqëronte:

- Ç'thotë për Çërçillin?

- Thotë se këta na i dërgon Çërçilli, - i qe përgjigjur shkurt doktori.

- Ollrajt, - kishte thënë anglezi, - ollrajt!

Po le t'i lëmë mënjandë «ndihmat bujare» të kryeministrit anglez për spitalet tona partizane, le të kthehemi në seancat e Kongresit të Përmetit. Siç thashë, diskutimet për raportin që mbajta unë vazhduan dy ditë dhe mund të vazhdonin edhe më, sepse të gjithë delegatët donin të merrnin fjalën, të tregonin për luftën në krahinat e tyre, të shprehnin gëzimin dhe besimin te Partia, të aprovonin vendimet historike. Përfaqësuesve të qyteteve, fshatrave e reparteve partizane u dukej se nuk e kryenin mirë porosinë që u kishte dhënë populli e partizanët, po të mos ngriheshin në Kongres e t'i shprehnin me fjalë ato që kishin në zënnër.

Salla e priti me simpati diskutimin e një shoku delegat të minoritetit grek në Shqipëri, i cili foli për udhëheqjen e drejtë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që vëllazëroi e bashkoi popullin, që u dha minoritarëve grekë po ato të drejta si edhe popullit vëlla shqiptar.

- Armët e bashkuara në këtë luftë për Tiri tregojnë për qëllimin e përbashkët, fatin e përbashkët: liria juaj është dhe liria jonë, - tha ai.

Një diskutim të mirë bëri në Kongres Nexhmije, Xhuglini, delegate e Bashkimit të Rinisë Antifashiste. Ajo foli për luftën dhe përpjekjet e rinisë shqiptare, e cila, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, u rrit, u edukua, u bë forcë e madhe në luftën për çlirim. Përmendi dëshmorët e shumtë që rinia i kishte falur qëllimit tonë të shenjtë, shprehu dhimbjen e të gjithë të rinjve e të popullit që mes nesh nuk ishin Qemali, Mistoja, Margarita, Mihali e të tjerë shokë të shtrenjtë të rinisë. Në diskutimin e saj Nexhmija vuri në dukje se qe Partia Komuniste ajo që e udhëhoqi rininë, që i dha idealin për të cilin luftoi.

- Pas apelit të Partisë, - tha ajo, - rinia forcoi luftën në fshat, në qytet e në shkollë, doli në mal dhe kështu u ndez flaka e luftës çlirimtare. Të rinjtëshkollarë dhe studentët !anë shkollat dhe universitetet, jo për t'u bërë kovaçë, siç thotë Lumo Skëndoja, po për të luftuar. Këtu, në Përmet, po vihen bazat e Shqipërisë së re, mbi gë madhat e fshatrave të djegura e fushave të papunuara. Rinia e di ç'kërkon dhe përse ka nevojë populli, prandaj po me hovin e luftës e po me atë dashuri do të punojë për ndërtimin e Shqipërisë demokratike popullore. Rinia ka përpara fytyrën e heronjve të saj dhe ka kujdes të ngrejë sa më lart flamurin për të cilin ata ranë.

Vazhdimi i luftës deri në fitore, zgjedhja e Këshillit Nacionalçlirimtar dhe e Komitetit Antifashist e vendimet e tjera me rëndësi kombëtare ishin objekt i diskutimit të shumë delegatëve, të cilët me fjalët e tyre e ngrinin peshë entuziazmin. Një diskutim të tillë, konkret e me gjuhë të thjeshtë mbajti edhe delegati i Vlorës, Hasan Puloja.

- Dita e madhe e 1 Majit, - tha ai, - ishte edhe dita e zgjedhjeve të delegatëve për këtë Kongres. Në Mesaplik më se 500 burra dhe 200 gra me lot gëzimi votuan për përfaqësuesit e vet, se këtij populli për të parën herë iu dha rasti, në sajë të sakrificave e të gjakut të derdhur, të votojë jo nën bajonetën e Taf Kaziut e litarëve të Ahmet Zogut, por lirisht e sipas vullnetit të tij. Nuk po zgjatëm këtu, - i ra shkurt ai, - por po them se populli është për luftë dhe më ka ngarkuar të njoftoj Kongresin e Qeverinë e re që do të kërrejme këtu se Vlora e tërë ka besim te Fronti Nacionalçlirimtar dhe te Partia Komuniste! Më porositën, gjithashtu, të kërkoj nga Qeveria të bëjë ç'të jetë e mundur e të kërkojë ardhjen e një misioni ushtarak sovjetik!

Fjalët e tij të fundit u mbuluan me duartrokasje dhe me thirrjen e delegatëve: «E duam misionin ushtarak sovjetik!».

Kjo ishte një dëshirë jona e vjetër që e kishte burimin në dashurinë tonë për atdheun e kolosëve të revolucionit, Leninit e Stalinit, për vendin e parë socialist, në respektin për Ushtrinë Sovjetike që kishte përballuar me heroizëm sulmin hitlerian dhe tash, e udhëhequr nga arti ushtarak stalinian, po e dërrmonte bishën naziste dhe po e shtynte drejt strolullës së vet, Gjermanisë. Ardhja e një misioni ushtarak sovjetik do të ishte një gjë e gëzueshme për popullin dhe për ushtrinë tonë. Ne kishim në Shqipëri misionet angleze, po këta qenë miq të paftuar që i prananim nga halli, nga respekti që duhej të kishim për aleatët, kurse oficerët sovjetikë do të ishin jo miq zyrtarë, por miq të zemrës. Që më parë ne ishim përpjekur të vihem në lidhje me sovjetikët, u kishim kërkuar dhe jugosllavëve Vi transmetonin komandës sovjetike dëshirën tonë. Na kishin thënë se ishte me rrezik hedhja e tyre me parashutë, se edhe ata e kishin shumë të vështirë të hynin në kontakt me njëri-tjetrin etj., etj. Sidoqoftë, gjatë ditëve që mbahej Kongresi i Përmetit rastësisht një ushtarak sovjetik ndodhej pranë Shtabit tonë të Përgjithshëm dhe ne e kishim ftuar të merrte pjesë në Kongres. Ai shprehu dëshirën të thoshte dy fjalë në përshëndetje të Kongresit dhe ne ia plotësuam.

- Ky Kongres, - tha ai, - edhe një herë i tregon botës se popujt e shtypur nga fashizmi u ngritën në luftë.

Ai foli për shoqërinë sovjetike që s'njeh shtypje e shfrytëzim, për luftën heroike kundër hordhive naziste; pastaj bëri shkurtimisht një pasqyrë të fitoreve të Ushtrisë së Kuqe, e cila ndodhej në portat e Ballkanit.

- Vetëm ata popuj të luftojnë e ngrenë zërin për liri, - tha duke përfunduar, - vetëm ata meritojnë të rrojnë. Kongresi juaj tregon se populli shqiptar e di se vetëm me luftë fitohet liria.

Pas dy ditë diskutimesh, më 26 maj kaluam në fazën tjetër të punimeve të Kongresit, në zgjedhjen e organeve legjislative dhe ekzekutive të pushtetit tonë popullor. Ky ishte një moment historik me rëndësi vendimtare për fatet e atdheut e të popullit, ishte kurorëzim i luftës së popullit për Tiri e për Shqipërinë populllore. Kishte ardhur momenti që me vullnetin e popullit shqiptar, të hidheshin themelet e një shteti të ri, i cili do të luftonte për interesat themelore të masave popullore, të punëtorëve, fshatarëve e të inteligjencies patriotë. Këshilli Antifashist, që do të ishte asambleja jonë e parë kushtetuese, dhe komiteti, me kompetencat e një qeverie, nuk do të ishin pjellë e kombinacioneve të kancelarive evropiane, as fantazma të së kaluarës, që fuqitë imperialiste i mbanin e i subvenciononin për t'i përdorur kundër popujve. Shteti i ri që po ndërtonim kishte mbështetjen dhe besimin e popullit, kishte ushtrinë e vet që luftonte heroikisht dhe së shpejti do ta shporrte tej armikun, kishte një sistem të tërë organesh që efektivisht e realisht drejtonin e administronin. Organet kryesore të këtij shteti po dilnin nga një kuvend i madh i përfaqësuesve të popullit që vinin nga frontet e luftës.

- M'u ngarkua mua nderi i madh, - e mori fjalën doktor Nishani i emocionuar, - të hap këtë seancë, ndër seancat më historike të këtij Kongresi. Erdhi pastë të zgjedhim Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar, atë këshill, i cili, për rolin dhe funksionet që do t'i ngarkohen, do të zgjedhë Komitetin Antifashist, të parën Qeveri Demokratike në historinë e Shqipërisë.

Pastaj doktor Nishani u shpjegoi delegatëve procedurën e zgjedhjeve, foli për numrin e anëtarëve të Këshillit etj. Për të përcaktuar kandidaturat që do t'i paraqiteshin Kongresit, u propozua të caktohej një komision me shokë të njohur në luftë e me autoritet.

- Prej sa vetash do të jetë komisioni? - pyeti dikush.

- Është mirë që numri të kufizohet në 10-15 veta, - tha doktor Nishani.

I pari, që nga vendi, me foddullëk, foli Mehmet Shehu, delegat nga Brigada I Sulmuese.

- Unë do të bëj ca propozime që ndoshta mund të pranohen. Unë mendoj që në komision të zgjidhen anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm e të Shtabit të Përgjithshëm dhe ca nga ne, kallaballëku...

Doza e mendjemadhësisë te ky njeri ishte e për

zier me ndjenjën e pakënaqësisë që bluante përbrenda. Konsiderata që kishte për veten ishte po aq e madhe sa edhe përçmimi e nënvleftësimi ndaj shokëve të tjerë të thjeshtë të Partisë e të luftës, të cilët ai me përbuzje i quante «kallaballëk», pra, një masë amorfe, pa vlera, e destinuar të aprovonte mendimet dhe vendimet e të tjerëve. Mehmet Shehu pretendonte se i ishte ngrënë hak-i, se e kishim

lënë në mes të «kallaballëkut», pavarësisht se ishte zgjedhur në plenumin e Komitetit Qendror si kandidat dhe ishte emëruar komandant brigade. Po Mehmet Shehu donte më shumë, edhe për të kënaqur ambiciet e veta, edhe për të zbatuar porositë e padronëve. Për shprehje të tilla të mendjemadhësisë e për gabime të tjera ato ditë do të kisha një bisedë të veçantë me të, ku do ta kritikojta ashpër e ai, aty për aty, siç e kishte zakon do të bënte një -autokritikë të fortë». Por të mos e «ndërpresim» zhvillimin e seancës.

Pasi u bënë propozimet e duhura, Omer Nishani pyeti:

- Doni të shtohet lista e komisionit, apo të mbetet me këta që shënuam?

Delegatët ngritën grushtin lart, se kështu votonim, dhe lista u aprovua. Komisioni doli për të hartuar listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.

Sa kishim filluar nga pupa për përpilimin e listës, kur, deri në kthinën ku ishim mbledhur, u dëgjua nga salla një breshëri duartrokitjesh.

Doktor Nishani, i përkulur mbi shkresa, ngriti gjyzykët me gishtin tregues:

- Ç'po bëhet?

Nakoja, i shkathët, lëvizi nga karrigia ku qe ulur, shkoi për një çast në sallë dhe u kthye sakaq duke qeshur.

- Profesor Sejfullai po i kshehas delegatët me muzën e vet poetike, - tha ai duke u drejtuar nga doktor Nishani, ndoshta pse përdori shprehjen gjirokastrite «kshahas».

- Ne, ne, - ia bëri Omer Nishani dhe vazhduam punën.

Nga Balla vinte zëri imponant i «poetit revolucionar», si e pagëzoi me këtë rast para dëgjues, re Dishnica, pastaj, me një ton tjetër, bënte sqarimet e rastit «shkruar në filan vit», «shkruar në kushtet e emigracionit të gjatë politik» etj., etj. Kishte disa ditë që Sejfullai, dembel klasik, po tregojte aktiv e i papërtuar. Diskutonte, bënte teorira, takohej me delegatë, recitonte, na pyeste në kishim ndonjë detyrë për t'i ngarkuar etj., etj. Dukej qartë se Sejfullai dente të reklamohet me çdo mënyrë si teoricien, si njeri që i njeh punët e shtetit, bile edhe si poet.

Pas gati dy orë diskutimesh komisioni përpiloi një listë me 115 kandidatë, u kthyem në sallë e seanca rifilloi. Doktor Nishani e këndoi listën dy herë me radhë e u dhanë shpjegime për çdo kandidat të propozuar, i cili, nga ana e tij, ngrihej në këmbë dhe «u prezantohet» shokëve. Në përgjithësi të gjitha kandidaturat e propozuara mirëpriteshin nga delegatët dhe kjo ishte e natyrshme, sepse ne kishim pasur parasysh që në Këshill të zgjidheshin patriotë të ndershëm, komunistë ose jo, militantë të Luftës Nacionalçlirimtare që ishin dalluar në punën e luftës e tyre në terren e në ushtri. Megjithatë, ishte e kuptueshme, kishte vend edhe për plotësime. Në përpilimin e listës së kandidatëve kishim pasur parasysh edhe një sërë faktorësh të tjerë si raportin mes shokëve anëtarë partie dhe atyre që nuk ishin të tillë, ndarjen gjeografike, besimet fetare, që edhe ky ishte një kriter që në atë kohë kishte rëndësi. Kështu, për kandidaturat e propozuara nuk pati rezerva esenciale, vetëm se u bënë propozime që në listë të futeshin edhe kandidaturat e disa shokëve të tjerë. Por meqë përbërja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar nuk mund të zgjerohej pa kufi u vendos që lista si numër të mbetej aq sa ishte dhe të diskutohet nëse ndonjë nga kandidatët mund të zëvendësohej me ndonjë shok tjetër. Dhe me të vërtetë pati edhe ndonjë kandidatë që u zëvendësua pas argumenteve e arsyeve bindëse që shprehën shokët. Kështu, për shembull, në një rast u ngrit shoku Hysni Kapo dhe tha:

- Për shokun që propozohet s'kam asnjë kundërshtim, e meriton plotësisht që të zgjidhet. Por, duke u nisur nga fakti që edhe ai është ushtarak dhe nga zona që përfaqëson gjer tani janë aprovuar edhe kandidatúra të tjera nga ushtria, mendoj që ta zëvendësojmë me një kandidatë tjetër nga terreni. Thuajse të gjithë u shprehën dakord, kur u hodh Mehmet Shehu e tha:

- Këtu luhet një intrigë! S'më duket e drejtë që pse njëri është ushtarak të mos marrë pjesë në KANÇ!

- Ke ankesë për rastin konkret? - e pytëm. apo e ke në parim?

- Edhe rastin konkret kam parasysh, por kryesorja është në parim, - u përgjigj ai.

- Atëherë e ke gabim, - i thashë. - Nuk dimë sa i njeh ti propozimet dhe a e dëgjove mirë listën që lexoi doktor Nishani, por, siç tha dhe Hysniu, atje janë emrat e shumë shokëve nga ushtria.

Në të vërtetë, që në zgjedhjen e delegatë ve ne e kishim pasur parasysh të vinin në Kongres sa më shumë shokë nga radhët e ushtrisë. Ishte e kuptueshme, me armë në dorë, duke derdhur gjak, ata kishin dhënë një provë të madhe para popullit e atdheut. Delegatët nga ushtria zinin më shumë se 40 për qind të numrit të përgjithshëm. Edhe në listën e kandidatëve për në Këshill kishte, gjithashtu, një raport të mirë midis shokëve të ushtrisë e të terrenit, kështu që «vërejtja» e Mehmet Shehut «në parim» ishte fare pa vend. Hallin, pra, ai e kishte «konkretisht» për kanpd, datura konkrete dhe, kuptohet në radhë të parë e mbi të gjitha synonte e kërkonte që t'i hapte udhë v-e, es për një vend në Komitetin Antifashist.

Pas sqarimeve e diskutimeve u aprovua përbërja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Këshilli i ri u duartrokit gjatë.

- Tani, - tha doktor Nishani duke mbyllur, seancën. - porositim të gjithë delegatët e Kongresit të ruajnë konspiracionin për të zgjedhurit qui janë në ilegalitet në zonat ende të pushtuara nga armiku. Pasi hëngra drekën date biseduar për zemërsisht me miqtë e mi të vjetër. Mila Lakon babë Myslimin, Esat Dishnicën, moasditë filluam mbiedljen e parë të KANÇ-it të ri.

Në këtë mbledhje, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar mori vendime shumë të rëndësishme: mbi funksionet dhe detyrat e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar e të Kryesisë së tij si dhe të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar për ndalimin e kthimit të Zobut në Shqipëri; mbi dhënien e gradave në Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Me kompetencat dhe prerogativat që i ngarkoheshin Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar apo KANÇ-it, siç thirrej shkurtimeisht, ky do të ishte organi më i lartë legjislativ i shtetit të ri shqiptar. Ai ishte asambleja, Kuvendi ynë Popullor i kohës së luftës dhe i muajve të parë të Clirimit, derisa në Shqipëri të bëheshin zgjedhjet e përgjithshme për Asambleenë Kushtetuese, e cila në vazhdim të KANÇ-it do të zgjidhte përfundimisht çështjen e formës së regjimit, do të emëronte Qeverinë e re, do të aprovonte Kushtetutën. Ie vendimin që do të aprovonin përfaqësuesit e popullit në Kongresin e Përmetit përcaktoheshin edhe funksionet e kompetencat e Kryesisë së Këshillit e të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, si organi më i lartë ekzekutiv me të gjitha atributet e një Qeverie popullore provizore.

Në këtë mbledhje të parë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, pas leximit të projektvendimeve që përmenda, pas diskutimit dhe aprovimit të tyre, u kalua në zgjedhjen e Kryesisë. Pas fiati një orë diskutimesh në komisionin e ngarkuar për caktimin e kandidatëve u përgatit lista prej rreth 30 vetash, të cilën doktor Omer Nishani ua lexoi anëtarëve të KANÇ-it.

- Kjo është lista që propozohet nga komisioni, - tha ai - Ka ndonjë kundërshtim?

Nuk pati vërejtje për shokët e propozuar dhe të gjitha kandidaturat u aprovuan me unanimitet.

- Atëherë, - tha Omer Nishani, - ju lutem të keni parasysh se zgjedhja në Kryesi e katër shokëve të fundit nuk duhet publikuar përderisa ata të lajmërohen, sepse ndodhen në qytete që ende s'janë çliruar. Tani, të mbeten në sallë vetëm shokët që u zgjedhën në Kryesi.

Pas disa minutash, filloi mbledhja e parë e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.

- Tani mund të pini cigare, se jemi të paktë, - na dha leje Omer Nishani, i cili gjatë gjithë seancave të Kongresit e të KANÇ-it e kishte ndaluar kategorikisht duhanin.

Në këtë mbledhje, në të cilën mungonin pesë nga anëtarët e Kryesisë, që s'kishin mundur të vinin në Përmet dhe pikërisht: Baba Faja, Qirjako Hárító, Ollga Plumbi, Gaqo Tashko e Gjergj Kokoshi, zgjedhëm kryetarin e Kryesisë dhe tre nënkryetarë. Kryetar u zgjedh doktor Omer Nishani, nënkryetarë Baba Faja Martaneshi, Hasan Pulo e Koçi Xoxe.

Kishte kaluar ora 8 e mbrëmjes.

- Do të vazhdojmë sot a nesër me zgjedhjen e Komitetit? - pyeti Nako Spiru.

- Zgjedhjet e Komitetit mendoj t'i bëjmë nesër, - propozova unë, - sepse ato mund të zgjatën dhe veç kësaj kemi për të shqyrtuar edhe disa ligje të tjera.

Propozimi im u pranua. Dolëm të gjithë së bashku nga salla e mbledhjes dhe ashtu grupe-grupe kaluam nëpër rrugët e qytetit që ishte plot gjallëri nga populli, nga partizanët e delegatët. Shumë njerëz qenë mbledhur në sheshin kryesor, ku jepeshin shfaqje me këngë, me valle, me skeçe të shkruara nga shkrimtarët tanë, të cilët edhe ata punonin e luftonin për çlirimin e Shqipërisë. Po nuk mund të rrinim shumë, ashtu siç dëshironim, mes miqve e shokëve, se, ndonëse ishim në «kohën e

lirë», prapë kishim shumë punë për të bërë. Në një nga ato mbrëmje «të lira» thirra edhe Mehmet Shehun të bisedoja me të për disa probleme që kishin dalë në brigadën që komandonte, sidomos për marrëdhëniet e tij me shokë të tjerë të brigadës.

Pak kohë më parë më kishte ardhur një letër nga një kuadër drejtues i Brigadës I Sulmuese, i cili ankohej për qëndrimet nënvleftësuese, përcmuese e despotike që mbante Mehmet Shehu ndaj tij dhe ndaj një numri shokësh të tjerë.

Për këto, si dhe për ndërhyrjet, pakënaqësitë e batutat e çuditshme që lëshonte herë pas here bile edhe gjatë punimeve të Kongresit, e thirra, pra, në një takim të veçantë dhe i tërhoqa vërejtjen për këto shfaqje të papajtueshme me figurën e një komandanti të një njësie partizane. I folta, mes të tjerash, edhe për raportet midis komandantit e komisarit e për marrëdhëniet e tyre me shokët e tjerë, qofshin këta funksionarë apo jo, duke i shpjeguar edhe dëmin që i sillnin Partisë dhe Luftës Nacionalçlirimtare pikëpamjet e veprimet e tij.

Siç kam shkruar diku më parë, kur ishte si komandant i Brigadës I Sulmuese Mehmet Shehu ishte kritikuar ashpër për veprimet e tij sektare, në kundërshtim me vijën e Partisë, si në Myzeqe, ashtu edhe në Çermenikë gjatë mësymjes së përgjithshme armike të dimrit. Gjithashtu e kishim kritikuar për pikëpamjen e shtrembër e nënvleftësuese që shprehte në një letër në lidhje me caktimin nga Shtabi i Përgjithshëm të një ish-oficeri të lidhur me Luftën Nacionalçlirimtare në një detyrë ushtarake të rëndësishme. Mehmet Shehu, në kundërshtim me vijën e drejtë që ndiqte Partia jonë ndaj ish-oficerëve të ushtrisë së vjetër me prirje e qëndrime përparimtare e revolucionare, i quante këta me përcmim «zabitë» dhe shprehej kundër ngritjes së tyre në përgjegjësi të ndryshme!

Mehmet Shehu «pranoi» gabimet, bëri «autokritikë» dhe premtoi se të tilla gjëra «nuk do të përsëriteshin më». Më pas më drejtoi edhe një letër, ku më shkruante se e kishte gjithmonë parasysh bisedën që kishim bërë në Përmet. Por nuk do të thahej akoma boja nga kjo letër, kur Mehmet Shehu, në vazhden e veprimeve të tij agenturore, do të kundërshtonte urdhrin për kalimin e Divizionit I në Veri, kurse ca më pas, në dhjetor të vitit 1944, në një letër drejtuar Komitetit Qendror të Partisë ose, më saktë, Koçi Xoxes (sepse këtij i adresohet me emër), Mehmet Shehu do të derdhte gjithë vlerin ndaj Partisë sonë, vijës dhe udhëheqjes së saj të shëndoshë, plotësisht në frymën dhe në unison me akuzat që Velimir Stoiniçi, Koçi Xoxe, Sejfulla Malëshova e të tjerë kishin derdhur në Plenumin e Beratit, në nëntor të atij viti. Për të gjitha këto kam shkruar hollësisht gjetkë (Shih: Enver Hoxha. «Titistët» (Shënime historike), f. 548.), këtu dua vetëm të vë në dukje se, veç të tjerash, kjo letër, drejtuar Koçi Xoxes, shpjegon në njëfarë mase edhe arsyen se pse Mehmet Shehu gjatë punimeve të Kongresit të Përmetit, si edhe më pas, ishte aq «i pizmosur» e «nervoz» (në letrën e shkruar me dorën e tij, ankohet se ishte i pakënaqur që nuk iu dha grada e gjeneralit e nuk u caktua në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë sonë!).

Por le të kthehemi përsëri te ditët e zjarrta e të paharruara kur vazhdonte punimet Kongresi.

Pas mbledhjes së parë të Kryesisë së KANÇ-it, të nesërmen në mëngjes, u mbledhëm për të vazhduar punën për caktimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, pra, të së parës Qeveri Demokratike të Shqipërisë. Mbledhjen e kryesonte Omer Nishani, i cili u dha fjalën anëtarëve të Kryesisë për të bërë propozimet përkatëse.

I pari u ngrit Ramadan Citaku, i cili propozoi që Komiteti të kishte 11 dikastere: për Punët e Brendshme, për Punët e Jashtme, të Ekonomisë, të Rindërtimit, të Drejtësisë, të Financave, të Shtypit e të Propagandës, të Arsimit, të Shëndetësisë, të Luftës, të Punëve Botore.

- Kisha për të propozuar edhe emra, - tha ai më në fund.

- Dale njëherë të merremi vesh për numrin e dikastereve, - ndërhyri Omer Nishani.

Sigurisht, për çështjet e organizimit të aparatit shtetëror, për Qeverinë etj. kishim biseduar shumë herë që më parë, kishim shkëmbyer mendime e kishim vrarë mendjen, sepse kjo punë për shumicën e shokëve që terra incognita, pothuajse asnjë nga ne më parë nuk kishte pasur të bënte me këto çështje. Sigurisht, njihnim në përgjithësi ç'ishin organet legjislativë e ato ekzekutive, dinim pak a shumë disa aspekte të organizimit shtetëror, strukturën e organeve lokale të pushtetit etj. Kishim lexuar për format e ndryshme të regjimeve në vendet e tjera, për monarkitë, për format e ndryshme të republikave borgjeze, ishim interesuar të dinim sa më shumë sidomos për organizimin e shtetit

socialist sovjetik. Kishim mes nesh Omer Nishanin, i cili kishte një kulturë të mirë juridike dhe njëfarë eksperience në punët e administratës shtetërore dhe tek ai drejtoheshim për shumë çështje, e ky, kur i njihte, na jepte udhë, kur ngecte. vriste edhe ai mendjen bashkë me ne. Mendonim se do të na jepnin ndonjë gjë nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik Sejfullai e Koço Tashkoja, po këta vetëm teorira të jepnin, sidomos Sejfullai që në këtë drejtim i kishte më të mëdha pretendimet, po që në mjaft raste veç oportunitetit, demonstronte edhe nulitetin e tij.

Mbështeteshim edhe te njëfarë përvoje që kishim grumbulluar gjatë punës për forcimin e centralizimit e këshillave nacionalçlirimtarë. Kjo përvojë ishte shumë e dobishme në bazë, në terren, por, për sa u përket organeve të larta, këtu ishim më të varfër në eksperiencë. Deri atëherë kishim vetëm përvojën e një periudhe të shkurtër, atë të pas Konferencës së Labinotit, ku, si të thuash, kishim bërë një hap përpara, duke i caktuar Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm disa funksione e kompetenca që i jepnin asaj ti paret e një qeverie fillestare; kishim krijuar edhe disa seksione për të drejtuar fusha të ndryshme të veprimtarisë së pushtetit tonë. Por shumë gjëra ende s'i dinim mirë. Për shembull, Baca, në bazë të bisedave e diskutimeve që kishim bërë më parë, propozoi numrin e dikastereve dhe i emërtoi ato. Po a i kishim menduar mirë dhe a i kishim plotësisht të qarta detyrat dhe funksionet e këtyre dikastereve? Ne mendonim se po, dhe, në përgjithësi, struktura që përcaktuam, me ndonjë modifikim, e justifikoi veten. Po ndodhte që kur ne kujtonim se e kishim zgjidhur këtë problem, ngrihej ndonjë nga shokët e Kryesisë e pyeste:

- Ç'është ky dikaster i Rindërtimit?

- Ky do të merret me rindërtimin e objekteve të shkatërruara nga lufta, - shpjegonte Baca, - me shtëpitë, urat etj.

- Po mirë, po ne kemi edhe një dikaster për Punët Botore, edhe një për Ekonominë, - pyeste një tjetër. - Mos përplasen me njëri-tjetrin?!

E diskutonim përsëri një problem të tillë dhe jo vetëm i përgjigjeshim një pyetjeje a një vërejtjeje, po qartësonim më mirë edhe veten, përcaktonim detyrat e një dikasteri në mënyrë më të plotë e më të qartë. Kështu këto diskutime e debate bëheshin për ne një lloj kursi teorik për organizimin dhe strukturën e shtetit të ri.

Sidomos për punën e emërtimeve të dikastereve «u hëngrëm» për një kohë të gjatë.

- Pse ta quajmë «dikasteri i luftës»? - pyeste Sejfulla Malëshova. - Ne nuk jemi për luftë, prandaj ta quajmë «dikasteri i mbrojtjes popullore», dhe gjeti rast për të na folur për karakterin e luftës sonë sot e në të ardhmen, për politikën e jashtme të shtetit etj., etj.

- Po mirë atëherë, le ta quajmë dikasteri i Luftës dhe i Mbrojtjes Kombëtare, - u propozua dhe u aprovua.

Po kështu debate pati a duhej thënë «dikasteri i shtypit e i propagandës» apo i kulturës popullore», i ekonomisë» apo «i ekonomisë popullore» etj.

Pasi e kapërcyem këtë problem kaluam në propozimet për përbërjen e Komitetit Antifashist. Një nga shokët propozoi listën e përbërë nga 12 veta, një kryetar i Komitetit, i cili do të ishte i ngarlkuar edhe me drejtimin e dikasterit të Luftës e të Mbrojtjes, një nënkryetar dhe të tjerët anëtarë të Komitetit që do të drejtonin nga një dikaster.

- Ka njeri ndonjë propozim tjetër? - pyeti doktor Nishani.

- Mendoj të kemi dy nënpresidentë të Komitetit, - tha Mustafa Gjinishi. - Propozoj për major Spiro Moisiun, caktimi i të cilit tingëllon nnië edhe sepse është ortodoks!

- Spiro Moisiu është komandant i Shtabit të Përgjithshëm dhe s'mund të marrë edhe këtë funksion, - ishim të një mendjeje unë dhe Omerr Nishani.

- Në luftën tonë nuk mund të marrim parasysh a është ortodoks a mysliman ai që propozohet. Këtu do të nisemi nga kriteri i punës, zotësia, verzdosmëria etj., - u hodh Sejfullai dhe hodhi një herë sytë rreth e rrotull.

Omer Nishani qeshi nën buzë, se e kuptoi që Sejfullai e kishte hallin te kandidatura e tij.

- Mendoj se tani për tanfi s'është nevoja për më shumë se një nënkryetar të Komitetit, - tha ai, - kështu që të mbetemi vetëm me kandidaturën e babë Myslimit.

- E tërheq propozimin tim, - tha Gjinishi.

Pati edhe diskutime të tjera dhe ishte e arsyeshme dhe e nevojshme të diskutohej, se për këtë punë qemë mbledhur, që në Komitet të zgjidhnim shokë nga më të mirët, por edhe të aftë, të zotë, që të ishin në gjendje të drejtonin. Po herë-herë në vërejtjet dhe diskutimet e disa anëtarëve të Kryesisë nxirrnin krye edhe tendenca të shtrembra e prirje personale drejt posteve.

- Pa të shohim pak a shkon dr. Nishani të jetë edhe kryetar i Kryesisë, edhe i ngarkuar me Punët e Jashtme? - ndërhyri Liri Gega dhe menjëherë Koço Tashkoja i mbajti tonin:

- Detyra «i ngarkuar me Punët e Jashtme» mos e lë në dorë të dytë detyrën e Kryesisë së Këshillit?

- Edhe mua më duket se nuk shkojnë të dyja bashkë, - ngriti supet Omer Nishani, modest, por edhe skrupuloz në gështjet juridike.

Në unison me Lirinë dhe Koçon edhe Sejfullai kujtoi se u bë deti kos dhe u hodh në sulm drejt «portofolit» të ministrit të Jashtëm. Kështu u bënë tre kandidatura për këtë portofol dhe secili prej tyre mendonte se ishte vetë rni i përshtatshmi.

Për të sqaruar se pse ne propozonim kandidaturën e Omer Nishanit ndërhyra edhe unë e u thashë:

- Mendoj se kandidatura e doktor Nishanit, sidomos aktualisht, është e përshtatshme për dikasterin e Punëve të Jashtme. Për momentet në të cilat ndodhet vendi ynë nuk ka ndonjë të keqe, përkundrazi do të ndikojë mirë në popull fakti që një figurë e tillë e njohur si shoku Omer Nishani, kryetar i Kryesisë së KANÇ-it, të jetë edhe anëtar i Qeverisë.

Po ashtu kishim gjykuar se doktor Nishani, si një personalitet demokrat, i njohur brenda e jashtë, me reputacionin dhe me punën e tij do të shërbente shumë për forcimin e lidhjeve tona me jashtë. Disa vite më pas, më 1947, kur vajta në Bullgari, në krye të një delegacioni qeveritar, për të nënshkruar Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke në mes RP të Shqipërisë dhe RP të Bullgarisë, gjatë takimeve e bisedave në Sofje e gjetkë me Dimitrovin, mora vesh se edhe ai e njihte dhe e respektonte Omer Nishanin. Dimitrovi kishte njohur mirë edhe Halim Xhelon, po kështu edhe Ali Kelmendin e veprimtarinë e tij, si komunist dhe si anëtar i Kominternit, dhe më shprehu keqardhjen që Aliu kishte vdekur. Unë i fola gjatë për emigracionin e dikurshëm «antizogist» dhe për përpjekjet e Partisë sonë për t'i bindur ata të bashkoheshin në luftë sipas direktivave historike që vetë Dimitrovi kishte dhënë si Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Ekzekutiv të Internacionales Komuniste dhe i tregova pastaj se si një pjesë e tyre ranë në batakun e fashizmit. I paharruari Dimitrov më tha: «Vija e Partisë suaj ka qenë e drejtë» dhe plaku u gëzua kur i thashë për Nolin e doktor Nishanin që kishin mbajtur qëndrim të mirë. Për mua ishte gëzim i veçantë që një personalitet i tillë si Dimitrovi e njihte dhe u interesua për doktorin, të cilin ne e kishim atëherë edhe Kryetar të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Kështu, pra, ne këmbëngulëm dhe më në fund u vendos që emri i Omer Nishanit të mbetej në listë, si kandidat për të drejtuar dikasterin e Punëve të Jashtme.

- Atëherë ta vëmë në votë listën një për një dhe *en groupe*, - e mori fjalën Omer Nishani.

- Një minutë, - u hodh dikush nga të pranishmit. - Si do të quhen shokët anëtarë të Komitetit që do të drejtojnë dikasteret?

Tjetër «telash» ky, tjetër rast për arsyetime të «teoricienëve» tanë! «Do të vazhdojmë edhe ndonjë orë me këtë çështje», mendova me vete, prandaj propozova:

- Të quhen: anëtarë të Komitetit, të ngarkuar me punët e ekonomisë, të arsimit e kështu me radhë.

- I ngarkuar me punë, - rrudhi buzët Sejfullai, - nuk më duket se tingëllon mirë.

- Si propozon ti? - e pyeta.

- Unë do të propozoja «komisar», po kjo do të quhej e majtë, prandaj them të quhen «anëtar i Komitetit për punët. . .». Është pak e gjatë, por e thjeshtë.

- Nuk shoh ndonjë ndryshim nga ajo që propozoi shoku Enver, - tha Ramadan Çitaku.

- Kam një propozim që e di që nuk do të pranohet, - u hodh Nako Spiru. T'i quajmë anëtarët e Komitetit «sekretarë».

- Në Amerikë quhen kështu, - iu ndërsye Sejfullai, kurse Koçi Xoxe, ministri i ardhshëm i Punëve të Brendshme, i vuri «vulën».

- Unë do të thosha më mirë «i besuar»!

Më në fund e kaluam edhe këtë problem dhe u vendos që anëtarët e Komitetit të quheshin «të ngarkuar me punë».

Pas kësaj u hodhën në votë kandidaturat një për një dhe lista në tërësi. Me unanimitet u aprovua Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar me këtë përbërje: kryetar dhe i ngarkuar me punët e Luftës e të Mbrojtjes Kombëtare - Enver Hoxha, nënkryetar - Myslim Peza, anëtar i ngarkuar me Punët e Brendshme Haxhi Lleshi, me Punët e Jashtme - doktor Omer Nishani, me punët e Ekonomisë - doktor Dieder Shtylla, me punët e Rindërtimit - Bedri Spahiu, me punët e Drejtësisë - Manol Konomi, me punët e Financave - Ramadan Citaku, me punët e Shtypit e të Propagandës - Sejfulla Malëshova, me punët e Arsimit - Gjergj Kokoshi, me Punët Botore - ing. Spiro Koleka, me punët e Shëndetësisë - doktor Ymer Dishnica.

Të nesërmen, më 28 maj, ishte dita e mbylljes së Kongresit Antifashist të Përmetit. Seanca përfundimtare, ku do të aprovohej vendimet historike për popullin shqiptar, u la të zhvillohej pasdite: në mbrëmje delegatët do të festonin bashkë me popullin patriot e mikpritës të Përmetit, do të përshëndeteshin e do të ndaheshin me të, që të nesërmen në mëngjes secili të nisej për atje ku e thërriste detyra ndaj atdheut.

Një atmosferë optimiste dhe e gëzuar zotëronte atë ditë. Ajo ndihej në shtëpitë përmetare, në rrugë, lexohej në fytyrat dhe në sytë e qeshur të shokëve delegatë, komandantë e komisarë, të cilët vinin e na takonin për çështje pune, sillnin raporte e informacione, merrnin urdhra e udhëzime e niseshin të gatshëm në detyrë. Ndërkohë vinin edhe të tjerë, për takime e biseda të lira, vinin miq e shokë për t'u çmallur e për t'u përshëndetur se «ku i dihet, mbase nuk shihemi më». Sikurse edhe shokët e tjerë, edhe unë kisha shumë punë dhe nuk më vinte mirë t'i ndërprisja ato po, kur haoej dera e hynte në dhomë, bie fjala, Hasan Puloia, e më ftonte për një kafe e për një duhan, nuk rrezitesha se nga këto tahime me shokët e dashur e njerëz të mirë të popullit të freskohet mendja, të gëzohet zemra, të shtohet vullneti për punë.

Pasdite, kur hymë në sallë, delegatët, që kishin zënë vend e këndonin grupe-grupe, na pritën me duartrokitje e ovacione për Partinë, për Frontin e për Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Nuk pushonin ato për minuta të tëra, sado qui Omer Nishani, edhe vetë i emocionuar, i ftonte delegatët të vendosnin qetësinë. Më në fund, kur u vu elisi «rregulli», doktori shpalli hapjen e seancës dhe i dha fjalën sekretarit të Kryesisë së KANÇ-it për të lexuar projektvendimet që do t'i aprovohej përfundimisht Kongresi. Leximi i projektit, që normalisht nuk do të dente as një orë, zgjati shumë më tepër, se duartrokitjet shpërthenin pas çdo vendimi, bile edhe midis tyre, për nene të veçanta. Si të mos brohoritnin me gjit: hë zemër të dërguarit e këtij populli që kishte luftuar në shekuj për Tiri e drejtësi, kur dëgjonin: «Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit!»! Ata shikonin në to kurorëzimin e! luftës së gjatë e të vështirë, qëllimin për të cilin mijiëra e mijëra shokë të tyre kishin derdhur gjakun, kishin dhënë rininë dhe jetën e tyre. Me unanimitet aprovuan ata edhe vendimin që Ahmet Zogut, satr apit e tradhtarit të popullit shqiptar dhe familjes së tij, t'i ridalohej hyrja në Shqipëri. U lexua ky vendim dhe Onzer Nishani, që drejtonte seancën, pyeti:

- A e aprovon Korvgresi?

Në sallë këtë herë nuk pati duartrokitje. Delegatët e shprehën mendimin e tyre me thirrjet «Poshtë Zogu!» dlie me përplasje të këmbëve. Njëzëri i aprovoi Kongresi edhe vendimet e tjera p.l.r mosnjohjen e asnjë qeverie tjetër që mund të formohej brenda ose jashtë vendit, për vazhdimin dhe ashpërsimin e luftës kundër pushtuesve, kuislingëve, Ballit Kombëtar, Legalitetit e çdo grupi tjetër reaksionar. Kongresi, gjithashtu, aprovoi vijën politike të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe veprimtarinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shprehu dëshirën që pranë tij të vinin misionet ushtarake të Bashkimit Sovjetik e të SHBA-së. Pastaj Kongresit iu lexuan edhe vendimet e tjera të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar e të Kryesisë së tij, mes të cilave edhe ato për rishikimin e prishjen e të gjitha marrëveshjeve politike e ekonomike skllavëruese të Zogut me vendet e tjera, për funksionet e kompetencat e KANÇ-it e të Kryesisë së tij etj.

Me duartrokitje e ovacione u prit nga delegatët vendimi i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për emërimin dhe përbërjen e Komitetit Antifashist me funksionet e një qeverie provizore.

Kështu, me këto vendime të një rëndësie historike, që hapnin një epokë të re të ndritur në historinë e lashtë të popullit shqiptar, Kongresi Antifashist i Përmetit kreu misionin e tij historik. Me grushtin e tyre të ngritur lart, ashtu siç përshëndetnim njëri-tjetrin në luftë për liri, delegatët vulosën aktet themelore që shënonin lindjen e shtetit të ri shqiptar dhe ravijëzonin konturet e rrugës në të cilën do të ecte Shqipëria në të ardhmen. E gjithë fryma revolucionare e Kongresit të Përmetit, përvoja e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, bashkë me vendimet historike që u morën, ishin pasqyruar në Deklaratën e Kongresit, të cilën e lexoi Sami Baholli dhe u përshëndet e u aprovua njëzëri.

Në këtë Deklaratë, e cila shpejt do t'i bëhej e njohur gjithë popullit, sintetizohej lufta e popullit shqiptar që nga 7 prilli 1939, etapat dhe momentet themelore të saj, konstatohej roli antikombëtar e antipopullor i regjimit të Zogut, i qeverisë kuislinge, i tradhtarëve dhe i kolaboracionistëve ballistë, zogistë e të tjerë, vihej me forcë në dukje roli udhëheqës e frymëzues i Partisë Komuniste në Luftën Nacionalçlirimtare. Në analizën e faktorëve të jashtëm, në Deklaratë theksohej lufta e popujve sovjetikë dhe e Ushtrisë së Kuqe nën udhëheqjen e Stalinit si faktori kryesor i fitores së koalicionit antifashist të popujve, vlerësohej drejt lufta e anglo-amerikanëve si dhe ajo e popujve të Ballkanit.

Pas leximit të Deklaratës dhe të disa mesazheve, në mbyllje e mora fjalën unë me cilësinë e kryetarit të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar.

- Ky Kongres, - thashë mes të tjerash në fjalimin tim të shkurtër, - është një nga sukseset më të mëdha të lëvizjes sonë, është tribuna ku për herë të parë në Shqipëri shfaqen lirisht mendimet dhe dëshirat e popullit, ku u morën vendime me rëndësi për fatin e atdheut tonë, për zhvillimin e luftës dhe për krijimin e një të ardhmeje të lumtur.

Të ndërgjegjshëm për barrën e rëndë që populli shqiptar na ngarkon, - vazhdova më poshtë, - do të vëmë të gjitha forcat tona dhe jetën tonë në shërbim të popullit dhe të atdheut, do t'i qëndrojmë besnikë deri në vdekje vullnetit të popullit tonë për realizimin e një Shqipërie independente e demokratike.

Vendimet e këtij Kongresi t'i çojmë menjëherë në popull, bashkë me të të luftojmë që t'i zbatojmë pa kursyer as jetën, të mobilizojmë të gjitha forcat e gjalla të popullit dhe, të bashkuar rreth Këshillit e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, të hidhemi më me hov në luftë për të shpejtuar çlirimin e popullit tonë!

Pas fjalës sime të gjithë delegatët njëri pas tjetrit vunë nënshkrimin e tyre poshtë vendimeve që ishin përmbledhur në Librin e Kongresit, në atë libër ku, në mënyrë simbolike, kemi vënë firmat sa herë kemi vajtur në Përmet, në përvjetorët e kësaj ngjarjeje të lavdishme.

Kështu u mbyll Kongresi i Përmetit, një nga ngjarjet më të rëndësishme të epopesë së Luftës sonë Nacionalçlirimtare, një monument i ngritur nga lufta dhe mençuria e Partisë dhe e popullit, një vepër e madhe me rëndësi kolosale për të ardhmen e Shqipërisë.

Në Përmet Shqipëria, e udhëhequr nga Partia e saj heroike Komuniste, u tregoi miqve dhe armiqve se ishte e patundur në rrugën e saj të drejtë. Hesapet nuk bëheshin më si dikur, ato kohë kishin kaluar për të mos u kthyer më kurrë. Historia s'përsëritej më si donin ata: populli ishte bërë zot i fateve të veta.

3. Drejt fitores përfundimtare

Menjëherë pas Kongresit të Përmetit u vendosëm në Odriçan, një fshat i ndërtuar mbi një brinjë, jo larg Përmetit, ndonjë orë a dy më këmbë. Odriçani ishte i vogël, por i këndshëm, me ujë të freskët dhe me pe më. Armiku nuk e kishte djegur, prandaj kishim dhe ku të rrinim. Banorët e tij na pritën krahëhapur dhe të gjithë na rregulluan nëpër familjet e tyre. Mua më caktuan në një shtëpi në krye të fshatit, i zoti dhe e zonja e së cilës ishin patriotë, ashtu sikurse i gjithë fshati ishte i lidhur me

Partinë e me Frontin Nacionalçlirimtar dhe e urrente Ballin Kombëtar, Ali Beun dhe babain reaksionar të teqesë së Sukës që ndodhej aty pranë. Të zotët e shtëpisë, sidomos nënë Vitori Jorgji, s'dinin ç'të më bënin më parë që të më kënaqnin e të më krijonin kushte për punë e për pushim. Pas Çlirimit plakun e kam takuar disa herë në Përmet kur kam vajtur për përvjetore të Kongresit. Tash nuk e di në rrojnë akoma ata njerëz të mirë, kurse djali i tyre, që atëherë ishte i vogël, më kanë thënë që është kuadër i mirë dhe sot punon në organet e pushtetit në Përmet.

Ngjitur me shtëpinë e nënë Vitorisë, ishte shtëpia e nënë Koces, si i thërritnin në fshat dhe si i thirrëm edhe ne, Kostandina Londarit. Shkoja shpesh për të punuar ose për të ndenjtur edhe në shtëpinë e nënë Koces, e cila sa më shihte më pyeste mos kisha nevojë për gjë, me një dashuri dhe dhimbsuri nënë. Nuk kishte fëmijë, por, për sa kohë punuam në Odriçan, ajo na bëri të gjithë fëmijë të saj, bile, për nevoja pune na liroi tërë shtëpinë dhe vetë shkoi te një kuzhinë e vogël, në oborr. Për këtë nënë të dashur ruaj në zemër dashurinë më të madhe dhe kujtimet më të bukura.

Qysh gjatë ditëve që zhvillonte punimet Kongresi, por sidomos pasi u vendosëm në Odriçan diskutuam me hollësi për gjendjen politike dhe ushtarake të vendit dhe morëm masa e vendime të reja për forci min e mëtejshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, për krijimin e brigadave të reja, të divizioneve dhe korparmatave etj.

Një ndër vendimet më të rëndësishme të ditëve kur ne ndodheshim në Përmet ishte edhe ai për krijimin e Divizionit I të UNÇSH, fakt ky që fliste për shkallën e lartë të pjekurisë e të organizimit që kishte arritur ushtria jonë.

Me krenari të ligjshme tash Partia dhe populli shihnin se si ishte rritur e forcuar në zjarrin e luftës për Tiri ushtria jonë heroike, e cila ishte bërë e dashur për popullin dhe tmerr për armikun. Në këtë periudhë në vendin tonë vepronin e kryenin operacione të fuqishme luftarake brigadat sulmuese, shumica e të cilave ishin formuar pas mësymjes së përgjithshme armike të dimrit, si dhe dhjetëra batalione, çeta e njësite të rregullta ose territoriale, në krye të të cilave militonin komandantë, komisarë e kuadro të tjerë politikë e ushtarakë të sprovuar, si: Hysni Kapoja, Shefqet Peçi, Adil Çarçani, Haki Toska, Manush Myftiu, Ramiz Alia, Rita Marko, Teki Kolaneci, Jaho Gjoliku e dhjetëra të tjerë.

Radhët e formacioneve tona luftarake mbusheshin pa pushim me djem e vajza të popullit, bile edhe me të moshuar, gjë që fliste qartë për forcën dhe autoritetin e padiskutueshëm që gëzonte në popull ushtria jonë çlirimtare. Ajo jo vetëm po i thyente kudo forca, naziballiste e po çlironte njëra pas tjetrës qytete, krahina e zona të tëra, por, ashtu si edhe më parë, bile më me forcë, po luante një rol shumë të madh për forcimin e këshillave nacionalçlirimtarë, për funksionimin sa më mirë të tyre, për mbrojtjen dhe afirmimin e pushtetit të ri që tashmë kishte marrë frenat e Shqipërisë në dorë.

Nuk do të kalonte shumë kohë dhe në vrullin e paparë të kryengritjes së përgjithshme të armatosur, ne do të formonim divizione të tjera, si dhe Korparmatën I të UNÇSH, komisar i së cilës u caktua djali trim i Labërisë, besniku i Partisë, Hysni Kapoja.

Kështu populli ynë, Partia dhe Qeveria e sapokrijuar në Përmet kishin në duart e veta armën dhe mbrojtësen e tyre të fuqishme, Ushtrinë Nacionalçlirimtare, e cila tashmë ishte shndërruar në ushtri të rregullt dhe kishte perfeksionuar e po perfeksiononte pareshtur edhe mënyrat e format e luftimit.

Të gjitha këto bënë të mundur që kudo të planizoheshin e të kryheshin operacione të koordinuara të masshtabeve të mëdha dhe të kalohej nga taktika e luftës partizane, në taktikën e luftës frontale.

Në këtë kuadër hyn edhe urdhri që i dhamë në ditët pas Kongresit historik të Përmetit Divizionit I të UNÇSH që të hidhej në sulm në Veri për të goditur e për të shpartalluar okupatorin e gjithë reaksionin, ballistët, zogistët e bajraktarët në Mat, Dibër e gjetkë.

Ky urdhër kishte rëndësi të veçantë, sepse do të bënte të mundur që Qeveria e krijuar në Përmet të ushtronte pushtetin e saj edhe në Veri, ku, sidomos në disa zona, reaksioni i brendshëm, i mbështetur e i frymëzuar nga anglezët, përpiquej të ruante pozita dominuese e të mbante në duar pushtetin e vjetër. Siç kam shkruar edhe gjetkë, synimet e reaksionit arrinin gjer atje sa të mendonte e të planifikonte edhe një «ndarje më dysh» të Shqipërisë dhe në këtë «ndarje» Shqipëria e Veriut të mbetej nën pushtetin e Ballit, të Legalitetit e nën influencën angleze!

Por edhe në këtë synim reaksioni gabonte. Pavarësisht nga pushteti i bajraktarëve apo i klerit, Lëvizja Nacionalçlirimtare kishte në Veri, nga Tropoja e deri në Shkodër, nga Dibra e deri në Mat e Mirditë, pikëmbështetjet e saj të fuqishme. Populli i atyre anëve, i cili vuante nga shtypja e bajraktarëve, klerikëve reaksionarë, sidomos të kishës katolike, ziente nga dëshira për të transformuar jetën dhe për të qenë i lirë. Kjo dëshirë përputhej plotësisht me luftën që bënte Partia, prandaj përditë e më shumë shtojte rezistenca ndaj të huajve dhe veglave të tyre, përditë e më shumë populli po e kuptonte se te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare qëndronte e ardhmja e tyre dhe rruga që duhej të ndiqnin. Zhvillimi i ngjarjeve do të vërtetonte drejtësinë e vijës së Partisë dhe do të bënte që, si kudo, të shkëlqente edhe trimëria dhe guximi i bijve të krahinave të thella të Veriut.

Që në fillim në zonën e Veriut vepronin njësite dhe çeta partizane, si ajo e Dibrës, e Shkodrës, e Hasit, e Matit, e Çermenikës, e Martaneshit, të cilat erdhën duke e shtuar aktivitetin e tyre dhe dulce e shtrirë atë gjithandej.

Çetat dhe më vonë batalionet partizane, si Batalioni i Dibrës, batalioni «Perlat Rexhepi», batalioni «Bajram Curri», Batalioni i Matit etj., kishin korrur disa fitore në Dibër, në Tropojë, në Malësi të Gjakovës, në Malësi të Madhe, në Mat e në Martanesh. Me komandantë e luftëtarë të tillë patriotë e trima, si: Ismail Poga, Din Bajraktari, Dulejman Çela, Idriz Mulosmani e të tjerë, këto njësite jo vetëm ua kishin bërë jetën të padurueshme pushtuesve italianë, gjermanë e reaksionarëve vendas, të lidhur me të huajt, por herë pas here, me kërkesën e vëllezërve të Kosovës e me urdhrin tonë, kishin kaluar edhe në thellësi të Kosovës e të Malit të Zi në ndihmë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të popullsisë shqiptare të atyre anëve dhe të popujve jugosllavë.

Po kështu, bijtë më të mirë të Veriut vepronin dhe militonin kudo në Shqipëri, atje ku i kishte caktuar Partia, duke treguar trimëri, zgjuarsis dhe devotshmëri të lartë. Ata do t'i gjeje nëpër brigadat partizane, në krye të qarkorëve, agjitorë të flaktë të vijës së Partisë, ilegalë sypatrembur, atentatorë të guximshëm, komunistë të zjarrtë.

Duke pasur parasysh gjithë këtë luftë që po bënte populli i Veriut, duke pasur parasysh edhe patriotizmin e thellë të popullit, ne ishim të bindur, se, sado që reaksioni dhe të huajt të përpiqeshin të ndanin Veriun nga pjesa tjetër e atdheut, nuk do t'ia arrinin kurrë këtij qëllimi.

Por pavarësisht se «ide» e «plane» të tilla dëshmonin për gjendjen e mjeruar e për çakërdisjen që kishte mbërthyer reaksionin, prapëseprapë neve s'na lejohej të nënvleftësonim asgjë dhe nuk duhej të humbitnim asnjë minutë. Prandaj bashkë me urdhrin për mësymjen në Veri, ne u rekomanduam shokëve të Partisë të ishin të pamëshirshëm me krerët e reaksionit dhe shumë të dashur e zemërhapur me popullin e Veriut, të bënin kuj des e të mos humbitnin kurrë durimin, pasi duhej të kishin gjithnjë parasysh propagandën e poshtër, që kishte bërë në popull pushtuesi dhe reaksioni. Me luftën tonë, me qëndrimin tonë dhe bërë jetën të padurueshme pushtuesve italianë, gjermanë e reaksionarëve vendas, të lidhur me të huajt, por herë pas here, me kërkesën e vëllezërve të Kosovës e me urdhrin tonë, kishin kaluar edhe në thellësi të Kosovës e të Malit të Zi në ndihmë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të popullsisë shqiptare të atyre anëve dhe të popujve jugosllavë.

Po kështu, bijtë më të mirë të Veriut vepronin dhe militonin kudo në Shqipëri, atje ku i kishte caktuar Partia, duke treguar trimëri, zgjuarsis dhe devotshmëri të lartë. Ata do t'i gjeje nëpër brigadat partizane, në krye të qarkorëve, agjitorë të flaktë të vijës së Partisë, ilegalë sypatrembur, atentatorë të guximshëm, komunistë të zjarrtë.

Duke pasur parasysh gjithë këtë luftë që po bënte populli i Veriut, duke pasur parasysh edhe patriotizmin e thellë të popullit, ne ishim të bindur, se, sado që reaksioni dhe të huajt të përpiqeshin të ndanin Veriun nga pjesa tjetër e atdheut, nuk do t'ia arrinin kurrë këtij qëllimi.

Por pavarësisht se «ide» e «plane» të tilla dëshmonin për gjendjen e mjeruar e për çakërdisjen që kishte mbërthyer reaksionin, prapëseprapë neve s'na lejohej të nënvleftësonim asgjë dhe nuk duhej të humbitnim asnjë minutë. Prandaj bashkë me urdhrin për mësymjen në Veri, ne u rekomanduam shokëve të Partisë të ishin të pamëshirshëm me krerët e reaksionit dhe shumë të dashur e zemërhapur me popullin e Veriut, të bënin kuj des e të mos humbitnin kurrë durimin, pasi duhej të kishin gjithnjë parasysh propagandën e poshtër, që kishte bërë në popull pushtuesi dhe reaksioni.

Me luftën tonë, me qëndrimin tonë dhe me fjalën tonë ne duhej t'i tregonim popullit në Veri se nuk ishim siç shpifnin tradhtarët e bajraktarët, sig shpifte Abaz Kupi me shokë, por, përkundrazi, ishim çlirimtarët e vërtetë dhe ata që e kishim sjellë popullin në fuqi.

Pikërisht në ato ditë filloi edhe operacioni i dytë i

madh armik, Operacioni i Qershorit, i cili e pengoi për një kohë zbatimin e urdhrit që kisha nënshkruar në Përmet për kalimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në mësymje të përgjithshme. Operacioni i Qershorit qe një provë tjetër e vështirë e forcës, e guximit dhe e mençurisë së partizanëve, e komisarëve dhe e komandantëve tanë, si dhe e aftësisë së Partisë e të Komandës së Përgjithshme për të drejtuar Ushtrinë Nacionalçlirimtare.

Edhe ne që ishim vendosur në Odrichan ndodheshim brenda zonës së ofensivës armike dhe në çdo çast mund të bëheshim objekt i një sulmi, sidomos po qe se gjermanët e ballistët merrnin vesh se këtu qe vendosur udhëheqja e Partisë dhe Komanda e Përgjithshme. Prandaj u kishim dhënë porosi shokëve si edhe banorëve të fshatit që të ruanin konspiracionin më të rreptë, njëkohësisht kishim marrë masat që në rast rreziku të shpërngulehim me shpejtësi.

Një natë vijnë me urgjencë Behar Shtylla dhe Stefo Grabocka e më lajmërojnë se forca gjermane ishte drejtuar për në Përmet, duke çarë nëpër malësinë e Korqës. Mora hartën, shënuam vendin nga ishin nisur gjermanët, kohën kur ishin nisur dhe llogaritëm kur mund të kalonin nga Odrichani ose aty afër. Na mbeteshin vetëm disa orë kohë. Lajmëruam batalionin e Riza Kodhelit, me komisar Misto Treskën, që të afrohej e të zinte me shpejtësi pyllin përballë Odrichanit, mbi rrugën që të çonte në Alipostivan dhe karshi rrugës që dilte nga fshati Pagri. Morëm masa për të vendosur në një vend të sigurt gratë, fëmijët e pleqtë dhe ne të Komandës së Përgjithshme kaluam të fundit matanë Odrichanit. Thirra Riza Kodhelin dhe Misto Treskën, të cilët më raportuan ku i kishin vendosur forcat, dhe u dhashë urdhër të gjithëve që asnjë të mos qëllonte pa dëgjuar tri të shtënat e Hmauzerit» tim.

Rrinim të gatshëm, në pritje dhe në heshtje. Në rast se gjermanët do të digjnin fshatin, atëherë ishte e sigurt se kishin marrë informata që ne ishim atje dhe se duhej të gjendeshim në pyjet rreth e rrotull, kështu ata do të futeshin në rrugën e Alipostivanit. Gjermanët erdhën, kolona e tyre doli nga Odrichani dhe nga Pagrija, me mushka të ngarkuara me armatim të lehtë dhe me mortaja, vazhdoi udhëtimin dhe doli në rrugën nën pyll. Dy orë të tëra ne i vrojtanim dhe ata na kalonin si në paradë. Nuk dogjën as Odrichanin, as Pagine, por u drejtuan për në Përmet, të cilit i vunë zjarrin për herë të fundit; s'bënë gjë tjetër veç ridogjën gërmadhat. Gjermanët, pra, nuk kishin informata se ne ndodheshim në zonën e operacionit. U rikthyem në Odrichan dhe vazhduam punët.

Çdo mbrëmje, ose në shtëpi, ose në hajatin e kishës së vogël në fund të fshatit, ku zbrisja vetë, i mblidhja shokët dhe i vija në dijeni për situatën dhe ngjarjet e reja dhe këshillohesha me ta. Nga Odrichani ndiqnim edhe zhvillimin e ofensivës gjermane.

Duke ndjekur me kujdes edhe zhvillimin e luftimeve në frontin e Lindjes, ne gjykonim se Gjermanisë naziste i kishte ardhur fundi, ajo po thyhej nën goditjet e tmerrshme dhe vdekjeprurëse të Ushtrisë së Kuqe të Stalinit, nën goditjet e të gjithë popujve që luftonin me heroizëm për liri. Komanda e Përgjithshme tashmë e kishte të qartë se edhe vetë ofensiva gjermane e qershorit 1944 në Shqipëri ishte momenti i drithmës së fundit të bishës që jepte shpirt.

Për t'iu përgjigjur kësaj ofensive në përputhje

me strategjinë tonë dhe me detyrën për çlirimin e shpejtë të gjithë vendit, i orientonim vazhdimisht repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të përballonin operacionin armik me mbrojtje elastike e aktive, duke evituar grumbullimet e mëdha dhe goditjet e armikut, me veprime të vazhdueshme sulmuese kundër forcave gjermane e reaksionare, për t'i lodhur, copëtuar, demoralizuar e asgjësuar në zjarrin e luftës popullor. Në këtë kuadër, edhe urdhri për kalimin e Divizionit I në Veri ishte një goditje e rëndë ushtarake e politike për gjermanët, tradhtarët dhe për qëllimet e planet e «aleatëve». Realizimi i këtij urdhri, me gjithë kundërshtimet e anglezëve dhe sabotimin nga ana e Mehmet Shehut, Dali Ndreut e Tuk Jakovës, shënoi faktikisht fundin e ofensivës armike dhe fillimin e mësymjes sonë të përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Të gjitha këto suksese në frontin e luftës bënë që çdo ditë e më tepër në plan të parë të kalonte puna për organizimin dhe funksionimin e shtetit të ri që sapo kishim krijuar. Veprimtaria e organeve shtetërore të zgjedhura në Kongresin e Përmetit, puna e të cilave për shkak të situatës ushtarake që penguar për një çast gjatë qershorit, menjëherë pas kësaj u shtri në gjerësi e u perfeksionua më tej. Që nga ko rriku e deri në tetor, Kryesia dhe Komiteti Antifashist e dikasteret e tij nxorën një sërë ligjesh, vendimesh e udhëzimesh për organizimin dhe mëkëmbjen e ekonomisë, të arsimit, të shëndetësisë etj. Në zonat e lira filloi puna për evidencimin e pasurive kombëtare dhe për administrimin e tyre, për vënien në shfrytëzim të atyre objekteve të pakta industriale që kishin mbetur nga e kaluara, për hapjen e shkollave, për sigurimin e kuadrove për fushat e ndryshme, si: mjekë, mësues, inxhinierë, teknikë etj. Me veprimtarinë e vet shteti i ri popullor tregonte se ekzistonte jo në kartë, por drejtonte e qeveriste realisht, në emër të popullit, me mbështetjen e përkrahjen e plotë të tij.

Pikërisht në valën e këtyre punëve Partia vendosi që të zhvillohej Kongresi I i Organizatës së BRASH-it. Kjo ishte një ngjarje e madhe jo vetëm për rininë, por edhe për Partinë e për gjithë popullin tonë, sepse rinia ishte forca më e gjallë dhe aktive në luftë dhe nesër, pas Çlirimit, kjo armatë e pamposhtur dhe e organizuar, do të luante një rol të pazëvendësueshëm në gjithë jetën e vendit, në rindërtimin, në fushën politike, në qeverisje. E edukuar me frymën e patriotizmit të lartë, kurdoherë rezervë luftarake e Partisë, ajo do të ishte vazhduesja e stafetës së revolucionit tonë të paparë ndonjëherë në historinë e popullit.

Pikërisht se e vlerësuam kështu, prandaj ne, shokë të udhëheqjes së Partisë, të Komitetit Antifashist e të Kryesisë, që ishim rivendosur përsëri në Helmës, me gjithë punët e shumta, u ndodhëm ato ditë pranë të rejave e të rinjve tanë revolucionarë.

Kongresi do të mbahej në Helmës, në një fushë të bukur mbi fshat. Ishin ditë të gëzuara dhe plot punë.

Nakoja e Nexhmija përgatitën raportin, të cilin pastaj e pamë së toku; shokët e tjerë të rinisë po bënë përgatitjet për të pritur delegatët dhe të gjithë, edhe ne «më të moshuarit», pritnim ditën kur do të hapej Kongresi. Nga të gjitha anët e vendit vinin delegatët e rinisë, zbritnin nga repartet ushtarake, nga çetat, nga terreni, legalë e ilegalë, gjithë zjarr e plot vrull rinor, me një dashuri dhe besnikëri të madhe për Partinë dhe Luftën Nacionalçlirimtare.

Ditën që filloi punimet Kongresi, më 8 gusht, u nisëm që në mëngjes nga Helmësi tok me doktor Nishanin dhe me shokë të tjerë dhe u ngjitëm në fushën e bukur të Lirëzës, që buçiste nga këngët e brohoritjet për Partinë Komuniste të Shqipërisë. Të gjithë delegatët të gëzuar, të qeshur, të lumtur, duke u hapur nga të dyja anët, na liruam rrugën dhe ne kaluam përmes tyre në revistë, si para një truproje nderi, të përbërë nga të reja e të rinj partizanë vendosur përballë njëri-tjetrit në pozicion për nder armë. Zëmë vend në tribunën e Kongresit krahas me shokë të udhëheqjes së rinisë, si: Nako Spiru, Ramiz Alia, Nexhmije Xhuglini, Alqi Kondi, Tasi Mitrushu e të tjerë.

Për një moment u vendos qetësia dhe zëri i kthjellët e plot emocione i një të riu na preku të gjithë:

- Shokë, - tha ai, - në emrin e të gjithë delegatëve që përfaqësojnë rininë e zonave të çliruara e të paçliruara dhe të të gjitha reparteve të ushtrisë sonë u uroj mirëseardhjen në Kongresin e Riisë udhëheqësve kryesorë të Partisë Komuniste, të ushtrisë e të shtetit tonë të ri. Duke i falënderuar nga zemra, ne e quajmë pjesëmarrjen e tyre në Kongres një nder, inkurajim e ndihmë të madhe për brezin e ri të Shqipërisë!

Ky i ri, me trup ende të imët, por me shikim të mprehtë e fjalë të zjarrta, ishte shoku Ramiz Alia. Me të për herë të parë u poqa në Helmës, ndërsa nga larg, si të thuash, qemë njohur me kohë. Shokët, sidomos Nakoja e Nexhmija, më kishin folur për Ramizin me respekt e simpati si për një shok të ri të shkathët e luftarak që ishte dalluar qysh në fillim në Tiranë e sidomos në organizimin dhe udhëheqjen e Komitetit e të organizatës së Rinisë të Qarkut të Beratit. Personalisht dy muaj më parë kisha marrë prej tij një letër, në të cilën menjëherë më tërhoqi vëmendjen kompetenca me të cilën ai ngrinte probleme të punës politike e të punës me rininë në Brigadën VII Sulmuese, ku qysh në fillim ishte ngarkuar me detyrat e përgjegjësit të rinisë dhe në seksionin politik të brigadës. Në përgjigjen time e përgëzoja dhe i transmetoja këshilla e udhëzime të udhëheqjes së Partisë për ta

çar edhe më tej punën për edukimin e rinisë. Atëherë Ramizi që djalë fare i ri, por me mendime të pjekura e të qarta, tip luftarak e me iniciativë, cilësi këto që ai i shfaqti edhe në ditët kur zhvillonte punimet Kongresi. Në Helmës delegatët e zgjodhën atë anëtar të udhëheqjes së BRASH-it dhe që këtej, me punë e veprimtari të pandërprerë e të frytshme, ai do ta çonte më tej rrugën e nisur si një nga udhëheqësit kryesorë të rinisë e më pas të Partisë dhe së bashku do të na lidhte një bashkëpunim e miqësi e ngushtë, që e ka bazën në punën tonë për triumfin e idealit të Partisë.

Salla e Kongresit I të Rinisë ishte fusha, seancat e tij u zhvilluan në hapësirë, në ajrin e pastër të Qafës së Martës.

E mora edhe unë fjalën dhe në emër të Komitetit Qendror të Partisë, duke përshëndetur Kongresin, u fola përfaqësuesve të rinisë për besimin e madh që kishte pasur gjithmonë Partia te brezi i ri heroik i Shqipërisë, vlerësova lart kontributin e madh të të rinjve në luftën për çlirim dhe theksova:

- Beteja të reja na presin për të ndërtuar atdheun, për të forcuar pushtetin demokratik, për ta futur Shqipërinë tonë në udhën e lumturisë! Prandaj ju, të rinjtë e të rejat e Shqipërisë, ashtu siç jeni sot në ballë të luftës vigane për lirinë e atdheut, të jeni që nga këto momente e kurdoherë edhe në ballë të punës për rindërtimin e vendit, për zhdukjen e prapambetjes, për mbrojtjen dhe lulëzimin e këtij trualli që po e vaditim me gjak.

Delegatët e pritën me ovacione fjalën time përshëndetëse në emër të Komitetit Qendror. Me brohoritjet dhe thirrjet e tyre të zjarrta, ashtu si edhe në diskutimet, ata shprehën dashurinë dhe besimin e patundur te Partia Komuniste, vendosmërinë për të ecur pa lëkundje në rrugën e saj.

Kishim shumë dëshirë të rrinim edhe ne atje në fushën e Lirëzës, ku ndihej freskia, vrulli dhe forca e rinisë. Por i lamë të rinjtë të vazhdonin punën, pse na pritnin punë dhe detyra të reja. Kur po zbritnim të gëzuar të tatëpjetën, të përcjellë nga brohoritjet, përsëritnim pareshtur lajtmotivin e bisedave tona:

- Ne do të fitojmë patjetër mbi çdo armik që do të na dalë përpara!

Doktor Nishani, tepër i emocionuar, fshinte me shami lotët dhe thoshte:

- Ç'ka bërë, ç'ka bërë kjo Parti! Ç'patriotizëm ka ngjallur në zemrat e të rinjve!

Duke i lënë të rinjtë lart të zhvillonin Kongresin e tyre ne anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë, të Komitetit Antifashist dhe të Kryesisë së Këshillit vazhdonim punën nga mëngjesi deri natën vonë dulce përcaktuar masat për ta bërë sa më të afërt ditën e Çlirimit, për të shëruar plagët e luftës, për të rindërtuar shtëpitë, shkollat, urat, për të siguruar bukën e popullit, për të mëkëmbur atë çikë industri që kishim etj.

Punët ishin të shumta sa, siç i thonë, s'kishe kohë të merrje frymë, por ishim tërë besim e optimizëm: pas kaq vjet lufte e përpjekjesh e shihnim se liria ishte afër, populli do ta gëzonte atë, të plotë, si kurrë ndonjëherë, në një Shqipëri të re, pa shtypës e shfrytëzues.

Dukej fare qartë se vjeshta e 1944-ës do të ishte stina e fundit e pushtimit në Shqipëri. Jugu ishte tërësisht i çliruar, bashkë me qytetet e mëdha e kryesore, si: Vlora, Gjirokastra, Saranda, Përmeti etj. Gjithashtu ishte çliruar me luftime të përgjakshme pjesa më e madhe e Shqipërisë së Mesme, kurse në Veri armiku mbante akoma nën kontroll disa qytete dhe vija komunikacioni, si shteg për tërheqjen e tij jashtë kufijve tanë shtetërorë.

Autoritetet e pushtimit, qeveria kuislinge dhe administratat e saj faktikisht nuk kishin asnjë pushtet real: në të gjitha zonat e çliruara, të cilat në tetor të atij viti përbënin rreth tri të katërtat e territorit të Shqipërisë, ishte vendosur pushteti i ri popullor, i cili funksiononte me organet e tij nga baza në qendër. Gjithçka tregonte se armiku nuk ishte më në gjendje të ndërmerre orvatje serioze për të rivendosur gjendjen e mëparshme; çlirimi i plotë i Shqipërisë ishte çështie javësh.

Në këto rrethana, udhëheqja e Partisë diskutoi mbi masat që duheshin marrë, sidomos në planin politik, përpara këtij evenimenti të pritshëm dhe, dulce pasur parasysh situatat aktuale të brendshme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit tonë të ri, Komiteti Qendror i Partisë e konsideroi si një ekzgjencë të momentit kthimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike Provizore të Shqipërisë.

Sikurse kam thënë më lart dhe sikurse dihet edhe nga historia, Komiteti Antifashist që u zgjodh në Përmet, ndonëse kishte të gjitha atributet e një qeverie (ne, midis nesh, kështu e quanim), publikisht nuk u quajt Qeveri dhe kjo u bë për disa arsye.

Kongresi i Përmetit vërtet themeloi shtetin shqiptar, të ri në formë dhe në përmbajtje nga shteti feudo-borgjez i regjimit zogollian; vërtet organet e larta shtetërore që u caktuan në Përmet kishin mbështetjen e gjerë të masave popullore dhe ishin shprehëse e bartëse të sovranitetit shtetëror, por s'duhet harruar se në maj të vitit 1944 një pjesë e madhe e Shqipërisë ishte akoma nën pushtimin e nën kontrollin e trupave naziste e të administratave kuislinge. Në të njëjtën kohë, në maj 1944 ne akoma nuk kishim krijuar një rrjet të plotë organesh administrative nëpërmjet të cilave Qeveria do të mund të drejtonte e të kontrollonte gjithë jetën e vendit. Veç këtyre, shpallja e krijimit të një qeverie nominale do të shtronte qysh në maj 1944 edhe çështjen që kjo Qeveri të njihet nga aleatët tanë, gjë që taktikisht në ato momente nuk do të ishte oportune. Kjo, sepse sidomos aleatët anglo-amerikanë, që ne e dinim se ç'«simpati» kishin për ne, do të na e refuzonin njohjen, duke na vënë si pretekst ato rrethana që përmenda më sipër. Prandaj u vendos që Komiteti të kthehet në Qeveri në një hap të dytë, kur ofensiva e përgjithshme e ushtrisë sonë do të shkatërronte thuajse krejt pushtuesin gjerman, reaksionin e brendshëm e, bashkë me ta, edhe shpresat e «aleatëve» për t'i kundërvënë Lëvizjes Nacionalçlirimtare një forcë tjetër politike, si kundërpartishë në luftën për pushtet.

Udhëheqja e Partisë në shtator 1944 gjykoi se kushtet për këtë hap të ri ishin pjekur dhe e shtroi Problemin për diskutim në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Pasi u argumentova shokëve se cilat ishin arsyet që ne në Përmet dolëm me Komitetin Antifashist dhe pse tani ai duhej kthyer e shpallur Qeveri Demokratike e shtetit të ri shqiptar, përfundova:

- Propozimi që Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar i zgjedhur në Përmet, të kthehet në Qeveri Demokratike Provizore të shtetit të ri shqiptar, është vazhdim logjik i rrugës në të cilën i ka udhëhequr Partia Komuniste masat popullore për çlirimin e vendit dhe për të marrë në duar pushtetin politik shtetëror. Në këtë kuptim, mbledhja që do ta aprovojë këtë propozim të Partisë do të jetë një vazhdim i Kongresit të Përmetit, një «seancë» e tij, po që mbahet disa muaj më vonë!

Të gjithë shokët e kryesisë së Këshillit e pritën

me entuziazëm propozimin e Komitetit Qendror të PKSH dhe ranë dakord që të thirrej Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në ditët e para të tetorit. Data e saktë do t'u komunikohet anëtarëve të KANÇ-it më vonë bashkë me qytetin ku do të zhvillohej mbledhja, i cili iu la ta caktonte Shtabi i Përgjithshëm, në varësi nga situata ushtarake. Nuk kaluan veçse pak dite nga kjo mbledhje kur morëm vesh se qyteti i Beratit ishte çliruar. Vendosëm menjëherë që ta zhvillonim atje Mbledhjen e Dytë të KANÇ-it, duke pasur parasysh se ai ishte një nga qytetet kryesore të Shqipërisë, i vendosur në qendër të vendit e me tradita të vjetra historike. Por data e fillimit të mbledhjes u shty disi, sepse akoma trupat gjermane mbanin pozitën e tyre në Kuçovë dhe se duhej njëfarë kohe gjersa të grumbulloheshin gjithë anëtarët e Këshillit Antifashist. Ndërkohë u dhamë urdhër njësitëve tona që vepronin në këtë zonë t'i jepnin fund sa më shpejt rezistencës së nazistëve dhe, më duket, 2-3 dite përpara fillimit të Mbledhjes së Beratit, edhe Kuçova u çlirua.

Kështu, në momentin e duhur u nisëm nga Odriçani, kaluam mepërmes Skraparit dhe pas dy diësh rrugë arritëm në Berat natën vonë.

Kur të nesërmen, populli mori vesh se në qytetin e tyre kishin ardhur shokët e Komitetit Antifashist dhe, 4ë Shtabit të Përgjithshëm, rrugët u mbushën me njerëz. Burra e gra, të moshuar, nëna me fëmijë në duar, të rinj e të reja, pioniere, me këngë e brohoritje të zgjatura na uruan mirëseardhjen. Për ore të tëra vazhduan këngët e brohoritjet nëpër rrugë si edhe përpara ndërtesës ku kishim zënë vend në krah të lagjes «Mangalem», aty ku tani është Muzeu i Luftës Nacionalçlirimtare të rrethit e që më pare kishte qenë shtëpia e Vrionëve.

Në qytet kishte rregull e qetësi: partizane e vullnetarë mbanin rendin, qyteti gumëzhinte, jeta rridhte e gëzueshme. Berati nuk kishte pësuar dëmtime të mëdha nga lufta, megjithëse shkatërtime e djegie kishte edhe atje, por, në krahasim me Përmetin, ku qemë mbledhur disa muaj më pare, Berati ishte në gjendje më të mirë. Ato dite të gjithë ne, partizanë e drejtues, jetonim në një atmosferë që

s'e kishim provuar prej kohësh. Rrugët ishin plot gjallëri, dyqanet të hapura e të mbushura plot e përplot (sigurisht me ato mallra që mund të gjendeshin atëherë), po kështu rrinin hapur deri vonë kafenetë, restorantet. Megjithatë ne nuk i «justifikonim» dot shpresat e tregtarëve e të pronarëve të këtyre lokaleve, se vërtet kishim qejf të blinim ndonjë gjë, po ishim hollë nga parate dhe kur shokët duke kruajtur xhepat gjenin ndonjë lek, i harxhonin për duhan, për ndonjë brisk për t'u rruajtur a për të pirë ndonjë kafe «si zotni» në hotel «Kolombo»!

Né Berat u vendosën ato dite edhe misionet ushtarake aleate të Bashkimit Sovjetik, të Britanisë së Madhe e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të kryesuar respektivisht nga Ivanovi, Smithi e Tomas Stefensi, alias Thoma Stefani. Ishte sigurisht edhe koloneli Velimir Stoiniç e «miqtë» e tjerë jugosllavë. Të gjithë këta ne i ftuam të merrnin pjesë në Mbledhjen e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, si përfaqesues të vendeve mike e aleate në luftën e përbashkët kundër nazifashizmit. Ivanovi dhe Stoiniçi pa dyshim e pranuan ftesën «me kënaqësi», po kështu edhe amerikano-korçari Stefens, i cili edhe në Kongresin e Përmetit kishte marrë pjesë «si dëgjues». Për çudi, edhe anglezët, ndryshe nga ç'kishin vepruar në Përmet, pranuan të asistojnë në mbledhje, ku dërguan majorin Smith, i cili zëvendësoi Palmerin që ishte larguar ditët e para të tetorit. Pas dështimeve që kishin pësuar në përpjekjet e tyre për të folur me ne me gjuhën e forcës, misionarët britanikë në qëndrimet e tyre tani kujdeseshin të dozonin bashkë me intrigat e kërcënimet, edhe «dashmirësinë» e «mirësjelljen»! Me sa duket, ata e kishin kuptuar më në fund se plani i tyre me Abaz Kupin e të tjerë si ai nuk kishte asnjë shans për sukses dhe tash do të përipiqeshin të punonin brenda Lëvizjes Nacionalçlirimtare, brenda Frontit me të tjerë kuaj Troje, për të sabotuar fitoren e revolucionit popullor.

Mbledhja historike e Beratit filloi më 20 tetor. Rreth orës dhjetë të mëngjesit ne, anëtarët e Kryesisë e të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, u nisëm në këmbë për në sallën ku do të bëhej mbledhja, që ruhet edhe sot si një monument i historisë. Grumbuj njerëzish nga të dy anët e rrugës na përshëndetnin, hidhnin lule. Para kinemasë, për nder armë, ishin rreshtuar partizanët e një kompanie të Brigadës VII Sulmuese, që kishin luftuar për çlirimin e qytetit.

Kur hymë në sallë, anëtarët e Këshillit dhe të ftuarit u ngritën në këmbë me duartrokitje. Gati gjysma e sallës, lozhat dhe galeria ishin të mbushura me popull. Ne kishim luftuar së bashku, gjithçka bëhej në emër të popullit, prandaj, si i thonë, letrat i kishim të hapura: populli do të shikonte vetë si do të procedohej në mbledhje nga përfaqësuesit e tij, të zgjedhur demokratikisht në Përmet. Asgjë të keqe s'kishte këtu, përveçse iu hap pak punë doktor Nishanit, që drejtonte punimet, të cilit i duhej të ndërhynte disa herë për të qetësuar njerëzit që brohoritnin pareshtur, të entuziazmuar.

- Ju lutem qetësi, - thoshte me «rreptësi» Omer Nishani, - jemi në mbledhje pune e jo në miting!

Gjithçka ishte e thjeshtë, e natyrshme, prekëse. Këtu s'kishte «deputetë» me qostekë, frakë e xhufka, as roja me shirita, as ndonjë «sekretar protokollar» me një mori dosjesh, letrash e kallamarësh si në parlamentin e «baballarëve» zogollianë. Deputetët e këtij «parlamenti» ishin njerëz të thjeshtë, bij të popullit që vinin nga shtigjet e luftës, ata nuk kishin as tituj e «oxhaqe» të trashëguara, por kishin dashurinë për popullin, të cilën e kishin provuar në betejat, si dhe dashurinë për të ardhmen e lumtur të atdheut. Vetë ky fakt, bashkë me shumë të tjera, tregonte se kjo që po ndodhte në Shqipëri ishte një përmbysje rrënjësore, ishte agimi i një bote të re, ku i përbuzuri, i shtypuri i djeshëm, kishte fituar me luftë e me gjak, me revolucion të drejtën për të vendosur fatin e kombit.

Salla e mbledhjes ishte zbukuruar me flamurë, me lule e me kurora dafinash. Mbi perden e skenës, në sfond, ishte vendosur një flamur shumë i madh i Shqipërisë, punuar me dashuri dhe në të dy anët e tij parulla «Vdekje fashizmit - Liri popullit»; në muret anash ishin vendosur portrete të patriotëve të Rilindjes, të dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe banderola ku shkruhej me gërma kapitale: «Rroftë pushteti popullor!», «Rroftë Ushtria Nacionalçlirimtare!».

Kryetari i Kryesisë së KANÇ-it, doktor Omer Nishani, në hapje të mbledhjes mbajti një fjalim të shkurtër, në të cilin, në mënyrë përmbledhëse, foli për situatën e brendshme e të jashtme dhe u parashtrroi anëtarëve të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar qëllimin e mbledhjes.

- Në këtë situatë, - tha ai, - kur tri të katërtat e Shqipërisë janë nën juridiksionin tonë, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar e pa të nevojshme të thërrasë këtë mbledhje të Këshillit për të aprovuar kthimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike të Shqipërisë. Kryesia e gjeti të arsyeshme që ky vendim të merrej solemnisht nga i gjithë Këshilli, megjithëse, në bazë të kompetencave që i janë ngarkuar asaj në Përmet, ajo mund ta kryente edhe vetë një akt të tillë.

Duartrokitjet e menjëhershme të anëtarëve të KANÇ-it dhe të popullit që asistonte në sallë tregonin që më parë aprovimin e këtij propozimi për këtë akt historik që do të votohej në fund të mbledhjes. Pas fjalës hyrëse të doktor Nishanit, me cilësinë e Presidentit të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, m'u dha mua fjala për të mbajtur raportin në emër të këtij Komiteti.

Pas një ekspozije të shkurtër të situatës ndërkombëtare, në të cilën spikatnin fitoret e reja të mëdha të Ushtrisë së Kuqe, e cila tashmë luftonte në Poloni, në Qekoslllovakë e në Prusinë Lindore si dhe hapja, më në fund, e frontit të dytë anglo-amerikan në Francë, në raportin që mbajta bëja një tablo të sukseseve që kishte arritur populli ynë, ushtria jonë, të udhëhequr nga Partia, në sulmin vendimtar për ta ndjekur bishën naziste nga trojet e shenjta të atdheut.

- Vendimet e Kongresit të Përmetit, - i raportova Këshillit, - po përmbushen me sukses. Divizionet e brigadat tona e thyen ofensivën e dytë gjermane dhe marshuan fitimtarë drejt Shqipërisë së Veriut, dhe bashkë me disfatat që u shkaktuan divizioneve të Vermahtit, bënë që të dhokrijnë si bora në ujë çetat e Ballit dhe bandat e Shefqet Vërlacit e të Abaz Kupit, të Fiqri Dines e të Hailil Alisë, të Markagjonit e të Muharrem Bajraktarit.

Në fjalimin tim fola me pasion e me frymëzim për heroizmin epik të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, për partizanët, komandantët e komisarët tanë trima, të cilët, të veshur e të pa veshur, të ngrënë e të pangrënë, në të nxehtë e në acar, në fusha, në qytete e në kreshta malesh, luftuan me vetëmohim, i vunë gjoksin atdheut, e lanë me gjalk çdo pëllëmbë të kësaj toke dhe ranë me këngë në gojë, e bënë vdekjen «si me le». Ku e gjente forcën, ku mbështetej kjo ushtri, ku armatosej, ushqehet e strëhohej? Në populi!

- Ushtria jonë, - theksova në këtë pjesë të raportit, - është armatosur në luftë me armët që i ka rrëmbyer armikut në be'-teja, është ushqyer me bukën e popullit që kafshatën ce tij e të fëmijëve e ndau me partizanët. Shtëpitë e pcpullit, malet dhe pyjet e atdheut kanë qenë dhe jaanë kazermat e ushtrisë sonë. Por, - u thashë duke u drejtuar nga përfaqësuesit ushtarakë aleatë, - për interesat e përbashkët të kësaj lufte të shenjtë, për të armatosur mijëra vullnetarë që çdo ditë shtojnë r,-adhët e ushtrisë sonë, për t'u prerë rrugët e tërheqjes; dhe për t'i asgjësuar forcat gjermane, ne kërkojmë nga aleatët tanë armë, armë, armë! S'ka kush të na jrefuzojë të drejtën të luftojmë; s'ka kush na e përli~ul vullnetin për të luftuar e për të fituar, por, e përsëfritim, kërkojmë armë dhe municion!

Kushedi për të satën herë u drejtohej «miqve» kjo kërkesë, kush e mbarn mend në sa takime, biseda, letra zyrtare e radiograme u kishim thënë se nuk kërkonim as karamete e çokollata e asgjë tjetër, përveç armëve, fishekëve, predhave! I përsëritnim këto kërkesa dhe merrnim premtime, buzëqeshje hipokrite diplomatike, justifikime, oferta për të shitur atdheun. Ne u bënim thirrje për ndihmë të sinqertë prej aleati, po thirrjet tona qenë *vox in deserto* (Latinisht - zë në shkretëtirë.). Ç'të bësh, ky ka qenë fati i popullit tonë, rrallëherë ka pasur miq besnikë e aleatë të sinqertë. Po s'ka gjë, pikërisht kjo ndoshta e ka bërë më vital, më të papërkulur dhe e ka bindur se vetëm nga forcat e veta mund të presë lirinë dhe lumturinë e tij.

Në mënyrë të veçantë u ndala në raport në efektet politike që kishte pasur krijimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Kongresin e Përmetit. Nënvizova këtu entuziazmin me të cilin e priti këtë ngjarje populli shqiptar, i cili nëpërmjet mijëra letrash shprehte gëzimin për krijimin e së parës Qeveri popullore, shprehte, gjithashtu, vullnetin e vet për ta mbështetur e për ta përkrahur atë në aktivitetin për të mirën e Shqipërisë.

Krejt i kundërt, qe reagimi i qarqeve dhe i forcave reaksionare, për të cilët krijimi i Komitetit Antifashist qe një bombë që ua dërrmoi krejt ëndrrat e tyre të fantaksura. Formimi i Komitetit me atributet e Qeverisë revolucionare, - theksova veçanërisht dhe jo pa qëllim, - i bëri qesharake përpjekjet e reaksionit brenda dhe jashtë Shqipërisë për të krijuar qeveri kukulla, pa asnjë simpati

dhe pa asnjë mbështetje në popull. Kush merret me prodhimin e krijesave të tilla të destinuara të vdesirl ai bën lodrën e armiqve të popullit shqiptar!

Më poshtë raportja për punën dhe për aktivitetin që kishte zhvilluar I~omiteti Antifashist Nacionalçlirimtar gjatë kësaj penludhe katërmujore. Në këtë pjesë të fjalimit i paraqita Këshillit një përmbledhje të përpjekjeve të Komititit për riorganizimin e jetës në krahinat e çliruara, në qytet e në fshat, për masat që ishin marrë për vënien në funksionim të ekonomisë, për sigurimin e bukës e të strehimit për popullsinë, për sigurimin e shërbimit shëndetësor, për hapjen e shkollave, për kulturën dhe propagandën.

Edhe me duartrokitjet e tyre gjatë kohës që lexoja raportin, por edhe në diskutimet e tyre më pas, anëtarët e Këshillit e vlerësuan pozitivisht dhe e aprovuan veprimtarinë e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar.

Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar punën e tij e kishte mbështetur deri atëherë në një sistem administrativ, akoma embrional, të papërkryer. Vetëm Komiteti kishte ndarje pune, kishte dikasteret, të cilat nzbulonin sektorët e ndryshëm të jetës së vendit, kurse në bazë, në këshillat nacionalçlirimtarë të qarqeve e të qyteteve, organizimi sapo kishte filluar të bëllej, sapo kishin filluar të ndaheshin seksionet, të krijoheshin aparatet administrative etj. Sigurisht, ishim akoma në luftë, shteti sapo kishte lindur, mungonin kuadrot dhe përvoja. Hap pas hapi çdo gjë do të ecte përpara, vetë praktika do të na sugjeronte format e përshtatshme, do të na mësonte të drejtonim e të qeverisnim.

Pasi u sqarova shokëve mënyrën e organizimit e të funksioniznit të shtetit tonë të ri, kalova në objektin kryesor të Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, në propozimin që. Komiteti Antifa~shist të kthehej në Qeveri Demokratike Popullore Provizore.

- Qeveria Demokratike që do të dalë nga kjo mbledhje, thashë, - de t'i qëndrojë besnike platformës politike e ushtarake të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe vendimeve të Kongresit të Përmetit. Në radhë të parë, ajo do të vazhdojë e do të çojë deri në fund detyrën e çlirimit të plotë të atdheut. Pas çlirimit të plotë të Shqipërisë, - vazhdova, dhe pasi të jetë stabilizuar gjendja, Qeveria Demokratike do të sigurojë d'he do të organizojë zgjedhjet e lira demokratike për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të caktojë formën e shtetit dhe do të aprovojë Kushtetutën e shtetit shqiptar.

Qeveria do t'u kërkojë aleatëve të bllokut të madh antifashist njohjen e saj si e vetmja qeveri e popullit shqiptar, e dalë nga lufta dhe nga gjiri i popullit, që shpreh vullnetin e tij dhe përfaqëson gjithë popullin shqiptar. Ata do të na njohin, - theksova, - se kanë parë me sytë e tyre sakrificat që kemi bërë në këtë luftë të tmerrshme dhe të pabarabartë, kanë parë heroizmin e përditshëm të popullit tonë të vogël, por të papërkulur, që, në kushte tepër të vështira, u vërsul mbi armikun me vetëmohim të patreguar.

Pas raportit që mbajta në emër të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar e që zgjati rreth një orë, bëme një pushim gjatë të cilit u dha një koncert me këngë patriotike partizane, nga grupet artistike të reparteve ushtarake e nga të rinj e të reja të qytetit të Beratit. Bashkë rne «artistët» në skenë, këndonin edhe pjesëmarrësit e mbledhjes, këndonte edhe populli në sallë. Mbase ky koncert i përbashkët, jashtë kufijve të skenës, çalonte ndopak dhe nuk i kënaqte ekzigjencat artistike të dirigjentit; kishte zëra që stononin, disa nuk i dinin mirë fjalët e këngëve, dikush harronte se kishte edhe koncerti program dhe pas mbarimit të një kënge kërkonte t'ia merrte tjetrës që i pëlqente më shumë; po, sidoqoftë, të gjithë ishin të kënaqur, të gëzuar e të lumtur; në zemrat e në sytë e shokëve kishte festë!

Pas këtij pushimi seanca u hap me përshëndetjet e përfaqësuesve të vendeve aleate, të cilët me fjalë të përgjithshme vlerësonin sukseset tona në Luftën Nacionalçlirimtare, shprehën simpatinë dhe përkrahjen. për popullin tonë. Sigurisht, përshëndetjet e secilit prej, tyre kishin edhe nuancat e veta, në varësi nga qëllimet e qëndrimet që mbanin ata ndaj nesh, qoftë edhe në aparence.

Smithi, për shembull, me gjithë vërejtjen e adresuar për ndihmat e pamjaftueshme, për të mos thënë inekzistente, nuk e zuri në gojë fare atë çështje, vetëm na premtoi se «aleatët nuk do t'i harrojnë shokët e tyre në luftë e në paqe», sikur të na paralajmëronte se edhe pas luftës do të kishim boll

telashe me ta; amerikani me origjinë shqiptare, por totalisht i bastarduar, me një shqipe të çalë, shprehu kënaqësinë e tij «si ushtarak amerikan dhe si shqiptari për familje të vet».

Velimir Stoiniçi, me një pamje fodulle, foli më gjatë se të tjerët dhe në ligjëratën e tij, në serbisht, të binte në sy përsëritja e shpeshtë e emrit të Titos, të Jugosllavisë, të Ballkanit etj. Kur fjala e tij u përkthye, u kuptua se koloneli jugosllav më shunië kishte folur për luftën e Jugosllavisë, për Titon, sesa kishte përshëndetur këtë eveniment historik në të cilin e kishim ftuar; Stoiniçi foli për «bashkimin e popujve ballkanikë», përmendi edhe «federatën e famshme», premtoi «ndihmën e përkrahjen e Jugosllavisë motër», po nuk iu dha të thoshte një fjalë, ta zëmë, për luftën e forcave tona në ndihmë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë e në Dibër, si shprehje konkrete të vëllazërimit luftarak të popujve e të vendeve tona në betejat kundër armikut të përbashkët.

Me entuziazëm e pritën delegatët përshëndetjen e

majorit Ivanov. Kur iu dha fjala atij si dhe në fund të fjalimit, salla brohoriti për Stalinin e madh e për Ushtrinë e Kuqe, bile edhe në mes të fjalës së shkurtër të Ivanovit, një nga shokët që ndodheshin në sallë thirri në gjuhën ruse «*Da zdrastvujet Savjetskij Sajuz!*».* *(Rroftë Bashkimi Sovjetik!) Kuptohet, kjo ishte shprehje e dashurisë së madhe që kishim ne komunistët shqiptarë për Partinë Bolshevike, për Leninin e Stalinin, për vendin e parë socialist në bëtë dhe me këtë dashuri kishte edukuar Partia jonë të gjithë popullin, i cili shikonte te Bashkimi Sovjetik jo vetëm forcën kolosale që theu bishën fashiste, por edhe mbështetjen e madhe të popujve të botës në luftë për liri e drejtësi shoqërore.

Vetë fjala e Ivanovit ishte tepër e thatë përballë pritjes së sinqertë e entuziaste që i bënë të pranishmit. Bile edhe në vlerësimin që i bënte ai luftës së popullit tonë, që «duke luftuar në prapavijat e armikut u kishte dhënë atyre një ndihmë të madhe», kishte diçka megalomane. Kam shkruar për përshtypjet e mia për këtë të dërguar të komandës sovjetike. Ardhjen e tij ne e kishim pritur me gëzim dhe e kishim vlerësuar si një ndihmë të madhe. Por asnjë përfitim nuk patëm nga Ivanovi, asnjë informacion të saktë nuk të jepte dhe, kur e pyetnim për diçka ose i kërkonim ndonjë mendim, e vetnija përgjigje e tij ishte: «Do të vë Moskën në korent me anën e radios», se kishte edhe një radiotransmetues me vete. Ivanovi e dinte që ne kishim nevojë edhe për armë e për furnizime ushtarake, por asnjëherë nuk punoi radioja e tij për t'i transmetuar komandës sovjetike nevojat tona dhe asgjë nuk na erdhi që andej.

Me një ton krejt tjetër qenë diskutimet e shokëve tanë pjesëmarrës në mbledhje, të cilët, me fjalët e tyre të zjarra, i gëzoheshin lirisë, shprehnin vullnetin dhe aspiratat e popullit, besimin dhe optimizmin për të ardhmen e ndritur.

Shkrimtari luftëtar Haki Stërmilli në diskutimin e tij foli për luftën e popullit të Dibrës, i cili traditat e tij patriotike i kishte përtërirë e i kishte zhvilluar më tej në Luftën Nacionalçlirimtare, përmendi djemtë dibranë, si Nazmi Rushiti me shokë, të cilët kishin dhënë jetën për Shqipërinë e lirë e demokratike. Në emër të popullit të kësaj krahine, Haki Stërmilli shprehu aprovimin e tij që në mbledhje të vendosej krijimi i Qeverisë Demokratike.

Patrioti Hysen Zaloshnja solli zërin dhe dëshirën e popullit të Beratit e të Skraparit. Fjala e tij ndoshta nuk ishte aq e lidhur si ajo e autorit të librit «Si kur të isha djalë», bile xha Hyseni e lexonte një çikë «me të ngecur» fjalimin që kishte shkruar, dhe, më në fund, e la mënjanë kartën që kishte përpara dhe foli qartë me atë të folurën e tij popullore, për jetën e lirë të cilën populli i Beratit dhe i Skraparit po e shijonin prej pak kohësh; ai preku edhe probleme që i dilnin tani përpara pushtetit popullor, duke u ndalur sidomos në «balle» të tilla, si shëndetësia, shkollat etj.

Pas këtyre e mori fjalën Met Seseri nga Kruja, i cili theksoi se me gjithë përpjekjet e Mustafa Krujës e të Abaz Kupit, populli krutan nuk u nda nga Lëvizja Nacionalçlirimtare. Me radhë diskutuan Abedin Çiçi, Haxhi Lleshi, Ethem Barhani, Kadri Baboçi, Manol Konomi, Ymer Dishnica, Nako Spiru, Shefqet Beja e plot të tjerë që nuk më kujtohen të gjithë. Njëzëri, shokët që folën, aprovuan propozimin për kthimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Provizore.

Një diskutim të mirë e të përgatitur bëri në këtë seancë shoku Spiro Koleka, të cilit në Përmet i ishte ngarkuar drejtimi i dikasterit të Punëve Botore dhe ishte një nga shokët më aktivë të Komitetit. Në

diskutimin e vet Koleka pasi theksoi rëndësinë e mbledhjes dhe shprehur aprovimin për vendimin që do të merrej, u ndal në çështjet e mëdha ekonomike që na dilnin përpara.

- Veç luftës me armë për çlirimin e vendit, tha ai mes të tjerash, - tani kemi përpara një luftë tjetër, luftën e punës. Kemi shumë e shumë probleme që presin zgjidhje për industrinë, për bujqësinë, për rrugët e urat, për banesa, shkolla e spitale etj. Për t'i bërë të gjitha këto duhet punë e pareshtur dhe e palo dhur, punë kolektive e të gjithëve. Të gjitha këto, theksoi Spiro Koleka, - do t'i bëjmë vetë, sepse edhe liria ekonomike nuk dhurohet, por fitohet me punë e me djersë.

Diskutimet vazhduan edhe të nesërmen, më 22 tetor. Qe ditë e diel e, veç kësaj, qe edhe një mot i bukur e i qeshur sa s'të besohej se ishte fundi i tetorit. Kur u drejtuam për në kinemanë ku bëhej mbledhja,

kudo na rrethonte populli, i cili ishte veçanërisht i shumtë në hyrje të godinës. Atë ditë do të hidhej në votë çështja e kthimit të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike Provizore. Por, siç thashë, votimi do të ishte vetëm një akt formal juridik; jo vetëm diskutuesit, por edhe të tjerët që ishin në sallë, me entuziazmin e tyre që shkonte kreshendo tashmë e kishin shprehur aprovimin. Atë ditë atmosfera në sallë dukej që kishte arritur kulmin, brohoritjet, ovacionet që përcillnin fjalët e shokëve që ngjiteshin në podium ishin të tilla sa shoku që mbante procesverbalin e

mbledhjes kishte rënë në dëshpërim, hapte duart, i pafuqishëm të kapte fjalët që thuheshin për t'i fiksuar në protokoll. Më pas, kur bashkë me shokët e tjerë kontrolluam dokumentacionin e mbledhjes, qeshëm me të madhe, kur në një pjesë të procesverbalit kishte vetëm emra diskutantësh dhe poshtë një shënim «Nga entuziazmi i madh në sallë, është e pamundur të mbash shënime».

Në këtë situatë, pasi morën fjalën 5-6 shokë dhe pas thirrjeve të pareshtura të anëtarëve të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe të popullit «Qeveri Demokratike!» dhe «Ta hedhim në votë!» doktor Omer Nishani shpalli mbylljen e diskutimeve dhe pasi vendisi për një çast qetësi, tha:

- Hedhim në votë propozimin që Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar të kthehet në Qeveri Demokratike Provizore të Shqipërisë. Kush është dakord të ngrejë grushtin lart.

Të gjithë në këmbë, ngritëm grushtet lart. Bashkë me anëtarët e Këshillit, edhe të ftuarit, popiflli, u ngrit në këmbë dhe votoi. Po kësaj here Omer Nishani skrupuloz, nuk e vuri re «shkeljen».

Pas këtij vendimi historik, doktor Omer Nishani shpalli se Kryesia e KANÇ-it më kishte ngarkuar mua me detyrën e Kryetarit të Qeverisë Demokratike. Në seancën e pasdites do t'i paraqisja Këshillit programin dhe përbërjen e Qeverisë.

Në seancën e pasdites, në emër të Qeverisë bëra një Deklaratë programatike në të cilën shprehej angazhimi i Qeverisë së re për të çuar deri në fund luftën për çlirimin e vendit, për t'i qëndruar beshikë vendimeve historike të Përmetit, për forcimin e pushtetit popullor, për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave demokratike për masat popullore etj. Në Deklaratë shpalla njëkohësisht edhe kërkesën ndaj aleatëve për njohjen e Qeverisë Demokratike Provizore si e vetmja qeveri e ligjshme e popullit shqiptar. Përbërja e Qeverisë qe identike me atë të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar.

Kështu, më 23 tetor përfundoi Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Vendimi historik që mori ajo për shndërrimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike ishte një hap historik i domosdoshëm, një rrjedhim logjik i luftës dhe i revolucionit popullor nën udhëheqjen e Partisë. Me këtë vendim marrja e pushtetit politik nga ana e masave punonjëse, që me luftë kishin rrëzuar pushtetin e vjetër, bëhej një realitet de facto dhe de jure. Rëndësia e këtij vendimi historik do të reflektehej edhe më vonë, në thellimin e revolucionit, në hapat e tjerë që ndërmori Partia në etapën e ndryshme dhe në kohën e duhur.

Pas përfundimit të mbledhjes rrugën nga salla deri në selinë ku ishte vendosur Qeveria e bëmë midis popullit që na përshëndeste. Një grumbull i madh njerëzish u mbledh pranë ndërtesës ku ishim vendosur. Shefat e misionëve aleatë, që për «kortezi» kishin ardhur për të na urrear, çuditëshin me atë që shihnin dhe, sigurisht, ndonjërit prej tyre nuk i vinte mirë. U ndamë nga masa e njerëzve që na kishin futur në mes, por, edhe kur hymë brenda, nuk pushuan brohoritjet e fuqishme:

Rroftë Shqipëria e lirë! Rroftë Qeveria Demokratike! Rroftë Partia Komuniste! Rroftë Ushtria heroike Nacionalçlirimtare!

Omer Nishani më vuri dorën në sup i prekur:

- Enver, duhet të dalësh. Pa dëgjo si bëjnë, tha ai dhe nxori shaminë e pastroi gjyzykët për të larguar mallëngjimin.

Dola në dritare dhe i përshëndeta me fjalët që më dilnin nga shpirti. Nuk më kujtohet me saktësi çfarë u thashë; mikrofona e altoparlante nuk kishte, por njerëzit e morën vesh përse u fola, ia thoshin njëri-tjetrit, brohoritnin, kishin besim te bijtë e vet, të provuar në luftën e përbashkët. Pas meje, me insistimin e popullit, dolën edhe shokët e tjerë në dritare.

E tani punë! Punë dhe luftë në krye të Partisë, të popullit, në krye të betejave të mëdha që na pritnin!

Disa herë në ditë bisedoja me Medarin, me Bacën, me Kolekën, me Gjergj Kokoshin, me Bedri Spahiun e të tjerë për problemet që u takonin dikastereve që ata drejtonin. Duhej vullnet, kurajë e punë e madhe që të përballoje çështje të tilla urgjente, si: grumbollimi i bereqetit, rregullimi i rrugëve e i urave, çelja e shkollave dhe e kurseve kundër analfabetizmit. E këto, në të njëjtën kohë, kur vendi akoma ndodhej në luftë, kur në krahinat e qytetet e çliruara ishte akoma i nxehtë hiri që kishte lënë mbrapa barbaria armike.

- Dimri po na afrohet dhe një pjesë të mirë të popullit e kemi pa bukë e pa strehë, - u thosha në këto biseda shokëve. - Duhet të intensifikohet puna në fshatra e lagje dhe të paktën të ngrihet për çdo familje nga një kthinë, duke ndihmuar njëri-tjetrin. Vështirësitë janë të mëdha, por le të vazhdojmë me atë entuziazëm, besim e vendosmëri që filluam luftën. Vetëm kështu do t'ia arrijmë qëllimit!

- Duhet të marrim masa për ruajtjen e gjësë së gjallë, sidomos të qeve të punës, - ngrinte Medar Shtylla një tjetër problem. Mbjelljet e vjeshtës akoma nuk kanë përfunduar dhe duhet menduar seriozisht si të bëhen këto punë. Na duhet buka. Të krijohen bindje që të përdoren edhe kuajt e mushkat për mbjellje; kemi dërguar edhe një qarkore për këtë qëllim, të shohim si do të venë punët...

E Kështu me radhë diskutonim e vendosnim për probleme të ndryshme të ekonomisë, kulturës, shëndetësisë etj. Për gjërat që nuk i njihnim pyetnim shokë specialistë, diskutonim me njëri-tjetrin dhe në sugjerimet e mendimet e shokëve gjenim rrugën më racionale. Më e rëndësishmja ishte që entuziazmit e besimit të popullit t'i përgjigjeshim me punë të palodhur, ditën dhe natën, që të mbanim me nder përgjegjësitë që na ishin ngarkuar e premtimet që kishim bërë.

- hlluk është koha për paralë! - i thosha ndonjë shoku që insistonte «të vemi atje, të shkojmë këtu» për vizita e për takime. - Duhet t'i përvishemi punës, të flemë pak dhe, mos harroni, na ndalohet të lodhemi! Edhe në mitingje do të vemi, edhe me popullin do të takohemi, por, në radhë të parë, do të bëjmë detyrën!

Në Berat ndenjëm rreth një muaj dhe dritat në ndërtesën ku kishte zënë vend Qeveria shiheshin deri vonë dhe jo rrallë mëngjesi i gjente të ndezura. Shokët ministra ishin të detyruar të merreshin jo vetëm me çështjet kryesore, por edhe me punë të vogla, deri edhe në çështje teknike, sepse «aparati» ynë qe fare minimal dhe një ministri e tërë, bie fjala, zinte një ose dy dhoma në godinën e Qeverisë. Më vinte ndonjëri dhe ngrinte problemin e kuadrove, të zëvendësministrave, por ia prisja shkurt e i thosha:

- Më vonë do t'i kemi të gjitha ashtu siç duhet. Tani vetë jemi edhe ministra, edhe drejtorë, edhe nëpunës.

Vinte ndonjë shok jetër e ankohej se në dikasterin e tij s'kishte asgjë, as mjete, as fonde, as specialistë, as bazë materiale. E kuptoja, gjendja që më raportohej ishte reale, por me «kërkesa» e «ankesa» ndaj Qeverisë s'arrihej asgjë.

- Ne me popullin e bëmë luftën, - u thosha. Ky popull që s'ka të hajë na mban edhe ne; edhe këto, punë së bashku do t'i bëjmë. Ku do t'i gjejë Qeveria ato që thoni ju? Ne për një çështje përpiqemi, prandaj s'mund t'i ndajmë hallet e Qeverisë sonë nga ato të popullit; sot edhe nesër për gjithçka popullit do t'i drejtohem dhe askujt tjetër, asgjë s'do të na bjerë nga qielli.

Biseda të tilla, mbledhje e takime pune kishim, çdo ditë, bile disa herë në ditë, po këto as na lodhnin e as na mërznin. Punët e Partisë, të shtetit, drejtimi i Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare në betejat finale, ishin një barrë të cilën Partia dhe populli na e kishin ngarkuar dhe do ta mbanim mbi shpatulla pa u lodhur, aq më tepër tani që ishim në prag të fitores së madhe.

Por ato ditë në Berat, një brengë të thellë po na, shkaktonte situata e rëndë që u krijua nga ndërhyrjet antimarksiste e antishqiptare të të dërguarit të Titos, Velimir Stoiniçit dhe, sidomos, nga kurthi e komploti që ky po përgatiste bashkë me Koçi Xoxen, Sejfullain, Pandi Kriston e të tjerë kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe së ardhmes së atdheut tonë. Se ç'qëllime kishte ky komplot armiqësor, këtë ne do ta realizonim më pas, po qysh ato ditë, siç kam shkruar hollësisht në librin «Titistët», isha i bindur se nga ana e të dërguarit të Titos po goditej padrejtësisht via e Partisë sonë.

Duke kujtuar ato momente më bie mirë ndër mend se ç'përpjekje të mëdha i imponoja vetes që shqetësimin dhe brengën të mcs ua komunikojta shokëve të tjerë. Nga njëra anë, më duhej të luftoja për të mbrojtur pastërtinë e vijës së Partisë kundër punës armiqësore të përfaqësuesit jugcsllav dhe klikës që po krijonte dhe, nga ana tjetër, duhej të mposhtja gjithçka dhe të prisja me buzë në gaz shokët e Këshillit dhe të Qeverisë për të biseduar për problemet e ndryshme dhe për masat e vendimet që do të merrnim menjëherë pasi të hynim në Tiranë.

Me zemër të brengosur, por me fytyrë të qeshur, prita edhe delegatët e qytetit të Beratit, të cilët vinin të më uronin për Partinë trime që çliroi popullin. Ata nuk e dinin dëshpërimin tim, nuk e dinin se një grup trockistësh i hidhnin baltë kësaj Partie që populli e donte shumë.

Pasi biseduam një ccpe herë, njëri nga pleqtë e delegacionit të qytetit m'u drejtua:

- Shoku Komandant, kemi një lutje nga populli i Beratit.

- Ma thoni, - i folta me buzë në gaz.

- Populli i Beratit kërkon që qyteti ynë, Berati, të bëhet kryeqyteti i Shqipërisë së re.

Kjo kërkesë për mua ishte një gjë e papritur dhe, duke qeshur, i thashë:

- Kur të shkruhet historia e kohës së Partisë, do të thuhet se Berati, për një kohë, ishte kryeqyteti i Shqipërisë së re, sepse këtu, tash, po qëndrojnë edhe Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Qeveria e Parë Demokratike e verdit tonë. Më tutje fjalën do ta ketë Asambleja Kushtet-xese që do të caktojë edhe formën e regjimit që do të ketë Shqipëria e re, edhe kryeqytetin e saj. Unë për këtë nuk ju kënaq dot, por po ju them se mendimi i Partisi dhe i popullit është që kryeqyteti të jetë Tirana, e cila së shpejti do të çlirohet përgjithmonë.

- Të bëhet si ta shohë më të miri Partia! - më thanë pleqtë e urti e patrioti të Beratit, u përshëndetëm përzemërsisht e i përcolla gjer poshtë. Ardhja e tyre, fjalët e ngrohta në adresë së Partisi e të Qeverisë më lehtësuan brengën e më shtuan forcat, por ndërkaq e dija se lart, në zyrat ku punonim e banonirn na pritnin hyrje e dalje të tjera, shpifje, akuza e presione të pandërprera.

Ato diti në Berat ishim duke u përgatitur edhe për dy ngjarje të tjera të rëndësishme, për Konferencën e Frontit Nacionalçlirimtar dhe për Kongresin e Gruas Antifashiste. Konferenca e Frontit që u bë, në mos gaboj, 3-4 diti pas Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, do të diskutonte e do të aprovonte vendimin që Fronti Nacionalçlirimtar tash e tutje të ishte një organizatë politike e madhe, e të gjithë njerëzve të ndershëm që luftonin për Shqipërinë e lirë demokratike e popullore, duke ua lënë funksionet e pushtetit këshillave nacionalçlirimtarë. Sikurse kishim rënë dakord në udhëheqjen e Partisi, organizata e Frontit do të krijonte kudo celulata e veta, këshillat e Frontit, të cilët do të luanin një rol kolosal për bashkimin e popullit, për mobilizimin e të gjitha energjive dhe aftësive krijuese të tij në shërbim të gështjes së ndërtimit të Shqipërisë së re.

Tamam kur përgatiteshim për këtë konferencë si dhe gjatë punimeve të saj, Velimir Stoiniçi e Nijaz Dizdareviçi, në unitet e në bashkëveprim me Koçi Xoxen, Sejfulla Malëshovën, Nako Spiu'n e të tjerë, u përpoqën të godasin e të shtremberojnë vijën e Partisi lidhur me Frontin Nacionalçlirimtar. Akuza për «sektarizëm», që ata e kishin vënë në rendin e ditës, u reflektua këtu në «sugjerimet» e «rekomandimet» për të zgjeruar «kufijtë e Frontit». Shqip kjo do të thoshte të futeshin në Frontin Nacionalçlirimtar elementi që gjatë viteve të luftës jo vetëm nuk kishin luftuar, po na kishin goditur

cleri edhe me armi. «Argumentet» për këtë nuk u mungonin as delegatëve të Titos, as apostujve të tyre shqiptarë. Kjo ishte një etapë në rrugën e realizimit të planit të hartuar në Beograd për të goditur Partinë Komuniste të Shqipërisë, për të treguar se aio gjatë viteve të ekzistencës së vet gjoja ishte treguar e paaftë për të përpunuar dhe për të ndjekur një vijë të drejtë politike e të përgatitej kështu terreni që frenat e Shqipërisë t'i merrte në dori Titoja me njer'ezit e tij.

Njëri pas tjetrit më vinin si rastësisht Koçi, Sejfullai e të tjerët dhe më përsëritnin pëi'rallat që i kisha dëgjuar më pari nga Stoinigi.

- Fronti, si organizatë e gjerë masash, nuk duhet të ketë dhe s'ka pse të ketë kufij të caktuar Përfundimisht, - më thotë njëherë Sejfullai. - Mbas Çlirimit ne, që kemi pushtetin toni, duhet t'i kemi tiri forcat me vete, në Front e jo përballë nesh, fridryshe do të bëhej fjalë për luftë civile!

- Nuk po të kuptoj, përse e ke konkretisht fjalën? - e pyeta.

- Gabimet që janë bërë më pari, të justifikueshme në rrethanat e atëhershme, sot kewi rast t'i riparojmë, - tha ai. - Kështu, urtë e butë, do t'u pritnim iniciativën kundërshtarëve të mundshëm. E ç'do të na bëjnë ata brenda Frontit? Praktikisht asgjë! Ata s'kanë forca, s'kanë baza dhe politikisht ua lidhim duart. - Ky do të ishte favorimi më i madh që mund t'u bënim, - e ndërpreva unë. - Të mos e hai-rojmë që Fronti është organizatë politike e popullit, e patriotëve që kanë luftuar për çlirimin dhe për pushtetin popullor. Kurse ti na propozon të futim në të tradhtarë e kriminelë, që nesër të na luftojnë nga brend.a, t'u krijojmë edhe kushtet që ata të penetrojnë edhe në organet tona të pushtetit, deri në Qeveri. Këtë nuk duhet ta lejojmë kurrë! Këtë s'e bëmë në kohët më të vështira dhe vepruam drejt e jo gabim, e jo tani kur vetë lufta e përcaktoi cilët qëndruan deri në fund në radhët e armikut.

- Unë s'them t'i futim në Parti, - nguli këmbë - «profesori», - Fronti nuk është si Partia, të mos i ngatërrojmë nocionet, sepse bëjmë gabime politike. Nuk them, gjithashtu, të futim në Front Mithat Frashërin apo t'i hapim dyert Abaz Kupit! Ah, jo, këto do të ishin gafa të rënda (!). Po ç'të keqe kemi, bie fjala, nga Cen Elezi? Ky mënjane ka qëndruar, na intereson ta kemi përballë? Apo s'ka edhe njerëz me vete! Të mos harrojmë edhe psikologjinë e malësorëve tanë, i ndjekin krerët, i besojnë... Ta shfrytëzojmë këtë rast. Një mendim të tillë kanë edhe shokët jugosllavë, duhet të vlerësojmë edhe praktikën e tyre; pastaj, përvoja historike na mëson se edhe në Bashkimin Sovjetik...

- Dëgjo Sejfulla, - ia ndërpreva leksionin që po mbante. - Unë në parim nuk jam dakord që të hapim dyert e Frontit «pa kufij», siç na thua ti. Nuk përjashtoj të diskutojmë për ndonjë element konkret, të shikojmë të kaluarën, efektivitetin e qëndrimin e tij dhe të vendosim.

Këto ishin fillimi i asaj fushate, e cila do të arrinte kulmin e vet në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror të Partisë në Berat me akuzat e Koçit, Sejfullait, Nako Spirut, Naxhije Dumes e të tjerëve, të orkestruar nga titistët se gjoja «s'ishin mbajtur afër njerëzit», «u ishin mbyllur dyert dhe Fronti ishte bërë i ngushtë» etj. Pas presionesh të tilla që bëheshin ditën e natën, në zyrë e në mbledhje, ata vërtet nuk arritën të hapnin dyert siç donin, por nga dritarja ia arritën të futnin në Frontin Nacionalçlirimtar edhe elementë të tillë, si Cen Elezi, Dan Kaloshi e ndonjë tjetër.

Veprimtaria e mëvo»nshme armiqësore e «patriotëve» të këtij kallëpi tregoi qartë edhe një nerë drejtësinë e pikëpamjes sonë si dhe qëllimet e atyre që na i imponuan përkohësisht. Është interesante se presionet e të deleguarve jugosllavë për «zgjerimin, e Frontit, përputheshin si ide e deri në individë të veçantë me ato të anglezëve, që kërkonin «pajtimin» tonë me Abaz Kupin dhe rne të tjerë krerë të reaksionit.

Ndërkohë armiku s'qie shporrur përfundimisht. Ziga Berati nënshkroi urdhrin drejtuar Korparmats I, divizioneve dhe brigadave për të sulmuar dhe për të çliruar Tiranën. Plani operativ për çlirimin e kryeqytetit që kishim hartuar, ishte pjesë përbërëse e planit strategjik, i cili do të bënte të mundur që deri në fund të nëntorit të mos mbetej këmbë armiku në gjithë Shqipërinë. I kishim të gjitha mundësitë për të arritur këtë objektiv. Ushtria Nacionalçlirimtare kishte tani në efektivin e vet mbi 70 mijë luftëtarë të organizuar në brigada, divizione, korparmata.

Për detajimin përfundimtar të planit të çlirimit të Tiranës bisedova me Hysni Kapon, i cili ishte i deleguari i Komitetit Qendror dhe komisar i Korparmats I dhe ishte përgjegjësi kryesor për realizimin e këtij plani.

Dhe ja në mbrëmjen e 16 nëntorit na erdhi në Berat lajmi se Tirana, kryeqyteti i atdheut tonë, thuhet ishte çliruar plotësisht. Pushtuesve dhe tradhtarëve nuk u kishin mbetur më shumë se disa orë jetë. Me një gëzim të papërmbajtur dhe me një emocion të veçantë, u ula dhe shkrova qysh atë mbrëmje mesazhin drejtuar popullit shqiptar për këtë sihariq të madh,* *(Enver Hoxha. Vepra, vëll. 2, botim i dytë, f. 586.) kurse të nesërmen, në mëngjesin e 17 nëntorit, u dëgjuan pushkët e fundit dhe kryeqyteti i atdheut tonë u çlirua një herë e përgjithmonë.

Rruga për Tiranë tashmë ishte e hapur. Pas kaq vjet betejash e përpjekjesh, mundimesh e sakrificash në krye të Partisë e të luftës për liri, erdhi çasti që ne djemtë e vajzat e popullit të liydim fitimtarë në kryeqytet.

Propozova që Qeveria të hynte në Tiranë më 28 nëntor, në ditën e shënuar të Shpalljes së Pavarësisë. Vetë zgjedhja e kësaj dite për vendosjen e Qeverisë Demokratike në kryeqytetin e çliruar nga armët partizane do të ishte kuptimplote.

Ndonëse r_ë kushte normale distanca nga Berati në Tiranë me automjetet rnbulohej në jo më tepër se tri orë, ne u nisëm nga Berati një ditë më parë, sepse rrugët ishin të prishura dhe mund të ndodhte edhe ndonjë vonesë e papara, shikuar. Dhe me të vërtetë udhë-timi ynë i parë nëpër atdheun e sapoçliruar s'mundi t'i shmangej njëfarë ocliseje. Deri tek ura e Hasan Beut, siç i thoshin në atë kohë Urës Vajguore, shkuam me disa automobila e me triçikla, që ia kishim zënë. armikut apo i kishim rekuizuar. Aty i lamë makinat e triçiklat, sepse më tutje nuk kalonin dot, ngaqë gjermanët në tërheqje e sipër e kishin hedhur në erë urën.

Kaluam, pra, Osumin me mjete rrethore dhe matanë hipëm në një autobus që r_a priste. Kur arritëm tek ura e Kuçit zbritëm edhe nga autobusi, e kaluam

am lumin me vështirësi rubi një trap të improvizuar dhe vazhduam rrugën, derisa në Rrogozhinë na «doli». përpara një tjetër pengesë: Shkumbini. E lamë autobusin, hodhëm lumin grupe-grupe me një trap të vogël dhe, me disa vetura të ardhura posaçërisht nga Tirana, u kthyem djathtas, në drejtim të Elbasanit, sepse rruga Rrogozhinë-Kavajë-Tiranë ishte e minuar dhe me ura të shkatërruara.

Meqë kishim kaluar vështirësi të panumërta gjatë luftës, nuk na bënë ndonjë përshtypje të jashtëzakonshme këto peripeci të urlhëtimit. Përkundrazi, na jepnin rast edhe për ndonjë shaka e humor. Sidoqoftë, gjatë gjithë kohës që urlhëtuam, duke parë majtas e djathtas mendoja se ç'punë të mëdha na pritnin, se rindërtimi duhej filluar nga gjithçka, nga shtëpitë e djegurat e nga këto ura, pa të cilat s'bëhej një hap.

Qyteti i Elbasanit kishte dy javë që ishte çliruar.

Nga ballkoni i hotelit akoma me emrin e mëparshëm «Moderno», ku u vendosëm për të kaluar natën, përshëndeta popullin, që kishte mbushur sheshin dhe rrugët. Të nesërmen në mëngjes, më 28 nëntor, kolona jonë u nis për në Tiranë e përcjellë me dashuri nga grumbuj njerëzish, nga të dy anët e rrugës, deri në të dalë të Elbasanit.

Edhe këtë rrugë ishte e dëmtuar, kudo dukeshin të freskëta gjurmët e luftës. Kolonat gjermane, të ardhura nga Greqia, nuk e kaluan dot Qafën e Kërrabës për t'u ardhur në ndihmë forcave të tyre, të futura në një darë të zjarrtë në Tiranë. Goditjet tona të fuqishme i shpartalluan krejtësisht. Anash rrugës shikonim tanke e autoblinda të përmbysura, automjete të djegurat, të zhvendosura pak sa për të hapur kalimin, pircje me gëzhoja mitralozash, helmata ushtarësh armiq. Sa më tepër i afrohem Tiranës aq më të dukshme bëheshin, nga të dyja anët e udhës, armët e shkatërruara të armiqve. Kishte diçka të bukur e simbolike në këtë peizazh: fitimtarët kalonin krenarë përmes armëve të thyera e mbeturinave të të mundurve, të pushtuesve.

Po kthehem në Tiranë tonë të dashur dhe, për herë të parë pas kaq vjetësh, hynim atje jo ilegalë, me emra e me dokumente false, por lirisht e, për më tepër, fitimtarë! Tirana që për vite me radhë ngrysej e gdhiehej mes fishkëllimave të bilbilave, sirenave të alarmit e në copifluco, tani ishte e gliruar pas një lufte heroike e të lavdishme. Këtë luftë e udhëhoqi Partia jonë marksiste-leniniste syshqiponjë, që nuk gaboi asnjëherë në vijë, se kishte në zemër dëshirat dhe aspiratat e popullit. Ajo mori përsipër barrën më të rëndë, por të shenjtë dhe e mbajti me nder duke e çuar këtë herë popullin tonë në fitoren e plotë, krahas lirisë ajo e sollti popullin në fuqi, në pushtet.

Duke iu afruar kryeqytetit, ndihesha i emocionuar dhe nëpër mend më vinin ditët që kisha kaluar atje, kur bashkë me shokë të dashur e të afërt, me Qemalin, me Vasilin e të tjerë, punuam që nga grupet e veçuara, në grindje me njëri-tjetrin, të krijonim Partinë tonë Komuniste, avangardën e çeliktë të popullit. Kujtoja demonstratat e aksionet tona të para, ditët e netët kur ilegalisht kalonim nga njëra bazë në tjetrën, t'6 ruajtur nga dashuria e njerëzve të thjeshtë të popullit. Këtu në Tiranë qemë rritur, qemë kalitur, kishim fituar eksperiencë për të organizuar e për të drejtuar, për të kryer detyrat që na kishte ngarkuar Partia jonë e dashur.

Që nga Pallati i Brigadave, gjatë Krugës së Elbasanit e deri në qendër, dukeshin gjurmët e luftës heroike. Nëpër rrugë, në gërmadhat e mureve të sht8pive e në godinat e tjera dukeshin shenjat që kishin lënë predhat e plumbat, deri edhe minarja në qendër, pranë sahatit të madh, ishte e prerë përgjysmë nga goditjet e artilerisë.

Por popullin e Tiranës e gjetëm të gëzuar, me këngë në gojë, entuziast e optimist, tek priste Qeverinë e tij. Një masë e madhe njerëzish kishte mbushur rrugët e bulevardin e madh para hotel «Dajtit».

Nga një tribunë e thjeshtë e përshëndeta popullin me rastin e Ditës së Pavarësisë, të cilën për herë të parë pas kaq vjet lufte e festonim të lirë.

- Flamuri ynë i lavdishëm, - thashë i emocionuar, - i skuqur me gjakun e heronjve të popullit të rënë në këtë luftë antifashiste, valon sot krenar në qiellin e Shqipërisë së lirë. Pesë vjet kanë kaluar nga robëria e rëndë fashiste, pesë herë nëpër rrugët e qyteteve të Shqipërisë, në çdo 28 Nëntor është derdhur gjaku i bijve heroikë, që përlesheshin me bajonetat e okupatorit dhe të tradhtarëve. Dita e Flamurit u bë kështu dita dy herë e shenjtë, Dita e Shpalljes së Pavarësisë dhe e bashkimit të popullit shqiptar.

I ndërprerë shpesh nga brohoritjet e duartrokitjet e pareshtura, fola për luftën heroike të popullit tonë, i cili iu përgjigj menjëherë kushtimit të bijve të tij më të mirë dhe, me Partinë në krye, arriti të çlirojë një herë e përgjithmonë atdheun e të marrë vetë frenat e së ardhmes në dorë.

- Ndërtimi i Shqipërisë, zhvillimi i ekonomisë, i kulturës dhe i arsimit të popullit, ngritja e nivelit të jetesës së tij hapin një faqe tjetër të historisë sonë, histori që është në dorën tonë ta bëjmë dhe do ta bëjmë po aq të lavdishme sa edhe Luftën Nacionalçlirimtare, - t'fiashë më poshtë. - Edhe në këtë luftë do të dalim fitimtarë, sepse tani ne kemi pushtetin tonë, që është i popullit dhe punon për popullin. Prandaj të japim çdo gjë për pushtetin, ta bëjmë këtë të fortë, se kështu do ta ndërtojmë vendin tonë të djegur, do të mëkëmbim bujqësinë dhe ekonominë tonë, do të ngremë shtëpitë e shkatërruara, do të çelim shkolla e do të ndërtojmë spitale. Shqipëria do të bëhet një kantier i madh pune. Në luftën për çlirim ne nuk kursyem as jetën, sot nuk duhet të kursejmë as mundin dhe djersën. I madh dhe i vogël e kupton se nuk robtohet më për të huajt, por punon e ndërton vendin e tij, jetën e tij.

Ishin çaste historike, emocionante e të paharruara për Partinë dhe për popullin tonë! Ishin çastet e gëzimit të fitores së madhe. Me gjak, me djersë, me mund e sakrifica kishim kryer një vepër gjigante dhe madhështore.

Të nesërmen e kësaj dite të paharruar na erdhi lajmi i çlirimit të qytetit të Shkodrës, i cili shënonte dhe çlirimin e gjithë Shqipërisë.

Pikërisht atë ditë dy divizione të Ushtrisë Partizane Nacionalçlirimtare, të asaj ushtrie heroike të popullit shqiptar, që me gjakun, heroizmin, vetëmohimin e saj kishte korrur fitore pas fitoreje mbi pushtuesit e huaj dhe bashkëpunëtorët e tyre, me urdhër të Koma

ndës së Përgjithshme, kaluan kufirin për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Fitore të reja do të shënoheshin në historikun e lavdishëm të Ushtrisë sonë Popullore. Ndërsa bijtë më të mirë të vendit tonë do të derdhnin gjakun për çlirimin e vëllezërve tane kosovarë, të Malit të Zi e të Maqedonisë dhe të popujve të Jugosllavisë, në Shqipëri 29 Nëntori shënonte fillimin e një epoke të re, të epokës së socializmit.

Kështu pranë ditës historike të 28 Nëntorit, Ditës së rradhe të Flamurit, u radhit Dita tjetër e madhe, 29 Nëntori, Dita e Çlirimit të Atdheut dhe e fitores së revolucionit popullor. Si njëra, ashtu edhe

tjetra datë përfaqësojnë dy periudha të ndryshme, por të lavdishme të popullit shqiptar, dy periudha të cilat do të shkëlqejnë me tërë madhësinë e tyre në rrjedhë të viteve dhe të shekujve. E tash periudha e re po niste. Të gjithë ishin të sigurt: ashtu siç kryem një vepër madhështore gjatë luftës, akoma më madhështore e më të mrekullueshme do ta ndërtonim e do ta mbronim veprën tjetër që kishim përpara - Shqipërinë socialiste!

V

VULLNETI I POPULLIT: SHQIPËRIA - REPUBLIKË POPULLORE!

Epoka e re filloi. Tani Partisë sonë, shtetit të ri shqiptar, organeve të tij të lindura në zjarrin e luftës, u duhej që me forca të shumëfishuara, bashkë me popullin e në krye të popullit, të ndërtonin nga themelet Shqipërinë e re. Duhej t'u provonim e t'u vërtetonim popullit tonë, miqve dhe armiqve, kujtdo, se ishim në gjendje jo vetëm ta merrnim, por edhe ta ruanim, ta forconim, ta bënim efektiv e vital pushtetin e ri, pushtetin popullor. Duhej ta bënim Shqipërinë vend të njerëzve të lirë e të lumtur, kështjellë të pakapërcyeshme nga çdo armik. E për këto nuk mjaftonin as dëshirat e mira, as thirrjet, as deklaratat. Mbi të gjitha, këto synime të larta do t'i realizonte e do t'i vërtetonte puna jonë, veprat loonkrete në të gjitha fushat, në të gjitha drejtimet. Koha nuk priste, gëzimin e madh të fitores historike të Clirimit, duhej ta shijonim vetëm në punë, në punët e mëdha, të shumta, të rënda, por të domosdoshme për t'u kryer.

1. Pushteti popullor në veprim

Kurrë nuk do të harrohen ditët, muajt e v:tet e para, kur ne hodhëm themelet e jetës së re. Kishim në duar pushtetin politik, kishim në mendje e në zemra idealet e larta të Partisë, kishim entuziazmin e besimin e madh të fitores së arritur, kishim vendosmërinë dhe gatishmërinë për të bërë gjithçka të mirë e të nevojshme për këtë vend e për këtë popull. Pa dyshim të gjitha këto ishin një bazë e fuqishme, një burim i madh energjish e frymëzimi që na shtynin e na siguronin Fe me punë, me përpjekje të gjithanshme: e do të arrinim gjithçka na mungonte.

Por fakti është se na mungonin shumë, shumë më tepër se ç'mund të imagjinojë apo të përfytyrojë sot kushdo që nuk e ka njohur Shqipërinë menjëherë sa kishte mbaruar lufta.

Varfërisë e prapambetjes së kaluar, gjendjes me të vërtetë mizerabël, në të cilën e kishin lëniu ekonominë, kulturën, arsimin, njeriun, regjimet e së kaluarës, në pesë vjetët e fundit u ishin shtuar shkatërrimet kolosale të luftës. Na duhej të mendonim e të siguronim sa më shpejt edhe strehën për dhjetëra e dhjetëra mijë njerëz të qyteteve e fshatrave të bëra shkrumb, edhe copën e bukës për popullin që vuante nga uria, edhe veshjen e mbathjen e njerëzve, edhe shkollën, punishtet etj. Na mungonin fondet, na mungonin mjetet, na mungonin specialistët, qoftë edhe me kualifikim minimal. „Nuk mund të lëvizje nga njëri rreth në tjetrin, sepse edhe ai rrjet i paktë komunikacioni që qe ndërtuar më parë, ishte hedhur në erë e qe paralizuar i tëri nga lufta. Kishte nisur dimri e ai akoma më tepër do ta vështirësonte gjendjen. Ndërkohë, megjithëse i tërë vendi qe çliruar, nëpër hone, pyje e shpella endeshin mbeturinat e fundit të botës së vjetër, kriminelë e banditë mercenarë që s'kishin arritur të largoheshin me pushtuesit, e tash, si bisha të plagosura, e kërkonin shpëtimin tek aktet e terrorit e të dhunës kundër popullit, kundër komunistëve e këshilltarëve. Në mbështetje të tyre, me fije të dukshme e të padukshme, ishin klasat e përmbysura nga pushteti dhe, doemos, fuqitë e huaja imperialiste e shoviniste, të cilat nuk mund të gëlltitnin kurrsesi përmbysjen rrënjësore që kishte -ndodhur e po thellohej në Shqipëri.

Të gjitha këto (dhe unë përmenda fare-fare pak nga mungesat, vështirësitë e armiqtë tanë të gjithanshëm të atyre momenteve), qëndronin përballë nesh e duheshin kapërcyer me çdo kusht. Gjersa fituam mbi pushtuesit dhe tradhtarët dhe morëm pushtetin me aq gjak e sakrifica, duhej ta çonim Shqipërinë patjetër përpara, për të mirën e lumturinë e popullit, për inatin e tërbimin e armiqve.

Më ka mbetur në mendje «historia» që më tregoi babai im ato ditë që ne u kthyem fitimtarë në Tiranën e çliruar. Pak ditë pasi në Berat qe krijuar e shpallur Qeveria jonë Demokratike, e kishte ndalur në rrugë një i njohur i vjetër, ballist dhe gjithë qesëndi i kishte thënë:

«E, o Halil, si e ndien veten tanfi që u bëre babai i zotit kryeministër?».

«Si gjithë vegjësia», i qe përgjigjur qetë-qetë babai dhe, pa ia zgjatur, kishte bërë të vazhdonte udhën, por ai e kishte zënë për krahu. «Je qerrata i madh ti Halil, bën mirë që s'e vret përpjetë, se e di mirë që Qeveria e djalit tënd s'e ka të gjatë». «Ç'thua, more edepsëz!», ia kishte kthyer babai, por ballisti kishte vazhduar: «E pse, kjo qeveri, me nder, e bythëgrisurve që po vijnë nga malet, kjo qeveri e rignonit do ta nxjerrë në selamet Shqipërinë!».

«Jazëk! ia ktheva, - më tregonte plaku. - Qeveria s'është e djalit tim, por e popullit, more edepsëz i edepsëzëve, dhe do të rrojë sa të rrojë populli!...».

Edhe herë tjetër, nga burime të ndryshme dëgjonim se si bota e vjetër, e përmbysur e armiqtësore, lëshonte helm e vrer kundër nesh, kundër pushtetit të ri popullor. Llogaritnin bile edhe ditën kur do të «kapitullonim» e do të «rrëzoheshim», merrnin edhe masa që ta bënin sa më të shpejtë kapitullimin e dëshiruar e të ëndërruar prej tyre.

Por ne as u ofenduam, as u stepëm nga nofkat, sharjet, klithmat e profecitë e asaj bote që i kishim vënë shqelmin. Vazhduam me këmbëngulje e heroizëm punën tonë, të bindur se me djersë e sakrifica do të bënim të gjitha ato që të tjerëve u dukeshin të pamundura.

Ashtu si gjer tanfi edhe për të ardhmen garanci e fener ndriçues, që do të na përcaktonte e do të na udhëhiqte në rrugën e drejtë, ne kishim Partinë, e cila tashmë ishte parti në fuqi, me moshë vërtet të re, por me një përvojë të madhe luftarake, me shpirt militant e vendosmëri të patundur për ta çuar veprën e nisur gjer në fund.

Shumë ishin përpjekur e do të përpiqeshin me lloj-lloj mënyrash, maskash, pretendimesh e teorizimesh, ta spononin Partinë tonë nga timoni, por fakt është se ne në realitet nuk lejuam e nuk ramë në këtë gabim tragjik. Veçanërisht në momentet e para pas Çlirimit, qoftë elementë kundërrevolucionarë të kamufluar brenda vendit, ashtu edhe forca të jashtme e ndër ta sidomos «miqtë» jugosllavë, na bënë presione të mëdha që, tash që fituam, të mos «e afishonim» Partinë, ta linim mënjane, të vepronte «brenda Frontit», e fshehur në Front, sipas «platformës së Frontit». E pse? Sepse, na thoshin, po të afishohet Partia Komuniste si parti në fuqi, dëmtohet «fasada demokratike» e Frontit dhe e rendit, egërsohen aleatët e mëdhenj demokratikë, Anglia e Amerika, dhe s*e njohin Qeverinë (!), tremben e largohen «të paqartët»! etj., etj.

Ndonëse kishte dhe ndonjë nga ata që në këto ujëra binte pa të keq, ngaqë kështu i dukej, kështu qe mësuar nga e kaluara, në përgjithësi, bartësit e nxitësit e zërave e të «këshillave» të tilla oportuniste e kapitulluese, niseshin nga qëllime të caktuara diversioniste politike. Ata s'i brente fare merak as për «demokracinë», as për «njohjen e Qeverisë»: hallin në realitet e kishin që ta spononin Partinë nga roli udhëheqës në jetën e vendit, ta kthenin në bisht të Frontit e gradualisht të devijonin krejt rrugën e revolucionit, të bënin që të na ikte nga duart gjithçka kishim fituar, pra ta futnin popullin nën zinxhirët e skllavërisë së vjetër e të traktateve të vjetra.

Pikërisht këtu synonin jo më elementë të tillë demokrato-borgjezë të afishuar, si: Shefqet Bejët, Riza Danët e Gjergj Kokoshët, por edhe Sejfulla Malëshova me shokë.

Nuk mund ta harroj kurrë atë çast, kur njëri nga këta, Gjergj Kokoshi, me «sinqeritet» prej naivi, më bëri një provokacion të ulët e nga më irrituesit.

Me të më kishte njohur që përpara pushtimit italian, kur isha mësues në Gjimnazin e Tiranës, Nexhat Peshkëpia, i cili e kishte Gjergjin shumë mik. Nexhati me të flitnin kundër Zogut dhe kundër influencës italiane në vendin tonë, bile që në takimin e parë, kur më prezantoi me Gjergjin,

Nexhati filloi të fliste hapur kundër Zogut. Gjergji shikoi Nexhatin, me siguri për ta pyetur me vështrim për mua.

- Mos ki frikë, - i tha Nexhati, - Enveri është yni, bile ky është komunist.

- Interessant është ky komunizmi, - tha Kokoshi dhe filltëm të shkëmbenim mendime, por që në bisedat e para u duk se në këtë çështje ai nuk ishte në një mendje me mua, kurse Nexhati nuk ishte as me mua, as me Gjergjin, ai qe anarkist. Veç një gjë na bashkonte: antizogizmi dhe antifashizmi. Në atë kohë Gjergj Kokoshi ishte një profesor me autoritet. Por nga idetë politike ai ishte demokrat liberal, partizan i parlamentarizmit, sidomos i atij anglez. Unë i vazhdova takimet me Gjergj Kokoshin edhe më vonë, sidomos pas prillit 1939, derisa e afruam me Frontin Nacionalçlirimtar dhe ne e konsideruam këtë një gjë pozitive për Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Kokoshi, si thamë, nuk tregoi lëkundje të hapura gjatë luftës, ai u zgjodh në instanca të larta të Frontit dhe, kur formuam Komitetin Antifashist dhe më pas Qeverinë Provizore, e caktuam si ministër të Arsimit, vend i përshtatshëm për të, sepse ishte njeri që e njihje arsimin, pastaj edhe kulturë kishte. Ne kishim respekt ndaj tij dhe ai, të paktën në aparencë, nuk tregonte ndonjë armiqësi kundrejt Partisë sonë. E ja, tani, në emër të «Frontit», të «njohjes sonë në botë», si një «mik nga jashtë Partisë», hyn edhe ky në vallen armiqësore për ta hequr qafe Partinë Komuniste të Shqipërisë!

Vërtitej fjala rreth «argumentit» se gjoja qeveritë e SHBA-së e të Anglisë do ta njihnin Qeverinë tonë, nëse ne e «tërhiqim» Partinë nga vija e parë, nëse e fshihnim, «qoftë edhe për taktikë» emrin e rolin e saj.

- Këtë s'do ta bëjmë kurrë, - ia preva «këngën» Gjergj Kokoshit, - sepse një veprim i tillë do të thotë që ne të braktisim me dëshirën tonë e për qejfin e anglezëve ato që kemi fituar. Kjo do të qe tradhti jo vetëm ndaj popullit, por dhe ndaj vetes.

- Po ne në fuqi jemi realisht! - më thotë Gjergj Kokoshi. - Ja, unë s'jam komunist, por jam ministër. Zoti Omer s'është komunist, por është President! Ju vërtet jeni komunist dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste, por, mbi të gjitha, edhe vendi edhe bota po ju njohin e duhet t'ju njohin si Kryeministër! Funkzioni shtetëror çmohet e nderohet në arenën ndërkombëtare!...

- Po, po e pastaj? - e pyeta me një zemërim që mezi po e përmbaja.

- Dua të dal atje ku e nisa ose më mirë atje ku qëndron edhe meraku juaj, - vazhdoi tjetri, dulce më ngulur sytë. - E ç'do të humbitnit nga fuqia e autoriteti juaj, nga pushteti juaj si Kryetar i Qeverisë, nëse

nuk do të jeni edhe Sekretar i Partisë?! Mendoj se asgjë! Po e njëjta gjë është edhe me fatet e vendit.

Gjersa kemi një Qeveri Demokratike né fuqi, gjersa

është Fronti si organizatë e gjerë politike, ç'do të prishte mosafishimi i Partisë suaj Komuniste? Asgjë! Ne kemi fuqinë né dorë, këtë s'ia japim askujt. Me...

- Të kam njohur për tjetër gjë, Gjergj Kokoshi! - thashë, e u ngrita né këmbë. - Nga marrëzia e intelektualizmit tuaj borgjez, ose nuk e di se nga ç'pozita të tjera, ju jo vetëm po hidhni baltë orbi Partinë tonë të shtrenjtë, por po më bëni edhe një l'rovokacion të rëndë. E si mendoni ju, mos unë e shokët e mi u bëmë komunistë dhe e udhëhoqëm popullin né luftë sa për t'u bërë kryeministra e ministra e, tash që morëm «fuqinë», të braktisim Partinë, çështjen e saj, fitoret e saj?! Kurrë, kurrë s'ka për të ndodhur kështu. Ne nuk luftuam që të bëhemi zotër të popullit, ne nuk luftuam sa për një ndërrim kabinetesh e kolltukësh, por luftuam e do të luftojmë gjer né fund për përmbysjen e madhe të kohës sé vjetër. S'jemi unë e ti né fuqi, por është populli. Pushteti që ngritëm, s'është as imi, as yti, por i popullit. Këto fitore populli i arriti me luftën e tij né rrugën që i tregoi Partia jonë Komuniste. Dhe mos harro, edhe ti vetë, pavarësisht se s'je komunist, u bërë ministër, sepse gjatë luftës re dakord, përkrahe e zbatove atë vijë, atë rrugë që tregonte e ku na udhëhiqte Partia Komuniste. Por ndryshimi E hendeku midis nesh qenka shumë më i rradh e më thellë se ç'e mendonim e parashikonim ne. Ti ke luf tuar për kolltuk, kurse ne kemi luftuar e luftojmë për Shqipërinë. Kjo qe përgjigjja më e butë që mund të të jap këto çaste. Sa për «merakun» tënd për rolin e Partisë sonë, po ta deklaroj prerë dhe pa ekuivok: kurrë s'do të lejojme jco më ta zbehim rolin e saj me duart tona, por as ta Drekin apo ta cenojnë të tjerë, kushdo qofshin ata!

Gjergj Kokoshi u largua si pulë e lagur dhe, pasi u thellua edhe më tepër në rrugën e tij, rrugë që ishte e kundërt me atë ku udhëhiqte Partia popullin, doemos e humbi edhe kolltukun, edhe pendët e tjera që i kishin mbetur. Do të flas edhe më poshtë për të e për të tjerë «demokratë» si ai, që rastësisht ose për diversion, ishin bashkuar me ne në ato vite, por këtu dua të nënvizoj se nga përpjekjet e insinuatat e tyre ne as u stepëm, as u ngatërruam ndonjëherë.

Ndryshe qëndron për puna, sidomos për një periudhë, me «miqtë» jugosllavë e me agjentët që kishin mundur të rekrutonin brenda radhëve tona, e për fat të keq, gjer në disa kuadro më kryesorë të Partisë.

Gjithnjë me po ato «merake», «argumente» e «këshilla» si demokratët borgjezë, edhe njerëzit e Titos bënin ç'është e mundur që ne ta mbanim Partinë në gjendje ilegale ose, e shumta, gjysmilegeale, ta fshihnim në Front, ta shkrinim me Frontin.

Presionet e demarshet e tyre të pandërprera, veçanërisht përpjekjet e tyre për të më izoluar mua nga Partia, arritën që, në rrafshet e tyre, të zënë edhe vend. Për njëfarë kohe të rrethimit u krijua një gjendje thuajse absurde dhe e papranueshme: ndonjëse Partia jonë drejtonte e udhëhiqte efektivisht, në pamje të jashtme, «për opinionin», bëheshin përpjekje të fshihej e të mbulohej emri e roli i saj i vërtetë.

Pa qenë nevoja të futem në ato hollësi që tashmë njihen mirë, dua vetëm të them se vërtet presionet e titistëve patën njëfarë efekti, por realiteti është se Partia jonë asnjëherë nuk lëvizti nga roli që kishte fituar me forcën e ideve të saj dhe me gjakun e veprën e anëtarëve të saj. E afishonim apo jo kudo e kurdoherë fjalën e rolit të Partisë, këtu kishte edhe ndonjë lëshim që vetë ne e quanim absurd, por, ama, në realitet ishte Partia, nga baza në qendër, që drejtonte e vepronte në gjithë jetën e vendit, në pushtet, në Front, në mbrojtje, në ekonomi, kudo.

Pikërisht se Partinë e mbajtëm në komandë e s'lejuam as ta zbehnim, as ta ndanim me kënd tjetër rolin e saj, ndaj edhe në atë periudhë të rëndë e të vështirë, kur shumë kapitulluan e degjeneruan, ne, «më të papërvojët», «më të rinjtë», ne «të qeverisë së rigonit», ditëm të kapërcejmë malet e vështirësive dhe jo vetëm ta ruanim, por edhe ta afirmuam, ta forcuam e ta kalitnim përshtur pushtetin e popullit në fuqi.

Si në luftë, edhe në periudhën e re të punës ndërtimore, Partia dhe Qeveria e re Demokratike iu drejtuan popullit, u mbështetën te populli duke bërë për vete e duke mobilizuar popullin.

Nuk mund ta harrojmë kurrë mobilizimin e paparë, entuziazmin e papërshkruar të popullit tonë të mrekullueshëm në betejat për shërimin e plagëve të luftës. Të pangrënë e të paveshur mirë, të ndërgjegjshëm se në shtëpi apo në strehën ku kishin futur përkohësisht kokën u mungonte edhe buka e fasulja për kalamanët, e, megjithatë, burra e gra, fëmijë e të moshuar e sidomos rinia jonë heroike, punonin vullnetarisht ditë e natë për të ngritur nga gërmadhat jetën e re. Shqipëria u kthye në një lloj kantieri ku, vërtet mbizotëronte vetëm puna e krahut, por njerëzit punonin me qejf e dëshirë, se e shihnin që punonin për vete. Kjo, doemos kishte efekte të mëdha për të kalitur unitetin, për të rritur dashurinë e popullit për Partinë dhe për Qeverinë tonë të ligjshme.

Shteti i ri po vendoste autoritetin e tij në radhë të parë në fushën ekonomike, duke vendosur kontrollin mbi të gjitha ndërmarrjet e shoqëritë e tregtarëve e të industrialistëve shqiptarë, duke rekuizuar produktet ushqimore, farmaceutike, rrejtjet e transportit, ndërtesat e nevojshme për administratën shtetërore apo për banesat etj., disa me pagesë, disa pa pagesë. Gjithashtu u konfiskuan të gjitha pasuritë e kriminelëve të luftës, të të arratisurve politikë, dhe pasuritë e Gjermanisë e të Italisë dhe të shtetasve të tyre. Gradualisht filloi shtetëzimi i të gjithë industrisë ekzistuese në vendin tonë; minierat, fabrikat, dyqanet e shtetëzuara apo të konfiskuara u bënë shtetërore dhe ishin baza e parë e pronës së përbashkët socialiste.

Kështu, duke përdorur me mençuri e konsekuencë pushtetin politik që e kishim krijuar e fituar me luftë, Partia na orientoi e na udhëhoqi edhe në rrugën e drejtë për të fituar pushtetin ekonomik, për ta vënë edhe ekonominë në shërbim të popullit e në duart e popullit. Vetvetiu, kështu fuqizohej edhe pushteti politik, fuqizohej e çelikosej besimi i masave tek organet e tij drejtuese, populli e ndiente dhe e shihte se gjithçka bëhej në favor të tij e në emër të pushtetit të tij.

Borgjezia po ndiente në palcë shpatën e mprehtë të diktaturës së proletariatit. Masat dhe reformat e para nuk kishin vetëm karakter ekonomik, tehu i tyre ishte më i mprehtë në thelbin e tyre klasor politik. E tillë ishte edhe venia e tatimeve të jashtëzakonshme për fitimet e luftës. Kjo që një masë me tendenciozitet të theksuar klasor, sepse godiste brinjë më brinjë borgjezinë tregtare, e cila, si gjithmonë, edhe gjatë periudhës së luftës, ishte majmur me gjakun dhe mjerimin e popullit.

Partia dhe Fronti u kishin dalë borxhit, duke u bërë vazhdimisht thirrje, që të bashkoheshin dhe të hidheshin apo të ndihmonin luftën e popullit, por tregtarët, borgjezët, feudalët, jo vetëm nuk dëgjuan, por e përçmuan dhe iu kundërvunë me të gjitha mjetet dhe mënyrat e paskrupullta të luftës popullore. Tani që populli ishte në fuqi dhe ushtronte diktaturën e vet, këto masa nuk shprehnin padrejtësinë (populli në asnjë moment të zhvillimit të shoqërisë nuk mund të jetë i padrejtë) e një pushteti, por drejtësinë më sublime që mund të aspirojë një shoqëri. Me këto masa i viheshin minat një herë e përgjithmonë kthimit të së kaluarës dhe hidheshin themelet e një shoqërie të re, të shoqërisë socialiste.

Që të vihej në vend dhe të realizohej drejtësia dhe hakmarrja popullore ndaj gjithë atyre që kishin lyer duart e tyre me gjakun e bijve më të mire të vendit, që kishin djegur, që kishin shërbyer si bashkëpunëtorë të pushtuesit, duke shitur gjithçka, po mbi të gjitha atdheun, në mars të vitit 1945 u hap gjyqi special. Para tij dolën një numër i madh kriminelësh e tradhtarësh, në mes të cilëve anëtarë të qeverive kuislinge, krerë të Ballit Kombëtar, spiunë të fashizmit, si: Fejzi Alizoti, Tefik Mborja, Shuk Gurakuqi, Bahri Omari, Kolë Tromara, Hilmi Leka, Ibrahim Biçaku e të tjerë.

Ndërkohë, në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë i dërgova një letër presidentit Truman, ku shprehja indinjatën e popullit tonë për trajtimin e mirë që u bëhej nga autoritetet anglo-amerikane në Itali kriminelëve shqiptarë të arratisur në fund të luftës. Kjo ishte një kërkesë e ligjshme dhe mospërgjigjja

ndaj saj ishte një padrejtësi tjetër që i bëhej popullit shqiptar, i cili këmbëngulte që Ali Këlcyra, Mithat Frashëri, Abaz Kupi, Kadri Cakrani, Koço Muka, Vehip Runa, në vend që të ishin në bankën e të akuzuarve krahas tradhtarëve dhe kriminelëve të tjerë dhe aty të merrnin dënimin e merituar, trajtoheshin mirë dhe liheshin të lire të vazhdonin intrigat e tyre fashiste në dëm të popullit tonë. Nuk ishte e vështirë të kuptohej se ku synonin anglo-amerikanët në trajtimin e tyre ndaj tradhtarëve dhe kriminelëve të popullit shqiptar. Nuk do të vononte që ata të përdroreshin si mish për top apo edhe t'i hanin kokën njëri-tjetrit, si karavidhe që ishin.

Gjyqi u dha dënimin kapital disa prej tradhtarëve të gjykuar. Ky ishte një dënim i merituar, që shprehte vullnetin e popullit, i cili e ndoqi me interesim të madh zhvillimin e këtij procesi. Në ditët kur zhvilloheshin seancat, populli, që i ndiqte ato si brenda në sallën e kinemasë, ashtu edhe jashtë saj, jepte dënimin e pakundërshtueshëm, duke thirrur

- Rroftë drejtësia popullore! Vdekje kriminelëve të luftës!

Pikërisht në kohën kur gjyqet e popullit dënonin kriminelët e luftës, tradhtarët, sabotatorët dhe komplotuesit kundër pushtetit popullor, Koçi Xoxe, si ministër i Brendshëm që ishte, më vuri në korent edhe për veprimtarinë e një grupi armiqësor mbi të cilin po bëheshin hetime dhe për personat kryesorë armiq. Radhazi. radhazi, një ditë më tha se në këtë grup ishte implikuar edhe Syrja Selfoja, «për rrëzimin e pushtetit» Unë hapa sytë dhe i them Koçit:

- Si the, Syrjai? Është e pamundur, gaboheni! Syrjai s'mund të ngrihet kundër pushtetit popullor.

Syrjai ishte nga Selfot, që qenë tregtarë të mëdhenj. Këta, me përjashtim të vetë Syrjait dhe Halitit, i cili doli partizan, qenë të këqij. E mes tyre vinte në radhë të parë Reiz Selfoja që mbahej si i pari i familjes së Selfove. Ky ishte një nga më reaksionarët e më dallaveraxhinjtë dhe ekspert në rrethin e tregtarëve të mëdhenj. E kishte mirë me çdo regjim, me Zogun dhe me italianët. Vetëm me ne nuk i shkoi, sepse, për krimet që kishte kryer ndaj popullit e atdheut, i treguam vendin dhe gjyqi e dënoi me pushkatim. Unë e njihja mirë Reizin, më kishte rastisur të takohesha me të, por rrallë të bisedoja. Ishte shumë i rëndë e «s'kishte kohë» të merrej me njerëz si ne. Kurse Syrjain e kisha shok të mirë, me të cilin bisedoja shpesh dhe më kishte kuptuar; ai komunist nuk ishte, por ishte patriot, antiitalian, antifashist. Mua veçanërisht më donte sinqerisht dhe unë po ashtu. Me Reizin ai nuk i kishte «të grunjtat», por Reizi s'kishte ç'bënte, pse Syrjai ishte më i zoti në punë dhe jo i lig si ai.

Syrjai e ndihmoi luftën sa munda, dy shtëpi që zuri me qira na i vuri në dispozicion të punës sonë ilegale. Jepte ndihma në të holla për luftën tonë, edhe mua personalisht gjatë luftës më ka ndihmuar shumë, po ashtu dhe familjen time kur dola në ilegalitet.

Kur çlirua Shqipërinë, Syrjai ishte i gëzuar. Një ditë e takoj dhe i them:

- Erdhi dita për të cilën luftuam, por lufta po vazhdon. Tash të gjithë tregtarëve do t'u vëmë taksat e luftës dhe këto do të jenë të rënda. Selfot do të jenë në mes të këtyre.

Syrjai më tha:

- Zjarri t'u hyjë nga fundi në krye, të tëra i merrni dhe unë do t'ju ndihmoj. Unë vetëm dua të punoj, pa të tëra i konfiskoni.

Dhe kështu bëmë. Syrjai ishte me ne, ai kurrë nuk mund të ndahej nga ne.

Dhe ja ku, krejt papritur, më vjen Koçi Xoxe e më thotë se Syrjai na qenkësh implikuar për «rrezimin e pushtetit popullor»! Tronditjes dhe kundërshtimit tim të hapur Koçi Xoxe aty për aty iu përgjigj me «gjakftohtësi»:

- Ka deponuar vetë. Ka pohuar çdo gjë dhe ka firmosur!

- Më sillni procesverbalin e tij, se unë ia njoh firmën.

Ma solli, e lexova dhe e pashë se ishte firma e Syrjait. U mendova dhe i thashë Koçit:

- Mos e kanë torturuar?

Koçi më bëri be e rrufe:

- Në asnjë mënyrë. Ne me vendim të Byrosë e kemi ndaluar torturën.

- Mirë, - i thashë, - të shkojë në gjyq, le ta gjykojë gjyqi dhe të zbatohet vendimi i gjyqit.

Më vonë, kur u zbulua tradhtia e Koçi Xoxes dhe e jugosllavëve, dolën në shesh të gjitha poshtërsitë e tyre, u gjetën edhe dosjet që përgatitnin në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mua e për të tjerët. Çështja e Syrja Selfos e ndonjë tjetri nuk ishte veçse një kurth për të më komprometuar, duke arrestuar miqtë e mi, duke i torturuar këta për vdekje për të pranuar dhe për të firmosur ç'u diktonte grupi i Koçi Xoxes dhe i jugosllavëve.

Gjatë po kësaj periudhe, po ky Koçi Xoxe që s'e kishte për gjë të çonte në gjyq të pafajshmit, bënte lloj-lloj presionesh e demarshesh për të zbutur dënimet e armiqve të vërtetë që ishin vënë në bankën e të akuzuarve. Duke i rregulluar telat edhe me Sejfulla Malalëshovën e Nako Spirun, propozuan në Byronë Politike t'ua falnin jetën kriminelëve që kishim çuar në gjyq. Në të vërtetë, qëllimi i Koçit, qoftë në dënimin e të pafajshmëve, ashtu edhe në butësinë ndaj kriminelëve ishte që të më komprometonte mua. Ishte koha kur ky, në bashkëpunim me jugosllavët, pas Plenumit të Beratit, kishte filluar të përgatiste «materiale» me akuza e shpifje komprometuese për mua. Unë e hodha poshtë propozimin e tyre dhe thashë që të gjithë tradhtarët e kuislingët të dënoheshin sipas vendimeve të gjyqit të popullit, duke mos përjashtuar edhe Bahri Omarin.

Po kështu, më vonë, do të merrte dënimin e merituar edhe Sheh Karbunara. Ky njeri shumë dinak, ky ballist, baslzëpunëtor i krerëve të Ballit, që hidhte gurin dhe fshihte dorën, nuk ishte afishuar publikisht as me italianët, as me gjermanët. Ai e kishte ruajtur lëkurën, bile në mornentet kur qerrja e nazizmit kishte marrë tatëpjetën, ishte hequr edhe si simpatizues i Frontit dhe i Partisë, por unë kurrë s'kisha pasur besim në këtë «kthesë» të baba Shehut dhe isha i bindur se ai qe njeri i reaktionit, që e urrente Partinë tonë. Ai kishte luftuar, ndonëse fshehurazi, kundër Frontit Nacionalçlirimtar. Por Karbunara ishte treguar, siç e thashë, më i mençur sesa miqtë e tij, si Kolë Tromara e Ali Këlcyra, të cilët, edhe kur Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar u bëri thirrje të bashkoheshin me Luftën Nacionalçlirimtare kundër gjermanëve, këta elmentë jo vetëm nuk pranuan, por, përkundrazi, si krerë të Ballit Kombëtar e bashkë me të, u futën hapur në shërbim të pushtetit. Që nga ajo kohë atyre s'iu drejtua më me thirrje, por me grykën V e pushkës.

Pas Çlirimit të Shqipërisë Sheh Karbunarën, Sejfi Vllamasin e ndonjë tjetër, duke mos qenë armiq të afirmuar si shokët e tyre, i lamë të lirë, nuk i arrestuam, se edhe fakte flagrante komprometuese nuk kishim. Mirëpo i paralajmëruam seriozisht se, në rastin më të vogël që do të konstatohej se do të vepronin ku

ndër pushtetit popullor, do të arrestoheshin dhe do të kalonin para gjyqit revolucionar. Pranuan me gojë, por jo me vepra, sidomos Sheh Karbunara.

Kur po zhvillohej gjyqi i tradhtarëve- kuislingë e kriminelëve të luftës, më kujtohet, një ditë po kthehesha në Tiranë nga Berati, ku kisha qenë për punë. Nii atë kohë mbaja uniformën blu të gjeneralit, me shirita të kuq e me çizme. Kur i afrohem Karbunarës, shoh Shehun, me taç e me xhybe, që kishte zënë mesin e rrugës e kishte ngritur dorën, duke bërë me shenjë që të ndaloja. I thashë shoferit ta ndalte makinën, ta linte Shehun të afrohej. Unë nuk zbrita nga makina, se doja apostafat ta poshtëroja dhe t'i jepja të kuptonte këtij armiku se pikërisht ne, Partia dhe populli, që luftuam dhe fituam, ishim né fuqi. Shehu, duke hequr këmbët, hapi derën e makinës, u përkul, më përshëndeti, më dha dorën dhe unë pa lëvizur i dhashë dorën.

- Ç'kishit? Pse më ndalët? - e pyeta.

- T'ju uroj, më parë, - tha.

- S'kam nevojë për urimet tuaja, - i them. Keni ndonjë gjë tjetër?

- Të ndala, - tha, - të të lutem të falësh disa nga ata që po gjykohen.

- E kam merak vetë, - i them prerë. - Koka e tradhtarëve, e ministrave kuislingë né shërbim të gjermanëve, e krerëve të Ballit Kombëtar e kujtdo, që na vuri pushkën, i është dhënë né duar drejtësisë se popullit. Shokët e miqtë e tu, Sheh Karbunara, i kanë duart të lyera me gjakun e popullit dhe të shokëve tanë, prandaj mos u bëj aspak merak, jam i sigurt se drejtësia e popullit do t'u japë atë që meritojnë.

- Ijata, more Enver...

- Dëgjo, Sheh Karbunara, - i them, - kur unë ju thosha, bile ju lutesha, të hiqni dorë nga rruga e tradhtisë, ju mendonit se italianin dhe gjermanin ishin më të fortë nga populli ynë dhe nga Partia jonë, që ju i tallnit dhe i luftuat. Mirëpo ndodhi e kundërta e asaj që mendonit dhe kjo nuk ishte një mrekulli e fatit dhe e zotit që beson ti, por ishte rezultat i mendjes, i zotësisë dhe i trimërisë së Partisë, të komunistëve dhe të popullit tonë.

Unë e di fare mirë që ti, Sheh, ke qenë tok me Kolë Tromarën me shokë, por ua hodhe mirë atyre, hodhe gurin dhe fshehe dorën. Ne nuk të arrestuam, jo për sytë e tu të buku.r, por se s'kishim aq fakte konkrete për ty, se perndryshe edhe ti do të ishe sot me ta, né bankën e tradhtarëve. Komunistët, që ju i shani, janë njerëzit më të drejtë né botë, më të dashurit me popullin dhe të sakrificës për çështjet e tij të mëdha. Pra, shpëtove një herë, të dytën herë nuk do të shpëtosh, prandaj të këshi: lloj të rrish urtë, të mos komplotosh kundër popullit, se atëherë do të të tregojmë vendin. Kaq kisha pi?r të të thënë.

Oficeri mbylli derën e automobilin, e lashë Sheh Karbunarën né tymin e rrugës e më s'ia pashë sytë. Ky armik nuk hoqi dorë nga veprimtaria kundër pushtetit popullor. Ai u bë pjesëtar i komplotit të kurdisur nga agjentura anglo-amerikane e Shefqet Bejës, Gjergj Kokoshit, Riza Danit e të tjerë. Kështu edhe Sheh Karbunara u dënua nga gjyqi i popullit.

Shoku tjetër i tyre, Sejfi Vllamasi, uli kokën, hëngri ato pare që kishte grumbulluar, u rreckos dhe, më né fund, kur mbeti keq për bukë, u detyrua të kërkonte një punë çfarëdo. Ishte plakur. As kisha pyetur për të ndonjëherë. Një ditë, kur shkoja për né Vlorë, u ndala né fermën e Gosës, u poqa me drejtorin dhe i them si venë me punët. Ai më dha shpjegime. Afec rrugës ishin ca baranga lyer me gëlqere. E pyes:

- Ç'janë këto baranga?

- Është stalla e derrave, - më thotë.

- Vemë e shohim, -- i thashë.

Hyj brenda dhe takoj një fshatar plah, kavajas. E dija se pleqtë kavajas, sidomos né vitet e para, ishin fanatikë, veçanërisht derrin jo vetëm s'e hanin, por as e duronin dot, sepse ishte bërë «haram nga pejkamberi». I them plakut:

- Më vjen shumë mirë që ti ruan derrat.

- Ç'të bëj, - thotë, - dua të rroj. Pastaj, si më njohu, më tha me zë të ulët:

- Po ta them ty në vesh, se ti na i di hallet. Këta derra nuk i shoh dot me sy, por unë e dua Partinë dhe bëj si thotë ajo. E shikon këtë shkop të gjatë? Me këtë i prek derrat, me afizallah se i zë me dorë.

Ia futëm një të qeshuri të madh që të tre. Të qeshurit tonë tërhoqi drejt nesh një plak tjetër, të rreshkur, të rreckosur, edhe ky ruajtës derrash që u afrua, më dha dorën dhe më përshëndeti.

- Si jeni, zoti Enver?

Ngre kokën ta shoh, se më tërhoqi vëmendjen fjala «zoti» në gojën e fshatarit, kur këta kurdoherë thonë «shoko». Po kë shoh? Sejfi Vilamasin! Ishte bërë rojtar derrash.

- Me gjithë ç'keni bërë, - i them, - Partia e komunistëve nuk ju la pa punë dhe për herë të parë po e fiton bukën me djersën e ballit.

- Si urdhëron, zoti Enver, por tash u plaka.

- V plake, ky është ligj i natyrës, por ç'të bësh, duhet të hash dhe, që të hash, duhet të punosh.

- Ashtu është, zoti Enver, - tha Sejfiu, - por në ka mundësi të më japë Qeveria një pension.

- Pension? Përse? Që nuk ke punuar kurrë, apo pse ke qenë në «Këshillin e shtetit» fashist, apo që s'ke bërë kurrë një vepër patriotike? Në kohën e Nolit ti votoje për reaksionarët, në emigracion luajte kumar kur populli vuante, pastaj erdhët me Italinë dhe i shërbyet asaj dhe gjermanit. Për këto «merita» e kërkon pensionin?

- Pse i tillë ishte ky, a?! - ndërhyri fshatari kavajas. - Ky qenka më i keq se këta derrat. Allahile, shoku Enver, nuk e njihja.

E pashë edhe një herë tjetër, pas disa vjetësh në një trotuar në Fier. Ishte kërrusur, qe bërë si xhumbë «diplomati i Ballit». Pyeta ç'bëhet. Më thanë se ka një pension të vogël, pse kishte qenë ruajtës derrash. Shoku që m'i tha këto ishte i ri, as që ia kishte dëgjuar kurrë emrin këtij ballisti, prej të cilit dhe prej shokëve të tij kishim hequr kaq të këqija.

Ja kështu nisën të spastrohen njëra pas tjetrës ferrat e gjembat e së kaluarës, shushunjat që i kishin pirë gjakun popullit, gjarpërinjtë që e kishin helmin në majë të gjuhës.

Të gjitha këto rritnin e fuqizonin pozitat dhe autoritetin e Partisë e të shtetit të ri, masat e popullit gjithnjë e më tepër po bindeshin se te rruga ku i udhëhiqte Partia ishte e ardhmja e tij më e sigurt.

Pritja e ngrohtë që u bëri populli masave e ligjeve të para që nxori Kryesia e Këshillit Antifashist (nga Çlirimi i vendit deri më 11 janar 1946, kur u mbledh Asambleja Kushtetuese, kjo Kryesi ishte organi më i lartë legjislativ), ishte aprovimi më i madh që mund t'i jepej drejtësisë së vijës që po ndiqte Partia dhe pushteti popullor. Reformat me karakter demokratik që u ndërmorën në këtë kohë, forcuan bazën ekonomike të shtetit, forcuan besimin e masave popullore tek ai, sepse tani të gjithë po e shihnin se pushteti i ri ishte armiku më i papajtueshëm i borgjezisë, i feudalëve, i spekulatorëve, se Qeveria Demokratike ishte e zonja të drejtonte dhe të organizonte jetën e vendit. Jeta e popullit ishte e vështirë, por ai po e shihte me sytë e tij se si Partia dhe organet e pushtetit po bënë pamundurën për të krijuar kushte të tilla, që jeta të rridhte normale, që plagët e luftës dhe të së kaluarës të mbylleshin sa më parë.

Një ndër revolucionet e mëdha e të thella që iu përveshëm qysh në fillim dhe, me përpjekje e konsekuencë e çuam gjer në fund, ishte kryerja e Reformës Agrare. Me këtë revolucion në jetën e fshatit shqiptar, ne jo vetëm plotësonim një nga aspiratat shekullore dhe premtimet e para që i kishim bërë gjatë luftës aleates besnike të klasës punëtore, fshatarësisë trime e patriote shqiptare, por edhe kryenim një shndërrim kolosal të marrëdhënieve në prodhim dhe hapnim udhën drejt lindjes së marrëdhënieve socialiste në fshat, që Partia e kishte në programin e saj perspektiv.

Për hartimin e këtij ligji, i cili, siç dihet, u aprovua në verën e vitit 1945, ishte punuar për një kohë të gjatë dhe, si gjatë hartimit, ashtu dhe gjatë diskutimit të tij, qoftë në Byronë Politike të Komitetit Qendror, qoftë në KANÇ, janë bërë debate të zjarrta. Orientimeve të Komitetit Qendror që Reforma Agrare jo vetëm do t'u jepte tokë fshatarëve pa ose me pak tokë, por duhet të zhdukte mundësinë e lindjes së ekonomisë kulake që shfrytëzonte punën e të tjerëve, iu kundërvunë me lloj-lloj marifetesh, «vërejtjesh», «sugjerimesh», që nga Riza Dani e Shefqet Beja e gjer te Sejfulla Malëshova.

- Vërtet fshatari i këputur duhet të marrë një copë tokë, - thoshte Riza Dani, - por të mos kalojmë në ekstremitete e të ndezim luftë civile, mërirë e hakmarrje në fshat. Nuk duhet të kënaqim disa e të armiqtë tonë të tjerët!

- Ata «disa» që përmendni ju, - iu ktheva, -. janë mijëra e dhjetëra mijë fshatarë, që tërë jetën kanë ëndërruar për tokën, duke e derdhur djersën lumë në favor të një grushti pronarësh të mëdhenj. Luftën nuk e bënë këta pronarë të mëdhenj të tokave, por e bënë ata që s'kishin asgjë, mijërat. Ndaj tokën do t'ua japim këtyre, pa u bërë shumë merak nëse u pëlqen apo s'u pëlqen kjo kulakëve. Sa për luftë civile është e kotë të flasim. Le të provojnë ata që do të shpronësohen të ngrenë dorë. Populli do t'ua presë gjer në rrëzë, se tani është koha e popullit e jo e feudalëve dhe e kapitalistëve. Sejfulla Malëshova luftonte kundër Reformës nga pozita më «të moderuara»:

- T'ua ndajmë tokën fukarasë, - thoshte, - por të mos harrojmë mentalitetin e fshatarit tonë. Ata do të kënaqen me pak në krahasim me hiçin dhe s'do të jenë të interesuar për prodhimin e madh bujqësor. Do të na kërcënojnë zia e bukës.

- E si mendon ti, si duhet bërë? - e pyeta.

- T'u japim një Basi minimale fakirfukarenjve, sa për të plotësuar nevojat e tyre, kurse pronarëve t'ua zvogëlojmë, por t'u lëmë të paktën deri 40 hektarë. Këta ia dinë leverdinë prodhimit të madh e do t'i bëjnë ekonomitë e tyre shembullore, do të prodhojnë edhe për qytetin.

- Kjo do të qe tallje me Reformën Agrare dhe me fshatarësinë, - e kundërshtova rreptësisht. - Për më keq kjo do të qe favorizim për kulakërinë.

- Kam qenë e jam në shpirt armik i deklaruar i kulakëve që në krijimet e mia të viteve 30-të, - u mbrojt menjëherë Sejfulla Malëshova. - Por tani duhet të mendojmë jo vetëm për bukën e fshatarit, por për bukën e gjithë popullit. Në emër të bukës së popullit duhet të bëjmë edhe ndonjë koncesion ndaj të pasurve, edhe ndonjë dallim. Të mos harrojmë, shokë, se këto janë probleme të thella. Të mos harrojmë se ta presësh shpëtimin nga copëzimi i vogël i pronës, kjo do të thotë të dekretosh mediokritetin e përgjithshëm !

- E kam kënduar te Lenini këtë! - ndërhyri aty për aty, më duket, Nako Spiru.

- Ekzakt! - tha duke u krekosur Sejfullai.

- Po! - ndërhyra për t'ua prerë vrullin «teorik». - Të gjithë e lexojmë Leninin dhe luftojmë të vëmë në vend mësimet e tij e të mësuave tanë të mëdhenj. Por, ti, Sejfulla, duke ngatërruar qëllimet tona, ngatërron e shtrembëron edhe Leninin. Asnjëherë ai nuk ka qenë e nuk është shprehur kundër Reformës Agrare. Ne vetë nga Reforma Agrare që duhet të kryejmë, nuk mendojmë se prej pronës së vogël do të gjejmë shpëtimin e plotë e përfundimtar. Jo, shpëtimin do ta gjejmë te prona e madhe, veç jo kapitaliste e as feudale, por te prona socialiste, shtetërore e kooperativiste. Le ta marrë bujku tokën që i takon dhe, gradualisht, ai vetë do të bindet e ne do të luftojmë ta bindim, që shpëtimi i tij dhe i shtetit, pra e ardhurja, i takon bujqësisë së madhe, kolektivizimit. Por e theksoj: te prona e madhe socialiste ne do të kalojmë përmes Reformës Agrare, përmes pronësimit të papronëve, bujqve të varfër!

Sidoqoftë me këmbënguljen e Sejfullait dhe me aprovimin e hapur apo të heshtur të Koqi Xoxes, Pandi Kristos e të tjerë në Byro e në Komitetin Qendror të Partisë dhe më pas me mbështetjen e Riza Danëve e Kokoshëve në Këshillin Antifashist Nacionalffirimtar, ligji i Reformës Agrare, ndonëse qe një ngjarje e rëndësishme në transformimin e marrëdhënieve në fshat, fillimisht pati një sërë të metash. Në ligj lejoheshin sasi të mëdha tokash në pronësi familjare për të ashtuquajturat «ekonomi shembullore» deri në 40 hektarë, që ishte një sipërfaqe mjaft e madhe për kushtet e Shqipërisë dhe ruante të pacenuar pozitat e çifligarëve e të kulakëve. Ndonëse fillimisht ky ligj nisi të zbatohet, e ndienim se kishte të meta dhe nuk do të na çonte në zbatimin e plotë të parimit «toka i përket atij që e punon». Prandaj në një varg mbledhjesh në udhëheqjen e Partisë e të shtetit, në takime me kuadro, me komunistë e me njerëz të thjeshtë gjithmonë diskutonim rreth këtij problemi dhe këmbëngulja që ligji i mëparshëm me çdo kusht të ndryshohej në favor të fshatarësisë së varfër në veçanti, në favor të thellimit të revolucionit socialist në tërësi.

Veçanërisht pas Plenumit të 5-të të KQ të Partisë të shkurtit 1946, kur goditëm ashpër pikëpamjet e qëndrimet oportuniste të Sejfulla Malëshovës, thuajse të gjithë u bënë të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e ndryshimit të ligjit mbi Reformën Agrare dhe në muajin maj doli ligji i ri me një përmbajtje të thellë revolucionare. Sipas këtij ligji të gjitha tokat, vreshtat, ullishtet etj., të atyre që nuk i punonin shpronësoheshin, bujqve dhe pronarëve që e punonin u liheshin gjer në 5 hektarë tokë, të cilat as mund të shiteshin, as të bliheshin e as mund të liheshin peng. Do t'i mbanin e do t'i gëzonin vetëm ata që i punonin! Kjo kishte rëndësi të madhe, sepse u pritej rruga spekulimeve me tokën, u pritej çdo mundësi elementëve kulakë për të blerë tokë a për t'u pasuruar duke shfrytëzuar djersën e të tjerëve. Kjo qe një fitore e madhe për fshatarësinë tonë patriotike, e cila kishte mbajtur mbi supet e veta peshën më të madhe në Luftën Nacionalçlirimtare. Ajo e priti me entuziazëm shpalljen e Reformës, e cila e lidhi edhe më shumë me Partinë dhe me pushtetin popullor.

Vendosëm që zbatimi i Reformës të niste me një akt simbolik, ndaj së bashku me shokët e mi, doktor Nishanin, Myslim Pezën, Spiro Moisiun, Shefqet Peçin, Gaqo Tashkon, që ishte bërë ministër i Bujqësisë, e shokë të tjerë shkua në Lushnjë, ku u bëmë dëshmitarë të gëzimit të papërshkrueshëm të myzeqarit që qante, ndërsa shtrëngonte fort tapinë me duart që i dridheshin. Nuk mund të mos prekeshe nga skenat më të Ilapritura të shprehjes së gëzimit, të dashurisë për Partinë dhe Frontin, për pushtetin e ri. Më kujtohet që mes këtij entuziazmi dhe hareje me të vërtetë popullore fola me zërin që më dridhej nga emocionet

- Shokë fshatarë, t'i kini sytë kurdoherë hapur dhe grushtin të rëndë për armiqtë e popullit. Ndarja e tokës u fillua, po ndahen tapitë; përditë e më tepër ju do të keni ndihmën e Qeverisë suaj. Të gjitha mundësitë tona do t'i vëmë në shërbim të popullit. Ne nuk premtojmë qiejt, por të jeni të sigurt se atë që themi, e bëjmë. Ju urojmë nga zemra për tokën që morët. Rrofshi dhe i lubzofshi fushat tona brez pas brezi !

Efektet ekonomike, xor sidomos ato politike, botëkuptimore, të kësaj Refcrme qenë me të vërtetë nga më të mëdhatë. Populli bënte be «për Parti e për pushtet» që i dha tokën, ashtu si «për sytë e ballit»! Duke i dhënë tokën që i takonte e duke e lidhur përjetë me të, Partia dhe pushteti e lidhën akoma më shumë veten me fshatarësinë.

Në mënyrë konsekuente, hap pas hapi, në ndeshje me vështirësi e lloj-lloj armiqsh, populli, i udhëhequr nga Partia, po merrte káhtu në duart edhe pushtetin ekonomik, po bëhej, në luftimin më të gjerë të fjalës, zot i fateve të veta.

Por, ndërsa populli ndiente gëzimin e madh për gjendjen e re që po k-ijohej, borgjezia ndiente se kishte ardhur ora kur aikthi dhe pesimizmi po mbulonin ditët e saj të fundi. Masat dhe reformat po goditnin për vdekje këtë ilasë, e cila, përballë këty re goditjeve, kërkonte të reigonte, të organizohej, të gjente aleatë, të endej në dëshpërim e sipër, e gatshme për të kryer edhe krimd më të përqudnueshme. Megjithëse situata, dekori, atmosfera kishin ndryshuar rrënjësisht, ata nuk donin ta besonin tragjedinë e tyre Në skenën e jetës së popullit ata donin të mbeteshin regjisorë të përjetshëm, prandaj filluan të hartojnë e t'u dërgojnë peticione nisioneve anglo-amerikane që të ndërhynin pranë Qeverisë sonë, filluan t'u bëjnë shantazhe dhe të aktivizojnë njerëzit e tyre që kishin penetruar në pushtet, në Front e bile edhe në Parti. Të tillë ishin Shefqet Bea, Gjergj Kokoshi, Riza Dani e të tjerë, të cilët, sig ktm përmendur edhe më parë, ishin bashkuar me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, kishin qëndruar përgjithësisht në favor të saj, bile qenë zgjedhur edhe në forume drejtuese.

Personalisht Riza Danin e kisha njohur vonë, ose në Përmet ose në Berat, por për të më kishin folur me kohë shokët e Shkodrës. Ky, ashtu si edhe Gjergj Kokoshi, ishte shkodran, burrë i kaluar nga mosha, njeri me influencë në Shkodër. Një vëlla i tij, Hasan Dani, ishte tregtar i madh, i cili, pasi kishte ngjyer dorën në «mjaltin» e Zogut, po gustonte atë të fashizmit, siç bënin edhe mjaft të tjerë, si për shembull, «demokrati» Fazlli Frashëri dhe vëllai i tij Qazka, për të cilët kam folur më parë. Kurse vetë Rizai ishte «demokrat liberal», antizogist, antiklerikal dhe antifashist. Në kuadrin e punës sonë me nacionalistët, shokët e Shkodrës ishin lidhur me Rizain dhe ai kishte pranuar të luftonte, të merrte pjesë në Frontin Nacionalçlirimtar. Kjo na gëzoi dhe ne e konsideruam një sukses.

Kurf Shefqet Bejën e njihja më mirë, sepse kisha biseduar më shpesh me të. Ai kishte qenë miku i Bahriut dhe i Muharrem Vllamasit, një element antizogist, që kishte qenë i mërguar në Bari. Shefqeti dhe Muharremi ishin moshatarë dhe që të dy kishin mbaruar një shkollë tregtare italiane, por, ndërsa Shefqet Beja e ndoqi profesionin e u bë tregtar, bile i madh, Muharrem Vllamasi u bë «politikan». Në kohën e pushtimit nga Italia Muharremi «demokrat e antizogist», u bë federal, kurse me formimin e Frontit Nacionalçlirimtar Shefqet Beja u bashkua me ne. Ishte një tip shumë i zgjuar dhe në bisedat që bënim, hiqej demokrat, sulmonte dhe tallte Duçen, Tefik Mborjen e kompaninë e gjerarkëve fashistë. Edhe bashkimin e Shefqetit me Frontin e konsideruam si një sukses. Gjatë luftës kam pasur biseda të gjata dhe të hapëta me ta, i vija në korent, sidomos Gjergj Kokoshin e Shefqet Bejën, që i takoja më shpesh, për gjendjen e luftës dhe për format e organizimit demokratik të pushtetit pas Çlirimit. As mund të kishin ata ndonjë rezervë kundrejt Partisë, se nuk i vinte në korent e se nuk këshillohej me ta. Çdo gjë dukej se e kishin hapur, në aparençë nuk kishin vërejtje dhe programin e Partisë, me gjithë ndonjë «mëdyshje» ose «moskuptim», në përgjithësi e aprovonin. Ishin ca dogmatikë dhe të vjetër në mendime, të rëndë dhe «demokratë» të stilit të vjetër, por dukeshin njerëz të pjekur. Unë përpiqesha të mos polemizoja dendur me ta, derisa në çështjet kryesore ishin dakord.

Dhe ja, kur Partia në krye të popullit filloi punën për rindërtimin e vendit të djegur e të shkatërruar e nisi të vinte në jetë reformat e mëdha, këta elementë, ndonëse nuk dilnin haptazi kundër kësaj vije konsekuente të Partisë, në realitet filluan të lëviznin. Ata erdhën shumë herë tek unë, për të biseduar, herë së toku, herë veç e veç. Ata, veçanërisht Riza Danin dhe Shefqet Bejën, i preokuponte Reforma Agrare, taksat e luftës kundër tregtarëve dhe gjyqet e popullit. Ndërhyrjet e tyre nuk më habitnin, bile unë isha i sigurt se ato do të vinin duke u shtuar, prandaj mbaja gjakftohtësinë me ta dhe u jepja përgjigjen e duhur:

«Ata janë pasuruar në kurriz të popullit dhe ç'kanë grabitur, duhet t'i vjellin».

«Fshatarësia derdhi gjak, u dogj, çliroi vendin, fitoi tokën e atdheut të vet, prandaj do të bëhet Reformë Agrare e vërtetë».

Y«Kriminelët e luftës duhet të japin Ilogari, ata navranë, na dogjën tok me pushtuesit, prandaj do të paguajnë krimet e tyre».

«pendi do të rindërtohet nga e para, prandaj banka, tregua e jashtme, transporti dhe në përgjithësi tregtia e brendshme do të jenë në dorën e pushtetit popullor».

Ata, sigurisht, për të gjitha këto ngrinin arsyet e tyre «demokratike», por edhe unë u jepja arsyet me të vërtetë demokratike. E ndieja se ata dilnin nga dhoma ime të pakënaqur, por detyroheshin t'i buzëqeshnin disfatës.

Por në fund të fundit nuk qe faji ynë që ata porrëshqitnin drejt greminës. Gjersa ne gjithçka ia kishim kushtuar çështjes së popullit, nuk mund e s'na lejohej që për ca poza e lodra «demokratike» të kënaqim orekset e synimet e ithtarëve të sé vjetrës. Nëse ata donin të jetonin e të shërbenin si njerëz të vërtetë, le të bashkoheshin e të vazhdonin rrugën e popullit, në të kundërtën, udha e mbarë!

Kryesorja që na gëzonte e na mbushte me forca ishte fakti që populli e aprovonte, e përkrahte dhe e zbatonte me entuziazëm vijën e Partisë dhe politikën që po ndiqte shteti ynë i ri. Në procesin e realizimit të kësaj vije shihnim dhe bindeshim se po bëhej gjithnjë e më i çeliktë uniteti Parti-popull që kishim krijuar në zjarrin e luftës. Dhe task, pas kaq e kaq fitoresh e realizimesh, kishte ardhur momenti e ishin krijuar kushtet të realizonim edhe një nga angazhimet e

detyrat themelore që ne e kishim përcaktuar që në fillim: kishte ardhur qasti që populli të shprehte lirisht e solemnisht vullnetin e tij për formën e regjimit që dëshironte të vendosej në Shqipëri.

2. Shpallja e Republikës Popullore

Kërkesën për t'u shprehur për formën e regjimit, populli e shtroi fillimisht në gusht të vitit 1945, në Kongresin I të Frontit Nacionalçlirimtar, organizatë e cila që nga ajo kohë e këtej mori emrin Fronti Demokratik i Shqipërisë.

Ky Kongres, i cili i zhvilloi punimet në atmosferën e një aprovimi entuziast të politikës së Partisë Komuniste e të programit të saj perspektiv, midis të tjerash kërkoi solemnisht nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar dhe nga Qeveria Demokratike Provizore që në Shqipërinë e lirë të zhvilloheshin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të shpallte vullnetin e popullit për formën e regjimit dhe do të aprovonte Kushtetutën e vendit.

Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, me propozimin e Qeverisë, e aprovoi këtë kërkesë të popullit, të shprehur nëpërmjet organizatës së tij, dhe ngarkoi një komision të posaçëm për të hartuar ligjet mbi zgjedhjet për në Asamblenë Kushtetuese. Nga fundi i muajit shtator projektet e këtyre ligjeve u paraqitën për aprovim dhe, në mbledhjen e vet, KANÇ-i shpalli në parim aprovimin e tij për zgjedhjet dhe, gjithashtu, diskutoi e aprovoi ligjin mbi zgjedhjet e atë mbi listat elektorale. Në këtë të fundit shpallej se të gjithë shtetasit shqiptarë, burra e gra, mbi moshën 18 vjeç, kishin të drejtën të zgjidheshin e të zgjidhnin. Përrjashtoheshin nga kjo e drejtë ish-ministrat kuislingë, kriminelët e luftës dhe, kuptohet, ata që, për fajet e tyre, kishin humbur përkohësisht të drejtat politike. Kështu, për herë të parë në historinë e Shqipërisë, krijoheshin mundësitë reale për pjesëmarrjen e gjithë qytetarëve në zgjedhje.

Mbaj mend se aprovimi i këtij ligji u bë pa debate dhe pa ыçkla edhe nga ata elementë demokratë-borgjezë e liberalë që kishin mundur të penetronin në Këshill e në Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. E them këtë, sepse nga të dhënat që kishim, si dhe nga presionet e mëdha që na bënë përfaqësuesit anglezë e amerikanë, ne parashikonim luftë të madhe me këta elementë që tash u qe ngarkuar misioni të hidheshin në sulm për të sabotuar vijën e Partisë sonë për zgjedhjet, të krijonin një «opozitë» brenda bse jashtë Frontit dhe, përmes saj, të manovronin për ta rrëmbyer në të ardhmen pushtetin. Por, si duket, helmin e kishin rezervuar për ligjin mbi zgjedhjet, ndaj ligjin mbi listat elektorale e pritën me buzëqeshje, bile me duartrokitje. I thartuan ca turinj të vetëm kur unë u ngrita e kërkova që ligji të pranonte një përjashtim.

- Propozoj, - theksova, - të bëhet një përjashtim për ata të cilët s'e kanë mbushur akoma moshën e caktuar, por që kanë marrë pjesë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Mendoj se ky është një përjashtim i drejtë. Këta djem e vajza, që kanë luftuar me armë në dorë për lirinë, që jetën e tyre të re ia kanë falur me ndërgjegje të plotë atdheut, kanë të drejtën të thonë me votën e tyre atë që e kanë thënë me pushkë. Ata e kanë të gjithë pjekurinë e nevojshme për të gjykuar për fatet e popullit.

- E mbështes me të dyja duart propozimin e Enverit, - u ngrit ndër të parët Omer Nishani. - Ta përfshijmë pa hezitim në ligj.

- Rinia e të gjitha moshave mbajti orbi supe luftën, - tha Nako Spiru, - ndaj i takon të mbajë edhe pushtetin...

Gjithë pjesëmarrësit e aprovuan propozimin tim dhe pas kësaj u kalua në diskutimin e projektligjit mbi zgjedhjet. Për përgatitjen e këtij projektligji,

ashtu si për krejt organizimin dhe kurorëzimin e fushatës së zgjedhjeve, na u desh të bënim punë e përgatitje të mëdha, sepse jo vetëm juristët kompetentë e me përvojë na mungonin, jo vetëm të gjithë ne s'kishim kurrfarë përvoje nga e kaluara në këto çështje, por edhe se në tërësi, në vendin tonë në të kaluarën

s'qe krijuar ndonjë traditë për zgjedhjet, veçanërisht për organe të tilla të larta, siç është Asambleja Kushtetuese. Edhe ajo farë përvoje që u krijua në vitet 1920-1924 për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, jo

vetëm ishte fillestare, por kishte gabime, kufizime e shtrembërime të mëdha, dhe, më kryesorja, ato zgjedhje më tepër ishin një lloj «ndeshjeje» e «garë parlamentare» që zhvillohej midis përfaqësuesve të klasave të

pasura, feudalëve e borgjezëve reaksionarë, nga njëra anë, dhe elementëve përparimtarë e demokratë që ishin ose hiqeshin si përfaqësues të «Opingës», nga ana tjetër. Vetë populli, në këto zgjedhje, në përgjithësi, ishte ose mbahej larg. Pas ardhjes së Zogut në fuqi, e sidomos pasi u shpall mbret më 1928 mori fund edhe ndonjë farë elementi demokratik që qe dukur në zgjedhjet e periudhës së mëparshme. Tani e tutje në farsat e zgjedhjeve zogiste votën e vendoste kërbaci,

ryshfeti dhe kondaku, të shoqëruara këto si me injorancën dhe prapambetjen e përgjithshme të masave, ashtu edhe me mosinteresimin e tyre të kuptueshëm për të ashtuquajturat zgjedhje.

Na duhej, pra, që gjithçka ta krijonim nga e para, dulce u mbështetur si zakonisht në ato që lexonim nga klasikët e marksizëm-leninizmit, në ato që mundëm të mësonim nga përvoja e Bashkimit Sovjetik etj. Mbi të gjitha niseshim nga parimi që të formulonim një projektligj të tillë, ku popullit t'i jepej mundësia dhe e drejta të shprehte sa më lirë, sa më qartë dhe drejtpërdrejt mendimin dhe vullnetin e tij, pra të siguronte të gjitha garancitë për një zhvillim normal e demokratik të këtij aktiviteti politik me rëndësi historike, Zgjedhjet për në Asamblenë Kushtetuese do të ishin të përgjithshme, direkte, të barabarta, të fshehta dhe ligji ndalonte e dënonte çdo lloj veprimi të kujt do qoftë për të cenuar këto parime.

Ndonëse projektligji mbi zgjedhjet, që e kishim përgatitur me mund e me kujdesin më të madh, garantonte një nga mënyrat më demokratike e më të plota për shprehjen e vullnetit të popullit, kundër tij, gjatë diskutimit për miratim, u ngritën me forcë një numër i kufizuar elementësh «demokratë» e «liberalë».

Në mënyrë të veçantë Gjergj Kokoshi u hodh në një sulm të egër ndaj ligjit që po diskutohej, që në fakt ishte një sulm kundër Frontit Demokratik, kundër Partisë dhe pushtetit popullor.

Sapo u paraqit projektligji, Gjergj Kokoshi kërkoi fjalën dhe, si i bëri disa elozhe hipokrite Frontit dhe pushtetit popullor, filloi të zbrazte vërejtjet e tij, që në fakt e hidhnin poshtë projektligjin që do të aprovohej. Vërejtjet e Kokoshit ishin refleksi i shqetësimit të thellë të klasave të përmbysura, i reaksionit dhe i imperialistëve, të cilët e kuptonin që në zgjedhjet e ardhshme nuk do të kishin asnjë shans jo më për fitore të plotë, por as për të siguruar një numër të mjaftueshëm deputetësh për të krijuar njëfarë opozite.

- Në Asamble, - predikonte Gjergj Kokoshi, duhet që përbri njerëzve të luftës, të jenë edhe njerëzit e paqes dhe njerëz të tillë ka edhe jashtë Frontit.

Sigurisht, një ndarje e tillë absurde në njerëz «të luftës» e «të paqes» në gojën e tij kishte kuptimin që në Asamblenë Kushtetuese të zgjidheshin edhe ata që, kur populli shqiptar luftonte për lirinë e vendit, rrinin e bënin sehir, nxirrnin fitime e bile, fshehurazi apo hapur, bashkëpunonin me okupatorin e me qeveritë kuizlinge. Gjergj Kokoshi kërkonte të përfaqësoheshin në organin më të lartë shtetëror tregtarët dhe pronarët, bejlerët dhe kulakët dhe këta të diktonin atje vullnetin e tyre. Ky zëdhënës i tyre e kishte të qartë se cili ishte mendimi i popullit për shtypësit e vet, prandaj kërkonte që ligji t'u siguronte mundësi të padrejta për t'u zgjedhur në Asamble.

- Populli, - i thamë me të urtë, - i organizuar në Frontin Demokratik, i paraqet kandidaturat e veta për në Asamble në listat e Frontit. Ata që janë jashtë Frontit, nëse kanë dëshirë të zgjidhen, le t'i paraqesin kandidaturat e tyre individualisht. Projektligji ua njeht këtë të drejtë e, bile, do t'ua mbrojë.

- Në krahasim me listat e Frontit që ka një organizim të shkëlqyer, - pranonte me hidhërim Kokoshi, - kandidaturat e veçanta janë të destinuara të falimentojnë, se këta elementë nuk janë të organizuar në parti politike e nuk kanë shtypin e propagandën e tyre. Nga ana tjetër, njerëzit e pushtetit janë të gjithë në Front, kështu që nuk japin garanci për zgjedhjen e kandidatëve të tjerë.

Kjo që një insinuatë e poshtër kundër pushtetit tonë popullor dhe me të drejtë një nga shokët anëtarë të Kryesisë ngriti pyetjen:

- A mos vallë zoti Gjergj Kokoshi kërkon kthimin e regjimeve të vjetra, të cilat do të japin garanci për zgjedhjet e lira?!

Në emër të Qeverisë dha shpjegime Manol Konomi, ministër i Drejtësisë, i cili e sqaroi Gjergj Kokoshin mbi aplikimin e parimit të proporcionalitetit për lista të organizatave të ndryshme dhe jo për individë.

Kundër «vërejtjeve» të Gjergjit u ngritën edhe Qirjako Haritoja, Siri Shaploja e të tjerë. Diskutuesit vunë në dukje se Fronti Demokratik ka fituar një autoritet e besim të madh në popull me luftë e me punë dhe nuk është faji i tij në qoftë se nuk ekzistonin parti apo grupe politike të tjera.

- Fakti që pas dhjetë muajsh çlirim nuk ka mundur të organizohet asnjë grup tjetër, - tha Siriu, do të thotë se krijimi i grupeve të tilla nuk ka qenë në interesin e popullit. Populli është me Frontin. Nëse

ka nga ata që duan të organizohen jashtë Frontit, le ta provojnë, por ata do të hasin në forcën e Frontit dhe do të humbasin. Ne s'kemi ç'u bëjmë.

Kështu dështoi kjo orvatje e reaksionit për t'i përdorur zgjedhjet për qëllimet e tyre. Avokati i tij mbeti në pakicë, Kokoshi u katandis një thellë, dhe pas kësaj, si ai i mbyturi që kërkon shpëtim, vendosi të hidhte në veprim gurin e fundit që i kishin vënë në xhep padronët e tij, anglezët, doli në mënyrë demonstrative nga Fronti Demokratik, duke dhënë me këtë sinjalin e krijimit të një «opozite», e cila, sipas planeve angleze e amerikane, do të merrte pjesë në zgjedhjet si kundërpeshë ndaj Frontit Demokratik.

Mirëpo gjesti i Kokoshit s'bëri gjë tjetër veçse shtoi në ato momente të entuziazmit të përgjithshëm edhe një temë të re për humor: Kokoshët e tjerë, përballë forcës sonë, u bënë pula të lagura dhe s'ua mbajti të pasonin Kokoshin në «opozitë». Ky mbeti i vetëm, natyrisht në dukje, sepse në realitet edhe elementët e tjerë si ai, vërtet do t'i fshihnin disi kthetrat, por do të shtonin në prapaskenë veprimtarinë e egër për të rrëzuar pushtetin popullor. Kjo do të provohej e do të dokumentohej pak më vonë, kur organet tona të diktaturës do të zbulonin krejt fijet e komplotit të tyre dhe këta dolën para gjyqeve të popullit.

Pas orvatjes së dështuar dhe sidomos pas daljes së tij nga Fronti, Gjergj Kokoshi ua la vendin në avanskenë miqve të tij, Riza Danit, Shefqet Bejës e të tjerëve. Këta të dy ishin përfshirë në listat e Frontit dhe arritën të zgjidhen edhe në Asambleenë Kushtetuese, sepse deri atëherë hiqeshin si përkras të programit të Frontit Demokratik dhe ishin ruajtur nga demonstrimi i qëndrimeve të hapëta armiqësore. Megjithatë ne prej kohësh e kishim ndjekur me vigjilencë aktivitetin e tyre dhe kishim parë se doza e rezistencës tek ata shtohet dita-ditës. Prej kohësh kishim informata se Riza Dani, Gjergj Kokoshi, Shefqet Beja dhe disa të tjerë, që xtendonin dhe ishin të bindur se Partia jonë do të falimentonte, ishin lidhur me misionin ushtarak anglez dhe me atë amerikan. Siç u zbulua më vonë, ishin këto misione që i organizuan dhe i drejtuan këta elementë për të krijuar rezistencën dhe opozitën, legale e ilegale, kundër pushtetit popullor, kundër Partisë dhe reformave të mëdha që po bënim. E dinim që këta hynin e dilnin në misionin anglez dhe kishin miqësi me funksionarët e tij. Këtë e konsideronim normale dhe ne e kuptonim që, po t'u bënim ndonjë vërejtje shoqërore për këtë, do të na thoshin se «s'ka ndonjë të keqe, se i kemi aleatë». Por shpejt u bindëm se këta nuk shkonin tek anglezët apo amerikanët për të folur për kohën e për të pirë ndonjë kafe apo uiski, por për «të qarë hallet» e për të koordinuar veprimtarinë kundër nesh. Dyshimet e mia m'u konkretizuan shpejt, pas një takimi që pata me gjeneralin anglez Hoxhson.

Disa ditë pas ardhjes së tij në vendin tonë, andej nga fillimi i 1945-s, Hoxhsoni, që ishte kryetari i misionit anglez, kërkoi audiencë dhe unë e prita në Kryeministri. Me fytyrën e tij të kuqe dhe me shkopin nën sqetull, më përshëndeti, hoqi kapelen dhe unë e ftova të ulej në një kolltuk. Sapo u ul, ia filloi me pompozitet.

- Sjell një gëzim për Frontin dhe për administratën tuaj, - dhe më nderi një letër zyrtare nga UNRRA. - UNRRA, - vazhdoi Hoxhsoni, - ka vendosur t'ju ndihmojë si aleatë që jemi me ushqime, me materiale etj. - Dhe vazhdonte lista. Ia dhashë letrën përkthyesit, i cili ma përktheu.

- Firmën nuk e lexoj dot, - më tha ai në fund.

- Pyet gjeneralin, - i them.

- Shkresa, - u përgjigj Hoxhsoni, - është firmosur nga majori Okli Hill, i cili është caktuar si përfaqësues i UNRRA-s në Shqipëri.

- Rron akoma ky njeri që ka qenë këshilltar i xhandarmërisë së Zogut? - e pyeta.

- Po, - tha gjenerali, - rron dhe ja rasti i jepet ta ndihmojë prapë Shqipërinë.

- Veçse nuk ekziston më Shqipëri e Zogut, por Shqipëri e partizanëve dhe e popullit, prandaj çuditë për këtë koincidençë që UNRRA ka caktuar në vendin tonë major Okli Hillin, që firmos këtë letër, kur dihet se në Shqipëri nuk ka më xhandarë për të stërvitur, i thashë.

Me siguri si gjenerali dhe Hilli ishin agjentë të Intelixhens Servisit anglez.

- Sidoqoftë, - thashë, - e falënderojmë UNRRA-n për simpatinë që demonstroi. Por, - vazhdova, duke i hedhur edhe një sy listës së materialeve që UNRRA kishte vendosur të dërgonte, - ne

mendojmë se sasia e caktuar nuk u përgjigjet as nevojave tona dhe as humbjeve që ka pësuar populli shqiptar gjatë luftës.

- S'di ç't'ju them, - u përgjigj Hoxhsoni. - Sidoqoftë, jam lajmëruar se, pas disa ditësh, do të vijë në Tiranë përfaqësuesja e UNRRA-s, kështu që këto mund t'i diskutoni me ta.

- Sigurisht, - i thashë.

(Përfaqësuesja e UNRRA-s erdhi vërtet, bashkë me instruktorin e xhandarëve të Zogut, por diskutimet me ta ishin të kota. Ata u morën më shumë me komplotese sesa me studimin e kërkesave tona dhe me organizimin e ndihmës.)

- Këto maura, - vazhdoi më tej gjenerali, do të zbarkohen në Durrës ose në Vlorë, ku të doni ju dhe bashkë me to të zbarkojnë dhe një grup ushtarësh e oficerësh britanikë.

- Ç'duan këta ushtarë dhe oficerë që: do të vijnë?

- Të shpërndajnë mallrat, natyrisht, ku t'i caktoni ju.

- Pse nuk i ndajmë dot vetë ne? Ne jemi shtet, jemi qeveri.

- Kështu duhet, - u përgjigj gjenerali, -- ndryshe nuk jepen.

- Ne nuk i refuzojmë furnizimet nga alcatët, i thashë Hoxhsonit, - por nuk jemi nga ata që pranojmë lëmosha dhe kushte s'na vini dot. Asnjë ushtar dhe oficer britanik nuk pranojmë të vërë këmbët, jo në tokën tonë, por as në portet tona. Çdo gjë do t'u dorëzohet autoriteteve tona të portit, në prani të njerëzve të misionit tuaj në Tiranë dhe ne do t'ju japim dëftesën që morëm në dorëzim këtë dhe atë mali. Kjo është e vetmja procedurë e pranueshme nga ne. Po të doni pranoheni, përndryshe ne i refuzojmë mallrat e UNRRA-s.

Gjenerali, natyrisht, mbeti i pakënaqur dhe iku duke thënë me flegmin anglez «do të lajmërc)j qeverinë time».

Pas ca kohësh, Kokoshi dhe Beja erdhën tek unë gjoja për punë të tjera dhe e nxorën fjalën të ndihmës e UNRRA-s. Unë ua shpjegova atyre ngjarjen. Shefqet Beja filloi të më thotë:

- Mirë, Enver, po qar e kemi, kemi nevojë, të bëjmë ndonjë lëshim se qeveri e madhe është dhe ofendohet, - e plot gjepura të tilla.

- Dëgjo Shefqet, - i them, - ne nuk ofendojmë kërrkënd, por është qeveria angleze që na ofendon ne. Për kë na merr ajo? Pse s'je në gjendje ti që ke qenë tregtar të shpërndash disa lecka, por të na vijë këtu anglezi e të na e bëjë këtë? Jo, asnjë lëshim nuk bëjmë, po të duan, fi sjellin me kushtet që u paraqesim ne.

Por aj o që më intrigo. ishte se nga e kishte marrë vesh Shefqet Beja dhe ku;h e nxiste që të ndërhynte? Patjetër gjenerali anglez.

Nuk do të kalonin shumë kohë, kur këta do të bënin një tjetër demarsh në favor të politikës arrogante të imperialistëve anglo-amerikanë. Kjo ndodhi në prag të zgjedhjeve për në Asambleenë Kushtetuese, në nëntor të atij viti kur u ahpall njohja e Qeverisë sonë nga Bashkimi Sovjetik, dhe bënë sikur do ta njihnin edhe SHBA-ja dhe Britania e Madhe. Siç dihet, ndërsa njohja nga ana e qeverisë sovjetike që e hapur dhe e sinqertë, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës na vunë kushte. Ne i hodhëm poshtë, sidomos kushtin e qeverisë amerikane për të njohur marrëveshjet që kishte lidhur ajo me Zogun. Përsëri Gjergj Kokoshi, Shefqet Beja dhe -:tiza Dani erdhën tek unë që të më bindnin se nuk duhej të tregoheshim kaq ekzigjentë përpara këtyre d5 fuqive të mëdha, se ne, si vend i vogël që ishim, kishim nevojë për ndihmën e përkrahjen e tyre, prandaj duhej të bënim edhe ndo një koncesion. Unë ua hodha poshti «argumentet» kityre njerëzve, për ti cilit po mi kristalizohej mendimi se ishin agjenti ti anglezive dhe ti amerikanive.

Sigurisht, duke e pari se as demarshet e tyre dhe as presionet e anglo-amerikanive nuk po jepnin asnjë rezultat, kita elementi, që gradualisht ishin hedhur në pozitë e reaksionit, do të kundërvepronin me mjete e forma të tjera. Dhe me ti virteti informacioni yni na komunikonte se kita elementi ishin vini në livizje dhe po organizoheshin. Ky organizim bihej, si ti thuash, me material të vjetër, se ni popull kita nuk kishin bazi. Ata po vendosnin lidhjet e vjetra me armiqtë tanë gjatë luftës, me intelektualë të falimentuar, me agallarë që humbin tokat, me borgjezi të shpronësuar e të tjerë dhe kishin për qëllim të krijonin «parti» të tyre dhe një opozitë në zgjedhjet e në Kuvendin Popullor.

Por, sig shkrova mi lart, ne, vigjilenti e ti gatshim qi ti mos lejonim ti gjenin terren planet e komplotet e fshehta ti reaksionit ti brendshim e ti anglo-amerikanive, ua dogjim atyre letrat ni duar, i detyruam me qindrimet tona ti pjekura e parimore, ti pilcitrnin nga zemirimi e ti vetidemaskoheshin, siç ndodhi me Kokoshin e, ndirkaq, vazhdonim me vrull punin pir pirtgatitjen e ngjarjeve ti tjera politike qi kishim pirtpara.

Disa diti pas aprovimit ti ligjeve mbi zgjedhjet pir Asambleni Kushtetuese, Kryesia e Kishillit Antifashist caktoi datin e zgjedhjeve, 2 dhjetorin e vitit 1945, dhe emiroi komisionin qendror ti zgjedhjeve. Filloi kishtu fushata elektorale.

Komiteti Qendror i Partisi dha udhizime ti veçanta për organizimin e punës politike, ti propagandis e agjitacionit nga ana e komunistive për zgjedhjet e 2 dhjetorit, ti cilat u çmuan si një eveniment me rëndësi historike pir fatet e Shqipirisi. Partia orientoi qi votimet e 2 dhjetorit ti ktheheshin ni një plebishit ti madh popullor, ku masat ti shprehnin qarti e hapur mendimin e tyre pir rrugin ni ti cilin do ti ecte vendi yni. Me votin e tyre shqiptarit dhe Ihqiptaret do t'i thoshin «Jo» si shkuaris si hidhur ti shtypjes e ti shfrytizimit, do ti afirmonin rrugin e ndritur ti socializmit. Puna e Partisi dhe e levave ti saj në ato momente mori një intensitet ti jasltzakonshim: shtypi, agjitacioni figurativ, bisedat, mbledhjet e konferencat, ti gjitha kito kishin pir qëllim t'u shpjegohej masave pirtse duhej ti votonin dhe ç'rindësi kishte vota e tyre pir ti ardhmen e atdheut. Në këto takime, mbledhje e konferenca, qi u zhvilluan kudo ni kuadrin e fushatis elektorale, populli e biri ti vetin thirrjen e Partisi e kudo shpirtshenin thirrjet e fuqishme:

- Republiki Popullore! Ti votojmi pir R,epublikin Popullore!

Programi i shpallur nga Fronti Demokratik, i cili ishte programi i Partisi pir momentet aktuale, pirtputhej me interesat dhe aspiratat e popullit. Ai ishte një program konkret, real e revolucionar, i cili i siguronte vendit zhvillimin dhe pirtparimin e tij ekonomik, politik e shoqiror. Asnji program tjetir nuk u shpall ti konkurronte me ti, sepse nuk mund ti kishte një platformi mi demokratike sesa ajo e Frontit.

Pirtqafimi i menjihershim e kudo i thirrjes pir Republiki Popullore, ishte pirtgjigjja mi e miri e më

paralizuese që po u jepte populli, me zërin e tij të fuqishëm, pirtpjekjeve të dëshpëruara të reaksionit që ç'nuk bënte për të larguar masat nga Fronti e nga zgjedhjet. Dështuan pirtfundimisht edhe pirtpjekjet e kombinacionet e anglo-amerikanëve e të agjentëve të tyre për të krijuar ndonjë lloj grupi apo partie politike opozitare. Ata ishin diskredituar krejt, askush nuk i pasonte. Kaq e vërtetë është kjo sa edhe kur ndonjë element i borgjezisë në prag të zgjedhjeve desh të vinte kandidaturën jashtë listës së Frontit, s'mundi ia bënte dot këtë, sepse nuk gjeti, jo më të paktën 20 veta (sa parashikonte ligji), por as 10-15 veta që ta pirtkrahnin kandidaturën e tij.

Shpallja e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese u prit me entuziazëm kudo në Shqipëri dhe, siç thashë, në mbledhjet që organizoheshin, populli shprehte vullnetin e tij për të dërguar në Asamble bijtë më të mirë. Përveç të tjerash atmosferën e fushatës së zgjedhjeve e ndezën, e gjallëruan më tepër dhe i dhanë pirtmbajtje më të shëndoshë ngjarje të tilla të rëndësishme në jetën shoqërore e politike të asaj periudhe, siç ishin Kongresi i Sindikatave, ai i Rinisë, shpallja e programit të Frontit Demokratik etj. Këto krijuan kudo një atmosferë pune, entuziazmi e mobilizimi të paparë.

Kështu 2 dhjetori 1945, dita e zgjedhjeve, u kthye në një nga festat më të mëdha që kishte njohur Shqipëria. Për herë të parë populli kishte mundësinë të thoshte me efektivitet fjalën e tij, të vendoste për fatet e veta. Nuk kishte asnjë dyshim për fitoren e kandidatëve të Frontit Demokratik. Lista e Frontit kudo gjente aprovimin e masave dhe ky fakt ishte kaq evident, saqë reaksioni as që tentoi të organizohej e të dilte me një listë të vetën.

Me sa më kujtohet, në të gjitha rrethet elektorale të Shqipërisë doli vetëm një kandidaturë e veçantë për t'u zgjedhur! Përfaqësuesit e klasave të pirtmbysura, të bindura se populli ishte kundër tyre, nuk ndoqën as shembullin e këtij Don Kishoti që votonte për «veten», as të Gjergj Kokoshit, i cili kishte dalë në mënyrë demonstrative nga Fronti. Ata aderuan në programin e Frontit dhe u pirtpoqën t'ia arrinin të futeshin në listat e kandidatëve. Në fakt, me ndihmën e Sejfullait, i cili bënte presion të

madh për politikën e «dyerve të hapura», mundën të futen në lista edhe disa elementë të reaksionit, e mes tyre edhe Sheh Karbunara, së bashku me të tjerë njerëz të maskuar, si Riza Dani, Shefqet Beja e ndonjë tjetër.

Dihet fitorja e shkëlqyer që korri Fronti Demokratik në përfundim të këtyre zgjedhjeve. Këtu dua të shënoj ndonjë kuriozitet që më ka ngelur në mendje nga ato zgjedhje të para që u zhvilluan në Shqipërinë e re.

Të moshuarit besoj i mbajnë mend, se kanë votuar edhe vetë, kurse të rinjtë nuk besoj se i dinë të gjithë. Në tekstet e historisë ata kanë gjetur plot analiza, shifra, konkluzione, të gjitha këto të nevojshme e të domosdoshme, por kam përshtypjen se pak e kanë të gjallë atmosferën e atyre viteve. Ne, më të moshuarit, e kemi për detyrë t'u tregojmë për ato kohë e të flasim jo me gjuhën e librave e të gazetave, por t'u tregojmë ngjarje reale e të gjalla, sepse shpesh këto lënë gjurmë më shumë në mendjen e njeriut se një përcaktim a një konkluzion. Të gjithë e dinë se në vendin tonë, megjithëse djep i një kulture e arti të lashtë që kishte nxjerrë plot mjeshtër të poezisë, të arteve e të shkencës, në vitet e para pas Çlirimit, shumica dërrmuese e popullit, për shkak të politikës obskurantiste të regjimeve në të kaluarën, ishte analfabete. Por ama po të pyesësh sot të rinjtë, bile edhe ata të moshës 35-40-vjeçare se si kanë mundur të japin votën e tyre këta njerëz që nuk dinin të lexonin emrin e deputetit apo të shkruanin një emër që dëshironin, besoj se pak e dinë se si është vepruar.

Në ato zgjedhje nuk kishim fletë votimi si sot dhe as atë të ndarën ku zgjedhësi mund të prishë a të shtojë në fletën që i jepet kandidatit atë që s'do ose atë që do. Çdo zgjedhësi i jepej një kokërr, një top i vogël gome, ku qe stamposur shqiponja, simboli i flamurit tonë, dhe këtë ai duhej ta hidhte në kutinë që dëshironte. Në sallën ku votohej kishte dy kuti: njëra e Frontit me ngjyrë të kuqe dhe tjetra për rastet kur kishte kandidatura të veçanta, jashtë atyre të Frontit dhe që populli e quante «kutia e zezë». Votuesi duhej ta fuste dorën në të dyja kutitë, që të mos merrej vesh se ku e kishte hedhur votën. Por kishte nga ata, që nga entuziazmi dhe emocioni, e dekonspironin të fshehtën e votës së tyre, sepse pasi futnin dorën në kutinë e kuqe thërritnin:

- Rroftë Partia! Rroftë Fronti! Votoj për Republikën Popullore!

Një kuriozitet tjetër qe edhe një nen i veçantë në ligjin mbi zgjedhjet, sipas të cilit dy ditë para dhe një pas zgjedhjeve ishin të ndaluar shitja dhe përdorimi i pijeve alkoolike!

Kështu më 2 dhjetor votuan të rinjtë e të rejat, të moshuarit, votuan edhe luftëtarët e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, të cilët, ndoshta për herë të parë pas shumë kohe, ishin pa pushkë, sepse, sipas ligjit, ishte e ndaluar të hyje në qendrën e votimit me armë.

Që jashtë ata ia linin pushkën njëri-tjetrit dhe hynin me radhë, të kryenin të drejtën dhe detyrën e tyre si qytetarë. Pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve, ku Fronti Demokratik korri një fitore të jashtëzakonshme, në emër të Qeverisë Demokratike Provizore i propozova Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar që të procedohej për thirrjen e sesionit të Asamblesë Kushtetuese. Kryesia e KANÇ-it caktoi si ditë të fillimit të punimeve të Asamblesë datën 10 janar 1946.

Derisa erdhi dita e caktuar populli kudo, në mi tingje, mbledhje e konferenca, me telegrame e letra drejtuar KANÇ-it, Qeverisë e Frontit, kërkonte me këmbëngulje që Asambleja të shpallte Shqipërinë Republikë Popullore. Ai u bënte thirrje përfaqësuesve të tij në organin më të lartë shtetëror që të kryenin misionin e vet dhe Vi jepnin popullit formën e regjimit që ky dëshironte dhe një Kushtetutë me të vërtetë demokratike.

«Republikë Popullore!», kjo ishte edhe thirrja e vetme që dëgjohej nga turma e madhe që kishte mbushur në mëngjesin e 10 janarit 1946 sheshin parandërtesës ku do të zhvillonte punimet Asambleja Kushtetuese, ku është sot Instituti i Lartë i Arteve. Ishte një ditë e bukur, që i shkente për mrekulli atmosferës festive që kishte mbuluar kryeqytetin. Gjatë gjithë kohës që u zhvillua seanca e parë e kësaj dite, si dhe të nesërmen, populli qëndronte para ndërtesës dhe ndiqte punimet e Asamblesë nëpërmjet altoparlantëve. Në orën dhjetë, kur ishte lajmëruar hapja e seancës, në sallë mbretëronte një heshtje e thellë solemne. Pasi zunë vendet e tyre anëtarët e Këshillit Antifashist e të Qeverisë, i pari e mori fjalën kryetari i Kryesisë së KANÇ-it, doktor Omer Nishani, i cili, pas një fiale të shkurtër, e deklaroi të hapur sesionin e parë të Asamblesë dhe, sipas ligjit, ftoi të merrte

kryesinë e seancës deputetin me moshë më të madhe. Ky ishte përfaqësuesi i popullit të qarkut të Elbasanit, doktor Petraq Popa, pjesëmarrës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, i cili ishte zgjedhur që në Labinot anëtar i Këshillit të Përgjithshëm. Në mos gaboj, doktor Popa ishte i ati i Bardhylit, i cili, para se të vritej në luftë gjatë mësymjes së përgjithshme armike të dimrit, kishte qenë ndër aktivistët e dalluar të rinisë së Elbasanit dhe ishte ngarkuar me detyrën e sekretarit politik të Qarkorit të Rinisë Komuniste.

Pas procedurave të zakonshme, si apeli, caktimi i komisionit të verifikimit të mandateve, betimi i deputetëve etj., u caktua që mbledhja të vazhdonte të nesërmen, më 11 janar 1946, dite që do të mbetet ndër më të shënuarat në historinë e shtetit e të popullit tonë.

E kujtoj gjithmonë me emocion atë atmosfere entuziaste që mbretëronte në sallën e Asamblesë, kur lexoheshin telegramet nga Korça, Berati, Durrësi, Pogradeci, nga e gjithë Shqipëria, në të cilat populli kërkonte shpalljen e Republikës Popullore. E kam parasysh si tanfi momentin kur Hysni Kapo, djalë tridhjetëvjeçar, por me një eksperiencë të madhe të komisarit, të komandantit e të udhëheqësit të Partisë, u ngrit më këmbë dhe i dha drejtuesit të seancës mocionin e delegatëve të Vlorës, të cilët, pasi shprehnin zërin dhe vullnetin e popullit trim e revolucionar që përfaqësonin, propozonin:

- Në emër të deputetëve të Vlorës, Shqipëria të shpallet Republikë Popullore!

Oshëtiu salla, oshëtiu edhe sheshi i bulevardit nga thirrjet e popullit. Për disa minuta vazhduan brohoritjet në sallë dhe në një çast kryetari i seancës thirri:

- Propozoj të hedhim në votë mocionin e deputetëve të Vlorës!

- Nuk ka nevojë për votë! - u dëgjuan zëra të njëpasnjëshëm nga salla. Dhe vërtet, kuptohej se dëshira e popullit do të bëhej, sepse ai vetë dhe përfaqësuesit e tij kishin votuar me pushkë në dorë, me gjak e me sakrificë që Shqipëria të hynte në rrugën e re të lirisë e të progresit. Por rregulli dhe procedura, Bado formale që mund të duken ndonjëherë, duhen respektuar, aq më tepër në një organ të lartë të tillë, siç ishte Asambleja Kushtetuese.

Deputetët votuan dhe menjëherë u shpall zyrtarisht

- Asambleja Kushtetuese me vota unanime dhe me aklamacion e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore!

Brohoritjet e shoqëruan këtë komunikim dhe pastai, spontanisht, deputetët e ngritur më këmbë kënduan së bashku Himnin e Flamurit. Të gjithëve na duhej të bënim një sforcim të madh, për ta mbajtur veten, por prapë mund të shihje tek-tuk ndonjë lot në fytyrën e këtyre njerëzve që kishin kaluar sa e sa prova në luftë me armikun e nën kërcënimin e vdekjes. Kur dolëm nga Balla, një provë «më e rëndë» i priste deputetët: populli na vuri në mes, na puthte, na përqafoi, e një pjesë të deputetëve i mori në krahë duke brohoritur. Ky entuziazëm që i pranishëm kudo në Shqipëri. Kur u dha lajmi njerëzit dilnin në rrugë, këndonin e hidhnin valle. Ndoshta për herë të parë pas kaq vitesh njerëzit i jepnin udhë lirisht gëzimit, harronin vuajtjet, sakrificat, mungesat e shumta. Një vit më parë, 29 Nëntori i 1944-ës u kishte dhënë lirinë, sot, 11 Janari i 1946-s u jepte Republikën e tyre Popullore, republikën e punëtorëve e të fshatarëve.

Kështu, pra, populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së vet, arriti qëllimin e luftës së tij. Në atdheun e lirë nga pushtuesit ai u bë zot i fateve të veta. Askush nuk ia fali atij këto fitore dhe kurrë nuk kishte marrë gjë populli ynë nga duart e të tjerëve, por çdo gjë e kishte arritur me luftë e me punë, me trimëri e me mençuri, me pushkë e me penë.

Këto fitore të mëdha historike që kurorëzuan përfundimisht de facto e de jure një periudhë të tërë lufte e përpjekjesh, gëzimi e entuziazmi i madh i popullit, vendosmëria jonë për ta forcuar e për ta lulëzuar Republikën Popullore që sapo krijuam, s'kishte se si të mos i tërbonin armiqtë tanë, të brendshëm e të jashtëm, të hapur e të maskuar. Shpërthyen përsëri përpjekjet e demarshet e tyre për ta kthyer mbrapa rrotën e historisë e, në këto përpjekje, u hodhën në veprim edhe ata elementë të reaksionit, si Riza Dani, Shefqet Beja e të tjerë, që kishin mundur të zgjidheshin në Asamblesë Kushtetuese.

Nga njëra anë, këta punonin ilegalisht, komplotonin, forconin lidhjet me reaksionin në Shqipëri dhe jashtë, me klerin katolik, këshilloheshin dhe raportonin në misionet angleze e amerikane, bënin

propagandë vesh më vesh dhe përgatitnin terrenin për të përgatitur një situatë të tillë që t'u jepte dorë dy «demokracive» perëndimore të ndërhyjnë në Shqipëri; nga ana tjetër, ata vepronin edhe legalisht në Asamblesë Kushtetuese apo në Kuvendin Popullor dhe nuk linin rast pa përdorur për të sulmuar ligjet që aprovoreshin, për t'i shtrembëruar ato sipas interesave të tyre. Riza Dani ishte veçanërisht aktiv në këtë «opozitë»; Gjergj Kokoshi nuk qe zgjedhur, kurse Shefqet Beja, qe më i zgjuar e më finok dhe nuk e afishonte shumë veten si pjesëtar i «opozitës».

Riza Dani, që në mbledhjet e para të Asamblesë, filloi të shfaqte rezervat dhe kundërshtimet e tij. Kur do të zgjidhej Presidiumi i Asamblesë, listës së paraqitur nga Kahreman Ylli në emër të deputetëve të Beratit, që u mbështet nga ti gjithë diskutuesit e tjerë, Riza Dani i kundërvuri një listë tjetër, ku, tok me disa nga shokët tanë, kishte futur edhe miqtë e tij. Sigurisht, kandidatët e preferuar të Rizait nuk fituan dot. Por ai do të vazhdon te më tej. Diskutohej, bie fiala, Rregullorja e Asamblesë, Rizai do të gjente rastin të kundërshtonte e të bënte kërkesa, të cilat me logjikë dhe argumente i hidheshin poshtë. Ky ihtar i regjimit të vjetër dhe sigurisht, edhe i parlamentit borgjez, kërkonte ta bënte edhe Asamblesë tonë një kuvend llogjesh, ku secili të fliste. sa t'i donte qejfi, pa asnjë kufizim dhe të gjitha ç'thoshin Riza Dani me shokë të botoheshin në shtyp. Midis llomotitjeve të tij plot helm, u ngrit edhe për diçka tjetër:

- Nuk jam dakord, - tha, - me përcaktimin që çdo deputet të jetë përgjegjës e të japë llogari para Asamblesë për punën e tij. Këtu nuk jemi për të dhënë ne llogari, por për të bërë ligjin!

- Para kujt, sipas zotërisë sate, duhet të japë llogari deputeti? - e pyeti një nga shokët.

- Para nderit dhe ndërgjegjes së vet! - thirri Riza Dani me ton deklamativ dhe iu kthye kryetarit të seancës. - Propozoj, - tha, - që përcaktimi mbi dhënien e llogarisë në Rregullore të shprehet «deputeti është përgjegjës para nderit e ndërgjegjes së vet».

- Domethënë para askujt! - iu përgjigj me qesëndi njëri nga delegatët.

Të tilla «vérejtje» e «propozime» ai lëshoi shumë, dhe ne, megjithëse u përgjigjeshim me gjakftohtësi sulmeve të tij, ishim plotësisht të ndërgjegjshëm se Riza Dani qe vetëm një marionetë e tjetërkujt. Tashmë i dinim fijet që e drejtonin atë, i mbanim nën kontroll dhe bëheshim gati për t'i prerë një herë e mirë, kur kandari të mos mbante më.

Por kulmi i sulmeve të reaksionit, nëpërmjet megafonit të tij në Asamblesë Kushtetuese, u arrit gjatë diskutimit të projektit të Kushtetutës së Republikës sonë Popullore. Kushtetuta apo Statuti, siç përdorej termi atëherë, ishte i përgatitur me kujdes, ishte diskutuar gjerësisht e hollësisht me masat punëtore e fshatare, me intelektualët e me ushtarakët. Projekti ishte pritur me entuziazëm dhe vérejtjet e sugjerimet e masave qenë marrë parasysh për ta perfeksionuar më tepër. Kështu projekti përfundimtar që iu paraqit për diskutim e aprovim Asamblesë Kushtetuese ishte një dokument historik, i cili jo vetëm konsolidonte fitoret e mëdha që kishte arritur populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, por siguronte mbrojtjen e interesave të tij dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e politik. Ky projekt, që me gjithë tërbimin e reaksionit, u aprovua, ishte baza juridike e një shteti të demokracisë popullore. Kushtetuta e Republikës u vinte një herë e përgjithmonë vijë regjimeve antipopullore të shtypjes e të shfrytëzimit, sundimit të Cifligarëve, të bejlerëve, të tregtarëve, të politikanëve që shitnin interesat e atdheut për lireta, dollarë e sterlina. Kjo nuk u vinte për shtat vetëm zotërinjve si Riza Dani e Shefqet Beja dhe padronëve të tyre të huaj.

Kështu, ndërsa të gjithë përfaqësuesit e popullit në Asamble (ashtu si vetë populli gjatë diskutimit paraprak), e aprovuan me gëzim projektin, Riza Dani u ngrit e bëri një insinuatë provokuese kundër thelbit të Projektkushtetutës. Asambleja e dëgjoji me gjakftohtësi dhe pastaj i dha përgjigjen e merituar.

- Do të flas sa më pak, - tha me cinizëm tellalli, - se Asambleja nuk i ka qejf fjalët e shumta dhe se fjalët nuk ndryshojnë asgjë, kur fakti është i kryer.

Pastaj ai sulmoi projektin e Kushtetutës, sepse, sipas tij, ajo ishte «me frymë ideologjike dhe jo me frymë kombëtare» (!).

- Unë, - shprehu më në fund «kredon» e vet Riza Dani, - jam për një demokraci të lirë dhe do të dëshiroja që edhe Statuti të inspirohej nga ky parim !

Sigurisht, ai ishte për demokracinë «e lirë» borgjeze, që Rizai me shokë të ishin vërtet të lirë, të nxirrnin fitime, të ishin elita e kornbit e të vendosnin fatet e tij, sipas interesave të vet.

Në fakt sulmet e tij ishin shfaqje e grahmave të fundit që po jepnin mbeturinat e klasave shfrytëzuese, ishin shprehje të tmerrit të tyre nga fakti që populli kishte marrë fuqinë dhe në udhëheqje të tij ishte Partia Komuniste. Ky fakt ata i tmerronte, jo vetëm për gjendjen që ishte krijuar aktualisht, por sidomos për perspektivën, sepse e dinin se në ç'rugë do ta drejtonte e do ta udhëhiqte Partia popullin.

Debati në Asamble ishte vetëm një etyd nga tabloja e madhe e luftës politike që ishte zhvilluar për çështjen se ç'do të bëhej Shqipëria: një vend i demokracisë borgjeze, i parlamentarizmit borgjez, i sunduar nga çifligarët e borgjezia, apo një vend ku do të sundonte diktatura e proletariatit, e mbështetur në aleancën e dy klasave punonjëse të vendit! Por noti Riza Dani ishte paraqitur me vonesë në skenë, historia dhe populli e kishin dhënë vendimin e vet: Shqipëria do të ecte në rrugën e socializmit, do të qe shtet ku do të sundonte e do të forcohej pareshtur armikja më e madhe e borgjezisë dhe e shfrytëzimit, diktatura e proletariatit.

Edhe në Asamble Rizai mori një dënim unanim. Të gjithë deputetët ia hodhën poshtë diskutimin dhe në emër të popullit shprehën entuziazmin për Ligjin Themelor të shtetit tonë. Riza Dani me shokët e tij u strukën në karriget e tyre e nuk guxuan jo më të vazhdonin poshtërsitë, por edhe votuan pro projektit të Kushtetutës!

Më pas, kur Asambleja Kushtetuese u kthye në Kuvend Popullor më takoi të kisha një debat direkt me Riza Danin. Në një sesion të Kuvendit, Riza Dani u ngiit dhe në mes një sërë objeksionesh mbi vendimet që po ligjëronim, m'u drejtua mua si Kryeministër me pyetjen:

- Ç'do të bëjmë me gjithë këtë ushtri që kemi në këmbë? Unë, - tha ai, - propozoj që pjesa më e madhe e ushtrisë të çmobilizohet.

U ngrita në tribunë dhe i dhashë një përgjigje të ashpër, sepse shihja që këta elementë kishin hyrë në rrugë të errëta.

- Mirë që nuk thatë, zoti Riza Dani, që kur t'i çmobilizonim partizanët, t'u jepnim edhe nga një qeleshe peshqesh, siç bënë qeveritarët e asaj kohe me heronjtë e Luftës së Vlorës në 1920-ën. Jo, zoti Riza Dani, në situatën ku ndodhemi ne nuk do ta çmobilizojmë për asnjë minutë ushtrinë, përkundrazi, atë do ta forcojmë dhe do ta zgjerojmë më shumë, do ta armatosim si duhet, do të ngremë shkolla ushtarake, do të përgatitim e do të edukojmë oficerë. Ushtria e çliroi atdheun dhe do ta mbrojmë atë nga çdo rrezik. Ajo është arma më e dashur e popullit dhe do të mbetet arma më e fuqishme në duart e popullit dhe të pushtetit të tij demokratik që e vendosi duke derdhur gjak. Ju, zoti Dani, - vazhdova, - doni të çarmatosemi, ju mendoni se ne do të jemi aq naivë sa armiqtë e popullit të na kapin në befasi, po gaboheni rëndë. Në qoftë se ndjekim këshillën tuaj, populli do të ngrihet dhe do të na dënojë, se duhet të dini që ju prekni një nga pjellat më të lavdishme të tij.

Riza Dani tundte kokën i skuqur në fytyrë, kurse shokët e tij nuk e bënë veten, sikur këto fjalë nuk ishin edhe për ata (!). Me kohë të gjithëve do t'u dilte kallaji, do të diskreditohehin e do të demaskoheshin përfundimisht dhe populli do t'i flakte nga radhët e Asamblesë si mikrobe të së vjetrës.

Më kujtohet se pale kohë pas kësaj, në një mbledhje tjetër të Kuvendit Popullor, u ngrit një mik tjetër i Danit e i Kokoshit dhe shtroi në Kuvend një çështje që kishte marrë fund prej kohësh: kërkoi krijimin e partive të tjera «demokratike», «siç ekziston dhe Partia Komuniste e Shqipërisë», u shpreh ai.

Atëherë u ngrit i gjithë Kuvendi dhe i hodhi poshtë propozimet dhe qëllimet e tij dhe mbrojti e vuri në dukje rolin e madh vendimtar të Partisë komuniste të Shqipërisë që luftoi, çliroi popullin dhe ndërtonte socializmin. Në të njëjtën kohë Kuvendi vuri në dukje rolin e madh të Frontit si organizatë e gjerë politike, ku shprehen dhe vihen në veprim të gjitha pikëpamjet politike në unitet të plotë e të çeliktë rreth Partisë.

Por, sulmet e helmi i këtyre elementëve, që gabimisht e aksidentalisht kishin mundur të pernetronin gjer në Asamble, për asnjë çast nuk i lëkundën vullnetin dhe vendosmërinë e popullit e të përfaqësuesve të tij.

Fitorja e 2 dhjetorit 1945 në zgjedhjet, ajo e 11 Janarit 1946 me shpalljen e Republikës dhe, pale më pas, aprovimi i Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë,* (Më 14 mars 1946 Asambleja aprovoi Kushtetutën e RPSH dhe, pas kësaj, Asambleja u kthye në Kuvend Popullor si organi më i lartë i pushtetit shtetëror në RPSH.) përfundimisht vulosën fitoret historike të arritura dhe sanksionuan vullnetin e popullit e të Partisë sonë Komuniste për rrugën dhe fatet e ardhshme të Shqipërisë.

Procesi i organizimit politik të rendit të demokracisë popullore, si shtet i diktaturës së proletariatit, me shpalljen e Republikës dhe pranimin e Kushtetutës, u përkrye. Në duart tona, në duart e Partisë e të popullit, tash kishim gjithçka për ta vazhduar e për ta çuar më tej revolucionin socialist, për ta përsosur e për ta demokratizuar pareshtur pushtetin, për të çelikosur diktaturën e proletariatit, për ta bërë jetën e popullit gjithnjë e më të lumtur, më të sigurt, më të begatë, për ta ngritur lart e më lart nderin dhe prestigjin e Republikës sonë Popullore.

3. Kështjellë e pamposhtur

Kaluan vite e dekada nga ato ditë të paharruara dhe tash vendi ynë, Republika jonë Popullore (sot Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë), është forcuar pareshtur, lulëzon e rrezaton në çdo hap gëzimin, lumturinë dhe sigurinë e një jete të re e të bukur. Kjo është jeta e njerëzve të lirë nga çdo shtypje e shfrytëzim, jetë e njerëzve trima, atdhetarë e punëtorë të talentuar që me ndërgjegje të lartë, me vigjilencë, me vendosmëri e me përpjekje të pandërprera ia kanë ndërruar krejtësisht fytyrën Shqipërisë së dikurshme.

Mbi gërmadhat e kasollet e mjeruara që gjetëm më 29 Nëntor 1944, tash janë ngritur qytetet e fshatrat e reja nga çdo pikëpamje; mbi kovaçhanat e vogla është ngritur e forcohet pareshtur një industri e madhe, moderne e shumëdegëshe; mbi moçalishtet e bokërimat janë shtrirë fushat e sistemuara e pjellore; mbi prapambetjen e injorancën e qëmoçme kanë shpërthyer energjitë e pashtershme mendore e krijuese të një populli të tërë të arsimuar, të kulturuar e artist. Me Partinë në ballë, me forcat e bashkuara të një populli të tërë, Shqipëria jonë socialiste është bërë edhe kantier i madh prodhimi e krijimi, edhe kështjellë e pamposhtur e socializmit.

Natyrisht të gjitha këto janë arritur me luftë të madhe, me përpjekje e me sakrificat të gjithanshme e të pandërprera.

Rrugën ku do të ecnim nuk e gjetëm të shtruar me lule, pengesat, vështirësitë, mosdija, prapambetja e së kaluarës na shoqëruan në çdo hap. E sikur këto të ishin pak, në çdo hap na kërcënuan e bënë gjithçka për të na përmbysur armiqtë klasorë të brendshëm e të jashtëm, armiqtë e popujve, të përparimit e të socializmit. Ata i vriste çdo fuqizim e sukses yni, prandaj në kuzhinat e tyre, të vjetra e moderne, do të përgatitnin agresionet, shantazhet, kërcënimet, bllokadat. Por ne, vigjilentë e të patundur në rrugën tonë, do t'i pritnim të gjitha planet e demarshet e armiqtë me burrëri e gjakftohtësi dhe që të gjitha do t'i bënim pluhur e hi.

Qysh në momentet kur krijuam Republikën Popullore, kur kishim aq shumë halle e probleme për të zgjidhur, një rrezik i madh e kërcënoi të ardhmen dhe ekzistencën e vendit tonë. Titistët vunë në veprim gjithë forcat dhe mjetet e egra të shantazhit, të komplotit, bile edhe përgjitjet për ndërhyrje ushtarake, me qëllim që Republika Popullore e Shqipërisë të humbiste ekzistencën e vet e të kthehej në republikë të 7-të të Jugosllavisë. Se si ua dogjëm në duar synimet e planet e tyre të egra, këto prej kohësh i ka shkruar historia. NP qemë betuar ta çonim përpara Shqipërinë, ta bënim vend të lulëzuar e kala dhe Partia na kishte mësuar e na mësonte që vendimet e betimet të mos i shkehim kurrë, por t'i zbatonim e t'i mbronim edhe me jetël tonë. Dhe Shqipëria shpëtoi.

Fitorja që arritëm rdaj kompleteve e ndërhyrjeve të revizionistëve jugosllavë na i shtoi akoma më shumë forcat e vendosmërinë për të ecur vetëm përpara, në unitet me popullin, drejt konsolidimit e fitoreve të reja. E dinim mui se kjo që arritëm nuk ishte fitorja jonë e parë dhe e fundit. Ishim të përgatitur e vigjilentë për betejat të ljera më të ashpra në mbrojtje të Republikës sonë dhe të marksizëm-leninizmit. Imperialistët anglo-amerikanë e shovinistët fqinj, sa djallëzorë aq edhe

agrevivë e të paskrupullt në synimet e tyre antishqiptare, vunë në veprim të gjitha rrjetat e merimangave agjenturore. Në pëlhurën e tyre do të përpëliteshin ftdërrinat e reaksionit, banda diversantësh e kriminelësh do të hidheshin nga deti, qielli e toka për ta mbytur Republikën tonë, por të gjitha do të gjenin vdeljen nga vigjilenca e popullit dhe nga drejtësia e pashmangshme e diktaturës së proletariatit. Edhe më pas kori i armiqve nuk do të hiqte dorë nga synimet e veta imperialiste e shoviniste ndaj Shqipërisë, nuk do të Ante mend nga dështimet e turpshme, por do të intrigonte e do të komplotonte në kurriz të popullit shqiptar. Por edhe ne do t'u përgjigjeshim gjithmonë me forcën e pathyeshme që të jep vetëm e vërteta dhe e drejta marksiste-leniniste. Ata do të lehnin dhe do të hungëronin si qentë, karvani ynë do të çante vetëm përpara, Republika jonë do të çelikej pareshtur e do të fitonte çdo ditë e më shumë prestigjin e merituar ndërkombëtar.

Kështu, në mes rrethimesh e bllokadash, populli shqiptar do të ndërtonte bazat e socializmit, do të fuqizonte ekonominë, do të zburonte jetën e punonjësve, do të ngrinte vepra gjigante dhe për asnjë çast s'do të hiqte syrin nga shënjestra. Asnjëherë populli ynë, Partia jonë nuk do të gjendeshin, sikurse nuk u gjendën, të papërgatitur para situatave.

Vazhduam, pra, rrugën tonë të drejtë dhe nuk u tutëm e nuk lëvizëm as qimen e qerpikut para bllokadave dhe kërcënimeve të hrushovianëve, të cilët, në etjen e tyre prej superfuqie, donin ta kthenin edhe OmRepublikën tonë Popullore në një vend vasal, në pjesë të perandorisë ruse! Por kurrë s'kishin lindur burra që të gjunjëzonin shqiptarin, e ca më pak mund të ndodhte kjo në një kohë kur shqiptarët kishin në krye një Parti heroike, si Partia jonë e Punës dhe udhëhiqeshin nga një ideologji pararojë si ideologjia marksiste-leniniste. Hrushovi me kompani tundnin dafinat e thara të «bashkekzistencës paqësore», për të vënë në gjumë letargjik popujt dhe komunistët e vërtetë, ne iu përgjigjëm atij dhë pasuesve të tij duke e forcuar më tepër diktaturën e proletariatit, këtë shpatë të mprehtë të klasës punëtore, e cila do të binte e pamëshirshme mbi kokën e çdo armiku të brendshëm apo të jashtëm. Dhe kur panë se nga rrugët «indirekte», nga teorizimet, «këshillat» e «orientimet» e tyre kapitulluese ne nuk devijuam nga rruga jonë, hodhën në veprim presionet, kërcënimet, nëndetëset, urinë. Ua përplasëm në sy: bar do të hamë, por nuk do t'u nënshtrohemi as juve, askujt tjetër; do të mbetemi aty ku jemi - në brigjet e Adriatikut! Dhe vërtet këtu jemi e këtu do të jemi gjithmonë, të pamposhtur, të bindur në drejtësinë e rrugës sonë, krenarë për ato që kemi arritur dhe të vendosur për t'iu përgjigjur, siç e meriton, çdo armiku e çdo situatë.

Të 40 vjetët e pushtetit popullor na kanë bindur se asgjë nuk e gjen Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, përderisa popull e Parti janë të lidhur si mishi me kockën. Te kjo lidhje politike e ideologjike, më e pathyeshme se çdo lidhje që mund të ekzistojë në botë, e kanë bazën e shpjegimit e vet sukseset e rëndë qe kemi arritur në punën tonë paqësore e ndërtimore; aty e gjen forcën e saj fjala jonë me peshë dhe e pavarur në arenën ndërkombëtare; aty e kanë shpjegimin e vet guximi dhe trimëria jonë në mbrojtje të së vërtetës së atdheut, të popujve e të socializmit. Te ky unitet Partipopull, që i ka themelet prej gjaku e baruti, thyen kokën të gjithë ata që deshën të na përçanin e ta bënin Shqipërinë lesh arapi, çiflig të të huajve, që nga Koçi Xoxet e viteve të para e gjer te poliagjenti i të gjitha viteve e i të gjithë padronëve të huaj, Mehmet Shehu.

Duke ndërtuar e dulce mbrojtur, në ndeshje e vështirësi jemi kalitur e forcuar më tepër dhe kurrë nuk do të shkelim mbi ato që kemi bërë. Lart e më lart do ta ngremë begatinë, sigurinë dhe emrin e Republikës sonë Popullore Socialiste. Ndaj, në emër të gjakut e të mundit, të djersës e të privacioneve, le t'u transmetojmë brezave që do t'vijnë mesazhin e madh, të cilin na e mësoi historia: të jemi përherë vigjilentë, përherë në punë e në sulm për të mbrojtur dhe për të çuar më tej fitoret e arritura. Të mos lejojmë kërrkënd, kushdo qoftë ky, të shkelë dhe të mohojë veprën tonë të pavdekshme dhe të shenjtë, RepublikëD Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ta forcojmë, ta kalitim, ta zburuojmë e ta mbajmë lart si vetë idealin tonë. Kështu do të fuqizohet e do të ngrihet edhe më madhështore nga brezi në brez kështjella jonë, Shqipëria socialiste! Zemra jonë të rrahë gjithmonë me zemrën e saj të madhe.

E për këtë garancia më e madhe është uniteti i popullit rreth Partisë, janë mësimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, është Partia jonë, e cila lindi në gjirin e popullit për ta udhëhequr, atë vetëm në fitore.